Im I Dashur

I Dërguari i Allahut

(sallallahu alejhi ve selem)

PENCERELER
YAYINEVİ

Prof. Dr. Ramazan Ayvallı

MESXHIDI NEBEVIJ- MEDINËJA Qytëti i Ndritur



"Çdo Pejgamber (paqja dhe meshira e Allahut qoftë mbi to) sipas kohës dhe vëndit që ka jetuar, në çdo aspekt ka qënë me i ngritur dhe më i nderuar se shoqëria dhe populli i tij. Ndërsa Muhamedi alejhis-selam prej kohës kur është krijuar bota dhe deri në ditën kur do të ndodh kijameti është me i ngritur dhe me i nderuar se çdo krijese, çdo qënie dhe çdo njëri tjetër, pra në çdo aspekt dhe për të gjithe koherat dhe popujt ai është me i ngrituri dhe me i nderuari. Askush nuk mund të jetë me i ngritur se ai. Dhe ky supërioritet i Muhamedit a.s. nuk buron prej tij, por buron nga Ai i Cili ka krijuar gjithçka, çdo gje dhe kujdeset për to në menyre të përsosur. Pra supërioritëti i Muhamedit alejhi selam nuk buron nga vetja e tij por ky supërioritët atij i është dhenë nga Allahu, Krijuesi dhe Zoti i vetëm i gjithesise. Padiskutim që Allahu është i vetmi sundimtare dhe padiskutim që nuk eksizton as një force dhe asnjë fuqi njërezore që ta mposht Atë."

Sayyid Abdulhakim Arvasi
(Allahu qoftë i kenaqur prej ti)

profesor i rregullt në Medrese-tyl-mytëhassısîn'

Im I Dashur

I Dërguari i Allahut

(sallallahu alejhi ve selem)

Autori
Prof. Dr. Ramazan Ayvallı

Paraqitja e faqes - Dizajni grafik
İsmail Tuna

Kopërtina dhe vizatimet e hartave
Emir Okke

Redaktor- korrektues gjuhësor
Ercan Bozoglu

Botimi i parë: Maj 2025

ëëë.**mybelovedprophet**.com
info@**mybelovedprophet**.com

Botuar nga
Shtëpia botuese Cinar
Yuzyil Mah. Matbaacılar Cad. Atahan No: 34 shkalla: 5 Bag-
cilar / ISTANBUL
Tël: (0212) 628 96 00

Numri ccertifikatës: 12683

Për origjinalin
Tël: 0212 876 09 67
Gsm: 0536 399 95 31
ëëë.pencereleryayinevi.com
info@pencereleryayinevi.com

HYRJE

Falenderimi i përket Allahut, i cili krijoi çdo gjallesë, çdo qënie, çdo ekzistence, ju ruan vazhdimesinë dhe i ruan ata prej shqetësimit dhe frikës. Paqja, mëshira, shpëtimi, begatitë dhe miresitë e Allahut qofshin për me të mirin, me të ngriturin dhe me të nderiturin e njrezimit **Muhmmedin aeljhi selam.** Për atë që jetuan dhe panë fytyren e ndritur të tij, për familjen, të afermit dhe mbi mbare ata që i besoje atij deri në ditën e fundit të kesaj botë kalimtare.

Allahu me meshirën e përsosur të Tij ka krijuar për mbarë njërëzimin gjëra të dobishme dhe ka ndaluar ato gjera që janë të dëmshme. Dhe në botën e përtejme (ahiret) e ka ndaluar që besimtarët të mos i djek zjarri i xhehennëmit (ferrin), por me urtësinë dhe bukuritë e Tij për besimtaret ka krijuar xhennëtin (parajsen). Muhammedi a.s., njëri, i derguar dhe profet i Allahut është **më i nderuari i bijeve të Ademit a.s..** Padiskutim që besimtaret dhe ndjekesit e rruges se tij do jenë shembulli me i mire nder mbare popujt që nuk i besojnë dhe nuk e ndjekin rrugen e Muhamedit a.s..

Allahu na ka nderuar dhe na ka dhenë dhuratën me të bukur, që të jemi ndjekesit e ketij I Dërguari i Allahut. Në krahasim me bukuritë e kesaj dhuntie madheshtore sado ta falenderojme Allahun, përseri falenderimet tona mbetën të pamjaftueshme. Allahu ndritshmerinë e Muhamedit a.s. e ka krijuar para zanafilles se gjithçkaje. Ashtu sikur thuhet dhe në Kuran se; **"Ty (Muhammed a.s.) të kemi derguar meshire për mbare botërat (ekzistëncat)."** Dhe sikur thuhet në një hadith se **" Po të mos kisha krijuar ty, nuk do kisha krijuar anjë krijese tjetër"**. Rendësinë e Muhammedit a.s. e tregon vetë fakti që Allahu ka urdheruar mbarë njërezimin që ti besojë dhe ta ndjek atë. Pra Allahu xh. sh. që ti tregoj mbarë njërezimit se shembulli më ideal dhe më i mirë për gjithe koherat pa dallim rrace, ngjyre, gjuhe, kulture dhe etnicitëti e dërgoi Muhammedin a.s. Pejgamber të fundit.

Të duash të dashurit e Allahut xh. sh. (xheleshanuhu shanuhu) dhe të urresh armiqtë e Tij është kusht kryesor i besimit në Islam **(Hubb-i fillah ve buğd-ı fillah)**. Nëse besimtari nuk e ka ketë besim atëher çdo vepër e tij mbetët e dushimtë dhe vetë besimtari ka probleme me përceptimin e besimit të tij. Për ketë arsye të duash **"Shembullin supërior të njërezimit"**, të mbash në zemer harmoni për të dhe të mvishesh me petkun e moralit të tij është detyrim për cilindo që i beson atij. Për vazhdimesinë e kasaj harmonie me Muhammedin a.s. janë shkruar dhe do vazhdojnë të shkruhen sasira veprash. Edhe në po për hir të kasaj harmonie morem iniciativen për të shkruar ketë vepër që ju sugjerojme të jemi bashke përfitues se harmonise se Muhammedit a.s. Allahu qoftë i kenaqur me të gjithe kontribuesit për daljen në dritë të kasaj vepre modestë.

Allahu na beftë edhe në prej atyre që i kanë të mbushura zemrat e tyre me harmoninë dhe dashurinë për **Sulltanin e Universist, Muhammedin a.s.** dhe na beftë prej pasueseve të dijetareve (dijetaret e ehli-sunnëtit) që ndjekin rrugen e Muhamedit a.s. Âmîn.

Dr. Enver Ören

QABEJA MADHESHTORE
DHE MESXHI I HAREMIT MEKKA



PARATHENIE

Falenderimet i përkasin Allahut xh.sh. për miresitë, begatëti dhe gjithe dhuntitë që Ai na dhuron… Paqja, meshira, shpetimi, begatitë dhe miresitë e Allahut qofshin për me të mirin, me të ngriturin dhe me të nderiturin e njrezimit Muhmmedin alejhi selam për at që jetuan dhe panë fytyren endritur të tij, për familjen, të afermit dhe mbi mbare ata që i besoje atij deri në ditën e fundit të kesaj botë kalimtare.

Morali i lartë është ai që e zbukuron, e ben të dashur, e nderon, e privilegjon dhe e ndriçon njëriun. Moralin nuk e zevendeson as pasuria, as fama, as pushtëti dhe as ndonjë privilegj tjetër ekzistues. O me i nderuari i Pejgambereve, o me miri, me i bekuari, me i ngituri, me i mbari, o i nderuari Pejgamber, burim i privilegjitëtit të njërezimit nuk pretëndojme të ngrejme ty me levdatat tona sepse ti je i ngritur dhe lavderuar prej Atij që të dergoi si meshire për mbare njërezimin, por pretëndojme se ndjehemi të privilegjuar kur shkrujme për ty.

O i Derguari i Allahut, nuk kemi fuqi për të lavderuar

Jemi të vetëdijshem që për hatër tënd jemi krijuar.

Muhammedi a.s. është i derguari i Allahut. Prej bijve të Ademit a.s. ai është me i nderuari. Ditën e gjykimit vetëm ata që janë pasues të tij do jenë prej të shpetuarve nga zjarri i xhehennëmit (denimit të ferrit). Ditën e Gjykimit ai do të ngrihet i pari prej varrit. Atij do ti pranohet të parit ndermjetësimi. Ai do të trokas i pari në deren e xhennëtit dhe dera atij do ti hapet e para. Ditën e gjykimit në doren tënde do të jetë flamuri i quajtur "**Livâ-i hamd**'' (flamuri i levdatave). Dhe të gjithe besimtaret prej Ademit a.s. deri në Ditën e Gjykimit do të mblidhen poshtë hijes se ketij flamuri.

Muhammedi a.s. thotë në një hadith se; **'' Ditën e gjykimit do të jem me i nderuar se para dhe pasardhesit e mij.''** Dhe në një tjetër hadith thotë se; **'' unë jam me i aferti dhe me dashuri i Allahut. Prijesi i Pejgambereve. Dhe nuk e them ketë për tu lavderuar.''**

Në shumicen prej librave të shkruajtur për lindjen e I Dërguari i Allahutt Muhammed thuhet se prinderit e tij ishin prej njërezve të pastër. Në transmetimet e Buhariut, i cili është nder burimet me të aplikuara pas Kuranit, thuhet se I Dërguari i Allahut a.s. ka thenë **'' jam me i miri, me i privilegjuari dhe me i begatari i mbare njërezimit dhe i të gjithe koherave.''** Dhe nder transmetime tjera ai a.s. thotë se; **'' Unë Muhammedi i biri i Abdullahut, jam profet dhe i Derguari Fundit. Pas meje nuk do ketë me të derguar prej Allahut xh.sh.. Allahu me ka krijuar përj njërezve me të mire. Ai i ndau njërezit në fise dhe me dalloi mua prej tyre. Pastaj i ndau fiset në etnicitëtë dhe prej tyre me ka dalluar mua. Pastaj i ndau në komunitëtë dhe komunitëtët në familje dhe mua me lindi prej familjes me të mire dhe me beri prej njërezve me të dalluar. Ditën e Gjykimit, atë ditë kur të gjithe njërezit do të heshtin unë do të jem i pari që do të flas dhe do kem të drejtën e ndermjetësimit për të gjithe ata që me kanë besuar dhe pasuar mua. Atë ditë kur të gjithe i kanë humbur shpresat unë do ti jem ndermjetësuesi i përgezimeve. Atë dita çdo e mire, çdo ndihme, dhe çdo çeles i çdo dere se bashku me flamurin "Livâ-i hamd'' (flamuri i levdatave) do të jenë në duart e mia. Pra ditën e gjykimit unë do të jem me prijesi i pejgambereve dhe i mbare njërezimit, do të jem ndermjetësuesi dhe lajmeruesi i të vertëtës. Dhe unë nuk i them keto për tu lavderuar por i them se kjo është detyra që jam ngarkuar prej Krijuesit të Gjithesise.**

Allahu, Zoti i gjithsise e krijoi atë (Muhammedin) a.s. me moralin me të lartë dhe e ngriti atë mbi gjithe krijesat. Madje e krijoi dhe e ngriti me lart se Âdemi a.s. i cili është babai i njërezimit. Pra edhe kur Âdemi a.s. ishtë uje e dhe Allahu e krijoi nurin (shpirtin) e Muhamedit a.s. mbi gjithe njërezimin. Ndaj dhe thuhet se për hatër të tij janë krijuar të gjitha gjallesat. Natyrisht që Muhammedi a.s. i ngrituri me moral dhe pastërti të lartë është me i dashur të Allahu se gjithçka tjetër dhe kush e dashuron atë (Muhammedin a.s.) padiskutim që Allahu atij ja ndrit zemren dhe e mvesh atë me petkun e moralit të Muhammedit a.s., Sepse është ligj i Allahut që aty ku shihen vetitë e Muhammedit a.s. aty leshohet meshira, bukuritë dhe ndritshmeria e tij. Pra, kush ndjek parimet, rrugen, moralin dhe udhezimet e Muhammedit a.s. padiskutim që ai është ummeti (komunitëti) me i mire, me i nderuar dhe me i ndritur se çfar do komunitëti tjetër. Ketë e vertëton Kur'anit në suren Al-i Imran në ajetin e 110'të ku thuhet se **''Je jeni populli më i dobishëm, i ardhur për të mirën e njërëzve...!''**. Ndersa ata që nuk e pranojnë, nuk i besojnë, nuk e vleresojnë dhe nuk e ndjekin atë (Muhammedin a.s.) ata janë njërezit me të urryer. Ketë na tregojnë edhe kuptimet e ajtëve 97-98'të të sures Et-Tëube **'' ty o (Muhammed a.s.) nuk të besojnë ata që i kanë zemrat e ngurta, injorantët dhe veçanërisht mynafiket (dyfytyreshit).''** Në ketë gjendjen që ndodhet bota sot, besuesit dhe pasuesit e Muhammedit a.s. janë me të nderuarit, me inferioret e njërezimit.

Allhu në kaptinën An-Nisa ajeti i 80'të thotë se; **''Kush i bindet I Dërguari i Allahutt, ai i është bindur All-llahut...''** dhe në kuptimin e ajetit 7 në kaptinën Al-Hashr thuhet se **'' Merreni atë që ju jep i Derguari i Allahut dhe largohuni prej atyre gjerave që ai ju ndalon'',** dhe ky është një nder ajetët që urdheron për të ju bindur ligjeve islame (Kur'anit dhe Sunnëtit). Ndersa në kaptinën El-Kelam në ajetin 4 Allahu thotë se; **''Sigurisht, ti (Muhammed a.s.) qëndron mbi morale madhore.''** Si dhe në kaptinën El-Ahzab në ajetin 21 **'' Sigurisht, për ju në të Dërguarin e Allahut ka një model të shkëlqyer...''**

Pa dyshim që Allau duke në bere edhe në prej pjesetareve të ummetit (komunitëtit) të Muhammedit a.s. na ka dhenë dhuntitë dhe miresitë me të çmueshme. Dhe sodo falenderues ti jemi Allahut xh. sh. për keto miresi madheshtore që n aka dhenë falenderimet tona prap do të janë të pa mjaftueshme.

Kjo vepër që ndodhet në duart tuaja është përgatitur për të njohur Muhammedin a.s., udherrefyesin e njërezimit, jetën shembullore të tij, moralin e lartë, mrekullitë dhe uretësitë e tij, si dhe rendesia që kap asimi i tij që të përfitohet nga miresitë e kasaj botë dhe botës tjetër.

Nëse deshirojme të jemi nder njërezit me të dobishem për vetët, familjet, kombin dhe mbare njërezimin rruga e vetëm është të pasuarit e Muhammedit a.s., ta pasojme atë që të përfitojme prej miresive të kesaj botë dhe botës tjetër.

Allahu na beftë ne prej pasueseve të Dërguarit të Allahutt tonë të dashur Muhammedit a.s., na i mbushtë zemrat tona me dritën dhe urtësitë etij si dhe na beftë në prej dijetareve të ehlisunnëtit (pasuseve të Kur'anit dhe Sunnëtit). Âmîn!

Prof. Dr. Ramazan Ayvallı

KAPITULLI I PARE

Gadishulli Arabik (Shekulli i 6'të pas eres sonë)

Essalâtu vassâmu alejke, o i Dërguar i Allahut!

Essalâtu vassâmu alejke, o i Dashuri i Allahut!

Essalâtu vassâmu alejke, ja Sayyidel-evvelînë vel-âhirîn

SULTANI I UNİVERSİT I DËRGUARİ İ ALLAHUT YNË

Muhammed alejhi selam; i derguari, i dashuri dhe njëri sikur njërezit e tjere të Allahut xheleshanuhu, ai është me i miri, me ngrituri dhe me i nderituri i njrezimit. Allahu xh. sh. atë e ngriti mbi të gjithe pejgamberet e tjere, e dergoi si pejgambere të fundit për mbare njërezit dhe xhindet.

"Po te mos kisha krijuar ty, Po te mos kisha krijuar ty Nuk do te ishte krijaur as nje gjallese."
Hadith Kudsij

Ai (Muhammedi a.s.) është derguar si meshire për mbare botërat dhe është me i nderuari i universit. Kuptimi i emrit **Muhammed** është i lavderuari, falenderuesi dhe i nderuari. ai është përmendur dhe me emrat të tjetër të nderuar sikur janë **Mahmud, Mustafa** dhe **Ahmet**. Babai i tij quhet **Abdullah**, ndersa sipas historianëve datëlindja e tij i përket datës **20 Prill të vitt 571** dhe sipas kalendarit henor 51 vitë para shpalljes se ketij kalendari. (**në ditën e 12 të muajit Rebîu'l-evvel në vitin 51 para kalendarit henore**).

I ati i nderroi jatë pak muaj para lindjes se tij, ndersa e ema i nderroi jetë kur ai ishtë në moshen 6 vjeçare. Për ketë arsye ai është quajtur edhe me nofken **"Durr-i Jetim** (Përla e vetme, më e madhe dhe më e çmuar në univers, nëna e përlës)". Deri në moshen 8 vjeçare ai qëndroi pranë gjyshit të tij **Abdulmuttalib**, por me vdekjen e ketij të fundit për të u kujdes xhaxhai i tij **Ebu Talibi**. Në moshen 25 vjeçare u martua me nënën e ummetit të nderuaren **Hatixhe r.a**. (radijallahu anha). Në kulturen arabe është traditë që prinderit të thirren me emrin e djalit të pare për ketë arsye Muhammedi a.s. është quajtur **Ebul Kasım "Babai i Kasemit**".

Kur ai ishtë në moshen 40 vjeçare Allahu i solli shpalljen dhe e dergoi atë Pejgamber i mabre njërezimit dhe xhinëve. Tre vite pas shpalljes ai filloi ti thërriste njërëzit hapur që të besonin në fenë Islame. Në moshen 52 vjeçare ai u dekorua me ngjarjen e Miraxhit (udhetimi i tij brenda natës nga Meka në Kudus dhe nga Kudusi në qiell). Në vitin 622 të eres sonë kur ai ishte ne moshen 53 (51.m) vjeçare u detyrua të shpërngulej nga Mekkes (qytëtit të lindjen) për në Medinë që atë kohe quhej Jesrib. Gjatë jetës se tij ai ka marrë pjese në 27 luftëra, në 9 prej tyre ishtë ushtare ndersa në 18 të tjera ai ishtë në postin e kryekomandantit të luftës. Kur ishtë në moshen **61 vjeçare të viti 632 sipas eres sonë dhe në moshen 63 vjeçare sipas kalendarit henore (e henë 12 të muajit Rebîu'l-evvel 11 H. sipas kalendarit henore)** në Qytëtin e Ndritur të Medinës pak para kohes se drekes nderroi jetë. Allahu pejgamberet para Muhammedit a.s. i ka thirrur në emer ndersa Muhammedin a.s. e ka thirru Habibi (I dashur). Ndersa në një ajet Kur'ani Allahu thotë **"Të kemi derguar meshire për gjithe botërat"**[1] dhe në një hadith kudsij thuhet se **"po të mos kishim krijuar ty o Muhammed nuk do kishim krijuar as krijesat e tjere."**[2]

Një nder dijetaret e shquar i bekuari Abdylhakîm-i Arvâsî në komentët e tije thotë se; " çdo Pjegamber në kohen, vendin dhe popullin e tij, në të gjitha aspektët ishtë i ngritur dhe inderuar. Ndersa Muhammedi a.s. prej zanafilles se universitë deri në Ditën e Gjykimit është me i ngrituri dhe i nderuari i universit, pa dallim kohe, vendi, gjyhe, kulture dhe populli. Keshtu ka dashur Allahu ta krijoi atë (Muhammedin a.s.).

[1] En-bija, ajeti 107.
[2] Syyûtî, Leâli'l-Masnûa, I, 272; Aclûnî, Kesf-yl-hafâ, II, 164.

Krijimi i Dritës (Nurit) të Bekuar

"Drita jote e Pejgamberllekut (o Muhammed a.s.) u transferua nepër ballerat që i binin ne sexhde (i përuleshin) Allahut dhe ne fund u transferua tek ti."
Shura 29/219

Allahu para se të krijontë gjithesinë krijoi Nurin (dritën) e I Dërguari i Allahutt tonë të dashur Muhammedit a.s.. Shumica e dijetarve të tëfsirit (komentuesit e Kur'anit) dhe hadithit (studjuesitë fjaleve, veprave dhe qëndrimeve të Muhammedit a.s) kanë thenë se; Allahu prej dritës se Tij kriji një një xevher (grimce) sa të madh aq edhe të bukur dhe prej kesaj grimce madheshtore aq të bukur krijoi mbare universin. Dijetaret ketë grimce Nuri (dritë) e kanë quajtur ''Nuri (Drita) e Muhammedit a.s''. ''Dhe kjo është quajtur si pika fillestare e mbare trupave dhe shpirtërave, mbare universit''.

Një ditë njëri prej shokeve të Muhammedit a.s. i quajtur Cebir bin Abdullah e pyeti atë se cila ishtë pika fillestare e universit dhe ai i përgjigjet se; **''Allahu para se të krijos fjalen (të folurit), të shkruarit, xhennëtin, xhehennëmin, engjejt, qiejt, token dhe gjithe krijesat e tjera prej dritës se Tij krijoi dritën e I Dërguari i Allahutt tënd.''**

Kur u krijua zemra dhe trupi i nderuar i Ademit aljhi selam, thuhet se Nuri i Muhammedit a.s. ju vendos në balle (Nuri i Pejgamberllekut). Dhe kur ju vendos shpirti Ademit a.s. ai vuri re se në balle kishtë një nur që ndristë si një yll i vertëtë.

Në veprat e Ibn Askairit është transmetuar se kur e krijoi Allahu xh.sh. Âdemin a.s. e thirre atë me emrin Ebu Muhammed, ndersa Ademi a.s. e pyet; O Zoti im përse me thirre me emrin Ebu Muhammed (Babai i Muhammedit a.s.)? Atëher Allahu e urdheroi Ademin a.s. të ngrintë koken dhe të shihtë në arshin (frontin) e Allahut xh. sh. dhe kur Âdemi a.s. ngriti koken pa të shkruar nën të Nurin (dritën I Dërguari i Allahutke) e Muhammedit a.s. dhe e pyeti Allahun se kush ishtë ky? Allahu ju përgjigj se ai ishtë një nder bijet, pasardhesit e Ademit a.s. i cili në qiiej do të thirrej Ahmet ndersa në toke do të thirrej Muhammed a.s.. Dhe Allahu i thotë Ademit a.s. se pe ratë i ka krijuar qiejt edhe token por edhe vetë Ademin a.s[3]..

Kalimi I Nurit (Dritës I Dërguari i Allahutke) Nga Një Balle I Ndritur Të Tjetri

Që kur u krijua Ademi a.s. në ballin e tij u vendos Nuri i Pejgamberrllikut të Muhamedit alejhi selam. Dhe ai nur (ajo dirtë) vazhdo të ndriçoi në ballin e Ademit a.s. dhe me pas të pasardhesit e ndritur të tij deri të Muhammedi a.s. me të cilin ajo dritë u shua dhe në vend të saj mbeti Kur'ani dhe Sunnëti i Muhamed Mustafait aalejhi selam. Në **Tëfisirin e Mazharit** thuhet se; ''Prej Ademit alejhi selam deri të Muhammedi alejhi selam Nuri i Pejgamberllekut u tansmetua nëpër pasardheti e pastër të Ademit a.s.'' Ndersa Allahu në Kur'an, kuptimi i sures Shura ajeti 219 thotë se;

"Drita jotë e Pejgamberllekut (o Muhammed a.s.) u transferua nëpër ballerat që i binin në sexhde (i përuleshin) Allahut dhe në fund u transferua tëk ti''[4]. (Shura 29/219)

Ndersa në një hadith Muhammedi a.s. thotë se; **'' Allahu është Krijues i mbare njërezimit, edhe unë sikur të gjithe njërezit e tjere jam njëri dhe krijese e Allahut. Ai me përzgjodhi prej familjes dhe popullit me të mire. Ndaj shpirti**

[3] Ibni Asâkir, Tarih-i Dımesk, VII, 437; Heysemî, Mecma'udh-dhevâid, VIII, Sem-seddin Sâmî, Sybyly'l-Hydâ, I, 85.
[4] Shu'arâ: 26/219; Tam İlmihâl Saadet-i ebedijje, 387.

dhe trupi im është prej krijesave të pastërta. Edhe paraardhesit dhe trungu im familjar është prej me të mireve."

Ndersa në një hadith tjetër Muhammedi a.s. thotë se; **"Allahu xh.sh. e krije çdo gje prej hiç gjeje, dhe i përzgjodhi, i vleresoi dhe i ngriti njërezit mbi çdo gje tjetër, mbi mbare njërezit përzgjodhi arabet, prej arabeve përzgjodhi kurejshitët dhe prej tyre me përzgjodhi mua. Kush i hap, kush i sulmon dhe kush i nënçmon i nënçmon njëkesit e mi atëher me ka hapur luftë, sulmuar dhe nënçmuar mua."**

Kur Zoti Ademin krijoi
Botën me të zbukuroi

Urdheroi melaiket ti përulen Ademit
Dhe atij i fali urtësitë e xhymertit

Nurin e Mustafait në balle ja vuri
Dije i tha se ky nur është i të Dashurit

E fali në ballin e tije dritën e Nurit
Të cilen e sollen ererat të I Dërguari i Allahut i fundit

Pastaj e transmetoj në ballin e Havase
Qëndroj në të vitë, muaj dhe jave

Lindi Siti, në ballin e tij u vendos ky Nur
Në ballin e tij gjatë priti ai Nur

Prej Ibrahim të Ismaili nisi e trashegoi
Nëse i radhisim të gjitha zgjatët përroi

Dhe keshtu rruge të gjata ai përshkroi
Gjer sa të Mustafai ai Nur Përfundoi

Erdhi të ai që botërave meshire ju dergua
Erdhe të ai që i fundit pejgamber u urdherua

Kushdo prej tij pret shefat
N'dashni e N'hall ti bjere n'salavat.

Kur u krijua njëriu i pare Ademi a.s. Nuri i Muhammedit (Pejgamberllekut) a.s. u vendos në ballin e tij. Pas vdekjes se Ademit a.s. nuri u trasnmetua të Havaja nëna e gjithe njërzimit dhe me pas të biri i saj Shiti a.s. (I Dërguari i Allahut i pare pas Ademit a.s.) dhe keshtu vazhdoi të transmetohet brez pas brezi nga nënat e pastërta të Pejgambereve për të bijet e tyre Pejgamberanë dhe deri sa arriti të i derguari i Fundit Muhammedi a.s..

Sa here e shihnin Engjejt Ademin alejhi selam në ballin e tij shihnin dritën e Muhammedit a.s. (drita Pejgamberanë) dhe ata (engjejt) i lutëshin për të (Ademin a.s.). dhe kur ketij të fundit ju afrua vdekja ai e porositi të birin e tij Shitin a.s. duke i thenë; **'' o bir përcillja ketë dritë nënave dhe pororsiti bejet e tyre se kjo dritë është drita e I Dërguari i Allahutt të fundit Muhammedit a.s. dhe keshtu ata ti porosisin bijtë e tyre gjer sa të arrij atje ku ka vendtakimin e fundit (të Muhammedi a.s.).''**

Deri në kohen kur u dergua Muhammedi a.s. të gjithe baballaret (Pejgamberet paraardhes) keshtu i porositën bijtë e tyre (Pejgambere). Të gjithe e kryen ketë porosi me priçizitët dhe u martuan me vejusha të pastërta. Dhe keshtu ky nur bres pas brezi arritë de adresa e fundit që ishtë Muhammedi a.s.. Sado që gjysheritë Muhammedit a.s. u ndanë në fise nuri i tij u transmetua të djemtë me të zgjuar, të mprehtë dhe me të dobishmit e kohes. Kushdo që e trashegoi atë nur ai u lartësua se bashku me familjen dhe trungun e tij dhe të gjithe keto trashegues me nder dhe me supërioritët dalloheshin prej fiseve dhe popujve të tjere[5].

Se fundimi I Dërguari i Allahut a.s. në një hadith thotë se; **''Asnjëri prej etërve të mi nuk ka bere zina (nuk ka kryer marredhenie ilegale), Allahu mua me krijoi prej nënave dhe baballareve të pastër dhe të ndershem. Nëse gjysherit e mi do të kishin nga dy djem padiskutim që me i miri prej tyre do të isha unë.''**

Përj Ademit a.s. nuri kaloi nge etërtit të bijet, prej Taruhu të İbrahimi a.s. dhe prej İbrahimit a.s. të Ismaili a.s. dhe prej Ismailit të Adnani, prej tij të Nadhari. Kur ky i fundit lindi babai i tij Meadi vuri re të ai një hijeshi të ndritur dh epër të organizoi një gosti speciale. Kur u pyet nga të afermit për arsyet e gostise ai u përgjigj se; **''për një djal të tille kjo gosti është gjeja me e vogel'', dhe për ketë emrin e të birit e vendosi Nadhar, kuptimi i të cilit është gje e vogel. Dhe keshtu u transmetua Nuri i profetësise nga njëri të tjetri gjer sa arriti të me i larti i Profetëve Muhammedi a.s., pra deri sa arriti të Hâtëm-ul-Enbiyâ (vula e Pejgambereve/I Dërguari i Allahut i fundit).''**

Në një tjetër hadith I Dërguari i Allahut a.s. thotë se; **" unë jam Muhammedi i biri Abdullahut, ai i biri i Abdulmuttalibit dhe në vazhdimsi vargu i gjysherve Hâshim (Amr), Abd-u Menâf (Mugîre), Kusajj (Zejd), Kilâb, Murre, Ka'b, Luvejj, Gâlib, Fihr, Mâlik, Nadr, Kinânë, Huzeyme, Mudrike (Âmir), Iljâs, Mudar, Nidhâr, Me'âdd, Adnan... Dhe sa here etërit e mi ndahesh në dy padiskutim që Allahu mua me beri të jem prej me të mireve prej tyre.''[6]**

Në një tjetër hadith ai a.s. thotë se; ''Allahu prej bijeve të Ibrahimit a.s. zgjodhi Ismailin a.s. dhe pre bijeve të Ismailit as. zgjodhi bijtë e Kenanit, prej bijeve të ketij zgjodhi Kurejshitët dhe prej tyre zgjodhi Hashimitët. Prej ketyre të fudnit zgjodhi bijtë e Abdulmutalibit prej të cileve me zgjodhi mua.''[7]

[5] Kâdî Ijâd, Shifâ-i Sherîf, 82.
[6] Ibni Sa'd, Tabakât, I, 55-56.
[7] Ibni Sa'd, Tabakât, I, 20; Hanbel, Musned, 4, 107; Tirmidhî, Sunen, 5, 583.

Trungu familjar i Muhammedit a.s. prej Adnanit dhe deri të I Dërguari i Allahut Muhammed a.s.

Muhammed alejhisselâm
Abdullah Abdulmuttalib (Seybe)
Hâshim (Amr)
Abd-u Menâf (Mugîre)
Kusajj (Zejd)
Kilâb
Murre
Ka'b
Lujejj
Gâlib
Fihr
Mâlik
Nadr
Kinânë
Hudhejme
Mudrike (Âmir)
Iljâs
Mudar
Nidhâr
Me'âdd
Adnân

Gjyshi i Muhammedit a.s., Abdulmuttalib'i

"O bir përcillja kete drite nenave dhe pororsiti bejet e tyre se kjo drite eshte drita e I Dërguari i Allahutt te fundit Muhammedit a.s. dhe keshtu ata ti porosisin bijte e tyre gjer sa te arrij atje ku ka vendtakimin e fundit (te Muhammedi a.s.)."
Ademi a.s.

I Dërguari i Allahut a.s. ynë i dashur i përket fisit të Kurejshitëve të cilet i përkasin fisit të bijve të Hshimit. I **ati quhej Abdullah** ndersa i ati i ketij, njëkohesisht **gjyshi i Muhammedit a.s. quhej Shejbe** i cili ka lindur në qytëtinë Medinas. **Shejbes i ati, Hashimi** vdiq kur ai ishtë ende i vogel. Një ditë kur Shejbe po luantë me shoket e tij të pranishmit vunë re një hijeshi të ai që dallohej se vjen nga një trung i dalluar familjar. Dhe kur ai leshoi shigjetën në shenjëstër therriti nga gezimi **''unë jam i biri i Hashimit, patjetër që shigjeta do e gjej epiqëndren në shenjëstër''.** Atëher të pranishmit e kuptuan se ai nuk ishtë vendali por vintë nga një fisi i dalluar që jetontë në Mekke. Por ketë kohe Mekkasi Hashim, babai i Shejbes kishtë nderruar jetë.

Kur njëri prej fisit të bijve të Menafit arriti në Mekke u prezantua me vellain e Hashimit Mutalibin të cilit i tha; **'' ju keni një nip, i biri i Hashimit, djali i vellait tuaj, ai është një femij i zgjuar dhe kan je hijshmeri që dallohet nga të tjeret. Su mundet një femije të tille ta lini në rruget e Medinas?''** Pasi degjoi keto fjale Mutalibi u nis për në medini dhe e mori nipin e tij për në Mekke, por në hyrje të qytëtit atë e pyetën se **kush ishtë i riu** që shoqërohej me të. **''është skllavi im''** ju

përgjigj Mutalibi. Pas ketij prezantimi emri i **Shejbes në Mekke u shnderrua në Abdulmutalib** që do të thotë sklavi i Mutalibit[8].

Deri në kohen kur xhaxhai i nderroi jetë Abdulmutalipi qëndroi pranë tij. Hijshmeria dhe bujaria e Abdulmutalbit kish lenë mbresa të Mekkasit e asaj kohe. Por ata nuk e dinin se prej trungut të tij do të linde drita e njërzimit, vula e pejgambereve Muhammedi a.s.. sa here Mekkasit hasnin në probleme madhore ose kur thatësira zgjastë me shume se duheja ata vinin të Abdulmutalibi kur kerkonin prej tij të ju zgjidh hallet, madje në thatësira të gjata kerkonin prej tij që të nxirrtë popullin në kodren e Mekkas të lutëshin që Allahu të ju jeptë shiun. Mekkasit me pare kishin venë re se sa here kishtë thatësira të gjata dhe kur dilnin të lutëhsin për renien e shiut, traditë kjo e trasheguar prej kohesh në popullian e asaj kohe në Mekke që me pas e trashegoi dhe Muhammedit a.s., kur lutëj Abdulmutalibi pas një kohe të shkurtër mbi tokat e Mekkas Allahu leshontë shiun. Dhe që prej atyre koherave Abdulmutalibi ishtë me i nderuari dhe me i respektuari i popullit të Mekkas. Madje Mekkasit atë e zgjodhen të parin e tyre, nuk i benin dyshe urdherat e tij dhe kush jetontë nën besen e tij ai ishtë i sigurtë dhe i qëtë në Mekka. Edhe prijesit e tjere e njihnin autoritëtinë Abdulmutalibit dhe nuk i kunderviheshin atij, me përjashtim të Kisras, mbretit të Përsise se asaj kohe i cili në menyre të hapur dhe të fshehur mbilltë armiqsi ndaj Abdulmutalibit.

Thuhet se Abdulmutalibi i përkistë besimit të pastër të trashguar nga Ibrahimi a.s[9]. që atë kohe njërezit me besim të pastër quheshin ''hanif''. Pra besonin se Allahu është një dhe nuk ka shok e ortak tjetër në njëshmerinë dhe pushtëtin e Tij absolut. Për ketë arsye thuhet se Abdulmutalibi nuk i dontë dhe nuk ju afrohej idhujve në Mekka, ai i kryentë ritët fetare sipas menyres se tij pa ju afryar aspak idhujve.

Zemzemi

"Zemzemi është ushqim për të uriturin dhe shërim për të sëmurin."
Hadith

Është transmetuar nga burimet e të pareve tanë se Abdulmutalibi prej kohesh shihtë enderra të ndryshme por që kishin të njëjtin kuptim. Në anderr ati i vintë një njëri i cili i thoshtë **"çohu Abdulmutalib germoje Tajjibin"**, një natë tjetër i kishtë ardhur duke i thenë "**çohu Abdulmutalib gerrmoje Berren"**, ndersa një here tjetër **"gerrmoje Mednunën"** dhe heren e fundit i njëjti përson i vjen në enderr dhe i thotë **"çohu Abdulmutalib gerrmoje zemzemin".** Dhe kur Abdulmatilibi e kishtë pyetur se kush është zemzemi? Njëriu enderr ju kishtë përgjigjur se; **"zemsemi është uji i cili buroi me urdher të Allahut që urdheroi engjellin Xhebrail të përplastë krahet në toke atëher kur Ibrahimi a.s. e kishtë lenë të birin vetëm me të emen në shkretëtiren e Mekkes. Burimi i ketij uji nuk shtëron, me të janë begatuar haxhileret që vijnë nga e gjithe bota për të vizituar Qabenë e shenjtë. Fundi i burimit nuk dihet dhe uji i zemzemit është sherim për çdo semundje që mund ta kaploi njëriun. Pra zemzemi ju heq eyjen të eturve, urinë të uriturve dhe semundjen të semureve. Ai ndodhet në vendin ku hidhen mbeturinatë kurbanëve që theren në Mekka, kur të shkosh atje në atë vend do gjesh një vatër mizash, aty do e gjenin vendndodhjen e zemzemit.''**[10]

[8] Ibni Sa'd, Tabakât, I, 82.
[9] "Ibrahimi nuk ishte as jehudi e as i krishterë, por ai ishte vetëm musliman Hanifan (me besim të vërtetë e të pastër Islam vetëm në Allahun Një e të Vetëm) dhe nuk ishte prej Mushrikëve (prej idhujtarëve)." [Âl-i imrân: 3/67]
[10] Ibni Ishâk, Sîret-i Resûl, 2-5; Ibni Hishâm, Sîret, I, 143; Ibni Sa'd, Tabakât, I, 83-84.

Pusi i zemzemit me pare ishte brenda territorit te Haremit, ekzaktesisht përballe Hxheri-Esved (guri i piknisjes se ritit te tavafit ne Qabe). Ne gryke kishte nje rreth prej guri, shtresa ishte prej mermeri dhe vashdonte rreth myrit. Ne kohene sulltan Abduulhamidit te Pare pusi ishte ndertuar ne ate menyre që nga jasht te mos hynte uje brenda tij.

Kjo trashgimeri e çmuar historike, dhe kjo vepër e paçmuar arti u shkaterrua ne vitin 19963 dhe u zhvendos disa metra poshte tokes. Me pas pjesen sipërfaqësore e mbuluan me mermer dhe aktualisht pusi i zemzemit eshte krejt i padukur (i mbuluar me mermer).

Në mengjes Abdulmutalibi se bashku me të birin Harisin, dolen në Mekka dhe filluan të kerkojnë për gjurmet e zemzemit. Pas një kerkimi të gjatë ata gjetën vatren e mizave dhe Abdulmutalibi urdheroi të birin që të germonin vendin ku ndodhej vatra e mizave. Dhe pasi germuan një pjese të tokes doli në shesh gryka e pusit të zemzemit, me të pare Abdulmutalbi gryken e pusit nisi të therras përj gezimit **''Allahu Ekber, Allahu Ekber (Allahu është me i madhi)!''**

Të pranishmit Mekkas edhe pse me pare nuk e kishin besuar enderren e Abdulmutalibit kur vunë re gryken e pusit i thanë atij se ''ky është pusi i gjyshit Ismai a.s. dhe prej tij kemi edhe në pjesen tonë, ndaj edhe në do jeme ortaket tuaj në këtë pus'' por Abdulmutalibi ju doli kunder duke ju thenë se ''**kjo është një urtësi që me është dhuruar mua''** atëher Mekkasit i thanë se; **''ti je i vetëm, nga pas ke vetëm djalin tënd dhe nuk ke fuqi të mjaftueshme për tu përballur me në!'',**

Pas ketij reagimi të Mekkasve Abdulmutualibi u thye shume sepse po përballej me një qëndrese që nuk kishtë fuqi ta mposhtë. Ai ndriti duart nga qielli dhe ju **''lut Zotit që nëse me jep 10 djem njërin prej tyre të e bej kurban në Qabe.''**[11]

Pas kesaj gjendje të krijuar nga mekasit ai vuri re se puna po merrtë një drejtim dyluftimi ndermjet tij dhe mekkasve, atëhere ai ndaloi se germuari pusin dhe zgjodhi rrugen e dialogut. Por ai ju kerkoi mekkasve që dialogun ndermjet tyre ta drejtontë një ndermjetës. Pas shume debatësh ranë dakort se një falletare që banontë në qytëtin e Shamit (Siria e sotme) mund të ndermjetësontë për zgjidhjen e kesaj mosmarreveshjeje. Me të renë në dakortësi një grup përj kurejshitëve u nisen drejt Shamit por gjatë udhetimit nëpër rruget e shkretëtires arabe ata i kaploi një etje e madhe. Kerkuan rreth e rrotull se mos hasin me ndonjë burim por në atë vend ishtë i pa mundur të gjendja e ndonjë burimi uji. Tahme ata ishin në gjendje të jepnin dhe jetën për një pike uje, por në atë shkretëtire të thatë ekzistënca e ujit ishtë e pa mundur.

[11] Ibni Hishâm, Sîret, I, 144-145; Ibni Sa'd, Tabakât, I, 88; Taberî, Târih I, 128.

Nderkohe që shpresat pothuajse ishin shuar, degjojnë zerinë e Abdulmutalibit i cili therristë **''Ejani, ejani, mblidhuni ketu! Sepse gjeta uje të mjaftueshem edhe për ju por edhe për kafshet tuaja.''** Njëriu i cili me vonë do të ishtë gjyshi i I Dërguari i Allahutt Muhammed a.s. duke kerkuar për uje në shkretëtire kishtë venë re se kembet e deves kishin hasur në një gure dhe kur levizi gurin vuri re se poshtë tij gjendej burim uji. Të gjithe vrapuan në anën ku ndodhej Abdulmutalibi dhe kur panë ujin e gjetën vetën krejt të turpëruar para tij. Pastaj ata ranë dakord duke thenë se; **'' o Abdulmutalib tashme nuk kemi fjale për të thenë ty. Ti e meriton të vazhdosh germimin në pusin e zemzemit dhe kjo nuk ka nëvoje me për ndermjetësues, eja të kthehemi në Mekka dhe me ty kurre nuk do të kemi me përplasje të tilla. Pra merita e pusit të zemzemit është e jotja dhe në do të jeminë dakortësi me vendimin që ti do të marresh për pusin.''** Dhe njëriu që në ballin e tij mbantë nurin e Muhammedit a.s. u nderua me nxjerrjen e ujit të zemzemit nga vendu ku kishtë kohe që ishtë i humbur.[12]

I Biri i Sakrifices (Kurbanit)

Pasi zbulimit të bunarit të zemzemit Abdulmutalibit ju rritë edhe me shume fama dhe inferioritëti në Mekka. Kaluan kohe të gjata dhe Allahu ja kishtë pranuar duanë që ai i ishtë lutur dikur. Tashme Abdulmutalibi i kishtë edhe 10 djem të tjere veç Harisit dhe 6 vajza. Djemtë e mutalibit quheshin **Kusem, Ebû Leheb, Abdulka'be, Haxhl, Zubeyr, Ebû Tâlib, Abdullah, Gajdak, Dirâr ve Mukavvim idi. [Hamza dhe Abbâs ende nuk i kishin lindur.] Ndersa emrat e vajzave; Safijje, Âtike, Umm-u Hakîm Bejdâ, Berre, Umejme ve Ervâ.** Prej hijeshmerise që kishtë Abdullahu duhej me shume se të tjeret nga Abdulmutalibi. Ai kishtë një nur ndryshe nga të tjeret dhe ky nur i tij e shtyntë Abdulmutaliben ta dontë atë me shume se djemtë dhe vajzat e tjera të tij.

Pas një kohe të gjatë **Abdulmutalibit i shfaqët një njëri në enderr ku i thoshtë se duhejt të pristë kurbanin.** Me tu zgjuar në mengjes Abdulmutalibi e beri një dash kurban. Pas pak ditës njëriu ju shfaq njëri në enderr ku i thoshtë **prit një kurban me të madh.** Abdulmutalibi pas enderres theri një deve. Por pa zagjatur shume njëriu i enderres i shfaqët sërisht Abdulmutalibit por kesaj radhe nuk kerkontë me kurban por i thoshtë atij se **duhet ti qëndroje besnik fjales që i kishtë dhenë Allahut atë ditë kur ju kishtë lutur që nëse Allahu do ti jeptë 10 djem njërin prej tyre do e pristë kurban në Qabe.**

Abdulmutalibi ishtë zgjuar në mengjes i trishtuar prej fjaleve të njëriut të enderres. Ai mblodhi djemtë dhe pasi ju tregoi për lutjen që kishtë bere dhe besen që i kishtë Allahut atëher kur ishtë përplas me Mekkasit për pusin e zemzemit. Djmetë pa i rezistuar dhe pa e kundershtuar të atin i thanë atij se **''duhet të silltë në vend besen e dhenë Allahut''**. Atëher Abdulmutalibi hodhi shortin por shorti i bintë dritës se syrit të tij Abdullahut, me i dashuri nder djem. Kjo e trishtoi me shume Abdulmutalibin dhe gjer sap o shkontë drejt Qabes lajmi ishtë përhapur në Mekka. Daja i Abdullahut i del para Abdulmutalibit dhe **''kerkon prej tij që të gjentë një zgjidhje tjetër që të silltë në vend besen e dhenë Allahut, dhe për ketë e sugjeroi të keshillohej me ndonjë fallxhore. Frika e Mekkasve ishtë që nëse Abdulmutalibi do e pristë kurnam të birin në Mekka prej fames dhe pushtëtit që ai kushtë në qytët ky veprim do kthehej në traditë të arabet.''**

[12] Ibni Hishâm, Sîret, I, 144-145; Ibni Sa'd, Tabakât, I, 81-88.

Është e ditur që atë kohe arabet në rastë të moszgjidhjeje të një çeshtjeje trokitnin në dyert e fallxhorve dhe sipas orientimit të tyre ata vepronin. Dhe Abdulmutalibi ashtu beri shkoi të falletor që quhej Kutbe. Kutbe e pyeti Abdulmutalibin; **''kur dikush e vret një njëri në Mekka cili është çmimi që ai duhet të paguaj për larjen e gjakut?'' Dhjet deve i përgjigjet** Abdulmutalibi. Atëhere fallëtori i tha se; **''duhet të merrësh dhjet deve nga njëra anë dhe të birin nga ana tjetër. Dhe të hidhtë short deri sa shorti të bintë në anën e deveve. Por me kusht që sa here shorti të binde nga Abdullahu ai duhet të shtontë dhjet deve nga ana tjetër.''**

"une jam i biri i dy kurbaneve."
Muhammedi a.s.

Abdulmutalibi ashtu beri por sa here hidhtë shortin bintë në anën e Abdullahut. Keshtu veproi disa here dhe kur numri i deveve shkoi në njëqind shorti bie në anën e deveve. **Allahu Ekber, Allahu Ekber** (Allahu është me i madhi) therristë nga gezimi Abdulmutalibi. Njëqind deve u prenë kurban dhe i gjithe mishi i tyre ju nda nëvojtareve të Mekkasve[13].

Riti i prerjes se kurbanit ekziston prej Ademit a.s. deri të Ismaili a.s. për ketë arsye Muhammedi a.s. thoshtë se; **''unë jam i biri i dy kurbanëve.''[14]**

Abdullahu Babai I Muhammedit a.s.

Është transmetuar se kur lindi Abdullahu, i cili me vonë do të ishtë babai i me të respektuarit të Dynjase dhe Ahiretit, itharet e librave të shenjtë kishin filluar të thonin se ''**në Mekka ka lindur babai i Peygamberit të fundit.''**

Me vonë kur një pjese prej hebrenjëve pranuan Islamin dhe pasi kaloi një kohe e gjatë burimet e tyre u moren si burime historike dhe u përzien me realitëtin e kohe. Madje hebrenjtë kishin trilluar se në doren e tyre gjendej rroba e I Dërguari i Allahutt Jahja e cila mbantë gjakun e tij kur paraardhesit e hebrenjëve e vranë atë. Sipas hebrenjëve **rroba e të Dërguarit të Allahutt Jahja kullontë nuk do ta thantë gjakun e tij deri në kohen kur të linde I Dërguari i Allahut i Fundit**.

Me pare u tregua se si Abdulmutalibi **prej hijëshisë që ai (Abdullahu) kishte e dallontë të birin e tij Abdullahun prej bijeve të tjere të tije.** Për ketë arsye Abdulmutalibi nuk e ndantë nga vetja dhe gjatëgjithe kohes e mbantë pranë Abdullahun. Kur Abdullahu erdhi në moshe madhore të atit filluan ti vinin oferat miqësie për martësen e të birit. Fama, autoritëti dhe pushtëti i Abdulmutalibit në Mekka njihej brenda dhe jasht gadishullit arabaik të asaj kohe ndaj transmetohet se për martësen e të birit ai kishtë marre disa oferta edhe jasht Mekkes. Një nder oferta që atij i ishin afruar ishin tregtaret e egjiptit ku kerkonin prej tij që ta martontë të birin me një vejushe egjiptianë. Se fundmi Abdulmutalibi **Abdullahun e martoi me vajzen e fisit Benî Dhuhre, pikerisht me vajzen e Vehbiut, Eminën.** Ky fis i përkistë një nder fiseve që jetonin në qytëtin e Medinës që atë kohe quhe qytëti Jesrib.

Kur Abdulmutalibi vajti ti kerkontë vajzen (Eminën) Vehbiut ky i fundit i thotë se kjo ofertë i kishtë ardhur edhe me pare nga njërez të aferm të përbashket tanët. Madje Vehbiu i thotë se **kishtë pare një ëndërr ku po lidhtë miqsi në Abdulmutalibin dhe prej asaj kohe kishtë mbetur nën ndikimin e ëndërrës.** Përsa i përket moshes se Abdullahut dhe Aminës kur ata lidhen kurore, ka shume

[13] Ibni Ishâk, Sîret-i Resûl, 10-17; Ibni Hishâm, I, 151-154; Ibni Sa'd, I, 88-94
[14] Ibni Ishâk, Sire, 38-44; İbni Hişâm, Sire, I, 43-56; İbni Sa'd, et-Tabakât, I, 55-56, 92, 108; Taberî, Târih, I, 557; Şemseddin Şâmî, Sübülü'l-Hüdâ, I, 216.

burime të ndryshme saktësia e të cileve është e dobet. Por ka dhe burime që thonë se Abdullahu kur u martua me Eminën ishtë 18 vjeç ndersa Eminëja ishtë 14 vjeçe.[15]

Nënan e Muhammedit a.s. dhe Nuri i Bekuar

Kur vdiq i Abdullahu, baba i Muhammedit a.s. i cili ende nuk kishte lindur, engjejt i thane Allahut xh.sh. "o Zoti yne Muhammedi a.s. mbeti jetim."
Abdullah ibn-i Abbâs radıyallahy anh

Kur kaloi nuri i Muhammedit alejhi selam të e jëma të gjithe gjallesat kuptuan se **"botës po i afron koha e ardhjes se I Dërguari i Allahutt të fundit"**. Pejgamber ky që do të jetë meshire për gjithe botërat, me i nderuari dhe me i respektuari. Atë natë edhe Iblisi (shejtani) mallkimi i Allahut qoftë mbi to, u pingellua nga merzia sepse lundrimi i tij se bashku me suhtritë e tij të se keqë kuotuan se ju kishtë ardhur fudni, kuptuan se njërezimi do i mblidhej rreth besimit në Allahun që një dhe të vetëm, u pikelluan se tashme në Mekka dhe në mbare rruzullin toksore do i vintë fundi adhurimit të idhujve. Nga ana tjetëtër u gezuan dhe u lumturuan Pejgamberet, Engjejt dhe të gjithe dashamiret e të mires sepse po ju vintë i dashuri i tyre, i dashuri i Allahut, vula e pejgambereve Muhammedi a.s. i cili do ta hijeshontë botën me urtësitë, miresitë dhe mbi të gjitha me Kur'anin famëlartë. U gezuan malet dhe kodrat, lumenjtë, detët dhe oqëanët, u gezuan sepse do të deshmonin Pejgamberllikun e Muhammedit a.s., I Dërguari i Allahut i fundit pas ndodhise se madhe (ditës se shkatërrimit të botës; Ditës se Gjykimit, Ditës e Kijametit). Është thenë se ato kohera Mekken e kishtë kapluar një thatësire e madhe.

Kishte kohe që nuk bintë shi. Gjethet e pemeve po thuajse ishin në prak të tharjes dhe dritherat kishin mbet të shkurrura. Mekkasit ishin ankth prej thatësires. Por në kohen e lindjes se Muhammedit a.s. në Mekke dhe për rreth saj ranë shira të bollshem se që ai vit u quajt **"viti i bollshem"**. Thuhet se edhe e ema gjatë shtatëzanise se saj nëntë mujore nuk kishtë ndjere asnjë shqëtësim prej shtatëzanise.

Kur e jema ishtë dy muajshe shtatëzenë me Muhammedin a.s. i ati si gjithe Mekkasit e tjere udhetoi për synime tregetare në Sham. Gjatë rruges se kthimit atë e kapi semundja dhe kur erdhen në vendin e quajtur **Dar-un-nabiga** pranë qytëtit të Medinës nuk mundi të vazhdoi me udhetimin dhe ndaloi të fisi i quajtur bijtë e Nëxhxharit, pranë të cileve edhe nderroi jetë. Thuhet se kur Abdullahu nderroi jetë ishtë në moshen 25 vjeçare.[16]

Kur moren lajmin për vdekjen e Abdullahut mekkasit i kaploi pikellimi[17]. Sipas transmetimeve të sahabiut Ibn Abas, " Kur vdiq i Abdullahu, baba i Muhammedit a.s. i cili ende nuk kishtë lindur, engjejt i thanë Allahut xh.sh. **" o Zoti ynë Muhammedi a.s. mbeti jetim."** Ndersa Allahu xh.sh. engjejve ja ktheu fuke ju se; **" Ndihmesi dhe Mbrojtësi i tija jam Unë."**

Ndersa për vdekjen e Ambullahut me shume pikellimi kishtë kapluar bashkeshortën, tashme vejushe, Eminën. Pikellimin e saj e tregojnë me se miri vargjet e kesaj poezie;

Nuk pritëj prej tij, shpejt e gjeti varri
Ai ishtë i meshirshem, ishtë me bujari

[15] Ibni İshâk, Sîret-i Resûl, 119-124; Ibni Hishâm, Sîre, I, 232-233; Ibni Sa'd, Tabakât, I, 94-95.
[16] Ibni Sa'd, Tabakât, I, 99; Belâdhurî, Ensâbu'l-eshrâf, I, 92.
[17] Ibni Sa'd, Tabakât, I, 99-100.

Ndodhia e Elefantit

"une jam zot i 200 deveve te mia dhe jam përgjegjes për, ndersa Qabeja ka Zotin e saj dhe ai padiskutim që do e ruaj shtepine e Tij."
Shejbet-ul Hamd

Dy muaj para se të lind Muhammedi a.s. një ushtri Habeshistanase (Etiopia e sotme) me në krye përandorin Ebreha marrshoi drejt qytëtit të Mekkes. Ushtria veç armatimeve të tjere në ketë marrshim kishtë përdorur elefantët, ndaj dhe është quajtur ndodhia e elefantit. Sipas transmetimeve historike thuhet se; Ebrehe kishtë mbjell një xhelozi urrejtëse për Qaben e bekuar sa që një kohe ai urdheron të ndrtohet një kishe dhe pretëndontë se me të do të zevendesontë Qaben. Kur kisha u ndertua ai thirri që në të të behej peligrinazh njëjtë sikur në Qabe. Por arabet jo që e përfillen thirrjen e atij por njëri prej tyre shkon dhe urinon drejt dhe në kishe. Kur degjio Ebrehe për ketë u betua se do të rrenontë Qaben. Dhe ky akt i arbeve të asaj kohe i kishtë mjaftuar Ebrehes që xhelozinë urrejtëse ndaj Mekkes ta tregontë qartë. Ai organizoi një suhtri të medhe ku në rrjet të pare vendosi elefenatët. Me tu afruar në Mekke puna e pare që beri ju rrembeu të gjitha pauritë Mekkasve.

Një nder ata që i ishtë rrembyer pasuria ishtë gjyshi i Muhammedit a.s. Abdulmutalibi. Ky i fundit i paraqitët Ebrehes dhe pa ju trembur syri kerkon 200 devet që ai ja kishtë rrembyer me dhunë ushtarake. Ebrehe i habitur për aktin e Abdulmutalibit tha; '' unë kam ardhur të ju shkatërroi shtëpinë e shenjtë dhe ti në vend se të mbrosh atë me kerkon devetë e tua që nuk kanë asnjë lloj vlere në krahasim me shtëpinë e shenjtë, Qabenë''. Atëher Abdulmutalibi u përgjigj; **''unë jam zot i 200 deveve të mia dhe jam përgjegjes për, ndersa Qabeja ka Zotin e saj dhe ai padiskutim që do e ruaj shtëpinë e Tij.''** Ebrehenë e kishtë nnxehur shume kjo përgjigje e Abdulmutalib dhe tha '' sot nuk ka askush ta mbroje Qabenë nga unë''. Dhe urdheroi ushtrin drejt saj. Në krye të ushtrise gjendej elefanti që e quanin **''mahmude''** e cila nuk leviztë nga vendi.

Ushtaret pranë saj nisen të godasin elefantin që ai të nisej drejt Qabes por elefenti kishtë ngulur kembet në rere dhe nuk leviztë vendi. Pra, edhe elefenti e dinte **që ajo që (Ebreheja) donte te shkatërronte ishte shtëpia e Allahut xh.sh..** Ushtaret e kapen për lidhezje dhe e drejtuan nga ana e kunder e Qabes elefanti nisi të vrapoi me të katërtat e tij.

I gjithe syksesi i ushtrise se Ebrehes ishtë lidhur mbi elefantin por me shkeputjen e ketij elefanti gjikand nga ushtria ketë të fundit e kapi paniku, ndersa Ebreha kishtë mbetur krejt i befasuar nga kjo ndodhi. Kur çtë shihtë në qiellin mbi to u duk një ushtri zogjsh të cilet gjuheshin ''zogjtë ebabil''. Zogjtë sapo ju afruan ushtrise leshuan mbi të guraleca të vockela sikur kokerrat e grurit. **Cilindo e kaptë ky guralec nga nxehtësia ja shpontë dhe ja shkirrtë mishin nga trupi sikur të ishin pika zifti që vlonin në kazan.** Përballe kesaj panorame Ebrehe nisi të vrapoi drejt vendit nga kishtë ardhur por ikja e tij u duke e pa mundur pasi trupin e tij e kishin shkirre mishin nga kockat.[18] Thuhet se në etë pjese të trupit ku binin guralecet mishi tretëj dhe rridhtë nga koscka sikur djeresa prej trupit.

Allahu e transmeton ketë ngjarje në Kur'an pikerisht në kaptinën Fil (elefanti). Ai (Allahu) thotë;

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit të madh! (O i Dërguar! A nuk e pe se si veproi Zoti yt me ata që deshën ta shkatërrojnë Qaben?) **A nuk e ke parë, se ç'bëri Zoti yt me poseduesit e elefantit** (ushtrisë së Ebrehes, e pajisur me elefantë)**? A nuk ua bëri përpjekjen e tyre** (përpjekjen e tyre për të shkatërruar Qaben e Lartësuar) **të dështuar? Dhe Ai kundër tyre lëshoi shpendë që vinin tufë-tufë! Dhe i gjuanin ata me gurë nga balta e gurëzuar! Dhe ata i bëri si gjeth i grimcuar** (I bëri si gjethet e korrura të bimës që janë kafshuar dhe copëtuar nga krimbat.)**![19]**

[18] Ibni İshâk, Sîret-i Resûl, 38-44; Ibni Hishâm, Sîret, I, 43-56; Ibni Sa'd, Tabakât, I, 55-56, 92, 108; Suhejlî, Ravd-ul-unf, I, 269-270.
[19] İbni İshâk, Sîret-i Resûl, 38-44; İbni Hişâm, Sîret, I, 43-56; İbni Sa'd, Tabakât, I, 55-56, 92, 108; Süheylî, Ravd-ül-ünf, I, 269-270.

Ndodhia e Elefantit

SHËNJAT PARAJALMERUESE

" O Allah! Më bëj dhe mua prej umettit të Muhammedit a.s."
Musa Alejhi selam

Për ardhjen e I Dërguari i Allahutt tonë të Dashur Muhammedin a.s. janë paralajmeruar të gjithe pejgamberet prej Ademit a.s. çdo I Dërguari i Allahut dhe çdo komunitëti i kanë ardhur shenja paralajmeruese për të. Dhe pak para lindjes se Muhammedit a.s. janë venë në dukje disa shenja paralajmeruese që tregonin se ardhja e tij është e afert.

Në librin e vertëtë të Muses a.s., në Tëvratin e shenjtë (i cili me vonë u devijua nga hebrenjët) për Muhammadein as. thuhej se;

''Ai do të jetë një prej njërezve me të dalluar, sakrificen e ka të lartë, ndihmen pa kufi. Do të jetë dahuri i nëvojtareve, fukarenjëve dhe mjeku i pasanikeve. Ai është i bukuri të të bukurve, i pastërti i të pastërve. Në biseda i butë, në peshoje i drejtë dhe i drejtë në çdo veprimtari. Përballe qafirve dhe dhunuesve është i ashpër dhe hejbetli. Ndaj të moshuarve i respektueshem, ndaj të vegjelve përkedheles dhe dashamires. Për pak gje është falenderues, sklleverit i liron. Ai ndrit me buzegjeshje, buzqëshjen e ka për dashamirsi dhe kurre nuk buzgjesh me të qëshura të larta. Është analfabet, nuk din shkrim-lexim, aitij i janë mesuar çdo gje pa ditur shkrim-lexim. Ai është i derguari i Allahut. Nuk është prej veskeqinjëve, as zemren nuk e ka të ashpër. Në tregje dhe pazare nuk flet me ze të lartë. Ummeti (komunitëti) i tij është prej të zotëve të moralit. Vazhdimisht i janë falenderues Allahut. Thirresit therrasin për falje (namaz) në vende të larta (minare). Pastrohen pastaj falen (marrin abdest para se të falen). Në namaz i mbajnë rrjeshta drejt dhe qëndrojnë në një vije. Gjatë natës zeri i tyre falenderues ndaj Allahut degjohet sikur mjalti i bletës në koshere. Do të lindi në Mekka, nami dhe pushtëti i tij do të sundoi mbi gadishullin arabik. Ai quhet Muhammed a.s., **unë atë e quaj Besnik**. Atij nuk do ti vije vdekja pa larguar fetë e devijuara dhe pa i zevendesuar ato fenë e vertëtë. Ai e therret njërezimin të e vertëta dhe e largon nga e keqja (në Fenë e Allahut). Dashamiresia e tij hap sytë e verbuar dhe veshet e sherdhuar, ata (sytë e verbuar dhe veshet e shurdhuar) prej dashamiresise se tij hapen, edhe zemrat braktisin mosmirenjohjen që i ka pushtuar ato...''[20]

Edhe në Zebur (i cili me vonë u devijua nga hebrenjët), librin që i zbriti I Dërguari i Allahutt Davut a.s. për Muhammedin a.s. thuhej se;

''Ai është një njëri me virtytë të larta, bujar dhe fisnik. Nuk nxehet kurre, i butë. Me një fytyre të ndritur dhe fjale embel. Mjek i njërezimit. Qan shume, qësh pak. Flen pak, mediton shume. Nga natyra është i dashur dhe dashamires. Fjalet e tij bien në zemer dhe fajelet e tij i qëtësojnë zemrat... O i Dashur! Nxirre shpatën e krenarise, dhe me gjithe fuqinë tënde luftoi me heroizem dhunuesit, keqberesit dhe të pameshirshmit. Me një gjuhe të bukur përhapi levdatat dhe thirrjen Tim tëk gjithe njërezimi. Të gjithe dhunuesit, zullumqaret dhe qafirat do të përkulen para dores tënde...''

Edhenë librin e vertëtë të Ises (Jezusit) a.s., Inxhilin, i cili me vonë u devijua nga hebrenjtë dhe romaket thuhej për Muhammedin a.s. se; '' Ai nuk ha shume ushqim, nuk është as koprrac. Nuk ben hile, as nuk nënçmon njëri (nuk i ben keq njëriu) dhe as nuk është i nxitueshem. Nuk është hakmarres. Ai nuk është dembel dhe nuk përgojon askend...''

[20] Ibni Ishâk, Sîre, 38-44; Ibni Hishâm, Sîre, I, 43-56; Ibni Sa'd, Tabakât, I, 55-56, 92, 108; Taberî, Târih, I, 557; Suheylî, Ravd-ul-unf, I, 123; Shemseddin Sâmî, Subulu'l-Hudâ, I, 216.

Abdulmutalibi ishtë i dashur dhe i kujdeshem për femijet e tij, ndersa për Muhammedin a.s. kujdesej veçanërisht ndryshe nga të tjeret, e mbantë pranë dhe në Qabe e ultë pranë vetës. Kur të afermit donin ta largonin prej tij ai ju thoshtë ''lerini nipin tim ai do është prej të veçantëve dhe prej të nderuarve.''[33] Urdherontë kujdestaren e tij Umu Ejmen të kujdesej për të dhe kur bintë të flintë e mbantë pranë në shtratin etij. Kujdesej, e përkedheltë me embelsi, ushqëntë me ushqime të mira dhe pa ardhur ai nuk e shtrontë sofren. Por ai edhe kur ishte fëmije tregonte sikur thoshte **''nuk dua, jam i ngopur''** pra tregonte se nuk ishte i uritur.

Pra aq i kujdeshem, aq i vemendshem dhe aq i dashur ishtë gjyshi Abdulmutalib për të birin e tij Muhammedin a.s. të cilin nuk e ndantë asgje prej tij. Madje tregohej

[31] Ibni Hishâm, Sîret, I, 168; Ibni Sa'd, Tabakât, I, 116.
[32] Kastalânî, Mevâhib-i ledunijje, I, 652.
[33] Ibni Sa'd, Tabakât, I, 70-74.

se ai e kishtë pare në enderr madheshtinë, supërioritëtin dhe lartnamesinë e të nipit sa që ju thoshtë Kurejshitëve se ''ky djale është ndryshe, do jetë i nderuar dhe i lartësuar nga të tjeret.''

"Tashme erdhi kohe me udhetuar për ne Ahiret. I vetmi pishmane ne jete eshte ky jetimi (Muhammedi a.s.). Ah, sikur te kisha mundesi ta ndalja vdekjen dhe te vazhdoja detyren time ndaj tij. Por ne nuk na eshte lejuar kjo! Prandaj sot nuk mund te bej asgje tjeter vetem se zemra me digjet."
Abdulmutalib

Prifti Prej Nëxhrani

Një Amdulmutalibi ishtë ulur në Mekke kur pranë tij u duk një prift i sili vintë prej Nëxhrani. Ai gjatë bisedes me Abdulmutalibin i tha atij se; '' në kemi mesuar prej Beni Izraelitve (hebrenjëve) se në keto toka do të vije një pejgamber dhe do ketë keto e keto cilesi veçuese...'' , atë moment vjen dhe afrohet Muhammedi a.s. pranë të gjyshit dhe kur e sheh prifi e pyet Abdulmutalibin se i kujt ishtë ky femi? ''është im bir'' ju përgjigj ai. Atëher prifti tha në librat e shenjtë është folur se I Dërguari i Allahut i fundit nuk do ketë nënë dhe babe, ai do jetë jetim. Prandaj po të ishtë ky femije jetim atëher do thoja se ky femi zotëron disa veçori që tregojnë se ky do të jetë I Dërguari i Allahut i shume pritur. Abdulmutalibi në heshtje e përcolli priftin dhe ju tha familjereve të tij që të kenë kujdes Muhammedin a.s. sepse ai nuk është femije sikur femijet e tjere.

Vdekja e Gjyshit të Nderuar

Fjalet e Abdulmutalibit që ju thoshtë familjareve kujdesuni për Muhammedin a.s. dukej qartë që ishin fjale tëstamenti. Ai nuk jetoi me gjatë dhe nderroi jetë. Para se të nderrontë jetë ai i mblodhi familjaret dhe po ju jeptë atyre keshillat e fundit. Kur erdhi radha të kujdestaria e të nipit ai kishtë dalluar se djali i tij Ebu Lehebi ishtë i pasur dhe ishtë i shqëtësuar se ky nuk do ishtë i drejtë në kujdestarinë e tij. Ndaj zgjodhi djalin e vogel Ebu Talibin të clit i kerkoj të kujdesej për Muhammedin a.s.. Ebu Talibi ekonomikisht ishtë i varferi femije kishtë shume por ishtë i drejtë në sjellje. Ai i premtoi të atit se do të kujdesej për Muhammedin a.s. njëjtë si për femijet e tij, nuk do e ndantë atë prej tyre dhe nuk do ta lendontë aspak për faktin që ai kishtë mbetur jetim, i vetmuar dhe pa përkrahes. Atëhere Abdulmutalibi pas fjaleve të të birit u qëtësua dhe tha; '' o bir ti je i drjtë dhe e thua të drejtën, kujdesu për të birin e vellait tënd të vdekur, kur të lind nëvoja konsultohu me të dhe kurre mos e ndaj dhe mos e le ratë pa mbështëtje.''

Pastaj Abdulmutalibi ju drejtua Muhammedit a.s. dhe e pyeti se me cilin prej xhaxhallareve kishtë deshire të jetontë? Dhe kur Muhammedi a.s. i tha se Ebu Talibi ishtë me i dashur për të atëhere Abdulmutalibit ju shtua gazi i gezimit dhe tha ''tani po shkoj rahat në botën e përtëjme.'' Pasi mori tëstamentin dhe emanëtët e të atit Ebu Talibi e mori Muhamedin a.s. në krah dhe e dergoi atë në shtëpinë e tij.[34]

Nën Kujdestarinë e Xhaxhait Ebu Talib

Pas vdekjes se gjyshit Abdulmutalib me i Nderuari i universit ishtë në moshen tëtë vjçare kur filloi të jetoi në familjenë Ebu Talibit, aty dhe ku rrit. Edhe ebu Talibi sikur i jati në Mekke gezontë një respekt të veçantë nga mekkasit e kohes. Ai nuk e ndantë nga vetja nipin e tij, kujdesej për të dhe njëjtë sikur i ait në ulese me të paret e Mekkes e mbantë dhe uletë pranë vetës atë, Muhammedin a.s.. Edhe kur

[34] Ibni Ishâk, Sîret-i Resûl, 45-48; Ibni Hishâm, Sîret, I, 169-178; Ibni Sa'd, Tabakât, I, 117; Suhejlî, Ravd-ul-unf, II, 188; Shemsed-din Sâmî, Subulu'l-Hudâ, II, 135; Ibni Esîr , Usud-ul-gâbe, I, 22.

mekkasit donin ta ndanin prej tij ai njëjtë sikur i ati ju thoshtë atyre '' lereni nipin tim, ai do behet një burre me nam të madh''. Por edhe në familje Ebu Talibi ishtë tëpër i kujdesur dhe tëpër i dashur me të, pa praninë e tij nuk e shtrontë sofren, nuk e nistë ushqimin dhe nuk flintë. Pra Ebu Talibi sikur dukej shihtë një veçori dashurore dhe shpirtëngrohtësi të Muhammedi a.s. sa që edhe kur bentë lutje, lutëj për të.[35]

"Tani ka ardhur koha që të kaloj nga kjo botë për në botën tjetër. E vetmja brengë që kam është ky jetimi. Ah, sikur jeta ime të ishte më e gjatë që ta vazhdoja me dashuri këtë shërbim kundrejt tij. Por çfarë mund të bëj? Jeta nuk do të zgjasë më shumë. Tani zemra dhe gjuha ime po digjen nga flakët e mallit."
Abdulmuttalip

Përj fisit të pastër del I Dërguari i Allahut
Rrin pranë Haxheri dhe Zemzemi

I gjithe si popull pran tij qëndroni
O bijtë e Amirit prej do përgezoni

Prifti Bahira

Erdhi koha që kurejshët të përgatisin karvanin e tyre për të shkuar në Siri. Me të shkontë edhe Ebu Talibi, por nuk deshi të martë Muhammedin a.s. ndërsa ky i fundit i tha; **''O xhaxha! Ti po ikën nga ky qytët dhe mua po me lë të vetëm. Ndërsa unë nuk kam as prindër dhe askënd tjetër që të kujdes për mua!...'** pas këtyrë fjalëve Ebu Talibi e mori me vetë edhe Muhamedin a.s. Ky që udhetimi i parë i Muhamedit a.s. për në veri. Pas disa ditësh udhëtimi, karvani arriti deri në një vend afër Sirisë, i njohur për nga tregtia që romakët bënin me arabët.

"Dëshmoj se ky është I Dërguari i fundit i Allahut xh.sh. ... për të cilin kanë folur librat e shënjtë. Ky është I Dërguari, që e nderon mbarë universi. Ky është i Dërguari që Allahu xh.sh. e ka dërguar mëshirë për mabarë univërsin."
Prifti Bahira

Afër këtij tregu jetontë një murg i quajtur **Bahira**. Qëlia e tij ishtë shfrytëzuar nga gjenëratat e murgjve para tij dhe përmbantë shumë dorëshkrime të lashta. Behira e pa karvanin nga larg dhe u habit kur pa se mbi të qëndrontë një re e bardhë. Ajo ishtë reja e vetme në qiellin e kthjellët e të kaltër dhe ishtë paraqitur me qëllim që udhëtarëve t'u bëntë hije. Murgu edhe më tëpër u befasua kur vërejti se reja që ndiqtë karvanin, çdo herë zhdukej kur njëriu, të cilit ajo i bëntë hije, ulej nën hijen e ndonjë druri. Nga shkrimet e vjetra, Behira e dintë se pas Isait a.s., pritëj të vintë një i dërguar dhe dëshira e tij ishtë që ta shohë këtë të Dërguar para se të vdesë. Kur e kuptoi se e tërë kjo që ndodhi para pak çastësh ishtë një mrekulli, ai filloi të mendojë se më në fund, dëshira e tij do të plotësohej. Murgu i ftoi mekasit që të vijnë dhe të hanë me të. Arabët u befasuan ngaqë ata shpesh kishin kaluar pranë, mirëpo Behira nuk i kishtë ftuar asnjëherë. Kur u mblodhën për të ngrënë, murgu pyeti: "A jeni të gjithë?" "Jo!" tha dikush. "Një djalë mbeti që të ruajë devetë."

Behira nguli këmbë që edhe djali të bashkohej me ta. Ai djalë ishtë Muhamedi a.s. Kur arriti ai, Behira nuk tha asgjë, por gjatë tërë kohës së drekës, vetëm e shikontë. Ai vërejti shumë gjëra, të cilat cekeshin edhe në dorëshkrimet e vjetra lidhur me paraqitjen e tij. Pastaj e tërhoqi Muhamedin a.s. mënjanë dhe i bëri shumë pyetje. Së shpejti kuptoi se ç''ndien ai rreth idhujve të Qabes. Kur Behira u përpoq ta binde që të betohet mbi to, ashtu siç bënin edhe arabët e tjerë, Muhamedi a.s. i tha**:" Mos**

[35] Ibni Hishâm, Sîret, I, 179-180; Ibni Sa'd, Tabakât, I, 119.

Udhetime Nga Mekka Për Në Basra



u betoni mbi idhujt. Sepse nuk ka gjë në botë, të cilën e urrej më tepër." Ata biseduan së bashku për Allahun dhe rreth jetës dhe familjes së Muhamedit a.s.. Nga e tërë ajo që u tha, Behira u bind se ky me të vërtetë është i Dërguari që vjen pas Isait. Pastaj murgu shkoi të Ebu Talibi dhe e pyeti se ç'e kishtë Muhamedin a.s.. Ebu Talibi iu përgjigj se Muhamedi a.s. ishtë biri i tij. Behira ia ktheu se nuk mund të jetë kështu, se fëmija është i paracaktuar të jetojë jetim, dhe pastaj e urdhëroi që ta ruajë Muhamedin a.s. dhe të kujdeset mirë për të. Më pas Bahira kërkoi që ta takoi dhe të bëjë një bisedë me Muhammedin a.s. dhe kur ja sollën atë ai e pyeti;

- **Djalosh, do të të pyes disa pyetje, vetëm dua që të më betohesh për Latin dhe Uzën se do të më thuash veçse të vërtetën. Besniku i Njërëzimit u shqëtësua shumë nga do farë emrash të përdorura mes fjalëve të këtij murgu.**

- Mos më pyet asnjë pyetje duke më përmendur emrat e Latit dhe Uzës. Të betohem për Allahun, se sa më nëvrikosin ata, nuk ka gjë tjetër që të më nëvrikosë.

Zatën Bahira, i kishtë përdorur ata emra veçse ngase e dintë se ishin dy idhuj për të cilët kurejshët linin kokën, dhe në njëfarë mënyre, dontë të shihtë qëndrimin që mbantë Më Besniku për idhujt.

- **Atëherë jepmë fjalën në emër të Allahut që do të më kthesh përgjigje për pyetjet që dua të të bëj, - i kërkoi ai sërish Muhamedit paqja qoftë mbi Të! - Pyesni ç'të dëshironi! - iu përgjigj ai. Tashmë Bahira e pyeti Muhamedin e përlartësuar paqja qoftë mbi Të! për çdo gjë që i vintë në mendje. Nga gjumi tëk ëndrrat, nga jeta e përditshme të dëshirat e tij. Bahira e pyestë, ndërsa I Dërguari i fundit i Allahuti përgjigjej qëtësisht. Tashmë për Bahiran çdo gjë ishtë aq e qartë sepse çdo gjë po ectë njëlloj sikur shkruhej në libër (Bibël). Ndaj Bahira dëshmoi se ai ishtë I Dërguari i Fundit i Allahut xh.sh. për të cilin flitëj në librat e shenjtë (në Tëurat dhe në Bibël)**[36]

Shkuarja në Jemen me xhaxhain e tij Zubejrin

I dashuri ynë Muhammedi a.s., i cili me çdo aspekt ishte një njeri i jashtëzakonshëm, plot virtyte dhe vlera të larta, kishte arritur moshën shtatëmbëdhjetë vjeçare. Në këtë kohë, xhaxhai i tij Zubejri, i cili shkoi në Jemen për tregti, e mori me vete atë në mënyrë që tregtia e tij të kishte e begatë. Gjatë kësaj udhëtimi, u panë shumë mrekulli të tij. Kur u kthyen në Mekë, këto mrekulli të tij u përhapën aq shumë në fisin e Kurejshëve sa që ata filluan të flasin: "Shkëlqimi i tij do të jetë shumë i lartë."

[36] Ibni Ishâk, Sîret-i Resûl, 53-58; Ibni Hishâm, Sîret, I, 180-182; Ibni Sa'd, Tabakât, I, 76, 154-156; Suheylî, Ravd-ul-unf, II, 216-220; Ibni Kethîr, Bidâje, III, 283-286.

RINIA DHE MARTËSA

Rinia

"Ja pra një njeri i mrekullueshëm sikur Muhammedi a.s. të cilin e nderon e gjithë bota, me besnikërinë dhe dashamirësinë e tij ja arriti që edhe armiqtë me te përebetuar deshmonin për besnikerinë e ti (Muhammed'ul Emin)."
Husejin Hilmi bin Sa'îd r.a.

Mbret i mbretërve dallontë shumë, madje në çdo sjellje, nga kushërinjtë dhe moshatarët e Tij. Tashmë ishtë njëzet vjeç, dhe nga çdo aspekt, ai kishtë fituar respektin e të gjithë mekasve. Qëndrimi që Ai mbantë dhe zgjidhjet që jeptë për probleme të ndryshme, viëheshin re nga të gjithë. Ata ishin të mahnitur nga goditja që Ai i bëntë zgjidhjeve të problemeve, andaj shkonin shpeshherë që të merrnin edhe mendime prej Tij. Nga vendosmëria dhe ndershmëria që kishtë shfaqur ndaj të gjithëve, Atë tashmë e thërrisnin si ''El-Emin (I Sigurti)". Ky cilësor nuk i kishtë shkuar askujt sa i shkontë këtij djaloshi, kësisoj që të gjithë mekasit ishin njëmendës që Ai e meritontë, madje kjo dukej edhe kur ata e thërrisnin më tëpër me anë të cilësorit sesa në vetë emrin e Tij. Porta e Tij kishtë filluar të hapej njësoj siç hapej për më të vjetrit e urtë dhe dijetarë, sepse statusi shoqëror ia kishtë falur pa kurrfarë lëkundjeje një status të këtillë.

Ndërkohë Muhammedi a.s. në jetën e tij të përdithsme ndojmontë xhaxhain e tij. Ai shkontë të kullostë bagëtitë dhe në një hadith ai thotë se; ''nuk ka anjë Pejgamber që nuk ka kullotur bagëtitë e tij''.[37] Pra pejgamberët janë njerëz të thjeshtë sikur gjithë njerëzit e tjerë. Ndaj Muhammedi a.s. thotë se; ''Edhe unë kam kullotur bagetitë.''

Kur i dashuri ynë Muhammedi a.s ndodhej rreth të njëzetave, gjendja e sigurisë në Mekë ishte përkeqësuar plotësisht. Padrejtësia ishte përhapur gjerësisht dhe nuk kishte mbetur më siguri për jetën, pasurinë dhe nderin e njerëzve. Banorët vendas të Mekës i bënin padrejtësi dhe i shtypnin të huajt që vinin për tregti apo për të vizituar Qaben. Njerëzit që përjetonin padrejtësi nuk kishin askënd ku mund të drejtoheshin për të kërkuar të drejtat e tyre. Në atë kohë, një tregtar nga Jemeni, i cili kishte ardhur në Mekë për tregti, u grabit nga një Mekkas. Ai (grabitqari) quhej As bin Vail, ky ishte që ia mori me forcë mallrat tregtarit Jemenas. Pas këtij incidenti, për të marrë të drejtën e tij, tregtari nga Jemeni u ngjit në malin Ebu Kubejs dhe, filloi duke thërriste në ndihmë fiset arabe… Pas kësaj ngjarje, e cila tregon se padrejtësia kishte arritur kulmin, udhëheqësit e fiseve Hashim dhe Zuhre, si dhe të tjerë, u mblodhën në shtëpinë e Abdullah bin Xhudas. Aty ata vendosën që asnjë vendas apo i huaj të mos shtypej e të mos i bëhej padrejtësi, si dhe të ndalohej çdo lloj padrejtësie.''[38]

Në vitët e rinisë, shkoi të luftontë në luftërat e Fixharit. Ndër mexhlise kishtë zënë vendin kryesor, dhe thirrej përherë si drejtues i bisedimeve për të zgjidhur çdo lloj problemi që shqëtësontë banorët e atij vendi. Aq sa ishtë ngritur edhe një vend-qëndër enkas për bisedime me emërtimin **"Hilfu'l Fudul"**, e Muhamed i Sigurti i shtrenjtë ishtë kthyer në një nga anëtarët më të respektuar të këtyre mbledhjeve.

Më parë, dy persona njëri quhej Fadl dhe tjetri Fudail kishin themeluar një bashkësi të ngjashme. Kjo bashkësi mori këtë emër në nder të asaj që ata kishin krijuar më parë. Kjo bashkësi ndaloi shtypjen dhe rivendosi rendin publik që

[37] İbni İshâk, Sîret-i Resûl, 53-59; İbni Sa'd, Tabakât, I, 120-123.
[38] Suheylî, Ravd-ul-unf, I, 91.

Tregjet dhe Panairet në Arabi dhe Zonat Për Rreth Saj

Njëriut i vjenë caktimi
Pa ndihme nuk mbet jetimi

Ç'ta beje shpirtin Ejubi
Kur jetën s'ka për bukuri

Mberti, I Dashuri Përendise
Paraqitja sherim i ligesise

Si mundem për ty me qënë dobi
Kur i dahuri ka humb shirtin e ti

ishte prishur në Mekkë. Ndikimi i saj vazhdoi për një kohë të gjatë. Pas shpalljes pejgamber, i Dërguari i Allahut (Paqja qoftë mbi të) u tregoi sahabëve dhe tha: "**Unë isha i pranishëm në betimin e bërë në shtëpinë e Abdullah bin Cud'ân. Për mua, ai betim është më i dashur se të kesh deve me qime të kuqe (pasuri). Nëse edhe tani do të thirresha në një asamble të tillë, do të merrja pjesë."**[39]

Kujdestaria Tregtare

"Ai Mysliman që punon dhe fiton hallall me djersën tij, nuk ja shtrin doren të tjerëve dhe ndihon familjen të afërmit dhe rrethin e tij. Ai ditën e gjykimit do te ndriçoi sikur hëna pesëmbedhjetëshe (hëna e plotë)."
Hadith

Mekkasit jetësën e tyre e kishin të ndërtuar mbi tregëtinë. Edhe Xhaxhai i Muhammedit a.s. ishtë njëri prej atyre që merrej me tregëti. I Dërguari i Allahut ynë i dahshur kur ishtë në moshën njëzet e pesë vjeçare nuk sihtë në gjëndje të mirë ekonomike. Një ditë xhaxhai Ebutalibi erdhi dhe i tha Muhammedit a.s. se; '' koha është e veshtirë, thatësira po na i vështirëson kushtët ekonomike. Mekkasit po përgatisin karvanët tregëtare për në Sham-Siri Hatixhe Ibni Velidi po këerkon një njëri të besueshëm që të kujdest për karavanin tregëtar të saj. Këtë detyrë më mirë se ti askush nuk e bën në Mekke veç tëje, pra padiskutim që nëse ti e pranon këtë detyrë Hatixheja do ta presi me shumë kenaqësi.'' Ndersa Muhammedi a.s. si gjithmonë me dukatën e tij të brishtë, **'' si të vendosësh ti xhaxha''** ja kethu Ebutalibit.

Hadixheja, për bukurinë, pasurinë, zgjuarsinë, virtytin, modestinë dhe edukatën e saj ishte një zonjë e njohur në të gjithë Arabinë e asaj kohe. Për këtë arsye, kishte shumë njerëz që nga çdo anë dëshironin dhe i bënin asaj kërkesa për martesë. Por, për shkak të një ëndrre që kishte parë, ajo nuk u kushtoi vëmendje askujt. Në ëndrrën e saj, kishte parë që nga qielli kishte zbritur një hënë dhe ishte vendosur në gjoksin e saj, dhe drita e asaj hëne kishte dalë nga sqetulla e saj dhe kishte ndriçuar gjithë universin. Në mëngjes, ajo ia tregoi këtë ëndërr të afërmit të saj, Varaka bin Nevfel. Varaka i tha: **"Pejgamberi i fundit ka ardhur. Ai do të martohet me ty dhe gjatë kohës tënde do t'i shpallet atij vahji. Drita e fesë së tij do të mbushë të gjithë universin. Ti do të jesh e para që do të besosh. Ai Pejgamber do të jetë nga fisi Kurejsh dhe Beni Hashim."**

Ebu Talibi, me të marrë përgjigjen pohuese nga i nipi, rendi menjëherë për të folur me Hatixhen. Më tëpër ai kishtë një ndjesi se duhet t'i flistë vetë asaj për cilësitë e përsosura të të nipit. Sepse ai ishtë njëriu më i mirë dhe më besnik i qytëtit të Mekës. Këto ishin disa nga cilësitë që duhet të përcaktonin përsonin e zgjedhur si dorëzanë të kësaj tregtie. Për më tëpër, edhe çmimi që do t'i jepej atij duhet të ishtë i veçantë. Ai e dintë edhe çmimin që do t'u jepej të tjerëve, prandaj vendosi që t'i kërkontë dyfishin Hatixhes. Pa kaluar shumë kohë, shkoi pranë Hatixhes. Pas përshëndetjeve të përzemërta, ai e pruri fjalën tëk karvani dhe të tregtia, duke numëruar një e nga një të gjitha virtytët e pashoqë të nipit të tij. ''O Hatixhe! Kam marrë vesh se për këtë punë ke vendosur një shpërblim prej dy devesh; Muhamedi im është më Besniku ndër të gjithë njërëzit, dhe unë për të po të kërkoj dyfishin, jo dy, por katër deve''. Me të mba- ruar fjalën e tij Ebu Talibi, ajo tha: ''O Ebu Talib! Të të them të drejtën, ti po më kërkon një çmim jo edhe aq të madh. Edhe sikur shumë më shumë të më kërkoje, prapëseprapë do të t'i kisha dhënë pa m'u dridhur syri. Sikur të ma kërkoje edhe për një njëri të parëndësishëm madje, lëre pastaj që ti je duke më folur për një njëri më se të dashur''

[39] İbni Hishâm, Sîret, I, 133; İbni Sa'd, Tabakât, I, 82; Suheylî, Ravd-ul-unf, I, 91; İbni Habîb, Muhebber, 167; İbni Kesîr, El-Bidâye, III, 290-293.

Mbreti i profetëve u nis bashkë me karvanin, por diçka e veçantë nuk po i shpëtontë askujt prej syve. Mejserja, një nëpunës i Hatixhes së nderuar në të tilla rastë e ndiqtë Besnikun Muhamed a.s. në çdo lëvizje dhe sjellje të Tij. Pas një rrugëtimi të stërgjatë e shumë të lodhshëm, më në fund, ata mbërritën në Siri. Të gjithë, të preokupuar që të gjenin çmimet më të përshtatshme për mallrat që kishin prurë me vetë. Edhe Muhamedi ishtë brenda një orvatjeje të tillë, derisa arriti një marrëveshje të mirë me një tregtar vendës për t'i vendosur edhe pikën kësaj tregtie. Në këtë pikë, tregtari përballë ishtë mërzitur paksa, sepse kërkontë që Muhamedi të kryentë betimin tradicional. Madje, këtë po e kërkontë në emrin e dy idhujve, Latit dhe Uzës. A ishtë e mundur që Ai të betohej mbi këto copa të gjora druri, të bëra veçse nga dora e njëriut? Edhe reagimi i tij do të ishtë ai më i natyrshmi: **''Nuk do të betohesha asnjëherë mbi ta (idhujt), zaten nuk kam asgjë tjetër që ta urrej më shumë së idhujt,''** u thotë Muhammedi a.s.

Më në fund të gjitha punët e tyre në Siri erdhën drejt fundit, andaj pa humbur kohë ata morën rrugën e kthimit për në Mekë. Rruga ishtë bërë e stërmundimshme dhe të gjithë ishin lodhur mjaft, andaj vendosën të bënin një pushim nën hijen e disa pemëve aty pranë. Të gjithë u ulën, dhe ndërsa disa po përkujdeseshin me hesapet e tregtisë që kishin bërë, I Dërguari i Allahut ynë ishtë ulur pranë një peme të moçme e po freskohej sadopak në hijen e saj. Pa kaluar shumë kohë, Mejsere pa dikë që po afrohej me një nxitim të pazakontë. Ky që po afrohej nuk ishtë tjetër, pos murgut Nastura. Ai iu afrua Mejseres për ta pyetur: ''Cili është ai që ka qëndruar nën hijen e asaj pemës atje?'' Mejsere iu përgjigj se Ai ishtë Muhamedi a.s., i biri i Abdullahut, me një fjalë, një nga djelmoshët e familjes. Murgu, në fillim tundi pak kryet kur dëgjoi këtë përgjigje. Filloi të thoshtë disa gjëra të veçanta, për të cilat edhe betohej; **''Ju betohem, se poshtë kësaj peme nuk ka qëndruar askush përpos Profetëve''**. Dukej që Nastura do të thoshtë edhe shumë gjëra të tjera, dhe dukej se e folura e tij sikur nuk dontë kurrsesi që të pushontë; **''Nuk është aspak për të dyshuar se Ai është I Dërguari i Allahut për të Cilin njërëzimi është kaq shumë i etur. Madje është I Dërguari i Allahut i fundit i Njërëzimit''**.

Mejserja vazhdontë të ishtë i habitur nga fjalët, që mbartnin një domethënie kaq shumë serioze, të murgut Nastura. Nuk po arrintë as t'i kuptimësontë dot. Ai nuk harroi t'i bëntë të paktën veshët katër për ta çuar deri në fund, ashtu siç duhej, këshillën e zonjës së tij, Hatixhes; ai po e regjistrontë çdo gjë pa humbur asnjërën prej detajeve të shprehura nga goja e këtij murgu të urtë. Kishtë shumë gjëra që mund t'i mësontë prej këtij murgu. Dukej qartë, se edhe ai kishtë rënë pikërisht në atë që po kërkontë, andaj nuk reshti së kërkuar sa më shumë informacion për Muhamedin. Prandaj, tanimë ishtë ai që e pyestë murgun për të Dërguarin e Allahut, duke i përmendur vazhdimisht edhe dukuritë e pazakonta që i kishin shoqëruar përgjatë gjithë udhëtimit. Ai nuk harroi t'i rrëfentë atij dukurinë e betimit, rrëfim ky që ia shumëfishoi emocionët murgut të shtangur nga një takim kaq i veçantë. Dukej që po gërryhej nga përbrenda. Mendimi i tij tashmë ishtë formësuar thuajse plotësisht, andaj, ashtu i sigurt në vetvetë, ai i tha Mejseres këto fjalë: **''Vallahi, që ky është I Dërguari i Allahut i fundit që në po presim prej kaq kohësh.''** Mandej, i mbërthyer nga emocionët shkoi në drejtim të vendit ku po qëndrontë i Dërguari i Zotit. Fillimisht e puthi në ballë, e në fund iu përul në fund të këmbëve, duke i thënë: **''Unë dëshmoj se Ti, je ai njëriu për të cilin flet Zoti në Tëurat''.**

Pas këtij pushimi, ata u nisën sërish në drejtim të Mekës. Koha ishtë shumë e nxehtë, dhe rrezet e diellit të përvëlonin. Mejserja, gjatë rrugës pa dy engjëj

"Nuk do të betohesha asnjëherë mbi ta (idhujt), zaten nuk kam asgjë tjetër që ta urrej më shumë së idhujt."
Hadith

bardhoshë, të cilët në trajtën e dy reve, po përpiqëshin që t'i bënin hije I Dërguari i Allahutt a.s. dhe për njëfarë kohe nuk po e merrtë dot vetën nga mahnitja. Dy re në një mot të tillë... Mbi të gjitha, dy re që ndjekin pa reshtur të njëjtin njëri... Dy re që e ndjekin tëksa ecën, dhe që ngalakaqën tëksa ai ndalon[40]. Padyshim ky ishtë ndoshta më i veçantë për Mejseren deri më tani; as nuk kishtë hasur ndofarë padrejtësie, apo ndonjë lloj parehatie të brendshme gjatë udhëtimit. E patën çuar dhe vlerësuar mallin ashtu siç duhej, madje i kishin shitur ato me një çmim shumë më të lartë prej atyre çmimeve që mund të ofroheshin në qytëtin e Mekës. Madje edhe mallrat e prura së andejmi, u shitën në Mekë me çmime me të vërtëtë të majme. Më në fund, edhe Hatixhja e gjeti sigurinë që e kishtë kërkuar për aq shumë kohë. Më herët kishtë bërë tregti me çdofarë njërëzish, veçse më Besniku ndër njërëz ishtë krejt i veçantë. Madje nëse do të shihej më me kujdes, halli i vërtëtë i Hatixhes nuk ishtë në faktin se ai ia kishtë shitur me një çmim shumë më të lartë. Këtë ajo e tregoi edhe në padurimin që po tregontë derisa të takontë Mejseren. Me ta parë, zuri ta pyestë për çdo gjë që kishtë ndodhur përgjatë udhëtimit. Mejserja fillimisht filloi t'i flasë asaj për fjalët e murgut Nastura. Mandej zuri t'i flasë për dy engjëjt që e mbronin Atë prej nxehtësisë përzhitëse të diellit. Nga kërkesa për t'u betuar në Siri deri të reagimi i Tij i veçantë, duke ia transmetuar një më një të gjitha fjalët e thëna nëpër këto biseda. Kishtë aq shumë që po i rrëfentë të gjitha këto, saqë herë-herë edhe i përsëristë ato, duke u dukur sikur nuk dontë t'i përfundontë këto fjalë të mira kushtuar një besimi të veçantë. Zatën, këto ishin ato fjalë që po pristë të dëgjontë edhe vetë Hatixhja. Po vdistë përbrenda ngase nuk po i fashistë dot dallgët emocionuese që dallgëzonin në brendësi të shpirtit të saj, të cilat po përpiqëj gjithashtu që t'i fshihtë me sa të mundtë. E si të mos jetë e mundur kjo, kur të gjitha veçse tregonin për Të.

U çua menjëherë për të shkuar pranë mësuesit të saj të përsosur, kushëririt të saj, Uaraka bin Nëufelit. Kësaj here, ajo dontë të ndantë me djalin e saj të xhaxhait pikërisht ndodhitë e rrugëtimit tregtar të karvanit. Edhe Uaraka u prek së tëpërmi nga fjalët që po i thuheshin. Tashmë ishtë edhe ai i sigurt se po i vërtëtoheshin mendimet që kishtë pasur deri më tash. **''Nëse këto që më tregove janë të vërtëta, o Hatixhe, atëherë po ta them se nuk ka asnjë dyshim se Ai është I Dërguari i Allahut i fundit i njërëzimit! E di edhe unë, se për këta njërëz, herët a vonë do të vijë një profet. Zatën kjo është edhe koha që i ngjan më së shumti kohës në të cilën do të vijë ai'',** i tha ai kushërirës së tij.

Kur i Dërguari i Allahut ishte 12 vjeç, ai shkoi deri në Busra për tregti me xhaxhain e tij Ebu Talibin. Kur ishte 17 vjeç, shkoi në Jemen me xhaxhain e tij Zubejrin. Kur ishte 20 vjeç, shkoi në Shamin me Ebu Bekrin, dhe kur ishte 25 vjeç, shkoi përsëri në Sham për të shitur mallrat e Hatixhes. Ai bëri gjithsej katër udhëtime. Përveç këtyre udhëtimeve, nuk bëri udhëtime të tjera.

Martësa Me Hazreti Hatixhen

Pasi Hatixheja mori lajmin nga Varaka bin Nevfel dhe duke parë virtytet e bukura të Pejgamberit tonë të dashur, dëshiroi të bëhej gruaja e tij (Muhammedit a.s.) dhe të nderohej me shërbyer atij. Nefise binti Munije, duke e vërejtur këtë situatë, ndërhyri për ti bashkuar ata. Ajo shkoi te Muhammedi (I Dërguarit të Allahut) dhe e pyeti:

[40] Kastalânî, Mevâhib-i ledunijje, 41.

"O Muhammed! Çfarë të pengon të martohesh?" Pejgamberi ju përgjigj: **"Nuk kam para të mjaftueshme për të martuar."** Nefiseja i tha: "O Muhammed! Nëse dëshiron të martohesh me një grua të ndershme dhe të nderuar, me pasuri dhe bukuri, unë jam e gatshme ta bin d atë që të martohet me ty." Kur Pejgamberi e pyeti: "kush është ajo grua?" ajo ju përgjigj: "Ajo është Hadixhe binti Huvejlidi." Pejgamberi pyeti: "Kush do të jetë ndërmjetës për këtë?" ajo tha: "Unë do ta bëj këtë punë." Ajo u largua nga ai dhe shkoi te Hatixheja dhe i dha lajmin e mirë. Hatixheja thirri të afërmin e saj, Amr bin Esed dhe Varaka bin Nevfel, dhe u tregoi për situatën. Ajo gjithashtu dërgoi një njeri te Pejgamberi për ta ftuar atë. Ebu Talib dhe vëllezërit e tij përgatitën gjithçka dhe shkuan me Pejgamberin tek Hatixhja. Si një shenjë mirënjohjeje për këtë ditë, ajo u dhuroi shërbëtoreve të saj të gjitha zbukurimet e saj. Pejgamberi i Allahut shkoi në shtëpinë e Hatixhes me xhaxhallarët e tij. Ebu Talib tha: "Falënderimi i takon Zotit tonë që na bëri pasardhës të Ibrahimit (a.s.) dhe të Ismailit (a.s.). Ai na bëri mbrojtës të Shtëpisë së Shenjtë. Ai na dha këtë vend të bekuar, të cilin njerëzit e prishën rendin dhe na mbrojti nga çdo të keqe. Djali im, Muhammedi, është më i mirënjohuri nga të gjithë Kurejshët. Edhe pse pasuria e tij është e vogël, por pasuria nuk është gjithçka. Sepse pasuria është si një hije që kalon nga dora në dorë. Nderi dhe superioriteti i nipit tim janë të njohura për të gjithë ju. Tani kërkojmë leje prej Hatixhe binti Huvejlidit që ajo të na thotë se sa e dëshiron shumën e mehrit? Varaka bin Nevfel e vërtetoi këtë bisedë. Amr bin Esed, xhaxhai i Hatixhes, tha: "Jeni dëshmitarë se unë ia dhashë për martesë Hatixhen Muhammedit (a.s.)." Kështu u përfundua akti i martesës. Sipas një rivajeti, mahrin ishte 400 miskal ari, sipas një tjetër rivajeti 500 dirhem, dhe sipas një rivajeti tjetër 20 deve.[41]

"Të gjitha këto pasuri tashmë janë të tuat. Unë jam në shërbimin tënd dhe do të jem mirënjohëse ndaj teje."
Hatixhe b. Huvejlidi Radijallahu anha

Ebu Talibi, për nder të dasmës, theri një deve dhe organizoi një festë të atillë që në Mëkka nuk ishte parë ndonjëherë më pare. Martesa u krye. Hatixheja ia dhuroi të gjithë pasurinë e saj të Dërguarit të Allahut dhe i tha: "**Të gjitha këto pasuri tashmë janë të tuat. Unë jam në shërbimin tënd dhe do të jem mirënjohëse ndaj teje."**

Pa kaluar shumë kohë, edhe kjo familje si çdo simotër e saj filloi të jeptë frytët e saj të para. Fillimisht lindi Kasemi. Pikërisht prej këtij fakti I Dërguari i Allahut (paqja qoftë mbi të) thërritëj edhe me emrin "Ebu Kasem", vetëm se ai ishtë shumë i përkohshëm në këtë botë kalimtare. Nuk kishtë shumë kohë, që sapo kishtë filluar të ectë këmbadoras, kur iu desh të haptë krahë e të fluturontë dhe për të mos u kthyer më udhëtoi drejt Xhenëtit. Kaluan dy vjet prej vdekjes së Kasemit, kur I Dërguari i Allahut i lindi vajza e parë, e cila quhej Zejnep. Ajo ishtë edhe vajza e parë dhe më e madhe e tij. Pas një viti lindi Rukija, dhe tre vjet pas Rukijes erdhi në këtë botë edhe Umu Kulthumi. Ndërsa, nëna jonë, Fatimja do ta nderontë këtë botë me ardhjen e saj në jetë në vitin e parë të revelacionit I Dërguari i Allahutk[42].

I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut) qofshin mbi të, vazhdoi të merrej me tregti edhe pas martesës me Hatixhen. Me fitimet e tyre, ata prisnin mysafirët dhe ndihmonin jetimët dhe të varfërit.

[41] İbni Hishâm, Sîret, I, 43; İbni Sa'd, Tabakât, VIII, 9; Suheylî, Ravd-ul-unf, II, 231; Kastalânî, Mevâhib-i leduniyye, 41; İbni Esîr , Usud-ul-gâbe, I, 23.
[42] Ibni Ishâk, Sîret-i Resûl, 59-61; Ibni Sa'd, Tabakât, I, 82-85; 131-132; Ibni Kethîr, Bidâje, III, 293-295.

Zejd Bin Haris

"Unë nuk zgjedh askënd mbi ty. Ti je si xhaxhai dhe babai im. Dua të qëndroj pranë teje."
Zeid bin Haris

Pas martësës, kur Hatixhjara ndjeu që zemra e ndjeshme e bashkëshortit nuk do të ndihej rehat, nëse ajo mbetëj e pasur ndërsa bashkëshorti nëvojtar i saj, atëherë i shprehu dëshirën që gjithë pasurinë dhe skllevërit e saj t'i dorëzontë në shërbim të tij. "Me të vërtetë e ke?", e pyeti Muhammedisa. Ajo pohoi. "Atëherë, më së pari unë do t'i liroj të gjithë skllevërit", i tha ai. Pasi i mblodhi skllevërit e saj, u tha: "Që sot, të gjithë jeni të lirë". Gjithashtu, edhe pjesën më të madhe të pasurisë ua shpërndau të varfërve.

Njëri ndër skllevërit që ai liroi, që edhe Zejdi, i cili ishtë më i mprehtë dhe më i mençur se të tjerët. Edhe prejardhjen e kishtë nga një familje fisnike. I rrëmbyer nga banditët dhe i shitur disa herë, më në fund kishtë ardhur deri në Mekë. Mençuria dhe urtësia e tij i thoshtë që ai më mirë të rrintë në robërinë e Muhammedit sesa të lirohej. Kështu që, Muhammedi a.s. kur i liroi të gjithë skllevërit, ai i tha: "Ju po më lironi mua, por unë nuk dua të lirohem, dua të qëndroj me ju". Në këtë mënyrë ai mbeti të ai që shquhej për **Besnikëri ("el-Emin)**, pra tëk I Dërguari i Allahut Muhammedsa. Dashuria ndaj tij sa vintë rritëj. Nga ana tjetër, babai dhe xhaxhai i tij, që ishin një familje e pasur, ishin nisur në kërkim të djalit të tyre.

M'dhimbet Zejdi, aspak për të s'di
S'di ku është, gjalle, rob a n'liri

Pse pyet oj zemer kur s'din për të
Nuk e din n'varr, apo n'jetë a gje

Malli i prirndërit për të birin vazhdon në poezinë kështu;

Zejd, o bir! Ah sikur ta dija që të tkhehet i ikuri
Vallahi ktimin tënd do të kerkoja unë i padituri

Aromën tënde e ndjej sa herë degjoj zërin e një fëmije
Sa here lind dielli zgjohme zgjohem me plotësimin e asj dëshire

Pikëllimi nuk gjen fund, mijëra herë më del para ai pikëllim
Dal me pikellimin e shpirtit, rrugëtë mi ka mbuluar ai përmallim

Unë dhe shoqëruesi im kërkojmë pa ditur çfar kërkojmë
Me shpresën se do të gjejme apo për të diçka t'mësojmë

Sado që shpresa ta gënjëjë njëriun ajo prap ka një përfundim
Bijtë e mi Kajs, Amr, Jezîd, Xhebel; Emanët Zjdin, mallin tim

Familjarët e Zejdit ju vunë nga pas gjurmëve të banditëve që e kishin grabitur Zejdin. Ata kishin dëgjuar prej fisit Beni Kelb se e kishin parë atë në Mekka ndaj ata kishin ardhur dhe kishin filluar të pyesnin Mekkasit për fëmijen e tyre. Aty ata morën vesh që djali i tyre jeton me Muhammedin alejhi selam.

Zemra m'digjet, larg jam prej familjes
Larg prej nënë e babe, pranë i jam Qabes

Malli për mua kurrë zemren të mos ju djegi
Gjer në qiej t'mos ju shkoj mallëkimi

Falënderuar qoftë Zoti për familjen që jam
Jam falenderues për nderin dhe t'mirat që kam

Kur arriti në Mekkë, mësoi adresën e shtëpisë së Pejgamberit dhe shkoi pranë të tij duke i thënë: "O zotëri i fisit Kurejsh, o nip i Abdulmutalibit, o bir i fisit të Benî Hashimit! Ju jeni fqinjët e Qabes së shenjtë. Ju nderoni mysafirët, i bëni mirësi robërve dhe i çlironi ata nga robëria. Për lirimin e djalit tonë, që është robi juaj, kërkoni sa para të doni dhe ne do t'i japim, ju lutem, mos e refuzoni këtë kërkesë tonën!" Pejgamberi, (paqja dhe bekimet e Zotit qofshin mbi të), tha: **"Le të thërrasim Zedin dhe ta lëmë të lirë, pra le ta bëjë vetë Zejdi zgjidhjen e tij. Nëse ai zgjedh të vijë me ju, atëherë mund ta merrni pa paguar asnjë para. Por, nëse ai zgjedh të qëndrojë me mua, për Allah, nuk do ta lë atë të shkojë te dikush tjetër."** Harisi dhe vëllai i tij u gëzuan shumë nga kjo përgjigje e Pejgamberit dhe thanë: "Ti na dhe një përgjigje shumë të drejtë dhe të drejtësishme."

Më pas, Pejgamberi thirri Zedin dhe i tha: **"A i njeh këta?"** Zedi tha: "Po, njëri është babai im dhe tjetri është xhaxhai im." Pastaj Pejgamberi i tha: **"O Zed, ti e di kush jam unë, e ke parë dashurinë dhe dhembshurinë time për ty. Këta kanë ardhur për të të marrë. Zgjidh, ose më zgjedh mua dhe qëndron me mua, ose i zgjedh ata dhe shkon me ta."** Babai dhe xhaxhai i Zeidit menduan se ai do t'i zgjidhte ata dhe do të shkonte me ta. Por Zedi tha: "Unë nuk zgjedh askënd mbi ty. Ti je si xhaxhai dhe babai im. Dua të qëndroj pranë teje." Babai dhe xhaxhai i tij mbetën të habitur. Babai i tij, me zemërim, i tha Zeidit: "Mjerë për ty, si mund të zgjedhësh skllavërinë mbi lirine me nënën tënde, babanë dhe xhaxhain tënd!" Zedi iu përgjigj babait të tij: "Baba im, unë kam parë aq shumë dhembshuri dhe mirësi nga ky person, saqë nuk mund ta zgjedh askënd tjetër veç tij."

Pejgamberi e donte shumë Zedin. Kur e pa këtë përkushtim dhe dashuri nga ana e Zedit, e mori atë në Qabe, në vendin e Hixhrit dhe ju drejtua të pranishmëve duke ju thënë: **"Dëshmoni se Zedi është biri im. Ai do të jetë trashëgimtari im dhe unë do të jem trashëgimtari i tij."** Kur babai dhe xhaxhai i Zedit e panë këtë situatë, zemërimi i tyre kaloi dhe ata u kthyen në vendin e tyre me gëzim. Pas kësaj, sahabët filluan ta quanin Zedin "Zed bin Muhammed" (Zedi, biri i Muhammedit). Më vonë, me shpalljen e ajetit të pestë të sures Ahzab: **"Thirrini bijtë tuaj me emrat e etërve të tyre, kjo është më e drejtë te Allahu."** Dhe ajeti i 40 i të së njëjtës sure: **"Muhammedi (alejhisselam) nuk është babai i asnjë burri prej jush,"** Birësimi u ndalua dhe Zedi filloi të quhej me emrin e babait të tij, domethënë "Zed bin Harise" (Zedi, biri i Harises)[43]

[43] Buhârî, Tefsîr, 2; Ibni Sa'd, Tabakât, I, 487

Ndermjetësimi Në Qabe

Kur Muhammedi a.s. ishtë në moshen tridhjetë e pesë vjeçare, u be ndërmjetësuesi për mosmarrëveshjet që kishin dalë ndermjet fiseve Mekkase. Atëherë në Mekke kishin rënë shumë reshje dhepërmbytjet kishin dëmtuar muret e Qabes[44], për këtë arsye Mekkasit e shkatërruan Qaben deri në vëndin e pikënisjes së Ibrahimit a.s. dhe çdo fisi kishtë marrë përgjegjesi për të dnërtuar muret e saj. Por kur erdhi koha për të vendosur gurin ''Haxherul-Evsed'' lindi moshmarrëveshja sa që Mekkasit ishin të gatshëm ti drejtonin armët njëri tjetrit. Sepse vendosja e gurit të shenjtë ishtë një nder i veçantë dhe ketë veçori e donin të gjithë. Po kalonin kohe dhe Qabja kishtë mbetur ashtu pa u përfunduar.

Një ditë kushuriri i Abdulmutalibit Mugirja tha se; '' o Kurejshit ju propozoj që ta zgjidhni këtë mosmarrëveshje duke ja lënë në dorë atij të cilit hyn i pari në derën e quajtur Beni Shejbe''. Mekkasit u pajtuan me këtë propozim të tij dhe po prisnin se kush do të jetë ai i nderuari që do të nderohet me vendosjen e gurit Hazxherul-Evsed. Kup a pritur në atë derë u duk Besniku (El-Emin) Muhammedi a.s.. Kur e panë Mekkasit u gëzuan dhe thanë se; ''jemi të kënaqur me vendimin e tij sepse ai nuk na ka zhgënjyer kurrë''.

Kurejshitët ju afruan Muhammedit a.s. dhe i treguan për vendimin që kishin marë para hyrjes së tij në Qabe. Atëherë ai mori një batanije dhe e vondosi gurin mbi të dhe ju tha Kurejshitëve që, të sjellin nga **një përfaqësues i çdo fisi të mbaji një cep të batanijes dhe ta ngrenë gurin deri në vendin ku do vendosej.** Pasi ata e bënë këtë atëherë ai e mori gurin dhe e vendosi në vëndin e duhur. Dhe kështu u mbyll konfliki i Mekkasve dhe përfundimi i mureve të Qabes u krye pa asnjë lloj problemi[45].

[44] Ibni Kethîr, Sîre, I, 273; Edhrakî, Ahbâr-u Mekke, I, 158-160; Bejhekî, Delâil, II, 57
[45] Ibni Ishâk, Sîret-i Resûl, 83-105; Ibni Hishâm, Sîret, I, 192-198; Ibni Sa'd, Tabakât, I, 145-147; Ibni Kethîr, Bidâje, III, 298-305.

PËRIUDHA E MEKKES DHE ARDHJA E PROFETËSISË

I nderuari i universit që kur ishtë në moshën **tridhjetë e shtatë vjeçare** pati filluar të shohi ëndërra të çuditshme të cilat ai i ndantë me bashkeshortën e tij Hatixhenë. Pak para se ti vijë shpallja, **kur ai ishte në moshën tridhjet e tetë vjeçare**, ai mori pjesë në panairin e përvitshëm që organizohej në Mekka. Në atë panair Kus bin Said i hipur mbi deve po ju mbantë fjalim të pranishmëve, i cili gjatë fjalimit po ju thostë se;

Muhammedi, paqja e Allahut qoftë mbi të, vendosi Haxherul Esvedin mbi mantelin e tij të bekuar dhe tha: "Le të mbajë nga një cep të tij një person nga çdo fis."
I dashuri ynë Muhammed Emin (paqja dhe bekimet eAllahut qofshin mbi të).

''O njërëz! Ejani dhe dëgjoni, hapni sytë dhe merni mësim! I gjalli padiskutim që do të vdesi, dhe këtë nuk e ndalon askush!... Hapni veshët dhe dëgjojeni mirë se; sipas shenjave të kohës është afruar koha e ardhjes së peygamberit për të cilin Allahu ka paralajmëruar. Ajo kohë nuk është e largët. Hija e tij po qëndorn mbi kokën tuaj. Lum kush do e dëgjoi dhe lum kush do ta pasojë atë. Mjerë ai që do ta kundërshtoi dhe mjerë ai që do ta përgënjështrojë atë. Mallkuar qofshin ata që komunitëtë që jëtojnë në shthurje!...''

Atë kohe në Mekka populli jetontë në shthurje dhe i ndarë në shtrësa, të varfërit, të pasurit, skllevërit dhe patronët. Më i forti e shtyptë pa pikën e mëshirës të dobëtin, patronët silleshin në menyre barbare me skllevërit. Të pafuqishmëvë ju merrej pasuria me dhunë. Frika dhe besimi ndaj Allahut pothuajse kishtë humbur ndikimin dhe ishtë larguar prej asaj shoqërie. Të gjitha llojet e imoralitëtit ishin përhapur në atë shoëri, dhuna, imoralitëti, bixhozi, alkooli, vjedhjet, vrasjet, kacafytjet, rrembimi i pasurise me dhunë, varrosja e vajzave të gjalla ishin aq të përhapura sa që askujt nuk i bëntë ndonjë përshtypje dhe as nuk kishin të ndalur. Ofshamat dhe dhimbjet e të shtypurve dhe atyre që përjetonin prej padrejtësive nag më të ndryshmet kishtë kapluar qiellin. Për çudi dhunuesit dhe zullumqarët pas gjithë këtyre veprimeve antinjoorëzore e quanin dhe e mbanin për nderë të madh adhurimin e idhujve.

Prj kohës se Ademit a.s. marrëzira të tilla nuk ishin përjetuar në rruzillin tokësorë, pra prej fillitit të jetës në tokë dhuna, imoralitëti, maskarat dhe shthurjet nuk kishin arritur një kulm të tillë. Njërëzit e kohës ishin kthyer në egresira xhungle. Shoqëria ishtë kthyer në një armiqësi me njëri tjetrin dhe në çdo kohë pritëj përplasja e dhunshme. Për ti qëtësuar dhe për të sjell paqën ndërmjët njërëzvë pritjej ai shpëtimtari i shumëpritur, ardhja e të cilit do ti dergontë njërëzit në një harmoni dhe paqë të përherëshme.

Erdhi ajo koha që pritëj të vintë të dashurit tonë Muhammedit a.s. kishtë filluar ti vinin ëndërra paralajmëruese për dërgimin e tij si Profet të Fundit në këtë botë të fundme. Çdo gjë që shihtë në ënderr ju bëntë realitët, kjo gjëndje po thuajse zgjati më shumë se gjashtë muaj. Kur po afrohej koha e ardhjes se shpalljes, pati filluar të dëgjintë zëra që thirrnin **''O Muhammed''**. Prej kësaj kohe ai ishtë në kërkim të qëtësisë dhe për këtë kishtë filluar të diltë në shpellën e quajtur Hira në të cilën meditontë gjatë e gjatë. Herë pas here zbristë në Mekka, vizitontë Qaben dhe shkontë në shtëpi, qëndrontë një kohe më pas merrtë ushqimin e duhur dhe diltë sërish në shpellën Hira. Madje ndodhtë që të qëndrontë me dit atje, ushqimin ja dërgontë e shoqja Hatixhe.[46]

[46] Ibni Hishâm, Sîret, I, 233-240.

Hera e Pare e Shpalljes (Vahji i Pare)

Kur Muhammedi a.s. **ishtë në moshën dyzetvjeçare** sikur herët e tjera ndodhej në shpellën Hira, ishtë muaji i Ramzanit dhe ai ishtë zhytur në meditimet e tij. Ishtë ditë e hënë e mujit Ramazan pikërisht në datën 17 të këtij muaji, pasi kishtë kaluar gjysma e natës dëgjoi një zë që i thirrtë në emëee. Ngriti koken dhe pa rreth e rrotull kur dëgjoi po të njëjtin zë dhe pa një dritë e cila kishtë ndriçuar mbarë vëndin. Dhe u paraqit Xhebrail Emini aljehi selam i cili i tha **''Lexo!''. ''Unë nuk dit ë lexoj''** ja ktheu Muhammedi a.s.. Atëherë ënjgëlli Xhebrai a.s. e shtrenogi dhe i tha **''Lexo!'',** ndërsa ai sërisht ja ktheu **''unë nuk di të lexoj''**. Xhebraili eshtrengoi edhe me fort duke i thënë për të tretën herë **''Lexo''**, ndersa ai përsëri ja ktheu **''unë nuk dit të lexoj!''** Xhibril duke e lëshuar Muahmmedin a.s. i citoi ajetët e para të Kuranit pikërisht 5 ajetët e para të kaptinës Alak **'' Lexo me emrin e Zotit tënd, i cili krijoi (çdo gjë). Krijoi njëriun prej një gjaku të ngjizur (në mitrën e nënës). Lexo! Se Zoti yt është më bujari! Ai që e mësoi (njëriun) të shkruaj me pendë. Ia mësoi njëriut atë që nuk e dintë.''**[47] Muhammedi a.s. i përsëriti këto ajetë së bashku me të dhe keshtu lindi dielli i ditës së parë njëkohësisht dhe dita kur filloi ndriçimin e mbarë njërëzimit.[48]

I Dërguari i Allahut u tremb dhe e kapi një panik i papërshkruar, menjëherë nxitoi për të e shoqja, Hatixhja. Kur po zbristë malin Xehbraili a.s. i doli dhe një herë para dhe i tha; **''O Muhammed a.s. ti je i Dërguari i Allahut dhe unë jam Xhebraili.''** Pas keetyre fjalëve Xhebraili i ra tokës me krahët tij dhe aty doli ujë, ai filloi të marre abdest ku njëkohesit e mësoi dhe Muhammedin a.s. të merrtë abdest. Më pas Xhebrail u bë imam ndërsa Muhammedi qëndroi pas tij ku falën dy rekat namaz. Pastaj Xhebraili i tha **'' O Muhammed a.s., ke selam prej Allahut. Ti je derguar Pejgamber për mabarë njërëzit dhe xhindët, ndaj thirri ato ti besojnë Njëshmërisë se Allahut (Tëvhidit).''** Kjo ishtë hera e parë që Muhammedi a.s. mësoi se ai që po i flistë dhe po dëgjontë ishtë Xhebrail Emini.

Selami I Gurëve Dhe Drurëve

"O ti (Muhammed) i mbështjellur në rroba! Ngrihu dhe këshillo! Dhe madhëroje Zotin tënd!"
Mudethir, 1-3

Ndërsa I Dërguari i Allahut Muhammedi a.s. po kthehej për në shtëpi dëgjontë gurët dhë drurët **''Esselamu Alejkum O i Derguar i Allahut''** kur i jepnin selam atij. Sapo hyri në shtëpi ju lut të shoqës që ta mbulontë me fjalet **''me mbuloni! Me mbuloni''** dhe i dridhej i tërë trupi. Pasi u qëtësua i tregoi të shoqës Hatixhes gjithçka i kishtë ndodhur. **''Xhebraili a.s. erdhi, me takoi dhe iku, por madhështia, presioni dhe frika ndaj tij ende nuk më ka ikur. Kam frikë se këtu e mbrapa do me thonë njërëzit injorant dhe do me përjashtojnë nga shoqëria si të çmendur.''** Ndërsa e shoqja ja ktheu; ''Allahu të ruajt, Allahu prej tëje kerkon sinqëritët dhe mirësi, Ait ë ka behatuar me urtësi dhe virtytë të pa fundme dhe unë besoj se ti je I Dërguari i Allahut i Fundit që Allahu ka dërguar për njërëzimin. Ndaj mos u tremb sepse ti i respekton misafirët, je i drejtë dhe e fol të drejtën. I ndihmon nëvojtarët, i përkrah jetimët dhe ju gjëndesh të vetmuarve. Ti je njëri me virtytë të larta dhe kushdo që i zotëron keto virtyte nuk duhet të trembet.''[49]

[47] Alak: 96/1-5.
[48] Ibni Sa'd, Tabakât, I, 196.
[49] Taberî Târih, II, 298-302; Belâdhûrî, Ensâb, I, 108-110.

Për të mësuar me shumë për këto ndodhi u nisën për të Varaka Bin Nëfvel. Varaka pasi dëgjoi atë që i tha i dërguari i Allahut xh. sh. tha; ''Urime Muhammed a.s., pa dyshim që ti je i Derguari i Allahut i fundit, për të cilin ka folur Isa a.s. më parë. Ai që të është shfaqur ty është Xhebraili, ëngjëlli që ju sjell shpalljen proftëve, ai më parë i ka ardhur edhe Musës a.s.. Ah sikur të isha më i ri që të gjënsësha pranë tëje kur të të përzenë nga Mekka, pra të isha ndihmësi dhe mbështëtësi yt kur ty të bëhen padrejtësi. Shumë shpejt ty o Muhammed a.s. do të vijë urdhëri prej Allahut që ti thirresh njërëzit në fenë e allahut dhe ti luftosh padrejtësitë, dhunuesit dhe zullumqarët.'' Por Varaka nuk jetoi më gjatë pas një kohe të shkurtër ai ndërroi jetë.

Ardhja e Urhdërit Për Thirje Në Islam

Prej ardhjes së vahjit (shpalljes) së pare kaloi një kohë e gjatë dhe I Dërguari i Allahutt a.s. nuk i erdhi më vahij. Muhammedi a.s. ishtë tëpër i shqëtësuar. Por pas një kohe, sipas disave thuhet se kjo kohe ka zgjatur afer tre vjet, u duk edhe një herë Xhabraili a.s. dhe e qëtësoi Muhammedit a.s. duke i thënë '' o i Dashuri i Allahut! Ti je i Dërguari i allahut Tëala''. Muhammedi a.s. këtë e ka transmetuar kështu;

''Ishtë koha kur nuk me erdhi më vahij, unë isha në shpellën Hira dhe po zbrisja poshtë malit kur dëgjova një zë. Ngrita koken të shoh se kush është ky që po me flet dhe pashë Xhebrailin a.s.. Ishtë ulur në një kursi (koltuk) që qëndrontë ndërmjet qiellit dhe tokës. Mua më kapi paniku dhe vrapova drejt edhe për në shtëpi dhe i thash bashkeshortës; Më mbuloni me ndonjë mbulesë. Sapo më mbuluan më erdhi vahij nga Allahu 'O ti i mbuluar! Ngrihu dhe tërhiqu vërejtjen (duke i thirrur). Dhe madhëroje Zotin tënd! Dhe rrobat e tua pastroji!'[50]. Keto ishin ajetët e para të sures Muddethir dhe prej asaj kohe nuk u ndërpre me vahji.''

"Unë jam Muhammedi a.s. që nuk di as shkrim dhe as lexim... Pas meje nuk do të ketë më të dërguar (Unë jam I Dërguari i Fundit). Dhe ai nuk flet nga mendja e tij. Ai (Kurani) nuk është tjetër pos shpallje që i shpallet."
Nexhm 3,4

Prej kësaj kohe I Derguari i Allahut Muhammedi a.s. filloi ti thërras njërëzit në Fenë e Allahut, pra në Islam. Kur Xhebraili a.s. ja silltë vahjin nga një herë i vintë në formen e njëriut, sahabet e kishin përngajsuar me sahabiun Dihje Kelbin. Nga njëherë vahji i vinti në formën e inspirimit në zemër, këtë Muhammedi a.s. nuk e shihtë me sy, dhe nga një herë i vintë në ëndërr dhe nga një herë i vintë në formën e një bubullime (zhurme) të llahtarshme. Kjo ishtë ardhja me e vështira për Muhammedin a.s. , kur i vintë ky lloj vajhi atij ai djerësitëj madje edhe kur ishtë klima më e ftohtë atë e mbulonin djersët dhe kur ishtë mbi deve, deveja gjunjëzohej në tokë, ndërsa kur e shihnin këtë gjëndje sahabet e kuptonin vështirësinë e vahjit. Ndersa Xhebraili a.s. i vintë në pamje të ndryshme por disa herë i ka ardhur në formën e tij origjinale.

Ka ndodhur dhe që Muhmmedit a.s. i ka ardhur vahji drejt për sëëdrejti nga Allahu xh.sh., pra pa ndërmjetësimin e ëngjëjve, dhe kjo ka ndodhur në natën e Miraxhit.

Prej kohës kur i erdhi shpallja e pare Muhammed Mustafait a.s. kohëzgjatja e Pejgamberllëkut ka zgjatur njëzet e tre vjet. Gjatë kësaj kohe ai trembëdhjet vitë ka jetuar në Mekka ndërsa dhjet vitët e tjera i ka jetuar në Medinë. Ndërsa Kur'ani Kerimi ka zbritur për përiudhë kohore 22 vjet e 2 muaj e 22 dit.

[50] Muddethir: 74/1-4.

Muhammedi a.s. ishtë analfabet (nuk dintë shkrim-lexim). Pra nuk dintë as të lexontë, as të shkruantë dhe as nuk kishtë marrë qoftë edhe një ditë mësim prej askujt. Kishtë lindur në Mekka dhe ishtë rritur sikur të gjithë fëmijët e tjerë. Dhe në këtë gjëndjë ai dha leksionë për Tëvratin, Ungjillin, për librat dhe ndodhitë në Botën Helenë dhe Romake. Në vitin e gjatë dhe të shtatë të profetësisë ai i dërgoi letra përandorivë më të mëdha të kohës që ishin; Përsët, Bizantinët dhe Habeshianët por edhe lidërve që udhëhiqnin atë kohë botën Arabe.

Për ta takuar dhe për të mësuar për të, e vizituan mbi gjashtëdhjet ambasadorë (përfaqësuës) të huaj nga e gjithë bota që kishin dëgjuar për Muhammedin a.s. Në Kur'an thuhet **'' Ti (Muhamed) nuk ishe që lexon ndonjë libër para këtij, e as që e shkruan atë me dorën tënde të djathtë, pse atëherë do të dyshonin ata të prishurit.''**

Ndërsa në një hadith ai thotë se; **''Unë jam Muhammedi a.s. që nuk di as shkrim dhe as lexim... Pas meje nuk do të ketë më të dërguar (Unë jam I Dërguari i Fundit).**[51] Dhe në Kur'an thuhet se; **'' Dhe ai nuk flet nga mendja e tij. Ai (Kurani) nuk është tjetër pos shpallje që i shpallet.''**[52]

Myslimanët e Parë

Pas ftësës dhe qartësimit që i Dërguari i Allahut u bëri njërëzve për të ndjekur udhën e drejtë të adhurimit të Allahut Krenar dhe të Lartësuar, nuk vonoi të vintë përgjigjja e njërëzve nga çdo fis. E para që pranio Isalmin ishtë Hatixheja[53] bashkëshortja e nderuar e Pejgamberit tonë të dashur. Pra thirrjes së të I Dërguarit të Allahut xh.sh nuk vonoi t'i përgjigjej edhe e sinqërta e grave, Hatixhe Bintu Huvejlidi, e cila, me të vërtëtë i plotësoi si duhej detyrat dhe kërkesat e gradës së njërëzve të sinqërtë dhe të çiltër.

Pasi ishtë takuar me Xhibrilin dhe pasi kishtë dëgjuar për herë të parë fjalën e Allahut, I Dërguari i Allahut (alejhi selam) u kthye i tronditur nga shpella Hira dhe shkoi tëk Hadixheja të cilës i tha: "U tremba.". Ajo i foli ëmbëlsisht duke e përgëzuar: **"Betohem në Allahun e Lartësuar, se Ai kurrë nuk ka për të të poshtëruar."** E si e argumentoi ajo qëndrimin e saj? Duke parë se I Dërguari i Allahut alejhi selam gëzontë cilësi të shkëlqyera dhe moral të lartë, kjo i shërbeu si argument për faktin se një njëri i tillë, kurrë nuk mund të poshtërohet. Ajo e kuptoi me mendjen e saj të madhe dhe me natyrën e saj të pastër e të papërlyer, se cilësitë e shkëlqyera, morali i lartë dhe vlerat e vyera, nuk mund të kenë frytë të tjera përveç nderimit dhe shpërblimit të madh nga Allahu i Madhëruar; ato meritojnë veç ndihmën, bamirësinë dhe suksesin e dhënë prej Tij.

Këto veçori qëndrojnë shumë larg poshtërimit dhe humbjes. Poshtërimi dhe humbja janë rrjedhojë e cilësive të poshtra, e moralit të ulët dhe pasionëve të shfrenuara. Atij, të cilin Allahu i Madhëruar e ka brumosur me cilësitë dhe veprat më të mira, Ai ka për t'ia përsosur këto dhunti. Ndërsa ai që mësohet me cilësitë dhe veprat më të këqija dhe më të poshtra, do të gëzojë veçse atë që i shkon për shtat natyrës së tij. Ky sinqëritët dhe kjo mëndje hollësi e saj, e bëri plotësisht të meritueshëm **''selamin që Allahu i Madhëruar, Zoti i saj, i dërgoi asaj me anë të**

[51] Hejsemî, Mexhma'udh-dhevâid, I, 205.
[52] Nexhm: 53/3-4.
[53] Ibni Haxher, El-Isâbe, IV, 281-283.

Xhibrilit dhe Muhamedit (a.s.).''[54] Një herë tjetër I Derguari i Allahut Muhammedi a.s. thotë se; **''Allahu mua dhe Hatixhes r.a. n aka përgëzuar me një shtëpi në xhennët, aty nuk ka dhimbje koke, as shqëtësime, as prishje qëtësie dhe asnjë lloj sëmundje.''**

Pas Hatixhes r.a. ai që e pranoi Islamin ishtë Ebubekri radijallahu anhu. Një nga përsonalitëtët më të veçantë mes sahabeve të Dërguarit të Allahut. I veçantë në besnikëri, i veçantë në drejtësi, i veçantë në sakrificë. Një jetë e mbushur plot e përplot me mirësi dhe shembuj për të gjithë ata që kërkojnë të instalojnë diçka në jetët e tyre sot.

Ebubekri r.a. jetoi pastër edhe para Islamit. Qoftë edhe një moment të vetëm, nuk i bëri dëm asnjë sendi frymor, apo jo frymor. Që në ato kohë pëlqëhej nga shoqëria e Mekës. Ishtë njëri me reputacion, i pasur dhe referencë për të dobëtit. E karaktërizontë miqësia e ngushtë me të Dërguarin e Allahut edhe pse Islami nuk kishtë ardhur akoma. Kur dëgjoi për thirrjen e Muhammedit a.s. Ebubekri shkoi dhe ju paraqit atij. Pra shoku i tij i fëmijërisë, Ebubekri kishtë qënë jashtë Mekës. Sapo hyri në qytët, dëgjoi pëshpërimat që shoku i tij ishtë çmendur, sepse thoshtë se i zbritka një engjëll prej qiellit dhe i paska folur. Pa u vonuar, Ebubekri shkoi të shtëpia e I Dërguari i Allahutt Muhammed a.s. dhe i trokiti në derë. Kur ai doli, Ebubekri e pyeti nëse lajmi i shumëpërfolur është i vërtëtë apo jo. Për të mos humbur shokun e fëmijërisë, I Dërguari i Allahutsa nisi t'ia shpjegontë hollësisht. Por Ebubekri nuk e lejoi dhe tha: **"Më thuaj vetëm kaq që a të erdhën engjëjt e Zotit dhe biseduan me ty apo jo?"** I Dërguari i Allahut a.s. përsëri filloi të ja shpjegontë, por ai sërish i refuzoi të dëgjontë shpjegime dhe i kërkoi t'i jeptë përgjigje me po, ose jo. Kur I Dërguari i Allahut a.s. iu përgjigj me pohim, Ebubekri tha: **"Deshmoj se nuk ka Zot tjetër veç Allahut dhe Deshmoj se Ti je I Derguari i Fundit i Allahut. Bëhu dëshmues që unë të pranova ty."**

Sipas një transmetimi tjetër thuhet se Ebubekri r.a. para se ti vintë shpallja Muhammedit a.s. kishtë shkuar për tregëti në Jemen. Atë kohë në Jemen jetontë një njëri në fisin Ezd i cili njihej si një njëri ëe ka lexuar librat e shenjtë. Ai takohet me Ebubekrin dhe e pyet se prej nga vintë dhe kur ky i përgjigjet se vintë nga Mekka ai e pyet;

- A mos valle je prej Kurejshitëve?

- Po!

- Je prej fisit Tëmim?

- Po

- Edhe një pyetje tjetër kisha nëse më lejoni?

- Po, urdhëroni, i përgjigjët Ebubekri.

- A mund ta shikoj barkun tënd?

Cila është arsyeja dhe urtësia e këtij shikim?

Kam lexuar në librat e shenjtë se në Mekka do të dërgohet një pejgamber. Atë do ta ndihmojnë dy veta. Njëri i ri dhe tjetri i plakur. I riu ja lehtëson vështirësitë, ndërsa i vjetri thuhet se është i bobët dhë lëkurbardhë në barkun e të cilit gjëmdet një pullë e zezë dhe veçoritë e tij duken se i posedon ti. Dhe pasi pa Ebubekrin i tha

[54] Hâkim, Mustedrek, III, 206; Ibni Hishâm, Sîret, I, 241; Suhejlî, Ravd-ul-unf, II, 416.

atij se ti je ai për të cilin kanë folur librat e shenjtë. Do me thënë se I Dërguari i Allahut fundit paska ardhur dhe ti je ndihmësi i tij.[55]

"Sâbıkûn-i Islâm (Myslimanët e Parë): Ebû Bekr-i Sıddîk, Ali bin Ebî Tâlib, Zejd bin Hâris, Osman bin Affân, Abdurrahmân bin Avf, Sa'd bin Ebî Vakkâs, Zubeir bin Avvâm, Talha bin Ubedullah." ***"radijallahu anhum exhmain"***

Thuhet se më vonë kur Ebubekri pranoi Islamin e ka transmetuar këtë ngjarje që i ka ndodhur në Jemen. Sipas këtyre transmetimeve Ebubekri ka parë dhe ëndërra të ngjashme me ngjarjen që ai përjetoi në Jemen. Dhe kur pranon Islamin thotë se ''sot u realizua ëndërra ime dhe ngjarja që përjëtova në Jemen.

Nga transmetimet e vajzës së tij, që njëkohësisht është bashkëshortja e Muhammedit a.s., Aishja r.a. tregon për të atin (Ebubekrin) se: ''Një ditë, babai doli nga shtëpia. Isha e bindur se po shkontë të Zotëria i Njërëzimit Muhammedi a.s.. Ata ishin shokë ende pa ardhur Islami. E njihnin shumë mirë njëri-tjetrin. Ebubekri hyri të shtëpia e të Dërguarit të Allahut Muhammedit a.s. dhe i tha: "O Ebul Kasim, po na mungon shumë nëpër kuvendet tona. Nuk po merr më pjesë. Për më tëpër, po flitët keq për prindërit e tu." I Dërguari i Allahut i tha: **"Unë jam i Dërguari i Allahut. Po të ftoj t`i besosh Allahut."** Ebubekri r.a. u bë mysliman akoma pa përfunduar fjalët Muhammedi alejhi selam. Ai u lumturua aq shumë kur Ebubekri u bë mysliman, sa nuk besoj se gjendej ndokush tjetër atë ditë më i lumtur sa ai." Ndërsa në një transmetim tjetër Aishja r.a. transmeton prej të Dërguart të Allahut e cila tregon se: "Këdo që kam ftuar në besim, pa dyshim që ka përjetuar një moment mëdyshjeje, përveç Ebubekrit." Një ditë tjetër, i Dërguari i Allahut e risolli edhe një herë në qëndër të vëmendjes cilësinë e hz. Ebubekrit dhe iu drejtua kështu të pranishmëve: **"Nuk ka dyshim që Allahu më ka dërguar pejgamber për ju. Kur unë jua përcolla juve këtë, të gjithë më thatë 'gënjën'. Ndërsa Ebubekri më tha: "Ke thënë të vërtëtën" dhe bashkë me fjalën e dhënë, i besoi kaq shumë kësaj rruge saqë dha çdo gjë nga aftësitë e tij dhe nga pasuria e tij. Më pas, përsëriti dy herë: "Tani, nuk do të ma mërzisni më mikun tim, apo jo?"**

Në fillim, këto gjëra i dinin vetëm i Dërguari i Allahut Muhammedi a.s dhe e shoqja e tij Hatixhja. Mirëpo një ditë, Aliu hyri në dhomë dhe e gjeti të Dërguarin a.s. me Hatixhenë duke falur namazin. Ai i hutuar i pyeti se ç'janë duke bërë. I Dërguari i Fundit Muhammedi a.s. i shpjegoi atij se; ''ishin duke iu lutur Allahut dhe duke e falenderuar Atë''. Atë natë Aliu mbeti zgjuar duke menduar shumë rreth tërë asaj që i Dërguari a.s. i tha; ai e admirontë shumë dhe e çmontë kushëririn e tij. Më në fund mori vendimin e të nësërmen shkoi tëk i Dërguari a.s. dhe i tha se dëshirontë që të bëhej myliman[56]. Muhammedi a.s. e priti me shume gëzim këtë vendim të Aliut r.a. Kështu, Hatixheja ishtë gruaja e parë që përqafoi Islamin, mësimet e të cilit i Dërguari a.s. i solli prej Allahut kurse Aliu ishtë i riu i pare dhe i treti që pranoi Islamin. Dhe prej ditës që pranoi Islamin deri në momentin e fundit të jetës Ali r.a. ishtë një ndër sahabët që ka sakrifikuar më shumë për Islamin.

Pas pak kohe, atyre iu bashkangjit edhe Zejd ibn Harithi që ishtë një rob të cilin e kishtë liruar I Dërguari i Allahut Muhammed a.s. dhe thuhet se Zejdi ishtë i pesti që pranoi Islamin.

[55] I nderuar lexues keto trasnmetme te autorit janë trillime më shum se transmetime te literaturës Islame. Keto tregime jane shpikur kohët e vona me pretendimin për të ngritur figuren e Ebubekrit, por ata nuk kanë nevojë për të tilla trillime sepse ata u ngriten me sinqëritetin dhe vendosmerine ne sakrificat dhe sfidat që treguan ne rrugën e të dërguratit të Allahut. Pra për fëmijërinë e Ebubekrit nuk ka snjë transmetim të saktë që flet në dëtaje për të. (Përkthyesi).

[56] Ibni Ishâk, Sîret-i Resûl, 120-121; Ibni Hishâm, Sîret, I, 249-250.

Me pranimin e Islamit Ebubekri menjëherë filloi punën për thirrjen e shokëve në Fenë e Allahut xh.sh., në fillim fshehurazi dhe më vonë haptazi kur ju leju nga I Dërguari i Allahut Muhammed a.s. Në fillim ai shkoi tëk Osmani, Talha, Zubejra dhe Seidi r.a. Ata e pranuan Islamin me predikimin e tij. Ditën tjetër ai shkoi tëk Osman bin Mazun, Abu Ubaidah, Abdur Rahman bin Auf dhe disa Kuraish të tjerë të shquar. Ata gjithashtu e pranuan Islamin me predikimin e tij. Në predikimin e parë të dhënë nga Ebu bekri e pranuan Islamin tëtë figura të shquara. Nga këta ishtë Osmani r.a., khalifi i tretë i Islamit. Kështu ai ishtë burri i parë që pranoi Islamin mbas I Dërguari i Allahutt a.s, dhe që thirri njërëzit në Fenë e Allahut me një rrugë të frytshme.Shkaku kryesor i suksesit të tij ishtë popullaritëti që kishtë tëk Mekkasit për sinqiritëtin dhe fisnikërinë e tij. Këtyre që pranuan Islamin pas Hatixhes r.a. quhen **Sabikun-i Islam** që do të thotë **mylimanët e pare.**

Osmani r.a. tregon se ai kishtë një të afërm i cili kishtë dëgjuar për Profetësinë e Muhammedit a.s. dhe i kishtë thënë Osmanit. Muhammedi a.s. i ka ardhur shpallja (vahji) pa diskutim që nëse ai e thotë të vërtëtën drita e tij do të përhapet në mbarë botën. Ndaj o kushiriri im nëse dëgjon për thirrjen e tij mos e refuzo sepse do vijë një kohë që të gjithë do ti binden atij. Osamani r.a. vazhdon më tëj. Unë isha shok i ngushtë me Ebubekrin r.a. dhe kisha dëgjuar që ai i ishtë bashkangjitur Muhammedit a.s. por me vintë rëndë ta pyesja, por kur më erdhi Ebubekri dhe me foli për Fenë e Allahut xh.sh. unë e pranova thirrjen e tij pa hezituar fare. Me pas Ebubekri r.a. më dërgoi tëk i Dërguari i Allahut Muhammedi a.s. i cili më tha **'' Osman të fton Allahu Tëala në xhennët. Pranoje ftësën e Allahut. Unë jam i Dërguari i Fundit i Allahut dhe jam dërguar për të thirrur mbarë njërëzimin në rrugën e Allahut.''** Pas këtyre fjalëve të I Dërguari i Allahutt Muhammed a.s. unë pranova ftësën e tij dhe dëshmova shehadetin **(Eshhedu En Lâ İlâhe İllallah Ve Eshedu Ennë Muhammeden Abduhu Ve Resûluhu).**

Prej ardhjes së vahjit Muhammedi a.s. i thirri njërizit fshehurazi në Islam. Sipas transmetimeve thuhet se ai tre vitët e para i thirri njërëzit fshehurazi dhe pas tre vitëve numri i atyre që kshin pranuar Islamin shkontë deri në 30 përsona. Ata i kryenin ritët fshehurazi dhe ajetët e Kur'anit i mësonin fshehurazi nëpër shtëpitë e tyre.

Thirrje Të Afërmëve

"Dhe tërhiqju vërejtjen farefisit tënd më të afërt."
Shu'arâ: 26/214.

Sikur u përmend më lart prej zbritjes së ajetëve të sures Muddethir Muhammedi a.s. i thirrtë njërëzit fshehurazi në Islam por me zbritjen e ajetit **'' Dhe tërhiqju vërejtjen farefisit tënd më të afërt.''**[57] Pas këtij ajeti I Dërguari i Allahut a.s. e dërgoi Aliun r.a. të thërrasi të gjithë të afërmit që të mblidhen në shtëpinë e Ebutalibit. Të gjithë të afërmit e Muhammedit a.s. u mblodhën në shtëpinë e Ebutalibit i cili ju shtroi me ngrënë dhe qumësht me pirë. I pari i këtij takimi ishtë Muhammedi a.s. dhe sipas adetit ai ja nisi i pari ushqimit me Bismilah, pastaj ju tha të pranishmëve ''Bujrun''. Pas ushqimit Muhammedi a.s. ja nisi ti thërras të afërmit ë tij në fenë e Allahut xh.sh.. Por ende pa mbaruar fjalën ja ndërpreu xhaxhai i tij Ebulehebi i cili nisi ta përgënjështroi Muhammedin a.s. me fjalet; o biri vellait tonë ti ke kohë që je i sëmurë, si duket ty të ka kapur magjia dhe po ju bën magji njërëzvë, çjanë keto që thua? Apo po don me na helmuar edhe në me këtë magji helmuese''! Ndersa I

[57] Shu'arâ: 26/214.

Dërguari i Allahut Muhammed a.s. ja ktheu **''Atë që po më bën ti nuk do ma kishin bërë të gjithë Kurejshitët dhe arabët''!**

Pas një kohe të shkurtër ai e dergoi Aliun r.a. sërisht ti thërrasë të afërmit ë tij. Ashtu sikur ishtë adeti përsëei i priti me ushqim dhe pas ushqimit ja nisi fjalës; **''Falenderimi i përket Allahut xh.sh.. Vetëm prej atij kërkoj ndihmë. Vetëm atij i besoj dhe tëk Ai kërkoj mbështëtje. Ndaj ju thërras të besoni se nuk ka Zot tjetër veç Allahut. Ai është Një dhe Ai nuk ka as shok dhe as ortak në udhëheqjen e tij.''** Pas ketyre fjaleve ai vazhdoi. **''Ju e dini që kurrë nuk ju kam gënjyer dhe kurrë nuk ju gënjëj, gjithmonë ju flas për të drejtën... Juve po ju thërras që të besoni në Allahun, Një dhe të Vetëm. Unë jam i Derguari i Fundit i Tij dhe jam dërguar që të thërras mbarë njërëzimin në Fenë e Allahut. Betohem në Allahun xh.sh. se ashtu sikur ju kap gjumi po ashtu do të ju kapi edhe vdekja, ashtu sikur zgjoheni nga gjumi po ashtu do të ringjalleni dhe do të jepni llogari për të gjitha veprat që keni bërë. Për çdo të mirë që keni bërë do të shpërbleheni dhe për çdo të keqë do të dënoheni. Dhe sipas peshojes për të mirat do të shpërbleheni me Xhennët ndërsa për të kqiat do të dënohëni më Xhehennëm dhe prej aty nuk kam ë dalje sepse në to ndodhet përjetësia. Ju jeni njërëzit e parë që po i paralajmëroj për dënimin në Ahiret.''**

Pas Muhammedit a.s. fjalen e Mori Ebutalibi i cila tha; '' o biri vëllait tonë nuk di punë më të mirë se sa ndihma që mund të japim ty. Të mbledhurit këtu janë bijtë e Abdulmutalibit ku edhe ti je njëri prej tyre. Nëse do kishtë njëri këtu që do ju përgjigjtë thirrjes tënde ai do isha unë por unë nuk e braktis dot fenë e të parve tanë. Pra ti vazhdo në rrugën tënde por unë nuk e braktis fenë tonë të vjetë.''

Pas Ebutalibit fjalën e mori Ebulehebi dhe me fjale kercenuese dhe me një ton të ashpër tha; '' o bijtë e Abdukmutalibit para se ta pengoi dikush tjetër Muhammedin a.s. ndalojeni ju. Nëse ju do të pranonin thirrjen e tij atëhere ju do të përballeni me ofendime, sharje dhe do të nënçmoheni nga Mekkasit. Edhe nëse do ta mbroni Muhammedin a.s. atëhere do të vritëni...'' Flajën Ebulehebit ja ndërpreu motra e tij, halla e Muhammedit a.s. me fjalet; '' O vella a të ka hije ty që ta braktisësh dhe ta kundërshtosh djalin e vëllat tënd? Betëhem se njërëzit sot po flasin se në fisin e Abdulmutalibit ka dalur një Pejgamber dhe ai Pejgamber është ky.'',

Por Ebulehebi as nuk ja vuri veshin fare këtyre fjaleve dhe ja nisi kërcenimeve sikur ai e kishtë bërë adet ndaj të Dërguarit të Allahut Muhammedit a.s.. Kesaj radhe fjalën ja preu Ebutalibi i cili tha; '' ore frikacak a nuk e din se sat ë jemi në gjallë askush nuk do të guxoi ta preki Muhammedin a.s.'' dhe duke ju kthyer Muhammedit a.s. '' o biri vellait tim, kur të dusha ti thërrasësh njërëzit në rrugën e Allahut na e bëj me dije që në të kapim armët dhe të dalim e të të mbrojmë prej sulmeve që mund të vijnë.'' Pas Ebutalibit fjalën e mori me i nderuari i Universit Muhammedi a.s. dhe si çdo herë tjetër me ëmbelsi ju tha të pranishmëve se**; ''O bijtë e Abdulmutalibit! Dijeni se kjo që unë po ju sjell juve nder Arabë është më e vlefshme se kjo botë dhe bota tjetër. Dijeni se askush para dhe pas meje nuk i ka dhuruar një dhuratë kaq të çmuar si kjo që unë po ju thërras juve. Unë juve po ju thërras në një fjalë që është e kollajtë në të thënë dhe peshon mu shumë se gjithçka në peshojë. Pra Nuk ka Zot tjetër veç allahut dhe se Muhammedi është rob dhe i Dërguar i Tij, janë fjalë të lehta në thënie dhë të rënda në peshoje. Mu më ka urhdhëruar Allahu që tju thërras të dëshmoni në këtë thënië. Tani cili prej jush më beson mua, i përgjigjet kësaj thirrje dhë të më dal krah mua?''** I

Dëurguari i Allahut a.s. i ripërsëriti disa herë këto fjalë por me përjashtim të Aliut r.a. askush nuk ju përgjigj. Ali r.a. tha ''edhe pse unë jam më i vogli ndër ju por unë jam më Muhammedin a.s.'' Atëhere Muhammedi a.s. e mori Aliun r.a. për dorë të tjerët i la kokëulur dhë doli prej aty.

Ky regim i të afërmëve të tij edhe pse e brengosi shumë të Dërguarin e Allahut ai nuk u ndal së thirruri ata për ti shpëtuar prej dënimit të xhehennëmit dhe për ti dërguar në xhennët.

Kur zbriti ajeti 94 i sures Hicr kishin kaluar katër vitë prej kohës së shpalljes së parë. **''Publiko haptas atë për të cilën urdhërohesh, e hiqju idhujtarëve.''** Prej kësaj kohe Muhammedi a.s. filloi të thërras haptasi këdo që shihtë, takontë dhe ulej me të. Pra tshmë në Mekka thirrja e Muhammedit a.s. bëhej haptazi. Një ditë ai dolin ë kodrën Safa dhe i thirri të gjithë Mekkasit; **'' O Kurejshë! Ejani dhe dëgjoni çfar po ju them!''** Pasi u mblodhën të gjithë Mekkasit aty ai ju tha; **'' a keni dëgjuar ndonjëhere për mua të ju kem gënjyer jyv?''** Të gjithë njëzëri ''Jo, Ti kurrë nuk na ke gënjyer!'' pasi dëgjoi këto fjalë të Mekkasve ai ju kthye dike ju thënë; **''Dijeni se mua më ka Dërguar Allahu Pejgamber të ju që tju thërras në Fenë e Tij.''** Pastaj ju citoi atyre ajetin 158 të sures Araf në të cilin thuhet'' Thuaj (Muhamed**): "O ju njërëz! Unë jam i Dërguari i Allahut të të gjithë ju. Allahut që vetëm i Tij është sundimi i qiejve e i tokës, s'ka të adhuruar të vërtëtë pos Tij; Ai jep jetë dhe Ai jep vdekje, pra besoni Allahun dhe të Dërguarin e Tij, I Dërguari i Allahutn e pashkolluar, që beson Allahun dhe shpalljet e Tij, ndiqëni rrugën e tij që ta gjeni të vërtëtën."** Edhe Kësaj here Muhammedin a.s. e kundershtoi Ebulehebi, kesaj radhe pa u përmbajtur fare ai tha; '' O Kurejshë apo dëgjoni këtë që nuk është në vetë, ky ka lujatur mendësh! Pse ka luajtur mendësh ky ju do të largoheni nga feja e të parëvë tuaj? Ikni ore mus u merrni me këtë se ky po trllon!'' Ebulehebi dhe të gjithë Mekkasit edhe pse ishin dëshmitarë për moralin, karaktërin dhe virtytët e larta që zotërontë Muhammedi a.s. ata i kishtë kapluar injoranca dhe kundërshtonin pa piken e mëndjes. Pas ofëndimeve që Ebulehebi i bëri të Dërguarit të Allahut xh.sh. Mekkasit u larguan pa ja vënë veshin fare asaj çfar ju tha Muhammedi a.s.

Këtë thirrje Muhammedi a.s. ja bëri dhe një herë Mekkasve po në kodrën Safa. Ai i thirri ata; **''O Kurejshitë! Ejani më dëgjoni, sot për ju kam informata të rëbdësishme!''**[58] Sapo degjuan këtë Kurejshitët vrapuan nga Muhammedi a.s. i cili ju tha; **''O Kurejshitë! Sikur të ju them se pas kesaj kodre gjëndet një ushtri e madha, e cila po pret në shtëg që t'ju kap juve në pakujdesi dhe sapo të ju gjej të fare të pa mbrojtur të ju sulmojë për tju vrarë e plaçkitur gjiçka keni! A do rë më besonit?''** Kurejshët në panik, O Muhammed a.s. ti nuk na ke gënjyer kurrë e si të mos besojmë në ty? Atëhere Muhammedi a.s. ja ktheu; **''O populli im unë jam Muhammedi i Dërguari i Allahut. Allahu më ka dërguar që të ju jap lajm juve për denimin e xhehennëmit, shpërblimet e xhennëtit dhe të ju ftoj në Fenë e Allahut, pra të ju ftoj në Islam. Ju thërras ju se Nuk Ka Zot Tjetër Veç Alahut Dhe Se Ai Nuk Ka As Shok Dhe As Ortak (*Lâ ilâhe illallahu vahdehû la sherîkeleh)*. Unë jam rob dhe I Dërguari i Fundit i Allahut. Nëse më besoni mua dijeni se fitoni xhennëtin, nëse me mohini dijeni se ka me ju kapluar dënimi i shehennëmit. Kush më beson mua ai do të përfitoi nga dobitë e kësaj botë dhe botës tjetër, kush më mohon ai nuk ka dobi as në këtë botë dhe as në tjetrën."** Me Përjashtim të Ebulehebit nga të pranishmit askush nuk foli. Ebulehebi sikur e

[58] Buhârî, Tefsîr, 4; Tirmidhî, Tefsîru'l- Kur'ân, 91.

kishtë bërë adet, ju përgjigj Muhammedit a.s. me fjalet; ''Mallkuar qofsh, a për këtë na ke thirrur!'' (Për këtë Allahu e Mallkoi Ebulehebin në suren Mesedë). Ndërsa të tjeret u larguan në heshtje.

Sikur T'ma Jepni Diellin Në Dorën e Djatht

"O xhaxhai im, të betohem për Allahun, se edhe nëse do ma jepni Hënën në doren e majtë dhe Diellin në dorën e djathtë, unë nuk do të heq dorë prej kësaj rruge! Gjithmonë do të jem i palëkundur dhe kurrën e kurrës, asgjë e kësaj bote nuk do të ma ndryshoi mendjen për të hequr dorë prej kësaj rruge. Pra sikur edhe shpirtin të ma marrin unë nuk do të heq dorë deri sa Feja e Allahut xh.sh. të përhabet në mbarë rruzullin tokësorë"
Muhammedi a.s.

Kurejshët tashmë kishin filluar të sulmunin Muhammedin a.s.. Ata edhe pse e dinin që ai kurre nuk i ka gënjyer, madje ata e dinin se ajo që po i thërristë ai nuk është gënjështër, por inati nuk i lintë të besonin në të. Një ditë prej ditësh ata vendosën të trokisnin sërish në derën e Ebutalibit. ''Shiko, o Ebu Talib, në e dimë se ti je më i madhi ndër në, si moshë dhe si përvojë e jetës! Ti je më i nderuari ndër të gjithë në. Patëm ardhur edhe herë të tjera të të tregojmë për paturpësitë që nipi yt është duke bërë, mirëpo ti nuk na u binde. Por dije se fyerjet që po bëhen, fjalët e hedhura mbi zotat tanë dhe akuzimi i të parëve tanë si të devijuar, po na e sos durimin. Kur ke ndërmend ta pengosh nipin tënd Muhammedin a.s.? Nëse do, na lejoje në, da ta zgjidhim sa më pare këtë çështje, kuptohet nëse ndonjëri nga në nuk e kalon cakun!'' I thanë ata. Edhe pse kjo dalje e Kurejshitëve e mërziti shumë Ebutalibin kjo vizitë dhe fjalët e shumta të mekkasve, ai thirri nipin e tij, ''Muhammedin a.s. dhe i tha, o Muhammed! o Fjalëdrejtë (Paqja e Allahut qoftë mbi të), O djali i tim vëllai! Kurejshët erdhen dhe më kërcënuan kështu e kështu, (pra i tregoi për ato çfarë i kishin thënë kurejshët.) Të lutëm të mendosh si për vetën ashtu edhe për mua, mos më ngarko mua me një barrë, të cilën nuk do ta mbaj dot!''

Muhammedi a.s. u trondit nga këto fjalë të Ebutalibit, saqë për një moment filloi të mendojë se mos vallë xhaxhai kishtë ndërruar qëndrim ndaj tij, dhe mos vallë e kishtë dorëzuar atë të kurejshët. A thua valle ishtë lodhur së mbrojturi atë ndaj sulmeve që i bënin mekkasit, pra mos vallë Ebutalibi këndej e tutje do ta lintë të pambrojtur atë. Muhammedit a.s. pas fjalëve dhe lajmeve që i dha xhaxhai atij zemra iu copëtua, dukej që në thellësitë e shpirtit të tij kishin filluar furtuna dhimbjesh. Ndoshta ishtë Allahu xh.xh. që nuk dontë t'i lintë tjetër portë shpëtimi pos Allahut xh.sh.. Pa u menduar fare ai ja ktheu; **''O xhaxhai im, të betohem për Allahun, se edhe nëse do ma jepni Hënën në doren e majtë dhe Diellin në dorën e djathtë, unë nuk do të heq dorë prej kësaj rruge! Gjithmonë do të jem i palëkundur dhe kurrën e kurrës, asgjë e kësaj botë nuk do të ma ndryshoi mendjen për të hequr dorë prej kësaj rruge. Pra sikur edhe shpirtin të ma marrin unë nuk do të heq dorë deri sa Feja e Allahut xh.sh. të përhabet në mbarë rruzullin tokësorë.''** Aq dhumr ishtë prekur i Nderuari i Njërëzimit a.s. sa që kur u ngrit për të ikur, nga cepat e syve kishin filluar t'i rridhnin lotët, ndërsa nga brenda kishtë kohë që e kishtë kapluar brenga e mërzisë. Mirëpo, ai kishtë folur me aq vendosmëri, saqë dukej gjithandej vendosmëria e tij në këtë kauzë.

Ky reagim i të nipit, e preku tëjmase Ebutalibin. Ai ishtë amanëti i babait të tij, Abdulmutalibit, jetimi i vëlla Abdullahut... Si mund ta lintë të vetëm, pa mbështëtje dhe ta bëntë pre e Kurejshitëve që prinin ta glabëronin sikur ujqërit e uritur gjahun e tyre?

Muhammedi a.s. u qëtësua shumë kur dëgjoi fjalët e xhaxhait të tij i cili i tha; Eja, o djali i vëllait, eja! Dhe ja bëri me shenjë të ulet pranë tij, ku në pamje dukej qartë

se ai edhe pse nuk i besontë nuk do ta dorëzontë tëk kurejshitët. Muhammedi a.s. u drejtua me një gëzim të thellë drejt xhaxhait, kuptohet duke fshirë ato dy pika lot që i ishin lëshuar prej gëzimi, ashtu pa i kontrolluar dot. Ngjantë sikur sytë e tij kuptonin gjithëçka, më parë se gjuha të flistë. ''O Muhammed a.s. shko i qëtë në shtëpinë tënde! Shko dhe bëj si të të dojë zemra! Sepse unë të betohem që nuk kam për të dorëzuar kurrë në duart e tyre!''[59] Dhe e përcolli me fjalë përkëdhelëse duke ia përforcuar bindjen se ai nuk do t'ia ndërpristë mbështëtjen deri në fund të jetës së tij.

Mekasit, të cilët e panë se as Ebutalibi nuk e kishtë ndërmend ta bindtë të nipin, madje tëk e panë se ai ishtë i vendosur, kësaj here ndryshuan mënyrë veprimi, andaj vendosën të shkonin edhe njëherë pranë Ebutalibit. Me vetë morën edhe një djalë tëjet të pashëm dhe të fortë. Sapo arritën të ai ja nisën ti thonë; ''O Ebutalib, ja, ky është Umra bin Velidi. Djaloshi më i pashëm dhe me i forti i Kurejshitëve. Le të bëhet ky djalë ndihmësi yt; mbaje sikur të jetë, bëje djalë tëndin, ndërsa në na jep Muhammedin a.s., i cili po guxon të ndërrojë fenë e të parëve tanë, që kundërshton çdo gjë që në i themi, e ta vrasim. Ashtu sikur ju e dini që sipas zakonëve tona, gjaku i një njëriu pakuhet kundrejt një njëriu; ja, le të jetë ky i ri njëriu i cili do zëvëndësoi tëki Muhammedin a.s. Ç'kërkesë e fëlliqur dhe e frikshme që ishtë kjo! Nga njëra anë qëndrontë I Dërguari i Allahut a.s., i shumëprituri për shekuj nga njërëzimi, e nga ana tjetër një njëri që dallontë vetëm për pamjen e tij të jashtme. E si mund të bëhej fjalë që ky djalë të zintë vendin e Tij! Prandaj, edhe përgjigja e Ebu Talibit ishtë e palëkundur: ''Vallahi, ju jeni duke më bërë një kërkesë të fëlliqur, të ulët dhe të poshtër! E shihni këtë djalë si të veçantë, e më kërkoni që ta marr në shtëpinë time, për t'ju dhënë juve që ta vrisni, atë që e kam si ta kisha djalin tim, Muhamedin a.s. e kam si sytë e ballit. Kjo që ju pretëndoni as që ka për të ndodhur kurrë, nuk mund t'i mbyll sytë karshi një gjëje kaq të flliqur.''[60] iu përgjigj ai. Muttim ibni Adiji, i cili e pa se Ebu Talibi sërish nuk do ta bëntë atë që po i kërkohej, u hodh:''Të betohem, o Ebutalib, që populli ynë ty të deshi e të respektoi përherë, këtë duhet ta kesh parë dhe nga sjelljet që kanë treguar ndaj tëje. Ata asnjëherë nuk kanë vepruar ndonjë gje që ty të mërzisin.''

Kërkesat e Kurejshitëve ishin të flliqura, të ulëta, të çuditshme, ata tanimë kishin mbërritur deri aty sa të kërkonin edhe vrasjen e I Dërguari i Allahutt të Mbramë të Njërëzimit Muhammedin a.s, dhe kur bëhej fjalë për një "jo!" nga ana e Ebutalibit, ata hidheshin përpjetë e pretëndonin se kjo ishtë një moskeqardhje nga ana e xhaxhait të palëkundur. Nuk mund të bëhej fjalë për paturpësi më të madhe, prandaj edhe përgjigjja duhej dhënë siç e meritonin. Për këtë Abdulmutalibi ju dha atë përgjigje që ata meritonin; ''Ju betohem në Zot o Kurejshitë, se ju deri më tani nuk jeni treguar asnjëherë keqardhës! Ja, ju, a shehni vetën se ç'jeni duke më kërkuar? Më kërkon që të bëhem i pashpirt, e t'ju lejoj të tjerëve të bëjnë ç'të duan me familjen time! Provojeni nëse jua mban ta beni atë që juve po ju shkon ndërmend!''

Kjo e folur nuk ishtë gjë tjetër veçse nxjerrja e shpatave, të cilat tashmë kishin dalur pothuajse gjysëm nga kellefi i tyre. Armiqësia që deri më sot ishtë shfaqur individualisht, tanimë do të zgjerohej në grupe më të gjera, për t'u përhapur në të tërë Mekkën. Tashmë dukej qartë se në epiqëndrën e sulmeve kurejshitë nuk ishtë vetëm Muhammedi a.s. por kush e besontë dhe kush e përkrahtë atë, pra tashmë të

[59] Ibni Ishâk, Sîret-i Resûl, 135; Taberî, Historia, II, 326-327
[60] Ibni Sa'd, Tabakât, I, 134-135; Taberî, Târih, II, 326-377.

gjithë i quajtën armiq të tyre. Besimtarëve dhe mbështetësve të Muhammedit a.s. kishtë filluar t'i hapej lufta haptas. Pra Kurejshitët kishin filluar sërish të përdornin të gjitha metodat, nga më çnjerëzoret, për t'i bindur myslimanët që të hiqnin dorë prej fesë së tyre. Madje edhe Ebutalibi tashmë ishtë në epiqëndrën e sulmeve të tyre, tani po aplikoheshin metoda tëjet antinjërëzore. Kundër këtyre sulmeve Ebutalibi vendosi të organizontë një mbledhje me vëllezërit të tij, qëllimi i kesaj mbledhje ishtë për të bërë për arsye që të mbronin nipërit e tyre. Mirëpo, ndërsa të gjithë bijtë e Abdulmutalibit dhe Hashimit vendosën të takoheshin me të, vëllai i tij, Ebulehebi edhe një herë e shprehu qartazi pozicionin kundër nipit të tij, pra ai e refuzoi ftësën e të vellait dhe nuk u paraqit në atë takim familjar. Në atë takim u mor vendim se të gjithë si familje do ta mbronin Muhammedin a.s., dhe për këtë, Ebutalibi ishtë tëpër i gëzuar sepse kishtë arritur të merrtë dhe fjalën e mbrojtjes nga familjarët e tij të tjerë.

Prej kësaj kohe, sa ishtë gjallë Ebutalibi Kurejshët nuk kishin guxuar më të sulmonin Muhammedin a.s., madje transmetohet se një ditë Ebutalibi kishtë urdhëruar të afëermit e tij që të dilnin të gjithë aë bashku me Muhammedin a.s. në Qabe dhe përgjatë rruges i kishtë kërcenuar Kurejshitët se; ''nëse do ti bënin ndonjë marrëzi Muhammedit a.s. ai do ta ekzekutontë me dorën e tij''. Dhe në sytë e tyre kishtë recituar poezi lëvdatash për Muhammedin a.s.

KERCENİME, MASAKRA DHE DHUNË

"O Kuresjhitë më dëgjoni me vëmëndje! Pasha Atë, në dorën e ti cilit është shpirti im, nësë nuk më besoni dijeni se Allahu xh.sh. do të ju shkatërroi plotësisht!"
Muhamedi a.s.

Kurejshitët prej kohesh kishin vazhduar dhunën ndaj Myslimanëve madje edhe vetë I Dërguari i Allahut Muhammedsa nuk ishtë me i sigurtë në Mekka. Pra edhe ai u torturua në mënyra të ndryshme. Një herë, ndërsa po adhurontë Zotin, disa njërëz i hodhën një pëlhurë në qafë dhe filluan ta tërhiqnin. Të Dërguarit të Allahut Muhammedit a.s. sa që gati i dolën sytë nga vëndi. Ndërkohë erdhi Ebu Bekri r.a. që e liroi dhe më pas u bërtiti: "**O njërëz, a do ta vrisni, vetëm sepse thotë që Zoti është Udhëheqësi i tij?!".** Edhe njjë herë tjetër i Dërguari i Allahut s.a. ishtë duke u falur në Qabe, ndërkohë dikush i vendosi në shpinë zorrët e devesë. Nga ngarkesa, i Dërguari i Allahut s.a. nuk e ngriti dot kokën derisa disa njërëz erdhën dhe ia hoqën nga shpina.

Ndërsa një herë tjetër, tëk po kalontë ai në pazar, u grumbullua një grup vagabondësh të Mekës rreth tij, të cilët gjatë gjithë rrugës e qëlluan në qafë me shpulla, duke thënë: "Ja ky është ai që thotë se është profet!" Shpesh i hidhnin gurë në shtëpinë e tij dhe pisllëqë në kuzhinë, që përbëheshin edhe nga zorrët e dhive apo të deveve. Kur ai falej, i hidhnin pluhur apo rërë, derisa ai u detyrua të gjentë një vend diku midis shkëmbinjve për të falur namazin. Këto tortura, megjithatë, nuk po shkonin kot. Njërëzit e sinqërtë kur i shikonin këto gjëra, tërhiqëshin pas Islamit.

I Dërguari i Allahut s.a. ndërsa ishtë i ulur një ditë në kodrën Safa, afër Qabes, kaloi pranë tij Ebuxheheli, armiku i tij më i egër, së bashku me disa krerë të tjerë të Mekkës. Ai e sulmoi I Dërguari i Allahutn Muhammed a.s. me sharje fyese, ndërsa i Dërguari i Allahut s.a. i dëgjoi gjakftohtësisht dhe nuk i ktheu asnjë përgjigje. U ngrit i heshtur dhe u kthye në shtëpi. Një skllave e fisit të tij i shikontë këto pamje. Xhaxhai i tij, Hamzai r.a. ishtë një njëri shumë i fuqishëm dhe trim, saqë banorët e

qytëtit i trembeshin. Si zakonisht ai kishtë dalë për gjah dhe kur u kthye në darkë, me hark në dorë hyri në shtëpi si çdo kthim tjetër prej gjahu hyri me plot me mburrje. Skllavja ishtë shumë e dëshpëruar nga ngjarja që kishtë rastis në mëngjesit ku arrogantët kishin sulmuar dhe ofenduar Muhammedin a.s., ajo kur e pa Hamzanë në këtë gjendje, nuk e duroi dot dhe i tha me plot hidhërim: "Mjaft u tregove trim me këto armët e tua! A ke ndonjë haber se si u soll Ebuxheheli me nipin tënd sot në mëngjes?!". "Çfarë i bëri Ebuxheheli?" e pyeti Hamzai r.a.. Ajo i tregoi gjithçka që kishtë ndodhur. Hamzai, edhe pse nuk ishtë musliman, ishtë njëri zemërmirë. Kishtë dëgjuar mësimet e Islamit dhe duhej të kishtë qënë i ndikuar nga ato mësime, por ngaqë kishtë një jetë të shkujdesur, akoma nuk kishtë menduar seriozisht rreth pranimit të Islamit.

Kur e mori vesh se çfarë kishtë ndodhur me nipin, ai nuk mund të qëndrontë i qëtë. Duke ndjerë që po bëheshin tëntativa për të zhdukur atë ai i dha fund çdo ngurrimi ndaj Islamit . Doli nga shtëpia me një vruall të turrshëm dhe u nis drejt e për në Qabe, pikërisht aty ku ishtë i mbledhur kuvendi kryesor i krerëve të Mekës. Nxori harkun nga shpatulla dhe me gjithë forcë i ra Ebuxhehelit me të dhe i tha: **"Dëgjo Ebuxhehil! Edhe unë e pranova fenë e Muhammedit a.s.. Sot në mëngjes guxove ta shash, ta ofendosh dhe ta sulmosh sepse ai nuk ju kundërpërgjigjet. Por nëse je trim apo guximtarë përgjigjju goditjes sime!".** Gjithçka ndodhi në mënyrë të papritur prej tyre, ndaj edhe Ebuxheheli kishtë mbetur i shtangur nga ky reagim i Hamzait r.s. Shokët e tij u ngritën për të sulmuar Hamzain r.a, por Ebuxheheli mori parasysh trimërinë e tij dhe bashkimin e fisit të tij dhe e kuptoi që nëse do të ndizej lufta, do të kishtë pasoja shumë të rënda, andaj i pengoi shokët tij duke ju thënë atyre: "Lëreni se me të vërtëtë e kam sharë dhe ofenduar nipin e tij Muhammedin a.s."

Sikur duket jo vetëm Hamzai r.a. por të gjithë ata që i kishin besuar Muhammedit a.s. ishin të gatshëm të jepnin jetën për të. Madje është transmetuar se Ebubekri r.a. kur nuk e takontë apo nuk e shihtë shokun e tij Muhammedin a.s. ai as nuk hantë as nuk pintë dhe thoshtë; **''Betohem në Allahun xh.sh. se pa e parë me sy Muhammedin a.s. as nuk më hahet dhe as nuk më pihet.''** Por jo vetëm kaq Ebubekri e dontë Muhammedin a.s. me shume se fëmijet dhe prindërit e tij. Sa herë ishtë nëvoja për ndonjë sakrificë dhe kur bëhej fjalë familja e tij ai thoshtë '' O Muhammedi a.s. mos u mërzit për ty qofshin falë edhe prindërti tanë, ndaj në nuk të lëmë kurrë vetëm.'' Pra sikur kuptohet Ebubekri ishtë një ndër ata që e dontë më shume Muhammedin a.s.. Edhe atëherë kur Mushriket (idhujtarët) e Mekkës e sulmuan Muhammedin a.s. në Qabe ishtë Ebubekri ai i cili ndërhyri për ta mbrojtur dhë idhujtarët e kishin dhunar aq shumë sa që ai ishtë mbuluar me gjak i tëri dhe pas godiyjeve që kishtë marrë e kishin dëturuar të qëndroi për dit të tëra i shtrirë në shtrat.[61]

Mallkuar Qoftë Ebulehebi

Një ndër ata që e kundërshtonin më ethshëm, dhe që ia donin të keqën Muhammedit a.s. ishin pikërisht komshinjtë e tij më të afërt. Shtëpia e Ebulehebit ishtë ngjitur me atë të Të Dërguarit të Allahut, Muhammedit a.s. (Paqja qoftë mbi të). Por edhe ata që nuk e kishin shtëpinë ngjitur me të nuk është se ishin shumë ndryshe prej Ebulehebit. Ndër kundërshtarët më të pamëshirshem të tij ishin

[61] Beyhekî, Delâil-un-nubuvve, II, 71; Ebû Ya'la, Musned, I, 26, 50; V, 413; İbni Asâkir, Tarih-i Dımeshk, LXVII, 173; Heysemî, Mecma'udh-dhevâid, VII, 53.

Hakem bin Ebi'l As, Ukbe bin Ebi Muajt, Adij bin Hamra dhe Ibnu Esda Huzeliu, koto ishin njërëz që ndjenin një urrejtje po aq të keqë sa ajo e Ebulehebit, të cilët kërkonin çdo cep mundësie, si e si ta shqtësonin sa më tëpër Mëshirën e Botëve Muhammedin a.s..Madje një ditë prej ditësh, tëksa i Dërguari i Allahut Muhammedi a.s po faltë namaz, Ebulehebi i hodhi përsipër pisllëqë nga të deleve, ndërsa dikush tjetër, i mori ato dhe ia hidhtë brenda enës së ujit nga e cila ai merrtë abdest.

"U thafshin dy duart e Ebu Lehebit dhe i shuar qoftë ai! Pasuria e tij dhe fëmijët e tij nuk do t'i sjellin atij asnjë dobi! Ai do të digjet në Zjarrin me flakë të tërbuara! Edhe gruaja e tij e cila mbante dru (ferra), Në qafën e saj është i lidhur fort një litar Mesed (litar shumë i fortë i cili bëhet me fije nga degët e palmës së hurmës)."
Tebbet 1,5

Kjo ishtë arsyeja që zbritën ajetët kuranore të sures Tëbbet ku Allahu xh.sh. thotë; **"Ju thafshin duart Ebu Lehebit. Faktikisht ju thanë..."** njëkohësiht kjo është surja e Kur'anit ku përshkakt të dhunës dhe intrigave që i bënin Muhammedit a.s. u mallkuan Ebu Lehebi dhe bashkëshortja e tij.

Fyerjet dhe intrigat ngacmuese, fizike dhe fjaluese të fqinjëve mushrikë kishin arritur deri at sa që situata u rëndua aq shumë, sa që I Dërguari i Allahut i Njërëzimit Muhammedi a.s. u detyrua të ndërtoi një mur që e ndantë shtëpinë e tij nga shtëpitë e fqinjëve. Një ditë tjetër, Ai e mori pisllëkun që i patën hedhur përkëndej murit, e nxori me majën e një shkopi, duke i thënë: ''Ç'është kjo marrëzi o fqinjtë e mi, a nuk ju vjen sado pak turp për këtë që po beni!?'' Por ky reagim i Muhammedit a.s. nuk e kishtë prekur fare Ukbe bin Ebi Muajin, madje ai mundohej si të gjenjë diçka më të rëndë. Ai një mbrëmje shkoi në shtëpinë e Ebuxhehlit, që të merrej vesh me të për të gjetur një mënyrë me të cilën mund të fyenin më Të Mirin në mesin e njërëzve Muhammedin a.s. (Paqja e Allahut qoftë mbi të). Ata dolën një ditë dhe pyesnin, se kush kishtë dëshirë t'i hidhtë një plëndës deveje apo ndonjë qëlbesirë më të rëndë së kjo mbi krye, atëherë kur Muhamedi i Nderuar a.s. do të ishtë duke u falur! Në këmbë u çua më i ndyri ndër ta, i cili nuk ishtë ndokush i panjohur, pos vetë Ukbes. Ja sollën një plëndësin aty, dhe prisnin kohën kur Më i Dashuri ndër njërëz Muhammedi a.s. të nistë faljen e namzit. Nuk vonoi shumë ardhja e Muhammedit a.s. dhe me të filluar faljen e namazit, mushrikët ju afruan dhe ja lëshuan pisllëkun mu në mes të dy shpatullave. Kjo është vetëm një nga ato përjetimet e shumta që përjetontë Muhammedi a.s. prej fqinjëve të tij. Edhe pse poshtërsitë e tyre nuk kishin të ndalur ata e dinin më mirë se çdo kush tjetër, që ata po i bënin padrejtësi dhe poshtërsi Fqinjit më të Sigurt që ka parë ndonjëherë kjo botë e përkohëshme.

Muhammedi a.s. qëndorntë në sexhde ndërsa ata rrinin për rreth tij dhe talleshin me të. Në njërën anë qëndronin Ukbja me miqtë e tij, të cilët ashtu si të poshtër që ishin po përpiqëshin të nxirrnin kënaqësinë më të mundshme, pra ata pretëndonin se ajo që po i bënin Muahammedit a.s. ishtë një argëtim i tyre, por ata nuk kuptonin se çdo poshtërsi që bënin i afroheshin më shumë mallkimit të Allahut xh.sh. Prej këtyre poshtërsive ata aq shumë patën qëshur atë ditë, sa mbaheshin fort pas njëri-tjetrit që të mos rrëzoheshin. I Dërguari i Allahut Muhammedi a.s. nuk e ngriti kokën nga sexhdeja për një kohë të gjatë. E bija e Tij, Fatimeja e nderuar, ishtë dëshmitare e të gjithë atyre çfar i kishin ndodhur të atit. Ajo nuk duroi dot më por duke vrapuar shkoi menjëherë tëk i ati. Nga njëra anë e pastrontë të atin dhe nga ana tjetër lëshontë ulërima ndaj atyre të pafytyrëve që bënë poshtërsira të këtilla.

Ata të shkretë nuk dinin se ai ishtë robi më i dashur për Allahun e Madhërishëm, mjaftontë që ai të ti lutëj Allahut xh.sh. për shkatërrimin e tyre, dhe Allahu i bëntë ata njësh me tokën, pra mjaftontë një fjalë e tij, dhe i pristë menjëherë dera e

xhehenëmit. Por ai ishtë I Dërguari Për Meshirën e mbarë botërave ndaj ai kurrë nuk u largua, qoftë edhe njëherë prej rrugës së mëshirës. Kishtë një besim të fortë, se në mos do të vintë një ditë që ata do të kuptonin dhe do të vetëturpëroheshin për këto poshtërsi që po i bënin atij.

"O Ebu Xhehil! Vallahi! Ose ti heq dorë nga rruga e keqë, ose Allahu do të shkatërroi ty së bashku me të kqiat tuaja."
Muhammedi Alejhi selam

Megjithatë, dukej se kjo e fundit e kishtë prekur jashtë mase, kuptohet që nuk ishtë gjë e lehtë. Bashkë me kokën, ngriti edhe duart të hapura e të drejtuara drejt qiellit dhe u lut sikur çdo herë tjetër; **''O Zot, po ta le Ty këtë Kurejshin, nuk kam se ç'të bëj me ta!''** Aq shumë ishtë prekur, sa e përsëriti tri herë këtë lutje. Mandej filloi t'i përmendtë me emra, një e nga një... **''O Zot, po t'i le Ty Ebu Xhehlin, Utbe bin Ebi Rebian, Shejbe bin Ebi Rebian, Velid ibni Utben, Umeje bin Halefin, Ukbe bin Ebi Muajtin. O Zot vetëm Ti mund t'ua tregosh atyre të drejtën!''** Pasi dëgjuan mushrikët që Muhammedi a.s. ju kishtë bërë keto bedua filluan të friksohen sepse ata e dinin që çdo lutje që behët në Beytullah pranohet. Më pas Pejgamberi ynë i Dashur i tha Ebu Xhehlit; **''Vallahi! Ose ti heq dorë nga rruga e keqë, ose Allahu do të shkatërroi ty së bashku me të kqiat tuaja.''** Lutja ishtë aq e sinqërtë dhe e përshpirtshme, saqë lënia vetëm për vetëm me Allahun, i pati trembur shumë poshtërsirat që nuk ndaleshin së dhunuari Muhamedin a.s. Sepse ata e dinin, që lutjet të cilat bëheshin në këtë vend të bekuar, pranoheshin, e kështu mund t'u ndodhtë ndonjë gjë e papritur. Sidomos kur lutjen e bëntë më I dashur I Allahut Muhammedi a.s.!,

Ebulehebi njëkohesisht ishtë xhaxhai i Muhammedit a.s. por ai nuk e vintë nëpërmënd fare se çdo pafytyrsi që bëntë njëkohësisht po ja bëntë djalit të vëllait të tij. Pra ai në vënd se ta mbrontë nga kurthet dhe keqbërja e të tjerëvë ai i ndihmontë dhe të tjerët ti bënin kë Muhammedit a.s.. Një ndërkeëbërësit ishtë dhe gruaja e Ebulehebit, Ummu Xhemil, ajo sa e sa herë mblidhtë pisllëqë, shkurre e gjëmba dhe i hidhtë në rrugën ku kalontë Muhammedi a.s.! Nga vintë gjith ë kjo urrejtje vetëm pse ai (Muhammedi a.s.) ju thoshtë mos gënjëni vetën tuaj, ikni prej të keqës dhe vraponi pas të mirës, pra kjo urrejtje ndaj tij vintë vetëm dhe vetëm pse ai i Besontë Allahut, Zoti i vetëm që nuk ka sa shok as ortak në krijimin e gjitheçkaje dhe pushtëtin e tij apsolut.

Ebulehebi bashkë me të shoqën i kishin kaluar të gjithë kufijtë dhe caqët në këqbërjë Muhammedit a.s., ata nuk kishin më pikën e vlerës si njërëz, kjo ishtë dhe asryeja që Allahu e mallkoi në suren Mesedë ku thotë; **''Qoftë i shkatërruar Ebi Lehebi, e ai më është shkatërruar! Atij nuk i bëri dobi pasuria e vet, as ajo çka fitoi! Ai do të hyjë në një zjarr të ndezur flakë. E edhe gruaja e tij, ajo që barti dru (ferra), e në qafën e saj ajo ka një litar të përdredhur.''**[62] Ja pra Ebulehebi bashke me të shoqën i kishin kaluar aq shumë kufinjtë sa që posaçërisht, madje duke ja përmendur edhe emrim Allahu xh.sh. i mallkoi ata në Kur'an, Mallkim ky që e lexon i mbarë ummeti i Muhammedit a.s. deri në ditën e fundit të kësaj botë përvizore.

Ndër ta Ebu Xhehli, ishtë më profesionisti në të bërit rolin e armikut, dhë vërtëtë ai ishtë armiku më i përbëtuar i Muhammedit a.s. dhe pasuesëve të tij. Madje ai sa herë të gjentë rastin vintë pranë të Dërguarit të Allahut alejehi selam (Paqja qoftë

[62] Messed 1-5

mbi Të), e dëgjontë tëksa këndontë ajetët kuranore, mandej shkontë pranë miqëve të tij, për t'i kthyer ajetët në objekt loje dhe jua përcilltë atyre në formë talljeje. Pra ai e kishtë kthyer në profesion talljen me të Dashurin Fisnik të Allahut Muhamedin a.s., dhe talljet i shihtë si diçka me të cilat mund të krenohej para Mekkasve dhe kurejshitëve. Prej këtyre veprimeve ai gëzmahej aq shumë sa që ju kapardisej të tjerëvë, pra atëherë kur shihtë entuziazmin dhe duartrokitjet e të tjerëve ai gëzohej pa fund. Që kur e kishtë parë për herë të parë Muhammedin a.s. kur kishtë faltë namaz në Qabe, përpiqëj sa herë për ta penguar, madje dontë medoemos ta pengontë atë që ait të mos i lutëj dhe falej Allahut xh.sh., Krijuesit të Gjithësisë në Qabe dhe jasht saj (në publik).

Një ditë Firauni i Ummetit (Ebuxhehli) të Muhammedit a.s. ishtë ulur në Qabe me shokët e tij mushrikë dhe ja nisi ti nxistë kundër I Dërguari i Allahutt të Fundit, pra kundër Muhammedit a.s.. Ebuxhehli ja nisi ti nxisë shokët e tij me fjalë pyetësë; '' o shoke a nuk e shihni se si Muhammedi a.s. vjen ketu dhe në prezencen tuaj ai nuk ndalet por duke ulur kokën në tokë vazhdon të na nënçmoj të gjithë në?'' Ata gjëja sikur ndjeheshin të irrituar ju përgjigjën njëzëri me një Po të përbashket pohuese. Pas këtij pohimi bështëtës të shokëve të tij, Ebuxhehli shtoi duke ju thënë; ''Ju betohem për Latin dhe Uzën, se nëse e shoh edhe njëherë duke vepruar ashtu, do ti hidhem sipër e do t'ia shtyp kokën me gur!''

Ja pra këto ishin ato poshtërsitë e tyrë që ata i bënin Muhammedit a.s. pothuajse çdo ditë, por sikur dihët që poshtërsitë dhe çmenduria nuk njëh rregulla dhe moral njërëzor! Madje Ebuxhehli nuk u ndal me aq, por ai tashmë kishtë nisur propagandën kundër Muhammedit a.s.. Ai për të nxitur mbarë Mekkasit kundër Muhammedit a.s. ai ju thoshtë atyre; ''O Kurejshitë, siç e shihni të gjithë, Muhamedi këmbëngul në fyerjet e tij karshi fesë së paraardhësve tanë, madje duke na akuzuar nëve si të pafe. Na shan zotat (idhujt), na fyen të parët tanë dhe po përpiqët të na çrregulloi marrëdhëniet tona me fënë e të parëvë tanë (pra me fenë idhujtare). Ja pra që unë sot po ju betohem që, nësër do të shkoj pranë tij me një gur të madh në dorë, e në çastin që do të fillojë të ulet në sexhde, do ta godas, e kështu kjo e keqë do të largohet nga mesi ynë. Pasi ta kem bërë këtë, bëni si të doni, ndaç më ndaloni, ndaç godisni edhe ju! Le të përpiqën të bëjnë ç'të dëshirojnë bijtë e Abdimenafit, mua nuk më intëreson më!''

"Edhe të dërguarit e tjerë para teje janë përqëshur, e ata që u tallën pësuan (dënim) për shkak se talleshin."
El-En'am 10.

Duke pasur parasyshë kushtët e jetës shoqërore të asaj kohe, këto ishin një ndër ato poshtërsitë që quhej shkurt e shqip marrëzi njërëzore. Madje as nuk ju bëntë aspak përshtypje së Meka pas një veprimi të tillë shndërrohej në luftë çivile, vlavrasësë dhe fillonin luftëra gjaqësh në mes fiseve, ku mund të vdisnin me mijëra njërëz! Faktikisht Kurejshët i dinin pasojat e këtyre poshtërsive që po bëntë Ebuxhehli andaj ata u mjaftuan me një përgjigje gjysgoje '' bëj çtë duash, në nuk do të mbështësim!'' Pas këtij reagimi Ebu Xhehli u largua prej tyrë me një hyxhym prej të xhindosuri sikur ai kishtë karaktërin e këqberësit arrogant. Të nësërmen Ebu Xhehli kishtë marrë në dorë një gur të madh, njësoj sikur ishtë betuar një ditë më parë, e po vintë në drejtim të Qabes. U ul diku aty, e filloi të pristë Muhammedin a.s. i cili erdhi pranë Qabes se Bekuar sikur vintë çdo ditë tjetëe, pa e kuptuar se ç'mund të kishtë thurur firauni i tij dhe ummetit të tji Ebuxhehli.

Muhammedi a.s. erdhi për të kryer adhurimet e tij të përditshme. Rretheqark qëndronin të gjithë ata që e kishin dëgjuar premtimin e Ebu Xhehlit, të cilët po

prisnin të shihnin se çfarë do dhe a do ta mbantë premtimin Ebuxhehli. Ky i fundit po rrintë e po pristë çastin e duhur për të kryer veprimin poshtrues që ju kishtë premtuar mekkasve idhujtare.

Ebu Xheli u çua dhe filloi të ectë në drejtim të I Dërguarit të Allahut (Paqja qoftë mbi Të). Çuditërisht ndodhi diçka që askush nuk e pristë të ndodhtë. Ndodhi që ebu Xhehli u kthye dhe po iktë pas me një hov trëmbjeje dhe me gurin në dorë janisi të ja mbathtë me të katërtat prej andej nga kishtë ardhur, të cilin mundohej ta fshihtë mirë, sikur të mos dontë që t'ia shihtë ndokush. E hodhi gurin diku andej në një cep, ndërsa në fytyrë nuk i kishtë ngelur pikë ngjyre a gjaku. Të gjithë po e ndiqnin me kujdes atë që po ndodhtë me Ebuxhehlin, por nuk po shihnin kurrfarë shkaku që të kuptonin përse ai e bëntë një veprim të tillë. Sepse as I Dërguari i Allahut Muhammed a.s. nuk e kishtë prishur fare faljen, e për më tepër nuk kishtë bërë asnjë lëvizje të çuditshme, dukej që ishtë plotësisht i përqëndruar në namaz. Për të kuptuar më mirë dimensionët e kësaj ndodhie, njërëzit filluan të shkonin e ta pyesnin Ebuxhehlin se ç'i kishtë ndodhur? Dhe ta pyesnin se përse nuk e solli në vend fjalën që ju kishtë premtuar.

''Ç'po të ndodh kështu me ty o Eba Hakem (Ky ishtë emri i Ebuxhehlit në Mekke, pra ai thirrej në emrin e të birit)? Pse ike ashtu sikur lepur prej frike me vrap?'' e pyetën ata Ebu Xhehlin që tashmë i kishtë rënë vlera para syve të tyre. Përgjigjja që ai ju dha ishtë me një pendesë të thellë për veprimin e pakmëparshëm; ''Në çastin që po i afrohesha Muhammedit a.s. dhe do godisja me atë gure në kokë, ashtu sikur jua kisha premtuar, përpara syve m'u shfaq një kafshe të madhe që i ngjasontë devese! Nuk kam parë asnjëherë një deve aq të madhe, e cila turrej drejt meje me thonj dhe dhembe të mprehtë që që mezi pristë të më gllabërontë. Nëse nuk do të ikja ashtu me atë vrap sikur më patë me sytë tuaj, kisha frikë se do të më kishtë gllabëruar të tërin.'' Si duket të pranishmit nuk ja besuan Ebuxhehlit keto që ai po ju thoshtë, ndaj ata shkuan dhe pyetën të Dërguarin e Allahut Muhammedin a.s. se çfar ishtë ajo që e shtyu Ebuxhehlin të vrapontë me të katërta prej frike, pra për ta kuptuar më mirë atë që kishtë ndodhur. Ndërsa Muhammedi a.s. iu përgjigj me këto fjalë: ''Ai ishtë Xhebraili a.s. dhe po të ishtë afruar qoftë edhe një grimce Ebuxhehli Xhebraili a.s. do ta kishtë shkatërruar plotësisht atë.''

Keshtu i ruan Allahu xh.sh. të dashurti e Tij, dhe me urtësinë e Tij e qëtësontë Muhammedin a.s. duke i treguar për vuajtjet dhe dhunën që pësuan të dërguarit paraardhes të tij. Allahu në kaptinën El-En'am thotë; **'' Edhe të dërguarit e tjerë para tëje janë përqëshur, e ata që u tallën pësuan (dënim) për shkak se talleshin.''**

Dhuna Ndaj Shokëve të I Dërguari i Allahutt a.s.

Fillimisht ata që ju përgjigjën thirrjes së Muhammedit a.s. dhe i basuan atij ishin të shtypurit, të varfërit dhe skllevërit. Veçoria e tyre ishtë sa ata nuk ishin të gjiyhë arab kurejshit por ishin nga popuj të ndryshëm. Ndër ta kishtë edhe njërëz afrikanë, siç ishtë Bilal Habeshiu r.a. edhe romak, siç ishtë Suhejbira etj... Njëkohësisht ata nuk ishin vetëm nga një fe, por nga fe të ndryshme. Për shembull, nëë mesin e tyre kishtë që ishin edhe të krishtërë sikur Xheberira dhe Suhejbira, ishin edhe nga idhujtarët si Bilali r.a. dhe Amarira. Bilalin r.a. pronarët e tij e shtrinin në rërë përvëluese dhe i vendosnin gur ose i lëshonin ca çapkënë t'i shtypnin gjoksin. Bilali r.a. vintë nga Habeshistani që është Etiopia e sotme dhe ishtë skllav i një pasaniku të Mekës, të cilin quanin Umeja bin Helef.

Allahu Është Një, Allahu Është Një

Sikur u përmen me lart Bilali r.a. vintë nga Habeshistani që është Etiopia e sotme dhe ishtë skllav i një pasaniku të Mekës, të cilin quanin Umeja bin Helef. Gjatë verës, ai e nxirrtë Bilalin jashtë Mekës në pikë të zhegut të vapes dhe e shtrintë të zhveshur në rërë përvëluese, i vintë përsipër gurë të mëdhenj e të nxehtë dhe i thoshtë: "Pranoje Latin dhe Uzzanë si zota dhe distancohu nga Muhammedi!" Por ai thoshtë vetëm **"Ahad! Ahad! (Allahu është Një, Allahu është Një)"**, pra do me thënë Allahu është vetëm Një, Allahu është vetëm Një. Sa herë Bilali thoshtë këto fjalë Umeja zemërohej edhe më shumë. Dhe sam ë shumë ai zemërohëj aq me shumë e dhunto Bilalin duke e lidhur me litar në qafë dhe ia dorëzontë vagabondëve, të cilët i porosistë që ta tërhiqnin zvarrë nëpër rrugicat e Mekkës. Atij rrithtë gjaku nga koka gjer në këmbë, por vazhdontë të thoshtë **"Ahad! Ahad!", "Zoti është një, Zoti është një".**

Shumë vonë dhe pas shumë e shumë sakrificash Allahu i Lartësuar ua mundësoi muslimanëve të gjenin paqë në Medinë, pra kur ata gjetën lirinë për të adhuruar Zotin, I Dërguari i Allahut Muhammed a.s. Bilalin e caktoi për të thirrur ezanin. Skllavi i dikurshëm afrikan, në vend të fjalëve "Esh-heduanla ilaha il-lallah", shqiptontë "Es-heduanla ilaha il- lallah", atëherë disa njërëz medinas që nuk dinin se çfarë kishtë hequr ai, qëshnin. Një herë I Dërguari i Allahut s.a. e pa vetë sesi njërëzit qëshnin për ezanin e Bilalit. Ai iu drejtua atyre duke thënë: "Juve ju vjen për të qëshur nga ezani i Bilalit, por Zoti i Lartësuar gëzohet në Arsh kur e dëgjon atë".

Muhammedi a.s. pa e prishur tërezinë, po me të njëjtin ritëm ''**ajo nuk është puna imë o kurejshitë, është puna Allahut ajo punë. Pra nëse Ai deshiron të jua plotësoi juve këtë dëshirë apo nuk dëshiron është punë e Tij dhe atë nuk e pengon asgjë dhe askush ta bëjë apo mos ta bëjë këtë.''** Por marrëzirat e mushrikëve nuk kishin të mbaruar pyetja e radhës që i drejtuan Muhammedit a.s. ''Po mirë o Muhammed! A nuk e dintë ai Zoti që në do të thirnim dhe do të bënim disa pyetje ty? a nuk ti ka mësuar ty ai pyetjet tona dhe përgjigjet që ti do të ju japësh pyetjeve tona? Në nuk të besojmë ty ndaj pse nuk të ka treguar ty Ai se çfar do na bëjë nëve pas këtij diskutimi të përbashket tonin, e me pas? ... dije o Muhammed, se pa na dërguar një Ëngjëll që të vertëtoi ato gjëra që ti na thua, në nuk do të besojmë ty... Tashmë erdhi koha të të tregojmë se në nuk kemi për tu ndalur më, o të na heqësh ti në qafe, o të heqim në ty...'' Pas këtyre fjalëve Muhammedi a.s. kuptoi që kurejshitët mushrikë nuk kishin ndërmend tja vënin veshin dhe ti besonin, anasjelltas ata ngulitën edhe me shumë në kryenëçësinë e tyre, ndaj ai u ngrit dhe u largua nga ata.[70]

Allahu xh.sh. Muhammedit a.s. i dërgoi Xhebrailin a.s. i cili i përcoli shpalljen (vahjin) e një vargu ajetësh për kundërshtinë dhe kryenëçesinë e mushrikëve Mekkas. Në ajetët 4-11 të sures En'am Allahu xh.sh. ka treguar gjëndjen dhe dënimin që i pret mushrikët dhe pasuesit e tyre. Në ato ajetë Allahu xh.sh. thotë; **''Nuk ka argument, që iu vjen atyre nga argumentët e Zotit të tyre, e që ata nuk i shmangen. Ata përgënjështruan të vërtëtën kur u erdhi, e më vonë do ta kuptojnë lajmin e asaj me të cilën talleshin. A e vërejtën ata, sa**

[70] Ibni Hishâm, Sîret, I, 315.

"Atë që Allahu e drejton në rrugë të drejtë, ai është udhëzuar, e atë që e lë të humbur, për ata nuk do të gjesh ndihmëtarë përveç Atij. Ne Ditën e Kijametit i tubojmë ata, duke i tërhequr rrëshqanas me fytyra përdhe, të verbër, memecë, të shurdhët. Vendi i tyre është xhehenemi, sa herë që të pushojë flaka Ne ua shtojmë flakën e zjarrit."
Isra ajeti 97

gjenërata para tyre i shkatërruam, e që Në iu patëm mundësuar atyre (komoditët) **në tokë çfarë juve nuk ju mundësuam; iu patëm lëshuar nga qielli shi me bollëk dhe iu patëm bërë, që të rrjedhin lumenj ndër ta, e për shkak të mëkatëve të tyre i shkatërruam dhe pas tyre sollëm breza të tjerë. Edhe sikur të zbritnim ty një libër të shkruar në letër, e ta preknin atë me duart e tyre, ata që mohuan do të thoshin: "Kjo nuk është tjetër përveç një magji e qartë". E pastaj thanë: "Pse të mos i zbresi atij** (Muhamedit a.s.) **një engjëll** (të na thotë për Muhamedin a.s., se është i dërguar)**". E sikur të zbritnim Në një engjëll çështja do të merrtë fund, duke mos iu dhënë atyre afat. Sikur ta bënim Në atë** (të dërguarin) **engjëll, atë do ta bënim** (në formë) **njëriu e do t'ua përzienim** (ngatërronim) **atyre atë, që i përzien ata vetës së tyre. Edhe të dërguarit e tjerë para tëje janë përqëshur, e ata që u tallën pësuan** (dënim) **për shkak se talleshin.** (Në vend që adhurimi, madhërimi dhe lavdërimi t'i bëhet vetëm Allahut, që krijoi tërë ekzistëncën me të gjitha qëniet dhe komandon me të gjitha ngjarjet e ndodhitë; Atij që është i adhuruar prej gjallesave të qiejve e të tokës, idhujtarët mekas i përshkruanin shok dhe i njihnin për zota idhujt e tyre të gdhendur me duart e tyre dhe nuk kuptonin, se do t'i shkatërrojë Allahu, sikurse i shkatërroi ata para tyre, të cilët ishin edhe më të fuqishëm. Nga kokëfortësia dhe inati, idhujtarët nuk deshën ta pranojnë Muhamedin a.s. si pejgamber, as Kuranin si shpallje të Zotit. Kërkuan t'u vijë ndonjë melek e të vërtëtojë për Muhamedin a.s. etj. Zoti e ngushëllon Muhamedin a.s. për talljet që i bënin, duke i thënë, se edhe me pejgamberët para tëje bëheshin kësi talljesh, dhe se Zoti do t'u japë atyre dënimin e merituar). **Thuaj: "Ecni nëpër tokë e mandej shikoni se si që përfundimi i përgënjështruesve.** Ndërsa në ajetët 7-10 në sures Furkan Allahu xh.sh. thotë; **'' E ata thanë: "Ç'është me këtë të dërguar, i cili ha ushqim dhe ec nëpër tregje? Përse të mos i jetë dërguar një engjëll së bashku me të, e të jetë qortues?" Ose atij t'i jepet ndonjë thesar, apo të ketë ndonjë kopsht nga i cili do të ushqëhej? Zullumqarët madje thonë: "Ju vetëm jeni duke ndjekur një njëri, që e ka zënë magjia!" Shih se çfarë shembujsh të sjellin, prandaj ata janë të humbur dhe nuk mund ta gjejnë rrugën e drejtë. Është i Madhëruar Ai, i cili po të dëshirojë mund të japë ty edhe më mirë se ç'thonë ata, kopshtë në të cilat rrjedhin lumenj, ku ka edhe pallatë.** Dhe po në të njëjtën sure ajeti 21 Allahu xh.sh. thotë; **'' E ata që nuk e shpresojnë takimin Tonë, ndaj thanë: "Përse të mos na dërgohen nëve engjëj, ose përse të mos e shohim Zotin tonë?" Ata e tëjçmuan lart vetën dhe u sollën me arrogancë."** Edhe në ajetin 9. të sures Sebe Allahu thotë; **'' A nuk e shohin qiellin e tokën, që i ka rrethuar ata para dhe prapa? Sikur të duam, Në e shembim tokën me ta ose lëshojmë mbi ta copa nga qielli. S'ka dyshim, se në këtë ka argument për secilin njëri, që kthen mendjen të Zoti."** Po ashtu në suren Isra ajeti 97 Allahu xh.sh. thotë; **'' Atë që Allahu e drejton në rrugë të drejtë, ai është udhëzuar, e atë që e lë të humbur, për ata nuk do të gjesh ndihmëtarë përveç Atij. Në Ditën e Kijametit i tubojmë ata, duke i tërhequr rrëshqanas me fytyra përdhe, të verbër, memecë, të shurdhët. Vendi i tyre është xhehenëmi, sa herë që të pushojë flaka Në ua shtojmë flakën e zjarrit.''**

Me zbritjen e këtyre ajetëve mushrikët u acaruan edhe më shume dhe filluan sulme më të ashpra ndaj Muhammedit a.s. dhe besimtarëve që i besonin atij.

Një ndër më shqëtësuesit për Muhammedin a.s. ishtë Ubej bin Halefi me të vëllanë. Një ditë Ubej kishtë marrë një rreshke të kalbur të ndonjë kafshe dhe kishtë ardhur pranë Muhammedit a.s. duke ju drejtuar atij '' O Muhammed! A mos valle thua se Allahu yt do ta ringjalli edhe një herë këtë rreshken e kalbur? A është ashut po thua a? Pra ti po thua që kjo rreshkë do ringjallet prap! Dhe duke e bërë pluhur rreshken me duart e tij dhe në formë injorimi ja hodhi para atij duke thënë; '' O Muhammedit! Po kush do të na ringjall nëve more kur në do të jemi bërë pluhur e hi?'' Ndërsa Muhammedi a.s. ju kthye ''Po ore Po, Allahu xh.sh. është ai që do të marri shpirtin, pastaj do të na ringjalli dhe ty do të fusi në zjarrin e xhehennëmit.'' Ky ishtë dhe shkaku i zbritjes se ajetëve 77-81 në suren Jasin ku Allahu thotë; **'' A nuk mendon njëriu, se Në e krijuam atë prej një pikë uji** (fare), **kur ja, ai kundërshtar i rreptë. Ai na solli Nëve shembull, e harroi krijimin e vet e tha: "Kush i ngjall eshtrat duke qënë ata të kalbur?" Thuaj: "I ngjall Ai që i krijoi për herë të parë, e Ai është shumë i Dijshëm për çdo krijim. Ai që prej drurit të gjelbër ju bëri zjarrin, e ju prej tij ndizni". A nuk është i fuqishëm Ai, që krijoi qiejt e tokën, të krijojë njërëz sikundër se i krijoi ata? Po, Ai është Krijuesi, i Gjithëdijshmi.''**

Besimi I Halid Bin Said

Që kohën kur kishtë filluar hapur thirrja në Isalm Sadi kishtë parë në ëndërr sikur i ati e kishtë kapur për beli dhe po e tërhiqtë drejt xhehennëmit por prej duarve të të atit e kishtë shpëtuar I Dërguari i Allahut a.s. i cili po kalontë aty pranë. Sadi u zgjua dhe tha kjo ënderr nuk mund të jetë gabim, ndaj në mëngjes ai dolin eë rrugë dhe takoi Ebubekrin r.a. të cilit ja tregoi ëndërrën që kishtë parë. Ebubekri i tha; ''O Sad! Ëndërra jotë është më se e vërtëtë, Muhammedi a.s. është I Dërguari i Allahut. Vrapo tëk ai dhe pranoje atë që ai i fton njërëzit! Ti bindju atij a.s. dhe nëse shoqërohesh me të do të shohësh se mu ashtu sikur tu ka shfaqur në ëndërr ai do të shpëtoi ty prej zjarrit të xhehennëmit. Ndërsa babai yt do të mbes aty ku e ke lënë në ëndërr (në xhehennëm)!''

Halid bin Sadi kishtë mbetur nën ndikimin e ëndërrës së tij dhe nuk po e zintë vëndi në vënd. Pa humbur kohë ai u nis drejt vëndit të quajtur Exhjad me shpresën se aty do ta takontë Muhammedin a.s. dhe ashtu ndodhi, i Dërguari i Allahut ishtë aty.

Sadi pa u përmbajtur aspak; '' O Muhammed (a.s.)! Kup o i thërret njërëzit ti?'' e pyeti Prefetin a.s. i cili me butësinë e tij ja ktheu; **''Unë po i thërras njërëzit tëk Ai i Cili nuk ka as shok, as ortak dhe as të ngjashëm me Të, pra po i thërras tëk Zoti i gjithësisë Allahu xh.sh. dhe po ashtu po i thërras të më besojnë së unë jam njëri sikur gjithë të tjerët dhe se Allahu më ka Dërguar ti thërras ata tëk Ai. Pra po ju them njërëzve se këto që ju po adhuroni nuk kanë asnjë lloj dobie, ata sjanë as për vetën e tyre dhe as për ju, ndërsa Ai që meriton të adhurohet është vetëm Allahu xh.sh..''** Pasi e dëgjoi Muhammedin a.s. Sadi i tha; ''Edhe unë tashmë do të dëshmoj se nuk ka Zot tjetër veç Allahut dhe se ti je I Dërguari i Tij.'' Dhe pranoi Islamin.

Pranimi i Islamit nga ana e Halid bin Sadit e gëzoi shumë Muhammedin a.s.. Së bashku me Sadin r.a. Islamin e pranoi bashkeshortja dhe vellai i tij Omeri. Ndërsa kur dëgjoi i ati se ata ishin bërë myslimanë i mblodhi fëmijët dhe të afërmit e tjerë që ende nuk e kishin pranuar Islamin dhe i urhdëroi ata të ja sillnin pranë Sadin, të shoqën e Sadit dhe vëllain e tij Omerin. Babai i tyre Ebu Uhajha ishtë një ndër armiqtë më të përbëtuar të Islamit. Ky filloi ti rrihtë dhe të ju kërkoi bijëve të tij që të

hiqnin dorë prej Islamit, ndërsa Sadit i thoshtë; ''Ti je ai që pranon Muhammedin (a.s.)? A nuk e sheh ti se si na i nëpërkëmbi idhujt dhe si na ndau me njëri tjetrin Muhammedi (a.s.)!'' I biri (Sadi) që ndodhej nën dhunën e të atit ja ktheu ''Betohem në Allahun se ajo që thotë Muhammedi a.s. është e vërtetë. Unë i besoj atij. Vdes dhe nuk heë dorë nga besa që i kam dhënë, pra vdes dhe nga Islami nuk heq dorë!''

"O Allah fali sepse ata nuk janë të vetëdijshëm për atë që ata bëjnë."
Hadith.

Kur dëgjoi i ati këtë dalje të Sadit u nërvikos edhe me shumë sa që e rrihtë mo shkop gjer sa shkopi u thye pastaj; ''O Femijë i prapë shko nga të duash. Betohem se ty nuk kam me ta dhënë kafshatën e bukes!'' Sadi duke dalur nga dera thoshtë; ''Ti mund të ma presësh hakun por nuk ka pikë dyshimi që Allahu do ma japë rrizkun.'' Me pas babai i Sadit ju kthye të tjereve dhe ju tha se nëse ndonjëri nga ju dëshiron ta pasoi Sadin të iki pas tij por prej frikes askush nuk e hapi gojën dhe nuk e luajti hapin.

I ati e mbylli Sadin edhe në qëlinë e tij dhe për tre dit radhasi as nuk dha të hajë as të pijë. Pas tre ditëve Sadi ja arriti ti shpëtoi të atit dhe u largua prej tij. Pa zgjatur shume të atin e Sadit e kapi një sëmundje e rëndë. Edhe pse ishtë në atë gjëndje ai thoshtë; ''Ah sikur të bëhesha mirë që të mos lejoja askënd nga myslimanët të marrin frymë. Të mos lejoj askënd ti nëpërkëmbi idhujt tanë, ti detyroj ata (myslimanët) të adhurojnë idhujt dhe të mos mbes kush pa i adhuruar idhujt në Mekka!..! Kur shihtë Sadi këtë vendosmëri armiqsie të i ati filloi ti lutëj Allahut që tja shpëtontë vëllezirët prej duarve mizore të të atit dhe ait ë mos ngrihej me nga shtrati e të dhonontë vëlleërit e tij. Allahu ja pranoi duanë Sadit, i ati nuk u ngre me kurre nga shtrati, ai vdiq aty, idhujtarë në shtratin e vdekjes.

Musab Bin Umejri Bëhet Mysliman

Musab bin Umejri radijallahu anhu vintë nga një ndër familjet më të pasura Kurejshitë. Kur dëgjoi pë I Dërguari i Allahutn a.s. në zemrën e tij lindi një simpati e madhe ndaj tij. Ai e pristë me padurim takimin me të. Më në funda i nuk duroi më dhe shkoi në Dar-ul Erkam dhe pranoi Islamin. Por kur dëgjuan prindërit e tij për këtë ja hoqën atij të gjitha të drejtat familjare dhe filluan ta dhunojnë. Ata e burgosën atë në shtëpi dhe për shumë ditë e lanë pa buke e ujë, me ditë të tëra e nxirrnin poshtë diellit të nxehtë të Arabisë dhe e dhunonin nën tëmpëraturat e larta. Të gjitha këto barbarizma ato i bënin vetëm dhe vetëm që ait ë hiqtë dorë prej besimit Islam. Por Musab bin Umejri i rezistoi të gjitha atyrë barbarizmave dhe nuk hoqi dorë prej besimit Islam. Ai para se të pranontë Islamin jetontë në konfor, luks dhe bollëkun e pasurise së familjes. Të gjithë e kishin zili për jetësën që bentë, por kur ai pranoi Islamin familja ja mohoi atij të gjitha të drejtat dhe trashgimërinë familjare, madje përtëj këtyre ata e mbanin nën presion e dhunë.

Ndaj ai nuk duroi me dhe u nis drejt e të I Dërguari i Allahut a.s. Aliut r.a. ketë e transmeton kështu; '' Në ishim të ulur bashkë me I Dërguari i Allahutn a.s.. Pa pritmas vumë re që po afrohej Musabi, ai mbi trup kishtë një veshje për të ardhur keq, shenjat e dhunës që kishin ushtruar mbi të dukej qartë në trupin e tij. Kur e pa I Dërguari i Allahut alejhi selam në atë gjëndje ju mbushën sytë me lot. Por kur vuri re vendosmërinë e tij në Islam ai s.a. tha; **'' A e shihni kë që ja ka ndriçuar zemrën me iman Allahu. E kam parë kur peindërit e tij e vishnin dhe e ushqënin me veshjet dhe ushqimet më të mira në Mekka por dashuria e tij për Allahun dhe Të Dërguarin e Tij e ka prurë në këtë gjëndje.''**

Përmende Hakkun nga të jesh
Ashtu urtësi shumë do gjesh
Të hapen dyert të gjitha
Sikur drita e syrit t,shtohet bukuria

Sikur thotë edhe Shems Tërbidhiu
Dynjaja ka fund, e keqja kacafiu
E gjitha shkrihet e zhduket
I përhershëm vetëm Allahu mbet

Salâtullah selâmullah,
Alejke jâ Resûlallah.

EMIGRIMI PËR NË HABESHISTAN (ETIOPI)

Emigrimi i parë në Habeshistan

"O Sahabë! Tashmë ka ardhur koha të ndaheni dhe të përhapeni në rruzullin tokësor, Allahu xh.sh. do të na ribashkoi përsëri."
Hadith

Prej kohës kur ju shpall Pejgamberllëku Muhammedit a.s. deri në në vitin e pestë numri i myslimanëve poshtohej nga dita në ditë. Por edhe mushrikët e kishin shtuar nga dita në ditë dozën e dhunës ndaj myslimanëve. I Dërguari i Allahutn a.s. e pikëllontë shumë dhuna dhe barbarizmat që ushtroheshin mbi myslimanët, ai nuk po arrintë ti durontë më ato brabarizma sikur lidhja e besimtaërve këmbë e duar pas deveve që ja coptonin trupin në copa, as varjen e myslimanëve nën tëmpëraturat e larta ku ju digjej trupi e mishi sikur piqët bagëtia në hell. Ndaj ai një ditë i mblodhi sahabët dhe ju tha; **'' O Sahabë! Tashmë ka ardhur koha të ndaheni dhe të përhapeni në rruzullin tokësor, Allahu xh.sh. do të na ribashkoi përsëri.''** Sahabët nga habi ku të shkojmë o I Dërguari i Allahut i thanë atij. I Dërguari i Allahut a.s. ngriti dorën dhe duke bërë me shenjë nga Habeshistani tha; **''Ja atje, në tokat e Habeshistanit shkoni![71] Shkoni atje sepse atje sundon një sundues që nuk i bën padrejtësi askujt. Dijeni se atje është shtëti ku sundon drejtësia. Shkoni dhe qëndroni atje deri sa Allahu xh.sh. të ju jap mundësi të shpëtoni prej kësaj dhunë dhe mizorie që ushtrohet mbi ju.''**

Muhammed Mustafai a.s. kishtë vendosur ti shpëtontë shokët e tij prej dhunës dhe barbarizmave të mushrikëve, ndërsa vetë do të qëndrontë në Mekka përballë tyre. Pasi I Dërguari i Allahut a.s. lejoi sahabët të emigronin një pjesë prej tyre u ndanë nga vendlinja dhe emigruan, por pikëllimi i tyre nuk ishtë se u ndanë prej vendlindjes së tyre por prej ndarjes nga I Dërguari i Allahut xh.sh.. Në këtë emigrim të parë kishin marrë pjesë prej sahabëve të Osmani dhe bashkëshortja e tij Rukijje binti Resûlullah, Ebû Huzejfe me bashkëshortën e tij Sehle binti Suheyl, Zubeyr bin Avvâm, Mus'ab bin Umejr, Abdurrahmân bin Avf, Ebû Seleme bin Abdulesed me bashkëshortën e tij Umm-i Seleme, Hâtib bin Amr, Âmir bin Rebîa me bashkëshortën e tij Lejlâ binti Ebî Hasme, Osman bin Maz'ûn, Ebû Sebre bin Ebî Ruhm me bashkëshortën e tij Ummu Gulsum binti Suhejl, Suhejl bin Bejdâ, Abdullah bin Mes'ûd "radiallahu anhum" etj...[72] Kjo ishtë ajo koha kur I Dërguari i Allahut a.s. tha për Osmanin r.a. se; '' Pas Lutit alejhi selam ai që udhëton për herë të parë me bashkëshortën e tij është Osmani radijallahu anhu.''

[71] Ibni Ishâk, Sîret-i Resûl, 194; Ibni Hishâm, Sîret, I, 321; Ibni Sa'd, Tabakât, I, 203- 204; Ibni Kethîr, Bidâje, III, 94
[72] Ibni Ishâk, Sîret-i Resûl, 205-210; Ibni Sa'd, Tabakât, I, 204.

Emigrimi Për Në Habeshistan (Etiopi)
(Foto-HARITA)

"O Kurejshitë! Ju më godisni mua por dijeni se unë jam I Dërguari i Allahut juaj."
I Dërguari i Allahut Muhammed a.s.

Një pjesë prej sahabëve u larguan fshehurazi me deve ndersa një pjesë prej tyre u larguan më këmbë. Kur arritën në Shuajbie kishtë dashur allahu që aty të gjëndeshin dy anije tregëtie, ata i paguan tarifën e udhëtimit tregëtarëve dhe hipën në anije. Por më të dëgjuar mushrikët u nisën për të ndaluar emigrimin e shabaëe, kur arritën në port anijet kishin kohë që ishin hapur në det, ndaj mushrikët u kthyen të dëshpruar në Mekka. Pra përpjekja për të penguar emigrimin e sahabëve ju kish shkuar bosh dhe u kthyen të humbur në Mekka. Ndërsa sahabët kishin mbërritur shëndosh e mirë në Habeshistan,[73]ku mbreti i Habeshistanit Nëxhashi i priti mirë myslimanët, i strehoi ata dhe ju dha i la të jetonin të lirë.

Pas ikjes së besimtarëve në Habeshistan Allahu i zbriti I Dërguari i Allahutt a.s. suren Nëxhm. I Dërguari i Allahut a.s. doli një ditë në Mesxhid-ul Haram dhe po këndontë ajetët 19-20 të kësaj sureje në të cilët thuhet se; **''E ju, a i shihni Latin dhe Uzanë? Dhe atë të tretin e të fundin, Menatin (a kanë fuqi si Zoti i Muhamedit, e ju i konsideroni zota)!''** Kur i dëgjuan mushrikët këto ajetë menduan se këto ishin fjalët e Muhammedit a.s. dhe thanë; ''Meqë Muhammedi (a.s.) e paska pranuar fenë tonë edhe në heqim dorë prej armiqësisë dhe pajtohemi me të.'' Ishtë Velid bin Mugire ai që ju afrua Muhammedit a.s. dhe i tha ''o Muhammed, këtu e mbrapa në as nuk të prekim dhe as nuk kemi më punë me ty!'' Muhammedi a.s. u habit kur i dëgjoi fjalët e tij. Ky lajm i mushrikëve u përhap sikur ata bënë paqë me Muhammedin a.s. (!) dhe pa zgjatur shume ky lajm arriti gjer në Habeshistan tëk sahabët që kishin emigruar atje! Kur ju arriti lajmi atyre ishtë fundi i muajit Ramazan dhe ata menduan se ky ishtë ai lajmi i shumëpritur që do të merrtë fund emigrimi i tyre. Pra arsyeja e emigrimit të tyre ishin barbarizmat që ushtronin mushrikët ndaj myslimanve dhe kur erdhi lajmi se u arrit marrëveshja për paqë me Muhammedin a.s. dhe pasuesit e tij ata menduan të kthehen në vëndlindje. Për këto ndodhira Allahu xh.sh. i përgënjështroi dredhitë e djave ku nëpërmjet Xhebrailit a.s. i zbriti Muhammedit a.s. ajetin 52 të sures Haxhxh në të cilin thotë; **'' Në nuk dërguam para tëje asnjë të dërguar (me shpallje) dhe asnjë pejgamber (të dërguar si vazhdues i shpalljes së mëparshme), e që kur ai (i dërguari) dëshiroi diçka të mos iu pat hedhur në atë dëshirën e tij djalli, e Allahu asgjëson atë që e hedh djalli, dhe Allahu fuqizon argumentët e Veta. Allahu është shumë i Dijshëm dhe me urtësi të madhe i rregullon çështjet.''** Kur degjuan mushrikët këtë ajet përsëri i rinisën sulmet dhe barbarizmat e tyre ndaj myslimanëve. Ndërsa myslimanët që kishin emigruar në Habeshistan në muajin SHeval u kthyen në Mekka dhe mësuan se lajmi që ata kishin marrë ishtë i rremë.[74] Ata në Habeshistan kishin qëndruar pak më shumë se dy muaj dhe kur u kthyen në Mekka ata tregonin për mikëpritjen që kishin parë atje. Mbreti i Habeshistnit ata i kishtë pritur me dashamirësi, ju kishtë dhënë të hanin dhe të pinin, i kishtë strehuar dhe kishtë treguar një mikëpritje të veçantë për to, sa që ata kishin mbetur të mahnitur nga kjo sjellje e tij.[75]

Hamzai Radijallahu Anhu Pranon Islamin

Në vitin e gjashtë pas ardhjes se shpalljes... Islami po kalontë nga veshi në vesh, nga goja në gojë, nga zemra në zemër dhe i kishtë kapërcyer kufinjtë e Arabisë. Kjo gjëndje i kishtë acaruar shumë mushrikët Kurejshitë sepse ata me gjithë përpjekjet dhe cakrificat e tyre nuk ja kishin arritur dot ta ndalnin përhabpjen e Islamit.

[73] Ibni Sa'd, Tabakât, I, 204; Taberî, II, 221; Ibni Sejjidinnâs, I, 116; Mevâhib Sherhi, I, 271.
[74] Ibni Ishâk, Sîret-i Resûl, 194-204; Ibni Hishâm, Sîre, I, 321-332; Ibni Sa'd, Tabakât, I, 204; Taberî, Histiria, II, 411.
[75] Ibni Ishâk, Sîret-i Resûl, 194; Ibni Hishâm, I, 364; Ibni Sa'd, Tabakât, I, 208; Taberî, Historia, II, 414.

Në **"Delâil-un nubuvve"** dhe në **"Me'ârixh-un nubuvve"** erdhi lajmi se;

"O Xhaxha! Unë gëzohem vetëm nëse ti pranon Islamin dhe e shpëton veten tënde prej zjarrit të xhehennemit"
Muhammedi a.s.

Mushrikët kishin një idhull që quhej Velid, ata ishin mbledhur në kodrën Safa dhe po i bënin adhuronin atë. I Dërguari i Allahut a.s. shkoi pranë tyre dhe i bëri thirrje atyre në Islam. Një shejtan qafir që ndodhej pranë idhullit filloi të flasë me fjalë ofenduese ndaj I Dërguari i Allahutt a.s. të cilin e prekën shumë fjalët e qafirit. Një ditë tjetër dikush erdhi dhë i dha selam I Dërguari i Allahutt a.s. dhe i tha; ''O i Derguari i Allahut! Kam dëgjuar se kur shkove në kodrën Safa një shejtan i mallkuar të kishtë sharë dhe ofenduar. Unë do shkoj dhe ku ta gjej do ja heq kokën atij. Prej jush kërkoj që nëse e shihni të arsyeshme nësër të vini sërish në kodren Safa dhe ti ftoni kurejshët në Islam. Unë do të jem pranë idhullit dhe do të them fjalë lëvduese për ty.'' I Dërguari i Allahut a.s. e pranoi ftësën e thirrësit dhe të nësërmen shkoi atje dhe filloi ti thërras Kurejshitët në Islam. Aty gjëndej edhe Ebuxhehli. Dhe kur dëgjoi atë që thuri lëvdata për I Dërguari i Allahutn a.s. u ngrit dhe së bashku me mushrikët filluan të sulmonin Muhammedin a.s., ata e sulmuan aq shumë sa që fytyra ju gjakos. Por Ai sallahau ve selam nuk e prishi natyrën të qëtë dhe ju kthye atyre duke ju thënë; **''O Kurejshitë! Ju më godisni mua por dijeni se unë jam I Dërguari i Allahut juaj.''** Dhe u largua prej tyre për të shuar në shtëpinë e tij.

Një grua skllave e kishtë parë gjithë atë çfar i kishtë ndodhur Muhammedit a.s. me mushrikët dhe ajo kishtë shkuar të xhaxhai i I Dërguari i Allahutt a.s. Hamzai i cili kishtë dalur për gjueti. Ju afrua atij dhe i tha; ''O Hamza! Nuk e di ç'njëri je që rrin duke gjuajtur sorkadhet apo kaprolët me shigjeta ndërkohë që nipin tënd jua ke lënë gjah Kurejshitëve, të cilët sillen si ju don qëjfi atyre me të?'' Hamzai r.a. u prek shumë nga këto fjalë që dëgjoi ndaj ai e la gjahun dhe u nis drejt e për në shtëpi. Pr sikur ishtë zakoni i asaj kohe tëk arabët para se të futëj në shtëpi a shkonin dhe bënin tavaf në Qabe, kështu bëri dhe Hamzai r.a. Pas tavafit atij ju ringjallën edhe një herë fjalët e gruas që i kishtë thënë për dhunën që kishtë pësuar nipi i tij Muhammedi a.s. prej mushrikëve. Por papritmas ai pa mushrikët që ishin mbledhur diku në një cep pranë Qabes, ai nxorri armët dhe u nis drejt tyre. Me tua afruar ju drejtua mushrikëve, pikërisht duke ju drejtuar Ebuxhehlit i cili ishtë iniciatori kryesore i sulmeve që i beheshin Muhammedit a.s., duke i thënë; ''A ti je ai që shan, ofendon dhe ja nxi jetën djalit të xhaxhait tim Muhammedit (a.s.)? Dijeni sa tani e tutje feja e tij është feja ime. Nëse ta mban atë që i bën atij eja ma bëj dhe mua dhe shihe pastaj ç'të ndodh'' dhe me harkun e gjahut që mbantë në dorë e goditi në kokë Ebuxhehlin, i cili nuk reagoi fare kundër tij, por ju kthye atyre që deshën ti kundërvhen Hamzait r.a. duke ju thënë; ''Lëreni sepse a ika të drejtë, unë ja kam sharë dhe sulmuar nipin e tij Muhammedin a.s.''

Pasi u largua Hamzai r.a. të pranishmit ju kthyen Ebuxhehlit dhe i thanë; '' O Ebuxhehil! Përse nuk na lejove ta godasim Hamzain!'' Ai ja ktheu atyre; ''Aman mos e luani! Sepse nëse ai nxehet me në do bëhet mysliman dhe do bashkohet me Muhammedin (a.s.), që do me thënë; pranimi i Islamit nga Hamzai e forcon me shumë Muhammedin (a.s.).'' Ebuxhehli e dintë mirë që Hamzai ishtë njëri trim, zotërontë respekt të veçantë tëk arabët dhe ishtë një ndër njërëzit më të fuqishëm në Mekka. Kjo ishtë arsyeja që Ebuxhehli, vetëm që Hamzai të mos bëhej mysliman, kishtë toleruar goditjen që i bëri ai (Hamzai r.a.) atij. Por Hamzai ishtë i vendosur tashmë ndaj ai shkoi të Muhammedi a.s. dhe i tha; ''O Muhammed (a.s.)! Gëzohu se

e mora hakun tënd nga Ebuxhehli, e kam goditur atë sa që ju gjakos fytyra!'' Prefeti i mëshirës ja ktheu; **''Unë nuk i gëzohem këtyre gjërave.''** Atëherë më thuaj çfar mund të bej unë që ta heq mërzinë dhe të gëzoi ty!'' Atëherë I Dërguari i Allahut a.s. **''O Xhaxha! Unë gëzohem vetëm nëse ti pranon Islamin dhe e shpëton vetën tënde prej zjarrit të xhehennëmit''** i tha Hamzait i cili pa një pa dy pranoi Islamin.

Sipas Abdullah ibni Abbasit r.a. ajeti 122 i sures En'am në Kur'an ka zbritur në kohën kur Hamzai r.a. pranoi Islamin. Ajeti 122 i sures En'am thotë se; **'' Vallë, a është ai që që i vdekur, kurse Në e ngjallëm dhe i dhamë dritë, me të cilën ecën mes njërëzve, si ai që ka mbetur në errësirë (i humbur) dhe nuk mund të shpëtojë nga ajo? Ja, kështu (si këtij në errësirë) iu duket mirë mohuesve ajo që veprojnë.''** Sipas Ibn Abbasit ''I Ndrituri'' në këtë ajet është Hamzair r.a. ndërsa ''I Humburi'' është Ebuxhehli.

"(O xhaxha!) Unë do të gëzohem vetëm nëse ti beson dhe shpëton trupin tënd të çmuar nga zjarri i Xhehenemit."
Hadith

Hamzai r.a. pasi pranoi Islamin shkoi të Kuresjhët dhe ju tha atyre se tashmë ka pranuar Islamin dhe kush ka guxim ti dal para dhe ta ndaloi apo kundërshtoi këtë vendim të tij. Mushrikët i kapi paniku sepse ashtu sikur u përmend më lart se Hamazi ishtë një ndër njërëzit më të respëktuar dhe me të fuqishëm në Mekka, ndaj ata nuk i pikëllontë vetëm fakti se ai kishtë pranuar Islamin por i pikëllontë fakti se me pranimin e Islamit nga ai e kishtë fuqizuar edhe më shumë Muhammedin a.s. Ndërsa nga an tjetër besimtarët ishin gëzuar shumë sepse vetëm atëherë e kishin ndjerë vetën më të fuqishëm nga mushriket. Kështu që myslimanët filluan të lëvinin lirshëm sepse mushrikët kishin frikë ti dhunonin apo ti sulmonin ata si më parë.[76]

Me dashuri udhëtova
Tëk ti Ja I Dërguari i Allahut
Nga gjynahet mu nxi fytyra
M'pastro Ja I Dërguari i Allahut

Omeri Radijallahu Anhu Bëhet Mysliman

Feja Islame po përhapej nga dita në ditë, drita e Kur'anit vazhdontë ti ndriçontë shpirtërat. Kush e kishtë rrisk/kismet ndriçohej dhe ju nashkangjistë udhëzimit të Allahut xheleshanuhu. Numri që kishtë fatin të ju bashkangjistë vargut të sahabëve radjiallahu anhum shtohej nga dita në ditë, zemrat bashkoheshin dhe ndërgjegjet ngriheshin të bashkuara dorë për dore. Rrethi i I Dërguari i Allahutt alejhi selam shtohej e zgjerohej sikur helikë. Nga sahabët një lëvizje e vogël e I Dërguari i Allahutt a.s. merrej sikur të ishtë një urdhër për ta, madje ata garonin kush të ishtë më i përkushtuar ndaj parmeve dhe udhëzimeve të tij. Ata ishin të gatshëm që edhe jetët ti flijonin për të.

Paniku dhe shqëtësimet e mushrikëve kishtë arritur kulmin, sepse edhe më të fortët e tyre po i braktistë ata dho po i bashkohej karvanit të Muhammedit alejhi selam. Një ndër ata që i kishtë braktisur për herë të fundit ishtë Hamzai r.a. i cili ju kishtë bashkangjit rrethit të Muhammedit a.s.. Kjo ndodhi e papritur i kishtë nxjerr nga mendët mushriket. Kjo ishtë arsyeja që dhe i biri i Hatabit Omeri (i cili ende nuk kishtë pranuar Islamin), një ditë kishtë daluar në rrugë dhe ishtë betuar se ku ta zintë Muhammedin (a.s.) da ta vristë. Ai e gjeti I Dërguari i Allahutn tonë të

[76] Ibni Ishâk, Sîret-i Resûl, 151-153; Ibni Hishâm, Sîret, I, 291-292.

dashur duke falur namaz në Qabe. Ai po pristë që të marontë faljen por kur dëgjoi ato fjalë që Muhammedi a.s. po kendontë atij (Omerit r.a.) ju shtua meraku dhe filloi ta dëgjontë me vëmëndje.

I Dërguari i Allahut alejhi selam po këndontë ajetët e sures Hakka… Allahu xh.sh. në suren Hakka thotë; **E Vërtëta** (Kijameti). **Ç'është e Vërtëta** (Kijameti)? **Çka të mësoi ty, se ç'është e Vërtëta** (Kijameti)**? Themudi dhe Adi përgënjështruan Tronditjen** (Kijametin). **Sa i përket Themudit, ata u shkatërruan me krismë të tmerrshme. Ndërsa Adi është shkatërruar me një erë të fortë, të pakufishme. Atë Ai e lëshoi kundër tyre shtatë nët e tëtë ditë rresht, kur i shihje njërëzit në to të rrëzuar, si të ishin trupa hurmash të zgavruara. A e sheh prej tyre ndonjë që ka mbetur?**

Erdhi faraoni dhe ata, që ishin para tij, si dhe të përmbysurit (fshatrat e popullit të Lutit) **me punë të gabuara. Ata kundërshtuan të dërguarin e Zotit të tyre, e Ai i dënoi ata me një dënim edhe më të madh (**prej dënimeve të mëparshme**). Pasi uji pat vërshuar Në ju bartëm në anije, për ta bërë atë (**ngjarje**) përkujtim për ju dhe për ta ruajtur atë veshët që janë përkujtues. E kur të fryhet në sur një fryrje, dhe të ngrihen toka e kodrat e ta godasin vrullshëm njëra-tjetrën me një të goditur. Në atë kohë ndodh Ndodhia e madhe (**Kijameti**). E qielli çahet, pse ai atë ditë është i brishtë. Dhe engjëjt qëndrojnë në skajet (**anët**) e tij, e atë ditë tëtë (**engjëj**) e bartin mbi vetë Arshin e Zotit tënd. Atë ditë ju do të ekspozoheni (**para Zotit**), duke mos mbetur fshehur asnjë sekret juaji.**

Kujt t'i jepet libri i vet nga e djathta e tij, ai do të thotë: "O ju, ja, lexojeni librin tim!" Unë kam qënë i bindur, se do të jap llogarinë time. Dhe ai atëherë është në një jetë të kënaqshme, në një xhenët të lartë. Pemët e tij i ka krejt afër. (E thuhet**) Hani e pini shijshëm, sepse në ditët e kaluara ju e përgatitët këtë. Ndërkaq kujt i jepet libri i tij nga e majta e tij ai thotë: "O i mjeri unë, të mos më jepej fare libri im. Dhe të mos dija fare se çka është llogaria ime. Ah, sikur të kishtë qënë ajo (**vdekja e parë**) mbarim i amshueshëm për mua. Pasuria ime nuk më bëri fare dobi. U hoq prej meje çdo kompetëncë e imja. U thuhet zebanëve: Kapeni atë, vendosjani prangat! Pastaj futëni atë në xhehennëm. Mandej lidheni atë me një zinxhir të gjatë shtatëdhjetë kutë. Se ai ka qënë që nuk besoi Allahun e Madhëruar. Ai nuk nxistë për t'i ushqyer të varfërit. Ai sot nuk ka këtu ndonjë mik, as ushqim tjetër përveç të të shpërlarave, që atë nuk e ha kush, pos mëkatarëve…"**[77]

"Nuk është as fjalë e ndonjë falltori, po ju nuk jeni të cekët ne mendim. Është zbritje prej Zotit të botëve!" ***Hakkah 42-43***

Omeri po e degjontë I Dërguari i Allahutn a.s. me një habi dhe vëmendje të madhe dhe këtë me vonë ai do e shprehtë kështu; '' Betohem se, kur po dëgjoja ato çfar thoshtë Muhammedi a.s. me bukurinë, rrjedhshmërinë dhe kuptimin e plotë të tyre, ai nuk ishtë tjetër por vetëm një poet sikur thonë Kurejshitët. Ndërsa Muhammedi a.s. këndoi ajetët 38-41 të sures Hakkah ku thoshtë; **'' Pra Unë betohem në atë që e shihni, edhe në atë që nuk e shihni, se me të vërtëtë ai** (Kurani) **është fjalë** (e Zotit), **që e lexon i Dërguari i ndershëm! Ai nuk është fjalë e ndonjë poeti, po ju nuk besoni..''** atëherë mendova me vetë se, me që ky kuptoj atë çfar po mendoja, duhet të jetë vetëm se një fallxhorë, ndryshe ku do ta tintë se çfar po mendoja unë.

[77] Kur'an, El-Hakkah, 1-37.

Por kur ai vazhdoi të lëxontë pjesën në vazhdim ajetët 42-52 ku thoshtë; **''Nuk është as fjalë e ndonjë falltori, po ju nuk jeni të cekët në mendim. Është zbritje prej Zotit të botëve! Sikur të trillontë ai** (Muhamedi) **për Në ndonjë fjalë! Në do ta kapnim atë me fuqinë Tonë, e pastaj do t'ia këputnim atij artërien e zemrës, e askush prej jush nuk do të mund të ndërhyntë për mbrojtjen e tij. Ai** (Kurani) **është këshillë për të ruajturit. S'ka dyshim, se Në dimë që prej jush ka që e përgënjështrojnë. Ai** (Kurani) **njëmend do të jetë dëshpërim për jobesimtarët. Ai është e vërtëta bindëse! Prandaj ti lartësoje nga të metat Zotin tënd të Madhëruar!''** atëhere në nëmein time lindi një simpati ndaj Islamit'' tha Omeri radjiallahu anhu.

Tri ditë pasi u bë Hamzai mysliman, Ebuxhehli i mblodhi mushrikët dhe ju tha; '' O Kurejshitë! Muhammedi na i nëpërkëmbi zotat (idhujt) dhe për t'parët tanë thotë se janë duke marrë dënim në zjarrin e xhehennëmit, madje ai thotë se dhe në do shkojmë në xhehennëm!... Nuk na mbetët zgjidhje tjetër vetëm se ta vrasim atë!... Kush ngrihet dhe e vret atë (Muhammedin a.s.) do ta paguaj me njëqind deve dhe me një shumë të madhe floriri! ...'' kur dëgjoi këto fjalë prej Ebuxhehlit Omeri harroi atë çfar kishtë ndjerë për Islamin kur kishtë dëgjuar I Dërguari i Allahutn të këndontë Kur'an në Qabe dhe u ngrit në këmbë duke drejtuar të pranishmëve; ''Nuk ka askush që e kryen këtë punë veç Birit të Hatabit (vetë Omeri).'' Këtë dalje të tij ata e pritën me duartrokitj dhe i thanë; '' hajde të shohim vendosmërinë tënde o Biri i Hatabit''

Omeri vendosi shpatën në brez dhe u nis të kërkontë Muhammedin a.s. por në rrugë rasitisi dhe u takuam më Nuajm bin Abdullah i cili e pyeti; ''nga je nisur me këtë vrull o Omër?'' ''Po shkoj të vras atë që na përçau vellai me vëllanë dhe na prishi traditën shoqërore, pra po shkoj të vras Muhammedin.'' Ju përgjigj Omeri Nuajmit i cila pa ja përtuar i tha; '' O Omer nuk është e lehtë ta vrasësh Muhammedin, ai është i rrethuar nga shokët e tij të cilët janë të gatshëm të vdesin për të, por edhe pot ë moa jenë shokët, nëse e vret ti atë kush do të mbroj ty prej bijëve të Abdulmutalibit të cilet janë të gatshëm të marrin gjakun e cilitdo që tënton ta vrasë birin e tyre Muhammedin.'' Omeri u acarua aq shumë sa që i tha; '' si duket edhe ti qënke prej atyre që mbrojnë Muhammedin'' dhe duke e kapur për leckash atë ''po e nis me ty të parin'' dhe nxori shpatën të godas Nujamin i cili prej frikës i tha; ''O Omer! Më lër mua po shko e merru me motrën tëndë Fatmën dhe burrin e saj Sad bin Zejdin sepse dhe ata janë bërë mysliman.'' Por kur pa që Omeri nuk i besoi fjalët e tij ''Ti nuk më beson mua por po deshe shko e shihi vetë me sytë e tu.'' Pas këtyre fjalëve Omeri e la të lirë Nujamin dhe u nis për të banësa e së motres.

Atë kohë ligjet e gjakmarrjes tëk arabët ishin të rrepta, nëse Omeri do ta kishtë vrarë Nujamin ndërmjet tyre do nistë lufta e gjakmarrjes dhe arabët do të coptoheshin e do bëheshin copë e çikë. Por Omeri ishtë njëri trim, guximtare dhe i fuqishëm ai nuk i mendontë këto. Arsyeja që ai nuk e vrau Nujamin ishtë mllefi që i lindi për të motren dhe bashkëshortin e saj. Atë kohe kishin zbritur ajetët e sures Taha, motra e Omerit Fatma së bashku me bashkëshortin Sadin dhe sahabiun e njohur Habbab bin Eret po lexonin këto ajetë. Omeri ishtë afruar të dera e tyre dhe i degjoi që po këndonin Kur'an. Ndërsa ata e kishin ndjerë që po vintë Omeri dhe e fshehën Habbabin. Omeri e hapi derën me një ashpërsi dhe ton të lartë, nxorri shpatën nga brezi dhe ashtu sikur ishtë i tëri në nërva i pyeti ata ''ç'far po thoshit (lexonit)?'' Fatma dhe Sadi të tmërruar prej frikës që kishin ndaj Omerit '' asgjë'' i thaë atij, por ai duke u nërvikosur edhe më shumë '' unë ju dëgjova! Qënka e drejtë ajo që dëgjova!

"O Zot! Forcoje këtë fe me udhezimin e Omerit ose më udhëzimin e Ebuxhehlit." ***Muhammedi a.s.***

Edhe juvë ju paske helmuar Muhammedi që paskeni pranuar fenë e tij!'' ju tha atyre dhe pa një pa dy e kapi Sadin, e shtriu për tokë dhe po e grushtontë më sa mundej. Ndërsa e motra ndërhyri ta shpëtontë bashkshortin prej kthetrave mizore të të vellait, ai e godit aq shume saqë ajo ra në anën tjetur dhe nisi ti rrjedh gjaku nga fytyra. Kur e pa Omeri të motrën në atë gjëndjë i erdhi keq për të. Ndërsa asaj tashmë i kishtë ikur frika dhe ja ktheu të vëllait ''O Omer! Pse more vëlla nuk të vjen turp nga Allahu? Përse nuk i beson I Dërguari i Allahutt a.s. të cilin e ka dërguar Allahu dhe i ka dhënë atij Kur'anin në të cilin ka mrekullira dhe miresi pa fund? Do pranoje do jo! Unë dhe bashkësorti im Sadi i besuam Muhammedit a.s. dhe pranuam Islamin, në tashmë jemi mysliman (dhe duke dëshmuar shehadetin **Esh-Hedu En-La Ilahe Illallah ve Esh-hedu ennë Muhemmeden Abduhu ve Rresuluh),** ti edhe sikur të na presësh kokat në nuk heqim dorë prej besimit Islam.'' Kur pa Omeri këtë vendosmëri jo të zakontë tëk e motra u zbut dhe u ul në tokë dhe me një zë të lehtë; ''pa nxirreni ta shoh një herë atë që po këndonit'' ju tha tyre. Por e motra pa ju trembur syri ''Ti nuk je i pastër, pa u larë e pa u pastruar, unë nuk ta jap ty atë'' ju përgjigj atij. Atëherë Omeri u zbut edhe me shumë dhe kërkoi prej saj ti përgatistë ujin që të pastrohej. Pasi u la dhe u pastrua Omeri e motra Fatma ja solli ajetët e Kur'anit dhe ai filloi të lexontë ajetët e sures Taha. Bukuria, rradhitja dhe kuptimi i mrekullueshëm i Kur'anit ja zbuti zemrën Omerit. Por kur lexoi; **'' E Tij është çdo gjë që ekziston në qiej dhe në tokë dhe çdo gjë që gjendet midis tyre, edhe ç'ka nën dhe.''** ajeti 6 i sures Taha u zhyt në mendime të thella dhe duke ju khtyer të motres; '' O Fatma! Po pse gjithë këto gjallesa dhe ekzistënca pa fund janë të gjitha të Atij Allahut që ju adhuroni a?'' e motra pa hezituar aspak, ''A mos po dyshon a? Patdikutim që Po!'' ju përgjigj Omerit i cili me plot habi e pyeti ''Po pse mi Fatma! Këto mijëra zotat (idhujt); që adhurojme në në rruzullin tokësore nuk paskan asgjë a?'' por pasi lexoi '' **Ai është Allahu, nuk ka të adhuruar të vërtëtë pos Tij, Atij i takojnë emrat më të bukur.''** Ajeti 8 i sures Taha u vetpërgjigj ''Padiskutim që kjo është e vërtëta''. Kur dëgjoi këto fjale të fundit prej Omerit, Habbabi i cili qëndrontë i fshehur doli në shesh dhe prej gezimit, ''Allahu Ekber (Allahu është me I Madhi)! Urime o Omer! Urime! Një ditë Muhammedi a.s. ju lut Allahut **'' O Zot! Forcoje këtë fe me udhezimin e Omerit ose më udhëzimin e Ebuxhehlit''.** Si duket duaja e I Dërguari i Allahutut u pranua dhe ti u nderove me Islam''. Omeri qëndrontë krejt i habitur, zemra ju kish mbushur me dritë e mëshire dhe kur dëgjoi fjalët e Habbabit kuptoi se në zemrin etij nuk kishtë më urrejtje dhe armiqsi për Muhammedin a.s., shokët e tij dhe për ata që i kishin besuar Muhammedit a.s.. Zemra e tij tashmë kishtë rënë nën ndikimin e simpatisë për Muhammedin a.s. ndaj Omeri u ngrit në këmbë dhe ''ku është I Dërguari i Allahutu?'' i pyeti ata.

Atë ditë I Dërguari i Allahut alejhi selam ndodhej në shtëpinë e Erkamit dhe po ju jeptë mësim Sahabëve. Sahabët ishin rrethuar rreth tij dhe po dëgjonin mësimet e tij që ju ndriçontë zemrat, ju kthjellontë mëndjet, ju qëtësontë shirtërat, i inspirontë dhe i aktivontë ata për të shijuar të mirën dhe të largoheshin prej të keqës. Sahabët ishin të përqënduar të I Dërguari i Allahut a.s. kur vunë re se drejt tyre po vintë Omeri bin Hatabi. Ata e njihnin trimërinë, guximin dhe qëndrueshmërinë e Omerit ndaj ata me trupat e tyre e moren nën mbrojtjë I Dërguari i Allahutn a.s., e rrethuan atë dhe Hamzai r.a. doli para sahabëve dhe ju tha; '' Mos u trembni prej Omerit, nëse vjen për mirë të mira do gjej por nësë vjen me ndonjë qëllim të keq atëhere ja heq kokën me shpatën e tij. Lëreni të vij brënda.'' Por sahabët nuk i qëtësuan fjalët e

Hamzait r.a. por fjalët e I Dërguari i Allahutt alejhi selam i cili ju tha; **''Lërni të birin e Hatabit të vijë brënda dhe mos u trembni prej tij''** Omeri hyri brenda dhe u ul në gjunjë para I Dërguari i Allahutt a.s. i cili e kapi për krahu dhe **'' Eja në Iman ej Omer''** i tha atij. Omeri r.a. ''për këtë jam këtu o I Dërguari i Allahut, jam këtu të dëshmoj se nuk ka Zot tjetër veç Allahut dhe ti je i Dërguari i Allahut xh.sh.''

Pranimi i Islamit nga Omeri r.a. i gëzoi aq shumë myslimanët sa që ata brohorsnin sat ë munden ''Allahu Ekber''. Omeri r.a. me vonë këtë do ta trasnmetoi kështu; ''Kur pranova Islamin myslimanët i ruheshin dhunës Kurekshitë dhe ritët fetare i kryenin fshehurazi. Kjo hjëndje e tyre ishtë e papranuar për mua ndaj shkova të I Dërguari i Allahutu dhe i thash; ''O I Dërguari i Allahut a nuk jemi në në fenë e Drejtë?'' Ai a.s. mu përgjigj se; **'' Po! Betohëm në Atë (Allahun xh.sh.), në dorën e të Cilit ndodhet shpirti im se të gjallë apo të vdekur jeni në rrugen e drejtë.''** Atëherë i thash; ''O I Dërguari i Allahut! Kur në jemi në rrugën e drejtë ndersa mushrikët në rrugën e gabuar, përse duhet të fshihemi dhe ti kryejmë ritët fetare fshehurazi? Betohem në Allahun se në duhet të jemi ata që e deklarojnë fenë e tyre haptazi dhe ata duhet të kenë frikë me kufrin e tyre. Pa dyshim që Feja e Allahut (Islami) do të triumfoi në Mekka. Nëse populli ynë do sillet mirë me në edhe në do sillemi mirë me to por nëse do të sillën keq atëherë në do luftojmë më to.'' Pasi i dëgjoi me butësi këto fjalë të miat më tha; **'' O Omer, në jemi pak në numër.''** Por unë këmbungula që ai të na e lejoi deklarimin e fesë hapur dhe kur ai na e lejoi këtë i thash; '' O I Dërguari i Allahut! Betohem në Atë që të ka Dërguar ty Pejgamber se; pa mu trembur syri dhe pa më bërë tërc veshi do dal dhe nuk do lë mushrik pa ftuar në Islam. Tashmë është koha të dalim në shesh.'' Pasi morëm aprovimin e tij dolëm në rrugët dhe u nisëm për në Harem (Qabe). Në krye të rrjeshtit qëndrontë Hamzai r.a. ndërsa në e ndiqnim nga pas atë. Kur hyme në Qabe mushrikët kurejshitë një herë me shihnin mua një herë shihnin Hamzain r.a., ata dukeshin që në shikim që ishin aq të dobët sa nuk nuk kishin rrugëdalje tjetër veç se të ulen ashtu sikur të ishin të ngrirë.''

Ndryshe nga mushrikët e tjerë Ebuxhehli ju afrua Omerit dhe i tha ''O biri i Hatabit! Çpo ndodh me ty?'' ndërsa Omeri r.a. pa ja vënë veshin fare tha ''Deklaroi se nuk ka zot tjetër veç Allahut dhe Deklaroj se Muhammedi është rob dhe i dërguar i Tij.'' Ebuxhehli ngriu në vënd, me gojë hapur dhe nuk kishtë fjalë me thënë. Omeri r.a. u kthe nga mushriket dhe ju tha; ''O Njërëz! Ju me njihni mua!... Unë jam Omeri i biri Hatabit!... dijeni se unë kam pranuar Islamin dhe kush deshiron ta le fëmijën pa babë, bashkeshortën pa burrë dhe prindin pa fëmije le të më dal para, të guxoi të më thotë qoftë edhe një gjys fjale, atëherë do ta shohi se si do ja fluturoi kokën me mprehtësi të shpatës.'' Me të dëgjuar këto fjalë prej Omerit mushrikët u ngritën nga aty dhe ja mbathën nga sytë-këmbët. Ndersa sahabët që ishin me Omerin r.a. nisën të gëzojnë prej gëzimit dhe filluan të bëjnë tavaf në Qabe. Kjo ishtë hera e parë që ata benin bënin tavaf lirshëm lirshëm në Qabe.[78]

Në kohën kur Omeri r.a. pranoi Islamin Muhammedit a.s. i zbriti ajeti 64 i sures Enfal ku Allahu xh.sh. thotë; '' O Pejgamber! Allahu të mjafton ty dhe besimtarëve që janë me ty.'' Njëkohëshisht ishtë ky ai momenti ku për shkak të Omerit një pjesë e kurejshëve pranoi Islamin, të cilët ju bashkangjitën vargut të nderuar të myslimanëve, numri i të cilëve shtohej nga dita në ditë.

[78] Ibni Ishâk, Sîret-i Resûl, 160-165, 221-229; Ibni Hishâm, Sîret, I, 342-350; Suhejlî, Ravd-ul-unf, II, 119.

Në Çdo punë ai përmendtë të Gjithmëshirshmin
Prej ekzistënces e bentë I Dërguari i Allahut Hamdin

Vëtëm Bëhu mjafton të thotë Krijuesi
Mënjëherë bëhet ajo që dëshiron Mëshiruesi

Çdo gjë është Hak prej Allahut
Udhërrëfyes është detyra e I Dërguari i Allahutut



Pamje e Vjetër Nga Qabja e Madhnueshme/ Mekke-i Mukerreme

Emigrimi I Dytë Në Habeshistan

"Me emrin e Allahut emigroni edhe një herë në Habeshistan"
Hadith

Dhuna dhe barbarizmat e mushrikëve vazhdontë të ushtrohej mbi sahabët në Mekka, madje sa vintë e doza e dhunës shtohej mbi ta. Mushrikët kishin humbur çdo lloj mëshire apo vlere dhëmbshurie, ata nuk dinin gjë tjetër vëtëm se të dhunonin myslimanët. Një ditë Osmani radijallahu anhu ''O I Dërguari i Allahut! Në Habeshistan kam vënë re se aty është një vënd shumë i përshtatshëm për tregëti. Qoftë edhe një muaj tregti mund të nas jelli shumë fitime. Deri sa Allahu të na tregojë ndonjë rrugëzgjidhje atje është vëndi më i përshtatshem për emigrimin e myslimanëve. Edhe sikur të mos bëhet tregti mjafton që myslimanët ti shpëtojnë këtyrë barbarizmave që mushrikët ushtrojnë ndaj nësh. Edhe mbreti i Habeshistanit Nëxhashi ka një simpati ndaj nësh, ai sillet mire dhe na mirepret.'' Ju tha I Dërguari i Allahutt a.s. i cili ju tha sahabëve **''Me emrin e Allahut emigroni edhe një herë në Habeshistan.''**

Osmani r.a. mori fjalën përsëri dhe tha '' O I Dërguari i Allahut nëse emigroni dhe ju atje populli i atij vëndi mund të pranoj Islamin. Idhtarët e librit (të krishtërët) sapot ë mësojnë për Islamin e pranojnë lehtë atë dhe na vijnë në ndihmë në.'' Pas këtyre fjalëve të Osmanit I Dërguari i Allahut ynë i Dashur tha; **'' O Osman! Unë nuk ndjehem rahat, i qëtë dhe mirë atje. Pastaj unë për emigrim pres urdhër nga Allahu xh.sh. dhe nëse ai më urhdëron atëherë unë do të emigroj.''**

Sipas shumë transmetimeve në vitin e gjashtë pas shpalljes se Profetësisë 83 burra dhe 18 gra prej sahabëve, total 101 përsona emigruan për të dytën herë në Habeshistan. Në krye të tyre ndodhej xhaxhai i I Dërguari i Allahutt a.s. Xhaferr bin Ebitalib. Ata mbërritën shëndosh e mirë në shtëtin e Nëxhasht. Sipas Ummu Selemes kur ata mbërritën atje gjetën një mikëpritje shëmbullore. Ajo (Ummu Seleme) thotë;

''Kur mbërritëm në Habeshistan gjetëm një komshi të mire, pra Mbreti Nëxhashi ishtë një komshi shumë i sjellshëm. Ai na i plotësoi nëvojat dhe na la të lirë ku në i kryenim lirshëm ritët tona fetarë. E Adhuronim allahun lirshëm dhe nuk na cënontë askush. Madje qoftë edhe një fjalë të vetme nuk e dëgjuam për besimin dhe ritët tona fetare.''

Por kjo qëtësi e myslimanëve që transmeton Ummu Seleme nuk zgjati shumë në Habeshistan sepse mushrikët Mekkas ishin shqëtësuar për emigrimin e myslimanëve dhe nga frika se ata mos organizoheshin dhe ktheheshin me ndonjë ushtri të madhe në Mekka vendosën të dërgonin një delegacion të Nëxhashi ku do të kërkonin prej tij ti përzintë dhe ti kthentë në Mekka myslimanët. Delegacioni i mushrikëve erdhi me dhurata të majme të Nëxhashi dhe u takuan me patrikët dhe pushtëtarët e lartë të cilve i thanë; ''Në mesin tonë kanë dalur disa njërëz që po na prishin traditat dhe veset tona të trashguara nga etërit tanë. Këto kanë shpikur një fe të re që as ju as në nuk e dimë se çështë. Në duam që ata ti kthejmë për andej nga kanë ardhur, ndaj kur të takoheni më Mbretin përcilljani atij këtë kërkesë tonën. Dijeni se ata më shumë se në i presin të afërmit dhe familjarët e tyrë.''[79] Nga paria e Nëxhashit ishin Patrikët ata që e pranuan të parët propozimin e mushrikëve Mekkas. Më pas delegacioni mushrik shkuan të Nëxhashi, i dhuruan atij dhuratat e tyre dhe biseduan një kohë me të ku i thanë atij se; ''O Mbret i Habeshistanit! Ketu tëk ju kanë ardhur disa prej

[79] Ibni Ishâk, Sîret-i Resûl, 195; Ibni Hishâm, Sîret, I, 334.

popullit tonë, ata kanë braktisur fenë e të parëve të tyrë, por as në fënë tuaj nuk kanë hyrë. Ata kanë shpikur një fe sipas kokës së tyre dhe as ju as në nuk e dimë se ç'fe është ajo. Në tëk j una ka dërguar paria e popullit tonë që të ju përcjellim ju kërkesën e tyr. Ata kërkojnë prej jush që ti ktheni mbarpsht ''trupriishurit tanë''. Duhet të ju bejmë me dije se ata të cilët këekojnë kthimin e tyre janë prindërit dhe të afërmit e vet. Pra dijeni se ata kërkojnë kthimin e myslimanëve sepse ata i njohin mirë dhe e dinë që ata nuk i përkasin as besimit tuaj dhe as besimit tanë...''

Delegacioni i mushrikëve përbehej nga Amr bin As dhe Abdullah Ebi Rabia, të dy këto prisnin që pasi ti dëgjoi Nëxhashi kërkesat e tyrë të ja kthejë myslimanët mbrapsht. Pas fjaleve të tyre fjalën e morën patrikët e Nëxhashit të cilët thanë; ''O Mbreti ynë! Këto po thonë të drejtën. Populli i tyre e din se si të sillet me ta sepse më mirë se e din populli i tyre se çfar kërkojnë ata në nuk e dimë. Prandaj ju sugjerojmë që tja ktheni mbapsht myslimanët komshinjëve tanë Mekkas, jepjani ti dërgojnë tëk populli i tyr...! Nëxhashi pasi degjo këtë prpozim të patrikëve u nërvikos dhe me një ton të ashpër ju tha; ''Për at Zot Jo! Unë nuk i kthej mbrapsht ata që në vënd të ndonjë vëndi tjetër kanë zgjedhur të strehohen tëk unë, nuk i tradhëtoj dhe nuk i dorëzoj ata tëk askush! Por thirrni ata të vijnë këtu dhe ti dëgjojmë pretëndimet dhe qëndrimet e tyre. Nëse ata janë të luajtur mendësh sikur thonë këto atëherë mund të ja kthej mbrapsht por nëse ata nuk janë ashtu atëherë ata nuk i dorëzoj por do ti mbajë dhe do kujdesem për tos sikur kujdesem për popullin tim.''Nëxhashi ishtë një ndër ata që i kishtë studiuar librat e shenjtë. Ai e dintë që një kohë do vijë I Dërguari i Allahut i fundit të cilin do ë përgënjështroi dhe do e dëboi nga vëndlindja populli i vet. Pra, e dintë që I Dërguari i Allahut do vijë në Mekka dhe populli i atyshëm do e përgënjështrontë dhe do e dëbontë nga Mekka. Kjo ishtë arsyeja që ai e kishtë refuzuar kërkësën e mushrikëve Mekkas. Por dhe meraku nuk e la të qëndrontë në heshtje ndaj ai nisi ti pyesi mushrikët se; ''Kujt i besojnë myslimanët?'' '' I besojnë Muhammedit'' ju përgjigjën ata. Nëxhashi vazhdoi ti pyestë ''Cila është feja e tyre dhe për ku thërrasin ata?'' ''Ata nuk kanë fe apo ndonjë sekt të tyren o Mbret i Nderuar'' i tha Amri. Atëherë Nëxhashi me një vendosmëri të prerë; ''Pa degjuar pretëndimet që ata kanë unë nuk mund ti dorëzoj tëk ju, ndaj ata do të vijnë dhe këtu para parisë do i dëgjojmë së bashku se çfar do të thonë. Kështu që edhe në mësojmë më shumë për fenë e tyre.'' Mushrikët skishin çbënin tjetër vetëm se të pranonin vendimin e Nëxhashit.

Myslimanët erdhen në pallatin mbretëror por kur kishin marrë lajmin se do të dilnin të prezantonin fenë e tyrë para parisë së mbretërisë së Habeshistanit dhe delegacionit mushrik, ishin këshilluar ndërmjet veti se çfar duhet të flisnin dhe çfar nuk duhet të flisnin. Ceferri që gjëndëj në krye të myslimanëve tha; '' Vallahi! Në nuk dimë gjë tjetër veç atyre gjërave që n aka mësuar Muhammedi a.s. dhe në veç atyre gjëravë nuk kemi çtë themi tjetër. Ndaj çfardo që të ndodh në ato gjëra do themi.'' Mbreti Nëxhashi kishtë mbledhur gjithë parinë e tij, patrikët dhe këshilltarët e tij, krahas këtyre ndodhej edhe delegacioni i dërguar nga mushrikët e Mekkas. Të gjithë ishin mbledhur dhe po prisnin ardhjen e emigrantëve myslimanë. Myslimanët u futën brënda i përshëndetën të pranishmit me selam, por nuk ju përkulën mbretit sikur bënin të tjerët.

"Në nuk i përkulemi askujt tjetër veç Allahut."
Hadith

Mbreti Nëxhashi nga habia e e këtij xhesti të myslimanëve i pyeti ''përse nuk përkuleni para mbretit?'' **''Në nuk i përkulemi askujt tjetër veç Allahut.** I Derguari

Myshrikët edhe pse i shihnin mrekullitë që vërtëtonin Pejgamberllëkun e tij ata jo vetëm që nuk i besonin atij por tregohëshin edhe barbar e dhunues të fëmijëve, grave, robërve dhe të gjithë atyre që pranonin I Dërguari i Allahutnë e Muhammedit a.s.. Dhuna dhe barbarizmat e mushrikëve e pikëllonin ndjeshëm Muhammedin a.s. ndaj ai mendoi që të shkontë në Taif, vënd cili ndodhej disa kilometra larg Mekkas dhe ta thirrtë popullin e atjeshëm në Islam. Kështu që ai mori pranë vetës Zejd bin Harisin dhe u nis për në Taif dhe me të arritur atje u takua me të parët e fisit Amr Abd-i Jalil, Habibin dhe Mesudin. Ai ju shpjegoi atyre Islamin dhe ju bëri ftësë atyre që ta pranonin atë. Por ata jo vetëm që nuk i besuan por e fyen dhe e ironizuan atë duke i thënë; ''A nuk ka gjet dikë tjetër Allahu që të ka dërguar ty për Pejgamber? A kaq i paaftë është Allahu që ka gjetur të përzgjedh një Pejgamber si ty? Ik nga të duash dhe na u shporr prej ktu! ... Ty stë ka pranuar populli yt ndaj ke arthur të në. Betohemi se dhe në nuk kemi për të pranuar ty dhe nuk do ti përgjigjemi asnjë lloj kërkëse që ti mund të kërkosh prej nësh.'' Pra sikur shihet paria e Taifit u tregua shumë arrogantë me Të Dërguarin e Allahut Muhammedin alejhi selam, i cili u largua tëpër i mërzitur prej tyre. Pastaj I Dërguari i Allahut a.s. shkoi në fisin Sakif dhe e thirri atë në Islam për dhjetë ditë apo afër një muaji sipas disa transmetimeve të tjera. Por askush nuk ju përgjigj ftësës dhe thirrjeve të tij. Në të kundërt ata e dhunuan, e nënçmuan, e shanë dhe e ofenduan atë, madje ata duke mos u mjaftuar me këto marrëzira të tyret, i nxorren dhe femijët, skllevërit dhe të lajthiturit e qytëtit para dhe e qëlluan Të Dërguarin e Allahut a.s. me gure. Kur ata e godisnin me gurë Zijdi ju diltë gurëve para që ta mbrontë I Dërguari i Allahutn a.s. prej tyre. Pra ky ishtë I Dërguari i Allahut i Allahut xh.sh. i cili shahej, ofendohej, ironizohej dhe dhunohej nga njërëzit vetëm dhe vetëm pse ai i thirrtë njërëzit në Parajs (Islam) dhe përpiqëj ti largontë nga e Keqja (Xhehennëmi). Ndërsa ai goditëj me gurë shoku i tij Zejdi behej copash vetëm dhe vetëm që trupi i nderuar i I Dërguari i Allahutt tonë të dashur të mos goditëj nga gurët. Trupi dhe koka e Zejdit radijallahu anhu u godit aq shumë sa që atij i rridhtë gjaku dhe pothuajse i gjithë trupi ju la me gjak. Por Zejdi r.a. nuk ja ndjentë për vetën e tij dhe thërristë me zë të lartë; **''Mosni! Mosni! Mos e godisni, ai është më i nderuari i universit, mos gjuani, ai është I Dërguari i Allahut suphanëhu ve tëla. Me mua beni çtë doni vetëm atë lëreni dhe mos e godisni.''** Por edhe pse Zejdi r.a. përpiqëj ta mbrontë I Dërguari i Allahutn a.s. prej gurëve që i drejtoheshin ishtë ishtë e pa mundur sepse ata gjuajtësit (femijet, skllevërit dhe të lajthiturit) ishin shumë në numër ndaj edhe trupi i bekuar i I Dërguari i Allahutt a.s. u godit aq shumë sa që gjaku i kishtë rrjedhur gjer të këmbët.

I Dërguari i Allahut a.s. dhe shoqëruesi i tij Zejdi r.a. u larguan të gjakosur nga Taifi. Zejdi r.a. i pikëlluar kur e shihtë I Dërguari i Allahutn a.s. në atë gjëndje ndërsa I Dërguari i Allahut a.s. ishtë i mërzitur pëersë populli i Taifit nuk pranoi të mirën dhe vazhdontë të këmbngultë në të keqë. Ai a.s. aq sa i mërzitur ishtë dhe i lodhur por dhe i plagosur ndaj u ndal për të pushuar në vreshtën e vëllezërve që quheshin Utbe dhe Shejbe. I Dërguari i Allahut a.s. dhe Zejdi r.a. aty pastruan gjakun që ju rridhtë,

mjekuan plagët dhe moren abdest dhe falën namazin ndërsa vëllezërit pronar të vreshtës i panë të gjitha këto veprimtari të tyren, madje tregohet se ata kishin parë edhe ndodhitë që i kishin ndodhur atyre në Taif. Vëllezërve ju erdhi gjynah kur panë atë ashtu në atë gjëndje ndaj urdhëruan skllavin e tyre Addasin që ti dërgontë rrush I Dërguari i Allahutt a.s. dhe kur ai ju afrua i dha rrushin dhe e dëgjoi I Dërguari i Allahutn a.s. kur thoshtë ''Bismilah'' edhe kur e lau edhe kur nisi ta haj atë. Addasi u habit kur dëgjoi të thoshtë ''Bismilah'' dhe nga habia nuk e mbajti dot vetën dhe e pyeti të Dërguarin e Allahut ''Prej vitësh jam këtu por këtë fjalë nuk e kam dëgjuar kurrë me parë! A më thoni çfar do me thënë kjo fjalë që unë nuk e kam dëjuar më parë?'' Ndërsa Profeti a.s. e pyeti ''prej nga je ti o njëri i mirë?'' ''Jam nga Ninëva'' ju përgjigj ai, ''Qënke nga vëndi i Muhammedit Junus a.s.'' ja ktheu I Dërguari i Allahut. Addasit ju shtua habi edhe më shumë dhe e pyeti ''Nga e njihni Junusin ju? Atë këtu nuk e njëh askush!'' **''Ai (Junusi alejhi selam) është vëllai im. Dhe a ika qënë një Pejgamber sikur unë''** ja ktheu me butësi Muhammedi a.s..'' Atëherë Addasi dëshmoi Pejgamberllëkun e Muhammedit a.s. duke thënë se ''Ti o njëri me këtë fytyr të ndritur dhe me këto fjalë të ëmbëla kurrë nuk mund të jesh prej atyre që gënjëjnë, ndaj unë dëshmoj se ti vërtëtë je Pejgamber i Allahut xh.sh.'' dhe kështu Addasi pranoi Islamin; ''O i Dërguar i Allahut! Prej vitësh i shërbej këtyre njërëzve, mirëpo këto nuk dinë gjë tjetër vetëm se ti shërbejnë epsheve të tyre, dhunojnë të tjeret dhe ju hanë hakun punëtorëve dhe skllevërve të tyre. Ndaj më lejo të vij me ty, ti shërbej misionit tënd dhe të jem pranë tëje''[90] i tha Addasi të Durguarit të Allahut i cili me buzëqëshje i tha; ''O Addas! Tani kthehu tëk patronët tuaj, kur ti vijë koha që këndëj të dëgjohet emri im atëhera eja pranë meje.''

Muhammedi a.s. pasi pushoi edhe pak aty u ngrit dhe vazhdoi rrugen për në Mekka por para pak se të arristë në Mekka i vjen Xhebraili a.s., ngjarje kjo të cilën e transmeton nëna e besimtarve Aisheja r.a. në transmetimet e Sahihi Buhari dhe në Musnëdin e Ahmet bin Hanbelit e cila thotë se; **''E pyeta Muhammedin a.s., O i Dërguari i Allahut! Në jetën tënde a ka pasur ditë më të vështirë se dita e Uhudit? Ai a.s. mu përgjigj ''Vallahi atë që kam përjetuar prej njërëzvë tuaj nuk e kam përjetuar nga mushrikët në luftën e Uhudit. Kur e kam thirrur në Islam Ibn-i Abd-i Jâlîl bin Abd-i Kulâlin ai nuk më pranoi dhe kur u ndava prej tij deri kur arrita në vëndin e quajtur Karn-ı Sealib nuk erdha dot në vetë. Aty ngrita kokën lart dhe pashë se mbi mua qëndrontë një re brënda së cilëc qëndrontë Xhebraili a.s. i cili më thirri ''O Muhammed! Allahu xh.sh. e dëgjoi gjithçka të ndodhi ty me popullin tënd (në Taif). Ai është dëshmitarë që populli yt nuk të doli në krah ndaj Ai (Allahu) ka dërguar ëngjëllin e maleve dhe e ka urhdëruar të veproi çfar ti thuash ti. Ëngjëlli pranë xhibriliti më përshëndeti me selam dhe pasi përsëriti fjalët e Xhebrailit a.s. më tha ''O i Dërguari i Allahut! Nëse me urdhëron ti bëj këto dy male (Kuajkianin dhe Ebukujbesjsin) copë e ti hedh mbi Mekkasit që ti fundosim nga faqja e dheut mjafton vetëm një aprovim i yti dhe unë i bëj ata copë e hi!'' Unë nuk dëshiroja këto që më thonin ëngjëjt ndaj ju thashë ''Jo! Unë jam dërguar mëshirë për mbarë universin, ndaj i lutëm Allahut që ta bëjë këtë popull prej popujve me të devotshëm (sinqërtë) dhe prej pasardhësve të tyre të mos dal askush që nuk i bën shok e ortak Allahut xh.sh. dhe nuk adhuron zot tjetër veç Allahut suphanëhu ëe tala.''**

[90] Ibni Sa'd, Tabakât, I, 42; Taberî, Historia, I, 344-346; Ibni Kethîr, El-Bidâje, III, 135- 137; Belâdhûrî, Ensâb, I, 227.

Rrugëtimi Mekka-Taif



I Dërguari i Allahut kur po kthehej nga Taifi për në Mekka u ndal të pushontë në vëndin e quajtur Nahle, aty i fali namzain. Kur ai (a.s.) ishtë në namaz, aty pranë kaloi një grup xhindësh dhe kur dëgjuan Kur'anin që po këndontë Muhammedi a.s. në namaz ata u ndalën për të dëgjuar. Dhe kur ai mbaroi namazin ata ju afruan dhe filluan ta pyesin për Kur'anin dhe pas bisedës me të ata pranuan Islamin. Muhammedi a.s. para se ti përcilltë xhindët i porositi ata që, **''kur të shkojnë tëk populli i tyre ti thërrasin në Islam''**. Dhe kur xhindët arritën tëk populli i tyre i folën për Islamin dhe të Dërguarin e Allahut dhe ata të gjithë pranuan Islamin.[91] Kjo ngjarje është treguar edhe në Kur'an surja xhindët edhe në dy librat e famshem të haditheve Buhariut dhe Muslimit.

"O Njerëz! Thoni La Ilahe Ilallah dhe shpëtoni."
Muhammedi a.s.

Kur ai a.s. u afrua në Mekka besimtarët mesuan për poshtërsitë që populli i Taifit i kishin bërë të Dërguarit të Allahut dhe i dërguan lajm atij ku i thanë se; ''O I Dërguari i Allahut! Kurejshët kanë dëgjuar për ndodhitë që ju përjetuat në Taif, ndaj nëse vini tani atëherë ata do e shtojnë edhe më shumë dozën e mizorisë dhe dhunës.'',

Muhammedi a.s. kur u afrua në Hira i dërgoi lajm Suhejl bin Amrit dhe kërkoi prej tij që ta merrtë në mbrojtje por ai i pashpirti nuk e pranoi ndaj Muhammedi a.s. ju drejtua Mutim bin Adit dhe kërkoi prej tij që ta mbrontë. Ky i fundit e pranoi atë dhe e mori në Mekka. Muhammedi a.s. nën mbrojtjen e Mutim bin Adit hyri në Mekka, bëri vizitën në Qabe, e puthi Haxhri Esvedin (guri në murin e Qabes) dhe pas disa ditësh i tha Mutimes se duhet të largohej prej mburojës së tij dhe do vazhdontë të rrintë i vetëmrojtur. Pa diskutim që mbrojtja më e madhe e tij ishtë mbrojta e Allahut xheleshanuhu.

[91] Ibni Sa'd, Tabakât, I, 212.

Thoni ''La Ilahe IlaAllah'' dhe Shpëtoni.

I Dërguari i Allahut vazhdontë ti thirrtë njërzit në fenë e Allahut xh.sh. por nga ana tjetër mushrikët vazhdonin ti dhunonin myslimanët, madje ata e kishin shtuar dozën e dhunës aq sap o thuajse nuk i linin të merrnin frymë në Mekka. Në të njëjtën kohë po afrontë koha e panaireve të përvitshëm që mbaheshin në qytëtin e asaj kohe të Mekkas. Allahu e urdhëroi Muhammedin a.s. që ti thirrtë vizitorët e panaireve në Islam. Ai vizitontë panairet Dhulmexhaz, Ukaz dhe Mexhennë që ishin organizuar rreth Mekkas dhe i thirrtë vizitorët në Islam, pra i thirrtë ti besonin Njëshmërisë së Allahut, të mos i bënin shok e ortak Atij dhe të mos adhuronin Zot tjetër veç Allahut. Atyre që praninin Islamin i përgëzontë me xhennët ndërsa atyre që nuk pranonin Islamin ju thoshtë se duhet ti tremben zjarrit të xhehennëmit. Pas gjithë thirrjeve dhe përpjekjeve që bentë Muhammedi a.s. në panaire askush nuk i besontë, mdaje disa prej tyre tregoheshin shumë arrogantë ndaj tij. Edhe kurejshët nuk rrinin bosh, i shkonin mbara Muhammedit a.s. dhe ju thonin të kundërtën e asaj që ju thoshtë I Dërguari i Allahut. Sapas transmetimeve të Imâm Ahmedit, Bejhekit, Taberânit dhe Ibn-i İshâkut, Rebia bin Abbad ka transmetuar se; ''Isha e re, kur shkuam bashke me babin në Mina. I Dërguari i Allahut shkontë në çdo vend ku ishin vendosur fiset arabe dhe ju thoshtë; **''O bijtë e filan fisi! Unë jam i Dërguari i Allahut, largohuni prej idhujve që nuk ju sillin asnjë lloj dobie, Adhuroni Allahun, Zotin e vetëm të gjithësise dhe më mbështësni e më me dilni krah mua në rrugën e Allahut tëala, i Cili më ka dërguar Profet për mbarë njërëzimin...!''** Ndërsa një njëri i shthururu që i shkontë nga pas ju thoshtë; '' 'O bijtë e filan fisi! Ky (Muhammedi a.s.) ju thërret të braktisni idhujt tuaj Latin dhe Uzzën dhe ju thotë të pranoni fenë e re që a ika vetëshpikur!... Kujdes. Kurrë mos i besoni dhe mos ju bindni atij! ...'' Taberaniu, trasnmeton prej Tarik bin Abdullahut se; ''Të Dërguarin e Allahut e kam parë në panairin Dhulmexhaz. Ai thërristë me zë të lartë që ta dëgjonin të gjithë ku thoshtë; **''O Njërëz! Thoni La Ilahe Ilallah dhe shpëtoni.''** Ndërsa njëri që shkontë pas tij e godistë me gurë dhe thoshtë; ''O njërëz! Mos i besoni!... Ruhuni prej tij! Sepse ai është mashtrues! ...'' I Dërguari i Allahut Muhammedi a.s. përpiqëj, sakrifikontë, pa lodhje, pa përtësë dhe vizitontë çdo fis dhe çdo çadër që ata kishin ndertuar rreth Mekkas aq sa edhe këmbët e tij ishin çarë e i rridhnin gjak sa prej gurëve që e godistë njëriu që i shkontë nga pas dhe sa vapes se shkretëtirës. Ata (fiset) pyesnin ''kush është ky djalë?'' ''Ai është një djalë prej fisit të Abdulmutalibit'' ju përgjigj dikush që e njihtë Muhammedin a.s. ndërsa ''po ai që e godet me gurë nga pas kush është?'' pyetën sërshti ata, ''ai është Ebulehebi, xhaxhai i Muhammedit'' ju përgjigj sërisht njëriu që i njihtë. Nga transmetimet e Imam Buhariut dhe në transmetimet e Taberaniut është transmetuar prej Mudrik bin Munibit i cili transmeton nga i ati i cili thotë se; ''Së bashku ma babin patëm shkuar në Mina dhe ishim xhvendosur aty ku ishin xhvendosur dhe disa fise tjera. Pranë nësh erdhi njëri dhe thoshtë ''o njërëz thoni La Ilahe Ilallah, dhe shpëtoni.'' Një pjesë prej njërëzve që e kishin rrethuar i hidhnin dhe mbi kokë, një pjesë tjetër e shantë dhe e ofendontë ndërsa disa të tjerë i hidhnin gëlbazë syve. Dhe kjo gjëndje vazhdoi deri në drekë kur pranë njëriut (Muhammedit a.s.) që shahej, ofendohej, nënçmohej dhe dhunohej nga njërëzit e fiseve të ndryshme ju afrua një vajzë e vogel me një enë uji dhe i lantë sytë atij. Ai i thoshtë **''o bija ime. Mos i frikëso se babait tënd mos e vrasin, dhunojnë apo masakrojnë!''** Në që ishim dëshmitarë të këtyre ndodhive pyetëm të pranishmit se kush ishtë ai njëri? ''Ai është Muhammedi prej fisit të Abdulmutalibit, ndërsa ajo është vajza e tij Zejnëpja'' na u përgjigjën ata.'' Edhe Said bin Jahja bin Emevi trasnmeton nga i

ati i cili transmeton prej Ebu Naim dhe ky trasnmeton prej Abdurrahman Amirit dhe shumë të tjerëve se; '' Një ditë Peygamberi ynë i dashur a.s. erdhi në panairin Ukaz dhe ju afrua fisit të bijëve të Amrit dhe ju tha **''O bijtë e Amrit si qëndron puna e atij që vjen dhe kërkon mbështetje nga ju?''** ''Në xjarrin tonë nuk afrohet skush, dhe pa leje në nuk afrohet askush.'' Ju përgjigjën at. Atëherë Pejgamberi a.s. i pyeti përseri **''unë jam i Dërguari i Allahut. Nëse vij pranë jush dhe vazhdoj të plotësoj dëtyren që më ka ngarkuar Allahu xh.sh. A do më pranonit dhe a do më mbronit mua?''** ''Prej cilit fis të kurejshitëve je ti o njëri?'' e pyetën ata. **''Jam prej fisit të bijëve të Abdulmutalibit.''** Ju përgjigj i Dërguari i Allahut. ''O njëri me që qënke prej atij fisi të nderuar përse duhet të të mbrojme në ty (pra përse ti kërkon mbrojtje prej nësh nderkohë që ti vjen prej një fisi të nderuar në Mekka), ata duhet të mbrojnë ty me mire se sa në!'' ju pëergjigën ata. I Dërguari i Allahut xh.sh. **'' O bijtë e Amrit ata ishin të parët që më përgënjështruan, (ndaj ata nuk më mbrojnë).''** Kur dëgjuan këtë përgjigjë fisi i bijve të Amrit pa hezituar i thanë '' O Muhammed! Në as nuk të refuojmë dhe as nuk i besojmë pretëndimeve tuaja. Por dije se në do të dalim në mbrojtje ty deri sa ti të plotësosh detyrën e Pejgamberllikut dhe t'ja përcillësh atë njërëzve.'' Pas këtij qëndrimi të tyre Muhammedi a.s. u ul pranë tyre. Pas pak u kthye kryetari i fisit Bejhara bin Farisi, i cili kishtë shkuar të bëntë tregti në tregjet e panairit dhe kur p Muhammedit a.s. që ishtë ulur aty pyeti të prenishmit se kush ishtë ai djalë që ishtë ulur pranë tyre. Dhe kur i thanë ata se ai është Muhammed bin Abdullahu ai i pyeti se çpunë kishin ata me të, që ai është i ulur pranë jush? Ata i thanë se ai thotë se është i Dërguari i Allahut dhe kërkoi strehim prej nësh deri sa të plotësoi detyrën e Pejgamberllëkut duke ju bërë thirrje njërëzve që ta pranojnë atë. Pasi dëgjoi të pranishmit Bejhara ju afrua Muhammedit a.s. dhe i tha ''Të strehojmë ty do me thënë ti hapim luftë mbarë arabeve dhe ti kthejmë shigjetat e tyre nga gjokset tona.'' Pastaj ju kthe fisit të tij duke i thënë se ''të marrësh në mbrojtje Muhammedin është budallallëku më i madh që mund të bëjë një fis! A mos vallë ju po kërkoni ti hapni luftë arabëve dhe të bëheni gjah i armëve të tyre? Pastaj po të ishtë aq i mirë ky dhe ajo që ky i fton njërëzit atë do ta mbrontë dhe do ta strehontë pupulli i vet, pra a mos keni luajtur mendësh ju që strehoni një njëri të cilin e ka dëbuar populli vet? Kjo nuk është asgjë tjetër vetëm se një çmenduri e juaja që e keni pranuar këtu! ...'' pastaj ai ju kthye të Dërguarit të Allahut dhe i tha ''Urgjentish largohu nga këtu! Dije se për at Zot po të mos ishe në mesin e fisit tim do ta kisha hequr kokën nga trupi! …''

I Dërguari i Allahu xh.sh. prej fjalëve që dëgjoi u brengos aq shumë sa që pa thënë qoftë edhe një fjalë u ngrit, i hipi devesë dhe sapo u nis të iktë Bejhara e shtyu dhe e hodhi nga deveja. Kur pa këtë ngjarje gruaja e nderuar sahabija Dabaa binti Amr filloi të thërrasi fisin e saj me zë të lartë që ata të vinin dhe të ndihmonin të Dërguarin e Allahut dhe ta shpëtonin prej duarve të kryetarit të fisit Amr Bejhara bin Farisit. Zërit të Dabbas r.a. ju përgjëgjën djemtë e xhaxhait të saj të cilët erdhen me të katërtat dhe ju vërsulën Bejaharas, edhe pse këtij të fundit i erdhën në ndihmë të afermit e tij nuk e shpëtuan dot nga djemtë e xhaxhait të Dabaas. Pas kesaj ndodhie I Dërguari i Allahut ngriti duart dhe u lut për djemtë e xhaxhait të Dibaas që Allahu ti begatontë me mirësitë e kesaj botë dhe botës tjetër. Ndërsa për Bejharan dhe ndihmësit e tij ju lut allahut që ti largontë prej mëshirës së Tij. Suphanallah! Sipas transmetimeve djemtë e xhaxhait të Dibaas pranuan Islamin ndërsa Bejhara dhe ndihmësit e tij vdiqën qafir.

Kur u kthye fisi i bijëve të Amrit në vëndlindje shkuan tëk më i vjetri i tyre i cili ishtë një njëri i cili kishtë dije nga librat e vjetër i treguan atij për ndodhitë që ju kishin ndodhur me të Dërguarin e Allahut. Kur dëgjoi këto fjalë i moshuri i fisit të bijve të Amrit u nërvikos dhe filloi ti mallkoi ata duke ju thënë '' o bijtë e Amrit! Mallkuar qofshi! Dijeni se deri më tani nuk ka dalur askush prej fisit të Ismailit që të këtë pretënduar se ai është Profet. Padiskutim që ajo që ai (Muhammedi a.s.) thotë është e vërtetë dhe ai është vërtetë një Pejgamber. Ju keni humbur një mundësi që kurrë nuk do keni më shancin ta keni! ...''

Me Xhibrilin muhabet e kelam
Refref erdhi u përkul me selam
Shkoi nami botë e univers
N'moment e dërgoi n'sidret

Isra dhe Miraxhi



MIRAXHI

"Nuk më hahet asgjë, mjafton të më tregosh një vend ku mund të fal namazin dhe të kryej adhurimet"
Muhammedi a.s.

I Dërguari i Allahut xheleshanuhu i shpjegontë Islamin edhe atyre që vinin të vizitonin Qaben edhe atyre që vinin nëpër panaire apo për tregëti. Ai kërkontë prej tyre që ta mbështësinin në misionin e tij, por askush nuk e pranontë thirrjen e tij dhe askush nuk e kishtë pranuar Islamin. E kundërta, atë edhe e ofendonin, edhe e përgënjënjshtronin por edhe e dhunonin. I Dërguari i Allahut shumicën e kohës kishtë mbetur pa ujë, pa bukë, i lodhur dhe i rraskapitur. Kështu i kishin shkuar ditët dhe nëtët atij gjatë thirrjeve që ai ju bëntë vizitorëve të panaireve dhe të Qabes. Por edhe mushrikët e Mekkas atë nuk e kishin lënë të qëtë ata i shkonin nga pas e dhunonin dhe i pengonin njërëzit që ta pranonin atë dhe thirrjen e tij. Madaje ata me barbarizmat e tyre nuk ishin aspak të mëshirshëm ndaj të Dërguarit të Allahut Muhammedit alejhi selam. Tashmë ai nuk kishtë nga t'ja mbantë, ngado ishtë i rrethuar me armiq të përbetuar. Kështu ai po kalontë muajt më të vështirë të jetës së tij në Mekka.

Natën e 27 të muajit Rexhep Muhammedi a.s. vajti në lagjen e Ebutalibit tëk banësa e Ummu Hanies e cila ishtë vajza e xhaxhait të tij Ebutalibit. Ajo atë kohë nuk e kishtë pranuar ende Islamin. Kur ju afrua derës së saj Muhammedi a.s. trokiti në derë, ''kush është?'' pyeti ummu Hania nga brënda, **''jam unë, Muhammedi djali xhaxhait tënd, kam ardhur misafir nëse më pranoni''** ju përgjigj I Dërguari i Allahut. ''Ku gjindet një misafir si ti? Fjalë embël, i drejtë, i urtë, i ndërshëm dhe besnik. Për misafirë sikur ti jepet jeta, urhdëronini mirësevini. Ah sikur të më kishit lajmëruar më parë që të kisha përgatitur ndonjë gjë, tani nuk më ka mbetur asgjë që mund t'ju jap me ngrënë.'' Thoshtë ummu Hania. **''Nuk më hahet asgjë, mjafton të më tregosh një vend ku mund të fal namazin dhe të kryej adhurimet''** ju përgjigj Muhammedi a.s..

"Më ka dërguar Allahu, i Cili të përshëndët më selam dhe të përgëzoj me udhëtimin që do të bëjmë së bashku, gjatë të cilit do të vizitojmë xhennetin, xhehennemin, mirësitë dhe begatitë që Allahu ka përgatitur për ty. Do të vizitojmë edhe gjendjen e atyre që të pasojnë ty, si dhe dënimin e atyre që të përgënjështrojnë, dhunojnë dhe tregojnë arrogancë ndaj teje dhe pasuesëve tuaj. Kështu që edhe ty do të qëtësohet zemra dhe do gjesh mprehtësi shpirtërore."
Xhebraili a.s.

Ajo e mori djalin e xhaxhait brënda i ofroi atij një enë me ujë që ai të merrtë abdest dhe një hasër që ait ë falej e ti lutëj Allahut suphanëhu ve tëala. Tëk arabët ishtë zakon që nëse mikut i ndodhtë ndonjë gjë e keqë ajo familje dhe ai fis përbuzej dhe i vendosej një damge e zezë në shoqëri. Edhe nëse ai misafiri ishtë një prej atyre që kërkohej të ekzekutohej nga armiqtë e tij, fisi apo familja që e merrtë atë në mbrojtje i bëntë roje tërë natën. Kështu mendoj dhe ummu Hania, që ta ruantë Muhammedin a.s. se mos i vjen ndonjë sulm i jashtëm, ndaj ajo do i bëntë roje atij. Ajo mori shpatën e të atit dhe filloi të rrotullohet rreth shtëpisë dhe shihtë rrugët se mos kishtë ndonjë zullumqar që mund të vintë për ta sulmuar të Dërguarin e Allahut xh.sh.

I Dërguari i Allahut atë ditë ishtë shumë i lodhur por edhe shumë i thyer nga ndodhitë e ditës. Ai mori abdest, fali namazin dhe u shtri të qëtësohej. Ashtu i shtrirë mbi hasër kishtë fjetur por ishtë Xhebraili a.s. të cilin e kishtë dërguar Allahu xh.sh., ai që e zgjoi atë i cili i tha; **''Më ka dërguar Allahu, i Cili të përshëndët më selam dhe të përgëzoj me udhëtimin që do të bëjmë së bashku, gjatë të cilit do të vizitojmë xhennëtin, xhehennëmin, mirësitë dhe begatitë që Allahu ka përgatitur për ty dhe ata që të pasojnë ty, si dhe dënimin e atyre që të përgënjështrojnë, dhunojnë dhe tregojnë arrogancë**

ndaj tëje dhe pasuesëve tuaj. Kështu që edhe ty do të qëtësohet zemra dhe do gjesh mprehtësi shpirtërore.'' Sipas një trasnmetimi tjetër kur Xhebraili erdhi të Muhammedi a.s. ai ishtë në një gjumë të thellë që Xhebrailit nuk i vintë ta zgjontë. Por flladi i ftohtë i Xhibrilit e zgjoi atë dhe kur e pa atë i tha **''O Xhibril! Ç'të solli tanin ë ktë orë? A mos vallë kam gabuar ndaj Zotit tim apo mos kemi ndonjë lajm të hidhur?'' ''O i Dërguari i Allahut! Erdha të të përcjell selamet e Allahut xheleshanuhu i Cili të thërrët pranë vetës. Ndaj çohu dhe eja të ikim''** i tha Xhebraili Pejgamberit tonë të dashur. I Dërguari i Allahut u ngrit dhe së bashku me Xhibrilin, i cili e përgatiti për udhëtimin e shenjtë, nisën atë udhetimi që nuk e kishtë përshkruar asnjë pejgamber tjetër para Muhammedit a.s.

Kibla e Parë e Myslimanëve Mesxhidi Aksa

Ata (Muhammedi a.s. dhe Xhibrili a.s.) dolën nga shtëpia dhe shkuan në Qabe. Aty Xhebraili a.s. ja hapi kraharorin të Dërguarit të Allahut xh. sh. ja pastroi zemren me ujë zemzemi dhe ja mbushi atë me urtësi, besim dhe begati të pafundme. Pastaj Xhebraili i tregoi Burakun, kafsha që përdoret për mjet udhëtimi të cilinë e kishtë sjellur nga xhennëti. **''O i Dërguari i Allahut! Eja tihipim Burakut, dhe dije se të gjithë ëngjejt po presin në gadishmëri udhëtimin tonë!''** Ato momentë I Dërguari i Allahut ishtë zhytur thellë në mendime por ishtë sërisht Xhibrili ai që ja prishi thellësinë e mendimeve ku e pyeti se çfar po mendontë i Dërguari i Allahut që dukej sikur nuk ishtë aty fare. I Dërguari i Allahut salallahu alejhi ve selam ja ktheu **''O Xhibril! Unë robi i Allahut, njëri i dobët kur po shoh kaq miresi dhe nderime që po me bëhen më erdhi në mëndje ummeti im, gjynahqar në Dtën e Gjykimit. A thua vallë si do të jetë gjëndja e umetit tim në atë ditë, e cila do të zgjas pesëdhjetë mijë vitë dhe si do ta kalojnë urën e siratit udhëtim i cili do të zgjasi tridhjetë mijë vitë?''** Xhibrila e qëtësoi duke i thënë**''O i Dërguari i Allahut! Mos u shqëtëso për ummetin tënd sepse Allahu xh. sh. atij pesëdhjetë mijë vitët do ja bëjë aq të lehtë sa do i duket sikur të jetë vetëm një moment i shkurtër fare.''**

"Mirësëvini o të nderuar. Mirësevjen o i Dërguari i Allahut! Mirësevjen o Muhammed paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi ty o njëri i bekuar. Me pas u hap dera e qiellit dhe aty gjeta Âdemin (a.s.)."
Hadith

Pejgamberi ynë i Dashur i hipi Burakut i cili nisi ta hedhi hapin me aq largesi sa i shihtë syri. Gjatë udhëtimit Xhibrili a.s. e ndali Profetin a.s. në disa vënde ku ata të falnin namazin. Thuhet se ata u ndalën në Medina ku falën namaz dhe aty Xhebraili a.s. e lajmëroi për hixhretin që do bënin më vonë, më pas u ndaluan në malin turi sina, aty ku Musa a.s. ka folur me Allahun xh.sh., u ndalen dhe falën namaz edhe në Bejt-i Lahm, pikërisht aty ku ka lindur Isai a.s. dhe pastaj udhëtuan për në Mesxhidi Aksa. Kur arritën aty i lidhën kafshët e tyrë dhe më pas vajtën tëk Pejgamberët paraardhes. Thuhet se shpirtërat e Pejgamberëve paraardhës ishin mbledhur në formën e tyrë njërëzore. Para se të nisnin faljen e namazit Pejgamberët Âdem, Nuh dhe Ibrahim paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi ta nuk pranuan të daln prijës në namaz. Atëherë Chebraili a.s. i tha të Dërguarit të allahut se; ''aty ku je ti o Muhammed nuk del kush tjetër imam veç tëje'' dhe i tregoi atij vëndin e imamit. Pejgamberët e Allahut xh. sh. u rrjeshtuan pas Muhammedit a.s. dhe falën dy rekat namaz. Sipas burimeve thuhet se pas namazit Xhebraili a.s. prej xhennëtit i solli Muhammedit a.s. dy kupa njërën me qumësht dhe tjetrën me verë. Muhammedi a.s. refuzoi kupën me verë dhe mori kupën me qumësht. Atëherë Xhebraili a.s. i tha se ti o I Dërguari i Allahut zgjodhe kupën e fitretit (natyrshmërisë). Pak më vonë Xhibrili i solli dy kupa tjera njërën me mjalt dhe tjetrën me ujë, dhe kur Muhammedi a.s. piu prej të dujave Xhibri i tha o I Dërguari i Allahut, ''mjalti simbolizontë vazhdimësinë e ummetit tënd deri në Ditën e Kijametit ndërsa uji simbolizontë pastërtinë e ummetit tënd prej gjynaheve.'' Më pas ata vazhduan rrugëtimin e tyre drejt qiellit.

Kur arritën në qiell Xhebraili a.s. trokiti derën e qiellit, ''kush je ti?'' e petën rojtarët, '' unë jam Xhibrili'' ju përgjigji ai, ''po ai që ke pranë kush është?'' e peyetën ata, ''Ky është Muhammedi a.s., I Dërguari i fundit i Allahut xh.sh.'' ju përgjigj Xhibrili a.s. ''A i ka ardhur atij a.s shpallja/ftësa për daljen në Miraxh.?'' e pyetën sërisht rojtaret e qiellit, ''po i ka ardhur'' ju përgjgjigj Xhibrili a.s.. ''Mirësëvini o të nderuar. Mirësevjen o i Dërguari i Allahut! Mirësevjen o

"O I Dashuri i Allahut xh. sh. Allahu nuk ka krijuar njëri më të nderuar se sa ty. Edhe ummeti yt është prej ummetëve me të nderuar. Dije se dhëmbshëria ime për ummetin tënd është më e madhe se dhëmbshuria e prindërve për fëmijët e tyrë."
Azraili a.s.

Muhammed paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi ty o njëri i bekuar'' thanë ëngjëjt e qiellit. Kur u hap dera e qiellit Muhammedi a.s. e gjeti vetën para Ademit a.s. i cili ishtë i rrethuar nga njërëz ku ata që i qëndronin në të djathtë ndriçonin sikur hëna dhe dielli dhe nga njërëz të nxirë skëtërrë që i qëndronin atij në të majtë. Dhe kur ai (Âdemi a.s.) shihtë majtas qantë dhe kur shihtë djathtas qështë. ''O Muhammed a.s. këto janë shpirtërat e bijve të Ademit a.s. ata që janë të nxirë janë bijtë dhe bijat e tijë në xhehennëm ndërsa ata që ndrisin janë xhennëtlinjtë. Ndaj kur Ademi a.s. sheh xhennëtlinjtë qësh dhe kur sheh xhehennëmlinjtë qan!'' i tha Xhibrili Muhammedit a.s..

Aty rastisa me shumë ëngjej të cilët qëndronin në kembe dhe me një qëtësi të madhe bënin dhikrin ''Subbûhun kuddûsun rabb-ul-melâiketi ver-rûh''. E pyeta Xhibrilin a.s. se përse ata (ëngjëjt) adhuronin Allahun në këmbë? Ai më tha **''O i Dërguari i Allahut këto deri ditën e Kijametit kështu në këmbë do ta adhurojnë Allahun ndaj nëse dëshiron lutë Allahun që edhe ummëtit tënd të ja dhurojë këtë dhuratë deri në ditën e Kijametit'', ju luta Allahut dheAi ma pranoi lutjen, dhe kjo është të qëndruarit në këmbë gjatë faljes së namazit.**

Aty rastisa edhe me një grup kokat e të cilëve sa herë i shtypnin mëngjëjt ju ktheheshin po në gjëndjen e mëparshme. Prap i godisnin, prap ju ktheheshin në gjëndjen e mëparme. ''Kush janë koto?'' e pyeta Xhibrilin i cili më tha se ata ishin ata të cilët kanë braktisur faljen e ditës së xhuma dhe namazit me xhemaat dhe ata të cilët nuk i kanë kryer në mënyrë të duhur përkuljen në ruku dhe sexhde gjtë namazit.

Më tutje rastisa dhe me një grup tjetër të cilit ishin të uritur dhe të zveshur lakuriq! ''Po kërto kush janë o Xhibril?'' ''Këto janë ata të cilet nuk e kanë dhënë zekatin dhe nuk kanë qënë të mëshirshëm me nëvojtarët dhe fukarenjtë'' mu përgjigj Xhibrili a.s. Po aty pashë edhe një grup tjetër të cilit përpara kishin ushqime të mrekullueshme dhe pranë tyre qëndronin edhe ushqime të kalbura. Ata nuk hani suhqimet e mrekullueshme por hanin kalbesirat. ''Çfar janë koto (o Xhibril)?'' ''këto janë ata burrat dhe gratë të cilët në vend se të ushqëheshin em hallall në dunja i ushqyen vetët e tyre me haram. Pra janë ata që në vënd se të konsumonin hallallin konsumuan haramin.'' Tha Xhibrili a.s.

Më pas pashë një grup të cilit ishin të ngarkuar me një barrë aq të rëndë sa që nuk ju kishtë mbetur pikë fuqie të qëndronin në këmbë. Edhe pse ishin aq të ngarkuar ju bënin thirrje atyre që kishin për rreth që ti ngaronin edhe më shumë ngarkesë. Kur pyeta se kush ishin ata? ''Këto janë ata që kanë tradhëtuar emanëtin, ju hanin hakun njërëzve dhe ju bënin padrejtësi atyre'' mu përgjigj (Xhibrili a.s.). Më pas rastisëm me një grup tjetër i cili thertë mishin e tij dhe ushqëhej me të. ''Kusha janë këto (o Xhibril)?'' Këto janë ato që merrën me thashetheme, bëjnë giybet dhe shpifin për të tjerët'' mu përgjigj ai.

Gjatë udhës rastisëm edhe me një grup tjetër fytyrat e të cilëve ishin të ncira stërrë, sytë ju kishin stërhapur, buzët e sipërme ju kishin ngjitur në ballë ndërsa të poshtmet ju ishin varur gjer të këmbët ndërsa prej gojëve të tyre rrithtë gjak e gjebesira. Atyre ju jepej kadeh gjaku e gjlbesira që rridhnin buronin prej burimeve të Xhehennëmit. Kur pyeta se kush ishin ata, ai (Xhibrili

"Atë natë (natën e miraxhit) u luta. O Zoti im! Ti je pranuesi ndërsa unë jam lutësi ndaj të lutëm Ty të ta falësh ummetin tim!"
Hadith

a.s.) mu përgjigj se ata ishin ata të cilët konsumojnë alkol, konsuojnë pije haram. Ndërsa pas tyre rastisëm me një grup tjetër të cilëve ju kishtë dalur gjuha jasht fytyres dhe përngjasonin me derrat. Kur pyeta se kush ishin këto të dënuar, ai mu përgjigj se ata ishin ata të cilët kanë dëshmuar në rrenë dhe me gënjështra. Pastaj rastisëm me një popull që ju kishtë fryre e varur barku poshtë këmbëve, ngjyrat ju ishin prishur ndërsa kembët dhe duart i kishin të prangosura dhe nuk lëvzinin dot vëndi. Kurt i thash Xhibrilit të më thoshtë se kush ishin këto, ai më tha se këto janë ata të cilët kanë kanë ngrënë kamatë dhe pasuri me faiz.[92]

Sipas trasmetimeve Muhammedi alejhi selam vazhdoi të tregoi se; **''atje kishtë rastisur me një grup grashë fytyrat e të cilëve ishin zeza, sytë i kishin të stërhapura dhe veshjet i kishin prej zjarri dhe ëngjëjt i godinin me kamxhikë zjarri. Ata ulurinin sikur ulurasin qëntë. Kur pyeti Xhibrilin a.s. se kush ishin ata ai i ishtë përgjigjur se ata ishin ata të cilat kanë bërë zina dhe janë sjellur keq me bashkëshortët e tyre. Ata aty ishtë një grumbull i madh, të cilat ishin burgosur në luginat e xhehennëmit. Sa herë i digjtë zjarrë aq herë ju ripërtërintë lëkura. Kur pyeta se kush ishin? Mu përgjigjën se ata ishin ata të cilët kanë trajtuar keq prinderit e tyre. Më pas rastisa me një grup që mbillnin të mbjellura ku sapo i mbillnin ata jepnin fruta. Kur pyeta se kush ishin ata, ai (Xhibrili a.s.) mu përgjigj se ishin ata të cilët kanë adhuruar vetëm Allahun xh.sh.. Më pas dolem dhe kaluam nga një luginë pamja e së cilës është e pamundur të krahasohet. Kur pyeta Xhibrilin se ç'ishtë ajo luginë, ai mu përgjigj se ajo luginë quhej ''Kjo Luginë quhet Deti i Jetës''**, kur Allahu xh.sh. do ti nxjerri njërezit prej varreve dhe do ti ringjalli ata (njërëzit) aty në atë luginë do të bjerë një shi dhe trupat e kalbur e shkrumbuar në dhe do të mblidhen dhe do të bashkohnë me eshtrat e tyre mu ashtu sikur mbin e gjelberon bari pas shiut...

Më pas u ngjitëm në qiellin e dytë. Xhibrili ashtu sikur më parë trokiti në derën e tij ku u dëgjua zëri i rojtarëve të cilët pyetën se kush jeni? ''Jam Xhibrili'' ju përgjigj ky. Po shoqëruesi yt kush është o Xhibril ja ktheu rojtari ''ky është Muhammedi a.s.'' ja ktheu Xhibrili a.s. ''Selamet qofshin mbi të, sa bashkëudhëtari i mirë është ai'' thanë ata. Kur kaluam në qiellin e dytë u takova me vllezërit e mi Isain dhe Jahja bin Zekerijjan paqja dhe meshira e Allahut qoftë mbi ta. Ata më përshëndetën me selam dhe u lutën për mua. Më Pas rastisa me një grup ëngjëjsh të cilët ishin rrjeshtuar sikur në namaz dhe po qëndronin të përkulur në ruku. Ata qëndronin ashtu të përkulur dhe nuk i ngrinin kokat lart. Xhibrili më tha së ''ky është adhurimi që këto ëngjëj i bejnë Allahut xh.sh., ata nuk ngrihen prej rukusë. Lutë Allahun që të ja dhuroi ummett tënd këtë mënyre falleje.'' Allahu e pranoi lutjen dhe prej asaj kohe rukuja është ajo që ummeti im bën në namaz.

Më pas u ngjitëm në qiellin e tretë ku u takova me vellain tim Jusufin a.s. i cili më përshëndeti më selam... më pas rastisa me një shumicë ëngjëjsh të cilët ishin të rrjështuar në sexhdë dhe nuk ngriheshin nga sexhdja. Xhibrili më tha se ''ata qëndronin ashtu sepse ajo është mënyra e tyrë që adhurojnë Allahun ndaj lutju Allahut që të ja dhuroi këtë lloj adhurimi ummetit tënd.'' Prej këtu e ka burimin sexhdeja që myslimanët (ummeti i Muhammedit a.s.) bëjnë në namaz.

[92] Suheyli, Ravd-ul-unf, II, 208.

"Miraxhi është nata ku mëndja dorëzohet dhe nata që fillon besimi."
Hadith

Më pas kaluam në qiellin e shtatë tëk dyert e të cilit shkruhej **''La Ilahe Ilallah Muhammed Rresulullah.''** Aty u takova me Idrisin a.s. i cili më përshëndeti me selam dhe ju lut Allahut xh. sh. për mua. Allahu xh. sh. në suren Mejrem ajeti 57, për Idrisin a.s. thotë se; **'' Në e ngritëm atë në një vend të lartë (ia ngritëm lart famën).''**

Aty vura re një ëngjëll i cili qëndrontë i ulur në një fron, rreth tij qëndronin aq shumë ëngjëj sa që numrin e tyrë vetëm Allahu e din. Ëngjejt që qëndronin në të fjathtën e tij ndritnin më shumë se drita, fytyrat e tyre shkëlqënin prej bukurise mahnitëse. Ndërsa ëngjëjt që qëndronin në të majtën e tij nxirrnin zjarr nga goja, në duar mbanin shkopij dhe kamxhikë prej zjarri. Pamja e tyre ishtë aq tmerruese sa që askush nuk do të dëshirontë të ja hidhtë shikimin. Ata shikimin e mbanin mbi librin që qëndrontë para tyre dhe nuk e hiqnin shikimin prej tij. Para tyre qëndrontë një pemë tëk çdo gjethe e saj gjëndej një emër i shkruar. Poshtë saj qëndontë një enë mbajtësi i të cilit gjethen që kaptë me dorën e djathtë ja jeptë ëngjëjve bdriçues ndërsa atë gjethë që kaptë me dorën e majtë ja jeptë engjejve të zjarrit. Kur po ndiqja këto ndodhi zemra po më dridhej. Kur pyeta xhibrilin se kush ishin ata dhe çfar ishtë puna e tyre ai mu përgjigj se; **'' Ai (ëngjëlli) që qëndron mbi fron është ëngjelli i vdekjes (Azraili), fytyrën e të cilit askush nuk ka dëshire më e pa.''** Xhibrili a.s. ju afrua dhe i tha atij se shoqëruesi im është Muhammedi a.s. I Dërguari i Fundit i Allahut xh.sh., ai (Azraili) ma hodhi shikimin me plot buzqëshje, u ngrit nga froni dhe pasi më përshëndeti me selam më tha **''O I Dashuri i Allahut xh.sh. Allahu nuk ka krijuar njëri më të nderuar se sa ty. Edhe ummeti yt është prej ummetëve me të nderuar. Dije se dhëmbshëria ime për ummetin tënd është më e madhe se dhëmbshuria e prindërve për fëmijët e tyrë.''** Ndërsa unë duke i trëguar për dobësinë e ummetit tim, kërkova prej tij që të jetë edhe më i butë edhe më i mëshirshëm me ummetin tim dhe të ja marri shpirtin çdo pjestari sam ë lehtë.

Më pas dolëm në qiellin e pestë ku u takuam me Harunin a.s., ai me përshëndeti me selam dhe u lut për mua. Në qiellin e pestë vura re ritët e adhurimit të melaikeve. Ata qëndorin të gjithë në këmbë, shikimin e mbanin tëk gishtat e këmbëve të tyre dhe kurrë nuk e hiqnin shikimin prej aty dhe bënin dhikër me zë të lartë. E pyeta Xhibrilin a.s. **''a kjo është mënyra e adhurimit të këtyrë?'' ''Po, keto kështu e adhurojnë Allahun xh.sh., ndaj lutë Allahun që të ja dhuroj ummetit tënd këtë lloj adhurimi.''** E luta Zotin e gjithësisë dhe a ima dhuroi këtë. Më pas u ngjitëm në qiellin e gjashtë ku u takuam me Musain a.s., ai më përshëndeti me selam dhe u lut për mua. Pastaj u ngjitëm në qiellin e shtatë ku u takuam me Ibrahimin a.s. i cili ishtë ulur dhe rrintë i mbështëtur me shpinë në murin e Bejt-i Ma'mur'a. Bejt-i Ma'mur'a është shtëpia që futën shtatëdhjetë mijë ëngjëj. Ibrahimin a.s. e përshëndeta me selam, i cili ma ktheu selamin dhe më priti me fjalët ''Mirëserdhe Pejgamber i bekuar, biri im i bekuar.'' Më pas vazhdoi **''O Muhammed! Xhennëti është një vënd tëpër i brishtë dhe toka e tij është e kristaltë. Ndaj porositë umetin tënd që atje të mbjelli sa më shumë pemë në të.''** Kur e pyeta se **''mbillen pemët në xhennët?''** ai mu përgjigj që ta përmendin Allahun me thëniet **"Lâ havle velâ kuvvetë illâ billah"** (sipas një transmetimi tjetër); **"Subhânallahi velhamdulillahi ve lâ ilâhe illallahu vallahu ekber."** Më pas Xhembraili a.s. më dërgoi në vëndin e quajtur Sidret-ulmuntëha.

Sidret-ulmuntëha është një në qiellin e gjashtë, rrënjët e saj janë në qiellin e gjashtë ndërsa trupi dhe degët i arrijnë deri në gjiellin e shtatë, gjethet e saj i

ngjasojnë veshëve të elefantit ndërsa frutat e saj ishin sikur kulla.[93] Dikuej sikur hija e saj i mbulontë qiejt dhe xhennëtin. Ngjyrat e saj janë prëj bukurive dhe hijëshive të dritës së Allahut, askush nga krijesat e Allahut nuk mund ta shpjegoi bukurinë, hijëshinë dhe ndritshmërinë e asaj peme. Xhebraili a.s. u ndal aty dhe me tha të vazhdoja i vetëm por kur e pyeta së përse nuk po më shoqërontë me tëj ai mu përgjigj se; **''Allahu xh.sh. deri këtu me ka urdhëruar të afrohem, edhe nëse unë guxoj të hedh një hap më para atëherë Allahu xh.sh. më tret të tërin.''** Profeti a.s. deri aty u ngjit së bashku me Xhebrailin a.s. më pas ai vazhdoi udhëtimin i vetëm. Dhe duke kaluar përde pas përdeje nëpër lartësitë e larta gjersa arriti aty ku e kishtë caktuar Allahu suphanëhu ve tëala i Cili foli më të Dërgyuarin e Tij Muhammedin a.s. pa ndërmjetës. Mënyra se si Muhammedi a.s. u ngjit deri në vëndin ku foli me Allahun xh. sh. nuk është e ditur, por sipas transmetimeve thuhet se ai u ngjit me një mjët i quajtur Refref, mjet ky i cili erdhi prej xhennëti, ngjyra e tij është më e ndritur se dielli. Urtësitë, mirësitë, begatitë dhe bukuritë e pafundmë që Allahu i dhuroi natën e miraxhit i Dërguarit të Tij Muhammedi a.s. nuk mund ti shpjegoi, komentoi apo ti radhisi ndonjë krijesë tjetër e Allahut xh. sh.

Imam Rabani në vepren e tij Mektubat thotë se; **''I Dërguari i Allahut Muhammedi a.s. natën e Miraxhit nuk u takua me Allahun xh. sh. në këtë boto por u takua në Ahiret. Sepse i Dërguari i Allahut xh. sh. atë natë doli në koncepti vënd-kohë dhe u ngjit aje ku është përhershmëria e pafundme. Ai arriti në një vend që nuk fillim e mbarim. Pa ata të cilët do futën në xhennët pas qindra apo mijera vitësh, rrugët e arritjes në xhennët dhe ata të cilët ndodheshin në xhennët. Ja pra që të gjitha këto nuk shihen në këtë botë por shihen vetëm se në botën e Ahiretit.''**

Pejgamberit tonë të dashur Muhammedit a.s. kur ju urdhërua të falenderontë Allahun xh. sh. ai tha; **"Ettëhiyyâty lillahi vessalevâty vettayyibât (Përshëndetjet i takojnë Allahut, falenderimi i takon Atij me të gjitha gjuhët, punët dhe veprat vëtëm Ai meriton të adhurohet)"** Ndërsa Allahu xh. sh. atij ju përgjigj **''Es-selamu 'alejke ejjuhen-nëbijju ve rahmetull-llahi ve berekatuhu (Paqja qoftë mbi ty, o Lajmëtar, si dhe mëshira e Allahut dhe begatitë e Tij).''** Ndërsa Pejgamberi ynë i dashur Muhammedi a.s. **tha '' Es-selamu 'alejna ëe 'ala 'ibadil-lahis-salihin** (Paqja qoftë mbi në dhe mbi të gjithë robërit e mirë të Allahut). Ëngjejt që dëgjonin Muhammedin a.s. thanë të gjithë një **zëri ''Esh-hedu en la ilahe il-lall-llah ve esh-hedu ennë muhammeden abduhu ve resuluhu** (Dëshmoj se s'ka hyjni tjetër pos All-llahut dhe se Muhammedi është robi dhe i dërguari i Tij).''

Kur Muhammedi a.s. tha **''Eselamu alejna...** (paqja e Allahut qoftë mbi në)'' Allahu xh. sh. i tha o Muhammed a.s. përse thua **''paqja e Allahut qoftë mbi në dhe nuk thua qoftë mbi mua'' atëherë Muhammedi a.s. ju përgjigj ''**o Zoti im! Ti je Zoti i gjithqsisë dhe gjithë botërave. Them paqja e Allahut qoftë mbi në sepse së bashku me mua janë edhe shpirtërat e ummetit tim. Ti o Allah na ke dhënë dhe na ke falur të gjitha mirësitë e Tua, na largove nga të kqiat dhe na drejtove tëk të mirat. Ndaj duke të falenderuar Ty lutëm edhe për ummetin tim që Ti ta falësh dhe ta ruash nga të kqiat e Dynjasë dhe dënimi në Ahiret.'' Atëherë Allahu xh. sh. i tha; **''O i Dashuri Im ti sontë je misafiri Im ndaj kërko pej Meje çfar të duash''** I Dërguari i Allahut xh. sh. Muhammedi a.s. ; **''O Zoti i Gjithësisë të lutëm ty të më**

[93] Ahmed bin Hanbel, Musned, III, 164; IV, 208; Bejhekî, Sunen, I, 265; Kâdî İyâd, Shifâ-i Sherîf, 179.

japësh Ummetin tim!'' Sipas transmetimeve thuhet se Muhammedi a.s. e përsëriti disa herë këtë dialog me Allahun xh. sh. dhe Muhammedi a.s. veç ummetit nuk kërkoi gjë tjetër. Dhe kur Allahu xh. sh. i tha **''o Muhammed a.s. veç ummetit nuk kërkove gjë tjetër!''** Atëherë Muhammedi a.s. ju lut **'' O Zoti im! Ti je pranuesi i lutjeve ndërsa unë jam lutësi ndaj të lutëm Ty të ma falësh ummetin tim!''** Allahu Suphanëhu ve Tëâla ja pranoi lutjen Muhammedit a.s. dhe i tha atij **''Ditën e Gjykimit ti do të jesh ndërmjetësues i ummetit tënd.''**

Ta dhurova ummetin ty o Habib
Xhennëti për të është bërë nasip
O i Dashur kjo ishtë e jotja kerkese
Që Në t'dhurojme sa here papendesë

Atë natë (nata e Miraxhit) Pejgamberi ynë i Dashur Muhammedi a.s. pa xhennëtin, xhehennëmin, u takua me pejgamberet e tjere paraardhës dhe vizitoi banorët e qiejve, dhe çfar është më e rëndësishmja ai u kontaktoi me Allahun xh. sh. drejt për së drejti, pa ndërmjetës. Allahu xh. sh. e shpërbleu të Dashurin e Tij Muhammedin a.s. me atë udhëtim ku i fali dhe i dhuroi atij shumë mirësi dhe shumë begati. Madje thuhet se Muhammedit a.s. atë natë i janë treguar edhe banorët e xhennëtit edhe të xhehennëmit. Pra dhuntitë e natës së miraxhit janë të pa shpjeguara për cilindo që përpiqët të shkruaj për vizitën e të Dashurit të Allahut xh. sh. Muhammedit a.s. tëk Krijuesi i gjithësisë Allahu suphanëhu ve Tëâla.

Dashnia jonë tëk ty o i Nderuar
N'dynja e Ahiret njëriu më i Bekuar
Të ngritëm ty pranë Zotit t'Gjithsisë
Edhe emri yt pranë Emrit t'Përëndisë

Allahu xh. sh. Të gjithë pejgamberëve ju ka dhënë dhunti dhe mrekulli të pa fundme por këtë dhunti Ai veç Muhammedit a.s. nuk j aka dhënë asnjë Pejgamberi tjetër. Pra, Allahu Pajgamberit Nuh a.s. i dha anije. Ndërsa Muhammedit a.s. i Burakun me të cilin u ngrit natën e Miraxhit ku kaloi nëpër qiejt e botëravë, vizitoi xhennëtin dhe xhehennemin. Gjithashtu atë natë Allahu ja bëri mbarë rruzullin toksore mesxhit Muhammedit a.s.

Po ashtu Allahu ju dhuroi Beni Izrailitëve begati dhe mirësi të pa fundme, ju dhuroi atyre ushqim të gatshëm atë kohë kur ata nuk kishin mundësi të ushqëheshin Allahu ju dërgontë prej qiellit mish të pjekur shpendësh dhe ëmbëlsira që ata nuk i kishin të mundshme atë kohë. Ndërsa ummetit të Muhammedit a.s. i fali mirësië e bagati të pa fundme, madje Allahu xh. sh. është aq i mëshirshëm me ummetin e Muhammedit a.s. sa që kur ndonjëri prej tyre bën mëkatë sa shkuma e deti Allahu nuk e dënon sikur dënontë Beni Izraelitët, fytyrat e të cilëve i kthentë në fytyra që i ngjasononin fytyrës së majmunëve apo fytyrës së derrave. Gjithashtu Allahu xh. sh. i dhuroi ummetit të Muhammedit a.s. një sure që nuk gjendët në librat e mëprashëm, pra nuk gjëndet as të Tëurati, as të Ungjilli dhe as të Zeburi dhe ajo është surja El-Fatiha e cila gjëndet vetëm se në Kur'an'in Fisnik. Gjithashtu Allahu xh. sh. të Dashurit të Tij Muhammedit a.s. i dhuroi namazin dhe i premtoi atij se kushdo që ndjek Islamin, pra kush i beson Allahut xh. sh. dhe nuk i bën as shok as

ortak Atij, kush i beson profetësisë së Muhammedit a.s. dhe kush ndjek rrugën e tij Allahu xh. sh. do ti jap një jetë të qëtë në këtë botë dhe do e shpërblejë me xhennët në botën tjetër. Allahu xh. sh. Zoti i gjithësisë Zoti i botërave kurrë nuk e thyen premtimin e Tij, sepse Ai është Besnik i pashok dhe i pa ortak në krijueshmërinë dhe sundimin e tij suprem.

"O Muhammed! Kush (i beson profetësisë së Muhammedit a.s.) dhe ndjek rrugën e tij Allahu xh. sh. do ti jap një jetë të qëtë në këtë botë dhe do e shpërblejë me xhennët në botën tjetër."
Hadith Kudsi

Përsa i përket namazit transmetohet se Allahu xh.sh. Muhammedit a.s. i dhuroi atij pësëdhjet kohë namazi por kur u takua me Musain alejhi selam e pyeti atë **''se sa kohë namazi i kishtë dhuruar Allahu suphanëhu ve tëala ummetit të tij?'' Dhe kur ai (Muhammedi a.s.) ju përgjigj së i kishtë dhuruar pësëdhjetë kohë Musai a.s. i tha ''lutë Allahun që ti zbresë pesëdhjetë kohët në pesë kohë dhe kështu ummeti yt do e ketë me të lehtë.'' Atëhere Muhammedi a.s. ju lut Allahut xh.sh. që kohët e namazit të jenë pesëkohët që sot i praktikojnë muslimanët në mbarë universin.** (Përsa i përket këtij trasnmetimi shumica e dijetarëve nuk e pranojnë si transmetim të saktë pasi Allahu xh.sh. e ka urhdëruar Muhammedin a.s. ti fali pesë kohët e namazit, pra nuk e pranojnë si të vërtë dialogun e Muhammedit a.s. me Muasin a.s.).'' **Sipas transmetimeve edhe pse në praktikë kohët e namazit janë pesë përllogaritja e tyrë tëk Allahu xh. sh. është për pesëdhjetë kohe. Sëpse një namaz ka shpërblim sa për dhjetë namaze. Madje Allahu xh. sh. është aq i mëshirshëm me njërëzit sa që nësë një besimtar e bën një të mirë Allahu i shënon atij dhjetë sevape, por edhe nëse ai e mendon një të mirë por nuk e bën atë Allahu ja shkruan sikur e ka bërë atë të mirë. Edhe kur besimtari bën një gjynah Allahu ja shënon atij vetëm një gjynah, por edhe nësë ai e mëndon një gjynah por nuk e bën atë Allahu nuk ja shënon si gjynah[94]. Ja pra sa i mëshirshëm është Allahu xheleshanuhu me besimtarët, mjafton që besimtarët të jenë të sinqërtë dhe ti drejtohen vetëm Allahut dhe të mos i bëj Atij as shok e as ortak.**

Kështu pra Allahu xh. sh. e shpërbleu të Dashurin e Tij Muhammedin a.s. i cili kishtë bërë dhe përballuar të gjitha sakrificat dhe vuajtjet e tij që mushrikët e kishin munduar në Mekka (sipas gjithë transmetimeve thuhet se nata e Israsë dhe Miraxhit kanë ndodhur atë vit kur Muhammedin a.s. i kishin vdekur dy të dashurit dhë të afërmit e tij bashkëshortja Hatixhe dhe xhaxhai Ebutalib. Pra një kohësisht dy mbështëtësit më të afërt të Muhammedit a.s.).

Afrohu o i dashuri i pikëlluar
Të thërret i Dashuri për t'qëtësuar

Eja n'miraxh qëtësohu n'prehtësi
I Dashuri nuk e djek t'dashtunin e Tij

Mendo natën kur t'erdhi lajmi i vertë
Atë e qaujtën natën, Lejlet-ul kader

Lartësohu tha Ai, u lartësua ai kader
N'shtëpi t'Umm-i Hanit ndodhej at'herë

Nuk ka ardhur më parë kjo lartësi
Askush më parë nuk i pa ato mirësi

[94] Ahmed bin Hanbel, Musned, III, 164; IV, 208; Bejhekî, Sunen, I, 265; Kâdî Ijâd, Shifâ-i sherîf, 179.

Sepse ti je ummet sikur e shiokove n'gjithsi
Shkove pranë e takove atë Lartmadhëri

I lartësuar prej ç'do gjëje është Dhulxhelali
Atje ku Ai t'caktoi u paraqitë tëk Ai i Larti

I shikove hapur miresitë t'Nderuarit Zot
Ashtu sikur ummeti do i shoh n'Ahiret

Ti arritë n'Miraxh e përjetove at fat
Ummetit namazin ja fale Miraxh

Besova! Shpirti të qoftë falë ty o I Dërguari i Allahut

Pasi i Dërguari i Allahut Muhammedi a.s. u kthye në Kuds (Jeruzalem) dhe u nis për në Mekka gjatë rrugës rastisi me një karvan tregtie të Kuresjhitëve Mekkas të cilit bënin tregti nga Kudsi dhe po shkonin drejt Mekkas. Dhe kur arriti në shtëpinë e Ummi Hanit thuhet se krevati i tij ende nuk ishtë ftohur. Në mëngjes kur u zgjua i Dërguari i Allahut i tregoi Ummi Hanit për atë që i kishtë ndodhur gjatë natës dhe i tha asaj se **''do të shkontë ti tregontë Mekkasve për këtë ndodhi madhështore të Israsë dhe Miraxhit.''** Ndërsa Ummi Hani i tha asaj ''o djali i xhaxhait tim! Mos shko të ju thuash këto ndodhi Kurejshitëve sepse ata do të përgënjështrojnë dhe do të tallen me ty, edhe ata që kanë besimin e dobët nuk të besojnë dhe largohen prej tëje. Ndërsa ai ja ktheu; **"Betohem në Allahun, unë do t'ua them këtë atyre. Ai që sot është i prishur, nesër gjithashtu do të jetë i kalbur. Unë do ta ndërtoj këtë Islam me ata që kanë besim të fortë. Nëse ka ende ndonjë që ka dyshime për mua, le të largohet. Unë nuk kam punë me ta. Ai që është i prishur, gjithmonë do të mbetet i tillë. Ai nëse nuk kalbet sot, patjetër që nesër do të kalbet. Më mirë të kalbet tani, që të mos mbështetemi në të kalburit. Ata që janë të fortë, do të më mjaftojnë."**

> *"Betohem në Allahun, unë do t'ua them këtë atyre. Ai që sot është i prishur, nesër gjithashtu do të jetë i kalbur. Unë do ta ndërtoj këtë Islam me ata që kanë besim të fortë. Nëse ka ende ndonjë që ka dyshime për mua, le të largohet. Unë nuk kam punë me ta. Ai që është i prishur, gjithmonë do të mbetet i tillë. Ai nëse nuk kalbet sot, patjetër që nesër do të kalbet. Më mirë të kalbet tani, që të mos mbështetemi në të kalburit. Ata që janë të fortë, do të më mjaftojnë."*
> ***Hadith***

Faktikisht Kurejshët një shkak të vogël kërkojnë për të të sulmuar ty. Numri i myslimanëve ende është i vogël dhe ju jeni të dobët, ndaj prit të shtohet edhe ca numri i myslimanëve ndërkohë që edhe ju forcoheni më shumë atëherë ju tregoni Kurejshitëve për Isranë dhe Miraxhin.'' Por i Dërguari i Allahut xh. sh. vendosi që të jua tregoi Mekkasve ndodhinë e Israsë dhe Miraxhit dhe sapo arriti në Qabe ja nisi të ju tregontë të pranishmëve që ndodheshin aty... Mushrikët me njëherë u hodhën në sulm duke thënë ''Muhammedi i Biri i Abdullahut ka lajthitur mendësh!'' Ata që ishin në mëdushje filluan të dyshonin ndërsa një pjesë prej musrikëve shkuan të shtëpia e shokut dhe mikut më të ngushtë të Muhammedit a.s. Ebubekri r.a., sepse ata e dinin që mbështëtësi më i madh i tij ishtë Ebubekri.

Ebu Bekri ishtë një tregtar i mençur dhe i hidhur ai dintë ti dallontë mirë gjërat dhe ishtë ndër të parët që i kishtë besuar të Dërguarit të Allahut Muhammedit a.s.. Kur arritën mushrikët tëk ai e gjetën atë në shtëpi dhe sapo ju hapi derën ata ''o Ebu Bekr! Ti je ndër tregtarët që e di mirë rrugën e Kudsit. Sa kohë duhet që të shkosh nga Mekka në Kudus dhe anasjelltas?'' ''Po! Unë e di mirë atë rrugë dhe duhet më e

pakta një muaj që të shkosh nga Mekka në Kuds.'' Ju përgjigj Ebubekri. Mushrikët i gëzoi përgjigjia e tij dhe menjëherë u hodhën; ''A e din ti o Ebu Bekr se shoku dhe miku yt Muhammedi (a.s), që ti i beson bindshëm, ka filluar të thotë se; ''për një kohë fare të shkurtër të natës kam udhëtuar nga Mekka në Kuds!'' A nuk e sheh se sa ka lajthitur ai?'' Por Ebubekri sapo dëgjoi emrin e Muhammedit a.s. ju tha atyre se; **''Kush i thotë këto fjalë Muhammedi a.s.? Nëse vërtetë ai thotë kështu unë pa pikën e dyshimit i beso atij. Dhe dijeni se ai vërtetë ka udhëtuar.''** Pas i tha këto fjalë Ebubekri radijallahu anhu e mbylli derën dhe u fut brënda. Ndërsa mushrikët mbetën gojëhapur pas dere dhe nuk ju mbeti gjë tjetër vetëm se të vazhdojnë me kokëfortësinë e tyre duke thënë; ''A nuk po e shihni çfar magjistari është Muhammedi (a.s.)! Ai ja paska arritur që me magjinë e tij ta lidhi pas vetës Ebubekrin (r.a.)!''

Ebubekrit r.a. nuk ju durua më dhe vendosi të shkontë ta shihtë dhe të dëgjontë prej vetë shokut dhe mikur të tij të ngushtë Muhammedit a.s., kur arriti pranë tij vuri re se ai ishtë rrethuar nga disa njërëz që gjëndeshin aty. Ebubekri pa ju afruar ende **''O i Dërguari i Allahut! Falenderuar qoftë Ai (Allahu xh. sh.) i Cili kan ë dorë zemrat tona dhe të ka dërguar ty për të na treguar në rrugën e drejtë. O i Dërguar (salallahu alejhi ve selem)! Falenderuar qoftë Ai i cili të bekoi ty me natën e Israsë dhe Miraxhit. Çfar do që ti thua është e vërtëtë dhe çfar do që ti përgënjështron është gënjështër. Unë të besova, dhe për ty jap jetën!''** Kur dëgjuan këto fjalë të Ebubekrit mushrikët që ndodheshin aty u larguan plot habi ndërsa i dërguari i Allahut xh.sh. Muhammedi alejhi selam e quajti Ebubekrin ''Sëdëk (Besnik)'' dhe prej asaj ditë deri në ditën e fundit të kësaj botë grada më e lartë do të jetë grada e Besnikut Ebu Bekr (Ebu Bekr es-Sëdëk) i cili i besoi Muhammedit a.s. pa mëdyshjen më të vogël[95].

Mushrikët u irrituan më shumë nga kjo gjëndje dhe për ta përgënjështruar të Dërguarin e Allahut Muhammedin alejhi selam filluan ta pyesnin ''O Muhammed (a.s.) maqë ti p ona thua se kë shkuar dhe ke vizituar Kudsin! Na thuaj sa dyer dhe sa dritare kishtë Kudsi?'' I Dërguari i Allahut Muhammedi a.s. i përgjigjej një për një pyetjëve të tyre. Sipas transmetimeve thuhet se Muhammedi a.s. nuk e kishtë mbajtur në mëndje se sa dyer, dritare apo hyrje kishtë Kudsi por kur e peyetën mushrikët ai (Muhammedi a.s.) tha se **''atë moment Xhibrili a.s. ma solli para syve tërë Kudsin.''** Kur mushrikët nuk u bindën atëherë Muhammedi a.s. ju tha se gjatë rrugës kishtë parë një karvan i cili po kthehej nga Kudsi për në Mekka dhe ai karvan filan ditë (p.sh. ditën e mërkurë) arrin në Mekka. Dhe kur ardhi ajo ditë vërtëtë karvani që kishtë përmendur i Dërguari i Allahut Muhammedi a.s. arriti në Mekka[96], por kryenëçsia e Mushrikëve nuk i bindi ata që ti besonin të Dërgyarit të Allahut por vazhduan me përgënjështrimet e tyre duke e mohuar atë.

Kur ndodhi mrekullia që quhet Miraxh ishtë nata e ditës se xhuma, pikërisht në datën 27 të muajit Rexhep (kalendari hënor), një vit para Hixhretit. I Dërguari i Allahut a.s. në Miraxh u ngjit i gjallë me trup dhe me shpirt. Natën e Miraxhit atij a.s. ju treguan shumë mrekullira dhe ishtë po ajo natë ku ju dhurua (ju bë farz) falja e pesë kohëve të namazit. Po ashtu atë natë i zbritën edhe dy ajetët e fundit të kaptinës Bakara. Miraxhi përmendet në Kur'an pikërisht në ajetin e parë të kaptinës Isra, në ajetët e para të kaptinës Nëxhm dhe në disa hadithe të Profetit Muhammed alejhi salatu ëe selam[97]. Pejgamberi ynë i Dashur alejhi selatu ve selam kur ju ka

[95] Ibni Sa'd, Tabakât, I, 144.
[96] İbni Sa'd, Tabakât, I, 215.
[97] Buhârî, Menâkıbul-Ensâr, 42; Tirmidhî, Tefsîru'l-Kur'ân, 20; Ibni Hishâm, Sîret, I, 403; Bejhekî, Sunen, I, 255; Suheylî, Ravd-ul-unf, II, 208.

folur shokëve të tij për natën e Miraxhit Xhennëtin e ka përshkruar se; **''O Ebu Bekr! E kam parë vendin tënd në Xhennët ishtë i stolisur me ar të kuqërrëmtë. Vura re për mirësitë që të prisnin ty atje.'' ''Falenderuar i Madhërishmi Allah, i Cili të ka dërguar ty në mesin tonë dhe ka përgatitur për në mrekullira në Xhennët''** ju përgjigj Ebubekri radijallahu anhu. Më pas i Dërguari i Allahut i thotë Omerit r.a. **''O Omer! E kam parë edhe vëndin tënd në Xhennët, e kishtë stolisur Allahu xh. sh. me mbarë mirësitë e tij.'' ''Falendëruar qoftë Ai i cili të ka Dërguar ty o I Dërguari i Allahut.''** Ju përgjigj Omeri radijallahu anhu. Po ashtu I Dëerguari i Allahut edhe Osmanit dhe Aliut radijallahu anhu i tha se i kishtë parë vëndet që Allahu ju kishtë përgatitur atyre në Xhennët. Edhe ata e Falenderuan të Madhërishmin Allah. Pra sikur shihet këto janë katër sahabët (shokët e Profetit Muhammed a.s.) të cilët Allahu i ka përgëzuar me Xhennët.

Sipas transmetimeve thuhet se pasi Profetit a.s. ju bë i detyrueshëm namazi ishtë Xhibrili a.s. ai i cili ja mësoi atij ritët dhe kohët e faljeve. Në sunnën e Bejhakit transmetohet një hadith i Profetit Muhammed alejhi selam ku thotë; **''Ishtë Xhibrili a.s. ai i cili hyri para dhe unë u fala pas tij para lindjes së diellit (Namazi i sabahut) në derën e Qabes. Kur dielli e kishtë kaluar kupën e qiellit Xhibrili erdhi përsëri dhe hyri para ndërsa unë pas tij falëm namazin e drekes. Ndërsa kur erdhi koha që hija e objektëve ishtë sa madhesia e tyre Xhibrili erdhi hyri para ndërsa unë ju bashkangjita nga pas dhe së bashku falëm namazin e ikindisë. Kur dielli përëndoi i tëri ai (Xhibrili a.s.) erdhi dhe ashtu sikur më parë falëm namazin e akshamit. Ndërsa kur hyri nata dhe u errësua i gjithë vëndi Xhibrili a.s. erdhi dhe së bashku falëm namazin e jacisë, pra kur kishtë hyrë një e treta e natës e falëm namazin e jacisë. Më pas Xhibrili a.s. më tha ''O I Dërguari i Allahut! Ky është namazi që kanë praktikuar edhe Pejgamberët para tëje.''** (Pra praktikojeni namazin ndërmjet sabahut dhe jacisë, pesë kohët e namazit).[98]'' Prej asaj kohe deri në ditën e fundit të kësaj botë kohet e namazit dhe menyra e praktikimit të tyre bëhen sipas këtij transmetimi nga i Dërguari i Allahut Muhammedi a.s., edhe ata besimtarë që e humbin një kohë të namazit e falin atë kaza (namazi që nuk arrihet të në kohën e tij praktikohet mënjëher sapo ti jepet mundësia e parë besimtarit praktikant).

[98] İbni Ebî Seybe, Musannef, VIII, 443-444; Hâkim, Mystedrek, IV, 648-649; İbni Hisâm, Sîret, I, 403-404; İbni Sa'd, Tabakât, I, 213-215.

Mesxhidi i ndërtuar në vëndin ku u bë besëlidhja e Akabes
Mesxhid-i Bej

BESËLIDHJA E AKABES

Besëlidhja e Parë e Akabesë

"O banorë të Medinës! A më premtoni se do të më ndihmoni mua në rrugën e Allahut, për hir të Allahut, ashtu sikur mbroni veten dhe nderin tuaj?"
Hadith

Besëlidhja e parë e Akabesë u realizua në vitin e njëmbëdhjëtë të shpalljes së vahjit, pikërisht në muajin fhulhixhe të kalendarit hënor. Në kohën e haxhit Esad bin Dhurure së bashku me njëmbëdhjet shokët e tij erdhën në Mekka. Kishtë kaluar një vit nga koha kur ishin takuar për herë të parë me të Dërguarin e Allahut Muhammedin a.s., këtë vit mushrikët tregoheshin edhe shumë më të dhunshëm se kohët e mëparme. Sjellja e tyre me myslimanët ishtë akoma më barbare dhe e ndiqnin Profetin Muhammed a.s. hap pas hapi dhe kush u takontë apo flistë me të ata e dhunonin barbarisht. Kur mësuan këtë Medinasit kërkuan prej Pejgamberit a.s. që të takoheshin në Akabe natën dhe kur errësira mbuloi vëndin ata u takuan aty ku e kishin lenë vënd takimin, pikërisht në vëndin e qaujtur Akbe. Ata i dhanë besën Muhammedit a.s. dhe i thanë se do të ndiqnin rrugëtimin e tij dhe ishin të gatshëm të bënin çfar do që ai ti urdhërontë. Kjo besëlidhje u bë duke ju marrë besën atyre se ata **''Nuk do i bëjnë shok Allahut xh.sh., nuk do të bëjnë zina (marrëdhënie jasht kurore), nuk do të vjedhin dhe nuk do të grabisin pat ë drejtë pasurinë apo mallin e askujt, nuk do të akuzojnë dhe nuk do të përgojojnë askënd pa të drejtë si dhe nuk do ti vrisnin fëmijët e tyre prej frikës së urisë apo prej frikës se mos përjashtohen apo nënçmohen nga shoqëria''.** [99]

[99] Ibni Sa'd, Tabakât, I, 220; Taberî, Târih, II, 356; Belâdhûrî, Ensâb, I, 252-253.

I Dërguari i Allahut Muhammedi a.s. këto 12 përsona që vinin prej fisit Evs dhe Hazrexh i ngarkoi me përgjegjësinë e përfaqësisë tëk fiset e tyre. Ata do të ktheheshin tëk fiset e tyre do ti shpjegonin Islamin dhe do ti bënin thirrje atyre që ta besınin të Dërguarin e Allahut dhe do të merrnin besën e tyre për ti dalur krah Muhammedit a.s., ndërsa Esad bin Dhuraren e emroi kryetar të këtij grupi njërëzish që i dhanë besën Muhammedit alejhi selam.

Pesë nga viti i kaluar dhe shtatë nga ky vit i beslidhjes përsonat që e kishin pranuar Islamin ishin; Prej fisit Nëxhar Mâlik bin Esad bin Dhurâre, Avf bin Hâris dhe Muadh bin Hâris. Prej fisit Amir Zurejk bin Râfi' bin Mâlik dhe Dhekvân bin Abdikajs. Prej fist Avf Ganm bin Ubâde bin Sâmit. Prej fisit Kusaj Jezîd bin Thalebe. Prej fisit Zejd Axhlân bin Abbâs bin Ubâde. Prej fisit Kab Ukbe bin Âmir. Prej fisit Ganm Sevâd bin Kutbe bin Âmir. Prej fisit Xhushem Abduleshel bin Ebu'l-Hejsem Mâlik bin Tëyyihân dhe prej fisit Avf Amr bin Ujejm bin Saîde.

Lindja e Diellit Në Medina

"Atëherë o të afërmit e mi! Dijeni se unë e pranova Islamin dhe u bëra Mysliman. Ndaj kërkoj prej jush që ta pranoni edhe ju Islamin duke dëshmuar se nuk ka Zot tjetër veç Allahut dhe se Muhammedi është njeri dhe i Derguar i Allahut. Kush nuk do ta pranoi këtë atëherë të mos vijë të flas më me mua, as unë nuk do ti flas askujt prej atyre që nuk da të pranojë këtë (Islamin)."
Sad bin Muadh r.a.

Pasi u kthyen besëlidhësit në Medina filluan të thërrasin të afërmit e tyre në fenë Islame. Ata përpiqëshin ditën dhe natën që të afërmit e tyre ta pranonin fenë e vërtetë, Islamin. Thirrjet e tyre kishin filluar të jepnin fyrtët e veta sa që Isalmi nisi të flitëj ngado nëpër qytët. Madje fiset Evs dhe Hazrexh e kishin lënë mënjanë armiqësinë e tyre historike dhe kishin filluar të flisnin për urtësitë e të Dërguarit të allahut Muhammedin a.s. dhe kishin filluar të mësonin prej njëri tjetrit sam ë shumë për Islamin. Ndërsa i Dërguari i Allahut Muhammedi a.s. për ti mësuar Islamin Medinasve i kishtë dërguar Musab bin Umejrin. Musabi r.a. kishtë filluar të banontë në shtëpinë e Esadit r.a. dhe së bashku me të vizitonin çdo familje dhe i mësonin Islamin atyre. Këto kërkonin prej Medinasve që ti jepnin bësën Muhammedit a.s. që ata do ti dilnin krah dhe ta mbronin atë prej çdo lloj sulmi që atij mund ti bëhej nga armiqtë e Islamit, pra ata i parapërgatitën Medinasit për besëlidhje me Muhammedin a.s.

Kryetari i fisit të Esad bin Dhurares ishtë Sad bin Muadhi ata kishin lidhje farefisnore dhe ashtu sikur ishtë traditë tëk arabët e asaj kohe brenda fisit ruhej lidhja edhe në rast së ata nuk pajtoheshin me njëri tjetrin. Ndaj dhe Sadi i cili ende nuk e kishtë pranuar Islamin nuk kishtë shkuar ta pengontë Esadin për përhapjen e kesaj feje (Islamin) që sapo kishtë nisur lulëzimin e saj. Pra ai si kryetar fisi që ishtë nuk ndërmorri asnjë hap për ta penguar Esadin që ait ë mos ju bëntë thirrje Medinasve që ata të pranon Islamin. Prandaj ai thirri një nga antarët e fisit Usejd bin Hudajrin dhe i tha këtij se duhet të shkontë dhe ta vizitontë Esadin dhe të shihtë se çfar po përpiqëj ait ë bëntë. ''Nëse Esadi nuk do të ishtë djali i sime tëze atëherë nuk do të të dërgoja ty o Usejd, ndaj shko edhe shikoje dhe vepro si të duash me të'' i tha Sadi Usejdit.

Usejdi sikur ishtë traditë veshi mburojën mori armët dhe u nis drejt shtëpise së Esadit dhe sapo arriti pranë tij nisi të flas me tonë të ashpra; ''Përse keni ardhur këtu të në? Për të mashtruar njërëzit tanë! Nëse ju dhimbset jeta largohuni sa më parë prej këtu!'' ju përgjigj Usejdi Musab bin Umejrit. Musabi nuk e prishi tërezinë por me butësinë e tij ''Eja ulu, qëtësohu pak, na dëgjo edhe ti njëherë në, pastaj nëse nuk të vijnë përshtat fjalët tona atëherë vepro si të duash. Ose na pranon dhe nal ë

të lirë në punën tonë ose na përzen prej këndej...'' ''Po thua të drejtën'' i tha Usejdi Musabit dhe u ul pranë tyre.

Musabi radijallahu anhu me zërin e tij të bukur dhe me butësinë e të folurit të tij nisi ti citoi disa ajeta nga Kurani Usejdit. Usejdi kur e dëgjoi Musabin kaloi në habi dhe i tha ''çjanë këto fjalë të mrekullueshme? Këto fjalë asesi nuk mund të jenë fjalët e një njëriu! Cilat janë kushtët që duhen plotësuar për të pranuar këtë fe Islame?'' Dhe kur ata i treguan atij për kushtët e pranimit të Islamit Usejdi pa u menduar fare dëshmoi **shehadetin'' Eshehdu en-Laa Ilahe Ilallah ve Eshhedu ennë-Muhammeden Abduhu ve Resuluhu''** dhe pranoi Islamin. Prej gëzimit që i solli qëtësia shpirtërore ai u ngrit në këmbë dhe ju tha të pranishmëve se; ''Unë po shkoj që të sjell dikë këtu tëk ju. Nëse ai që do të sjell unë këtu pranon Islamin, prej fisit të tij në Medina askush nuk mbetët pa e pranuar Islamin.'' Më pas Usejdi doli dhe iku më shpejt se sa erdhi drejt e tëk Sad bin Muadhi. Kur e pa këtë ardhje të Usejdit Sadi tha ''Betohem se Usejdi nuk po vjen me fytyren që iku'' dhe nuk priti më prej meraku por ju drejtua ende pa ju afruar ''Çfar bëre me to (myslimanët) o Usejd?'' Usejdi r.a. tashmë e dëshirontë shumë që Sadi ta pranontë Islamin ndaj ai u përpoq ti jeptë një përgjigje që atij ti shkontë në zemër ndaj i tha ''O Sad! Unë fola me to (Musab bin Umejrin r.a.) nuk pash tëk ata asnjë gjë të keëqë, madje nuk besoj se prej tyre na vjen ndonjë e keqë. Por dëgjova se fisi Beni Haris po përgatitëj të sulmontë djalin e tëzes tënde Esadin sepse kjo veprimtari e këtij të fundit i kishtë shqëtësuar disi tëpër ato.''

Fjalët e Usejdit e prekën shumë Sad bin Muadhin r.a. Sepse pak vitë më parë kishtë ndodhur një dy luftim ndërmjet fisit të tij dhe fisit Beni Haris ku këto të fundit ishin detyruar të shpërnguleshin në Hajber. Një vit më vonë ata ishin pajtuar dhe i kishin dhënë lejë që të kthehëshin në vëndlindjen e tyre. Pra kur ai degjoi fjalët e Usejdit se fisi Beni Haris po përgatitëj për të sulmuar një prej anëtarëve të fisit të tij, posaçerisht Esad bin Dhuraren. Por në realitët ky lajm nuk ishtë i vërtëtë, por ishtë një Stratëgji e Usejdit i cili kishtë për qëllim të merrtë nën mbrojtje Esadin dhe Musabin radijallahu anhum. Kështu që edhe Sadi do ti dëgjontë ata dhe do të pranontë Isalmin.

Ashtu ndodhi Sadi nuk pati më durim por u ngrit dhe vrapoi drejt e tëk shtëpia e Esad bin Dhurares të cilin e gjeti aty ulur me Musab bin Umejrin radijallahu anhuma. Sapo i pa Sadi ja nisi mi një ton të lartë ''O Esad! Ti po përfiton nga lidhjet tona farefisnore që ke ndërmarrë të tilla iniciativa apo si e ke hallin...?'' Esadi dhe Musabi nuk e prishën qëtësinë por ashtu sikur ishin ja kthyen atij butësisht ''O Sad! Eja ulu të merremi vesht urtë dhe butë. Na dëgjo edhe ti në një herë, më pas nëse nuk të pëlqëjnë fjalët tona atëherë ti ngrihesh dhe ikën...'' Sadi u ndikua nga qëtësia dhe pritja e ëmbël e tyre ndaj u ul në një qoshe të dhomës dhe ja nisi të dëgjoi Musabin. Musabi më parë i foli për Islamin, për parimet dhe urtësitë Islame, më pas ja nisi të recitoi disa ajetë nga Kur'ani Famëlartë. Sadi që dëgjontë me vëmëndje ishtë ndikuar aq shumë saqë zemra po i luntë vëndit. Ndaj ai u hodh dhe pyeti **''Si ja bëni ju që e pranoni këtë fe?''** Musabi i tha se më parë dëshmojmë shehadetin. **''Çështë shehadeti?''** e pyeti sërisht Sadi. **''Të dëshmosh se nuk ka Zot tjetër veç Allahut dhe të Dëshmosh se Muhammedi është njëri sikur gjithë të tjerët dhe I Dërguari i Allahut''** ju përgjigj Musabi. Atëherë Sadi pa pikë mëdyshje dëshmoi shehadetin **''Eshhedu en-Laa Ilahe Ilallah ve Eshhedu ennë Muhammeden Abduhu ve Resuluhu''** dhe pranoi Islamin.

Kur e pranoi Islamin Sad bin Muadhi ndjeu një qëtësi dhe harmoni të brëndëshme që kurrë nuk e kishtë ndjerë më parë. Ai i ngrit nga aty dhe uredhëroi të omblidhej i tërë fisi, sikur ai e kishtë zakon që për çdo çështje të rëndësishme e thirrtë fisin e tij dhe bashkëbisedontë me to. Pasi bëri dush (mori gusull) mori pranë Usejd Bin Hudajrin dhe shkoi atje ku mblidhej fisi. Kur arriti atje i përshëndeti të pranishmit dhe sikur e kishtë zakoni i kryetarit të fisit Sadi ja nisi **''O të Afërmit e mi! Më thoni se si më njihni ju mua?''** ata njëzëri ''O Sad! Ti je kryetari ynë dhe në të jemi bindur ty pa kushtë.'' Pasi dëgjoi vendosmërinë e fisit të tij Sadi ju tha se **''Atëherë o të afërmit e mi! Dijeni se unë e pranova Islamin dhe u bëra Mysliman. Ndaj kërkoj prej jush që ta pranoni edhe ju Islamin duke dëshmuar se nuk ka Zot tjetër veç Allahut dhe se Muhammedi është njëri dhe i Derguar i Allahut. Kush nuk do ta pranoi këtë atëherë të mos vijë të flas më me mua, as unë nuk do ti flas askujt prej atyre që nuk da të pranojë këtë (Islamin)...''**

Senët-us-Surur (Viti i Gëzimit)

Fisi i Sadit r.a. sapo mori lajmin prej tij se ai kishtë pranuar Islamin e pranuan Islamin me të madh e të vogël. Atë ditë në Medinë ngulonin rrugët me shehadet dhe tëkbire.[100] Prej ditës kur fisi i Sadit pranoi Islamin kishin kaluar vetëm pak dit kur edhe fiset Evs dhe Hazrexh që jetonin në Medinë e pranuan Islamin. Kështu që në çdo familje të këtyre fiseve kishtë hyrë drita Islame. Më pas Sadi së bashku me Usejdin u ngritën dhe i thyen të gjithë idhujt që kishin adhuruar fiset e tyre deri atë kohë. Kur arriti lajmi për lulëzimin e Islamit në Medinë tëk i Dërguari i Allahut alejhi selam si së bashku me sahabët u gëzuan shume. Kjo ishtë arsyeja që ai vit (H. 621) u quajt **''Senët-us-Surur** (Viti i Gëzimit).''

Esselâtu vesselâmu alejke jâ Resûlallah
Esselâtu vesselâmu alejke jâ Habîballah
Esselâtu vesselâmu alejke jâ Sejjidel evvelînë vel âhirîn!

Beslidhja e Dytë e Akabes

Në vitin e dymbëdhjetë të ardhjes së Vahjit mushrikët Mekkas e kishin rritur aq shumë dozën e barbarizmit ndaj myslimanëve saqë atyre ju kishtë humbur durimi. Ndërsa në Medinë fiset Evs dhe Hazrexh me në krye Esad bin Dhurare dhe Musab bin Umejr po prisnin me padurim që ti dilnin krah myslimanëve dhe ti prisnin ata në Medina. Edhe Profeti alejhi selam ishtë i gatshëm të shpërngulej nga Mekka dhe të vendosej në Medina. Medinasit po e prisnin ardhjen e tij me pa durim, madje ata ishin të gatshëm të sakrifikonin edhe shpirtërat e tyre për të. Koha e Haxhit kishtë afruar. Ndaj në muajin Dhulhixhe Musab bin Umejri së bashku me 73 burra dhe 2 gra erdhën në Mekka për të kryer ritin e Haxhit. Pasi kryen Haxhin të gjithë së bashku shkuan në Akabe për tu takuar me të Dërguarin e Allahut Muhamedin a.s. ata kërkuan prej tij që të shpërngulej në Medina. I Dërguari pasi i recitoi atyre disa nga ajetët e Kur'anit mori besën prej tyrë që ta mbronin dhe të kujdeseshin për të ashtu sikur ata kujdeseshin për familjen dhe të afërmit e tyre. Pran të Dërguarit të Allahut gjendej dhe xhaxhai i tij Abasi i cili ende nuk e kishtë pranuar Islamin. Ai e mori fjalën dhe ju drejtua Medinasve me fjalët; ''O Medinas! Muhammedi (a.s.) është djali i vëllait tim. Dijeni se ky është njëriu që dua më shumë ndër njërëz.

[100] Ibni Hishâm, Sîret, I, 435; Taberî, Târih, II, 88; Suheylî, Ravd-ul-unf, II, 258; Ibni Kethîr, Sire, II, 182

> *"Ne tashmë jemi të vetëdijshëm që edhe nëse nuk do e mbajmë besën e dhënë, mallkimi i Allahut xh. sh do jetë mbi ne. Ndaj betohemi në Madhështinë e Allahut se ti do të jesh i sigurtë në mesin tonë."*
> ***Esad bin Dhurarë Radijallahu anhu***

Nëse ju i besoni këtij dhe asaj çfar këtij i ka ardhur (Islamin) dhe kërkoni që ta merrni atë në Medina atëherë ju duhet të na jepni besën që ju do e mbroni më shumë se sa mbroni fëmijët dhe shpirtërat tuaj. Pra ju duhet të na bindni në që Muhammedi alejhi selam do të jetë i sigurtë në mesin tuaj. Ashtu sikur ju e dini që Muhammedi (a.s.) është prej nësh dhe në po i dalim krah atij kundër atyre (mushrikëve) që e sulmojnë dhe duan ta zhdukin atë. Ai po jeton me nder e me krenari në mesin tonë. Edhe pse sot ky po vendos që së bashku me ju të vijë në qytëtin tuaj. Ndaj nëse jeni të bashkuar dhe keni fuqi ta mbroni kundër të gjithë fiseve arabe atëherë merreni. Ndaj uluni dhe konsultohuni mirë me njëri tjetrin që nësër të mos bieni ndesh me njëri tjetrin. Pra na jepni besën që ju do ta mbroni Muhammedin (a.s.) prej armiqëve të tij? A do e mbani besën e dhënë dhe do ti dilni në mbrojtje kundër armiqve të tij (Muhammedit a.s.)? Nëse dombani besën atëherë ju do jeni më të nderuarit. Por nëse ju do bëni të kundërtën dhe sapo ait ë dali nga Mekka do e lini të vetëm atëherë hqini dorë që tani dhe lërni të qëndroi i ilrë këtu në vendlindjen e tij.'' Kur dëgjuan Medinasit këtë fjalim prej Abasit r.a. u prekën pasi menduan se mos ndoshta ata nuk do i dilnin kraj të Dërguarit të Allahut Muhammedit a.s. kur ait ë shkontë në Medina.

Esad bin Dhurarë u ngrit në këmbë dhe ju drejtua të Dërguarit të Alahut Muhammedit a.s. **''Më lejoni o Resulullah të ju them disa fjalë! Në edhe prindërit, fëmijët dhe shpirtërat tanë jemi të gatshëm ti sakrifikojmë për ty! Pa diskutim që çdo thirrje ka lehtësitë dhe vështirësitë e saj. Tani ju po na thirrni në një rrugëtim sakrifice që njërëzit nuk e kanë të lehtë ta pranojnë. Sikur e dini, njërëzit nuk e kanë të lehtë të heqin dore nga adhurimet e idhujve, dhe të pranojnë Islamin. Ndërsa në i kemi marrë të gjitha parasysh, e pranuam Islamin dhe jemi të gatshëm që të bejmë çfar do që të na urdhërohet. Pra nëse lind nëvoja që të ndërpresim lidhjet me jo besimtarët nga fisi ynë edhe atë pa pikë mëdyshje e bëjme. Ju edhe në jemi të vetëdijshëm që këto nuk janë të lehta për në. Ndaj në po ju japim besën se do të bëjmë atë që nuk e bënë as xhaxhallarët tuaj, pra kur ata të braktisin në kurrë nuk do të ju braktisim. Dhe do na shohësh se do të jemi të gatshëm të sakrifikojmë gjiçka në zotërojmë për të të mbrojtur ty.**

Në tashmë këtë detyrë e pranuam dhe ja bëmë detyrë vetëve tona që edhe shpirtërat tona do ti japim në rrugën tënde. Dijeni se çfar na thotë gjuha na e vërtëton zemra se ashtu sikur kujdesemi për familjen, fëmijët dhe prindërit tanë ashtu do të kujdesemi edhe për ty. Në tashmë jemi të vetëdijshëm që edhe nëse nuk do e mbajmë besën e dhënë, mallkimi i Allahut xh. sh do jetë mbi në. Ndaj betohemi në Madhështinë e Allahut se ti do të jesh i sigurtë në mesin tonë. Dhe së fundmi na thuaj o i Dërguari i Allahut xh. sh. çfar kërkohet **tjetër prej nësh?''**

I Dërguari i Allahut xh. sh. pasi i këshilloi ata me Islam dhe ju citoi disa ajetë nga Kur'ani Famëlartë ju tha; **''Kushti i parë është që ju të mos adhuroni zot tjetër veç Allahut xh.sh. dhe të mos i bëni shok e ortak Atij. Ndërsa për vetën dhe shokët e mi kërkoj prej jush që të na dilni krah dhe të na qëndroni pranë në çdo sakrificë tonën. Pra ashtu sikur kujdeseni për vetët tuaja, të na hapni dyert dhe të kujdeseni për në ashtu sikur kujdeseni për fëmijët tuaj.''** Pasi

përfundoi fjalët i Dërguari i Allahut Muhammedi a.s., fjalën e mori Berra bin Maruri i cili tha; **''Betohemi në Atë që të ka dërguar ty me fenë e vërtetë ty dhe të bëri ty Pejgamber se; do të kujdesemi për ju më shumë se sa kujdesemi për prindërit dhe fëmijët tanë. Ndaj sot është koha të lidhim besën o i Dërguari i Allahut.''**

Pastaj Medinasi Abas bin Ubade u ngrit në këmbë dhe ju drejtua Meddinasve, ''O banorët e Medinës! A jeni të vetëdijshëm se përse po e pranojmë Muhammedin a.s. në Medina?'' pasi ata ju përgjigjën ''Po'' të gjithë njëzëri ai vazhdoi ''Dijeni pra se në po e pranojmë atë për ti dal krah atij në kohë luftë dhe në kohë paqëje, po i bindemi atij. Ndaj që nëse vjen një kohë që pasuria apo fëmijët tuaj janë në rrezik dhe ju për të shpëtuar ato e braktisni Muhammedin a.s. atëherë mos e lini për atëherë por braktiseni që tani. Dijeni se nëse sot thoni kështu dhe atëhërë veproni ndryshe mallkimi i Allahut xh.sh. është mbi ju, pra dijeni se në të gjithë së bashku do jemi të shkatërruar në Dynja dhe Ahiret. Ndaj nëse e merrni përsipër këtë, pa menduar se çfar do që të ndodhi dhe si do të jetë situata nuk do e braktisni atë, atëherë qëndroni në besë dhe mbajeni të Dërguarin e Allahut në mesin tuaj. Betohem në Allahun se kjo barrë që ju po merrni është më mirë për ju se sa Dynjaja dhe Ahireti.'' Pasi dëgjuan këto fjalë shokët e tij medinas thanë; ''Edhe sikur të na shkatërrohet e gjithë pasuria, edhe sikur të na vritën të gjithë familjarët në kurrë nuk do të heqim dorë së mbrojturi të Dërguarin e Allahut xh. Sh. Muhammedin alejhi selam. Pra dijeni se në prej tij n andan vetëm vdekja.'' Më pas ju kthyen të Dërguarit të Allahut Muhammedit a.s. dhe i thanë ''O i Dërguari i Allahut! Çfar na pret në pas gjithë kësaj sakrifice?'' I Dërguari i Allahut ju tha ''Nëse do e mbani premtimin dhe besën e dhënë atëherë ju ja keni arritur ta fitoni kënaqsinë e Allahut dhe ju presin xhennëtët e mrekullueshme.''

Pas fjalimit të Muhammedit a.s. të gjithe Medinasit me në krye Esad bin Dhuraren dhe u betuan në Allahun xh. Sh. Se ata do ti dilnin në krah të Dërguarit të Allahut dhe nuk do e lin atë të vetëm në asnjë moment të çdo lloj sfide që ata do të përballeshin. Dhe pasi u betuan dhe ja dhanë besën të Dërguarit të Allahut një për një, burra e gra, pa dallim të gjithe të pranishmit tashmë ishin të vetëdijshëm për barrën që kishin marrë mbi supe. Pasi ju dha besa Profeti a.s. u ngrit në këmbë dhe ja nisi të ju jap porositë si vijon; **''O njërëz! Sot ju i dhatë besën Allahut dhe të Dërguarit të Tij Muhammedit alejhi selam! Tashmë erdhi koha të ktheheni pranë familjeve dhe popullit tuaj dhe kurrë mos i bëni shok e ortak Allahut suphanëhu ëe tëala sepse Ai nuk ka as shok dhe as ortak. Allahu është Një dhe nuk ka zot tjetër veç Tij. Mos hani hakun e askujt dhe mos i bëni padrejtësi askujt. Mos gënjëni, mos vidhni dhe mos bëni zina. Mos i vrisni fëmijët tuaj prej frikës së varfërisë apo prej frikës se mos ju cënohet nderi. Mos pengoni ata që bëjnë punë të mira dhe mos ju dilni krah atyre që bëjnë punë të kqia...''** Sipas transmetimeve të Imam Nësait i cili transmeton prej Ibn Abasit thuhet se; ''Prej Ensarëve (Medinasve) që ishin në bësëlidhjen e Akabes ishin edhe disa Muhaxhire (Mekkas) që gjëndeshin pranë të Dërguarit të Allahut xh. sh. Muhammedit a.s. kum ë vonë edhe ata udhëtuan për në Medina.''[101]

[101] Ibni Hishâm, Sîre, I, 438; Ibni Sa'd, Tabakât, I, 221-223; Suhejlî, Ravd-ul-unf, II, 261; Ibni Kethîr, Sire, II, 192.

Zogjtë (kumria) sillen me kryeneçësi ndaj lutjeve,
Vetëm nëse duke u lutur për ujë kapin cepin e rrobës dhe bien në gjunjë.

Duket se bilbili dëshiron të pijë gjakun me një ngjyrë,
Që të futet në natyrën e degës së trëndafilit dhe të shpëtojë.

Natyrën e tij të pastër ai e ka bërë të qartë për botën,
Duke ndjekur rrugën e Ahmedit të Zgjedhurit (Muhamedit).

I Nderuari i njerëzimit është një det i perlash së zgjedhurisë,
Që është shkaku i mrekullive kundër zjarrëvënësve të së keqes.

Për të ndriçuar lëndinën e profetësisë me freskinë e re,
Ai shfaqi një mrekulli duke nxjerrë ujë nga shkëmbi i fortë.

Mrekullia e tij është një det i pafund në këtë botë,
Nga i cili shtatëdhjetë herë më shumë ujë doli për armët e pabesimtarëve.

Me habi njerëzit kafshojnë gishtin e tyre,
Për shkak të mrekullisë së ujit që i dha Ansarëve në ditën e vështirësisë.

Hegira-Rute

Hajber
Mindese
Uyûn
Medîne-i Munevvere
Vexhme
Mesxhidi Kubâ
Jenbû Nahle
Atîk
Lugina Ranona
Ferish
Jenbû
Musejxhid
Vasita
Jetme
Bedr
Ebû Rejjik
Mehd
Ekhûl
Nesajif
Suvejrikijje
Mubejrik dhe Pusi i tyre
Karân
Mestûre
Ebvâ
HİCÂZ BÖLGESİ
Rabig
Xhuhfe
Gadîr-i Hum
Kilje/Lugina
Çader Banesat
e Ummu Mabedit
Berike
Dahâ
Sevl
Kâmil
Emlexh Lugina
Hulejs
Usfân
Hashshash
Rıdvân
Mukajtî
Hudatu'sh-sham
Kufre
Cemûm
Atife
Xhidde
Hudejbije
Mekka Mukerreme
Shpella e Sevrit
Tâif
Deti i Kuq
Rrugetimi qe ndoqi i Derguari i Allahut
Rruget e tregtareve
Shuajbe
Jelmem

HIXHRETI (EMIGRIMI)

"O shokët e mi! Tashmë erdhi lajmi (vahji) që ju të emigroni dhe Allahu xh. sh. e ka bërë Jesribin (Medinan) vënd emigrimi për ju dhe ju urdhëron që të emigroni dhe të bashkoheni me vëllezërit tuaj në Medina. Dijeni se Allahu ju ka bërë vëllezër juve me to. Allahu xh. sh. tashmë e ka bërë Medinan vënd të sigurtë për ju. Atje ju do të jetoni të lirë, në paqë dhe harmoni me njëri-tjetrin."
Hadith

Prani i Islamit nga fiset Evs dhe Hazrexh në Medina dhe dalja e fjalëve për emigrimin e myslimanëve Mekkas derjt Medinas i kishtë tronditur dhe frikësuar mushrikët në Mekka. Madje kur ata kishin mësuar besëlidhjen e dytë të Akabes ishin irrituar aq shumë sa që dhuna dhe tërrori i tyre ndja besimtarëve në Mekka kishtë aaritur kulmin. Ndërsa për besimtarët mysliman tashmë ishtë hapur një derë prej të cilës ata do ti shpëtonin dhunës dhe tërrorit mushrik. Medina për to ishtë kthyer në një ëndërr që ata mezi prisnin ta realizonin. Ndaj myslimanët kishin filluar të përgatitëshin për të nisur emigrimin që atyre do ju silltë freski, rehati dhe paqë, pra prisnin emigrimin që do ti shpëtontë nga dhuna dhe tërrori që ushtrohej mbi ta në Mekka.

Për të nisur udhën e emigrimit myslimanët erdhën tëk i Dërguari i Allahut dhe kërkuan leje prej tij. Ata ja paraqitën mendimet e tyre Muhammedit a.s. dhe kërkuan që ait ë ju jeptë leje për emigrim. Por ai i këshilloi sahabët dhe ju tha se duhet të bënin durim deri sat ë vintë leje (prej Allahut xh.sh.). Përfundimisht leja për emigrim erdhi. Atë ditë ı Dërguari i Allahut plot gëzim doli në Mekka dhe shkoi tëk shokët e tij dhe ju tha atyre; **''O shokët e mi! Tashmë erdhi lajmi (vahji) që ju të emigroni dhe Allahu xh. sh. e ka bërë Jesribin (Medinan) vënd emigrimi për ju dhe ju urdhëron që të emigroni dhe të bashkoheni me vëllezërit tuaj në Medina. Dijeni se Allahu ju ka bërë vëllezër juve me to. Allahu xh. sh. tashmë e ka bërë Medinan vënd të sigurtë për ju. Atje ju do të jetoni të lirë, në paqë dhe harmoni me njëri-tjetrin.''** Pas këtij lajmi të gëzueshëm që ju dha Muhammedi a.s. shokëve të tij ata u ngritën dhe filluan të emigronin grupe grupe drejt Medinas.[102]

Pejgamberi i Allahut Muhammedi a.s. i këshillontë shokët e tij para se ata të dilnin në emigrim. Ju thoshtë atyre se duhet të jenë të kujdeshëm dhe nuk duhet ti tregojnë askujt për emigrimin e tyre. Kështu ata duke ndjekur me përkushtim udhëzimet e Muhammedit a.s. emigronin fshehurazi dhe pa ju rënë në sy mushrikëve në Mekka. Ndër të parët që emigroi për në Medina ishtë sahabiu Ebu Seleme, i cili ishtë një ndër më të dhunuarit nga mushrikët në Mekka. Sapo mësuan mushrikët për emigrimin e myslimanëve filluan të bllokojnë rrugët e Mekkas që shkonin për në Medina dhe këdo që zinin e dhunoni, ata që ishin pa mbështetjë i burgosnin, i ndani gratë nga burrat dhe burrat nga gratë. Pra mushrikët filluan të përdorin të gjitha rrugët dhe metodat që mund të ndalonin emigrimin e myslimanëve nga Mekka për në Medina. Mushrikët kishin frikë të derdhnin gjakun e kujtdo prej myslimanëve pasi friksoheshin nga revelta e përgjithshme ndaj ata kishin zgjedhur rrugën e dhunës dhe burgosjes. Por myslimanët as që i pëngontë dhuna dhe tërrori i mushrikëve, ata sapo gjenin mundësinë dilnin nga Mekka dhe merrin rrugën e emigrimit.

Ai që nuk ju trembej mushrikëve dhe që mushrikët kishin frikë prej tij ishtë Omeri radaijallahu anhu. Omeri r.a. një ditë doli në Qabe, bëri ritin e tavafit dhe pasi përfundoi nxorri shpatën nga brezi dhe ju drejtua mushrikëve, të cilët gjëndeshin aty rreth Qabes. Ai ju drejtua atyre me zë të lartë; **''Unë për ti dal zot fesë timë, sot**

[102] Ibni Sa'd, Tabakât, I, 226; Taberânî, Mu'cemu'l Kebîr, VIII, 31; Bejhekî, Delâil-un-Nubuvve, II, 394.

po nisem për në Medina! Kush është trim që dëshiron ta lërë gruan pa burrë, fëmijët pa prindër dhe nënat pa të bijtë le të më dali para dhe të më pengoi nga emigrimi...'' Askush nuk pati guximin ti kthej përgjigje Omerit r.a. dhe kështu ai së pashku me një grup myslimanësh në mest ë ditës dhe në sy të mushrikëve mori rrugën dhe u nis për në Medina. Askush nuk kishtë guxuar ti dal para apo ti thotë ndonjë fjalë atij.

Emigrimi i myslimanëve tashmë ishtë bërë i pa ndaluar, ata nga dita në ditë udhëtonin grupe grupe drejt Medinas. Kishtë ardhur koha që edhe Ebubekri r.a. të bëhej gati për emigrim. Ndaj ai erdhi tëk i Dërguari i Allahut dhe kërkoi leje prej tij që të nisej për në Medina. Por i Dërguari i Allahut xh. sh. Muhammedi a.s. i tha; **''O Besnik! Bëj durim. Në Dashtë Allahu xh. sh. ti nuk do jesh i vetëm nëpër rrugët e emigrimit.''** Kur dëgjoi këto fjalë Ebubekri u gëzua tëj mase, sepse ai kuptoi që nuk do të emigrontë i vetëm por do të udhëtontë me të Dashurin e Allahut dhe me të dashurin e universit Muhammedin aelhi selam. Dhe kur i tha Muhammedi a.s. Ebubekrit radijallahu anhu se duhej të përgatistë emigrimin për dy përsona ai u ngrit dhe prej gëzimit bleu dy deve dhe po pristë lajmin nga i Dërguari i Allahut Muhammedi a.s. për ditën e emigrimit.

"O i Dërguar i Allahut! Betohem në Allahun që ty të ka dërguar me fenë e vërtetë dhe si pejgamber të vërtetë, se do të doja që çdo fatkeqësi që mund të të ndodhë ty, të më ndodhë mua në vendin tënd," tha ai (Ebu Bekri)."
Ebu Bekri r.a.

Tashmë në Mekka kishin mbetur I Dërguari i Allahut Muhammedi a.s. shoku, miku i tij besnik Ebubekri, Aliu r.a., të moshuarit dhe ata mysliman që mbanin të burgosur mushrikët. Ndërsa ata që kishin emigruar në Medina ishin mirëpritur nga Medinasit (Ensarët) më mire se ata e kishin parashikuar. Tashmë në Medina ishtë ndërtuar bashkësia e myslimanëve dhe prisnin me padurim ardhjen e Muhammedit a.s. Ndërsa nga ana tjetër Mekasit ishin tëpër të shqëtësuar sepse tashmë ata e dinin që së shpejti edhe Muhammedi a.s. do ta braktistë Mekkan dhe do të udhëtontë për në Medina. Ndaj paria mushrike mblodhi kuvendin në Darun-Nëdva dhe filluan të diskutimet për moslejimin e emigrimit të Muhammedit alejhi selam. Aty u shtruan disa propozime por askush nuk arrintë të pajtohej me të njëjtin propozim. Një i moshuar që ndodhej aty në mesin e tyre, (sipas transmetimeve dhuhet se ishtë shejtani lanëtullahi alejhi në paraqitjen e të moshuarit Shejhi Nëxhdi). Mori fjalën dhe propozoi se; ''Muhammedi është një njëri që këto që ju thoni nuk e mposhtin Muhammedin (a.s.) ndaj ofroni diçka që në do të pajtohemi të gjithë bashkë.'' Pas tij fjalën e mori Ebuxhehli dhe tha; ''Të përzgjedhim nga seçili fis nga një ose dy ushtarë dhe të gjithë së bashku ta godasin me shpatë dhe ta vrasin Muhammedin a.s. kështu që askush nuk do ketë mundësinë dhe fuqinë të hakmerrët për gjakun e tij. Sepse nuk do të kuptohet se cili pjestarë i të cilit fis e vrau atë. Ndaj të gjithë së bashku paguajmë çmimin e gjakut dhe shpëtojmë prej tij.'' Sipas transmetuesve thuhet se ky propozim nuk ishtë i Ebuxhehlit por ishtë propozimi i shejtanit lanëtullahi alejhi (mallkimi i Allahut qoftë mbi të).[103]

Kur mushrikët po bënin planët për vrasjen e të Dërguarit të Allahut xh.sh. Xhibrili a.s. kishtë ardhur dhe e kishtë lajmëruar atë (të Dërguarin e Allahut xh.sh.) për rrezikun që i kanosej nga mushrikët dhe i kishtë thënë që atë natë të mos flintë në krevatin e tij. Por në shtarit të tij të lintë Aliun radijallahu anhu dhe ti lintë porosi atij që ti dorëzontë emanëtët pronarëve që i përkisnin. (Mushrikët edhe pse nuk e donin të Dëerguarin e allahut Muhammedin a.s. pasuritë e tyre ja linin atij emanët që ait ë

[103] Ibni Hishâm, Sîret, I, 124; Ibni Sa'd, Tabakât, I, 227.

kujdesej për to. Këtë ata e bënin sepse e dinin që Muhammedi a.s. ishtë njëri i besës dhe çfar do që atij ti lihej emanët ai kujdesej më shumë se sa kujdesej për vetën dhe pasurinë e tij). Tashmë kishtë ardhur leja për emigrim (Hixhret) ndaj Muhammedi a.s. atë natë në shtratin e tij la Aliun r.a. dhe i la atij porosi që ti dorëzontë emanëtët pronarëve që i përkisnin. Më pas Muhammedi a.s. doli nga shtëpia e tij dhe shkoi tëk Ebubekri i cili e pristë gati për emigrim. Sipas disa transmetimeve thuhet se; në kohën kur doli Muhammedi a.s. nga shtëpia, pa ushtarët e mushrikëve që kishin rrethuar shtëpinë e tij dhe prisnin kati për sulm. Por nata i kishtë lenë në një gjumë aq të thellë sa që kur doli Muhammedi a.s. ata askush nuk e kishtë dëgjuar. Madje Muhammedi a.s. ju kishtë hedhur dhe nga koka ata prap nuk ishin ndjerë. Atë natë zbritën ajetët e para të sures Jasin ku në ajetin 9 Allahu xh. sh. thotë; **''Dhe atyre ju kemi vendosur një pengesë para edhe një pengesë mbrapa dhe (po ashtu) u kemi vënë përde, prandaj ata nuk shohin.''**

Mushrikët prisnin mesnatën që ata të gjithë së bashku ta sulmonin në gjumë Muhammedin a.s. dhe kur arriti mesnata dikush prej tyre ishtë zgjuar dhe thirri të tjerët duk ju thënë se erdhi koha që të sulmonin Muhammedin a.s. pasi mesnata po kalontë. Kur ata u vërsulën në dhomën e Profetit Muhammed dikush prej tyre tha mos e sulmoni pa e parë atë në sy, por kur hapën jorganin dhe panë në shtrat Aliun r.a. ata u tmerruan pasi nuk e prisnin një gjë të tillë. Menjëherë dolën prej aty dhe shkuan ti jepnin lajmin mushrikëve (parisë Mekkase) se Muhammedi a.s. nuk ndohej në shtëpinë e tij por kishtë marrë rrugën e mërgimit.

Në mëngjes mushrikët u mblodhën në Qabe duke marrë edhe Aliun r.a. të cilin e mbajtën peng për një kohë të shkurtër[104] dhe filluan të diskutojnë për stratëgjinë që të gjenin dhe ekzekutonin Muhammedin alejhi selam. Pas diskutimeve të shumta Ebuxhehli u ngrit dhe tha ''kush e gjen Muhammedin dhe shokun e tij Ebubekrin do ti jepen 100 deve''. Pasi dëgjuan mushrikët për këtë çmim u ngritën dhe nisën të kërkojnë në çdo cep të Mekkas Muhammedin alejhi selam dhe Ebu Bekr Es-Sidikun radijallahu anhu.

I dërguari i Allahut, kur shkoi në shtëpinë e Ebu Bekrit dhe i tha: **"Erdhi leja për të emigruar në Medina."** Ebu Bekri, me emocion pyeti: ''O i Dërguar i Allahut! Pluhuri i këmbëve të tua u bëftë dritë për fytyrën tim. Por a do të jem edhe unë me ju?" I dërguari i Allahut u përgjigj: **"Po..."** Ebu Bekri, nga gëzimi filloi të qante dhe mes lotëve tha: "Nëna dhe babai im, madje edhe jeta ime qofshin të sakrifikuara për ty, o i Dërguar i Allahut! Devetë janë gati. Zgjidhni cilën të dëshironi". Ndërsa i dashuri i universit i tha: **"Unë nuk hipi në deve që nuk është e imja. (Por) do ta blej atë me para"**.

Përballë këtij urdhri të prerë të Pejgamberit, Ebu Bekri, i detyruar, tregoi çmimin e devesë. Më pas Ebu Bekri thirri një person të quajtur Abdullah bin Urejkit, ai njihej si udhërrëfyes i famshëm. Këtë e punësoi Ebu Bekri për ti treguar rrugën dhe e urdhëroi atë që t'i sjellë devetë pas tre ditësh në shpellën e malit Sevr. Në vitin e trembëdhjetë të Bi'setit, më 27 të muajit Safer, ditën e enjte, Profeti ynë i Dashur dhe Ebu Bekri u nisën duke marrë me vete pak ushqim. Ebu Bekri, rrotullohej rreth Profetit a.s., herë në të djathtë, herë në të majtë, herë para tij dhe herë pas tij. Kur Profeti e pyeti pse po e bënte këtë, ai u përgjigj: ''Për të parandaluar çdo rrezik që mund të vijë nga përreth. Nëse do të ndodhë diçka e keqe, le të më ndodhë mua

[104] Suheylî, Ravd-ul-unf, II, 309

i pari. Jeta ime është e sakrifikuar për ty, o i Dërguar i Allahut!" pas këtyre fjalëve I Dashuri i universit i tha: **"O Ebu Bekr! A dëshiron që ndonjë fatkeqësi që mund të më ndodhë mua, të ndodhë ty në vendin tim?"**

"Oj Mekka! Betohem në Allahun! Se ti je vëndi më i bekuar që ka krijuar Allahu në tokë, njëkohësisht ti je vëndi më i dashur i Allahut xh.sh.! Nëse nuk do më dëbonin prej tëje unë kurrë nuk do të largohesha prej tëje. Për mua nuk ka vënd më të dashur dhe me të bekuar se ti. Nëse popylli im nuk do më dëbontë prej tëje unë kurrë nuk do të kisha zgjedhur shpërnguljen drejt një vendi tjetër. Madje as nuk do të preferoja të jetoja në një vënd tjetër."
Hadith

''Po, o i Dërguar i Allahut! Betohem në Allahun që ty të ka dërguar me fenë e vërtetë dhe si pejgamber të vërtetë, se do të doja që çdo fatkeqësi që mund të të ndodhë ty, të më ndodhë mua në vendin tënd," tha ai (Ebu Bekri).[105]

Kur arritën tëk shpella Ebubekri r.a. tëntoi të futëj i pari në të dhe të kontrollontë mbrënda saj se mos kishtë ndonjë rrezik. Kur vuri re Muhammedi a.s. këtë përkujdesje të Ebubekrit r.a. ju drejtua atij dike i thënë; **''O Besnik! A po të dhimbesm më shumë unë se vetja? që po përpiqësh të rrezikosh çdo moment?''** Ebu Bekr es-Siduku r.a. ''Po o i Dërguari i Allahut! Betohem në atë që ka zbritur fenë e vërtë Islamin, njëkohësisht Ai që të ka dërguar ty Pejgamber se më shumë se jeta më dhimbsesh ti.''

Ata të dy u futën në shpellë she përsa kohë ishin aty mushrikët nuk kishin lënë cep të Mekkas dhe rrugëve që shkonin për në Medina pa kërkuar. Çdo kërkim i tyre ju kishtë shkuar bosh sepse ata nuk kishin rastisur qoftë edhe me një gjurmë të tyre. Madje ata kishin marre nën përndjekje edhe të afërmit e Ebubekrit r.a. dhe të Dërguarit të Allahut Muhammedit a.s. por edhe prej tyre nuk ja kishin arritur të rastisin në ndonjë gjurme. Për këtë ata kishin filluar të kontrollonin edhe shpellat nëpër malet për rreth. Kur erdhën tëk shpella ku gjëndej i Dërguari i Allahut dhe shoku i tij Besnik Ebubekri r.a. por kur erdhën aty vunë re se gryka e shpelles ishtë e mbyllur nga foleja e marimanges dhe në hyrje gjëndej edhe fole pëllumbash. Gjurmuesit kur panë folenë e marimanges thanë ''është e pa mundur që ata të kenë hyrë këtu, sepse pot ë hynin ata këtu do të prishej foleja e marimangës!'' Kur njëri prej mushrikëve propozoi që ata të futëshin në shpellë mushriku Umeyye bin Halef tha; ''A mos vallë keni luajtur mendësh! A nuk e shihni që foleja e marimangës duket sikur është ndërtuar që në kohën kur ende nuk kishtë lindur Muhammedi (alejhi selam)!''

Kur mushrikët ishin afruar tëk hyrja e shpellës dhe fjalët e tyre dëgjoheshin nga brënda, Ebubekri duke menduar se ata tashmë i kishin gjetur mushrikët u friksua shumë dhe po mendontë se si do ta mbrontë të Dërguarin e Allahut para tyre. Tashmë dihej që nëse mushrikët do ti gjenin ata do ti ekzekutonin në vënd. Pra ishtë vendosur një çmim i majmë për kokat e Ebubekrit dhe të Dërguarit të Allahut ndaj mushrikët kishin dalur për ti ekzekutuar ata. Kur vuri re Muhammedi a.s. se Ebubekri po trembej ju drejtua atij **''O Ebu Bekr mos ki frikë! Pa dyshim që Allahu është me në... O Ebu Bekr mos ki pikë meraku sepse i treti i dy përsonave është Allahu xheleshanuhu. Ndaj mos u tremb! Pa dyshim që Allahu është me në.''** Ndërkohë mushrikët ishin larguar prej aty pa u futur në shpellë.[106]

Allahu xh.sh. në Kur'anin Famëlartë këtë ngjarje e ka përmendur në suren Et-Tëvbe ajeti 40 në të cilin Allahu thotë; **Nëse ju nuk ndihmoni atë (pra, të Dërguarin), Allahu (vetëm) e ka ndihmuar atë (edhe më parë), kur atë**

[105] İbni Sa'd, Tabakât, I, 230; İbni Asâkir, Tarih-i Dımeshk, XXX, 78.
[106] Muslim, Fedhâilu's-Sahâbe, 1; Tirmidhî, Tefsîru'l- Kur'ân10; İbni Sa'd, Tabakât, I, 228; İbni Ebî Sheybe, Musannef, VII, 471; VIII, 459.

e dëbuan mohuesit, kur ai ishtë njëri prej të dyve, kur ata të dy ishin në shpellë, kur ai i thoshtë shokut të vet: "Mos u brengos, Allahu është me në". Pra, Allahu zbriti qëtësinë e Tij mbi të, e ndihmoi me një ushtri që nuk e keni parë, kurse fjalën e atyre që mohuan e çoi poshtë. Fjala e Allahut është ajo që është më e larta dhe Allahu është i Plotfuqishëm, i Urtë[107].

Peygamberi ynë i Dashur së bashku me Ebu Bekrin në këtë shpellë qëndruan plot tre ditë dhe tre nëtë. Abdullahu i biri i Ebu Bekrit çdo natë vintë në shpellë dhe ju silltë lajmet që dëgjontë në Mekka, ndërsa shërbëtori dhe çobani i Ebu Bekrit Amir bin Fyhreje për të fshirë gjurmët dhe për ti ushqyer me qumesht i silltë delet rreth shpelles. Në ditën e katërt Pejgamberi a.s. i hipi deves së tij e cila quhej Kusva dhe u largua prej shpellës Sevr. Sipas një transmetimi në devenë e Pajgmaberit a.s. hipi dhe Ebu Bekri. Ndërsa në devenë e Ebu Bekrit hipi Amr bin Fyhri dhe Abdullah bin Yrejkët, të cilit i dinin mirë rrugët e Mekkas që shokin për në Medina. Kështu i Dashuri ynë Muhammedi a.s. me plot mërzi po largohej prej vendit më të dashur të tij, pra po largohej nga Mekka. Ai a.s. mërzinë e tij do e shprehtë me fjalët; **''Oj Mekka! Betohem në Allahun! Se ti je vëndi më i bekuar që ka krijuar Allahu në tokë, njëkohësisht ti je vëndi më i dashur i Allahut xh.sh.! Nëse nuk do më dëbonin prej tëje unë kurrë nuk do të largohesha prej tëje. Për mua nuk ka vënd më të dashur dhe me të bekuar se ti. Nëse popylli im nuk do më dëbontë prej tëje unë kurrë nuk do të kisha zgjedhur shpërnguljen drejt një vendi tjetër. Madje as nuk do të preferoja të jetoja në një vënd tjetër.''**

Mërzinë e Pajgamberit a.s. që ndjentë për daljen nga Mekka do e qëtëspntë Xhebraili a.s. i cili i rikujtoi ajetin 85 të sures Kasas ku e përgozinin atë (Muhammedin a.s.) për rikthimin në Mekka.

Udhëtimi po ju kalonte në qetësi. Idhujtarët, megjithëse po kërkonin kudo, nuk po arrinin t'i gjenin. Allahu i Madhëruar po e mbronte të Dërguarin e Tij nga të këqijat e mushrikëve. Kur i Dërguari i Allahut arriti në vendin e quajtur Kudejd, aty ndaluan përpara çadrës së një gruaje të quajtur Ummu Mabed, ajo njihej për bujarinë, mençurinë dhe ndershmërinë e saj. Ata kërkuan që prej saj të blejnë hurma dhe mish. Ummu Mabed u përgjigj: "Nëse do të kishim ushqim, nuk do t'ju kërkoja para, por do t'ju shërbeja falas. Për shkak të thatësirës dhe varfërisë, nuk më ka mbetur asgjë." Kur ata e pyetën nëse kishte qumësht, ajo u përgjigj: "Jo, bagëtitë janë pa qumësht." Atëherë, Sundimtari i botës, pa një dele të dobët pranë çadrës dhe tha: **"O Ummu Mabed! Pse është e lidhur kjo dele këtu?"** Ajo u përgjigj: "Është shumë e sëmurë dhe e dobët, kështu që nuk mundi të ndiqte kopenë. Nuk ka fuqi për të shkuar më tej." Profeti e pyeti: **"A ka qumësht? A më lejon ta mjel?"** Ummu Mabed tha: "Nëna dhe babai im qofshin të sakrifikuar për ty, nuk ka qumësht, por nuk të pengoj që të provosh ta mjelësh atë." Atëherë, i Dërguari i Allahut iu afrua deles dhe përmendi emrin e Allahut. Pas një lutjeje për bereqet, ai preku me dorën e tij të bekuar gjirin e deles, dhe menjëherë u mbush me qumësht që filloi të rrjedhë. Ata sollën një enë dhe e mbushën atë. Së pari i dhanë të pijë Ummu Mabedit, pastaj Ebu Bekrit dhe të tjerëve derisa u ngopën të gjithë. Në fund, piu vetë i Dërguari. Pastaj, ai preku përsëri gjirin e deles dhe kërkoi një enë më të madhe për ta mbushur, dhe e dorëzoi atë tek Ummu Mabed. Sipas rrëfimeve, ajo dele jetoi tetëmbëdhjetë vjet, dhe familja e saj jetonte me të falë bereqetit të të Dërguarit të Allahut.

[107] Et-Tevbe 40.

Pasi u larguan ata, erdhi burri i Ummu Mabed dhe e pa qumështin. Nga lumturia e pyeti: "Nga erdhi ky qumësht?" Ummu Mabed u përgjigj: "Një person i bekuar erdhi dhe e nderoi çadrën tonë. Gjithçka që po sheh është për shkak të ndihmës dhe bereqetit të tij." Burri e pyeti: "A mund ta përshkruash? Si duket ai?"

Ummu Mabed tha: "Njeriu i bekuar që pashë ishte shumë i bukur dhe me një fytyrë të ndritur. Kishte pak të kuqe në sytë e tij dhe një zë të butë. Qerpikët e tij ishin të gjatë, e bardha e syve shumë e pastër dhe e zeza e tyre shumë e thellë, dukej sikur të ishte lyer natyrshëm. Flokët e tij ishin të zeza dhe mjekra e tij e dendur. Kur heshtte, kishte një qëndrim të qetë dhe dinjitoz. Kur fliste, buzëqeshte, dhe fjalët e tij rridhnin si perla të vendosura bukur në gojën e tij. Nga larg, dukej madhështor dhe plot respekt, por kur afroheshe, bëhej shumë i këndshëm dhe tërheqës. Ata që ishin me të, vraponin me shpirt për të zbatuar urdhrat e tij." Burri, pasi dëgjoi përshkrimin, tha me habi: "Betohem që ky njeri është ai që Kurejshët po kërkojnë. Nëse do ta kisha takuar, do ta kisha nderuar duke i shërbyer dhe nuk do të isha larguar prej tij." Burri i Ummu Ma'bed shkoi pas të Dërguarit të Allahut, e arriti atë në luginën e Rim-it dhe u bë mysliman, duke u nderuar si një sahab. Më vonë, edhe Ummu Ma'bed u bë myslimane. Mushrikët e kishin kërkuar Të Dërguarin e Allahut në çdo cep por nuk kishin arritur ta gjenin. Allahu e kishtë ruajtur Të Dërguarin e Tij prej sherrit të mushrikëve. [108]

Surâka bin Mâlik

Mushrikët pandërprerë ishin në kërkim të Muhammedit a.s. dhe Ebu Bekrit të cilët ishin nisur drejt Medinas. Mushrikët ishin të vetëdijshëm se nëse nuk do i gjenin ata (mushrikët) i pristë një rrezik i madh. Sepse tashmë ata e dini që myslimanët do të ndërtonin shtëtin e tyre, pra **shtetin Islam,** dhe do i luftonin mushrikët. Kjo ishtë arsyeja që mushrikët kishin vendosur çdo gjë në dispozicion për gjetjen e Muhammedit a.s. dhe shokut të tij besnik Ebu Bekrin r.a.. Pas shumë kërkimesh ata nuk ja kishin arritur të gjenin Muhammedin a.s. ndaj në fund ata premtuan se kush i gjen ata të gjalle apo të vdekur do të shpërblehet me 100 deve dhe me shuma të majme monëdhash.

Kur kishtë dëgjuar Syraka bin Malik për këtë premtim të majmë të mushrikëve kishtë dalur në kërkim të Muhammedit a.s. dhe Ebu Bekrit r.a.. Syraka ishtë një gjahtar i mirepërgatitur dhe dintë të gjitha rruget dhe stratëgjitë e udhëtimeve. Ai nuk dëshirontë që ta ndantë me ndonjë tjetër çmimin e premtuar prej mushrikëve ndaj kishtë dalur i vetëm në kërkim.

Syraka bin Malik kishtë dalur në kërkim të Muhammedit a.s. dhe Ebu Bekrit por për të mos lënë gjurme që ishtë në kërkim të tyre kishtë dalur i vetëm dhe pa i treguar armët e tij. Ai ja kishtë arritur të gjentë gjurmët e tyre dhe ju kishtë afruar aq shumë sa që dëgjontë edhe ajetët e Kur'anit që lexontë Muhammedi a.s.. Ndërsa Muhammedi a.s. nuk e kthentë kokën nga pas. Ndërsa Ebu Bekri r.a. herë herë kthentë kokën pas dhe ndiqtë udhën nga pas. Kur vuri re Ebu Bekri r.a. se pas tyre ishtë afruar Syraka bin Malik filloi të shqëtësohej. Por Pejgamberi a.s. ashtu sikur në shpellën Sëvr i thoshtë **''mos u frikëso o Ebu Bekir! Allahu është me në.''**

Sipas transmetimeve të Buhariut rahimehullahu alejh kur e pa Ebu Bekri r.a. Syrakën e lajmeroi Pejgamberin a.s. që po afrohej Syraka. Pejgamberi a.s. u lut **''O Zot na ruaj prej sherrit të Syrakës.''** Ndërsa sipas transmetimeve të tjera thuhet

[108] İbni Sa'd, Tabakât, I, 230; Taberânî, Mu'cemu'l Kebîr, IV, 48; Beyhekî, Delâil-un Nubuvve, I, 26.

se kur e pa Ebu Bekri Syrakën filloi të shqëtësohej dhe ju mbushën sytë me lot. Kur e pyeti Pejgamberi a.s. se pse po shqëtësohej? Ai (Ebu Bekri) ''nuk shqëtësohem për vetën por shqëtësohem për ty o I Dërguari i Allahut'' ju përgjigj Ebu Bekri.

"O Syraka! Sot po shoh që në duart e tua janë vendosur bilezikët e Kisras, në qafën tënde gjerdanët e tij dhe në kokën tënde kurora e tij."
Hadith.

Ndërkohë Syraka bin Malik ishtë afruar aq pranë tyre sa që ju tha ''O Muhammed (a.s.)! kush do të mbroj sot ty prej shpatës sime!'' **''Në na ruan i Plotpushtëtëshmi Allah''** ju përgjigj Pejgamberi ynë i Dashur. Atë moment këmbët e para të kalit të Syrakës u ngullën në rërë. Syraka filloi të godistë kalin që ti afrohej me tëj Muhammedit a.s. por kali nuk i lëviztë dot këmbët prej rërës. Syraka përpiqëj të shpëtontë kalin e tij por më kot sepse kali nuk lëviztë dot prej vëndi. Pas shumë përpjekjeve ai kuptoi që nuk do shpëtontë dot prej asaj gjëndje të trishtë dhe e gjeti vetën në një vështirësi pa zgjidhje. ''O Muhammed (a.s.)! Sot kuptova se nuk ka fuqi që ty të të mposhti! Ndaj lutu për mua dhe më shpëto prej kësaj gjëndje. Nëse më ndihmon ti do jesh i sigurtë prej meje'' filloi ti kërkontë ndihmë Syraka Muhammedit a.s.. I Nëduari i universit Muhammedi a.s. u lut me fjalët**'' O Zot! Nëse ai është i sinqërtë në atë që thotë shpëtoje.''** Allahu xh.sh. e pranoi lutjen e të Dërguarit të Tij dhe Syraka së bashku me kalin e tij shpëtuan prej mbytjen në rërë.

Syraka pasi kuptoi dhe mësoi shumë gjëra nga kjo ndodhi u bind se Muhammedi a.s. ishtë i mbrojtur nga Zoti i Gjithësisë. Në fund Syraka thirri: '' O Muhammed a.s.! unë jam Syraka bin Malik nga sot e tutje dije se unë nuk do të bej qoftë edhe gjënë më të vogël kundër tëje. Dije se populli ynë ka premtuar shuma të majme për atë që të kap dhe të kthen ty tëk ato, por unë të premtoj se kushdoqë do më pyes për ty unë do të mbaj anën tëndë. Urdhëro o Muhammed kërko çtë duash prej meje.'' Ndërsa I Dërguari i Allahut ja ktheu: **''O Syraka! Përderisa ti nuk do të pranosh Islamin unë nuk kërkoj sgjë nga ti. Kthehu tëk populli yt dhe nëse të pyesin për në thuaju se në nuk jemi takuar.''**

Ndërsa Ibn Sadi këtë ngjarje e transmeton me fjalët; Syraka kërkoi nga Pejgamberi a.s. që ta urhdërontë atë me çtë dëshirontë por I Dërguari i Allahut i thotë **''kthehu në vendlindje dhe mos lejo askënd të ndjeki gjurmet tona.''**

Nuk ndodh asgjë pa lejen e Allahut xh.sh. çdo gjë është nën kontroolin dhe lejen e Tij. Syraka kishtë dalur në udhë dhe ishtë vërsulur pas Muhammedit a.s. sikur një luan i egërsuar vërsulet mbi gjahun e tij. Pra një Syraka që kishtë dalur për të vrarë Muhammedin a.s. dhe shokun e tij besnikun Ebubekir r.a. tashmë ishtë zbutur dhe ishtë kthyer në një fëmij që i bindet nënës së tij.

I Gjithëpushtëtshmi Allah kështu duke ja kthyer zemren Syrakës në butësi dhe dashuri e ruantë të Dashurin e Tij. Pa diskutim që Allahu xh.sh. të Dahurin e Tij Muhammedin alejhi selam nuk do ta lintë të vetëm. Sepse ai ishtë i Dërguari i Tij (Allahut) që e kishtë dërguar për ta drejtuar mbarë njërëzimin në rrugën e drejtë dhe për ta mëshiruar mbarë universin në dynja dhe ahiret.

Kështu Syraka bin Malik u kthye në Mekka pa i treguar askujt çfar kishtë ndodhur me të.[109]

[109] İbni Hishâm, Sîret, I, 489; İbni Ebî SHeybe, Musannef, IV, 424; Beyhekî, Delâil-yn Nybyvve, II, 346; Taberânî, Mu'cemy'l Kebîr, VII, 133; Ebû Ya'la, Mysned, I, 107. 133 Tevbe: 9/108.

Mbreti i Universit po Vjen

Pejgamberi ynë i Dashur a.s. së bashku me shokun e tij besnikun Ebu Bekir dhe dy udhërrefyesit Amr bin Fyheyre dhe Abdullah Bin Yrejkit pas një jave udhëtim. Sipas llogarive i bie 13 vjet pas shpalljes se Pejgamberllëkut dhe viti i par i Hixhretit (në vitin e 622 sipas kalendarit djellor) arriti në fshatin e quajtur **''Kuba''**. Aty u pritën nga Kylsym bin Hadmi e cila kishtë pranuar Islamin.

Profeti a.s. para se të arrij në Medina xhaminë e parë në rruzullin toksore e ndërtoi në Kuba. Xhamia u ndërtua në pronën e bijëve të Amr bin Avfit, pikërisht në atë vënd ku ata e përdornin për përpunimin e hurmave. Kjo xhami është përmendur në Kur'an pikërisht në ajetin 108 të kaptinës Tëube ku thuhet; **'' ...Padyshim se xhamia, themelet e së cilës u vunë që nga dita e parë në përkushtim është më e vlefshme që ju të rrini në të (për falje)...''** [110]

Profeti a.s. së bashku me shokun e tij besnik Ebu Bekrin r.a. në Kuba qëndruan pak dit ku pushuan dhe u qëtësuan prej lodhjes së udhëtimit të gjatë. Në natën e dymbëdhjetë të Rabiul Evelit, pikërisht natën e ditës së xhuma dolën nga Kuba dhe u nisën për në Medina. Namazin e xhumasë e falën në vëndin e quajtur Ranona, vend i cili ndodhet ndërmjet Kubas dhe Medinas. Profeti alejhi selam hutben e parë të xhumasë e ka mbajtur në Ranona dhe po atë ditë arriti në Medina.[111] Kohë më vonë në vëndin ku Profeti alejhi selam fali namazin e xhumasë u ndërtua një xhami e cila quhet **''Mesxhid-i Xhuma''**

Gjatë kësaj kohe Aliu r.a. në Mekka kishtë dalur në Qabe dhe ishtë ulur aty ku ulej I Dërguari i Allahut Muhammedi a.s. dhe thirri mushrikët që të vinin të merrnin pasuritë që ja kishin lënë emanët Muhammedit alejhi selam. Mushrikët vinin dhe pasi thonin shenjën që i kishin vendosur mbi mallin e tyre kur ja kishin dorëzuar Muhammedit a.s. i merrnin mallrat e tyre. Nëse dikush nuk e dintë ose kishtë harruar shenjën e mallit të tij nuk e merrtë dot derisa Aliu r.a. të sigurohej se ai vërtëtë kishtë diçka për të marrë. Dhe kështu të gjithë e kishin marrë malllin e tyre dhe askush nuk kishtë mbetur pa e marrë atë që ja kishtë lënë nën mbrojtje Muhammedit alejhi selam. Imagjino mushrikët ishin organizuar për ta vrarë Muhammedin alehi selam, madje ata e kishin detyruar atë a.s. të largohej nga Mekka, pra nga vendëlindja e tij ndërsa pasuritë e tyre të çmueshme ja kishin lënë në mbrojtje Muhammedit a.s.. Pra ata e dinin që Muhammedi a.s. nuk i tradhëtontë, as nuk ja shpërdorontë mallin, as nuk i thyentë në besë, madje mushrikët e dini që Muhammedi a.s. nuk i gënjën por kur ishtë puna ti besonin se ai ishtë i Dërguari i Allahut ata nuk i besonin[112].

Aliu r.a. pasi i dorëzoi të gjitha porositë e Muhammedit a.s. ju drejtua mushrikëve Mekkas duke ju thënë: ''Në dashtë Allahu unë nësër do të nisem për në Medina. Nëse dikush ka diçka për të thënë le të dal këtu në shesh të burrave dhe ta thotë. Pra nëse keni diçka për të më thënë dilni dhe ma thoni në sy.'' Askush prej mushrikëve nuk guxoi ti dal para Aliut r.a.

Të nësërmen në mëngjes Aliu r.a. mblodhi plaçkat e tij dhe u nis për në Medina. Gjatë rrugës i dolën para një grup mushrikësh prej 4-5 vetash por nuk ja arritën ta ndalin Aliun r.a. që ait ë mos udhëtontë për në Medina. Sipas transmetimeve

[110] Tevbe: 9/108.
[111] İbni İshâk, İbni Hishâm, Sire, II, 146, 147; Eby'l-Fidâ, Bidâye ven-nihâye, II, Taberî, Târih, II, 255, 256; Eby'l-Fidâ, el-Bidâye ven-nihâye, III, 213, 214.
[112] İbni İshâk, İbni Hishâm, Sire, II, 146, 147; Ebu'l-Fidâ, Bidâye ven-nihâye, II, Taberî, Târih, II, 255, 256; Ebu'l-Fidâ, el-Bidâye ven-nihâye, III, 213, 214.

> *"Dhe nga njerëzit është edhe ai i cili e shet veten e vet (e mohon vetveten) duke kërkuar Kënaqësinë e Allahut. Dhe Allahu është plot mirësi ndaj robëve (të Tij)."*
> ***Bakara 207***

Aliu r.a. Pejgamberin tonë të dashur e zuri kur ai ishtë ende në Kuba dhe udhëtuan së bashku për në Medina. Kur u takua Pejgamberi alejhi selam me Aliun r.a. dhe e pa atë të rraskapitur prej udhës së gjatë u ju lut Allahut xh.sh. që ta begatontë Aliun r.a. me miresitë e Tij. Sipas transmetimeve[113] thuhet se në Kur'an për sakrificat e Aliut r.a. ka zbritur ajeti 207 i kaptinës Bakara ku thuhet se: **''Dhe nga njërëzit është edhe ai i cili e shet vetën e vet (e mohon vetvetën) duke kërkuar Kënaqësinë e Allahut. Dhe Allahu është plot mirësi ndaj robëve (të Tij)**.''[114]

Sahabët që kishin migruar më parë në Medina dhe medinasit që kishin pranuar Islamin kur të gjuan për migrimin e Muhammedit a.s. drejt tyre kishin filluar të nxirrnin vëshgues nëpër rrugët që vinin nga Mekka dhe prisnin me padurim ardhjen e tij (Pejgamberit alejhi selam). Malli dhe dashuri ndaj Pejgamberit aljehi selam ju kishtë kapluar zemrat aq shume sa që kur dëgjuan zërat e lajmëtarëve që thërrsinin **''Po vjen! Po vjen..!**'' lanë gjithçka kishin në duar dhe filluan të vraponin andej nga vinin zërat ''Po vjen! Po vjen!'' Madje as rrezet e forta të diellit, as rëra e tëjnxehur dhe as vapa e paduruar nuk i kishtë ndalur sahabet të vraponin drejt lajmëtarëve që lajmëronin për ardhjen e Muhammedit alejhi selam.

Po vijnë!... Po vijnë!... thërrsinin zërat që tingullonin plot gëzim nëpër rrugët e Medinas. ''Urime!... Urime!... po vjen i Dërguari i Allahut!... Po vjen Pejgamberi ynë i Dashur!.. Përgëzime o Medinas sot është dita e gëzimit tonë! I Dashuri i Allahut po vjen!.Po vjen **Elemini..**'' këto zëra filluan të dëgjohen ngado nëpër rrugicat e Medinas.

Ardhja e Muhammedit alehiselam në Medina, nga më i vogli deri tëk më i madhi, për të gjithë ishtë krijuar një ambjent gëzimi. Medinasit kishin dalur nëpr rrugët e Medinas dhe po prisnin ardhjen e Pejgamberit tonë të dashur. Medinasit me lot gëzimi falenderonin dhe madjëronin Allahun suphanëhu ve tëala. Medina po përjetontë një ditë historike. Atë ditë gëzimi dhe hidhërimi ishin bashkuar dhe po prisnin ardhjen e njëriut të cilin Allahu xh.sh. e kishtë dërguar mëshirë për mbarë universin. Medinasit prinin me padurim të shihnin fytyrën e njëriut që i kishin besuar pa e parë atë (Muhammedin alejhi selam). Ndërsa myslimanët Mekkas që kishin ardhur para Muhammedit alejhi selam po prisnin me plot mallëngjim të shihnin fytyrën e njëriut (Muhammedit alejhi selam) për të cilin kishin sakrifikuar dhe flijuar edhe me të dashurit e tyre. Pra kjo ishtë ajo dita kur të gjithë njëzëri recitonin vargjet e mëposhtme:[115]

Tale'al-bedru 'alejnâ,
Min senijjâti'l-vedâ',
Vecebe'sh-shykry 'aleynâ,
Mâ de'â-lillahi dâ'.

'Ejjhe'l-meb'ûsy fînâ,
Xhi'të bil-'emri'l-mutâ',
Xhi'të sherraftë'l-Medînë,
Merhaben jâ hajra dâ'.

[113] Ibni Esîr, Usudy'l-gâbe, IV, 96; Halebî, Insân-u'l-uyûn, II, 233.
[114] Bekara: 2/207.
[115] 137 Beyhekî, Delâil-yn-nybyvve, V, 351; Ibni Kesîr, Sire, II, 269; SHemseddin SHâmî, Sy-byly'l-Hydâ, III, 278.

Entë shemsun, entë bedrun,
Entë nûrun â'lâ nûr,
Entë misbâhu's-Sjrejjâ,
Jâ Habîbi, Jâ Resûl!

Kad lebithnâ thevbe 'idhin,
Ba'de esvâbi'r-rika',
Ve rada'nâ sedje mexhdin,
Ba'de ejjâmi'd-dajâ'.

Kaalet ahmâru'd-dejâxhî,
Kulli erbâbil-İslâm,
Kjllj men jetba' Muhammed,
Jenbeğî en lâ jjdâm.

Ve të'âhednâ cemîan,
Jevme aksemnë'l-jemîn,
Len nëhûnë'l ahde jevmen,
Vettëhaznë's-sıdka dîn.

Lestë vallahi nëzijjen,
Mâ jukâsîhi'l 'ibâd,
Meshheden jâ nëcme emnîn,
Zû vebâin ve vidâd.

Nga Thenijati na doli hëna e plotë
falënderimi na u obligua derisa të mbetët ndonjë thirrës i Allahut
O ti i Dërguar mes nësh!
Të bindemi në çdo urdhër që na jep.
...
Nga Senejet-ul-Veda,
Badr ndriçoi mbi ne,
Sa herë që thërrisni për të vërtetën,
Ne jemi të detyruar të falënderojmë.

Ti u dërgove tek ne,
Solle urdhrin e Allahut,
Mirë se erdhe në Medinë,
Ftesa jote na nderon.

Ti je diell, ti je hënë,
Ti je dritë mbi dritë,
Ti je ndriçimi i yllit të Suresë,
O i dashur, o i Dërguar.

Jemi mbushur me nder dhe bujari,
Jemi çliruar nga e kaluara,
Jemi ngopur me madhështi,
Ishim në humbje, por gjetëm fitimin.

Hëna që largon errësirën thotë,
Përshëndetje për njerëzit e paqes,
Ata që ndjekin Muhamedin (alejhisselam),
Kurrë mos i bëni padrejtësi.

Të gjithë së bashku dhamë fjalën,
Në ditën e betimit,
E vërteta është rruga jonë,
Nuk ka pabesi në fe.

Betohem për Allahun, nuk e harroj,
Nuk kishte ditë pa dhembje,
Ylli i sigurisë është dëshmitar,
Dashuria dhe besnikëria jote ishin të mëdha.

Në Medinë, Profeti Muhammed a.s. nuk hyri nga lindja, andej nga shfaqëj hëna e plotë. Medinasit në këto vargje tregonin që hëna e vërtëtë është ajo shpirtërore dhe se ata, deri më tani, jetonin në errësirë. Ata thonin një zëri **mirëseredhe o Resulullah**. Tashmë atyre tani u kishtë lindur hëna, për herë të parë, në drejtimin ku zakonisht nuk shfaqëj. Dita kur Profeti Muhammedsa kishtë hyrë në Medinë ishtë e hënë. Ditën e hënë ai kishtë dalë nga shpella Theur dhe çuditërisht po ditën e hënë ai do ta triumfontë Mekkën.

Kur Muhammedi a.s. hyri në Medinë, çdo njëri dëshirontë që Profeti a.s. të qëndrontë në shtëpinë e tij. Hareja i kishtë mbështjellë të gjithë. Ngado që kalontë deveja e tij, familjet e asaj rrugice dilnin për ta mirëpritur dhe për t'i thënë: **"Urdhëroni o i Dërguar i Allahut në shtëpinë tonë. U flijoftë jeta dhe pasuria jonë për ju! O i Dërguar i Allahut! Jemi të aftë t'ju mbrojmë. Qëndroni në shtëpinë tonë!".** Disa prej tyre dilnin përpara nga gëzimi dhe përpiqëshin t'ia kapnin frerin devesë së tij, në mënyrë që ta ndalnin të shtëpia e tyre. Por Profetisa çdokujt i thoshtë**: "Lëreni devenë time. Sot ajo drejtohet nga Zoti i Madhërishëm dhe do të ndalet atje ku dëshiron Ai"**. Më në fund, deveja u ndal në një truall, që u përkistë bonjakëve të Benu Nëxharit**. "Duket se dëshira e Zotit të Lartësuar është që në të qëndrojmë këtu"**, u shpreh Profetisa. Pastaj pyeti se i kujt ishtë trualli. Kujdestari i jetimëve doli përparadhe iu përgjigj se trualli ishtë i këtyre jetimëve, por ai tashmë ishtë në shërbim të të Dërguarit të Allahutsa. Profetisa refuzoi ta merrtë tokën pa pagesë. Iu caktua një çmim dhe Profetisa e mori atë për të ndërtuar xhaminë dhe shtëpinë e tij.

Deveja e Pejgamberit a.s. Kusva përfundimisht u ndal në vendin ku sot ndodhet porta e xhamisë së të Dërguarit të Allahut (Paqaja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të). Por I Dërguari i Allahut, paqja qoftë mbi të, nuk zbriti nga deveja. Pastaj deveja u ngrit përsëri dhe filloi të ecë, por më pas u ndal në të njëjtin vend dhe nuk u ngrit më. Atëherë, Profeti ynë i Dashur zbriti nga Kusva dhe tha: **"Inshallah, ky është vendi ynë i ndalesës"** dhe pyeti: **"Kujt i përket ky vend?"** Ata u përgjigjën: "O i Dërguar i Allahut! Ky vend i përket djemve të Amrit, Suhejl dhe Sehl." Këta fëmijë ishin jetimë. Profeti ynë më pas pyeti: **"Cila shtëpi e të afërmve tanë është më afër këtij vendi?"** Ai pyeti sepse gjyshja e të Dërguarit të Allahut, pra nëna e Abdulmutalibit ishte nga fisin Nexh-xhar. Halid bin Zejd, Ebu Ejub el-Ensari, me gëzim tha: "O i Dërguar i Allahut! Shtëpia ime është më afër. Duke treguar me emocion deren e saj thanë, ja, kjo është shtëpia ime dhe kjo është dera e saj."[116]

Ata zbrazën barrën e Kusvës dhe i Dërguari i Allahut hyri në shtëpi. Myslimanët e Medinës dhe Muhaxhirët u gëzuan shumë për ardhjen e të Dërguarit të Allahut. Ky vit njihet si **"viti i lejimit (senet-ul-idhin)."** Në kohën e Hixhretit, balsami i zemrave dhe kurora e njerëzimit, i dashuri i Allahut, Profeti i shenjtë, ishte 53 vjeç.

[116] İbni Hishâm, Sîre, I, 346.

Ç'ËSHTË ËSHTË GJENDJA IME

Çfarë është gjendja ime, o i Dërguar i Allahut?
Digjet shpirti dhe trupi im, o i Dërguar i Allahut.

Si një tymues i ndezur dhe i zjarrtë,
Jam unë që digjem nga dashuria jote, o i Dërguar i Allahut.

Nga malli për ndarjen tënde, për një kohë të gjatë,
Unë jam ai që shkrirë e përfunduar, o i Dërguar i Allahut.

Ti je Mbreti i Levlakut, në pragun tënd të lartë,
Jam unë që përkulem me përulësi, o i Dërguar i Allahut.

Në tokën ku ke ecur, janë çelur trëndafilat,
Ndërsa unë jam gjembi në të, o i Dërguar i Allahut.

Ebû Ejjûb-el Ensârî radıjallahu anh

PËRIUDHA E MEDINËS

"Lëreni devenë time. Sot ajo drejtohet nga Zoti iMadhërishëm dhe do të ndalet atje ku dëshiron Ai"
Hadith

13 vitë pas shpalljes Hyjnore në ditën e 12 të Rebiul evvelit dhe në vitin 622 sipas kalendarit diellor Pejgamberi ynë i Dashur nisi përiudhën e Medinas. Pejgamberi a.s. në Medina preferoi të zhvendoset në katin e parë në banësën e Halid bin Zeyd Ebu Ejjub el-Ensarit.[117] Qëndrimi i Pejgamberit a.s. në banësen e sahabiut Ejub El-Ensari r.a. ishtë një nderim i madh që ju bë këtij sahabiu të nderuar. Këtë ndodhi Ejjub El-Ensari më vonë do e tranmetontë si më poshtë:

''Kur erdhi I Dërguari i Allahut në banësën tonë preferoi të banontë në katin e parë të banësës sonë. Ndëersa unë me familjen time u ngjitëm në katin e dytë. Qëndrimi ynë një kat mbi të Dërguarin e Allahut në na shqëtësontë aq shumë saqë nuk dorova dot dhe zbrita të I Dërguari i Allahut dhe i thash; O I Dërguari I Allahut qëndrimi ynë një kat mbi ty në na ka mërzitur tëj mase, na është prishur qëtësia dhe nuk ndjehemi të lumtur. O i Dërguari i Allahut të lutëm dil në katin e dytë ndersa në dalim në katin e parë. Pas këtyre fjlaëve I Dërguari i Allahut më tha; **''O Ebu Ejjub! Për në është më e lehtë dhe më e përshtatur të banojmë në katin e parë.''** I Dërguari i Allahut e shihtë të përshtatur të jetontë në katin e parë me mendimin që misafirët që vinin ta vizitonin atë të mos na shqëtësonin në. Pas disa ditësh, ndërkohë që unë më bashkëshortën ishim në katin e dytë, na u thye ena e ujit. Prej frikës se mos bie uji mbi të Dërguarin e Allahut filluam ta thajmë ujin me jorganin e vetëm që kishim. Pas kësaj ndodhie nuk na u durua më dhe zbritëm tëk I Dërguari i Allahut dhe kërkuam prej tij (alejhi selam) të diltë në katin e dytë.'' Sipas tranmetimeve të Ebu Ejubbit pas kësaj ndodhie Pejgamberi alejhi selam u transferua në katin e dytë dhe qëndroi aty për aq kohë sa jetoi në shtëpinë e Ebu Ejjub El-Ensarit.

Ebu Ejub El-Ensari transmeton se; ''në i përgatisnim ushqim e darkës Pejgamberit tonë të dashur dhe pasi ai mbarontë ushqimin na e silltë në atë që kishtë tëpruar. Unë së bashku me shkëshortën time përpiqëshim që të shijonim edhe pikën më

[117] İbni Hacer, El-İsâbe, I, 405.

Medına Dhe Rajonı Rreth Saj



"O Allah! Na e bëj ne Medinan të dashur ashtu sikur na ke bërë Mekkan. Na i shto mirësitë sikur na e ke shtuar në Mekka dhe na begato me begatitë e Tua, na e bej këtë qytet te shëndetshëm ashtu sikur na begatove ne Mekka." ***Hadith.***

të fundit nga ajo që tëprontë prej tij (alejhi selam). Kur një natë në përgatitëm një ushqim me qëpë (sipas një transmetimi tjetër, ushqimin e përgatitëm me hudhra) Pejgamberi alejhi selam na e ktheu ushqimin pa e prekur fare. Unë me bashkëshortën time sapo vumë re që ushqimi nuk ishtë prekur fare u ngjita të Pejgamberi alejhi selam dhe e pyeta? ''O I Dërguari i Allahut! Ju e kthyet ushqimin e drakës mbrapsht. Por në vumë re që ju nuk kishit vënë dorë farë në të! A mos vallë në të (ushqimin) ka ndonjë problem?'' I Dërguari i Allahut alejhi selam na tha se; **''Në përimet e ushqimit ndjeva një erë, por unë komunikoj me ëngjëllin (Xhebrailin a.s.), ndaj nuk e hëngra.''** Pas përgjigjes që mora e pyeta ''O I Dërguari Allahut a mos vallë këto përime (qëpa dhe hudhra) janë haram?'' ai (alejhi selam) ma ktheu; **''Jo! Nuk është haram por unë prej aromës nuk e preferoj atë ushqim.''** ''Atëherë edhe unë nuk e preferoj atë që ju nuk preferoni.'' I thash të Dërguarit të Allahut xh.sh. por pasi ai (aljehi selam) na tha **''Jo! Ju hajeni atë.''** Në e hëngrëm atë ushqim dhe prej asaj natë nuk i përgatitëm më Pejgamberit alejhi selam ushqim me qëpë (me hudhra).

Një natë tjetër përgatitëm ushqim që i mjaftontë pejgamberit aljhi selam dhe Ebu Bekrit radijallahu anhu dhe kur ja dërgova atyre I Dërguari i Allahut më tha: **''O Ebu Ejjub! Thirr prej Ensarëve (medinasve) të hanë ushqim me në.''** Ndërkohë që unë nisa të mendoj se mos vallë ushqimi nuk është i mjaftueshëm për Pejgamberin alejhi selam ai më tha përsëri: **''o Ebu Ejjub! Thirri ensarët të darkojnë me në.''** Unë dola prej aty dhe thirra Ensarët të darkonin me Pejgamberin alejhi selam. Prej tyre erdhen diku tëk tridhjet veta ku hëngrën ushqim me Pejgamberin alejhi selam dhe ripërtërinë besën që i kishin dhënë më parë Pejgamberit alejhi selam. Pasi ikën të parët Resulullahu tha **''thirr edhe medinasit e tjerë''** prej ensarëve erdhën edhe disa të tjerë ku darkuan me të Dërguarin e Allahut dhe ripërtërinë beslidhjen me të. Madje ait tha **thërrit edhe më prej ensarëve** Atëherë unë mësova se kjo ishtë një prej mrekullive të Të Dërguarit të Allahut xheleshanëhu.''[118]

Vllazërimi i Ensarëve (Medinasëve) me Muhaxhirët (Mekkasit)

Pejgamberi alejhi selam për të krijuar një lidhje sa më të ngushtë ndërmjet muhaxhirëve (emigrantëve Mekkas) me vëndasit (Medinasit) që ju kishin hapur dyert e mikpritjes zgjodhi rrugën e vëllazërisë. Pasi Pejgamberi alejhi selam i vëllazëroi të gjithë njëri me tjetrin në fund mbeti Aliu radijallahu anhu. Ali duke menduar se mos Pejgamberi a.s. atë e kishtë harruar i tha; ''O I Dërguari Allahut! A mos vallë më harrove mua?'' atëherë I Nderuari i universit ja ktheu; **''O Ali! Ti edhe në dynja edhe në ahiret je vëllai im.''**

Vëllazëria që ndërtoi I Dërguari i Allahut në Medina ishtë një vëllazëri e ndërtuar edhe matërialisht edhe shpirtërisht. Kështu që emigrantëve ju ishtë lehtësuar edhe dhimbja e të mbeturve larg familjarëve por edhe nga ana ekonomike ju ishtë lehtësuar barra e skamjes. Kështu që vëndasit tashmë jo vetëm që ju kishin hapur dyert emigrantëve (muhaxhirëve) por edhe pasuritë e tyre i kishin ndarë vëllazërisht me emigrantët që kishin braktisur vëndlintjet e tyrë vetëm për të përhapur fenë e Allahut Suphanëhu ve Tëala. Por edhe Pejgamberi alejhi selam vëllazërimin ndërmjet tyre e kishtë bërë në atë mënyre që ata (vendalit me emigrantët) të përputheshin

[118] Kâdî İyâd, SHifâ-i sherîf, 289.

me njëri-tjetrin sikur ata të ishin vëllezër biologjik prej një nënë dhe prej një babai.[119]

"O Ali (radijallahu anhu) edhe në dynja edhe në ahiret ti je vëllai im."
Muhammedi alejhi selam

Medinasit çdo pasuri që kishin si tokë, banësë, kopshtë dhe monëdha i ndanë më dyshë me vëllezërit e tyre Mekkas. Muhaxhiri (emigranti) Abdurrahman bin Avf transmeton se; '' kur emigruam në Medinë I Dërguari i Allahut mua më vëllazëroi me Sad bin Rebiun. Pas vëllazërimit vëllai im Sadi me tha 'o vëllai im Abdurrahman! Unë jam një ndër më të pasurit në Medina. Pasurinë që kam e ndava në dy pjesë njëra pjesë është e jotja pjesa tjetër është e imja.' Atëherë unë i thash; Allahu ta begatogtë dhe ta shtoftë pasurinë. Por unë nuk kam nëvojë për pasuri. Por mua mjafton të më tregosh tregun ku ju bëni tregëtinë tuaj.'' Kjo sakrificë vëllazërore është e mundur vetëm në vëllazërinë Islame.

Prej Ademit alejhi selam deri në ditët tona bota ka parë shumë lloje emigrimi. Por emigrimi i Mekkasve për në Medina është ndryshe nga të gjithë migrimitë tjera. Ndaj dhe në vënd të migrimit është quajtur Hixhret. Njëkohësisht vëllazërimi i vëndalinjëve me emigrantët nuk ka ngjashmëri me asnjë vëllazërim tjetër. Një vëllazërim ky ku edhe gjëja me e vogël u nda më dysh me vëllain e tij prej feje. Ndaj Allahu në Kur'anin Famëlartë thotë**; ''Besimtarët padiskutim që janë vëllezër.''**[120] Pra Allahu xh.sh. në këtë ajet kuranor na tregon se dashuria dhe sinqëritëti i vërtëtë vëllazëror nuk është në përfitimët matëriale por sinqëritëti dhe dashuria e vërtëtë është në besimin dhe fenë Islame.

Vëllazërimin e sahbëve (shokeve të tij) Pejgamberi alejhi selam e ndjentë në thellesinë e zemrës së tij. Ai ishtë aq i nderuar dhe aq i dashur tëk sahabet saqë ata çdo vendim, orjentim, fjalë dhe këshillë të dij e vinin në veprimtari pa pikën e mëdyshjes. Kështu ndodhi edhe në kohën kur ail (aljhi selam) ndërtoi vëllazërinë ndermjet ensarëve dhe muhsxhirëve. Ata (sahabët) i mbushën zemrat me dashuri për njëri-tjetrin, ndaj ata nuk hezituan për të ndarë dhe sakrifikuar çdo gjë për vëllezërit e tyre. Kështu sahabët u lidhën ngushtë me njëri-tjetrin dhe për të lartësuar fenë e Allahut xh.sh. me plot përkushtueshmëri sakrifikuan gjiçka kishin. Ata ishin betuar pranë Pejghamberit alejhi selam se deri më vdekje do të sakrifikonin gjiçka për të lartësuar fenë e Allahut. Ndaj ata u bënë shembull i mbarë njërëzimit deri në ditën e fundit të kësaj botë. Kjo është dhe arsyeja që Pejgamberi alejhi selam thotë se sahabët (shoket e tij) janë sikur yjet që zbukurojnë qiellin, natën dhe ndriçojnë (orjentojnë nga vërtëta) këdo që i merr shembull ata. Sepse shembulli i vërtëtë i tyre ishtë I Dërguari i Allahut Suphanëhu ve Tëala. Pra me ndërtimin e vëllazërisë së sahabëve në Medina dhe lidhja e tyre ngushtë me njëri-tjetrin rreth Pejgamberit alejhi selam ishin hapat e para për ndërtimin e **''shtetit Islam''** në Medina.

Në qytëtin e Medinas së bashku me sahabët jetonin edhe të krishtërë, jahudi dhe idhujtarë. Jahuditë përbëheshin prej tre fiseve Beni Kurejdha, Beni Kajnuka dhe Beni Nadr. Këto njëkohësisht ishin kundërshtarët dhe armiqt më të përbetuar të Pejgamberit alejhi selam. Ndërsa kur kishin dëgjuar mushrikët (idhujtarët) në Mekka për vëllazërimin e sahabëve (ensarëve me muhaxhirët) ishin tronditur shumë pasi ata tashmë ishin të vetëdijshëm për rrezikun që ju kanosej. Mushrikët Mekkas tashmë kishin filluar të mendonin se nëse nuk i lajnë hesapet njëherë e mirë me Pejgamberin a.s. dhe shokët e tij më vonë për to rreziku do rritëj dhe do ju vintë në derë. Pra Mekkasit tashmë filluan të mendojnë se Pejgamberi alejhi selam me shokët e tij dp të fuqizoheshin në Medina dhe do ktheheshin të çlironin

[119] İbni Sa'd, Tabakât, I, 238; İbni Kesîr, Bidâye, III, 226-229; Belâdhûrî, Ensâb, I, 270-271.
[120] Huxhurât: 49/10.

Mekkan prej tyre. Sepse ata të gjithë pasurinë pas emigrimit ja kishin grabitur. Pro njëkoheshit ata i kishin dhunuar aq shumë Pejgamberin dhe shokët e tij në Mekka saqë i kishin detyruar të emigronin në Medina. Kjo ishtë frika e mushrikëve Mekkas që i kishtë detyruar këto që tju dërgonin vazhdimisht letra kërcënuesë sahabëve dhe Pejgamberit a.s në Medina. Në një prej letrave që ju kishin dërguar mushrikët Mekkas sahabëve dhe Pejgamberit a.s. shkruhej si më poshtë; ''Padyshim që asnjë prej fiseve arabe nuk n aka detyruar të ndjejmë aq armiqsi sa ndjejmë për ju. Sepse ju në vënd se të na e dorëzoni atë (Pejgamberin a.s.) në ju i hapët krahet po e mbani dhe po e forconi atë. Kjo është një vepër që kurrë nuk do të ju falet. Ndaj kërkojmë prej jush që të distancoheni prej tij, të na e lini në atë dhe të mos bëheni pjesë mes nësh dhe tij. Ai (Muhammedi a.s.) është i joni, të drejtat e tijë janë të tonat dhe nëse e kërkon nëvoja të lahen hesape jemi po në ata që do të përgjigjemi për të...'' Sikur duket mushrikët Mekkas kërkonin prej Medinasve që të hiqnin dorë prej mbështëtjes që ata i jepnin Pejgamberit a.s. dhe shokëve të tij Mekkas. Por mushrikët Mekkas letra kërcënuese nuk i dërgonin vetëm sahbëve por ata i kishin dërguar letra kërcënuese edhe idhujtarve Medinas. Në një nga letrat kërcënuese që ata i kishin derguar idhujtarëve Medinas kërkonin prej tyre që të ekzekutonin ose të dëbonin nga Medina Pejgamberin alejhi selam ose në të kundërt ata (mushrikët Mekkas) do vinin në Medina dhe do i luftonin deri në vdekje.

Kur morën këtë letër kërcënuese idhujtarët e Medinas u mblodhën rreth dyfyturshit Abdullah bin Ubej dhe nisën të diskutonin për ekzekutimin e Pejgamberit alejhi selam. Sapo mësuan sahabët për këtë akt të idhujtarëve Medinas u mblodhën rreth Pejgamberit alejhi selam dhe morën çdo masë për të mbrojtur Pejgamberin alejhi selm. Ubej bin Kabi trasnmeton se; ''Që kur Pejgamberi alejhi selam erdhi në Medina së bashku me Sahabet u bënë shenjëstër e kërcënimeve të mushrikëve. Kjo ishtë arsyeja që sahbaët mberthyen armët dhe e rrethuan Pejgamberin a.s. për të mos e lënë atë preh sulmeve të mushrikëve. Sahabët për të mbrojtur Pejgamberin a.s. prej sulmeve që mund ti vinin nga jasht rrinin në gadishmëri ditë dhe natë. Madje ata ishin organizuar aq bukur sa që qoftë edhe për gjënë më të dyshimtë ata ishin të gatshëm të organizoheshin vetëm për pak sekonda.''

Përsëri erdhi Dita
Kur universit i lindi Drita
Drita e Ndriçimit
Dynja-Ahiret dritë e shpëtimit

Mblidhen për shefat
Pa fund vargu i gjatë
Mblidhet ç'do sahab
Rreth tij mblidhen vrap

Përsëri erdhi Dita
Kur lindi dashuria
Dhe u mposht kotësia
N'Bedër u pa urtësia

Bedri është treguesi
Ku t'keqës ju bë pusi
N'Bedër është shenjtëri
Që u varros kotësia

Përsëri erdhi Dita
E muajit që lindi Drita
Drita e Mirësisë
Mëshirës dhe Dashurisë

Pamje Nga Medina

Toka ku u ndal Kuvsa deveja e Pejgamberit alejhi selam kur ai emigroi në Medina. Pejgamberi alejhi selam më vonë e bleu këtë tokë dhe ndërtoi xhaminë e tij. Shtëpia e tij ku sot gjëndet edhe varri i Pejgamberit alejhi selam gjëndet i bashkangjitur me xhaminë e tij. Në të njëjtin vënd (dhomë) janë të varrosur edhe Ebu Bekri me Omerin radjallahu anhuma.

ARSIMIMI I (SAHABËVE) SHOKËVE TË BEJGAMBERIT ALEJHI SELAM

Mesxhidi Nëbevi (Xhamia e Pejgamberit a.s.)

"Padiskutim që besimtarët janë vëllezër." ***Huxhurât: 49/10.***

Puna e parë që bëri Pejgamberi alejhi selam kur arriti në Medina ishtë ndërtimi i xhamisë që sot quhet Mesxhidi Nëbevi, ku në të sahabët falnin namazin me xhemaat. Sipas transmetimeve thuhet se ''**për ndërtimin e Mesxhidi Nebevi Pejgamberin alejhi selam e lajmëroi Xhebraili alejhi selam.''** Kur kishtë ardhur në Medina Pejgamberi ynë i dashur xhaminë e ndërtoi pikërisht në vëndin ku kishtë ndalur për herë të parë deveja e tij Kusva. Kur deveja u ndal Pejgamberi alejhi selam pyeti për pronarët e tokës dhe kur këto të fundit u paraqitën para tij ai ju tha se dëshirontë ta blintë tokën e tyre. Ndërsa pronarët e tokës i thanë; **''O I Dërguari i Allahut! Në shpërblimin e kësaj toke e presim vetëm prej Allahut xh.sh. ndaj ju merreni dhe bëni çtë doni me të.''** I Dërguari i Allahut këmbënguli dhe nuk ua pranoi tokën atyre si dhuratë por jua bleu me një shumë më të madhe se sa ajo kishtë vlerën.[121] Sapo e bleu Pejgamberi a.s. tokën urdhëroi sahabët që të nisnin punimet për ndërtimin e xhamisë. Sahabët së bashku me Pejgamberin alejhi selam nga njëra anë rregullonin truallin nga ana tjetër përgatisnin tullat prej dheu me të cilat u ndërtua xhamia e Pejgamberit alejhi selam.

Kur erdhi koha për të hedhur themelet e xhamisë kurthemelin e parë e hodhi vetë Pejgamberi alejhi selam me duart e tij. Pas **Pejgamberit alejhi selam edhe sahabët, që më vonë do të ishin kollozët e hilafetit Islam, Ebu Bekri, Omeri, Osmani dhe Aliu radijallahu anhuma morën pjesë në hedhjen e gurthemelit të xhamisë.** Krahas këture në ndërtimin e xhamisë morën pjesë edhe shumë sahabë të njohur ku ata së bashku me Pejgamberin alejhi selam punuan pa reshtur deri në përfundimin e ndërtimit të xhamise. Muret e xhamisë u ndërtuan me kerpiç (tulla prej baltë) në bartjen e të cilave vetë Pejgamberi a.s. merrtë pjesë. Madje sipas transmetimeve kur sahabët shihnin Pejgamberin a.s. të ngarkuar me tulla në shpinë i thanë; ''O I Dërguari i Allahut xh.sh.! Na lejo në që ti mbajme tullat që ti ke mbi shpinë.'' Ndërsa I Dërguari i Allahut ja ktheu ''Edhe unë kam nëvojë për të fituar sevapet e mia në ndërtimin e kësaj xhamie. Ndaj më lërni që edhe unë të jap kontributin tim.''

Kështu pra sikur në ndërtimin e xhamisë I Dërguari i Allahut xh.sh. merrtë pjesë në çdo kontribut kolektiv që kishtë nëvojë shoqëria në kohën e tij. Njëkohësisht Pejgamberi a.s. i motivontë sahabët duke i treguar atyre për mirësitë që kanë punët dhe shërbimet në shoqëri. Madje ai i përgëzontë sahabët duke ju treguar atyre për shpërblimet ëe Allahu xh.sh. i jep atyre që kontribojnë në të mirë të shoqërisë.

Përkjekjet dhe këshillat e Pejgamberit alejhi selam ishin motiv për sahbët, të cilit punonin ditë natë për ndertimin e civilizimit Islam. Sepse gurthemeli i xhamise (Mesxhidi Nëbevi) në Medina njëkohësisht është gurthemeli i parë për ndërtimin e civilizimit Islam. Sakrifica e shabëve për ndërtimin e civilizimit Islam shihej qartë në mbartjen e tullave që u ndërtua xhamia e Pejgamberit a.s.

Majde sahabiu Ammar bin Yaser mbantë mbi shpinë dy tulla të mëdha dhe përpiqëj ti shpientë sam ë parë në duart e ustallarëve që punonin në ngritjen e

[121] İbni Sa'd, Tabakât, I, 239.

mureve të xhamisë. Kur e pa Pejgamberi a.s. përpjekjen e Yaserit ju afrua dhe i tha; **''O biri i Sumejjes! Të tjerët kanë nga një shpërblim, ndërsa ti ke dy shpërblime.''**

Muret e xhamisë u ngritën për një kohë farë të shkurtër. Pasi u vendos çatia ndarja e brëndëshme e xhamisë u bë sipas kulturës arabe të asaj kohe, ndërsa dyerve ju vendosën vetëm përde. Pranë xhamisë u ndërtua edhe shtëpia e Pejgamberi alejhi selam. Dyert e banësës së Pejgamberit a.s. dilnin nga xhamia. Dhoma e vajzes së Pejgamberit a.s. Fatmas r.a. me dhomën e bashkëshortës së Pejgamberit a.s. Aishes r.a. ishin të ndara. Sipas transmetimeve pasi përfundoi ndërtimi i xhamisë Pejgamberi a.s. së bashku me famijen e tij u transferu nga shtëpia e Halid bin Zejdit tëk shtëpia e tij.[122]

O RESULULLAH

Dashamirët e të dashuruarve të hutuar gjithmonë,
Janë për shkak të bukurisë sate, o i Dërguar i Allahut.
Dhimbja dhe ofshamat e mia ditë e natë,
Janë për shkak të mallit për ty, o i Dërguar i Allahut!

Ditë dhe natë, puna ime është veç dëshpërimi,
Zemra ime digjet me zjarrin e mallit,
Këto sy të mi janë gjithmonë me lot,
Për shkak të ndarjes me ty, o i Dërguar i Allahut!

Ajo që e panë njerëzit e ndershëm është hiri i Allahut,
Gëzimi dhe lumturia që shijuan të dashurit e Tij,
Lartësia që profetët arritën,
Është bekimi yt, o i Dërguar i Allahut!

Trego mëshirë për mua, këtë të vetmuar dhe të mjerë,
Jam një mëkatar, më mëshiro dhe mos më refuzo,
Të tregosh dhembshuri për të pafuqishmit dhe të varfrit,
Është zakoni yt, o i Dërguar i Allahut!

Ti je Ndërmjetësi i mëkatarëve, drita e Allahut të vetëm,
Më mëshiro, unë jam një shërbëtor i yt, mos më dëbo,
Nga dera jote e hirit trego bujari, mos më refuzo,
Unë jam pjesë e ymetit tënd, o i Dërguar i Allahut!

Nasûhî Uskudârî

Vajtimimi i Trungut të Hurmës

"Betohem në Allahun xh.sh.! Se nësë nuk do e prekja me dorë këtë trung, ky do të qante nga malli për mua deri në ditën e Kijametit."
Hadith

Brënda xhamisë së Pejgamberit a.s. gjëndej një trung hurdh **''Hananne''** mbi të cilin Pejgamberi a.s. mbantë fjalimet (hutben) e xhumasë. Pas pak kohësh në xhami u ndrtua minmberi me tre shkallë ku Pejgamberi a.s. nisi të mbantë fjalimet e të xhumasë. Një ditë të xhuma Pejgamberi a.s. së bashku me shabët ishin mbledhur në xhami. Kur erdhi koha për të mbajtur fjalimin e të xhumasë Pejgamberi a.s. u ngjit në minber dëgjoi të qarët e trungut të hurmës që ai mbantë fjalimet e të xhumasë para ndërtimit të minberit.

[122] Ibni Kesîr, Sire, II, 280.

Transmetohet se zëri që vintë nga trungu i hurmës u dëgjua nga sahabët që gjëndeshin në xhami por askush nuk e kishtë kuptuar se çishtë ai zë. Ndërsa i Dërguari i Allahut zbriti nga minberi dhe ju afrua trungut të tharë të hurmës dhe vendosi dorën mbi të. Pasi Pejgamberi a.s. e preku trungun zëri i trungut nuk u dëgjua më. Pejgamberi a.s. kur vendosi dorën mbi trung u kthye nga sahabët dhe ju tha atyre se; **''Betohem në Allahun xh.sh.! Se nësë nuk do e prekja me dorë këtë trung, ky do të qantë nga malli për mua deri në ditën e Kijametit.''**

Sipas një tjetër transmetimi tjetër thuhet se; **Pejgamberi a.s. e pyeti trungun e hurmës që ta mbilltë në xhennët ose ta zhvendostë prej aty në një vënd tjetër dhe ai të ringjallej dhe të riprodhontë fruta. Por sipas transmetimeve Pejgamberi a.s. ju lut Allahut; ''O Allah! Vendose këtë trung në xhennët dhe bëje atë ushqim për xhennëtlinjtë.''**

Sahabët që ishin dëshmitarë të kësaj ndodhie më vonë transmetuan se Pejgamberi a.s. ju kishte thënë; **''ai trungu nuk zgjodhi botën e përkohëshme por zgjodhi botën e përjesthme.''** Pastaj me urdhër të Pëjgamberit a.s. trungu i hurmës u shkul prej aty dhe u gropos në një vënd tjetër.[123]

Mbërritja e Pjestarëve të Familjeve në Medina

Pejgamberi a.s. së bashku me Ebu Bekri r.a. kur emigruan për në Medina familjarët e tyre i kishin lënë në Mekka. Sipas trasnmetimeve të Imam Buhariut thuhet se bashkëshortja e Pejgamberit a.s. ka transmetuar se I Dërguari i Allahut ka thënë**; ''Oj Aishe! Ti me je treguar dy herë në ëndërr. Ishe e veshur me rroba prej kumashi me ngjyre jeshile. Dhe mu tha se ti ishe bashkëshortja ime.''**

Sipas transmetimeve Pejgamberi a.s. ishtë fejuar me Aishen r.a. që kur ishtë në Mekka (një vit pas ndarjes nga jeta e ish bashkëshortës së parë Hatixhes r.a.). Por koha nuk kishtë premtuar që ata të bënin martësën në Mekka. Aisheja radijallahu anha martësës e saj me Pejgamberin a.s. e tranmeton si vijon; ''Kur Pejgamberi a.s. emigroi në Medina në na la në Mekka. Kur emigroi në Medina, skllavi i liruar Zejd bin Haris së bashku me Ebu Raifin blenë dy deve dhe gjërat e nëvojitura për migri me një shumë prej 500 dirhemësh (monëdha e asaj kohe). Ndërsa babai (Ebu Bekri) dërgoi Abdullah bin Yrejkitin me ma matërialet e duhura për udhëtim dhe me dy-tre deve që të emigronin motra ime Esma dhe nëna jonë. Pasi ishim përgatitur për emigrim unë (Aishja) së bashku me nënën Ummu Ruman, vajza e Pejgamberit a.s. Fatma, Ummu Gylsym, Sevde hatun me Ummu Eymenin dhe Usame morëm rrugën e mërgimit. Kur arritëm në vëndin e quajtur Kudejd Zejdi ble edhe 3 deve. Më pas në na u bashkangjit edhe Talha bin Ubejdullah. Gajtë rrugës deveja ime nisi të dal jasht kontrolli. Nëna ime nisi të shqëtësohet për mua por Allahu e qëtësoi deven dhe në vazhduam rrugën pa hasur në ndonjë problem. Më në fund kur arritëm në Medina familja e Pejgamberit a.s. u ndal tëk shtëpia ku sapo ishtë ndërtuar ndërsa unë me nënën dhe motrën time shkuam atje ku ishtë vendosur babai im Ebu Bekri radijallahu anhum.''

Sipas këtyre transmetime Aishja radijallahu anha kur emigroi në Medina qëndroi në shtëpinë e babait të saj (Ebu Bekrit) deri sa u martua me Pejgamberin alejhi selam. Transmetuesit thonë se martësa e Pejgamberit alejhi selam me Aishen r.a. është realizuar pas luftës së Bedrit.

[123] İbni Sa'd, Tabakât, I, 239; Kâdı Iyâd, SHifâ-i SHerîf, 300-301.

Sa i lumtur ai, njëriu
Kur'anin, kur e ndjeu
Kur dëgjon Kametin dhe Ezanin
Me besim mbush shpirtin dhe shtatin

Ezani i Muhammedit a.s.

"Edhe thirrjen tuaj (Ezanin) për falje, ata e marrin për tallje e lojë; kjo ngaqë ata janë popull që nuk kupton."
El-Maide 58

Pas ndërtimit të Xhamisë së Pejgamberit a.s. në Medina ende nuk ishtë qartësuar mënyra se si do të thirreshin besimtarët në namaz. Atë kohë thirrja bëhej vetëm me fjalët **''Essalatu Camia''** (mblidhuni në namaz).

Një ditë Pejgamberi a.s. nisi të konsultohet me shokët e tij (sahabët) për mënyrën e thirrjes në namaz. Disa nga sahabët thonin se duhet të përdorin ndonjë vegël si buri prej briri, daulle apo të ngjashme me këto. Disa të tjerë thonin të ndezim zjarr në kohën kur duhet të vihet në xhami. Por Pejgamberit alejhi selam nuk i kishtë ardhur për shtat asnjë nga këto propozime të shokëve të tij. Ndaj ai nuk i kishtë pranuar propozimet e tyre.[124]

Abdullah bin Zejd bin Salebe dhe Omeri radijallahu anhuma, kishin parë në ëndërr ezanin. Abdullahu kishtë ardhur tëk I Dërguari i Allahut xh.sh. dhe i kishtë thënë; **''O I Dërguari i Allahut xh.sh.! Kam parë në ëndërr një njëri i cili në dorë mbantë një kumbanë. Unë i thash ma shit mua atë (kumbanën). Ai më tha ç'të duhet ty kjo? E dua për të thirrur mylimanët për namaz i thash. Atëherë a ima ktheu a dëshiron të mësoj diçka më të bukur se këmbana. Pastaj ai u kthe nga Qabja dhe ja nisi të thotë ''Allahu Ekber, Allahu Ekber...'' pasi mbaroi ezanin për të nisur namazin përsëriti fjalet ''Kad Kamettus Salah.''**

Pasi e dëgji Abdullahun I Dërguari i Allahut Muhammedi a.s. i tha; **''Ëndërra jotë është e vërtetë. Mësoja ato fjalë Bilalit, ti recitoi!''** Ky recitim u quajt Ezan (Thirrje).[125]

Bilali radijallahu anhu doli në një çati që ishtë pranë xhamisë së Pejgamberit alejhi selam dhe thirri ezanin me fjalët që i kishtë mësuar Abdullah bin Zejd bin Salebe. Kur dëgjoi Omeri r.a. ezanin erdhi duke vrapuar tëk I Dërguari i Allahut dhe i tha se të njëjtat fjalë që këndoheshin në ezan i kishtë dëgjuar në ëndërr.

Sipas transmetimeve ëndërra të ngjashme për thirrjen në namaz (ezanin) i kishin parë edhe disa shokë të tjerët të Pejgamberit alejhi selam. Në këto kohë zbriti ajeti i 9 i sures Xhuma.

Një mëngjes Bilali r.a. kishtë ardhur tëk dera e Pejgamberit a.s. dhe kishtë kënduar dy herë fjalët '' Es-salatu hajrun minënnëvm.'' Pejgamberi a.s. e kishtë pëlqyer thirrjen e Bilalit r.a. ndaj ai i tha; **''O Bilal! Në ezanin e namazit të sabahut pas fjalëve hajja alel salah përsëriti dy herë fjalët essalatu hajrun minënnëvm.''** Kështu Bilali vazhdoi ta thirrtë ezanin e namazit të sabahut.

Bilali e thirri ezanin deri kur u nda nga jeta Pejgamberi a.s.. Bilali kishtë një zë të bukur, të dëgjueshëm dhe të pëlqyeshëm për të gjithë. Ai e tthirrtë ezanin me një zell dhe dashuri të madhe. Madje transmetohet se kur Bilali thirrtë ezanin sahabët i kaplontë vaji.

[124] İbni Sa'd, Tabakât, I, 247; Taberânî, Mu'cemu'l Kebîr, XII, 287; Ebû Ya'la, Musned, IX, 378.
[125] İbni Sa'd, Tabakât, I, 247.

Mënyra e thirrjes së myslimanëve në namaz, pra ezani, i kishtë habitur mushrikët dhe jahuditë në Medina. Madje ata nga habia kur thirrej ezani nuk dinin çtë bënin tjetër por ja nisnin të argëtoheshin dhe të talleshin me ezanin. Reagimet e mushrikëve dhe jahudive ndaj ezanit u bënë shkak i zbritjes së ajetit 58 i surës el-maide ku thuhet: **''Edhe thirrjen tuaj (Ezanin) për falje, ata e marrin për tallje e lojë; kjo ngaqë ata janë popull që nuk kupton.''**[126]

Thirri muezini, ezan e kamet
U drejtua nga qabja, bëri nijet

Besimtaret kur dëgjuan, respektuan
Pastaj n'namaz u ndalen, Zotin adhuruan.

As'habı Suffa (Banorët e Suffas)

Pejgamberi a.s. në pjesën veriore të xhamisë ndërtoi një vënd pushim dhe urdhëroi që aty të zhvendoseshin emigrantët e mekas, pikërisht të rinjtë dhe beqarët, që nuk kishin familje dhe pasuri.[127] Por aty nuk qëndronin vetëm të rinjtë që kishin emiguar nga Mekka, njëkohësisht edhe të rinjtë Medinas që nuk kishin mundësi ekonomike. Angazhimi i këtyre të rinjëve që qëndronin pranë **Xhamiseë së Pejgamberit** ishte vëndi i quajtur **Suffa** ishtë që të mesonin dije dhe të ju mësonin dije atyre që nuk dinin.

Numri i të rinjëve që qëndorin në Suffa nuk ishtë numër i konsestueshëm por sipas transmetimeve thuhet se numri i tyre ishtë i ndryshueshem nga dhjetë deri në katërqind. Këto sahabe nuk ndaheshin nga Pejgamberi a.s. dhe nuk i braktisnin kurrë mësimet e tij. Ata natë ditë mësonin Kur'an, hadithet e Pejgamberit a.s. dhe njohuri të ndryshme të kohës. Krahas dijes sahabët e Suffas kohën e vlersonin duke agjeruar dhe duke falur namaz.

Të rinjtë që shkolloheshin në Suffa pas shkollimit emigronin nëpër fiset që ende nuk dinin për Islamin. Ata shkonin dhe kontribonin për përhapjen e Islamit nëpër fiset dhe trevat e tjera të gadishullit arabik, Afrikë dhe botës për rreth. Pra të rinjtë e Suffas ishin ata të cilët përhapën Islamin nëpër botën e asaj kohe. Ndërsa Pejgamberi a.s. ishtë shumë i dashur me to, madje ai a.s. ulej dhe ushqëhej së bashku me to. Qëndrimi i tyrë në vëndin e emëruar Suffa ju vendosi atyre nofkën **''Ashabul-Suffa''** (banorët e Suffas).

Një ditë Pejgamberi a.s. po shihtë se banorët e Suffas, me gjithë skamjen që jetonin aty, ata përpiqëshin të mësonin dije dhe i kryenin adhurimet me plot zell tha; **''O Banorët e Suffas! Ju Përgëzoj! Ndaj dijeni se, nëse do ketë dikush në botë që jeton i lumtur në skamje dhe vështirësi, ata jeni ju, shokët e mi.''** (Pra Pejgamberi a.s. ndjentë keqardhje për qëndjen e tyre në skamje por i përgëzontë ata për përkushtueshmërinë në mësimin e dijes.)

Pejgamberi a.s. kujdesej për banorët e Suffas ashtu sikur kujdesej për familjen e tij. Madje ai a.s. shumë herë ju gatuantë ushqim në shtëpinë e tij dhe ju dërgontë banorëve të Suffas. Eby Hurejre transmeton se; ''Betohem në Allahun se, kishtë kohë që nga njëhëre nuk kisha futur gjë në gojë, madje prej urisë vendosja gur në bark dhe shtrihesha mbi të që të mos e ndjeja urinë. Kur një ditë isha në këtë gjëndjë u ula në

[126] Mâide: 5/58.
[127] Ahmed bin Hanbel, Musned, III, 235; İbni Sa'd, Tabakât, I, 255.

një cep të rrugës ku Profeti a.s. kalontë për të shkuar në xhami. Pas pak kohe aty pranë meje kaloi i dashuri ynë Muhammedi a.s. i cili e kuptoi gjëndjen time dhe me një buzqëshje të ëmbël më tha; **''O Ebu Hurejre! Eja pas meje.''** Unë pa një pa dy u nisa pas të Resulullahut i cili më çoi drejt e në shtëpinë e tij. Kur u futëm brënda nxorri një enë me qumësht me dha të pi dhe pasi u ngopa më tha **thirri dhe banorët e tjerë të Suffas.** Unë shkova i thirra shokët dhe erdhëm të Resulullahu k una ushqëu të gjithëve më qumësht.''

"O Banorët e Suffas! Ju Përgëzoj! Ndaj dijeni se, nëse do ketë dikush në botë që jeton i lumtur në skamje dhe vështirësi, ata jeni ju, shokët e mi."
Hadith

Ebu Hujrere transmeton në një tjetër transmetim se para së I Dërguari i Allahut ti jeptë **qumështin e kishtë urdhëruar të thërrasë banorët e Suffas** dhe pasi ata kishin ardhur dhe ishin ngopur me qumësht në fund kishtë mbetur Ebu Hurejre dhe I Dërguari i Allahut. **I Dërguari i Allahut e kishtë marrë gotën me qumësht** dhe para se ta pij thotë **''Bismilah''**. Kjo tregon se Pejgamberi alejhi selam nuk kujdesej vetëm për ushqimin e banorëve të Suffas por ai njëkohësisht kujdesej edhe për edukimin e tyre. Këtë e tregon vetë fakti i Ebu Hurejres i cili ishtë një nga banorët e Suffas. Ebu Hurejre është një ndër transmetuesit më të mëdhenj dhe më të shumtë të hadittheve të Pejgamberit alejhi selam. Madje pot ë radhitëshin transmetuesit në një listë radhitësë emri i Ebu Hurejres do të ishtë i pari në listë. Thuhet në disa trasnmetime se Ebu Hurejre transmetontë aq shume hadithe prej Pejgamberit a.s. sa që një ditë Omeri r.a. nga frika se mos Ebu Hurejre po i ngatërron hadithet ja kishtë ndaluar të transmetontë atij të transmetontë hadithe.

Përfundimisht përkujdesia e Pejgamberit a.s. për banorët e Suffas, ndryshe mund të quhen nxënësit e dijes, ishtë aq i lartë sa që kur ai nuk kishtë ndonjë gjë për të ngrënë në shtëpinë e tij kërkontë prej sahabëve që ti ushqënin banorët e Suffas. Sipas transmetimeve një natë një nga banorët e Suffas nuk e kishtë duruar më dot urinë dhe kishtë shkuar tëk i Dërguari i Allahut dhe kishtë kërkuar prej tij ushqim por ai alejhi selam i kishtë thenë se në shtëpinë e tij me përjashtim të ujit nuk gjëndej gjë tjetër. Por Pejgamberi a.s. **kishtë kërkuar prej shokëve të tij që ta ushqënin misafirin e tij.** Njëri nga sahabët e merr misafirin e Resulullahut dhe e dërgon në shtëpinë e tij por ai në shtëpi veç ushqimit të fëmijve skishtë pasur ushqim tjetër. Dhe që të mos e kuptoi misafir ai i zoti i shtëpise ishtë ngritur dhe rrotullohej nëpër shtëpi sikur po kërkontë vaj kandili. Dhe në fund pasi misafiri i tij e kishtë mbaruar ushqimin e kishtë ndezur kandilin. Kur dëgjoi Pejgamberi a.s. për këtë veprim të tij i tha; '' O Filan! Dije se Allahu është kënaqur mbrëmë me veprimin tënd.'' Ky ishtë dhe shkaku i zbritjes së ajetit 9 i sures el-Hshr ku thuhet; **''Edhe ata të cilët para tyre patën shtëpitë e tyre (në Medinë) dhe pranuan Besimin, - i duan ata që u shpërngulën tëk ata dhe nuk kanë aspak zili në gjokset e tyre për atë që iu dhe atyre (nga plaçka e Beni-Nadir) dhe i parapëlqëjnë ata (të shpërngulurit) mbi vetën e tyre, edhe pse ata vetë kishin nëvojë për të. Dhe kushdo që shpëton nga lakmia vetjake, tamam të këtillët do të jenë ngadhënjimtarët.''**

Thënie;

Pa pasur parasysh se çmund të jetë, të presësh një mik është pasuri e madhe!

Mësimet e Mbretit të Zemrave (Të Resulullahut)

I Nderuari i Universit (Muhammedi a.s.) salallahu alejhi ve selem për të edukuar dhe përgatitur sa më mirë sahabët filloi të mbantë mësime në Xhaminë e tij. Ai ju jeptë leksionë dhe i begatontë sahabët me begatitë dhe mësimet zemërore që e kishtë begatuar Allahu xh.sh..

Ata që merrnin pjesë në leksionët e Pejgamberit a.s. jo vetëm që përfitonin prej urtësive të tij, por ata njëkohësisht motivoheshin aq sa ata ishin të gatshëm që të sakrifikonin çfar do që I Dërguari i Allahut të ju thoshtë. Njëkohsisht leksionët e Pejgamberit a.s. shërbenin edhe për ti afruar dhe për ti forcuar sam ë fuqishëm marrëdhëniet ndërmjët sahabëve. Gjitashtu sahabët ishin dëshmitarë të zbritjes së vahjit gjatë leksionëve të Pejgamberit alejhiselam. Pra Allahu i kishtë begatuar ata duke i bërë dëshmitarë të zbritjes së vahjit (shpalljes/ajetëve kuranore). Ky ishtë edhe fakti që, pas ëngjejve dhe pejgamberëve, sahabët u bënë më të ndëruarit e njërëzimit.

Pejgamberi alejhi selam sahabëve ju jeptë leksionë për çdo tëme dhe për çdo gje që ata kishin nëvojë. Madje ai ju mësontë edhe detajet më të imta të jetës dhe Islamit. Ai nuk ju mësontë sahabëve vetëm adhurimet sikur janë Besimi/Imani, Zekati, Namazi, Haxhi etj..por Pjegamberi a.s. ju mësontë sahabëve edhe se si të pastroheshin kur kryenin nëvojen në tualet. Kështu shabët kishin mësuar çdo detaj të Islamit sikur edukata në shoqëri, edukata në pastërti, edukata në adhurime, edukata në familje, edukata në marrëdhëniet farefisnıore, edukata në ndarjen e pasurisë, edukata për shëndetin, edukata për ambijentin, edukata për edukimin e fëmijëve, edukata në martësa, gezime dhe hidhërime familjare.[128] Edhe gratë e Pejgamberit a.s. ishin të angazhuara për të transmetuar grave dhe vajzave të sahabëve çdo gjë që mësonin prej tij.

Ngjarja Me Xhebrailin Alejhi Selam

Guximtari, Heroi dhe Triumfatori i ummetit Islam Omeri ardijallahu anhu transmeton se: ‘’Një ditë të bukur kur ishim të ulur me të Dërguarin e Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem). Atë ditë dille ndristë si çdo ditë tjetër. Koha ishtë e kthjellet dhe vapa ishtë e freskët. Në si çdo herë tjetër ishim mbledhur tëk i Dërguari i Allahut dhe po dëgjonim predikimet e tij. (Ku dinim në se ajo ditë do të ishtë dita që Xhibrili alejhi selam do vintë në në formën e një njëriu dhe në do të nderoheshim duke dëgjuar zërin e tij me veshët e kësaj dynjoje).

Njësia që u dërgua kundër Kurejshëve dhe fisit Benî Damra përbëhej nga gjashtëdhjetë përsona. Flamuri e mabantë Hamzai r.a.. Por gjatë rrugës nuk u

[139] Vâkıdî, Megâdhî, I, 9; Kilâ'î, İktifâ, II, 6; SHemseddin SHâmî, Subulu'l-Hudâ, VI, 11.
[140] Vâkıdî, Megâdhî, I, 10; İbni Sa'd, Tabakât, II, 7; Kilâ'î, İktifâ, II, 3-4.

përballën me mushrikët Mekkas. Myslimanët arritën deri në vendin e quajtur Veddân. Dhe aty u arrit një marrëveshje me fisin Benî Damra. Në marrëveshje thuhej se;

"Përgëzime atyrë që vdesin në rrugën e Haxhit dhe atyrë që dalin në luftë në rrugë të Allahut."
Hadith

1. Fisi Damra nuk do të ndihmojë, në asnjë mënyrë, mushrikët e Mekkas.
2. Siguria e jetës dhe pasurisë së Damra do të jetë nën mbrojtjen e myslimanëve,
3. Në këmbim, kur Pejgamberi të thërrasë fisin Damra për ndihmë në një luftë, ata do ti përgjigjen pa kushtë thirrjes së tij.

Gazveja e Buvatit

Kjo gazve është gazveja e dytë e Pejgamberit a.s.. Ajo ka ndodhur në muajin Rebî'ul-evvel të vitit të dytë të vitit, sipas kalendarit Hixhri. Saib bin Osman bin Maz'un u la si përfaqësues i Pejgamberit në Medina. Kur u mor vesh se një karvan idhujtarësh nën drejtimin e Ebu Sufjanit, me njëqind njërëz dhe dy mijë e pesëqind deve, po shkontë në Sham, u dërgua një grup prej dyqind ushtarësh kundër karvanit të Kurejshëve. Megjithëse çdo vend deri në malin Buvât u kontrollua me kujdes, idhujtarët ndërruan rrugë dhe nuk u përballën me myslimanët.

Gazveja e Dhul Ushejerës

Kjo gazve ndodhi në fillim të muajit të gjashtëmbëdhjetë të Hixhrit. Atë kohë erdhi lajmi se një karvan i madh tregtar idhujtarësh nga Meka, nën komandën e Ebu Sufjanit, po shkontë në Sham. Pejgamberi a.s. në Medina la Ebu Seleme bin Abdulesed si përfaqësues në të tij. Flamuri iu dha hazretit Hamzait r.a.. Myslimanët kishin tridhjetë deve dhe kalonin radhazi sikur kalon një kolonë ushtarake. Kur arritën në vendin e quajtur Ushejre, numri i tyre arrintë rreth njëqind e pesëdhjetë ose dyqind ushtarë, pritën disa ditë por nuk arritën të kapnin karvanin e Ebu sufjanit. Mslimanët gjatë qëndrimit në Ushejre bënë paqë me fisin e Beni Myxhidli dhe u kthyen në Medinë pa bërë luftë.

Gazveja e Parë e Bedrit

Gazveja e parë e Bedrit ndryshe quhet Gazveja e Safevân. Kjo ka ndodhur disa ditë pas kthimit nga Gazveja e Buvâtit. Këtë kohë erdhi lajmi në Medina se një Kurejshit i quajtur Kurdh bin Câbir Fihri, me njërëzit e tij kishtë bërë një sulm në malin Cemma dhe ju kishtë marrë grabitur bagëtitë që mbështëtësit e Pejgamberit a.s. po kullosnin në këto toka.

Pejgamberi a.s. u bë gati për sulm dhe duke lënë Zeyd bin Hârise si përfaqësues të tij në Medina dhe u nis me shokët e tij drejt vendit të ngjarjes. Flamuri këtë herë iu dha Aliut radijallahu anhu.

Kur Pejgamberi a.s. arriti në vendin e ngjarjes, Kurdhi së bashku me shokët e tij, duke lënë bagëtitë që kishin grabitur, ja mbathën dhe duke u strehuar nëpër zonë i humbën gjurmët. Edhe pse myslimanët kontrolluan çdo gur e kodër deri në luginën e quajtur Safevân të Bedrit nuk arritën ti gjejnë grabitqarët sulmues.

Njësia e Abdullah bin Xhurejshit (Seriyya Batn-ı Nahle)

Një ditë Pejgamberi alejhi selam dëshiroi të organizontë një serijje (njësi ushtarake) për të survejuar Kurejshët. Ai urdhëroi që Abu Ubejde bin Xherrah të emërohej komandant i njësisë që do të dërgohej në këtë survejim. Pasi mori këtë urdhër, Abu Ubejde bin Xherrah filloi të qantë nga dhimbja e qëndrimit

Gazvet e Pejgamberit alejhi selam

larg Pejgamberit a.s.. Prandaj, Resulullahu sallallahu alejhi ve sellem emëroi si komandant Abdullah bin Xhahsh.[141]

Abdullah bin Xhahsh ishtë një njëri i apasionuar pas Islamit. Kur u bë mysliman, qafirët e torturonin në mënyra të paimagjinueshme, por ai u përballontë atyre me forcën e besimit dhe i përballontë vuajtjet e tyre me qëndresë. Për këtë arsye, Pejgamberi a.s. për të tha: "Ai është nga ata që e duron më shumë urinë dhe etjen." Abdullah bin Xhahsh dëgjontë lajmet e ngushëllimit për dëshmorët dhe gjithmonë dëshirontë që dhe ai të bientë dëshmorë. Për këtë ai luftontë guximshëm dhe pa pikë frike në frontin e luftës.

Hazreti Abdullah bin Xhahsh thotë se: "Atë ditë kur Pejgamberi alejhisselam pasi kreu namazin e jacisë më thirri dhe më tha; "Nësër në mëngjes herët eja i përgatitur dhe i armatosur për luftë. Sepse nësër do të të dërgoj diku,"

Në mëngjes u përgatita ashtu sikur më kishtë pororsitur Pejgamberi a.s. dhe shkova herët në xhami. Pejgamberi alejhisselam, pasi e kreu namazin e sabahut, u kthye në shtëpi. Duke qënë se kisha ardhur më parë, prisja para derës së tij. Aty gjeta disa prej sahabëve që do të vinin me mua, Pejgamberi a.s. mu drejtua dhe me tha; "Të emërova komandant mbi këta njërëz," dhe duke më dhënë një letër shtoi se; "Shko! Pas dy nëtëve, hap letrën. Vepro sipas asaj që është shkruar në të." Kur e pyeta se; "! Në cilin drejtim të shkoj? O Resulallah'' Ai më tha "Nisu për në Nëxhd. Shko drejt Rekije, aty drejt pusit!"

Kur u emërua Abdullah bin Xhahsh për ekspeditën në Nahle, ju dha titulli prijesi i besimtarëve (emirulmu'minin). Ai ishtë i pari që u quajt emirulmu'minin (prijësi i besimtarëve) në Islam. Ai, së bashku me një grup të përbërë prej tëtë ose dymbëdhjetë përsonash, arriti në Melel pas dy ditësh. Kur ariti atje hapi letrën që i kishtë dorëzuar Pejgamberi alejhi selam ku thoshtë;

"Bismillahirrahmanirrahim. Kur të lexosh këtë letër, ec në emër të Allahut dhe me bekimin e Tij deri në luginën Nahle, lugina që gjëndet në mes Mekes dhe Taifit. Asnjë nga shokët e tu nuk duhet të detyrohet të vijë me ty! Duhet të survejosh dhe ndjekësh Kurejshët dhe karvanin e tyre në luginën Nahle. Na dërgo informacion për çdo ndodhi dhe çfar do që të ndodh me ata."

"O Xhebrail! Unë dëshiroj që Allahu të ma kthejë fytyrën (orientimin e namazit) nga kibla e hebrenjve drejt Qabes."
Hadith

Emiri i besimtarëve Abdullah bin Xhahsh, pasi lexoi letrën, tha: "Në jemi robër të Allahut dhe do të kthehemi tëk Ai. E dëgjova dhe do të përmbush urdhrin e Allahut dhe të Pejgamberit tonë të dashur." Më pas ai e puthi letrën dhe e vendosi në kokë. Pastaj iu drejtua shokëve të tij: "Cili nga ju dëshiron të bëhet dëshmor, le të vijë me mua. Ai që nuk dëshiron mund të kthehet. Askush nuk është i detyruar të vijë në betëjë. Nëse nuk vini, unë do të shkoj vetëm dhe do ta përmbush urdhrin e Pejgamberit aleyhisselam." Ndërsa shokët ju përgjigjën të gjithë njëzëri: " O Xhahsh! Në i kemi dëgjuar urdhërat e Pejgamberit a.s. një për një. Ndaj në do t'i bindemi Allahut, Resulullahut sallallahu alejhi ve sellem dhe ty o prijësi i besimtarëve. Nga cilido drejtim që ti të dëshirosh, në me bekimin e Allahut do të ecim pas tëje."

Kjo njësi e vogël e udhëhequr nga Abdillah bin Xhahshi pjesë e së cilës ishtë edhe Sa'd bin Ebi Vakkas, u nis për në Hixhaz dhe shkoi deri në Nahle. Aty u fshehën dhe filluan të survejonin Kurejshët që kalonin aty pranë. Në këtë moment po kalontë një

[141] İbni Hishâm, Sire, I, 601; Vâkıdî, Megâdhî, I, 2; İbni Sa'd, Tabakât, II, 7; Taberî, Târih, II, 410; Kilâ'î, İktifâ, II, 9-10.

karvan Kurejshitësh. Devet e tyre ishin të ngarkuara mirë me mall. Myslimanët pa ju trembur syri iu afruan karvanit dhe i ftuan ata në Islam. Mirpo kur panë se ata nuk pranuan thirrjen e tyre, filluan të luftonin me ta ku rranë njërin prej tyre dhe kapën dy të tjerë. Ndërsa njëri ju iku sepse ai ishtë kalorës dhe nuk zbriti nga kali. Të gjitha pasuritë e mushrikëve që ishin në atë karvan përfunduan në duart e myslimanëve. Abdullah bin Xhahsh pasi ndau një të pestën e këtyre pasurive për Resulullah ju dha pjesëtarve të betëjës pjesën që ju takontë nga kjo betëjë. Kjo ishtë dhe pasuria e parë që muslimanët moren si triumforë të një përleshje luftarake.

Pejgamberi alejhi selam duke u shpjeguar pengjeve Islamin. Pra ju bëri thirrje atyre që ata të pranonin Islamin por prej tyre vetëm Hakem bin Kejsâni u bë musliman ndërsa Osman bin Kejsân e refuzoi Islamin dhe kërkoi që të shkoi në Mekke, keuërkesë të cilën e pranoi Pejgamberi a.s. dhe e la të lirë.

Mesxhidi me Dy Kible (Xhamia me Dy Drejtime)

I Dërguari ynë i Allahut xh.sh. (sallallahu alejhi ve selam) kishtë plot shtatëmbëdhjetë muaj që që kishtë emigruar në Medinë. Deri atë kohë kur i falnin namazet duke u kthyer drejt Bejtul-Mukaddesit (Mesxhidul Aksa i sotëm) që ndodhet në Kudus-Jeruzalem. Mirëpo ishin përhapur lajmet që hebrenjtë thanin se: "Çfarë punë e çuditshme! Feja e tij është ndryshe nga në, por kibla e tij është sikur e jona!" Mirepo kur arritën këto bilbëzima të hebrenjëve deri tëk i Dërguari i Allahut xh.sh. (sallallahu alejhi ve selam), zemra e tij e pastër u brengos tëj mase.

Ndërsa Pejgamberi a.s. nga njëra anë brengosej prej bilbëzimave të hebrenjëve dhe nga ana tjetër zemrën ja kaplontë malli për Mekkan i erdhi Xhibrili alejhi selam dhe këtij të fundit i tha; **"O Xhebrail! Unë dëshiroj që Allahu të ma kthejë fytyrën (orientimin e namazit) nga kibla e hebrenjve drejt Qabes."** Xhebraili, alejhi selam, i tha**: "Unë jam vetëm një krijesë e Krijuesit të Gjithësisë. Ndaj Lutë vetë Allahun për këtë!"**

Pas kësaj ndodhie nuk zgjati shumë dhe Allahu suphanëhu ve tëala i zbriti ajetin e 144 të sures Bekara ku Allahu xh.sh. thotë; **''Vërtët që Në tashmë e kemi parë kthimin e fytyrës tënde** (O Muhammed salallahu alejhi ve selem) **drejt qiellit. Sigurisht që Në do të të drejtojmë ty drejt një Kibleh (drejtim falleje) që do të të kënaqë ty; kështu pra ktheje fytyrën tënde në drejtim të Mesxhidil-Haramit** (Xhamisë së Shenjtë në Mekë). **Dhe kudo që të jeni ju, o njërëz, ktheni fytyrat tuaja në falje në këtë drejtim. Padyshim, atyre që u janë dhënë Librat e Parë (jehuditë e të krishtërët) e dinë mirë këtë gjë, se** (kthimi juaj drejt Kabës në Mekë gjatë faljeve) **është e vërtëta nga Zoti i tyre. Dhe Allahu nuk është i pavetëdijshëm për çfarë ata veprojnë.''**

Sipas transmetimeve kur zbriti ky ajet kuranor ishtë mesi i muajit Shaban. Atë kohë i Dërguari i Allahut ndodhej në xhaminë e Beni Selime dhe po udhëhiqtë shokët e tij në namazin e drekës ose ikindisë. Sipas transmetimve thuhet se ata ishin në rekatin tretë të namazit. Dhe kur iu urdhërua Pejgamberit alejhi selam që të kthehen drejt Qabesë. Ai menjëherë e kthyu fytyrën e tij drejt Qabesë së bekuar. Edhe shokët e nderuar të Profetit a.s. gjithashtu u kthyen në atë drejtim, duke ndjekur Pejgamberin e dashur të Allahut. Që nga ajo ditë kjo xhami është quajtur **"Xhamia e Kibletëjni-t''** që do të thotë xhamia me dy kible.

Më pas I Dërguari i Allahut shkoi në Kuba dhe me duart e tij të bekuara e rindërtoi mihrabin e xhamisë së parë që ishtë ndërtuar në Kuba dhe i ndryshoi muret e xhamisë sipas orientimit drejt Qabesë.[142]

[142] İbni Hishâm, Sîret, I, 549; Suheylî, Ravd-ul-unf, I, 409.

LUFTA E BEDRIT

" O Ummu Varaka! Ti qëndro në shtëpi dhe lexo Kuranin. Pa dyshim, Allahu do të ta dhurojë dëshmorësinë."
Hadith

Lufta e Bedrit në historinë e Islamit quhet edhe si Betëja e Dytë e Bedrit, Bedr-i Kital, Bedr-i Kubra. Me suksesin e Profetit a.s. dhe shkoëve të tij në ekspeditat e mëparshme, idhujtarët filluan të frikësoheshin. Tani karvanët e tyre udhëtonin në grupe dhe të shoqëruar me kolona ushtarake. Në vitin e dytë të Hixhretit, idhujtarët e Mekës mblodhën kapital nga çdo familje dhe dërguan drejt Shamit një karvan të përbërë me një mijë deve. Në krye të karvanit ishtë Ebu Sufjani, i cili ende nuk ishtë bërë mysliman. Karvanin e ruanin rreth dyzet ushtarë të mirëstërvirue për luftë. Pasi të shitëshin mallrat në Sham me të gjithë paratë që do të fitonin do të blinin armë dhe këto armë do të përdoreshin në luftë kundër myslimanëve që tashmë ishin transferuar në Medina.

Kur i Dërguari i Allahut (sallallahu alejhi ve selam), mori lajmin se idhujtarët po dërgonin për tregti drejt Shamit një karvan të madh, ai dërgoi disa nga Muhaxhirët për të mbledhur informacionë rreth tyre. Kur arritën në vendin e quajtur Dhul Usheira, mësuan se karvani kishtë kaluar dhe u kthyen në Medinë për ti dhënë lajmin Pejgamberit alejhi selam. Pra nëse armët dhe mallrat e mosbesimtarëve do të bllokoheshin pa ju rënë në dorë atyre, ata nuk do të mund të dëmtonin myslimanët dhe do të humbnin fuqinë që ata po mblidhnin kundër myslimanëve. Për këtë arsye, i Dërguari i Allahut (sallallahu alejhi ve selam), pasi bëri një vlerësim të situatës, filloi menjëherë përgatitjet për luftë kundër mushrikëve mekkas.

Pejgamberi alejhi selam në vend të tij, në Medina, la Abdullah ibni Ummi Mektumin. Ndërsa Talha bin Ubejdullahin dhe Sa'id bin Zejdin e dërgoi për të mbledhur informacionë rreth kthimit të karvanit. Për shkak të sëmundjes së rëndë të gruas së Hazretit Osmanit r.a. Profeti a.s. e urdheroi këtë të fundit të qëndrontë në Medinë. Më pas u dhanë detyra katër përsonave të tjerë, duke e bërë numrin e përgjithshëm të tyre tëtë. Pra për myslimanët parandalimi i armëvë që të mos bienin në duart e mushrikëve dhe për pengimin e fuqizimit të tyrë kjo ishtë një mundësi që nuk duhej humbur. I Dërguari i Allahut bëri përgatitjet dhe mori me vetë 305 sahabë nga Muhaxhirët dhe Ensarët dhe u nisën drejt Bedrit. Kjo ka ndodhur më datën 17 të muajit të Ramazanit. Numri total i tyre, së bashku me ata që ishin caktuar në detyrat e vrojtimit, arriti në 313 ku gjashtëdhjetë e katër prej tyre përbëhej nga Muhaxhirët.

Mali i Bedrit është një vend ku kryqëzohen rrugët për në Mekë, Medinë dhe Siri.

Shumë prej të rinjëve, madje edhe prej grave kërkuan që t'i bashkoheshin Profetit alejhi selam në këtë ekspeditë. Një prej tyre ishtë edhe Ummu Varaka e cila shkoi tëk i Dërguari i Allahut dhe i tha: " O i Dërguari i Allahut! Prindërit e mi qofshin të flijuar për ty. Nëse më lejon, dua të vij të luftoj së bashku me ju. Edhe nëse nuk do mundem të luftoj më e pakta do të kujdesem për të plagosurit dhe të sëmurët. Ndoshta Allahu do të më dhurojë edhe mua dëshmorësinë!" I dashuri Profet, sallallahu alejhi ve selam, i tha: **" O Ummu Varaka! Ti qëndro në shtëpi dhe lexo Kuranin. Pa dyshim, Allahu do të ta dhurojë dëshmorësinë."**

Sa'd bin Ebi Vakkas tregon se: "Kur Resulullahu (paqja qoftë mbi të) dontë të kthentë mbrapsht fëmijët që kërkonin të shkonin në betëjë me në, vëllai im Umeyr u përpoq të fshihej dhe të mos shihej. Aitëherë ishtë gjashtëmbëdhjetë vjeç a. Unë e pyeta: 'Çfarë të ka ndodhur që po fshihesh?' Ai tha: 'Kam frikë se Resulullahu do të më

Xhamia e Kibletëjni-t

Kibla e parë e myslimanëve ishtë në drejtim të veri-përëndimit, pikërisht drejt Xhamia Al-Aksa që ndodhet në Palestinën e sotme. Pr kjo njëkohësisht ishtë edhe kibla e hebrenjve. Hebrenjtë talleshin me shokët e Profetit a.s. duke thënë se myslimanët po i kthejnë fytyrat nga kibla jonë. I dashuri ynë Profeti sallallahu alejhi ve selam, u lut tëk Zoti i Lartë Madhëruar dhe kërkoi që kibla e myslimanëve të bëhej Qabeja e madhërishme. Ndërsa i Dërguari i Allahut po udhëhiqtë një namaz të drekës [në një transmetim tjetër thuhet se ishtë namazi i ikindisë] në këtë xhami, u shpall ajeti që urdhërontë: "Kthehuni drejt Qabesë." Pastaj ata u kthyen drejt juglindjes, ku ndodhet Qabeja e madhërishme. Për këtë arsye, kjo xhami quhet "Xhamia e Kibletëjni-t", që do të thotë xhamia me dy kible.

konsiderojë të vogël dhe kështu do të më kthejë mbrapsht! Por unë dëshiroj të marr pjesë në betëjë dhe të fitoj dëshmorësinë nga Allahu.' Kur këtë ia treguan Resulullahut, ai i tha vëllait tim: **'Kthehu në shtëpi!'** Atëherë, vëllai im Umejri filloi të qantë. Atëherë Resulullahu, nuk mund t'i rezistontë lotëve të tij dhe i dha leje të vintë në betëjë. Ndërsa unë isha ai që ia vura shpatën Umejrit në brez sepse ai nuk ishtë në gjendje ta mbantë atë vetë."[143]

"O Allah! Ata janë në këmbë. Ti u jep atyre mjete transporti! O Allah! Ata janë të zhveshur. Ti i vesh ata! O Allah! Ata janë të uritur, ti i ushqë ata! Ata janë të varfër, bëji të pasur me bollëkun tënd!"
Hadith

Flamurin e të dashurit të gjithë botëve, të dashurit tonë të shtrenjtë Muhammedit a.s., e mbantë Mus'ab bin Umejri, Sa'd bin Mu'adh dhe Aliu radijallahu anhum.[144] Shokët e tij të nderuar kishin vetëm tre kuaj dhe shtatëdhjetë deve. Njëri nga kuajt ishtë i Mikdadit, njëri i Zubejrit dhe tjetri i Mersed bin Ebi Mersed. Dy ose tre përsona hipnin me radhë mbi një deve. Resulullahu, hazreti Aliu, Ebu Lubabe dhe Mersed bin Ebi Mersed hipnin me radhë mbi një deve. Por ata të gjithë e donin që Resulullahu të mos zbristë kurrë nga deveja dhe i thoshin: "Jeta jonë qoftë flijuar për ty, o Resulullah! Mos zbrisni nga deveja. Në do të ecim për ju." Por i Dashuri i Universit, duke mos e dalluar vetën nga të tjerët, tha: **"Ju nuk jeni më të fortë se unë për të ecur, as nuk jam i pasur dhe i privuar nga shpërblimi dhe sevapet më shumë se ju."** I Dërguari i Allahut (paqja, mëshira dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të) dhe shokët e tij të nderuar ecnin shkretëtirës nën diellin përvëlues. Për më tëpër, ata ishin dhe agjërueshëm. Shokët e nderuar për të përhapur Islamin ecnin me dashuri dhe përkushtim pas të dashurit tonë Pejgamberit a.s.. Sepse ata ishin tëpër të vetëdijshëm se në fund të saj, ishtë kënaqësia e Allahut dhe e të Dërguarit të Tij, si dhe dëshira e tyre për të rënë dëshmorë në rrugën drejt xhenëtit. I dashuri ynë Profeti a.s. duke parë gjendjen e shokëve të tij, u lut: **"O Allah! Ata janë në këmbë. Ti u jep atyre mjetë transporti! O Allah! Ata janë të zhveshur. Ti i vesh ata! O Allah! Ata janë të uritur, ti i ushqë ata! Ata janë të varfër, bëji të pasur me bollëkun tënd!"**

Pejgamberi ynë i dashur dhe ushtria e tij e bekuar, ndërsa marshonin në këtë nxehtësi të madhe drejt Bedrit, njëkohësisht edhe karvani i idhujtarëve që vintë nga Shami po i afrohej Bedrit. Dy shokët që Profeti a.s. dërgoi për të marrë lajme nga karvani mësuan se karvani do të arrintë në Bedr brenda një ose dy ditësh dhe u kthyen me nxitim tëk i Dërguari i Allahut. Kur karvanët arritën në fshatin ku myslimanët morën lajmet, ata pyetën fshatarët: "A keni dëgjuar për ushtrinë e myslimanëve?" Ata thanë: "Nuk dimë gjë. Por dy prej shokëve të Pejgamberit (a.s.) erdhën dhe qëndruan këtu për një kohë, pastaj u larguan."

Ebu Sufjani, nisi të hulumtontë për vendndodhjen e ushtrisë myslimanë mirëpo kur shkoi për të hetuar vendinë tyr, shtypi jashtëqitjen e devesë dhe aty pa brenda fara hurme dhe tha: "Këto janë fara nga Medinëja. Mendoj se ata dy njërëz ishin vëshguesit e Muhamedit." Atë e kaploi një frikë e madhe dhe vendosi të largohej prej aty pa humbur kohë. Ebu Sufjani për të shkuar drejt Mekës përzgjodhi rrugën që ikën përgjatë bregdetit të Detit të Kuq. Përveç kësaj, ai për të lajmëruar mushrikët mekkas për situatën që ndodhej dërgoi një njëri të quajtur Damdam bin Amr Gifari në Mekë.[145]

Kur përsoni në fjalë arriti në Mekë, e çau këmishën nga para dhe nga mbrapa. Ai përmbysi shalën e devesë dhe thirri me zë të lartë: "Ndihmë! Ndihmë!... O kurejshë!

[143] İbni Sa'd, Tabakât, III, 150; Hâkim, Mustedrek, III, 208.
[144] İbni Hishâm, Sîret, I, 612; İbni Kesîr, Sire, II, 388; Kilâ'î, İktifâ, II, 18.
[145] İbni Hishâm, Sîret, II, 607; Suheylî, Ravd-ul-unf, III, 47.

RRUGËTIMI I BETËJËS SË BEDRIT

Shpejtoni të Shpëtoni Karvanët tuaj! Shpejtoni të shpëtoni mallrat tuaja që janë me Ebu Sufjanin, sepse ky i fundit është në rrëzik të sulmohet nga Muhammedi (a.s.) dhe shokët e tij. Nëse do të arrini, do ta shpëtoni karvanin tuaj!" Mekasit, pasi e dëgjuan këtë, menjëherë filluan përgatitjet e tyre. Ata mblodhën shtatëqind deve, njëqind kalorës dhe njëqind e pesëdhjetë këmbësorë. Kur i thanë Ebu Lehebi: "Ejani dhe ju!" ai nga frika që kishtë u justifikua duke thënë se ishtë i sëmurë dhe në vend të tij dërgoi As bin Hishamin. Ndërsa mushriku Umejje bin Halef e kishtë marrë çeshtjen e luftës me myslimanët si me frikë sepse ai kishtë dëgjuar Profetin e Allahut (sallallahu aleyhi ve sellem) duke thënë: **"Shokët e mi do ta vrasin Umejjen."** Pra kjo ishtë frika që kishtë Umejje bin Halef sepse ai e dintë se Profeti asnjëherë nuk largohej nga e vërtëta. Prandaj, për t'u mbrojtur nga insistimet e Ebû Xhehil, ai pretëndoi se ishtë i moshuar dhe shumë i shëndoshë. Megjithatë, pasi Ebû Xhehil e akuzoi për frikacak, ai u detyrua të shkontë në luftë kundër Pejgamberit alejhi selam.

Ushtria e mushrikëve përbëhej prej rreth një mijë veta. Të gjithë kishin veshur mburojë të hekurt. Kishin me vetë gra me zë të bukur që ti motivonin djemt dhe burrat e tyre në betëjë. Ata gjithashtu nuk kishin lënë pas dore instrumentët muzikore dhe alkoolin. Me një ushtri të tillë të fortë, ata ishin të menduar se do të fitonin me lehtësi, jo vetëm ndaj treqind vetave që përbëhëj ushtria e Pejgamberit a.s., por edhe ndaj një ushtrie prej mijë veta, sa ishin ata vetë. Madje disa prej mushrikëve kishin filluar duke llogaritur se cilët prej myslimanëve do t'i vrisnin dhe cilat pasuri do të merrnin prej tyr. Megjithatë, qëllimi i tyre më i madh ishtë të shfarosnin Islamin. Ky grup i egër politëistësh u nis me ritmin e defeve dhe këngëve motivuese që këndonin gratë.

Në këtë kohë, Ebû Sufjân kishtë bërë një distancë të konsiderueshme nga Badr dhe kishtë arritur pothuajse deri afër Mekkes. Dhe kur ishtë siguruar se rreziku i kishtë kaluar, ai dërgoi një njëri me emrin Kajs bin Imri-ul-Kajs të Kurejshët dhe e porositiatë ti lajmërojë ata me fjalët: "O Kurejsh! Ju kishit dalë nga Mekka për të mbrojtur karvanin tuaj, njërëzit dhe pasuritë tuaja. Në jemi shëndoshë e mirë, pa pësuar asnjë dëm dhe të çliruar nga rreziku i myslimanëve. Ndaj, kthehuni!... mos shkoni në Medinë për të luftuar me myslimanët!"

Kur Kajsi arriti tëk mushrikët dhe kur ju përcolli mesazhin e Ebu Sufjanit, Ebû Cehil tha: "Betohem se do të arrijmë në Badr dhe do të festojmë për tri ditë e tri nëtë, do të therim deve dhe do të pimë verë. Fiset përreth do të na shohin dhe do të na përgëzojnë, duke parë se nuk kemi frikë nga askush. Pas kësaj, askush nuk do të guxojë më të na sulmojë. O ushtri e pamposhtur e Kurejshëve! Marrshoni përpara.."

"Ai që nuk është në fenë tonë, nuk mund të jetë me ne."
Hadith

Kajsi e kuptoi se Ebu Xhehli nuk ishtë në gjendje të dëgjontë porositë e Ebu sufjanit dhe u kthye për t'i treguar Ebu Sufjanit situatën e Ebu Xhehlit. Ebu Sufjani, që ishtë një stratëg largpamës dhe i kujdesshëm, tha: "Mjerë Kurejshët! Ky është një plan i Amr bin Hishamit (Ebu Xhehlit). E bën këtë gjë vetëm nga pasioni për të qënë lider i mekkasve. Megjithatë, një sjellje e tillë e tëpruar është gjithmonë një mangësi dhe fatkeqësi e madhe. Nëse do të ndeshen me myslimanët, atëherë mjerë për Kurejshitët!" Me këtë, ai drejtoi karvanin me shpejtësi drejt Mekkës dhe arriti atje ku qëndrontë ushtria e mushrikëve.

Ndërkohë, i Dërguari i Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) së bashku me shokët e tij po i afrohej Bedrit. Kur ndaluan, pa se në të mes ushtrisë

islame gjëndeshin dy idhujtarë nga Medinëja, të cilët quheshin Hubejb bin Jesaf dhe Kajs bin Muharris. Edhe pse Hubejbin kishtë një helmetë hekuri mbi kokë nuk i kishtë shpëtuar syve të Pejgamberit a.s., ndaj dhe i Dërguari i Allahut i tha Sa'd bin Muadhit: **"A nuk është ky Hubejbi?"** Ai u përgjigj: "Po, o i Dërguari i Allahut!" Hubejbi ishtë një luftëtar trim dhe i aftë. Ai dhe Kajsi iu afruan të Dërguarit të Allahut dhe ai i pyeti: **"Pse po vini me në?"** Ata ju përgjigjën: "Ti je djali i motrës sonë dhe fqinj i yni. Kemi ardhur me njërëzit tanë për të mbledhur plaçkë luftë." Kur i Dërguari e pyeti Hubejbin: **"A ke besuar në Allahun e Madhëruar dhe në të Dërguarin e Tij?",** ai tha: "Jo." Pejgamberi (paqja qoftë mbi të) i tha: **"Atëherë kthehu mbrapsht! Ai që nuk është në fenë tonë, nuk mund të jetë me në."**

Hubejbi ju përgjigj: "Të gjithë e dinë trimërinë dhe aftësitë e mia si luftëtar, unë jam ai që shkakton plagë në zemrën e armikut. Do të luftoj përkrah tëje kundër armikut për të marrë plaçkë." Por, i Dërguari i Allahut nuk pranoi propozimin e tij. Pas një kohe, Hubejbi përsëriti kërkesën e tij, por Pejgamberi përsëri e refuzoi duke thënë se nuk mund ta pranontë pa u bërë mysliman. Kur arritën në vendin e quajtur Revha, Hubejbi erdhi përsëri të i Dërguari i Allahut dhe tha: **"O i Dërguari i Allahut! Unë besoj në Allahun e Madhëruar, Zotin e të gjitha botëve dhe dëshmoj se ti je i Dërguari i Tij."** Pranimi i Islamit nga Kjasi e gëzoi shumë të Dërguarin e Allahut xh.sh..

Ushtria Islame tashmë kishtë arritur në luginën e quajtur Safra, dhe aty dëgjuan lajmin se mushrikët mekkas për të shpëtuar karvanin e tyre kishin ngritur një ushtri të madhe dhe po vinin drejt Bedrit. Atëherë për këtë situatë I Dërguari i Allahut i mblodhi shokët e tij dhe nisi të diskutoi me ta. Këtu ata i kujtuan se kur medinasit ishin betuar dhe i kishin dhanë besën të Dërguarit të Allahut xh.sh (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) në Akabe, ata i kishin thanë: "O i Dërguari i Allahut! Eja në qytëtin tonë. Në do të të mbrojmë ty me jetën tonë kundër armiqve të tu dhe do të jemi ndjekësit e tu." Por tani ata ishin jashtë qytëtit Medinës (pra jsaht beslidhjes së Akabes) dhe përballë një ushtrie të madhe armike, që ishtë shumë më e shumtë në numër, njëkohësisht edhe e mirëpajisur me armë dhe pasuri të tëjmjaftueshme për luftë.

Kështu që i Dërguari i Allahut i pyeti shokët e tij për mendimin e tyre, nga muhaxhirët fajën e morën Ebu Bekr-i Siddik dhe Omer-ul Faruk, ata u ngritën dhe thanë se ishtë e nëvojshme të luftonin kundër mushrikëve mekkas. Po nga muhaxhirët u ngrit Mikdad bin Esved dhe tha: "O i Dërguari i Allahut! Çfarëdo që të jetë urdhri i Allahut të Madhëruar, zbatoje atë. Ec përpara me urdhrin e Tij. Në jemi gjithmonë me ty dhe nuk do të të braktisim kurrë. Nuk do të themi kurrë siç i thanë Izraelitët Musait (paqja qoftë mbi të): **Ata thanë: "O Musa! Në kurrë nuk do të hyjmë në të përderisa ata janë aty. Kështu që, shko ti dhe Zoti yt dhe luftoni ju të dy, ndërsa në nuk po luajmë fare prej këtu ku jemi."**[146] Në do të flijojmë jetën dhe kokën tonë për Allahun dhe të Dërguarin e Tij. O i Dërguari i Allahut! betohemi për Allahun që të ka dërguar ty Pejgamber për të na treguar në rrugën e drejtë, që nëse na dërgon përtëj detit në Abisini, përsëri do të shkojmë. Në kurrë nuk do të kundërshtojmë ty, as edhe për gjënë më të vogël. Jemi të gatshëm të përmbushim çdo urdhëresë tënden. Prindërit e mi, jeta ime dhe gjithçka që unë zotëroj, pra gjithçka e imja sot është e jotja dhe flijohet për ty dhe Allahun xh.sh." Kur dëgjoi

[146] Mâide: 5/24.

I Dërguari i Allahut këto fjalë që tha Mikdadi u gëzua shumë dhe nisi ti ti begatoi shokët e tij me lutje të mira[147].

Mirëpo këto ishin fjalët e muhaxhirëve (emigrantëve) ndaj mendimi i myslimanëve të Medinës (ensarëve) ishtë shumë i rëndësishëm, sepse ata ishin më të shumtë në numër dhe i kishin premtuar të Dërguarit të Allahut se do ta mbronin në Medinë. Sepse ata nuk i kishin dhënë ndonjë premtim Pejgamberit a.s. për të luftuar për të jashtë Medinës. Kur kjo çështje u kuptua, Sa'd bin Muadh nga Ensarët u ngrit dhe tha: "**O i Dërguari i Allahut! Nëse më lejon, do të flas në emër të Ensarëve." Dhe pasi ai mori leje, tha: "O i Dërguari i Allahut! Në të kemi besuar ty, e kemi pranuar Pejgamberllëkun tënde dhe kemi dëshmuar se çdo gjë që ke sjellë është e drejtë. Ndaj sot po ripërtërijmë dhe njëherë beslidhjen që kemi dhënë në Akabe. Ndaj ju bejmë me dije se kurrë nuk do ta kthejmë mbrapsht fjalën e dhënë, dhe kudo që të ti shkosh në gjithmonë do të jemi më ju nën urdhërat tuaja,. Urdhri yt tëk në është më i rëndësishëm se kokat tona. Dije se jeta dhe kokat tona janë të flijuara për ty. Betohemi në Allahun që ty të ka dërguar Pejgambe, se nëse ti futësh në det, edhe në do të futëmi pas teje. Asnjëri prej nësh nuk do të lërë ty të vetëm. Çfarëdo që të jetë në mendjen tënde, urdhëro dhe në do ta zbatojmë atë. Pasuritë tona së bashku me jetët tona janë të flijuara për ty. Në kurrë nuk do të ja kthejmë shpinën armikut dhe ty kurrë nuk do të lëmë të vetëm përballë armikut. Do na shohësh se në do të jemi të durueshëm në luftë. Shpresa jonë është që ty të të bëjmë të lumtur dhe të fitojmë kënaqësinë e Allahut xh.sh. dhe të të Dërguarit të Tij. Mëshira e Allahut qoftë mbi ty o I Dërguar."** Mirëpo kur dëgjuan sahabët së bashku me të dashurin e tyre Pejgamberin a.s. fjalët e Ensariut Sa'd bin Muadh r.a. aq shumë sa u gëzuan po aq shumë dhe u emocionuan. Ndaj ata të gjithë njëzëri dhe me një zemër të vetme u pajtuan me fjalët e tij. Ndërsa I Dërguari i Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) u kënaq shumë dhe i përgëzoi Sadin r.a. dhe shokët e tij ensarë.

Tashmë të gjitha dyshimet ishin zhdukur. Pra sahabët, vetëm për të fituar kënaqësinë e Allahut dhe të Dërguarit të Tij (paqja dhe meshira e Allahut qofshin mbi të), do ta ndiqnin Pejgamberin a.s. ngado që ai ti urdhërontë. Pra pavarësisht sa i madh apo i fuqishëm të ishtë armiku, ata pa asnjë hezitim, madje duke shkuar me dashuri të plotë drejt vdekjes, për ta mjaftontë që i Dashuri i universit ti urdhërontë. Kur i Dërguari i Allahut pa vendosmërinë dhe entuziazmin e shokëve të tij ju lut Allahut xh.sh. që ti begatontë me kënaqësinë e Tij sahabët dhe Sadin radijallahu anhuma. Më pas I Dërguari i Allahut ju tha; **"Marshoni përpara! Tashmë unë po shoh triumfin tuaj dhe mposhtjen e mushrikëve në fushëbetëj. Marshoni përpara! Ndihma dhe kënaqsia e Allahut është me ju."** pas këtij përgëzimi sahabët u nisën drejt Bedrit me një intuziazëm të pa përshkruar.

Ardhja e Melaikeve në Ndihmë të Besimtarëve

Kohën kur sahabët arritën në Bedër, ishtë natë e xhuma. Profeti ynë i dashur i tha shokëve të tij: **"Shpresoj që nga ky pus afër kodrës së vogël të merrni disa informacionë."** Më pas urdhëroi që Aliun, Sa'd bin Ebi Vakkâs, Zubejr bin Avvâm së bashku me disa sahabë të tjerë të shkonin atje tëk pusi që ndodhej para tyre. Aliu r.a. dhe shokët e tij menjëherë, pa

"O i Dërguari i Allahut! Çfarëdo që të jetë urdhri i Allahut të Madhëruar, zbatoje atë. Ec përpara me urdhrin e Tij. Në jemi gjithmonë me ty dhe nuk do të të braktisim kurrë."
Mikdad bin Esved r.a.

[147] Ibni Sa'd, Tabakât, II, 14.

hezitim shkuan atje tëk pusi. Kur arritën atje panë aty karvanin që i dërgontë ujë mushrikëve Kurejshit. Kur ata i panë myslimanët, prej frikes iken me vrap. Por dy prej tyre ran peng. Njëri prej tyre ishtë skllavi i fisit Haxhxhâxh i quajtur Eshlem, ndërsa tjetri ishtë skllavi i fisit As bin Said që quhej Arîdh Ebû Jesâr. Kur i sollën këto të dy para Profetit a.s., ai ju tha: **"Ku janë Kurejshit?"** Ata u përgjigjën: "Janë vendosur pas kësaj kodre të dukshme." Profeti tha: **"Sa është numri i tyre?"** Ata thanë: "Nuk e dimë." Por kur i pyeti Profeti a.s. se: "**Sa deve therin ata çdo ditë?"** Ata ju përgjigjën: "Një ditë nëntë, një ditë dhjetë." Atëherë Profeti tha: **"Janë më shumë se nëntëqind, por më pak se një mijë."** Pastaj pyeti përsëri: **"Kush është nga elita e Kurejshit?**" Ata thanë: "Utbe, Shejbe, Hâris bin Amr, Ebul-Buhtërî, Hâkim bin Huzâm, Ebû Xhehli, Umejje bin Halef..." Kur ata e thanë këtë, Profeti u kthye nga shokët e tij dhe tha: **"sot Kurejshitët e kanë zbrazur zemrën e tyre për ju**." Më pas sahabët pyetën: "A kishtë ndonjë që u kthye nga Kurejshi?" Ata u përgjigjën: "Po, që që u kthye ishtë Ahnës bin Ebi Sherik nga Beni Dhuhre." Atëherë Profeti a.s. tha: **"Kur ai nuk e njihtë Allahun xh.sh. shpalljen e Tij Kur'anin dhe botën e përtëjme (Ahiretin), e ka drejtuar fishin Beni Dhuhure në rrugë të drejtë. A kishtë njëri tjetër që u kthye pas tij (Ahnësit)?''** Ata (pengjet) ju përgjigjën: " po pas tij u kthye edhe Adî bin Kab."[148]

Profeti për herë të fundit e dërgoi Omerin r.a. përqë tu thoshtë atyre se Muhammedi a.s. nuk dëshiron të luftoi me to. Kur arriti Omeri bin Hattâbi r.a. ju tha atyre**: "O Kurejshitë! Resulullahu (alejhi selam) thotë se: "Për mua paqja është më e dashur se lufta ndaj, hiqni dorë nga lufta dhe kthehuni në vendlindjen tuaj. Sepse është më e pranueshme të luftoj me dikë tjetër, përveç jush!..."**

"InshaAllah, nesër fialni do virtetë ne këtë vënd! InshaAllah, nesër në mëngjes filani do vritet këtu! Ja këtu! Dhe Aty"
Hadith

Kur dëgjuan kurejshitët për propozimin e Pejgamberit a.s dëgjuan Hâkim bin Hudhâmin i cili ju thoshtë: "O Kurejshitë! Muhamedi (a.s.) me plot të drejtë po ju therret për paqë. Nëse nuk e pranoni propozimin e tij, betohem se paskësaj thirrje ai nuk do të ndal pa e çuar deri në fund betëjen e tij!..." Ndërsa kur e dëgjoi Hakemin Ebû Xhehli nga zemrimi prej fjalëve të tij u ngrit në këmbë dhe tha: "Nëse do e pranonim Muhammedin (a.s.) në nuk do të ishim këtu. Ndaj sot në jemi betuar se do ti lajmë hesapet njëherë e përgjithmonë me Muhammedin (a.s.) dhe me pasuesit e tij. Kështu që askush më nuk do të marrë guximin të na i ndal udhët dhe karvanët tanë." Fjalimi i Ebu Xhehlit e bëri Omerin të kuptoi se tashmë nuk kishtë mbetur rrugë tjetër veç luftës, ndaj ai u kthye tëk Pejgamberi a.s. dhe e lajmëroi atë për situatën që përjetoi me Kurejshitët.

Atë natë Pejgamberi a.s. së bashku me shokët e tij të nderuar arriti para mushrikëve kurejshitë në Bedir dhe u vendosën pranë puseve të ujit. Aty Pejgamberi a.s. nisi të konsultohet me shokët e tij se ku duhet ti ndërtonin çadrat e vendqëndrimit. Prej sahabëve fjalën e mori 33 vjeçari Habbab bin Mundhir i cili tha; ''O i Dërguari i Allahut! Vëndqëndrimi ynë këtu a të është emruar nga Allahu xh.sh. apo ti me stratëgjinë tënde e pe të arsyeshme që në të ulemi këtu?'' ''Jo! Këtu më është dukur më e përshtatur për vetëmbrojtje në një luftë si kjo.'' Ju përgjigj Pejgamberi alejhi selam.

Kur dëgjoi fjalët e Pejgamberit a.s. Habbabi tha; '' O i Dërguari i Allahut! Prindërit e mi të qofshin falë! Ju e dini që në jemi luftëtarë dhe e dini që në i dimë mirë këto vënde. Por nëse në e ndërtojmë vëndqëndrimin tonë këtu atëherë pusi që është

[148] Ahmed bin Hanbel, Musned, I, 117; İbni Hishâm, Sîre, I, 616; Vâkıdî, Megâdhî, I,

përballë nësh është i mbushur me ujë dhe aty pranë tij do të qëndrojnë kurejshët. Kështu që ata do të jenë më epror se në. Ndaj në zhvendosemi atje tëk pusi përballë, ndërkohë puset përreth i mbyllim dhe kurejshët do të jenë poshtë nësh. Sepse kur në të na kaploi etja kthehemi dhe pimë ujë tëk pusi ndërsa armiqtë nuk kanë nga tja mbajnë tjetër, veç dorëzimit.''[149]

Pejgamberit a.s. i pëlqëu propozimi i Habbabit ndaj ai tha; **''Kë të drejtë o Habbab! Ndaj ngrihuni dhe ndërtojeni vëndqëndrimin atje ku thotë Habbabi.''** Sahabët u ngritën të gjithë dhe shkuan tëk pusi ku kishtë thënë Habbabi dhe pasi ndërtuan vëndqëndrimin e tyre i mbyllën të gjithë puset që ndodheshin përreth. Ndërsa Sad Bin Muadh erdhi tëk i Dërguari i Allahut xh. sh. (paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të) dhe i tha; ''O i Dërguari i Allahut! A ta ndërtojmë një vëndqëndrim me degë hurmash që aty të vendoseni ju dhe të mbahen kuvendet e konsultimit për betëjë?'' Pejgamberi a.s. e pa të duhur propozimin e Sadit dhe i dha leje atij që të ndërtoi vëndpushimin aty, të cilin e ndertuan sahabët pa vonësë.

Pejgamberi a.s. së bashku me shokët e tij të nderuar e vizituan vëndin dhe bënin analiza për betëjën që do të mbahej një ditë me pas. Gjatë vizitës nëpër fushbetëjë Pejgamberi a.s. ju thoshtë shokëve të tij se; **''InshaAllah, nësër fialni do virtëtë në këtë vënd! InshaAllah, nësër në mëngjes filani do vritët këtu! Ja këtu! Dhe Aty...''** pra Pejgamberi a.s. ju tregontë shokëve vëndet se kush prej mushrikëve ku do të virtëj në betëjën që do të mbahej një ditë me pas ndërmjet myslimanëve dhe mushrikëve mekkas.

Omeri r.a. e ka treguar këtë ngjarje kështu: "Pashë se secili prej tyre u vra pikërisht aty ku Pejgamberi i nderuar e kishtë vënë dorën e tij të bekuar. Trupat e tyre nuk ishin as pak më përpara, as pak më prapa."

I Dërguari i Allahut xh. sh. (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), i ndau shokët e tij në tri grupe: flamurin e Muhaxhirëve ia dha Mus'ab bin Umejrit, të Evsve ia dha Sa'd bin Mu'adhit dhe flamurin e Hazrexhëve ia dha Habbab bin Mundhirit. Secili grup u mblodh nën flamurin e tij.[150]

Pejgamberi ynë i Dashur e rreshtoi ushtrinë në formën dhe në rendin disiplinar ashtu sikur i kishtë hije një ushtrie e cila nuk njihtë Zot tjetër veç Allahut. Gjatë rreshtimit, kur Sevâd bin Gazijje doli përpara rreshtit, Pejgamberi i nderuar i preku gjoksin me një shkop që mbantë në dorë dhe tha: **"Kthehu në rresht, o Sevâd!"** Sevâdi u përgjigj: "O i dërguar i Allahut! Shkopi yt më dhembi. Për Allahun, që të dërgoi me fenë e vërtëtë, Librin dhe drejtësinë, dua që edhe unë të të prek me shkop." Të gjithë shokët e bekuar u habitën nga kjo kërkesë. A mund të kërkohej kësas (hakmarrje e drejtë) nga Pejgamberi? A ishtë e mundur të bëhej një gjë e tillë? Resulullahu, duke hapur këmishën e tij të bekuar, tha: **"Hajde o Sevad, bëje kësasin dhe merre hakun tënd."**

Kur pa Sevadi r.a. barkun e bekuar të Pejgamberit a.s. u ul dhe e puthi me një gëzim dhe dashuri të madhe gjoksin e bekuar të Habib-i Ekremit (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të). Ndërsa të gjithë prisnin që Sevadi të kërkontë kësas, para skenës që panë, shokët e tij mbetën të habitur dhe e admiruan Sevadin për veprimin që ai bëri. I dashuri ynë Pejgamberi a.s. e pyeti: **"Pse veprove kështu o Sevad?"** Sevadi iu përgjigj duke i thënë: "më të dashurit e mi, edhe jeta ime qofshin flijuar për ty o i Dërguar i Allahut! Sot, me urdhrin e Allahut, po ndiej se më ka ardhur fundi

[149] Hâkim, Mustedrek, III, 482.
[150] Vâkıdî, Megâdhî, I, 58; İbni Sa'd, Tabakât, II, 373.

BETËJA E BEDRIT



në këtë dynja dhe kam frikë nga ndarja prej tëje. Për këtë arsye, dëshirova që për herë të fundit buzët e mia të prekin trupin tënd të bekuar. Këtë e bëra që në Ditën e Kiametit të mund të ndërmjetësosh për mua dhe të shpëtoj nga denimi i Allahut." Përballë kësaj dashurie, edhe Pejgamberin tonë të Dashur (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) e kishtë prekur shumë veprimi i tij ndaj ai ju lut Allahut për Sevadin radijalahu anhu.

Në krahun e djathtë të ushtrisë së bekuar Islame do të komandontë heroi Zubejr bin Avvami, ndërsa në krahun e majtë do të komandontë Mikdad bin Esvedi. Ndërsa I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), së bashku me sahabët e tij të nderuar, si gjithmonë, konsultohej rreth mënyrës së nisjes së betëjës dhe i pyeti ata: **"Si do ti luftojmë mushrikët?"** (Pra ishtë fjala se si do të nishtë sulmi i përleshjeve kundër mushrikëve mekkas). Asim bin Sabiti u ngrit në këmbë, duke mbajtur harkun dhe shigjetën në dorë tha: "O i Dërguar i Allahut! Kur kurejshët të na afrohen rreth njëqind metra, t'i godasim me shigjeta. Pastaj, kur të arrijnë në distancën e hedhjes së gurëve, t'i godasim me gurë. Kur të afrohen aq sa t'i arrijmë me shtizat tona, të luftojmë me to derisa ti mposhtim. Dhe pastaj duke përdorur shpatat tona do të hyjmë në dyluftim me to."

Pejgamberi a.s. e pëlqëu taktiken e Asim bin Sabitit ndaj ai u ngrit dhe ju dha këtë udhëzim shokëve të tij**: "Rrini të radhitur në rrjesht dhe askush të mos largohet nga rreshti. Lidhuni ngushtë me njëri-tjetrin dhe ashtu qëndroni të paluhatur në vendin tuaj. Mos filloni luftën derisa të ju jap urdhërin e luftës. Mos i përdorni shigjetat tuaja pa u afruar armiku pranë jush, pra mos i shpërdoroni ato. Kur armiku të hapë mburojat, atëherë lëshoni shigjetat. Kur të afrohet shumë, hidhni gurë me duar tuaja. Kur të afrohet më shumë, përdorni shtizat tuaja. Dhe kur të arrini në përballje trup më trup, luftoni me shpatat tuaja."**

Pastaj Pejgamberi a.s. la në shërbim patrullor rojet dhe i urhderoi shokët e tij të bekuar që të pushojnë. Ata ranë në një gjumë të thellë, njësoj sikur nuk mund të ngrihnin as qëpallat. Pejgamberi ynë i nderuar u tërhoq në një qoshe dhe nisi të pushoi aty në mesin e shokëve të tij. Por para se I Dërguari i Allahut xh.sh. (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) u shtri me fjet, ngriti duart drejt qiellit dhe, me një hidhërim të madh, iu lut Allahut të Madhëruar**: "O Zoti im! Nëse e shkatërron këtë grusht njërëzish, atëherë në tokë nuk do të adhurohesh më kurrë..."** pra I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) ju lut Allahut xh.sh. që Allahu ti vintë në ndihme sahabëve në fush vetëjë.

Ushtria e bekuar islame tashmë ndodhej në shkretëtirën e Bedrit. Për këtë arsye, ecja ishtë e vështirë sepse këmbët fundoseshin në rërën e nxehtë. Mëshira dhe mirësitë e Allahut të Madhëruar dhe begatitë e lutjeve të Pejgamberit alejhi selam, ishin motivi, guximi, triumfi dhe martirëria e sahabëve, të cilit ë ndjenin vetën e tyre sikur vërtëtë ata të ishin zogj që fluturonin nëpër hapësirat e qiellit. Pra sahabët ishin aq të motivuar dhe të zellshëm sa që gjëndja e tyre dukej sikur po fluturonin nëpër hapsirat e qiellit dhe jo sikur po shkonin në luftë.

Në mëngjes herët Pejgamberi ynë i dashur i zgjoi shokët e tij për të falur namazin e sabahut. Pasi e kreu faljen e namazit të sabahut, ai (alejhi selam) duke i inkurajuar për luftën u foli sahabëve për virtytët e luftës në rrugën e Allahut xh.sh..

Ai ju tha sahabëve se: **"Me siguri, Allahu i Madhëruar urdhëron për të drejtën dhe të vërtëtën. Ai (Allahu xh.sh.) nuk pranon asnjë vepër që nuk bëhet për kënaqësinë e Tij... Përpiquni të përmbushni urdhrin e Tij, ku Ai, në këto vende**

ju ka premtuar mëshirën dhe faljen e Tij, ndaj duhet ta kaloni me sukses këtë provë! Sepse, premtimi i Tij është i vërtetë, fjala e Tij është e drejtë dhe ndëshkimi i Tij është i ashpër. Unë dhe ju jemi të lidhur me Allahun suphanëhu ve tëala. Tëk Ai jemi mbështëtur, prej Tij jemi dhe tëk Ai është kthimi ynë. Pra në jemi prej Tij dhe kthimi ynë përfundimtarë është tëk Ai. Allahu i Madhëruar më faltë mua dhe të gjithë myslimanët!"

"O Zoti im! Mushrikët kurejshitë po vijnë me tërë krenarinë dhe arrogancën e tyre! Ata të bëjnë shok Ty dhe e mohojnë Profetin Tënd. O Allah! Të kërkoj që të përmbushësh premtimin Tënd për ndihmë dhe fitore!... O Allah! Nëse dëshiron shkatërrimin e këtij grushti myslimanësh, atëherë në sipërfaqën e tokës nuk do të mbetet më askush që të të adhurojë Ty!..."
Hadith

Dielli i ditës së xhuma, pikërisht në datën 17 të muajit të Ramazanit tashmë kishtë lindur. Pak më pas, do të fillontë një nga betëjat më të pamëshirshme, më të pabarabarta, më të rëndësishme dhe më të mëdha në historinë e njërzimit... Nga njëra anë ishtë I Dashuri i Universit Pejgamberi ynë i dashur Muhammedi (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), dhe një grusht i vogël që përbëhej prej shokëve të tij të nderuar, të cilët nuk hezitonin të flijonin jetën për të. Ndërsa nga ana tjetër, ndodhej një grup idhujtarësh dhe mushrikësh të cilët mbjellnin në gjokset e tyre një urrejtje të shfrenuar dhe ishin mbledhur për të shkatërruar Islamin dhe për të vrarë një profet të nderuar nga Allahu i Madhëruar. Madje mes tyre ishin edhe disa nga të afërmit e Pejgamberit tonë të nderuar (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të). Edhe ata kishin ardhur në Bedër për të luftuar kundër nipit të tyre që ishtë vetë Pejghamberi a.s.. Pra në mesin e ushtrisë mushrike ishin edhe të afërmit e Muhammedit a.s. të cilit kishin ardhur për të luftuar kundër tij.

Para se të nishtë betëja Pejgamberi alejhi selam e rishikoi edhe një herë rregullin e ushtrisë së tij dhe ripërsëriti udhëzimet që ju kishtë dhënë më parë. Në këtë kohë, idhujtarët kurejshë dolën nga kampi i tyre dhe filluan të marshonin drejt luginës së Bedrit. Shumica prej tyre ishin të mbrojtur me mburoja të hekurta. Ata (mushrikët) u vërsulën për të sulmuar ushtrinë islame me një krenari dhe arrogancë të papërshkruar. Kur Resulullahu pa këtë gjendje të tyre, së bashku me Ebu Bekrin hyri në çadër dhe ngriti duart e tij të bekuara duke iu lutur Allahut të Madhëruar**: "O Zoti im! Mushrikët kurejshitë po vijnë me tërë krenarinë dhe arrogancën e tyre! Ata të bëjnë shok Ty dhe e mohojnë Profetin Tënd. O Allah! Të kërkoj që të përmbushësh premtimin Tënd për ndihmë dhe fitore!... O Allah! Nëse dëshiron shkatërrimin e këtij grushti myslimanësh, atëherë në sipërfaqën e tokës nuk do të mbetët më askush që të të adhurojë Ty!..."**

Peygamberi a.s. me lotë e përulësi vazhdimisht, duke e përsëritur kërkesën e tij për ndihmë, i lutëj Allahut. Më pas I Dërguari i Allahut lexoi ajetët Kurani ku Allahu xh.sh. thotë se**; "Mizoria e tyre do t'ia mbathë dhe do të kthejnë shpinën. Por jo, afati i tyre është Ora (për shpërblimin e tyre të plotë) dhe Ora do të jetë më e tmerrshme dhe më e hidhur"**[151] dhe doli nga çadra.

I Dërguari i Allahut xh.sh. (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) ju afrua ushtrisë së tij dhe ju lexoi sahabëve ajetët e Kuranit: **"O ju që keni besuar! Kur të takoheni me forcat (armike), qëndroni fort përballë tyre dhe kujtoni fort Emrin e Allahut (me gojë e me zemër) që të jeni me të vërtetë të fituar. Bindjuni edhe Allahut edhe të Dërguarit të Tij, mos u kundërshtoni (me njëri-tjetrin) që të mos humbni kurajon dhe të mos ju lënë fuqitë dhe jini të duruar e të qëtë. Vërtët që Allahu është me të duruarit."**[152]

[151] Kamer: 54/45-46.

Kjo ishtë hera e parë ku të dyja ushtritë do të përballeshin me njëra tjetrën në një luftë-betëjë të plotë. Palët prisnin me padurim që lufta të nishtë, kjo padurimsi më tëpër ishtë e mushrikëve të cilët pretëndonin se do ti lanën hesapet me myslimanët dhe do ti zhduknin ata një herë e përgjithmonë. Ndersa Sahabët radijallahu anhuma me durim dhe qëtësi dëgjonin urdhrin e të Dërguarit a.s. i cili ju thoshtë se nuk duhet të hynë në luftë pa përmendur Allahun xh.sh. Kështu sahabët të gjithë njëzëri filluan të thërrasin: "Allahu Ekber! Allahu Ekber!" dhe i lutëshin Allahut që t'u dhurontë fitoren. Tani për të filluar betëjën ata prisnin vetëm një shenjë nga i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të).

Zakonët e asaj kohe ishin që para se mes dy ushtrive të fillontë betëja, secila palë përzgjidhtë më trimin, më të përgatiturin dhe më guximtarin dhe i urdhëronin ata që të dilnin në duel. Këto dyluftime bëheshin për të motivuar dhe për të shtuar dëshirën e seciles pale kunder palës tjetër. Por këtë rregull e theu një nga jobesimtarët i cili quhej Amir bin Hadremi. Ai e theu zakonin sepse sulmoi me një shigjetë drejt ushtrisë myslimanë. Shigjeta goditi një nga muhaxhirin Mihxhan, i cili përshkak të goditjes së shigjets ra dëshmor. I Dërguari i Allahut tha për të: **"Mihxha është zotëria i dëshmorëve."** Kjo ngjarje u bë shkak që sahabët sa nuk mund të rrinin më në vend. Megjithatë, ata nuk guxonin të lëviznin pa urdhërin e të Dërguarit të Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të).

Tashmë nga njëra anë ushtria e cile nuk lëviztë as qërpikët pa urdhërin e të Dërguarit të Allahut dhe nga ana tjetër mushrikët e Mekkas të cilët prej urrejtjes ndaj myslimanëve nuk po i zintë vëndi. Pra njëra ushtri luftontë për të përhapur dritën e Allahut në tokë (Islamin) ndërsa ushtria tjetër luftontë për të shuar dritën e Allahut xh.sh. Në këtë çast nga radhët e mushrikëve u dukën që dolën para tre nga armiqtë më të përbetëura të myslimanëvë. Ata ishin Utbe, vëllai i tij Shejbe dhe djali i tij Velid, që të tre prej fisit Rebia. A dolën përpara dhe filluan të sfidojnë myslimanët dhe thërrisnin: "A ka ndonjë burrë midis jush që të marrë guximin dhe të na përballet në dyluftim?" Prej sahabëve u hodh Ebu Hudhejfah i cili doli për të luftuar kundër babait të tij, pra kundër Utbes. Por i Dërguari i Allahut e ndaloi: **"Ndalu ti!"** Atë moment për t'u përballur me Utben, Shejben dhe Velidin u ngritën tre sahabë të tjerë, djemtë e Afra-së nga Medinëja, Muadhi, Muavedhi dhe Abdullah bin Revaha. Që të trë rrokën shpatat në duar dhe qëndronin në gadishmëri për dyluftim.

Kur panë jobesimtarët mushrikë se tre trimat myslimanë ishin të panjohur për ta i pyetën: "Kush jeni ju?" dhe kur ata u prezantuan si myslimanë nga Medina, jobesimtarët mushrikë thanë: "Në nuk kemi punë me ju. Në duam të luftojmë me njërëz nga fisi i Abdulmuttalibit (pra mushrikët kerkonin që në dyluftim të dilnin muhaxhirët jo ensarët)." Ata u kthyen nga ushtria e myslimanëve dhe thirrën: "O Muhamed! Për të luftuar në dyluftim me në mos na xirr medinnasit por na nxirr përpara të barabartët tanë nga fisi ynë, pra na nxirr mekkasit!"

Pasi i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), i urdhëroi të tre trimat ktheheshin në vendet e tyre. Pastaj, hodhi një vështrim mes sahabëve të tij dhe tha: **"O bijtë e Hâshimëve! Ngrihuni! Luftoni, kundër atyre që me fenë e tyre të rreme kanë ardhur për të shuar dritën e Allahut. Luftoni në rrugën e drejtë dhe dijeni se për këtë qëllim e ka dërguar Allahu të Dërguarin e Tij**

[152] Enfâl: 8/45-46.

(paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) **në mesin tuaj. Ngrihu, o Ubejde! Ngrihu, o Hamza! Ngrihu, o Ali!"**

"O Allah! përmbushe premtimin Tënd mbi ne! O Allah! Nëse e shkatërron këtë grup të vogël myslimanësh, nuk do të mbetet askush më që në sipërfaqën tokës të të adhurojë Ty!"
Hadith

Luanët e Allahut, Hamzai, Aliu dhe Ubejdeja (kënaqësia e Allahut qoftë mbi të tre ata), rrokën shpatat, vunë përkrenaret dhe dolën në fushëbetëjë. Kur u afruan përballë armikut jobesimtarë, ata (armiqtë) i pyetën: "Kush jeni ju? Nëse jeni të barabartë me në (nëse jeni prej mekkasve) në do të luftojmë kundër jush." Sahabët ju përgjigjën njëri pas tjetrit duke thënë: **"Unë jam Hamza! Unë jam Ali! Unë jam Ubeyde!"** Atëherë jobesimtarët thanë: "Ju jeni të barabartë me në, ndaj pranojmë që të luftojmë kundër jush." Luanët e guximshëm të Islamit fillimisht i bënë thirrje mushrikëve të pranonin Islamin, por ata i refuzuan. Pas refuzimit, të tre nxorën shpatat dhe u vërsulen mbi jobesimtarët. Hamzai r.a. dhe Aliu r.a. me një goditje të vetme i vranë Utben dhe Velidin. Ndërsa Ubejde e plagosi Shejben, por edhe ai u plagos nga Shejbeja. Por ardhja në ndihmë e Hamzait dhe Aliut (radijallahu anhuma) e shpëtuan Ubejden dhe e vranë Shejben. Më pas ata e morën Ubejden dhe e sollën tëk I Dërguari i Allahut[153] (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të).

Plagët që kishtë marrë Ubejde ishin në kyçin e këmbës së tij dhe gjaku i rridhtë rrëke. Edhe pse ai ishtë në këtë gjëndje, ai nuk i kushtoi aspak rëndësi gjendjes së tij po pyeti: "Shpirti im të qoftë flijuar në rrugën tëndë o i Dërguari i Allahut! Nëse vdes në këtë gjendje, a jam dëshmor?" Ndërsa I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) ju përgjigj: **"Po, ti je dëshmor,"** dhe e lajmëroi se ai ishtë banor i Parajsës (xhennëtit). (Ubejde ndërroi jetë gjatë kthimit nga lufta, pikërisht në vendin e quajtur Safra.)

Jobesimtarët mushrikë në dyluftim humbën ndre tre njërëzit më të rëndësishëm të tyre, ndaj ata u shokuan nga gjithë ajo çfar i shihnin sytë. Por pavarësisht kësaj humbje, Ebu Xhehli përpiqëj të ngrintë moralin e ushtrisë së tij duke thënë: "Mos u shqëtësoni për vdekjen e Utbes, Shejbes dhe Velidit! Ata u vranë sepse u hodhën me nxitim në betëjë! Betohem se në nuk do të largohemi nga kjo luftë pa i zënë myslimanët robër dhe pa i lidhur ata me litarët tanë!" Ndërkohë, sahabët e ndershëm mezi prisnin që të shpërthenin me shpatat e tyre kundër jobesimtarëve. I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) vazhdontë të përsëristë duanë: **"O Allah! përmbushe premtimin Tënd mbi në! O Allah! Nëse e shkatërron këtë grup të vogël myslimanësh, nuk do të mbetët askush më që në sipërfaqën tokës të të adhurojë Ty!"**

Përballë kesaj situatë u duk që nga radhët e jobesimtarëve të doltë Abdurrrahmani, i biri i Ebu Bekrit r.a., i cili ende nuk ishtë bërë mysliman. Ai kërkoi që prej myslimanëvë ti diltë një kundërshtar për dyluftim. Sapo e panë myslimanët nga radhët e tyre doli një përson i cili nxori shpatën dhe u hodh përpara për të luftuar me të. Përsoni që u hodh nga radhët e myslimanëve ishtë vetë Ebu Bekri, babai i Abdurrrahmanit, një kohësisht sahabiu i parë që ishtë bërë mysliman dhe mbantë titullin Seddık (i drejtë). Ai u nis për të luftuar kundër të birit, por i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) e ndaloi duke i thënë: **"O Ebu Bekir! A nuk e di se ti je syri im që sheh dhe veshi im që dëgjon? A nuk e din ti se kur ndjej shqëtësim në trupin dhe zemrën time, lehtësohet kur sheh fytyrën tënde të bekuar. Pra ti o Ebu Bekir je ai që më jep forcë, ndaj mos u largo prej**

[153] İbni Hishâm, Sîret, I, 708; İbni Sa'd, Tabakât, II, 17; Taberî, Târih, II, 134-135.

meje." Ndërsa Ebu Bekri i thirri të birit duke i thënë: "O i poshtër! Ku mbeti lidhja jotë me mua?"

"O Ebu Bekir! A nuk e di se ti je syri im që sheh dhe veshi im që dëgjon? A nuk e din ti se kur ndjej shqëtësim në trupin dhe zemrën time, lehtësohet kur sheh fytyrën tënde të bekuar. Pra ti o Ebu Bekir je ai që më jep forcë, ndaj mos u largo prej meje."
Hadith

Më pas I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të).u ul në tokë dhe mori një grusht rërë nga toka dhe e hodhi rërën drejt armiqve duke thënë: **"Le t'u nxihen fytyrat!... O Allah! Fut frikë në zemrat e tyre dhe bëji ata që t'u dridhen këmbët!"** Pastaj u kthye nga sahabëve, të cilët rrinin të rrjeshtuar dhe në gadishmeri për të sulmuar armikun e tyre përbindësh, dhe u tha: **"Sulmoni!"** Sahabët, të cilët prisnin vetëm një shenjë prej tij, u hodhën në sulm sipas udhëzimeve që I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) ju kishtë dhënë më parë. Në mes të thirrjeve "Allahu Ekber! Allahu Ekber!" shigjetat filluan të fishkëllenin, gurët të godisnin objektivat e tyre dhe shtizat të përplaseshin me parzmoret e armikut.

Luanët e Allahut, sikur Hamzai dhe Aliu (radijallahu anhuma), po luftonin me të dyja duart, pra me dy shpata. Aliu, Omeri, Zubejr bin Avvami, Sa'd bin Ebi Vekasi, Ebu Duxhanë dhe Abdullah bin Xhahi (raijallahu anhum), ishin vërsulër frejt e në mes radhëve të armikut dhe ju kishin shkaktuar jobesimtarëve një humbje të thellë, gjë kjo që ata (mushrikët) kurrë nuk e kishin imagjinuar. Secili prej tyre luftontë sikur të seçili përj tyre të ishtë një kështjellë e pathyeshme. Prej tyre dëgjoheshin vetëm thirrjet **"Allahu Ekber!"** thirrje të cilat binin në kokat dhe trutë e jobesimtarëve si po i godistë një çekiç i vërtetë. Ndërsa I Dërguari i Allahut vazhdontë gjatë përleshjeve thërristë dhe lutëj: **"O i Gjallë dhe I Pavdekshmi Allah! O Mbajtësi i gjithësisë!"**

Spas transmetimeve thuhet se Aliu r.a. ka thënë: "Në Bedër, më i guximshmi dhe më trim ndër në ishtë vetë i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të). Ai ishtë më pranë radhëve të armikut se kushdo tjetër. Kurdoherë që pëerballe armikut ngushtoheshim, kërkonim strehë të ai." Ndërsa jobesimtarët mushrikë e rrethuan liderin e tyre Ebu Xhehilin dhe e morën atë në mbrojtje. Madje thuhet se ata (mushrikët) veshën një njëri që ti ngjantë Ebu Xhelit, prar për të krijuar një mashtrim në sytë e besimtarëve ata e kishin kamufluar liderin e tyre Ebu Xhehlin. Ky njëri fatkeq, ishtë Abdullah bin Mundhiri të cilin e sulmoi Aliu r.a. dhe ia preu kokën para syve të Ebu Xhehilit. Ndërsa Ebu Kajsin që ingjantë Ebu Xhelit e vrau Hamzai r.a. Kur I Dërguari i Allahut, duke parë se si sahabët luftonin me kaq trimëri kundër mushrikëve tha: **"Ata janë luanët e Allahut në tokë."**

Resulullahu, (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të), luftonte përkrah Hazretit Ukâshe, të cilit iu thye shpata. Kur e pa këtë, i Dërguari i Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të), mori një shkop nga toka dhe ia zgjati atij, duke i thënë: **"O Ukâshe! Lufto me këtë!"** Ukâshe mori shkopin dhe filloi të luftonte me të sikur ai të një shpatë të e vërtetë. Me këtë shpatë, ai luftoi deri në fund të betejës, duke vrarë shumë idhujtarë.

I Dërguari i Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të), nga njëra anë luftonte dhe nga ana tjetër nxiste entuziazmin e shokëve të tij, duke u thënë atyre: **"Betohem në Allahun! Në duart e të cilit është jeta ime se; sot ata që luftojnë me shpresën për të fituar kënaqësinë e Allahut, me durim dhe vendosmëri, dhe që vriten duke përparuar pa u kthyer prapa, Allahu me siguri do ti fusë në Xhenet."** Kur dëgjoi këto fjalë të bekuara Umejr bin Humâm filloi të brohorasë: "Sa bukur! Sa bukur! Pra, për të hyrë në Xhenet nuk më nevojitet asgjë tjetër veçse të bie dëshmor."Kështu ai luftonte në fushë betejë plot zell e guxim. Nga njëra anë, luftonte

kundër armikut, dhe nga ana tjetër thoshte: "Tek Allahu nuk mund të shkosh me ushqime të kësaj bote, por me frikë ndaj Allahut, me veprat e ahiretit dhe duke luftuar në rrugën e Allahut me durim dhe vendosmëri. Të gjitha ushqimet e tjera padyshim do të mbarojnë dhe do të shterojnë!" Dhe kështu luftonte ai deri se sa ra dëshmor.

Lufta po bëhej gjithnjë e më e ashpër! Mbi një sahab sulmonin të paktën tre idhujtarë. Sahabët e lavdishëm godisnin me shpatat e tyre një për një, pra çdo armik që ju dilte para e luftonin guximshëm dhe pa paikë frike. Sa herë që thërrisnin **"Allahu ekber! Allahu ekber!"**, ju shtonte fuqia dhe guximi ndaj ata nuk u ndalën së sulmuari armikun. Por për një moment, sulmet e idhujtarëve mbi sahabët u bënë më të forta dhe sahabët u gjendën përballë një vështirësie sikur dukej e pathyeshme, por ata nuk ndaleshin së sulmuar mbi armikun.

Kur pa i Dërguari i Allahut që lufta po ashpërsohej së bashku me Ebu Bekir u kthyen në vënd dhe u konsultuan për strategjinë dhe ecurinë e luftes. Më pas I Durguari i Allahut duke u kthyer në fushëbetejë filloi ti lutet Allahut: **"O Zoti im! Më jep ndihmën që më ke premtuar!"** Atë moment erdhi shpallja hyjnore ku Allahu xh.sh. thotë: **''(Përkujtoni) kur ju kërkuat ndihmë te Zotit tuaj dhe Ai u përgjigj (duke ju thënë): "Do t'ju ndihmoj me njëmijë melekë radhë-radhë."**[154] Profeti ynë i Dashur ju kthye Ebu Bekrit dhe i tha: "Përgëzime o Ebu Bekir! Erdhi Ndihma e Allahut! Xhebraili elejhi selam, qëndron atje mbi kodrat e rërës, duke mbajtur frerin e kalit të tij dhe është duke pritur urdhrin e Allahut."

Thuhet se ky është shkaku i zbritjes së sures Enfal ku Allahu i Lartësuar ju thotë engjëjve: **''**(Përkujto) **kur Zoti yt i frymëzoi melekët: "Vërtet Unë jam me ju, mbani pra dhe jepuni forcë besimtarëve. Unë do t'ju fus tmerrin në zemër mosbesimtarëve, kështu që goditni në qafa dhe ua hiqni krejt gishtat** (ua pritni duart e këmbët). **Kjo për shkak se ata nuk përfillën dhe nuk iu bindën Allahut dhe të Dërguarit të Tij dhe kushdo që nuk përfill dhe nuk i bindet Allahut dhe të Dërguarit të Tij, atëherë me të vërtetë Allahu është i Ashpër në ndëshkim.''**[155]

Në betejën e Bedrit, me urdhrin e Allahut xh.sh.! Së bashku me Xhebrailin, Mikailin dhe Israfilin (paqja qoftë mbi ta), moren pjesë edhe shumë engjëj të tjerë. Të cilët u pozicionuan rreth të dashurit të Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të). Xhebraili qëndronte pranë tij, Mikaili në të djathtën e tij, dhe Israili në të majtën e tij. Të gjithë ishin mbi kuaj të bardhë. I dërguari i Allahut u tha shokëve të tij: **"Engjëjt mbajnë shenja dalluese. Edhe ju vendosni për vete nga një shenjë dalluese!"**[156]

Prej këtu tranmestohet se Zuberi bin Avvam në kokë mbështillte një shall të verdhë, Ebu Duxhane një shall të kuq, ndërsa Aliu radijallahu anhuma mbante në betejë një flamur të bardhë. Edhe Hamzai r.a. kishte vendosur një puplë deveje në gjoksin e tij.

Me ardhjen e engjëjve në betejë, situata ndryshoi përnjëherë. Para se sahabët të godisnin me shpatat e tyre idhujtarët, koka e tyre (idhujtarëve) shkëputej dhe binte në tokë. Përreth të Dërguarit të Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të), shiheshin të luftonin kundër idhujtarëvë ushtarë të panjohur.

[154] Enfâl: 8/9.
[155] Enfâl: 8/12-13.
[156] Vâkıdî, Megâdhî, I, 57; İbni Sa'd, Tabakât, I, 16; Beyhekî, Delâil-un-nubuvve, III, 40; Hâkim, Mustedrek, III, 72.

Më vonë Sehli r.a. transmeton se: "Në Betejën e Bedrit, sa herë që çdonjëri prej nesh ngrinte shpatën ndaj një idhujtari, para se shpata të arrinte armikun, koka e tij (armikut) shkëputej dhe binte në tokë!"

Vrasja e Ebu Xhehlit

"(O Sahabë) Engjëjt mbajnë shenja dalluese. Edhe ju vendosni për vete nga një shenjë dalluese!"
Hadith

Abû Azîz ibn Umajri, ishte mbajtësi i flamurit të idhujtarëve. Ky u kap rob nga sahabët ndërsa komandanti i idhujtarëve Ebu Xhehli, për të inkurajuar kurejshët dhe për të rritur moralin e ushtarëve të tij, vazhdimisht recitonte poezi. Ai sulmonte sahabët si një i ri, dhe duke u mburrur: "Nëna ime më lindi për këto ditë!" dhe kështu ai nxiste të tjerët.

Ubejda ibn Saidi, ishte një nga idhujtarët, ky ishte i pajisur me armaturë të plotë. Matdje atij vetëm sytë i dukeshin. Ai qëndronte mbi kalin e tij dhe brohoriste duke thënë: "Unë jam Abû Dhâtulkarish! Unë jam Abû Dhâtulkarish!" që do të thotë, "Unë jam babai i barkut (kam bark të madh)." Ai me mënyrën e tij të veçantë përpiqej të sfidonte muslimanët. Por heroi i madh i Islamit Zubejr ibn Avvâmi r.a., iu afrua dhe duke marrë në shënjestëre hodhi shtizën drejt syrit të tij duke thënë: "Allahu ekber!" Shtiza e goditi dhe e rrëzoi nga kali në tokë. Dhe kur Zubejri arriti pranë tij, vuri re se shtiza e kishte goditur Ubejdan dhe e pe se ai tashmë kishte vdekur. Zubejri u përpoq me gjithë forcën e tij për ti nxjerr xhtizen por ajo (shtiza) ishte ngulur në trupin e mushrikut aq fort sa që doli me plot vështirësi.

Heroizmi që tregoi Zubeyri r.a. në Betejën e Bedrit ishte i pa përshkrueshëm. Në trupin e tij nuk kishte vend që të mos i ishte plagosur. Djali i tij, Urva, e transmeton këtë situatë: "Babai im kishte marrë tre goditje të rënda me shpatë. Njëra prej tyre ishte në qafë. Plaga kishte lënë një shenjë aq të thellë sa që mund të fusja gishtin në të."

Abdurrahmân ibn Auf r.a. gjithashtu luftonte me një zell të madh kundër idhujtarëve kurejshitë. Ai pa u ndalur prej gjakut që i rridhte nga plagët e marra, rrëzonte këdo që përballej me të. Abdurrahmâni r.a. më vonë rrëfeu një ngjarje të cilën e kishte përjetuar në Bedir: "Në një moment vura re se, nuk kishte mbetur askush përballë meje. Kur shikova rreth e rrotull, më ranë në sy dy të rinj nga Ensarët. Doja të isha pranë më të fortit prej tyre. Njëri nga këta të rinj kur më pa mu drejtua dhe më pyeti: 'O xhaxha! A e njeh Ebu Xhehlin?' Unë iu përgjigja: 'Po, e njoh.' Kur e pyeta: **'O biri i vëllait tim, çfarë do të bësh me Ebu Xhehlin?' ai u përgjigj: 'Më kanë thënë se ai fyen Resulullahun. Betohem në Allahun që, sapo ta shoh, nuk do të largohem prej tij derisa ta vras ose derisa të vdes vetë përballë tij.'** Në fakt, mbeta i mahnitur nga këto fjalë të qarta dhe vendimtare, të cilat dilnin nga një i ri, i cili ishte në një gjendje emocionuese. Edhe i riu tjetër gjithashtu kur me pa tha po të njëjtën gjë. Ndërkohë, e pashë Ebu Xhehlin! Ishte në mesin armikut idhujtar, ai lëvizte vazhdimisht sa andej këndej. Kur thashë: 'O të rinj! Ai person që po lëviz me nxitim është Ebu Xhehli,' ata menjëherë kapën shpatat dhe iu afruan Ebu Xhehlit dhe filluan të luftojnë përballë tij. Këta të rinj ishin vëllezërit Muâdh dhe Muavaz, djemtë e Zonjes Afra."

Ndërkohë, Muadh ibn Amri, një nga heronjtë e shabëve, gjeti mundësinë të afrohej pranë Ebu Xhehlit. Ai me tërë forcën e tij e goditi në këmbë e sulmoi Ebu Xhehlin, i cili ishte mbi një kalë me bisht të gjatë. Këmba e Ebu Xhehlit ra në tokë. Pastaj Ikrimaja, i cili ende nuk kishte pranuar Islamin, iu afrua për të ndihmuar të

atin dhe filloi të luftonte me Mudh ibn Amrin. Në atë moment, vëllezërit Muadh dhe Muavaz u vërsulën në sulm sikur të ishin një shqiponjë e vërtetë. Ata rrëzuan të gjithë ata që kishin përballë dhe arritën pranë Ebu Xhehlit dhe e goditën atë me shpatat e tyre derisa menduan se ai tashmë kishte vdekur. Muadh ibn Amri ndërsa luftonte kundër Ikrimas u plagos në dorë dhe në krah. Dora e tij e bekuar u pre nga kyçi dhe mbeti vetëm një copë lëkure që e mbante të varur. Muadh ibn Amri, i cili ishte i përkushtuar në luftë, nuk kishte kohë të humbiste për dorën e tij. Megjithëse dora e tij e prerë ishte e varur vetëm nga një copë lëkure, ai vazhdoi të luftonte me heroizëm.

"Allahu ekber! Çfarë besimi të fortë! Çfarë gjendje për tu marrë mësim! Ai duke luftuar kështu, Muadhi r.a. pas një kohe e kuptoi se lëvizshmëria i ishte ngadalësuar. Dhe ku ai vuri re se shkaku i ngadalsimit ishte dora e plagosur, menjëherë e shkelmoi dorën e tij dhe e hodhi tutje nga trupi..."[157]

Navfal ibn Huvejlid, ishte një armik i egër i Islamit njëkohësisht ai ishte dhe një nga trimat më të njohur të kurejshëve. Ai në betejë bërtiste dhe vazhdimisht përpiqej të nxisë dhe të motivojë idhujtarët kundër myslimanëve. Kur Profeti ynë i dashur e pa këtë sjellje të tij, u lut: **"O Allah! Mposhte Navfal ibn Huvejlidin dhe më ndihmo mua kundër tij."** Alîu r.a., luani i Allahut, sapo e vuri re ju vërsul menjëherë idhujtarit Navfal ibn Huvejlidit. Edhe pse Navfal ibn Huvejlidi ishte imirëarmatosur Aliu r.a. e goditi aq fort me shpatën e tij sa që ja preu të dyja këmbët. Pastaj ju afrua dhe e goditi me shpatë në qafë ku ja preu kokën aty në vënd.[158]

Umajje ibn Khalafi, i cili zakonisht e shtrinte Bilâl el-Habashiun mbi rërën e nxehtë dhe i vendoste gurë të mëdhenj mbi gjoks. Ai ishte një nga idhujtarët më të egër. Ky armik i Islamit, i cili shfrytëzonte çdo mundësi për të torturuar të Dërguarin tonë të Dashur, Muhammedin alejhi sela, dhe për të shuar dritën e Islamit përpiqej të mblidhte idhujtarët në luginën e Bedrit. Bilâli r.a., kur e pa atë, u afrua dhe u vendos para tij me shpatën e tij duke thënë: "O Umajje ibn Khalaf, o udhëheqësi i mosbesimit! Nëse ti shpëton sot, unë shpresoj që të mos jetoj më!" dhe e sulmoi me shpatën e tij. Dhe kur Bilali thirri, "O vëllezër të Ensarëve! Më ndihmoni, udhëheqësi i mosbesimit është këtu!" Sahabët e rrethuan Umajjan dhe menjëherë e vranë atë.[159]

Tashmë ushtria e idhujtarëve mbeti pa udhëheqës. Askush prej tyre nuk e dinte çfarë të bënte; ata përpiqeshin të largoheshin me të katërtat nga Bedri. Tashme fortesa e mosbesimit kishte rënë. Sahabët e nderuar vazhduan ti ndiqnin ata nga pas. Disa prej idhujtarëve u kapën rob të gjallë. Një ndër ata që u kap rob ishte Abbasi, xhaxhai i Profetit tonë të dashur.[160]

Triumfi i Përket Besimtarëve

I Dërguari i Allahut (sall-Allahu 'alaihi ëa sallam) i pyeti shokët e tij të nderuar: **"A ka dikush informacion për Nevfal ibn Huvejlidin?"** Aliu doli përpara dhe tha: "O i Dërguari i Allahut! E kam vrarë unë." Profeti ynë i dashur, prej gëzimit thirri **"Allahu ekber!"** dhe shtoi: **"Allahu Taâlâ e pranoi lutjen time për të."**

Kur i treguan Atij se edhe Umejje ibn Halefi ishte vrarë, Ai u gëzua shumë dhe tha: **"Elhamdulillah! Falënderimi i qoftë Allahut Taâlâ. Zoti im e përkrahu robin e Vet dhe e bëri fenë e Tij të triumfore."**

---

[157] Buhârî, "Megâdhî", 8; Muslim, "Cihad ve Siyer", 147; İbni Hishâm, Sire, I, 634; Beyhekî, Delâil-un-nubuvve, III, 83; Suheylî, Raddhu'l-unf, III, 77.
[158] Vâkıdî, Megâdhî, I, 92; Beyhekî, Delâil-un-nubuvve, III, 98; SHemseddin SHâmî, Subu-lu'l-Hudâ, IV, 94.
[159] Buhârî, Vekâlet, 2; İbni Hishâm, Sîre, II, 631; İbni Ebî SHeybe, Musannef, VIII, 477; Beyhekî, Delâil-un nubuvve, III, 94; Taberî, Târih, II, 153.
[160] İbni Hishâm, Sîret, I, 715; Suheylî, Ravdu'l-unf, III, 173.

"Betohem në emër të Zotit tim, i cili më dërgoi si Profet të Fundit, se ju nuk më dëgjoni më shumë se sa më dëgjojnë ata (mushrikët e vrarë). Por vetëm se ata nuk mund të më përgjigjen."
Hadith

Sa i përket Ebu Xhehlit, i dashuri i ynë, Muhammedi a.s. tha: **"Po me Ebu Xhehlin çfarë ka ndodhur. Kush do të shkojë ta kërkojë dhe të shoh gjëndjen e tij?"** Dhe dha urdhër që të kërkohej mes të vdekurve. Ata kërkuan, por nuk e gjetën. Profeti ynë i dashur tha: **"Kërkojeni atë, kam bërë një betim për të. Nëse nuk mund ta njihni, shikoni për shenjën në gjurin e tij. Një ditë, ai dhe unë ishim në festën e Abdullah ibn Judanit. Të dy ishim të rinj. Unë isha pak më i madh se ai. Kur më zuri ngushtë, e shtyva. Dhe ai ra në gjunjë. Njëri nga gjunjët iu plagos, dhe prej asaj dite shenja e asaj plage nuk iu zhduk më nga gjuri."**

Pas këtyre fjalëve të Pejgamberit a.s., Abdullah ibn Mesudi shkoi për të kërkuar Ebu Xhehlin. Ai e gjeti atë të plagosur dhe e pyeti: "A je ti Ebu Xhehli?" dhe kur ai ju përgjigj '' Po unë jam.'' Abdullah ibn Mesudi vuri këmbën mbi gjoks Ebu Xhehlit, ia kapi mjekrën dhe e tërhoqi duke i thënë: "O armik i Allahut! Më në fund a të bëri Allahu xh. sh. të padenjë?" Ndërsa Ebu Xhehli ju përgjigj: "Pse do të më bënte të padenjë? O barishtar! Allahu të bëftë të padenjë ty! Ti je në këmbë dhe po e sheh situatën! Më thuaj, në cilën anë qëndron fitorja." "Fitorja është e Allahut dhe e të Dërguarit të Tij." I tha Abdullah ibn Mesudi. Dhe pastaj ja hoqi mburojën e luftës Ebu Xhehlit duke i thënë: "O Ebu Xhehl! Do të të vras." Ebu Xhehli edhe njëherë e tregoi shkallën e mosbesimit, krenarisë dhe arrogancës së tij duke thënë: " Ti nuk je i pari që vret fisnikët e popullit të vet. Por e vërteta është se për mua nuk është e lehtë që të pranoi të vritet nga një njeri si ti. Por të paktën ma pre fytin pranë gjoksit që koka ime të duket madhështore!"

Ibn al-Mes'udi nuk ja arriti të ja priste kokën e Ebu Xhehlit me shpatën e tij. Ndaj ai ja preu kokën atij me shpatën e vetë Ebu Xhehlit. Pastaj armën, përkrenaren dhe kokën e tij i solli tek Profeti ynë i dashur dhe i tha: "O i Dërguari i Allahut! Kjo është koka e Ebu Xhehlit, armikut të Allahut Teâlâ." Profeti ynë i dashur tha: **"Nuk ka zot tjetër veç Allahut."** Pastaj u ngrit dhe shkoi tek trupi i Ebu Xhehlit dhe tha: **"Falënderimi i qoftë Allahut ta'âlâ, që të bëri të pavlerë dhe të padenjë. O armik i Allahut! Ti ishe faraoni i këtij umeti."** Pastaj falënderoi Allahun Teâlâ duke thënë: **"O Zoti im! Ti e përmbushe premtimin Tënd ndaj robit Tënd."**

Rasûlullahu (sall-Allahu 'alaihi ëa sallam) pasi ja mjekoi plagët Sahabëve që ishin të plagosur urdhëroi që të gjendeshin trupat e dëshmorëve që ishin vrarë në betejë. Prej sahabëve kishin rënë dëshmore katërmbëdhjetë sahabë, gjashtë nga Muhaxhirët dhe tetë nga Ensarët. Shpirtrat e tyre të bekuar tashmë kishin fluturuar për në Xhenet. Ndërsa prej atyre që përpiqeshin të shuanin dritën e Islamit shtatëdhjetë idhujtarë ishin vrarë dhe shtatëdhjetë të tjerë u zunë rob nga sahabët.

Rasûlullahu pasi i fali namazin e xhenazes dëshmorëve dhe pasi i varrosi ata dërgoi në Medine Abdullah ibn Revahan dhe Zajd ibn Harithin. Ata shkuan në Medina për ti dhënë medinasve lajmin se Profeti a.s. së bashku me sahabet kishin triumfuar në Bedir.

Pastaj Profeti a.s. urdhëroi shabët që të varrosin idhujtarët, ku 24 prej tyre u varrosën në një pus të thatë, ndërsa pjesa tjetër u groposën aty për rreth.

Pas varrimeve Pejgamberi a.s. ju afrua vëndit ku u groposën idhujtarët dhe tha: **"O ju që u hodhët në pus!"** dhe duke thënë emrat e politeistëve të vrarë së bashku me emrat e etërve të tyre: **"O Utba ibn Rabia! O Umejja ibn Khalaf! O Ebu Xhehl**

ibn Hisham! ... Çfarë populli i keq që ishit ndaj profetit tuaj. Ju më mohuat, por të tjerët më pranuan dhe më konfirmuan. Ju më dëbuat nga qyteti, nga atdheu im i dashur. Ndërsa të tjerët më hapën dyert dhe më përqafuan. Ju luftuat kundër meje, ndërsatë tjerët më ndihmuan. Ja pra ju e keni arritur atë që Zoti im ju premtoi? Edhe unë e kam arritur fitoren që Zoti im më premtoi."

Kur e dëgjoi Omeri e pyeti: "O i Dërguari i Allahut! Kujt poo ja thua këto fjalë? Trupave të vdekur!?" Ai a.s. i tha: **"Betohem në emër të Zotit tim, i cili më dërgoi si Profet të Fundit, se ju nuk më dëgjoni më shumë se sa më dëgjojnë ata (mushrikët e vrarë). Por vetëm se ata nuk mund të më përgjigjen."**

Mushrikët, për të shpëtuar jetët e tyre ikën me të katërtat nga fusha e betejës dhe nuk ja arritën të merrnin asgjë nga ato që kishin sjellë me vete. Të gjitha të sjellurat e tyre ranë në duart e myslimanëve. Profeti ynë i dashur ja shpërndau plaçkën e luftës të gjithë Sahabëve që morën pjesë në Luftën e Bedrit. Pas ditës së betejës ata qëndruan në Bedr edhe tri net të tjera dhe u kthyen në Medinë pas nëntëmbëdhjetë ditësh, nga dita e parë që kishin dalur prej saj (Medinas).

Ndërkohë, Abdullah ibn Revaha dhe Zajd ibn Harithi, që ishin dërguar si lajmëtarë, kur iu afruan Medinës u ndalën në vendin e quajtur Akik. Aty u ndanë me njëri tjetrin dhe Abdullah ibn Revaha hyri në Medinë nga një ana e lindjes së saj. Ndërsa Zajd ibn Harithi hyri nga perëndimi i saj. Ata shkonin nga shtëpia në shtëpi dhe i lajmëronin medinasit për fitoren në Bedir.

Abdullah ibn Revaha, poeti i Rasûlullahut, po përhapte lajmin e fitores me zë të lartë duke recituar:

Po ju sjell lajmin e gëzueshëm, o Ensarë!
Pejgamberi i Allahut është i sigurt dhe i gjallë.

Politeistët u vranë dhe robër u zunë,
Mes tyre janë figura të njohura shumë.

Të gjithë bijtë e Haxhaxhit dhe t'fisit Rabia
Në Bedë, Ebu Xhehl Amr ibn Hisham u vra.

Kur dëgjio këto fjalë Asim ibn Adi ju afrua dhe e pyeti: "O Ibni Revaha! A është e vërtetë ajo që the?" Abdullah ibn Revaha tha: "Po, betohem në Allahun që është e vërtetë! Inshâ-Allah, nesër Rasûlullahu së bashku me ata që janë zënë rob do të vijë në Medina!"

Ndarja nga Jeta e Rukijjes r.a.

Atë ditë, Rukijja (radij-Allahu 'anha), bija e të Dërguarit të Allahut, ndërroi jetë. Burri i saj, Osman, udhëhoqi namazin e xhenazes së saj. Lajmi për fitoren në betejën e Bedrit në mes të kësaj dhimbjeje atij i solli një farë ngushëllimi.

Profeti, paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të, dhe sahabët duke bërë sexhden e falënderimit e falënderuan Allahun e Madhëruar që u dhuroi fitoren e Bedrit. Më pas, u nisën për në Medinë me të burgosurit. Abdullah ibn Ravaha dhe Zajd ibn Harisi, të cilët kishin sjellë më parë lajmin e fitores, treguan se çfarë ndodhi në luftën e Bedrit, madje ata i dhanë lajmin medinasve edhe se kush kishte rënë dëshmor në Bedir. Fëmijët, gratë dhe të gjithë njerëzit që kishin mbetur në

"(O Abbas) Allahu e di nëse je apo nuk je mysliman. Nëse po thua të vërtetën, pa dyshqim që Allahu do të të shpërblejë për këtë. Por në dukje ti ishe kundër nesh. Prandaj duhet të paguash për lirimin tënd."
Hadith

Medinë u gëzuan për fitoren. Ata dolën jashtë qytetit për ta pritur Profetin e dashur. Hâris ibn Suraka ishte një ndër dëshmorët. E ëma e tij, Rabia, kishte mësuar se i biri i saj kishte rënë dëshmor. Kur dëgjoi këtë lajm, nëna jonë Rabia tha: "Nuk do të qaj për tim bir derisa të vijë i Dërguari i Allahut në Medinë. Kur të na nderojë me praninë e tij, do ta pyes. Nëse im bir është në Xhenet, nuk do të qaj kurrë. Nëse është në Xhehenem, do të derdh gjak nga sytë."

Kur Profet ynë i dashur së bashku me sahabët arriti në Medine, Rabia erdhi para tij dhe i tha: ''O i Dërguari i Allahut! Ti e di dashurinë që kam për tim bir Harisin. A është ai dëshmor dhe a hyri në Xhenet? Nëse po, do të bëhem e duruar. Nëse jo, do të derdh gjak nga sytë e mi." Profeti i nderuar e përgëzoi duke i thënë: **"O Ummu Haris! Yt bir nuk është në një, por në shumë xhenete. Vendi i tij është në Firdeus (një nga nivelet e larta të Xhenetit)."** Atëherë Rabia tha: "Kurrë nuk do të qaj për tim bir." Pastaj Profeti a.s. kërkoi një kupë me ujë. Për shkak të dhembshurisë së tij, ai e futi dorën e bekuar në ujë dhe ua dha që të pinin ujë nënës dhe motrës së Harisit r.a.. Gjithashtu, me atë ujë lau fytyrat dhe kokat e tyre. Pas asaj dite, fytyrat e Rabias dhe të bijës së saj u bënë shumë të ndritshme.

Udhërrëfyesi i universit Profeti (alejhi salatu ve selam), i shpërndau ndërmjet sahabëve shtatëdhjetë të personat e kapur rob në luftën e Bedrit dhe i urdhëroi sahabët që ti trajtonin mire ata. Ende nuk kishte ardhur ndonjë shpallje nga Allahu për fatin e të burgosurve. Pas konsultimit me sahabët e tij, Profeti ynë i dashur, vendosi që të burgosurit të liroheshin kundrejt shpërblimit. Shuma e shpërblimit përcaktohej sipas pasurisë së secilit. Ata që nuk kishin pasuri, por qe ishin të shkolluar, do të mësonin dhjetë persona që të lexonin e shkruanin dhe më pas do të liroheshin, pra do të liheshin të lire dhe ata mund të ktheheshin në Mekë. Profeti ynë i dashur i tha xhaxhait të tij Abbasit, i cili ishte një ndër ata që ishin zënë rob në luftën e Bedrit: **"O Abbas! Paguaj për lirimin tënd, të djalit të vëllait tënd Ukajl (Akil) ibn Abi Talib dhe Navfal ibn Haris. Sepse ti je i pasur."** Abbasi tha: "O i Dërguar i Allahut! Unë jam mysliman. Kurejshët më sollën në Bedër kundër dëshirës sime." I Dërguari i Allahut iu përgjigj: **"Allahu e di nëse je apo nuk je mysliman. Nëse po thua të vërtetën, pa dyshqim që Allahu do të të shpërblejë për këtë. Por në dukje ti ishe kundër nesh. Prandaj duhet të paguash për lirimin tënd."** Por kur Abbasi tha: "O i Dërguari i Allahut! Nuk kam pasuri tjetër përveç 800 dirhemëve që mi morët si plaçkë lufte," Profeti ynë i dashur i tha: **"O Abbas! Pse nuk tregon për atë ar?''** Ai pyeti: "Cilin ar? O I Dërguari i Allahut!" Atëherë Profeti ynë i dashur iu përgjigj: **"Arin që i dhe gruas tënde Ummu'l-Fadl, bijës së Harisit, ditën që u largove nga Mekka! Kur ti ia dhe, nuk kishte askush tjetër me ty. Pra po të them për arin që kur ia dhe gruas tënde i the asaj; ' O Umm al-Fadl! Nuk e di çfarë do të ndodhë me ne ketë betejë. Nëse më ndodh që unë vritem dhe nuk kthehem më, atëherë kjo shumë është për ty. Ndërsa kjo tjetra është për Fadlin, ndërsa kjo është për Abdullahun, dhe kjo tjetra është për Ubejdullahun dhe kjo e fundit është për Kusamin,''** Abbasi u mahnit dhe tha: "Betohem se kur i dhashë gruas sime atë ar nuk kishte me ne askush tjetër. Si është e mundur që ti e di këtë?" Atëherë Profeti a.s. iu përgjigj: **"O xhaxh! Allahu më informoi për gjithçka që ti fole atë kohë me bashkëshorten tënde."** Atëherë Abbasi r.a. tha: **"Dëshmoj se ti je i Dërguari i Allahut dhe ti nuk thu asgjë tjetër vetëm se të vërtetën."**[161]

Pasi Abbasi u bë mysliman, Profeti ynë i dashur e liroi dhe e urdhëroi atë që të kthehet në Mekka dhe të mbrojë myslimanët atje njëkohësisht ti dërgojë lajme Pejgamberit a.s. për planet që do të thurin armiqtë e Islamit kundër Profetit a.s..

"Vallahi, unë nuk njoh dikë që të jëtë më i keq se sa ti. Ti je ai i cili e mohon Allahun xh.sh., Të Dërguarin e Tij. Te je ndër kryesorët që tallesh me Kur'anin dhe që e ke torturuar tortur pas torturash të Dërguarin e Allahut Teâla."
Hadith

Kurejshët, të cilët pësuan disfatë në luftën e Bedrit, u njoftuan se mund t'i kthenin robërit e tyre duke paguar shpërblimin kundrejt lirimit. Vetëm, Nadir ibn Harithit, i cili ishte një ndër armiqtë e përbetuar të Islamit, madje ai e kishte torturuar Profetin a.s. në Mekka, u dënua me vdkje. Pra Nadir ibn Harithit iu pre koka. Gjithashtu, atij që ju pre koka ishte edhe Ukbe ibn Ebi Muajti. Ky ishte ai i cili i kishte vendosur blonc deveje në kokë Profetit tonë të dashur, kur ai po ishte duke falur namaz në Qabe. Kur koka e këtij armiku të egër të Islamit u nda nga trupi i tij, Pejgamberi a.s. e lavdëroi Allahun xh. sh. për gjithë triumfin që i kishte dhënë në Bedir. Pastaj Profeti a.s. shkoi pranë e tij (Ukbe ibn Ebi Muajtit) dhe i tha: **''Vallahi, unë nuk njoh dikë që të jëtë më i keq se sa ti. Ti je ai i cili e mohon Allahun xh.sh., Të Dërguarin e Tij. Te je ndër kryesorët që tallesh me Kur'anin dhe që e ke torturuar tortur pas torturash të Dërguarin e Allahut Teâla.''**

Pengjet derisa u morën nga kujdestarët e tyre në këmbim të shpërblimit qëndruan me sahabët (radhiallahu anhum). Të gjithë sahabët silleshin shumë mirë me pengun e tyre dhe atë ushqim që kishin e ndanin me ta. Vëllai i Musab bin Umejrit, Ebu Azizi, ishte mes atyre që ishin zënë pëng në luftën e Bedrit i cili trasnmeton se: "Unë isha peng në shtëpinë e një muslimani në Medinë. Ata silleshin shumë mirë me mua. Në mëngjes dhe në darkë mua më jepnin ushqim nga ushqimet më të mira që ata kishin, ndërsa ata vetë hanin vetëm hurma. Sa herë që njëri prej tyre merrte një copë bukë, ma sillte mua. Kur më vinte turp dhe ia ktheja bukën, ata ma sillnin prapë." Një tjetër peng ishte Jezidi nga Kurejshët, i cili tregonte se: "Ndërsa muslimanët shkonin nga Bedri në Medinë, ata na hipën ne pengjeve mbi deve, ndërsa ata vetë ecnin në këmbë."

Ndër pengjet ishte edhe Ebu'l-As ibn Rabi, djali i motrës së Hatixhes (radhiallahu anha) dhe dhëndri i Profetit (salallahu alejhi ve selam). Ebu'l-Asi ishte një tregtar i njohur i Mekës, me shumë pasuri dhe i famshëm për besnikërinë dhe devotshmërinë e tij. Kur nga erdhën shpërblimet Mekka për lirimin e pengjeve, Zejnebia (e bija e profetit a.s.) për të liruar bashkëshortin e saj Ebu'l-Asin, i dërgoi një gjerdan Profetit a.s.. Ajo veç këtij gjerdani që e kishte dhuratë nga e ëma e cila ja kishte dhuruar ditën e martesës. Kur e pa gjerdanin Profeti (salallahu alejhi ve selam), tha: "O sahabe! Nëse e shihni të arsyeshme, lirojeni pengun (bashkëshortin) e vajzës sime Zejnebes." Sahabët e liruan Ebu'l-Asin dhe i thanë atij të kthehej në Mekë, me kusht që ta dërgonte Zejneben në Medinë.

Kur ai arriti në Mekka e dërgoi Zejneben së bashku me të afërmit e saj dhe me të vëllain e tij, Kinanen për në Medina. Kur e dëgjuan mushrikët këtë, menjëherë dërguan disa njerëz pas tyre. Ata i arritën në vëndin e quajtur Zi-Tuva. Habar ibn el-Esvedi ende pa ju afruar filloi të godiste me shigjetë drejt devesë së Zejnebes radijallahu anha. Zejnebja prej frikës r.a. nga deveja dhe u plagos. Faktikisht ata kishin menduar se ra nga frika por realiteti ishte se një nga shigjetat e kishte

[161] Taberî, Târih, II, 523, 524.

plagosur vajzën e Profetit a.s. Zjenepen. Kinani, për të mbrojtur Zejnepen dhe shoqeruesit e saj, u përgatit dhe mori pozicion, duke thënë: "Kushdo që tenton t'i bëjë dëm Zejnebes, do të vritet nga unë." Kështu ai ja kishte arritur ta nxirrte Zejneben nga Mekka dhe ta çonte në Medina. Por si pasojë e plagëve të marra nga shigjeta Zejnepia u sëmur rëndë dhe, pasi arriti në Medinë, humbi fëmijën që ajo priste të lindte. Kur mori vesh lajmin Profeti (salallahu alejhi ve selam) u pikëllua shumë.

Fitorja e muslimanëve në Bedër dhe ikja e politeistëve prej Bedri në një gjendje të mjerueshme e tronditi thellësisht Mekkën. Ashtu sikur Ebu Lehebi, as mushrikët e tjerët nuk ju kishin besuar lajmëtarëve të parë që kishin ardhur erdhi nga Bedri. Dhe kur mbërriti Ebu Sufjani në Mekë, ata vrapuan pranë tij dhe Ebu Lehebi ishte i pari që e pyeti: "O biri i vëllait tim! Na trego, çfarë ndodhi në Bedir?" Ebu Sufjani, duke u ulur mes tyre, tha: "Mos pyet. Kur u ndeshëm me muslimanët, ishte sikur na kishin lidhur duart. Ata na sulmuan si deshën; disa prej nesh u vranë, disa të tjerë u zunë rob. Ndërsa unë nuk fajësoj asnjërin nga njerëzit tane. Sepse ne Bedir u përballëm me disa krijesa të veshura me të bardha, të cilat qëndrorin mbi kuaj gri! Ata iknin dhe vinin mes qiellit dhe tokës dhe askush nuk kishte mundësinë ti mposhte ata."

Velid ibn Velidi ishte një ndër kurejshitët që u kapën peng në Bedër. Pengëmarrsi i tij ishte Abdullah ibn Xhahshi. Vëllezërit e Velidit, Hishami dhe Halid ibn Velidi, të cilët ende nuk e kishin përqafuar Islamin, për të liruar vëllain e tyre erdhën në Medinë. Por Abdullah ibn Xhahshi edhe nëse nuk jepej shpërblimi nuk donta ta lironte Velidin. Edhe pas tentativave të Halidit, Hishami, prap nuk nuk e pranonte. Ndërsa Profeti ynë i dashur (salallahu alejhi ve selam) sugjeroi që shpërblimi të bëhej me armët dhe pajisjet e babait të tyre. Atëherë Hishami pranoi sugjerimin e Profetit a.s. por kësaj radhe ishte Halidi ai që nuk e pranonte këtë. Më në fund, u dakorduan që të jepnin shpatën, armaturën dhe përkrenaren e babait të tyre, të cilat u çmuan me njëqind dinarë. Kështu ata shpëtuan Velidin nga robëria dhe së bashku më të u nisën për në Mekkë. Por pasi ata kishin shkuar katër milje larg Medinës, Velidi i la vëllezërit e tij në Dhu'l-Hulejfe dhe u kthye tek i Dashuri ynë Profeti a.s. dhe sapo arriti në Medina, duke u bërë një nga sahabët e Profetit a.s. e pranoi Islamin. Pasi Velidi pranoi Islamin nuk qëndroi në Medina por ai shkoi në Mekkë, tek vëllezërit e tij. Kur Velidi arriti në Mekka Halid ibn Velidi i tha: " O Velid! Meqenëse do të bëheshe musliman, përse nuk u bëre para se ne të paguanim shpërblimin tënd? Pse e bëre këtë? A nuk e kupton që ti na bëre të ndahemi me trashgimërine e babait tonë?" Ai ju përgjigj: "Kisha frikë se Kurejshit do të thoshin: 'Ai nuk e duronte robërinë ndaj ju bind Muhamedit (alejhis-selam).''

Kjo përgjigje e Velidit i kishte tërbuar vëllezërit e tij. Ndaj ata e burgosën atë së bashku me disa muslimanë nga fisi Manzum. Prej të burgosurve ishin dhe Ijash ibn Ebi Rabian dhe Seleme ibn Hishami (radijallahu anhum). Velid ibn Velidi vetëm për faktin që pranoi Islamin u burgos për vite të tëra. Madje ai përjetonte dhe iu nënshtronte torturave nga më të ndryshme që i bëntë xhaxhai i tij Hishami, i clili ishte vërtetë një armik i përbetuar i Islamit. Profeti ynë i dashur (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) u lut për Velid ibn Velidin, Ijash ibn Ebi Rabian dhe Seleme ibn Hishamin, të cilët po persekutoheshin dhe po dhunoheshin nga politeistët. Ai (Profeti a.s.) u luste **"O Allah! Shpëtoje Velid ibn Velidin, Seleme ibn Hishamin, Ijash ibn Ebi Rabian dhe muslimanët e tjerë që po përjetojnë dhunëra dhe padrejtësi nga**

jobesimtarët. O Allah, ndëshkoje Mudarin (Kurejshitët). O Allah! Le të jenë këto vite të vështira për Velid ibn Velidin, Seleme ibn Hishamin, Ijash ibn Ebi Rabian sikur vitet e Jusufit a.s..”

“Falënderimi i takon vetëm Allahut të Madhëruar, sepse Ai e bëri të Dërguarin e Tij fitimtar në Bedër dhe i dha atij triumfin mbi mushrikët zullumqarë të Mekkas.”
Hadith

Allahu ja pranoi lutjet Profetit a.s. dhe Velidit ju dha të gjende një mundësi për të ikur nga vendi ku ishte i lidhur. Ai u kthye në Medinën e ndritur dhe arriti te Profeti ynë i dashur. Kur e pyeti Profeti për gjendjen e Ijash ibn Ebi Rabias dhe Seleme ibn Hishamit, ai i tha se ata ishin të lidhur bashkë dhe po përjetonin tepër tortura të rënda. Profeti ishte shumë i trishtuar për gjendjen e tyre dhe kërkonte rrugëzgjeidhje për t’i shpëtuar ata nga kthetrat e Kurejshitëve. Pastaj Profeti a.s. e thirri përsëri Velidin dhe pyeti se kush mund t’i shpëtoi ata. Atëherë Velidi, pavarësisht viteve të torturave që kshte përjetuar, me guxim të pa thyeshëm i tha: “O i Dërguari i Allahut! Unë do t’i shpëtoj ata dhe do t’i sjell këtu te ti.” Velidi shkoi përsëri në Mekkë dhe duke ndjekur një grua që u çonte ushqim mësoi vendndodhjen e tyre. Ata ishin të burgosur në një ndërtesë pa çati. Me pas Velidi priti të errësohej dhe me një guxim të madh, zbriti murin e rrethimit dhe shkoi tek miqtë e tij. Pra shkoi tek Muslimanët e shtypur, faji i vetëm i të cilëve ishte besimi i tyre. Ata, në nxehtësinë përvëluese të shkretëtirës së Arabisë ju kishin lidhur dhe nga një gur të madh në shpinë, po perjetonin dhunëra më të pa durueshme.

Velidi ja arriti ti shpëtoi vëllezërit mysliamn dhe duke u nisur për në Medinë i hipi ata në devenë e tij. Ndërsa, për të arritur sa më parë te i Dashuri ynë Profeti a.s., ai vetë ecte këmbë zbathur dhe i uritur nëpër shkretëtirë. Nuk ishte nxehtësia përvëluese e shkretëtirës ajo që e shtynte atë të ecte me shoejtësi, por ishte dashuria për t’u takuar sam ë parë me Profetin tonë të dashur. Ai i zbathur, pa ushqim dhe ujë në Medina arriti pas tre ditësh. Kur arriti atje këmbët i ishin plagosur nga ashpërsia e gurëve dhe nxehtesia e rërës. Ky ishte një ndër shebujt se çfar dashurie kishin sahabët për Profetin tonë të Dashur Muhammedin alejhi selam.

Kështu pra fitorja në Bedër ju solli gëzim të madh muslimanëve, ndërsa politeistëve ju kishte sjellë një pikëllim dhe zhgënjim të papërshkruar. Madje trasnmetohet se kur Nexhashi, sundimtari i Habeshistanit, kishte dëgjuar për fitoren e Resulullahut në Bedir. Kishte shkuar tek sahabët që ndodheshin në vendin e tij dhe i kishte përgëzuar duke ju thënë: **“Falënderimi i takon vetëm Allahut të Madhëruar, sepse Ai e bëri të Dërguarin e Tij fitimtar në Bedër dhe i dha atij triumfin mbi mushrikët zullumqarë të Mekkas.”**

Pas ngjarjes së Gazës së Bedrit

Sakrificat dhe sfidat e të Dërguarit të Allahut (paqja qoftë mbi të) tashmë kishin filluar edhe në Medine. Në Medine ai luftonte kundër hebrenjve, hipokritëve si Abdullah bin Ubej, të cilët dukeshin si myslimanë, por në fshehtësi ata ishin pranë idhujtarëve. Krahas kësaj, ai për t’i nderuar dhe ata me Islam, i ftonte në Islam fiset idhujtare jashtë Medinës. Por paralelisht u zhvilluan njëra pas tjetrës Gaza Karkara, Beni Kajnuka, Sevik, Gatafan, Bahran... të gjitha këto beteja u zhvilluan pas Gazës së Bedrit.

Disa ngjarje të vitit të dytë të Hixhretit

Në vitin e dytë të Hixhrsht u urdhërua dhënia e zekatit, lëmosha e iftarit, falja e

namazeve të bajrameve dhe therja e kurbanit. Po në këtë vit I Dërguari i Allahut martoi vajzën e tij, Ummu Gulsumin me Othmanin radiaAllahu anhum. Ai gjithashtu kurorëzoi Hafsën, vajzën e Omerit, dhe Zejnep binti Huzejme (Allahu qoftë i kënaqur me to). Krahas këtyre ndodhime këtë vit lindi nipi i Prpfetit a.s. Hasani, djali i Aliut r.a..

"Falënderimi i takon vetëm Allahut të Madhëruar, sepse Ai e bëri të Dërguarin e Tij fitimtar në Bedër dhe i dha atij triumfin mbi mushrikët zullumqarë të Mekkas."
Nexhashi Eshame (rahmetullahi aleyh)

Martesa me Hz. Aishen

Profeti ynë i Dashur ishte fejuar me Hz. Aishen që kur ishin në Mekka. Por kurorën ende nuk kishin bërë. Një ditë Ebu Bekri i tha të Dërguarit të Allahut: "O i Dërguar i Allahut! Çfarë po të pengon të martohesh me vajzën time, bashkëshorten tende Aishen r.a.?" I Dërguari tha: **"Mehri"** (shpërblimi për martesë). Atëherë Ebu Bekri mori për sipër mehrin dhe ja pagoi. [162]

Pastaj u bë dasma e Hz. Aishes me të Dërguarin e Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të). Në atë kohë, Profeti ynë i dahsur ishte pesëdhjetë e pesë vjeç[163]. Ndërsa Hz. Aishja në moshë ishte më e re. Por përtej moshës së saj, ajo ishte shumë e zgjuar dhe e aftë. Madje ajo mund t'i shprehte ngjarjet menjëherë në formë poezie dhe nuk harronte kurrë diçka që kishte mësuar apo të dëgjuar më parë. Ajo ishte shumë e mençur, e zgjuar, e ditur, e sjellshme, e pastër dhe e drejtë. Për shkak të kujtesës së saj të fuqishme, shumë nga sahabët e pyetnin dhe mësonin shumë prej saj. Për këto cilësi ajo ishte lavdëruar në një ajet të Kuranit.

Beteja e Karkara-i Kedr

Një grup nga fiset Beni Selim dhe Gatafan ishin mbledhur në Karkara. Kur kjo gjë iu njoftua të Dërguarit të Allahut, ai u nis nga Medina me dyqind persona nga Muhaxhirët dhe Ensarët. Në Medinë, Ibni Umm-i Mektumi u la si përfaqësues i Pejgamberit a.s. Ndërsa flamurin e ushtrisë e mbante Aliu r.a.. Dhe kur arritën në Karkara, aty nuk gjetën askënd. Sepse idhujtarët kishin degjuar që ushtria islame po vinte, kishin ikur me të katërtat. Ushtria Islame kishte vazhduar rrugën rreth luginës që ndodhej aty pranë ku aty takuan me një çoban që kujdesej për devetë e ushtrisë idhujtare. Sahabët e pyetën çobanin për vendndodhjen e fisit Beni Selim dhe Gatafan. Çabani ju tha se: "Ata ikën duke më lënë devet mua dhe më paguan që unë të kujdesem për kafshët e tyre për pesë ditë. Por tani nuk e di se ku janë."

Pesëqind deve që ata kishin lënë pas u kapën si plaçkë lufte, ndërsa çobani Jesar u mor peng. Sahabët qëndruan tre netë në luginën e Karkarat'ul Kedrit dhe më pas duke i devetë me vete morën rrugën drejt Medinës. Kur arritën në një vend të quajtur Derar I Dërguari i Allahut (Paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të) u ndal aty dhe ju ndau sahabëve një të pestën e deveve, ndërsa pjesën tjetër e mbajti për buxhetin e shtetit të asaj kohe, udhëheqës i të cilit ishte vetë Pejgamberi a.s.. Secilit nga sahabët i ranë nga dy deve. Të nesërmen, kur po falnin namazin e sabahut, panë se edhe Jesari, çobani që kishin marrë peng, po falej së bashku me ta. Atëherë I Dërguari i Allahut e liroi atë dhe u kthyen të sigurt në Medinë.

Çdo shpirt që digjet nga zjarri i dëshirës bëhet dritë.
Shpirti që bëhet i dërrmuar nga dashuria, ndërtohet përsëri.

[162] İbni Sa'd, Tabakât, I, 239; Kâdî İyâd, SHifâ-i SHerif, 300-301.
[163] Buhârî, "Menâkıb-ul-Ensar" , 44; Tirmidhî, "Nikâh", 18.

Beteja e Beni Kajnukasë



BETEJA E BENI KAJNUKASË

"Thuaju (O Muhammed) atyre që mohojnë: Ju do të shkatërroheni dhe do të grumbulloheni bashkë në Xhehenem dhe vërtet, sa i keq është ai vend për pushim!"
Âl-i İmrân: 3/12

Një ditë, hebrenjtë e fisit Beni Kajnuka u tallën me një grua myslimane. Një sahabi që po kalonte aty pranë sapo e pa këtë, nxori shpatën dhe e vrau hebreun që po tallej me gruan myslimane. Ky lajm u përhap tek hebrenjtë të cilët u mblodhën dhe e vranë sahabiun e nderuar. Ngjarja iu raportua të Dërguarit të Allahut (Paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të). Atëherë Profeti a.s. i mblodhi hebrenjtë në tregun e Kajnukasë dhe u tha: **"O Hebrenj! Kini frikë nga një ndëshkim si ai që Allahu i dha Kurejshëve, pranoni Islamin. Sepse ju e dini mirë që unë jam një profet i Dërguar nga Allahu. Ju këtë e lexoni në librin tuaj dhe e dini premtimin që Allahu ka dhënë për ju..."**

Edhe pse Muhammedi a.s. tregoi mëshirën e tij e tij dhe nuk i ndëshkoi hebrenjtë e Beni Kajnukas, të cilët kishin shkelur marrëveshjen e paqes që kishin lidhur me të. Ata në një mënyrë shumë arrogante i thanë të Dërguarit të Allahut (Paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të); ''O Muhamed! Të mos mashtroi ty fitorja ndaj një populli që nuk di të luftojë! Betohemi se ne jemi mjeshtra të luftës! Dhe nëse guxon të përballesh me ne, atëherë do ta shohësh trimërinë tonë! Ndaj mos guxo të na armiqsohesh me ne!" Kjo përgjigje e hebrenjëve u bë shkak që ata në mënyrë të hapur e prishën marrëveshjen me të Dërguarin e Allahut (Paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të).

Pas kësaj ngjarje zbriti ajeti Kuranor ku Allahu thoshte: **''Në qoftë se ti (O Muhammed) ke frikë nga tradhtia e çfarëdo populli, ktheju prapa (marrëveshjen) atyre që të jeni të barabartë (që të mos ketë më marrëveshje mes teje dhe atyre). Vërtet që Allahu nuk i do tradhëtarët."**[164] Në një tjetër ajet, Allahu thotë: ''**Thuaju (O Muhammed) atyre që mohojnë: Ju do të shkatërroheni dhe do të grumbulloheni bashkë në Xhehenem dhe vërtet, sa i keq është ai vend për pushim!"**[165]

Pas zbritjes së këtyre ajeteve në muajin Sheval I Dërguari i Allahut menjëherë organizoi një ushtri dhe u nis drejt fortesës së hebrenjve të Beni Kajnukas. Flamurin e ushtrisë e mbante Hamzai r.a., ndërsa Ebu Lubabe u la si përfaqësues në Medinë[166]. Ushtria myslimane rrethoi fortesën e Beni Kajnukasë. Ndërsa Hebrenjtë, që më parë thoshin se; "Ne jemi luftëtarë të guximshëm!" Nuk patën guximin as të qëllonin qoftë edhe me një shigjetë të vetme nga brenda fortesës. I Dërguari i Allahut (Paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të) mori nën kontroll e hyrje-daljet e fortesës së Hebrenjëve. Askush as nuk mund të hynte dhe të dilte.

Rrethimi i fortesës së gebrenjëve zgjati plot pesëmbëdhjetë ditë. Pas pesmbëdhjetë ditëve hebrenjtë i kaploi frika dhe u dorëzuan.[167] Megjithëse, për shkak të trahdëtisë ata duhej të vriteshin, i Dërguari i Allahut, tregoi mëshirë ndaj hebrenjtë të Beni Kajnukas dhe ju vendosi atyre kusht që askush prej tyre të mos qëndronte në Medinë dhe i lejoi ata të largoheshin drejt Shamit.[168] Kështu, ata të gjithë u dëbuan nga toka e Medinës. Ndërsa pasuritë dhe armët e tyre u morën si plaçkë lufte nga myslimanët.

[164] Enfâl: 8/58.
[165] Âl-i İmrân: 3/12.
[166] İbni Sa'd, Tabakât, II, 29.
[167] İbni Sa'd, Tabakât, II, 29.
[168] Vâkıdî, Megâdhî, I, 176-180; İbni Sa'd, Tabakât, II, 29.

Beteja e Sevikut

"Osmani është miku im në Xhennet."
Hadith.

Pas Betejës së Bedrit Ebu Sufjani u kthye në Mekkë. Aty ai betohet se nuk do të lyente kokën me vaj (nuk do pastrohej) dhe nuk do t'i afrohej grave të tij derisa të merrte hak ndaj Profetit Muhammed (Paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të). Në vitin e dytë të Hixhretit, pra ne diten e dyte te muajit Dhul-Hixhe, Ebu Sufjani vendosi të përmbushte këtë betim dhe u nis për në Medinë me dyqind kalorës. Natën, Ebu Sufjani u ndal në një shtëpi në Medinë dhe kërkoi për Profetin, por nuk iu kushtua vëmendje dhe shtëpia nuk iu hap. Ai më pas gjeti strehim te Selam bin Mushkem. Ditën tjetër, ai vazhdoi drejt rajonit Arid, ku takoi dy njerëz nga Ensarët, Ma'bed ibn Amru dhe shërbëtorin e tij, të cilët i vrau ndërsa ata ishin të zënë me punët e tyre. Me pas Ebu Sufjani dogji një pemishte hurmash dhe dhe tha: "Betohem që tashmë e kam përmbushur zotimin tim," dhe u largua.

Kur degjoi per këto ndodhi Profeti Muhammed (Paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të), e la Ebu Lubaben si zëvendës të tij në Medinë dhe bashkë me dyqind sahabë u nis të ndiqte Ebu Sufjanin. Por kur mësuan idhujtarët se po përndiqeshin nga myslimanet, ja mbathën duke lënë pas gjithëçka kishin me vete, të cilat myslimanët i morën si plaçkë lufte. Kjo ngjarje u njoh si Gazveja e Sevîk.

Martesa e Aliut me Fatimen (Radiallahu Anhuma)

Në vitin e dytë të Hixhretit, vajza e Profetit Fatimja r.a., kishte arritur moshën e pjekurisë. Shumë persona kërkuan dorën e saj, por Profeti nuk pranoi asnjërin, duke thënë: **"Çështja e saj është në dorën e Allahut."** Një ditë, Ebu Bekri, Umeri dhe Sad bin Muadh radijallahu anhum, diskutonin në xhami se të gjithë, përveç Aliut r.a., kishin kërkuar Fatimen, por asnjë nuk ishte pranuar. Ebu Bekri sugjeroi që të vizitonin Alinë dhe ta inkurajonin që ai të shprehte dëshirën për martesë.

Kur ata u takuan Aliun r.a., ai po ujiste hurmat në bahçe. Ebu Bekri r.a. i tha; '' O Ali (kënaqsia e Allahut qoftë mbi të)! Pëerse nuk e kërkon të bijën e Muhammedit (Paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të), Fatmën. Ti e di se Allahu dhe Profeti a.s. nuk i jepnin rëndësi pasurisë materiale dhe se varfëria nuk është pengesë për tu martuar?'' Aliu pranoi këtë sugjerim të Ebu Bekrit dhe shkoi ti kërkonte dorën e Fatimes r.a. të cilën Pejgamberi a.s. ja dha pa mëdyshje. Mertesa e Aliut me Fatman radijallahu anhuma u realizua, ku martesa e tyre është një nga martesat më të nderuara në historinë islame.

Më vonë Ali r.a. transmeton se: "Kur hyra te i Dërguari i Allahut (Paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të), isha i turpëruar dhe i ndrojtur. U ula pranë tij, por prej turpit nuk munda të flas. Atëherë Profeti a.s. i cili e shihte gjëndjen time më pyeti: **'Pse ke ardhur o Ali, a mos vallë të duhet diçka?'** Por kur pas se prej turpit unë nuk fola, ai më tha: '**A mos vallë ke ardhur për të kërkuar dorën e Fatimës për martesë?'** Atëherë munda të them: 'Po.' (Profeti i dërgoi lajm Fatimes se Aliu e kishte kërkuar për grua, por dhe ajo nuk tha asnjë fjlë, pra heshti.) Profeti më pyeti: **'Çfarë do t'i japësh si mehër (dhuratë martesore)?'** Kur unë i thashë: 'Nuk kam asgjë për t'i dhënë, o i Dërguari i Allahut.' Ai më tha: **'Çfarë ndodhi me mburojën e luftës që unë të kam dhënë, ku e ke atë?'** Kur i thashë se e kisha me vete. Atëherë Profeti a.s. më tha: **'Shite atë dhe shuma e saj do të jetë e mjaftueshme për mehër.'"**[169]

[169] Beyhekî, Delâil-un-nubuvve, III, 173; İbni Kesîr, Sire, II, 544.

Sipas një transmetimi tjetër, Profeti e pyeti Aliun se çfarë pasurie kishte në zotërim, dhe ai iu përgjigj se kishte vetëm një kalë dhe parzmoren e tij. Profeti tha: **"Kali të duhet, por shit parzmoren."** Aliu r.a. e shiti mburojën e luftës në treg, të cilën e bleur Osmani r.a. për 400 dirhemë. Por kur mësoi Osmani r.a. se Aliu r.a. e shiste mburojën e luftës sepse i duheshin paratë për martësë. Ja dhuroi Aliut r.a. edhe paratë edhe mburojën e luftes.

"O Fatime! Çfarë të ka ndodhur që po qan? Betohem në Allahun e Lartësuar se të kam martuar me atë që është më i dituri ndër ata që kanë kërkuar dorën tënde, më i urti dhe më inteligjenti, dhe i pari që ka pranuar Islamin."
Hadith

Kur dëgjoi i Dërguari i Allahut (Paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të) për kërë xhest të Osmanit r.a. tha: **"Osmani është miku im në Xhennet."** Pastaj ai e thirri Bilalin dhe i tha **"Merri këto para, shko në Pazar dhe bli një trëndafili dhe mjaltë. Pastaj, vendose ujin e trëndafilit në një enë të pastër, ndersa enën vendose në një cep të xhamisë. Mjaltin përziejeni me një dhe bëjeni dhe bëjeni sherbet që ta pimë pasi të lidhet nikahu. Ftoji në xhami sahabet e mi që janë nga Ensarët dhe Muhaxhirët dhe njoftoje popullin që do të lidhet nikahu i Fatimes me Aliun (Radijallahu anhum)."**

Bilal Habeshiu doli jashtë dhe lajmëroi popullin e Medinas per martesën e Aliut me Fatimen, vajzën e Profetit a.s.. Ne diten e martesës së tyre sahabët e mbushën Xhaminë e Profetit brenda dhe jashtë saj. Më pas Profeti ynë u ngrit në këmbë dhe lexoi këtë fjalim:

"Gjithë lavdërimi dhe falënderimi i përket Allahut, Zotit të gjithësisë. Ai është i Lavdëruari për begatitë që na ka dhuruar, Atë e adhurojmë për fuqinë dhe madhështinë e tij të pafundme, i frikësohemi Atij nga denimi i xhehennemit. Ai është i Vetmi Sundus që sundon në tokë dhe në qiej. Ai, që krijoi krijesat me fuqinë e tij, që ndan me drejtësinë e tij, që e nderoi njerëzimin me fenë e Islamit dhe me Profetin Muhammed (paqja qoftë mbi të)...Allahu më urdhëroi që vajzën time Fatimen ta martoj me Ali bin Ebi Talibin. Tani ju marr për dëshmitarë se, me urdhrin e Allahut, me një mehër prej 400 miskalesh argjendi, Fatimen e kam martuar me Ali bin Ebi Talibin. Zoti im i bashkoftë ata dhe ua bekoftë këtë bashkim. Pasardhësit e tyre qofshin të pastër, çelës i mëshirës dhe burim i urtësisë, të besueshëm për umetin e Muhamedit alejhi selam. Kjo ishte e gjitha ajo çfarë desha të them. Lus Zotin që ta na mëshiroi mua dhe ju." Më pas Aliu r.a. mbajti një fjalim të shkurtër, ku e nisi duke falenderuar Allahun xh.sh. me pas ai falënderoi Profetin a.s. që ja dha Fatimen për bashkëshorte. Gjithashtu Aliu r.a. falendoroi edhe Sahabet që po dëshmonin martësen e tij. Pas përfundimit të ceremonisë, të pranishmit hëngrën hurma dhe pinë shërbet mjalti, dhe ne fund te gjithë bënë lutje për çiftin e ri.[170]

Në kohën e martesës, Hazreti Fatime ishte pesëmbëdhjetë vjeç, ndërsa Hazreti Ali ishte njëzetepesë vjeç. Pas martesës Fatimja ishte e përlotur. Profeti e pyeti **"O Fatime! Çfarë të ka ndodhur që po qan? Betohem në Allahun e Lartësuar se të kam martuar me atë që është më i dituri ndër ata që kanë kërkuar dorën tënde, më i urti dhe më inteligjenti, dhe i pari që ka pranuar Islamin."** Ndërsa e bija i tha; "O Babai im! Për çdo vajzë që martohet, mehri caktohet dhe përcaktohet me ar e argjend. Nëse edhe mehri im caktohet kështu, ku është ndryshimi mes teje dhe të tjerëve? Ditën e Kiametit, ti do të ndërmjetësosh për besimtarët mëkatarë, ndërsa unë dua që të ndërmjetësoj për gratë e tyre. Kjo është dëshira ime."

[170] İbni Sa'd, Tabakât, VIII, 24; İbni Asâkir, Tarih-i Dımeshk, LII, 445.

Kur ju lajmërua Profetit a.s. se Allahu i Lartësuar e pranoi këtë dëshirë të Fatimes, i Dërguari i Allahut tha: **"O Fatime, e tregove që ti je fëmijë i një profeti."**

Më pas Aliu r.a. thotë: "Kishin kaluar disa muaj nga dita e martesës, dhe për këtë çështje nuk flitej më në mbledhje. Unë prej ndrojtjes nuk e hapa gojën. Megjithatë, i Dërguari i Allahut, ndonjëherë kur më shihte vetëm, më thoshte: **'Gruaja jote është vërtet një grua e mirë. Përgëzime, sepse ajo është zonja e grave në botë.'**

Por pas një kohe vëllai i Aliut, Ukaili, i tha: 'O Ali! Jemi ne të lumtur për këtë martesë. Por dëshira ime është që ju të dy tashmë jeni pranë njëri-tjetrit (të jetoni në një banesë tuajën).' Ndërsa Aliu r.a. iu përgjigj: 'Edhe unë kam të njëjtën dëshirë, por prej ndrojties nuk i them dot gjë të Dërguarit të Allahut.' Atëhere Ukaili e kapi për dore Aliun dhe shkuan së bashku në shtëpinë e Profetit a.s.. Atje, takuan shërbëtoren e të Dërguarit të Allahut, Ummu Ejmen."

Kur ja treguan situatën Ummu Ejmenit. Ajo u tha: "Për këtë çështje nuk është e nevojshme që ju të vini. Ne do të diskutojmë me gratë e Resulullahut dhe do t'ju njoftojmë. Dijeni se në këto çështje dëgjohet fjala e grave." Ummu Ejmeni e tregoi këtë situatë tek gratë e të Dërguarit të Allahut. Gratë shkuan dhe u mlodhën në shtëpinë e Aishes ku përmendën Hatixhen radijallahu anha, duke thënë: **"Nëse ajo do të ishte gjallë, nuk do të shqetësoheshim për Fatman."** Kur dëgjoi lëto fjalë I Dërguari i Allahut u përlot dhe tha: **"Ku ka grua si Hatixhja? Kur njerëzit më mohonin, ajo më besoi dhe shpenzoi gjithë pasurinë e saj në rrugën time. Ajo i ndihmoi shumë Islamit. Allahu më ka urdhëruar ta përgëzoj atë se në xhenet ka për të një kështjellë nga smeraldi."**

Më pas, gratë e Resulullahut i treguan atij dëshirën e Aliut r.a. që ai donte të jetonte me Fatimen në nje banesë të tyren. Atëherë Resulullahu urdhëroi Ummu Ejmenin të thërriste Aliun. Kur Aliu arriti, gratë që ishin të pranishme u larguan dhe e lanë Ali të vetëm me Rësulullahun. Resulullahu e pyeti: **"O Ali! A mos vallë dëshiron ta marrësh gruan tende?"** Aliu u përgjigj: "Po, o i Dërguari i Allahut (Paqja dhe Meshira e Allahut qofshin mbi të)!" Më pas I Dërguari i Allahut thirri Esma binti Umeis dhe i tha asaj; **''përgatite shtëpinë e Fatimes.''** Esma shkoi në shtëpinë e Fatimes dhe përgatiti disa ulëse të thjeshta, një ulëse prej lëkure të re, një ulëse prej lëkure të vjetër dhe një ulëse prej kashte, duke i mbushur të gjitha me fibra hurmeje. Pas namazit të jacisë Profeti alejhi selam e kontrolloi shtëpinë e Fatimes dhe urdhëroi që një pjesë e lekëve që solli Aliu r.a. të shpenzoheshin për ushqime, një pjesë zbukurime të shtëpisë, ndërsa pjesa tjetër për veshëmbathje.

Kështu që çejizi i Fatimes përfshinte materialet si me poshte; tre jastëkë të përgatitur nga Esma binti Umeis. Një qilim të thjeshtë dhe një jastëk të mbushur me fibra hurmeje. Dy mulli dore, një enë uji, një kupë uji prej balte dhe një shtamë lëkure për ujë. Një peshqir, një fustanellë, një ulëse të përpunuar prej një lëkure dashi dhe një qilim të vjetër nga Jemeni. Si dhe një shtrat të thurur nga gjethet e palmës, dy rroba nga Jemeni dhe një batanije kadifeje. Më pas Resulullahu i dha Aliut një shumë të vogël parash dhe e urdhëroi të blinte hurma dhe vaj për shtëpi.

Aliu r.a. e transmeton se: "Me paratë që më dha I Dërguari i Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të). Bleva hurma që kushtuan 5 dirhem dhe vaj i cili kushtoi 4 dirhem. Pastaj ja solla përpara të Dërguarit të Allahut, i cili kërkoi një sofër prej lëkure. Ai përgatiti një ushqim duke përzier hurmat, vajin dhe kosin me dorën e tij të bekuar dhe tha: **'O Ali! Dil dhe fto të gjithë ata që gjen.'** Unë dola

dhe pashë shumë njerëz, kështu që i ftova të gjithë dhe pastaj shkova brenda dhe i thashë: 'O i Dërguari i Allahut! Ka shumë njerëz.' Profeti, krenaria e universit, më tha: **'Sillini brenda nga dhjetë e nga dhjetë, që të hanë.'** Dhe kështu bëra. U numëruan, dhe në fund, ishin 700 burra dhe gra që hëngrën dhe u ngopën."

"O Ali! Kujdesu për Fatimen, sepse ajo është pjesë e imja. Nëse e mërzit atë, më ke mërzitur mua."
Hadith

Sipas rrëfimit të Ummu Ejmenit, pas darkës së dasmës së Aliut dhe Fatimes (Allahu qoftë i kënaqur me to), i Dërguari i Allahut i tha Aliut: **"O Ali, vajza ime Fatimja shkoi në shtëpinë tënde si nuse. Pas namazit të akshamit do të vij të bëj dua. Më pritni."** Mirëpo kur Aliu r.a. arriti në shtëpi, u ul në një qoshe, ndërsa Fatimja u ul në një qoshe tjetër. Pastaj i Dërguari i Allahut erdhi dhe trokiti në derë. Umm-i Ejmeni e hapi derën, dhe Profeti e pyeti: **"A është këtu vëllai im?"** Ummu Ejmeni i tha: ", o Resulullah! Nëna dhe babai im qofshin flijuar për ty. Por nuk e di kush është vëllai yt?" I Dërguari i Allahut u përgjigj: **"Ali bin Ebi Talibi."** Më pas Umm-i Ejmeni nga habia e pyeti nëse vajzën e tij e kishte martuar me vëllanë e tij, Profeti a.s. ju përgjigj se **Po** dhe i sqaroi se vetëm të lindurit nga e njëjta nënë janë të ndaluar për martesë. Më tej, i Dërguari i Allahut e pyeti Ummu Ejmenin që a kishte ardhur Esma binti Umeis dhe kur Ummy Ejmeni u përgjigj po, ai tha: **"Pra, ajo ka ardhur të shërbejë për vajzën e Resulullahut,"** dhe bëri lutje për të.

Pastaj, Profeti kërkoi një enë me ujë, lau duart e tij të bekuara dhe hodhi pak misk në ujë. Ai thirri vajzën e tij Fatimen, e cila nga turpi i mbante syte ulur. I Dërguari i Allahut mori pak ujë dhe e spërkati mbi gjoksin, kokën dhe shpinën e Fatimes, duke bërë dua: **"O Allah, kërkoj mbrojtje për të dhe pasardhësit e saj nga shejtani i mallkuar."** Pastaj ai bëri të njëjtën gjë për Aliun, duke thënë: **"O Allah, bekoi ata dhe pasardhësit e tyre."** Më pas I Dërguari i Allahut recitoi suret Ihlas, Felek dhe Nas tha: **"O Ali! Me emrin dhe bekimin e Allahut, hyr te gruaja jote."**[171]

Pas katër ditësh, i Dërguari i Allahut e vizitoi përsëri shtëpinë e çiftit të ri. Ju dha atyre këshilla dhe urdhëroi Aliun r.a. të sillte ujë. Një pjesë të ujit e piu ndërsa pjesën tjetër e hodhi mbi kokën dhe gjoksin e Aliut. Më pas e bëri të njëjtën gjë për Fatimen dhe për një moment e dërgoi Aliun jashtë. Ndërkohë, ai e pyeti vajzën e tij për Aliun. Fatimja i tha se Aliu ishte i përkryer, por disa gra të Kurejshit i thoshin se ai ishte i varfër. Profeti i tha: **"O bija ime! Babai yt dhe bashkëshorti yt nuk janë të varfër. Të gjitha thesaret dhe pasuritë e qiellit dhe të tokës m'u ofruan, por nuk i pranova. Pranova atë që është i pranuar dhe i vlefshëm për Allahun e Madhëruar. O bija ime! Sikur ta dije atë që di unë, bota do të ishte e pavlerë dhe e ulët në sytë e tu. Për Allahun e Madhëruar, bashkëshorti yt është ndër sahabët e parë, është i madh në Islam dhe më i thelli në dije. O bija ime! Allahu i Madhëruar ka zgjedhur dy persona nga Ehli Bejti: njërin, babain tënd, dhe tjetrin, bashkëshortin tënd. Kujdes, mos i bëj kurrë kundërshtim dhe mos vepro ndryshe nga urdhrat e tij."** Pastaj Profeti e këshilloi Fatimen të jetë e bindur ndaj Aliut dhe i kujtoi asaj virtytet e tij. Ai e ftoi Aliun brenda dhe e porositi që të kujdesej për Fatimen, duke i thënë: **"O Ali! Kujdesu për Fatimen, sepse ajo është pjesë e imja. Nëse e mërzit atë, më ke mërzitur mua."**

Kur mbaroi I Dërguari i Allahut Fatimja i kërkoi atij një shërbëtore për ta ndihmuar me punët e shtëpisë, por Profeti ja refuzoi kërkesën dhe i tha: **"O Fatime! A të jap diçka më të mirë se një shërbëtore?"** Po o I dërguari i Allahut ja ktheu

[171] Abdurredhdhâk, Musannef, V, 485.

e bija. Atëherë ai e këshilloi që çdo natë para gjumit të recitonte tridhjetë e tre herë **"Subhanallah," "Elhamdulillah,"** dhe **"Allahu Ekber,"** dhe një herë **"Lā ilāhe illallahu vahdehu lâ sherîke leh. Lehul mulku ve lehul hamdu ve huve alâ kulli shey'in kadîr."** Dhe para se të largohej i i tha se kjo do të sillte shpërblime të mëdha në Ditën e Gjykimit.

Ekzekutimi i Ka'b bin Eshrefit

"Ai na shqetësonte vazhdimisht dhe thurte poezi kundër nesh. Dijeni se, kushdo që vepron me poshtërsi dhe tradhëti, ndëshkimi për të është shpata."
Hadith

Pas triumfit të myslimanëve në Betejën e Bedrit, ra një frikë e tmerrhme mbi zemrat e hebrenjve dhe idhujtarëve që jetonin në Medinë. Disa hebrenj u treguan të drejtë dhe thanë: "Personi për të cilin kemi lexuar në librat tanë me siguri është ky. Nuk do të jetë e mundur të qëndrojmë kundër tij, sepse ai gjithmonë do të triumfojë." Disa të tjerë, menduan se fitorja e Profetit (a.s.) ishte vetëm sepse ai kishte luftuar me kurejshët që nuk dinin luftë dhe thanë se nëse ai do të kishte luftuar me ta, ata do t'i tregonin Profetit (a.s.) si luftohet dhe si arrihet fitorja. Ndërsa një hebre me emrin Ka'b bin Eshref, kur dëgjoi për fitoren e myslimanëve, nga urrejtja që kishte ndaj tyre, shkoi në Mekkë. Atje ai mblodhi idhujtarët dhe duke u thënë poezi për t'i motivuar dhe për t'i nxitur kundër myslimanëve, i nxiste idhujtarët që të sulmonin Medinën. Ai arriti të bëjë një marrëveshje me idhujtarët e Mekkës për të luftuar kundër Profetit (a.s.). Madje ai planifikoi kurthe për ri ngritur një atentat kundër Muhammedit alejhi selam. Allahu xh. sh. e informoi të Dërguarin e Tij për këtë dhi i zbreiti ajeti Kuranor, ku Allahu thotë: "Ata janë të mallkuar nga Allahu dhe janë të larguar nga mëshira e Tij."[172] Pas kësaj, i Dërguari i Allahut (a.s.) pyeti shokët e tij: **"Kush do ta vrasë Ka'b bin Eshrefin? Sepse ai i ka bërë dëm Allahut dhe të Dërguarit të Tij."** Muhammed bin Mesleme u ofrua të kryente këtë detyrë dhe i Dërguari i Allahut i dha leje.

Muhammed bin Mesleme përgatiti një plan dhe u takua me shokët e tij Ebu Naile, Abbad bin Bishr, Haris bin Evs dhe Ebu Abs ibn Xhebr. Të gjithë ata ranë dakord për planin dhe shkuan te Profeti (a.s.) për të marrë leje që të flisnin në një mënyrë që do të pëlqehej nga Ka'bi, për ta qetësuar atë dhe për ta futur në kurth. Profeti (a.s.) u dha leje qe ata ta kryenin planin e tyre. Ata shkuan te Ka'b bin Eshrefi dhe i thanë se Profeti a.s. kishte kërkuar prej tyre sadaka dhe u kishte vendosur taksa të larta, prandaj kishin ardhur për t'i kërkuar hua. Ka'bi u gëzua dhe mendoi se ata mendonin njësoj si ai. Ka'bi kërkoi si peng diçka me vlerë dhe pasi refuzuan të linin gratë apo fëmijët e tyre, ranë dakord të linin armët e tyre peng.[173]

Një natë Muhamed bin Mesleme se bashku me Ebu Nailen shkoi te Ka'bi. Kabi doli ti ftonte ata që të hynin në kështjellë. Gruaja e Ka'b-it i tha: "O Kab! Ku po shkon në këtë orë të natës?" Ka'b iu përgjigj: "Ata që kanë ardhur janë Muhamed bin Mesleme dhe vëllai im i gjirit, Ebu Naila." Gruaja i tha atij se: "Zëri që dëgjoj nuk më jep një ndjesi të mirë, më duket sikur prej tij rrjedh gjak." Ka'b tha: "Jo, ata janë Muhamed bin Mesleme dhe vëllai im i gjirit, Ebu Naila. Ai është një njeri i mirë. Edhe po ta thirrisja në mes të natës për të luftë, ai nuk do të hezitonte për të mos ardhur. Pra ai është një djalë i mire dhe guximtar." Muhamed bin Mesleme mori me vete dy persona të tjerë ose, sipas një transmetimi tjetër, tre persona të tjerë. Këta ishin Ebu

[172] Nisâ: 4/52.
[173] İbni Sa'd, Tabakât, II, 33-34.

Abs bin Xhebr, Haris bin Evs dhe Abbad bin Bishr.[174] Muhamed bin Mesleme u tha shokëve të tij: "Kur të vijë Ka'bi, do t'i kërkoj që të nuhas flokët e tij. Kur ta kap kokën dhe ta nuhas, sapo të më shihni që e kam mbajtur fort, atëherë goditeni me shpatat tuaja." Ka'b bin Eshref erdhi i veshur bukur dhe duke përhapur aromë të këndshme. Muhamed bin Mesleme i tha: "Asnjëherë më parë nuk kam ndjerë një aromë kaq të këndshme," dhe iu afrua Ka'b-it. Ka'bi u mburr: "Aromat më të mira të grave arabe janë me mua." Muhamed bin Mesleme i tha: "A më lejon ta nuhas kokën tënde?" Ka'bi pranoi. Mesleme e nuhati dhe u kërkoi edhe shokëve të tij ta bënin të njëjtën gjë. Pastaj tha se dëshironte ta nuhaste përsëri. Këtë herë, Muhamed bin Mesleme ia kapi kokën dhe u bëri shenjë shokëve që ta godisnin me shpatat e tyre. Kur u dha goditja e parë, Ka'bi klithi me forcë, por nuk vdiq. Pas kësaj, Muhamed bin Mesleme e goditi me thikë. Pas vrasjes së Ka'bit, luftëtarët u larguan menjëherë nga vendi dhe mbërritën në Medinë. Kur i sollën lajmin e mirë të Dërguarit të Allahut për vrasjen e Ka'b bin Eshrefit, Profeti (a.s.) falënderoi Allahun dhe bëri dua për luftëtarët.

Vdekja e Ka'b bin Eshrefit shkaktoi një frikë të madhe tek hebrenjtë, sepse ai ishte një udhëheqës i shquar, kështuqë vrasja e tij krijoi një pasiguri të hebrenjëve në Medina. Hebrenjtë duke ditur tradhëtitë dhe lojrat e pista te tyre ndaj mysliamnë dhe të Dërguarit të Allahut (paqja dhe mëshira e Allshut qoftë mbi te) i kishte bërë ata të mendonin se edhe ata do të ishin nën shënjestrën e myslimanëve për t'u vrarë. Në mëngjes, ata u mblodhën dhe për të paraqitur ankesën e tyre për ngjarjen e natës së kaluar shkuan te i Dërguari i Allahut. I Dërguari i Allahut u tha: **"Ai na shqetësonte vazhdimisht dhe thurte poezi kundër nesh. Dijeni se, kushdo që vepron me poshtërsi dhe tradhëti, ndëshkimi për të është shpata."** Pas këtij paralajmërimi, hebrenjtë tashmë të frikësuar, për të ruajtur paqen vendosën të bëjnë një marrëveshje të re me të Dërguarin e Allahut.[175] Më vonë shumica prej tyre pranoi Islamin.[176]

Beteja e Gatafanëve

Kjo ngjarje njihet edhe si "Gazaja e Beni Sulejmit" ose "Gazaja e Nexhranit." Lajmi arriti se një numër i madh idhujtarësh të mbledhur në Beni Sulejm po planifikonin të sulmonin Medinën. Hazreti Ibni Ummi Mektum u la si zëvendës. I Dërguari i Allahut marshoi me një forcë prej treqind vetash drejt armikut. Kur armiqtë mësuan se ushtria islame po afrohej, ata u strehuan në male. Si rezultat, nuk pati përballje mes palëve. Fushata zgjati dymbëdhjetë ditë.

[174] İbni Sa'd, Tabakât, II, 32.
[175] Buhârî, Megâdhi, 15; Vâkıdî, Megâdhî, I, 182; İbni Sa'd, Tabakât, II, 31; İbni Asâkir, Tarih-i Dımeshk, LV, 271.
[176] İbni Sa'd, Tabakât, II, 35.

Dashuria më ka marrë veten,
Të dua Ty, o Zoti im!
Dashuria Jote, sa e ëmbël qenka,
Të dua Ty, o Zoti im!

As pasurisë nuk i gëzohem,
As varfërisë nuk i dorëzohem.
Me dashurinë Tënde kënaqem,
Të dua Ty, o Zoti im!

Na urdhërove për adhurime,
Na lavdërove veprat e mira,
Na dhurove begati pa fund,
Të dua Ty, o Zoti im!

Sa i pabesë qenka shpirti im,
Për kënaqësi gjithnjë më dëmton!
Por tashmë e gjeta kënaqësinë e vërtetë,
Të dua Ty, o Zoti im!

Adhurimi të bëhet si duhet,
Edhe për këtë botë të punohet.
Kjo është puna ime natë e ditë,
Të dua Ty, o Zoti im!

Dashuria nuk është vetëm fjalë,
Rabbi thotë: "Punoni, mos qëndroni kot!"
Le të duket qartë nga gjendja jote,
Të dua Ty, o Zoti im!

Armiqtë e Islamit janë shumë,
Kundër fesë veprojnë tinëzisht.
A është e drejtë të qëndrosh në heshtje,
Të thuash: Të dua Ty, o Zoti im?

A mund të rrijë një i dashuruar përtac?
A mund t'i hedhë njollë të dashurit?
Hesht armiqtë, pastaj thuaj:
Të dua Ty, o Zoti im!

BETEJA E UHUDIT

"Uhudi na do ne, edhe ne e duam Uhudin"
Profeti Muhamed s.a.v.s.

Ishte vitit i tretë i Hixhretit, muaji Sheval... Idhujtarët e Mekës, jo vetëm që nuk kishin marrë mësime nga disfata e tyre në Betejën e Bedrit, por gjithashtu ata kurre nuk mund ta harronin atë humbje të hidhur për ta. Kurejshët në atë betejë kishin humbur shumë prej udhëheqësve të tyre. Për më tepër, kalimi i rrugës tregtare të Shamit nën kontrollin e myslimanëve i kishte tërbuar edhe më shumë. Këtë kohë një karvan tregtar nën drejtimin e Ebu Sufjanit, i cili kishte arritur një fitim 100% ishte kthyer në Mekkë. Por shumica e pjesëtarëve të këtij karvani kishin humbur jetën në Betejën e Bedrit, ndaj fitimi i karvanit ruhej në ndërtesën Darun-Nedve, vënd ky ku idhujtarët mblidheshin për të marrë vendime.

Ata që kishin humbur baballarë, vëllezër, burra dhe djem në Bedër, si Safuan bin Umejje, Ikrime bin Ebi Xhehli dhe Abdullah bin Rebia, iu drejtuan Ebu Sufjanit duke i thënë: ''O Ebu Sufjan! Myslimanët na shkatërruan në Bedir, ata na i vranë të mëdhenjtë tanë. Tani është koha për të hakmarrë ndaj tyre. Pra, fitimin e karvanit ne duhet ta përdorim, për të marrë hakun tonë dhe me ato të ardhura të përgatisim një ushtri me të cilën do të sulmojmë Medinën.''

Për shkak se në betejën e Bedrit ishin vrarë Ebu Xhehli, Utbe dhe Shejbe, në krye të idhujtarëve qëndronte Ebu Sufjani, i cili ende nuk e kishte pranuar Islamin. Nga tregtia në Sham ishin fituar 100,000 monedha ari. Gjysma e këtyre parave ishin kapital, ndërsa gjysma tjetër fitim. Kapitali iu shpërnda menjëherë pronarëve të tij, ndërsa fitimi u nda në dy pjesë: njëra për të blerë armë dhe tjetra për të mbledhur ushtarë. Përveç kësaj, u shpërndanë para poetëve dhe oratorëve që me poezi dhe elegjitë e tyre të nxisnin popullin për luftë. Gratë luanin instrumente si def dhe daulle, duke mbështetur burrat në këtë fushatë. Qëllimi i idhujtarëve ishte që të dëbonin myslimanët nga Medina, të eliminonin të Dërguarin e Allahut dhe të shuanin Islamin. Për këtë arsye, ata udhëtuan edhe në fiset përreth për të mbledhur sam ë shumë trupa të reja.

Më në fund, në Mekkë u përgatit një ushtri e madhe prej 3000 personash. Nga këta, 700 ishin të pajisur me mburoja lufte, 200 ishin kalorës, dhe kishin gjithashtu 3000 deve. Kjo ushtri e madhe, ku morën pjesë poetë, muzikantë dhe gra, komandohej nga Ebu Sufjani. Ndërsa gruaja e tij, Hindi, ishte në krye të grave dhe nxiste idhujtarët për të luftuar. Ajo kishte humbur babanë dhe dy vëllezërit e saj në Betejën e Bedrit, dhe kjo dhimbje nuk po e linte atë të qetë. Hind iu kundërvihej atyre që nuk donin që gratë të merrnin pjesë në betejë, duke ju thënë: "Kujtoni Betejën e Bedrit! Ju ikët për t'u kthyer te gratë dhe fëmijët tuaj! Nga tani e tutje, ata që duan të ikin nga beteja do të përballen me ne!" Me këto fjalë, Hindi i provokonte dhe i nxiste Kurejshët të luftonin me të gjithë fuqinë e tyre.[177]

Në periudhën e betejës së Uhudit, Xhubeir bin Mutimi, i cili ishte një nga liderët e Mekkës, kishte një skllav të quajtur Vahshi. Vahshi ishte i njohur për aftësitë e tij të jashtëzakonshme si shtizëhedhës dhe për saktësinë e tij të jashtëzakonshme. Xhubeiri i premtoi Vahshit se, nëse do të arrinte të vriste Hamzain, xhaxhain e Pejgamberit a.s., do ta lironte nga skllavëria. Në të njëjtën kohë, Hind bint Utbe, gruaja e Ebu Sufjanit, përshka të urrejtjes ekstreme që kishte për Hamzain i premtoi Vahshit se nëse do të realizonte këtë akt hakmarrjeje, ajo do ti jepte shpërblime të

[177] SHemseddin SHâmî, Subulu'l-Hudâ, IV, 182.

mëdha, pasi ajo kërkonte të hakmerrej për babain e saj, Utben, që i ishte vrarë në Betejën e Bedrit.[178] Ndërkohë, ushtria e Kurejshëve po përgatitej për një betejë të madhe kundër myslimanëve. Ata mobilizuan një forcë prej 3000 burrash, ndër të cilët 700 ishin të pajisur me mburoja dhe 200 kalorës, të shoqëruar nga deve dhe armë të shumta. Abbasi, xhaxhai i Profetit Muhamed (a.s.), i dërgoi një letër Profetit a.s. përmes një personi të besueshëm, duke e paralajmëruar për këtë lëvizje të armikut dhe duke kërkuar prej tij marrjen e masave mbrojtëse.

"Mos flisni keq për shokët e mi! Edhe sikur të jepni sadaka sa mali Uhud në ar, nuk do të mund të arrini shpërblimin e një grushti elbi që ata kanë dhënë si sadaka!"
Hadith

Pas marrjes së kësaj informate, Profeti Muhamed (a.s.) ndërmori hapa për të verifikuar situatën dhe dërgoi disa sahabë për të vëzhguar ushtrinë e Kurejshëve. Kur ata u kthyen me informacione që përputheshin me atë që ishte shkruar në letër, Profeti (a.s.) filloi menjëherë përgatitjet për mbrojtje. Për të parandaluar një sulm të papritur, ai bëri thirrje për mobilizim dhe caktoi rojtarë të cilët patrullonin përreth Medinës.

Kur mori lajmin e organizmit të idhujtarëve Pejgamberi alejhi selam ishte ditë e xhuma ndaj në hutben e të xhumasë, Profeti (a.s.) theksoi rëndësinë e xhihadit në rrugën e Allahut. Dhe shpërblimin e madh për ata që binin dëshmorë. Ai gjithashtu ndau një ëndërr që kishte pare se **''se ishte duke i ftuar sahabët e tij për të diskutuar mbi të dhe për të vendosur strategjinë e duhur. Në ëndërr, ai ishte parë duke mbajtur një zire të fortë (armaturë mbrojtëse), e cila simbolizonte Medinën dhe sigurinë e qëndrimit në të. Gjithashtu, kishte parë shpirtin e disa sahabëve që do të binin dëshmorë, si dhe një fitore të ardhshme për myslimanët.''** Kjo ëndërr u interpretua si një shenjë për rrezikun që i priste myslimanët dhe për nevojën për të qëndruar të bashkuar dhe të gatshëm për sfidat që do të vinin në vazhdim. Ndërsa sahabët u përgatitën për betejën, ata u drejtuan nga Profeti Muhamed (a.s.), duke shprehur përkushtimin dhe gatishmërinë e tyre për të qëndruar përkrah tij në mbrojtjen e Islamit.

I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të), dëshiroi të këshillohej me shokët e tij të nderuar për vendin ku duhet të zhvillohej lufta dhe u tregoi ëndrrën që kishte parë atë natë. Ai tha: **"Në ëndërr pashë veten të veshur me një parzmore të fortë. Pashë gjithashtu se te tehu i shpatës sime, Zulfikarit, ishte hapur një gropë, pashë një lopë të therur dhe pas saj u soll një dash."** Shokët e nderuar e pyetën: **"O i Dërguar i Allahut! Si e shpjegove këtë ëndërr?"** Ai u përgjigj: **"Të veshësh një parzmore të fortë simbolizon Medinën dhe qëndrimin në Medinë. Qëndroni atje... Tehu i thyer i shpatës sime tregon për një dëm që do të pësoj. Lopët e therura simbolizojnë rënien dëshmorë të disa prej shokëve të mi. Ndërsa sjellja e dashit pas kësaj tregon për një njësi ushtarake që, me dëshirën e Allahut, do të mposhtet prej Tij."** Në një transmetim tjetër thuhet: **"Në ëndërr e përplasa shpatën time në tokë dhe tehu i saj u thye. Kjo është shenjë që në ditën e Uhudit disa nga shokët e mi do të bien dëshmorë. Pastaj e përplasa përsëri shpatën dhe ajo u kthye në gjendjen e saj të mëparshme, të rregullt. Kjo tregon për një fitore të dhënë nga Allahu dhe për bashkimin e besimtarëve."**

Profeti Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) në çështjet që nuk i zbriste shpallje hyjnore, gjithmonë konsultohej me sahabët e tij dhe vepronte

[178] Buhârî, Megâdhi, 23; İbni Hishâm, Sîret, II, 69; Suheylî, Ravdu'l-unf, III, 253.

sipas mendimeve të tyre. Në rastin e vendimit për përballjen me armikun, disa nga sahabët sugjeruan që të mbrohej Medina, duke zhvilluar një luftë mbrojtëse brenda qytetit. Ky propozim përputhej edhe me dëshirat e Profetit a.s. dhe me mendimin e disa nga sahabët më të shquar, si Ebu Bekri, Omeri dhe Sad bin Muadhi (Allahu qoftë i kënaqur me ta). Por një grup tjetër sahabësh, veçanërisht të rinjtë dhe ata që nuk kishin marrë pjesë në Betejën e Bedrit, dëshironin të përballeshin me armikun jashtë Medinës. Ata ishin të motivuar nga dëshira për të fituar shpërblimet dhe gradat shpirtërore që fituan sahabët e Bedrit. Ndër këta ishte edhe Hamzai, N'man bin Malik dhe Sad bin Ubade (Allahu qoftë i kënaqur me to).

"Një profet që ka veshur mburojën e luftës nuk e heq e atë pa luftuar, derisa Allahu të vendosë mes tij dhe armikut. Këshilla ime për ju është që të zbatoni urdhrat e mia, të përmendni emrin e Allahut dhe të tregoni durim dhe qëndrueshmëri. Nëse bëni këtë, Allahu i Madhëruar do t'ju ndihmojë."
Hadith

Një nga këta sahabë, Haiseme, u shpreh me emocion të madh për dëshirën e tij për të marrë pjesë në luftë dhe për të rënë dëshmor. Ai kujtoi djalin e tij, i cili ishte bërë dëshmor në Bedër, dhe tregoi një ëndërr ku kishte parë djalin e tij në xhenet, i cili e kishte ftuar t'i bashkohej në xhennet. Me zemër të mbushur me mall për xhenetit dhe për të takuar djalin e tij, Haiseme kërkoi që Profeti të lutej për të që të arrinte dëshmorësinë. Profeti (paqja qoftë mbi të) nuk ia refuzoi këtë dëshirë dhe u lut për të.

Përfundimisht Profeti a.s. e pa që shumica e sahabëve ishin në favor të luftës jashtë Medinës. Ndaj ai pranoi mendimin e tyre dhe vendosi të përballej me armikun në terren të hapur dhe i inkurajoi sahabët e tij, duke ju thënë: **"Nëse tregoni durim dhe qëndresë, Allahu do t'ju ndihmojë. Detyra jonë është të tregohemi të vendosur dhe të përkushtuar në betejë."** Pas faljes së namazit të ikindisë, Profeti a.s. u kthye në shtëpinë e tij për tu përgatitur për luftë. Ebu Bekri dhe Omeri radijallahu anhuma (kënaqsia e Allahut qoftë mbi ta) e ndihmuan atë të lidhej me turbanin, të vishte parzmoret dhe të mirëarmatosej. Kështu Profeti a.s. duke u bërë gati për të udhëhequr sahabët në betejën e madhe që i priste, mori shpatën dhe mburojën dhe u nis drejt sahabëve.

Ndërkohë shokët e Profetit (paqja qoftë mbi të) ishin mbledhur jashtë dhe po prisnin që ai të dilte. Ata që dëshironin të qëndronin në Medinë dhe të bënin një luftë mbrojtëse, u thanë të tjerëve: "I Dërguari i Allahut nuk ishte për të dalë jashtë Medinës. Ai pranoi këtë mendim pas sugjerimit tuaj. Por i Dërguari i Allahut merr urdhrat nga Allahu i Madhëruar. Ju duhet t'ia lini këtë çështje Atij dhe të veproni ashtu sikur urdhëron ai." Të tjerët, të penduar për qëndrimin e tyre, thanë: "Nuk dëshirojmë të jemi në kundërshtim me të Dërguarin e Allahut," dhe hoqën dorë nga mendimi i tyre. Kur i dashuri i Allahut doli nga shtëpia e tij, ata shkuan para tij dhe thanë: "Jeta jonë qoftë flijuar për ty, o i Dërguar i Allahut! Vepro ashtu siç dëshiron ti. Nëse dëshiron të qëndrojmë në Medinë, do të qëndrojmë. Kërkojmë falje te Allahu për kundërshtimin ndaj urdhrit tënd." I Dërguari i dashur tha: **"Një profet që ka veshur mburojën e luftës nuk e heq e atë pa luftuar, derisa Allahu të vendosë mes tij dhe armikut. Këshilla ime për ju është që të zbatoni urdhrat e mia, të përmendni emrin e Allahut dhe të tregoni durim dhe qëndrueshmëri. Nëse bëni këtë, Allahu i Madhëruar do t'ju ndihmojë."**

Ndërkohë, Amr bin Xhemuh (Allahu qoftë i kënaqur me të) i tha katër djemve të tij në shtëpi: "Bijtë e mi, më merrni edhe mua me vete në këtë luftë!" Por ata i thanë: "Babai ynë, në vendin tënd do të shkojmë ne. Ndërsa ty për shkak të këmbës tënde

të dëmtuar, Allahu të ka dhënë lehtësim dhe i Dërguari i Allahut të ka përjashtuar nga detyrimi për të dalu në luftë." Amr bin Xhemuh, i zemëruar, ju përgjigj: **"**Turp për ju, o fëmijët e mi! Edhe në luftën e Bedrit më ndaluat të merrja pjesë dhe të fitoja Xhenetin. A do të më privoni edhe nga kjo luftë?" Pastaj shkoi te Profeti a.s. dhe tha atij: "Jeta ime qoftë flijuar për ty, o i Dërguar i Allahut! Bijtë e mi, duke sjellë si justifikim këtë dhe këtë arsye po më ndalojnë të marr pjesë në këtë luftë. Për Allah, dua të dal me ty në këtë luftë dhe të fitoj nderin e hyrjes në Xhenet. A nuk është e përshtatshme që unë të luftoj për hir të Allahut dhe të bëhem dëshmor dhe të eci në Xhenet me këtë këmbë të dëmtuar?" I Dërguari i Allahut i tha: **"Po, është e arsyeshme të vish me ne në kuftë."** Amr bin Xhemuhu u gëzua shumë nga përgjigjia e Profetit a.s. dhe me të katërtat u përgatit dhe iu bashkua ushtrisë.[179]

Profeti a.s. pasi emëroi që në Medine, për të udhëhequr namazin, e la Abdullah bin Umi Mektum,[180] lidhi tri flamuj. Të parin ia dha Habbab bin Munzirit, tjetrin Usajd bin Hudajrit dhe të tretin Musab bin Umejrit. Ushtria e Pejgamberit a.s. numëronte rreth një mijë luftëtarë, përfshinte dy kalorës dhe njëqind të armatosur me parzmore. Sa'd bin Ubade dhe Sa'd bin Muadh ecnin përpara, Muhaxhirët ishin në krahun e djathtë ndërsa Ensarët në të majtë. Pas namazit të xhumasë, i Dërguari i Allahut, i shoqëruar nga thirrjet e sahabëve **"Allahu Ekber"**, u nis drejt Uhudit sikur ata po niseshin për në një festë.[181]

Gjatë rrugës, një njësi ushtarake prej gjashtëqind burrash hebrenj, aleatë të hipokritit Abdullah bin Ubaj bin Selul, u përpoq të bashkohej me ushtrinë myslimane. Profeti pyeti: **"A janë bërë ata myslimanë?"** Kur iu përgjigjën **"Jo, o i Dërguar i Allahut,"** ai tha: **"Shkoni dhe u thoni që të kthehen mbrapa, sepse ne për të luftuar idhujtarët nuk kërkojmë ndihmë nga jobesimtarët."**

I Dërguari i nderuar i Allahut (paqja qoftë mbi të) së bashku me ushtrinë mbërriti në vendin e quajtur Shejhajn. Vënd ky që ndodhet midis Medinës dhe Uhudit. Aty u ndalën për të kaluar natën por dielli ende nuk kishte perënduar. Brenda ushtrisë kishte edhe disa shokë të rinj të Profetit, të cilit ishin ende fëmijë. Ata dëshironin të luftonin kundër armikut dhe të arrinin gradën e dëshmorit. Kur i dashuri i Allahut inspektoi ushtrinë, vërejti se kishte rreth shtatëmbëdhjetë djelmoshë. Ndër ta ishte dhe Rafi bin Hadixh, i cili për t'u dukur më i gjatë qëndronte në majë të gishtave të këmbëve. Kur Zuhajri i tha: "O i Dërguar i Allahut! Rafi është një harkëtar i shkëlqyer." Atëherë Profeti e pranoi atë në ushtri. Kjo e entuziazmoi shumë Semure bin Xhundupin, i cili tha: "Unë mund ta mund Rafinë në mundje, prandaj dua të marr pjesë edhe unë në luftë." Profeti buzëqeshi dhe i lejoi ata të mundeshin. Kur Semure e mundi Rafinë, edhe ai u pranua në mesin e luftëtarëve. Ndërsa djelmoshët e tjerë u dërguan në Medinë për të mbrojtur ata që kishin mbetur atje.

Bilali i Habeshiu me zërin e tij të mrekullueshëm thirri ezanin për aksham dhe jaci. Pas namazit, Profeti caktoi Muhamed bin Meslemen si udhëheqës të një grupi prej pesëdhjetë burrash dhe u dha atyre detyrë që të ruanin kampin deri në mëngjes. Ndërsa shokët e tjerë të Profetit a.s. u tërhoqën për të pushuar. Atë natë, nderi për të qëndruar roje pranë Profetit a.s. i takoi Zekvanit (Allahu qoftë i kënaqur me të).

Ndërkohë që ushtria e armikut mësoi se myslimanët ishin vendosur për të pushuar në Shejhajn, dërguan një patrullë kalorësish të udhëhequr nga Ikrime, i cili

[179] İbni Hishâm, Sîret, II, 90; Vâkıdî, Megâdhî, I, 265.
[180] İbni Sa'd, Tabakât, IV, 209.
[181] Vâkıdî, Megâdhî, I, 215, 240; İbni Asâkir, Tarih-i Dımeshk, LV, 267.

ende nuk ishte bërë mysliman. Ikrime dhe njerëzit e tij iu afruan zonës së Harresë, por nga frika e patrullës myslimane u tërhoqën mbrapsht. Pas agimit, i dashuri i Allahut zgjoi shokët e tij dhe i nisi ata për tek mali Uhud. Tasme në Uhud të dyja ushtritë mund të shihnin njëra-tjetrën. Bilal Habeshiu, me zërin e bukur të tij që i mbushte zemrat me plot emocion dhe enrgji, thirri ezanin e sabahut. Myslimanët, falën namazin e sabahut të armatosur, pas Profetit dhe së bashku me të bënë dua.

Profeti, i cili kishte veshur një parzmore tjetër dhe një helmetë mbi kokë, riorganizoi edhe një herë ushtrinë. Gjatë kësaj kohe Abdullah bin Ubaji, udhëheqësi i hipokritëve tha "A kemi ardhur këtu për të vdekur? Pse nuk e kuptuam këtë që në fillim?" Më pas, duke braktisur ushtrinë myslimane, ai së bashku me rreth 300 hipokritë u kthye në Medinë. Tani përballë mbi 3000 ushtarëvë të armikut kishin mbetur rreth 700 myslimanë të vërtetë që kishin vendosur t'ia kushtonin jetën, deri në pikën e fundit të gjakut, mbrojtjes së Profetit a.s..

Profeti a.s. e vendosi ushtrinë me shpinë nga mali Uhud dhe përballë Medinës. Ai caktoi Ukasha bin Mihsanin komandant të krahut të djathtë dhe Ebu Seleme bin Abdulesedin komandant të krahut të majtë. Sa'd bin Ebi Vakkasi dhe Ebu Ubejda bin Xherrah qëndruan përpara, duke udhëhequr njësitë e harkëtarëve. Ndërsa Zuberi bin Avami mori drejtimin e forcave të blinduara. Edhe Hamzai (Allahu qoftë i kënaqur me të) mori drejtimin e forcave të paarmatosura përpara. Kurse Mikdad bin Amri u caktua të udhëhiqte forcat në prapavijë.

Beteja e Bedrit



Ai i donte njerëzit për hir të Allahut, për hir të Tij ndjente urrejtje;
Ai burim i mirësisë dhe bujarisë, nuk u bë as mik as armik për interes të vet.

Kurrë nuk qeshi me zë të lartë, as nuk e ofendoi askënd;
Fjalët e tij ishin të bukura, fytyra e tij e qeshur, burimi i mirësisë dhe bujarisë.

Ai ishte i njohur për turpin dhe butësinë, për mirësinë dhe respektin;
Kurrë nuk e linte me lot atë që i drejtohej për ndihmë, burimi i mirësisë dhe bujarisë.

Në anën e majtë të ushtrisë islame ndodhej kodra Ainein. Në këtë kodër ishte një

kalim i ngushtë. I Dërguari i Allahut (paqja qoftë mbi të), nën komandën e Abdullah bin Xhubeirit vendosi në këtë kalim pesëdhjetë harkëtarë. Kur harkëtarët zunë vendet e tyre në pritë I Dashuri i Allahut shkoi pranë tyre dhe u dha të prerë: **''Qëndroni në vendet tuaja dhe mos u largoni kurrsesi prej aty. Pra na ruani që armiku të mos na sulmoi nga pas. Por edhe nëse e shihni që ne e kemi mposhtur armikun, ju kurrë mos u largoni derisa t'ju njoftoj unë ose t'ju dërgoj ndonjë lajmëtarë. Edhe nëse mendoni se armiku po na mbyt ose na ka mbytur, mos ejani të na ndihmoni.**[182] (Pra kurrë mos e lini kodrën edhe nëse ne na mposht armiku)**. Nëse ata ju afrohen, gjuani kalorësit e armikut me shigjeta, sepse kalorësit nuk mund të afrohen drejt shigjetave të hedhura.''** Dhe ne fund duke ngritur duart nga qielli tha; **''O Allah! Ti je dëshmitar që unë ua përcolla këtë porosi!''** I Dërguari i Allahut e përsëriti disa herë këtë urdhër të prerë dhe pra se të largohej ju tha: **"Edhe nëse e shihni që zogjtë po na rrëmbejnë trupat tanë, derisa t'ju dërgoj unë ndonjë lajmëtarë ju kurrë mos u largoni nga vendet tuaja. Edhe nëse shihni që po i thyejmë mosbesimtarët dhe po i shkelim me këmbët tona, ju përsëri mos e lini vendin tuaj pa u njoftuar prej meje!''** Më pas, i Dërguari u largua nga aty dhe kaloi në krye të ushtrisë. Flamurin e ushtrisë ia dha Musab bin Umejrit. Musabi r.a., duke mbajtur flamurin në dorë, u pozicionua para të Dërguarit të Allahut[183]. Në këtë kohë, sahabiu Hanzalla r.a., i cili sapo ishte martuar, erdhi me shpejtësi nga Medina dhe iu bashkua radhëve të ushtrisë së Pejgamberit alejhi selam.

"Qëndroni në vendet tuaja dhe mos u largoni kurrsesi prej aty. Pra na ruani që armiku të mos na sulmoi nga pas. Por edhe nëse e shihni që ne e kemi mposhtur armikun, ju kurrë mos u largoni derisa t'ju njoftoj unë ose t'ju dërgoj ndonjë lajmëtarë. Edhe nëse mendoni se armiku po na mbyt ose na ka mbytur, mos ejani të na ndihmoni."
Hadith

Ndërsa ushtria e idhujtarëve, e cila kishte mbërritur në Uhud tri ditë më pare se të arrinte ushtria Islame, drejtohej nga Ebu Sufjani. Ata ishin vendosur duke pasur Medinën nga prapa shpinës. Krahu i djathtë i kalorësve komandohej nga Halid bin Velidi, ndërsa krahu i majtë nga Ikrima. Po ashtu, thuhet se Safvan bin Umejja komandonte njësi të tjera kalorësish. Ndersa flamurin e ushtrisë së idhujtarëve e mbante Talha bin Ebi Talha. Balanca e forcave mes dy ushtrive ishte shumë e ndryshme. Ushtria idhujtare, për nga numri, armët dhe pajisjet luftarake, ishte katërfish më e madhe sa ajo e myslimanëve. Ndërkohë që në anën e ushtrisë së Kurejshëve dëgjoheshin zhurma dhe thirrje hakmarrjeje. Ndërsa gratë e tyre për të nxitur ushtarët në luftë këndonin nën shoqërinë e muzikës, defit e daulles dhe kërkonin ndihmë nga idhujt që idhujt ti ndihmonin ushtrisë idhujtare. (Pra kjo ishte ajo skena e vërtetë ku mashtrimi me një superfuqi në numër luftonte të vërtetën që ishte në pakicë). Ndërsa në anën e myslimanëve bëheshin lutje, dëgjoheshin thirrjet: **"Allahu Ekber! Allahu Ekber!"** dhe kërkohej ndihma e Allahut të Lartësuar për mbrojtje dhe përhapjen e Islamit.

I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të), i inkurajonte sahabët, që të angazhoheshin në xhihad dhe u shpjegonte atyre shpërblimet që ka te luftuarit në rrugën e Allahut. Pejgamberi ju thoshte; **“O Sahabë! Për një grup të vogël njerëzish është e vështirë të përballen me armikun. Por, nëse ata tregojnë qëndrueshmëri dhe përpjekje, Allahu i Lartësuar do t’i çojë në fitore. Sepse Allahu është me ata që i binden Atij... Kërkoni shpërblimin që Allahu i Lartësuar ju ka premtuar...”**

[182] Buhârî, Cihâd, 164; Megâdhi, 10, 20; Ebû Dâvûd, Cihâd, 116; Ahmed bin Hanbel, Musned, IV, 293; İbni Hishâm, Sîret, II, 65; Vâkıdî, Megâdhî, I, 160, 220, 224; İbni Sa'd, Tabakât, I, II, 47; III, 476; Taberî, Târih, II, 192.
[183] İbni Hishâm, Sîret, II, 73; Taberî, Târih, II, 199; Suheylî, Ravdu'l-unf, III, 258.

"O Sahabë! Për një grup të vogël njerëzish është e vështirë të përballen me armikun. Por, nëse ata tregojnë qëndrueshmëri dhe përpjekje, Allahu i Lartësuar do t'i çojë në fitore. Sepse Allahu është me ata që i binden Atij... Kërkoni shpërblimin që Allahu i Lartësuar ju ka premtuar..."
Hadith

Në ajetet Kuranore që flasin për betejën e Uhudit, Allahu i Lartësuar thotë: **''Dhe bindjuni Allahut dhe të Dërguarit (Muhammedit sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) që të mund të mëshiroheni. Dhe nxitoni në rrugën e faljes nga Zoti juaj dhe drejt Xhennetit të gjërë sa hapësira e qiejve dhe e tokës, i përgatitur për Muttekunët (të përkushtuarit në Besimin e Pastër Islam). Ata që shpenzojnë (për Çështjen e Allahut) në kohë begatie e fatkeqësie; ata të cilët e përmbajnë zemërimin dhe ata të cilët e falin njëri-tjetrin; vërtet Allahu i do shumë Muhsinunët (mirëpunuesit në rrugë të Allahut).''**[184] **"Për të tillët shpërblimi është Falja nga Zoti i tyre dhe Kopshte me lumenj që rrjedhin poshtë tyre për të banuar ndër to përgjithmonë. Sa i shkëlqyer është ky shpërblim për punuesit (e veprave të mira e të drejta sipas Urdhrave të Allahut).''**[185]

Sahabët e ndershëm, me zemrat e tyre të mbushura me iman dhe me sytë që ju reflektonin shkëndija guximi dhe të etur por prisnin me padurim urdhrin për të sulmuar armikun. Ashtu sikur në betejën e Bedrit, Aliu lidhi një shall të bardhë, Zubejr bin Avam një të verdhë dhe Ebu Duxhane një të kuq (Allahu qoftë i kënaqur prej tyre). Ndërsa Hamza r.a. e zbukuroi veten e tij me një pendë deveje mbi helmetë.

Ndërkohë që dy ushtritë iu afruan njëra-tjetrës emocionet arritën kulmin. Pak më vonë, do të fillonte një betejë e madhe midis luftëtarëve të Islamit, të cilët ishin gati të luftonin edhe kundër të afërmve të tyre për hir të fesë së Allahut, dhe armiqve të Islamit që ngulmonin në rrugën e gabuar. Kur distanca midis tyre u zvogëlua, sikur në një të shtënë me hark, një armik i veshur me parzmore doli nga radhët e tyre me devenë e tij dhe kërkoi një luftëtar nga muslimanët për t'u përballur me të. Ai përsëriti thirrjen e tij tre herë, duke menduar se askush nuk do të guxonte ta sfidonte. Atëherë, nga ushtria islame, një luftëtar i gjatë me një shall të verdhë, Zubejr bin Avami doli përpara. Atë moment nga radhët e muslimanëve u ngritën thirrje **"Allahu Ekber!"** dhe lutje për fitoren e tij. Zubejri u hodh mbi devenë e armikut dhe ndërmjet tyre nisi një përleshje e ashpër.

Pejgamberi ynë i dashur u dëgjua duke thënë: **"Rrëzoje atë!"** Dhe sapo Zubejri dëgjoi këtë urdhër e hodhi armikun përtokë dhe me një goditje të vetme të shpatës ia ndau kokën nga trupi. Kur pa triumfin e tij Pejgamberi ynë i Dashur e përgëzoi Zubejrin radijallahu anhu. Më pas, flamurtari i idhujtarëve, Talha bin Ebi Talha, doli përpara duke sfiduar muslimanët. Përballë tij doli Luani i Allahut, Ali radijallahu anhu. I cili me një goditje të vetme ia ndau kokën kundërshtarit. Duke parë këtë triumf Pejgamberi a.s. thirri: **"Allahu Ekber!... Allahu Ekber!"** Kjo thirrje u përsërit nga të gjithë sahabët, duke bërë që tingulli i tekbirit të trondisë qiellin dhe tokën.[186]

Më pas, kur vëllai i Talhasë, Osman bin Ebi Talha, pa që flamuri i idhujtarëve kishte rënë në tokë vrapoi drejt fushës së betejës. Ai ngriti flamurin dhe ja nisi të sfidoi myslimanët për një duel. Përballë tij doli Hamzai r.a. i cili tha **"Ya Allah!"** dhe goditi me një goditje të fuqishme shpate Osmanin në shpatull, duke ia prerë këtij të fundit krahun që mbante flamurin. Osman bin Ebi Talha ra përtokë dhe ndërroi jete aty në vënd[187].

[184] Âl-i İmrân: 3/132-134.
[185] Âl-i İmrân: 3/136.
[186] İbni Hishâm, Sîret, II, 151; Vâkıdî, Megâdhî, I, 224, 308; İbni Sa'd, Tabakât, II, 40; Beyhekî, Delâil-un-nubuvve, III, 239; Suheylî, Ravdu'l-unf, III, 318.
[187] İbni Hishâm, Sire, II, 74; Vâkıdî, Megâdhî, I, 227; İbni Sa'd, Tabakât, II, 41; Suheylî, Ravdu'l-unf, III, 258.

"Lufta është hile."
Hadith

Pas kësaj, një tjetër idhujtar, Ebu Sa'd bin Ebi Talha, pa flamurin e tyre të rrëzuar dhe doli në fushë për ta ngritur. I veshur plotësisht me parzmore, ai e ngriti flamurin dhe, duke u kthyer nga ushtria myslimane, bërtiti: "Unë jam babai i Kusemit. A ka ndonjë që mund të më dalë përballë?" Pejgamberi ynë dërgoi sërish Aliun r.a. për tu përballuar me të. Ali pa vonuar e vrau atë idhujtar dhe e rrëzoi përsëri flamurin e idhujtarëve. Pas kësaj beteje Aliu r.a. u kthye në rreshtat e ushtrisë myslimane.

Më pas, shumë idhujtarë duke sfiduar myslimanët për duel dolën njëri pas tjetrit për të ngritur flamurin e tyre të rrëzuar. Sikur çdo herë sahabët trima triumfonin me lejen e Allahut të Lartësuar. Sa herë që një flamurtar i armikut vritej, nga ushtria myslimane jehonin thirrjet "Allahu Ekber!" e cila përhapej në të gjithë fushën e betejës. Një kohësisht kjo thirrje e tyre sjellte një tronditje të madhe dhe dëshpërim në radhët e armiqve. Madje, gratë idhujtare që më parë brohorisnin me entuziazëm, filluan të bërtasin të zemëruara: ata për ti nxitur ushtarët e tyre thirrnin plot trishtim "Turp për ju!...": "Çfarë prisni më?!"

KUSH DO TË JA JAPI TË DREJTËN E KËSAJ SHPATE?

Në një moment kur emocionet e të dyja palëve arritën kulmin, i dashuri Pejgamber (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) ngriti një shpatë mbi të cilën shkruhej

Turpi është në frikë, nderi dhe lavdia janë në përparim.
Njeriu nuk mund të shpëtojë nga fati duke u trembur.

Pejgamberi a.s. tha: **"Kush do ta marrë këtë shpatë nga unë?"** Kjo pyetje i nxiti shumë sahabët e nderuar te cilët dëshironin që menjëherë të shtrinin duart për ta marrë atë. Pejgamberi ynë i Dashur edhe një herë ripërsëriti: **"Kush do ta marrë dhe të ja japi hakun kësaj shpate?"** Por këtë herë sahabët heshtën. Midis atyre që e dëshironin shumë marrjen e shpatës nga dora e Resulullahut ishte edhe Zubejr bin Avami, i cili tha: **"Unë do ta marr, o i Dërguar i Allahut!"** Por Pejgamberi nuk ia dha shpatën as atij, as Ebu Bekrit, as Omerit dhe as Aliut (Allahu qoftë i kënaqur me ta). Atëherë Ebu Duxhane pyeti: **"O i Dërguar i Allahut! cili është haku i kësaj shpate?"** Pejgamberi iu përgjigj: **"Haku i saj është që ta përdorësh atë kundër armikut derisa ajo të përkulet** (nga përdorimi i shumtë)**. Të mos vrasësh myslimanë, të mos ikësh nga armiku dhe të luftosh në rrugën e Allahut derisa Ai të të dhurojë fitoren ose të të japë gradën e dëshmorit."** Atëherë Ebu Duxhane tha: **"O i Dërguar i Allahut! Unë do ta marr dhe do të ja jap hakun asaj."** Më pas Pejgamberi a.s. ia dorëzoi shpatën Ebu Duxhanes.[188]

Ebu Duxhane ishte i njohur për trimërinë dhe zgjuarsinë e tij në fushëbetejë. Ai duke recituar vargje u nis drejt armikut me një ecje krenare dhe plot vetëbesim. Ai mbante të veshur vetëm një këmishë të thjeshtë dhe shallin e tij të kuq. Disa sahabë nuk e pëlqyen këtë mënyrë ecjeje, por Pejgamberi tha: **"Kjo është një ecje që jashtë fushës së betejës do të shkaktonte zemërimin e Allahut, por në luftë ndaj**

[188] Buhârî, Cihâd, 157; Muslim, Cihâd, 29; Ebû Dâvûd, Cihâd, 101; Tirmidhî, Cihâd, 5; İbni Mâce, Cihâd, 28

armikut është e lejuar." Ky ishte dhe shkaku i hadithit ku Pejgamberi a.s. thote **''Lufta është hile''**[189]dhe Ebu Duxhane ishte ai strategu qe ja jepte hakun këtij hadithi.

"Unë e pashë Hanzalan, engjëjt po e lanin midis qiellit dhe tokës me ujë shiu."
Muhammedi alejhi selam

Atë kohë Halid bin Velidi dha urdhër dhe me trupat e tij nisi një sulm të ashpër mbi ushtrinë myslimane. Sapo e pa I Dërguari i Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të) dha urdhrin për sulm ku thirrjet **"Allahu Ekber!"** mbushën fushën e betejës. Në ballë të myslimanëve ishte Hamzai r.a. i cili përparonte duke goditur çdo armik që i dilte përpara.

Sapo e panë Halid bin Velidi dhe njerëzit që myslimanët po përparonin në fushëbetejë e tij u zmbrapsën menjëherë. Dhe Halidi duke ndërruar strategji tentoi ti sulmonte myslimanët nga pas. Por duke kaluar përmes kalimit malor pa se Abdullah bin Xhubejri dhe pesëdhjetë luftëtarët e tij po e sulmonin atë me një breshëri shigjetash, ndaj ai u detyrıa të kthehet mbrapsht.

Nga ana tjetër Ebu Duxhane duke përdorur shpatën e Pejgamberit po luftonte trimërisht, kundër armikut. Në fushëbetejë, ai hasi një armik të fuqishëm, me një trup të madh dhe të mbuluar plotësisht me parzmore, të cilit vetëm sytë i dukeshin. Armiku sulmoi i pari, por Ebu Duxhane bllokoi goditjen me mburojën e tij ku shpata e armikut ngeci në mburojën e Ebu Duxhanes. Ebu Duxhane iu hodh krahut të shpatës së armikut, i cili kishte ngecur në mburojën e tij, por nuk mundi ta nxirrte. Tashmë ishte radha e Ebu Duxhanes të vepronte i cili me një goditje të vetme e vrau kundërshtarin e tij. Më pas, duke rrëzuar çdo mohues të besimit që i dilte përpara, ai arriti deri tek gratë idhujtare të cilat rrinin pranë shpatit të malit duke rrahur defat dhe daullet dhe nxisnin armikun. Megjithëse ngriti shpatën për ta vrarë Hindin, gruan e Ebu Sufjanit ai në atë moment vendosi ta falte dhe hoqi dorë nga goditja. [190]

Kur e pa këtë skenë e pa Zubejr bin Avami, i cili tha me vete: "Allahu dhe i Dërguari i Tij e dinë më mirë se kush meriton të mbajë këtë shpatë." Dhe shtoi: "Pasha Allahun, nuk kam parë asnjë luftëtar më të aftë dhe më të guximshëm se Ebu Duzhane." Trimëritë e sahabëve si Mikdad bin Esved, Zubejr bin Avam, Hazreti Ali, Hazreti Omer, Talha bin Ubejdullah dhe Musab bin Umejr (Allahu qoftë i kënaqur me të gjithë ata) ishin si një kështjellë e pakalueshme. I dashuri ynë Pejgamberi alejhi selam duke bërë sulme të njëpasnjëshme luftonte shumë afër armikut. Kur e shihnin Sahabët e nderuar nuk duronin dot ta shihnin atë në rrezik, ndaj rrethoheshin rreth tij, duke mos i lënë hapësirë armikut të ju afronte atij. Në këtë kohë, Abdullah bin Amr ra dëshmori i parë i Uhudit. Kur sahabët e panë atë të bie dëshmor, u hedhën në zemër të armikut për hir të kënaqësisë së Allahut, dhe ata filluan të loftojnë edhe më me vendosmëri.

Tashmë ishte kulmi i betejës, Abdullah bin Xhahi dhe prijësi i shigjetarëve Sa'd bin Ebi Vakkasi kur u takuan vunë re se të dy ishin të plagosur në disa pjesë të trupit. Sa'd bin Ebi Vakkasi transmeton se: "Gjatë një çasti të ashpër të luftës në Uhud, Abdullah bin Xhahi u afrua tek unë, më kapi dorën dhe më tërhoqi pranë një shkëmbi. Ai më tha: 'Lutu tani, që unë të them "Amin". Pastaj do të lutem unë dhe ti thuaj "Amin". Unë u luta: 'O Allah, më dërgo armiq të fuqishëm dhe të ashpër që të luftoj me ta. T'i mund dhe të kthehem si fitimtar.' Abdullahu tha me gjithë zemër: 'Amin.' Pastaj ai filloi të lutej vetë: **'O Allah, më dërgo armiq të fuqishëm dhe të**

[1889]Ahmed bin Hanbel, Musned, III, 123; İbni Hishâm, Sîret, II, 66; Vâkıdî, Megâdhî, I, 259; İbni Ebî SHeybe, Musannef, VII, 562, VIII, 491; Taberânî, Mu'cemu'l Kebîr, XIX, 9.
[190] İbni Hishâm, Sîret, II, 68; Suheylî, Ravd-ul-unf, V, 456; İbni Kesîr, Sîre, III, 33.

ashpër që të luftoj me ta. Më mundëso të përmbush të drejtën e xhihadit duke i vrarë të gjithë. Por në fund, bëje njërin prej tyre të më vrasë mua. Pastaj le të më presë buzët, hundën dhe veshët. Dhe unë të vij para Teje i mbuluar në gjak. Kur Ti të më pyesësh: " o Abdullah, çfarë bëre me buzët, hundën dhe veshët e tua?", unë të them: "O Allah, me to kam bërë shumë gabime dhe nuk i kam përdorur siç duhet. U turpërova t'i sjell para Teje, ndaj u përbaltën në pluhurin e kësaj lufte ku ishte i Dërguari Yt.'

Për një lutje të tillë zemra ime nuk dëshironte të thoshte 'Amin' por për shkak të kërkesës së tij dhe premtimit tim, e thashë 'Amin' me dëshirë të pakët." Pas kësaj, ne nxorëm shpatat dhe vazhduam luftën. Të dy vrisnim çdo armik që na dilte përpara. Ai sulmonte me një guxim të paparë, duke shkatërruar radhët e armikut dhe sulmonte herë pas here me një dëshirë të pashuar për të rënë dëshmor. Ndërsa luftonte, duke thirrur: **"Allahu Ekber! Allahu Ekber!"**, shpata e tij u thye. Në atë moment, i dashuri Pejgamber i dha një degë hurme dhe i urdhëroi të vazhdonte luftën. Me një mrekulli, kjo degë u shndërrua në shpatë, dhe ai vazhdoi të luftonte me të, duke vrarë shumë armiq. Në fund të betejës, me shigjetat e hedhura nga një idhujtar me emrin Ebu'l-Hakem, ai arriti të bëhej dëshmor. Pas rënies së tij, mohuesit i sulmuan trupin, duke i prerë hundën, buzët dhe veshët, dhe e lanë të mbuluar me gjak.

Ndërkohë, një tjetër sahab, Kazmani, i cili e thyeu mbajtësen e shpatës dhe thirri: **"Të vdesësh është shumë më mirë se të ikësh!"** dhe u hodh i vetëm në mesin e armikut. Ai tregoi trimëri dhe guxim të jashtëzakonshëm, duke vrarë shtatë ose tetë idhujtarë. Në fund, u plagos dhe ra në tokë. Kur sahabët e nderuar, të mahnitur nga trimëria e tij, e informuan Pejgamberin alejhi selam për të, ai tha: **"Ai është një banor i Xhehenemit."** Kur Katade bin Nu'mani i tha Kazmanit: "O Kazman! Shpresoj që martirizimi yt të jetë i bekuar!", ai u përgjigj: "Unë nuk luftova për fenë, por që kurejshët të mos shkatërronin hurmat e mia." Më pas, ai vrau veten duke shpuar damarët me një shigjetë, dhe kështu u kuptua pse Pejgamberi kishte thënë se ai ishte banor i Xhehenemit.

Që nga fillimi i betejës, i dashuri ynë Pejgamberi alejhi selam, së bashku me sahabët e tij, luftuan me guxim të jashtëzakonshëm. Ata me sulmet e tyre të fuqishme ja arritën ti sprapsin radhët e ushtrisë idhujtare. Mohuesit, të cilët kërkonin ndihmë nga idhujt e tyre të bërë prej guri e druri, si Lat, Uzza dhe Hubel, u çorientuan dhe filluan të largoheshin nga fusha e betejës. Gratë që kishin ardhur për t'i nxitur, ja nisën qanin me zë të lartë dhe përpiqeshin të ndalonin ushtarët e tyre që po iknin nga fushëbeteja.

Kur kurejshitët, duke lënë pas mallrat që kishin sjellë vete, filluan të braktisin fushën e betejës dhe të largoheshin drejt Mekkës, myslimanët falënderuan Allahun për fitoren që u kishte premtuar. Megjithëse ishin shumë më të paktë në numër dhe forcë, myslimanët kishin arritur një fitore të jashtëzakonshme. Sahabët filluan ti ndjekin nga pas armiqtë dhe vrisnin këdo që kapnin.

I sapo martuari Hanzala bin Ebu Amiri, gjatë kësaj ndjekjeje arriti me kalë deri tek komandanti i ushtrisë kurejshite, Ebu Sufjani. Ai goditi këmbët e kalit të tij, duke e rrëzuar Ebu Sufjanin në tokë. Sap ora në tokë Ebu Sufjani ai thirri: "O kurejshitë! Më ndihmoni! Unë jam Ebu Sufjani! Hanzala po më vret me shpatën e tij!" Të gjithë ata idhujtarë që ishin pranë tij, i kishte kapluar frika dhe ishin të shqetësuar për jetët e tyre ndaj ata nuk i kushtuan vëmendje Ebu sufjanit. Në atë moment një idhujtar i quajtur Shaddad bin Esved, i cili ishte pas Hanzalas, e goditi atë me një

shtizë. Hanzala thirri: **"Allahu Ekber!"**, tentoi të bëjë një lëvizje të fundit, por ra në toke ku ra dhe dëshmor. I dashuri Pejgamber tha: **"Unë e pashë Hanzalan, engjëjt po e lanin midis qiellit dhe tokës me ujë shiu."** Ndërsa Ebu Usejdi transmeton se: "Kur dëgjova këto fjalë të Pejgamberit, shkova pranë trupit të Hanzalas. Nga koka e tij pikonte ujë shiu. Për këtë Hazreti Hanzala u njoh si **'Gasil-ul-Melaike' (Ai që u la nga engjëjt)."**[191]

Duke parë se idhujtarët po iknin, disa nga harkëtarët në kalimin Ajnein menduan se lufta kishte përfunduar dhe i braktisën pozicionet e tyre. Edhe pse komandanti i tyre Abdullah bin Xhubejr u përpoq ti ndalte ata nuk u ndalën, kështu që në kodër mbeti vetëm Abdullah bin Xhubejri së bashku me dymbëdhjetë shokë të tij.[192]

Trimëria e Aliut (Allahu qoftë i kënaqur me të)

Halid bin Velidi, komandanti i njësisë së shigjetarëve kurejshitë, i cili po priste në gatishmëri dhe po përpiqej të shfrytëzonte çdo mundësi, vuri re se numri i muxhahidinëve në kalimin Ajnein ishte pakësuar. Ai së bashku me kalorësinë e tij dhe me Ikrime bin Ebu Xhehilin, u hodhën menjëherë në sulm. Ata arritën në luginën e kodrës Ajnein dhe sulmuan ato pak mysliman që nuk e kishin braktisur kodrën. Sapo e panë Abdullah bin Xhubejri dhe shokët e tij, afrimin e Halidit dhe Ikrimes u rreshtuan dhe filluan të qëllonin me shigjeta kundër armikut. Ata e sulmuan armikun derisa shigjetat në kograt e tyre përfunduan. Kur përballja kaloi në luftë trup më trup. Sahabët, të cilet shfaqën një trimëri të pashembullt, luftonin nën shoqërimin e thirrjeve "Allahu Ekber! Allahu Ekber!" Edhe pse sahabët ishin në një disavantazh numerik të madh, një besimtar përballë njëzet e pesë jobesimtarëve, ata për të përmbushur urdhrin e Profetit a.s. luftuan deri në pikën e fundit të gjakut të tyre. Ata ranë dëshmorë njëri pas tjetrit, ku trupat e tyre të bekuar ranë në tokë ndërsa shpirtrat e tyre fluturuan drejt e në Xhennet (radijallahu anhum).

Idhujtarët nga mllefi e zhveshën Abdullahun nga rrobat dhe trupin e tij të bekuar ja shpuan me shtiza. Ata ja hapën barkun atij dhe ja nxorën organet e brendshme. Pasi Halid bin Velidi dhe Ikrime mposhtën muxhahidët në pritën e kodrës Ajnain ja arritën ta sulmonin nga prapa krahëve ushtrinë islame. Kur panë shokët e Profetit që armiku po shfaqej papritur pas tyre u ndjenë të papërgatitur. Madje shumë prej tyre kishin lënë edhe armët. Kështu që situata ndryshoi në çast. Kurejshitët që po tërhiqeshin përpara, kur panë sulmin e Halidit nga prapa, u kthyen përsëri në luftë. Kështu që muxhahidinët u gjendën mes dy zjarreve. Tashmë armiku duke i vënë ata nën presion të madh sulmonte nga të dyja anët, edhe përpara edhe nga prapa. Tashmë sahabët u thyen dhe lidhja mes sahabëve për një moment u ndërprenë dhe ata u detyruan të shpërndaheshin.[193]

Aliu radijallahu anhu transmeyon se: **"Në atë kohë, hyra në mesin e një njësie armike ku në mesin e tyre ishte edhe Ikrime bin Ebu Xhehili. Ata më rrethuan, por unë i kalova ato duke vrarë shumë prej tyre. Pastaj u hodha në një tjetër njësi armike dhe përsëri neutralizova shumë prej tyre. Meqë e kisha ende jetën** (perderisa isha ende gjallë)**, asgjë nuk më ndodhi. Një moment nuk po e shihja Profetin alejhi selam dhe thash me veten: 'Betohem që ai nuk është prej atyre që e lë fushën e betejës. A mos ndoshta, për shkak të gabimeve tona, Allahu e ka larguar atë nga ne. Ndaj tashmë për mua nuk mbetet asgjë tjetër**

[191] Ibni Hishâm, Sîret, II, 74; Vâkıdî, Megâdhî, I, 273-274; Taberî, Târih, II, 203; Suheylî, Ravd-ul-unf, V, 436.
[192] Ahmed bin Hanbel, Musned, IV, 293; İbni Sa'd, Tabakât, II, 47.
[193] Vâkıdî, Megâdhî, I, 232, 301.

përveçse të luftoj derisa të vdes.' Dhe prej aty ethyeva këllëfin e shpatës dhe sulmova armikun me të gjithë forcën time. Kur i shpërndava ata, pashë që Profeti ndodhej në mesin e tyre. Aty kuptova që Allahu e mbante të mbrojtur me ndihmën e engjëjve të Tij."

"O Allah! Pranoje lutjen e Sa'dit! O Allah, mundësoje që shigjeta e tij të godasë shënjestrën! Vazhdo, Sa'd! Vazhdo! Nëna dhe babai im qofshin të flijuar për ty!"
Hadith

Situata në beteje ishte bërë shumë e rrezikshme. Idhujtarët i kishin rrethuar myslimanët dhe ishin afruar aq shumë, sa që kishin arritur pranë të Dërguarit të Allahut, (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të). I dashuri ynë Profeti alejhi selam qëndronte i palëkundur, ashtu sikur të ishte një mal i lartë i cili rri në këmbë pa lëvizur nga vendi i tij. Ai luftonte nga njëra anë me armikun dhe nga ana tjetër përpiqej t'i mblidhte sahabët që ishin shpërndarë. Ai ju thirrte shabëve: **"Ej, filan! Eja tek unë! Ej, filan! Eja tek unë! Unë jam i Dërguari i Allahut. Ai që vjen drejt meje Allagu ka me i dhënë Xhenetin!"** Ebu Bekri, Omeri, Abdurrahman bin Avf, Talha bin Ubejdiullah, Ali bin Ebi Talib, Zubejr bin Avvam, Ebu Duxhane, Ebu Ubejde bin Xherrah, Sad bin Muadh, Sad bin Ebi Vekas, Habbab bin Munzir, Usejd bin Hudajr, Sehl bin Hanif, Asim bin Sabit dhe Harith bin Sima (Allahu qoftë i kënaqur me ta) u mblodhën dhe u bënë murë mbrojtës rreth Pejgamberit alejhi selam. Në këtë kohë Abbas bin Ubade dëgjohej duke thirrur sahabët e shpërndarë: "O vëllezërit e mi! Kjo fatkeqësi që na ka goditur është pasojë e moszbatimit të urdhrit të Profetit tonë. Mos u shpërndani! Ejani rreth Profetit tonë! Nëse nuk qëndrojmë në mbrojtjen e tij dhe i ndodh diçka të Dërguarit të Allahut, atëherë nuk do të kemi asnjë arsyetim para Zotit tonë."

Abbas bin Ubade së bashku me Harixhe bin Zejdin dhe Evs bin Erkam, u hodhën në mesin e armikut duke thirrur "Allahu Ekber!" dhe filluan të përleshen trimërisht me armiqtë që përpiqeshin të sulmonin të Dërguarin e Allahut. Harixhe bin Zejdi mori nëntëmbëdhjetë plagë, ndërsa dy të tjerët nga plagët që kishin marrë nuk ishin më pak se ai. Të tre arritën gradën e dëshiruar të shehidllëkut. Kështu në këtë moment të rrezikshëm sahabët filluan të mblidheshin rreth Profetit a.s.. Ndërkohë që një grup idhujtarësh u hodh drejt Profetit alejhi selam. Sapo i pa, i Dërguari i Allahut iu drejtua shokëve të tij: **"Kush do t'i ndalë këta?"** Sapo **e** dëgjoi thirrjen e Profetit alejhi selam Vehb bin Kabus tha: "Jeta ime është për ty, o i Dërguari i Allahut! Unë do t'i ndal." Dhe u hodh përpara me shpatë në dorë. Profeti i tha: **"Po të përgëzoj me Xhenet."** Kur pa trimërinë e tij tha: **"O Zot, ki mëshirë për të! Mëshiroje atë!"** Ndërsa Vehbiu u rrethua nga armiku dhe prej goditjeve të tyre ra shehid. Atë moment Sad bin Ebi Vekas u hodh përpara për ta ndihmuar, por kur u kthye tek i Dërguari i Allahut e dëgjoi atë të thotë për Hazreti Vehbin: **"Unë jam i kënaqur me ty. Edhe Allahu qoftë i kënaqur prej teje!"**

Beteja ishte në kulmin e ashpërsisë, idhujtarët i sulmonin myslymanët sikur ujqërit e tërbuar. Një moment Profeti pa se një grup tjetër idhujtarësh u nisën drejt tij dhe sulmonin sahabët që ishin rreth tij. Profeti alejhi selam thirri Aliun dhe i tha: **"O Ali! Hidhu dhe zmbarpsi ata!"** Aliu radijallahu anhu pa një pa dy u vërsul si një luan i vërtetë dhe vrau Amr bin Abdullahun, ndërsa rë tjerët i dëtyroi të zmbarpsen. Por gjatë përleshjes me armikun shpata e Aliut u thye, Profeti duke e orientuar atë mbi një grup tjetër i hodhi atij, Zulfikarin, shpatën e vet dhe i tha: **"O Ali, zmbarpsi edhe këto!"** Luan i Allahut, Hazreti Aliu sërish duke i sprapsur të tjerët luftoi dhe vrau Shejbe bin Malikun. Në atë moment, Cebrail (Xhebraili) a.s. erdhi tek Profeti

dhe i tha; **"O i Dërguari i Allahut! Kjo ishte një trimëri e jashtëzakonshme e Aliut!"**, i Dërguari i Allahut ju përgjigj: **"Ai është nga unë, dhe unë jam nga ai."** Atëherë Xhebraili a.s. shtoi: **"Edhe unë jam nga ju të dy."** Në atë moment, një zë dëgjohej duke thënë: **"S'ka trim si Aliu dhe s'ka shpatë si Dhulfikari."**

Rimobilizimi i sahabëve i bëri idhujtarët të kuptojnë se nuk mund të afroheshin pranë të dashurit të Allahut, ndaj ata filluan të lëshonin shigjeta drejt Pejgamberit alejhi selam. Por, shigjetat ose kalonin mbi kokën e tij, ose binin përpara tij, në të djathtë apo në të majtë. Sahabët për të sprapsur armikun po luftonin me të gjithë forcat që kishin dhe kur panë këtë situatë, u mblodhën rreth Profetit dhe për të ndalur shigjetat që vinin drejt tij ata u bënë mburojë me trupat e tyre. Përballë kësaj situate I Dërguari i Allahut i urdhëroi sahabet që të kundërpërgjigjeshin me shigjeta, ata filluan t'i lëshonin shigjetat drejt armikut. Sa'd bin Ebi Vekasi ishte një mjeshtër i shquar në hark, filloi të lëshonte shigjeta njëra pas tjetrës drejt armikut. Sa herë që nxirrte një shigjetë nga çanta, ai lutej: "**O Zoti im! Kjo është shigjeta Jote. Godite armikun me të!"** Nga pas Profeti a.s. lutej: **"O Allah! Pranoje lutjen e Sa'dit! O Allah, mundësoje që shigjeta e tij të godasë shënjestrën! Vazhdo, Sa'd! Vazhdo! Nëna dhe babai im qofshin të flijuar për ty!"** Sadit vazhdonte të hidhte shigjeta mbi ushtrinë idhujtare pa u ndalur. Por në fund kur Sadit i mbaruan dhe që Sadi të vazhdonte të gjuante Profeti i dha shigjetat e tij. Çdo shigjetë e tij godiste ose një idhujtarë ose godiste kafshën që ngiste idhujtari.

Beteja vazhdonte të ruante ashpërsine, tashmë më shumë së dy luftimi ishin shigjetat ata që po përlesheshin me njëra tjetrën. Shigjetave që lëshonte armiku drejt të Dërguarit të Allahut, ju doli përpara Ebu Talha, i cili duke përdorur trupin dhe mburojën e tij për të ndalur çdo shigjetë që mund të godiste Profetin alejhi selam. Herë pas here, ai lëshonte britma që trondisnin armikun. I Dërguari i Allahut tha: **"Zëri i Ebu Talhas në ushtri është më i dobishëm se ai i njëqind burrave."** Ebu Talha sa herë që gjente mundësinë me shpejtësi dhe me saktësi të madhe gjuante shigjeta drejt armikut. Kur i Dërguari i Allahut ngrinte kokën për të parë gjuajtjet Ebu Talha i tha: **"Nëna dhe babai im qofshin të flijuar për ty, o i Dërguari i Allahut! Mos e ngrini kokën se mos ndoshta ju godet ndonjë shigjetë e armikut! Trupi im është mburoja për trupin tuaj të bekuar! Unë sa të jem gjallë, pa më therur mua, kurrë nuk do ti lejoj idhujtarët t'ju afrohen ju!"**

Në Uhud nga të gjitha anët lufta vazhdonte me një egërsi dhe ashpërsi ta madhe. Nga radhët e ahabëve, për të mbrojtur besimin kundër mosbesimit luftonin, disa luftonin mbi kuaj ndërsa disa të tjerë luftonin në këmbë, por sahabët ende nuk ishin organizuar plotësisht. Vetëm rreth të Dërguarit të Allahut ishin mbledhur rreth tridhjetë sahabë, të cilët binin dëshmore dhe shpritërat e tyre fluturonin në xhennet sikur flutura. Aty dukej ajo panorama e qartë se sahabet ishin bërë mburojë për të mbrojtur të Dërguarin e Allahut trupat e tyre i kishin vëne nën shënjestër të shigjetave, shtizave dhe shpatave që idhujtarët lëshonin nga të gjitha anët. Qëllimi i tyre i vetëm ishte të zbatonin urdhrat e Profetit a.s. dhe të largonin çdo dëm që mund t'i ndodhte atij.

Hamzai ishte komandanti dhe trimi i trimave, (radijallahu anhu), gjatë kaosit luftarak që ishte ndertuar ne fushëbeteje ishte ndarë nga i Dërguari i Allahut dhe ndodhej mes një turme idhujtare. Ai me dy shpata në duar luftonte me gjithë guximin e tij dhe sa herë luante shpatat thirrte: **"Allahu Ekber!"** Por sa herë që

Hamzai thirrte **''Allahu Ekber''** në zemrat e armiqve mbillej një frikë dhe tmerr i pashpjeguar. Hamzai nuk ndalej, ai vazhdonte ti çante turmat idhujtare duke rrëzuar kedo që i dilte perpara. Ndërsa ai shpërndante grupin e armikut përreth tij, një idhujtar i quajtur i doli përpara dhe thirri: "A ka ndonjë trim që të përballet me mua?" "Eja tek unë, o biri i gruas synetçare! A mos vallë mendon se po i sfidon Allahun dhe të Dërguarin e Tij?" iu përgjigj Hamzai radijallahu anhu. Më pas me një lëvizje të shpejtë ai e rrëzoi në tokë dhe duke e zënë nga këmbët dhe ia ndau kokën nga trupi Sibâ' bin Ummu Enmârin.[194] Kur ktheu kokën mbrapa Hamzai r.a. vuri re që pas një shkëmbi që ndodhej aty pranë tij, qëndronte një njeri i quajtur Vahshi (që ende nuk ishte bërë mysliman) i cili po e qëllonte me mprehësinë e një shtize. Atëherë Hamzai ju drejtua dhe filloi të ecte drejt tij, por kur mbërriti në një gropë të krijuar nga ujërat, rrëshqiti dhe ra mmbi shpinë. Në atë moment, mburoja luftarake e tij u hap dhe i doli nga trupi. Atë moment Vahshi, cili gjatë gjithë betejës gjuante Hamzain, gjeti rastin dhe e hodhi shtizën me forcë drejt tij. Shtiza e shpoi trupin e bekuar të Hamzës dhe i doli në anën tjetër të trupit. Ky ishte momenti që Hamzai ra dëshmoërë ku fjalët e fundit të tij ishin **"O Allah''!** Hamzai radijallahu anhu ishte një ndër trimat të cilët sakrifikonin jetën në rrugën e Allahut dhe për të mbrojtur të Dërguarin e Tij (paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të).

Ndërkohë përplasja ndërmjet dy ushtrive vazhdonte të ruante ashpërsinë, në Uhud era, pluhuri dhe ajri ishin përzier me aromën e gjakut. Nga njëra anë ishin idhujtarët që luftonin për hiç gjë ndërsa nga ana tjetër ishte I Dërguari i Allahut me shokët e tij të bekuar të cilët luftonin për të përhapur Dritën e Allahut suphanehu ëe teala. Idhujtarët për ta ndalur përhapjen e Dritës së Allahatu nga urrejtja, idhujtaria dhe inati vazhdonin të këmbëngulnin në të keqen e tyre. Por gjithsesi Drita e Allahut nuk pengohet, as nuk ndalet, madje as nuk mbulohet. Të veteditur dhe të bindur në këtë vërtetësi sahabët edhe pse kishin mbetur në mes dy ushtrive dhe në mes dy sulmeve idhujtare vazhdonin të sakrifikonin jetët e tyre. Sepse ata e dinin që fundi i tyre nuk është varri i errët, as gropat e xhehennemit por fundi i tyre ishte kënaqsia e Allahut, dashuria e Pejgamberit dhe parajsat e xhennetit. Ndërkohë që situata në Uhud vazhdonte të ishte e tillë u dëgjuan një zë idhujtari i cili thërristë **"O Kurejshitë! Mos hezitoni të luftoni kundër Muhammedit, i cili na ka prishur lidhjet familjare dhe ka përçarë popullin tuaj. Dijeni se nëse Muhammedi sot shpëton dhe del i gjallë nga kjo betejë, unë nuk dua të jetoj më!"** Kjo ishte thtirje vinte prej, i cili nuk dinte se çfar po thirrte. Po thoshte se Muhammedi alejhi selam ka prishur familjen, ndërkohë që Muhammedi alejhi selam luftonte për të ndërtuar një familje, një popull dhe një ummet të ndritur dhe të bekuar nga Krijuesi i Gjithësisë Allahu suphanehu ve Teâla.

Ebû Duxhâne, i cili dëgjoi thirrjen e idhujtarit Âsım bin Ebî Avfit, u betua se nuk do tu ndalte pa e gjetur dhe pa e vrarë atë. Ai u vërsul në turmat idhujtare duke i përçarë e coptuar ata deri sa e gjeti Âsım bin Ebî Avf dhe e vrau aty në mes fushës së betejës. Por një idhujtar tjetër i quajtur Ma'bed, i cili ndodhej pas tij e sulmoi me tërë forcën e tij. Më të vënë re Ebû Duxhâne me bekimin e Allahut bëri një lëvizje të shpejtë dhe ja arriti të shmangë sulmin vdekjeprurës. Pasi e shmangu sulmin e tij Ebu duxhane u ngrit dhe e goditi Mabedin duke e lënë të vdekur aty në vënd.

Qëllimi i vetëm i kurejshëve në betejën e Uhudit ishte ekzegutimi i Të Dërguarit të Allahut. Ata me të gjitha forcat përpiqeshin ti mposhtnin sahabët dhe të shkonin

[194] Buhârî, Megâdhi, 23; Ahmed bin Hanbel, Musned, III, 501; İbni Sa'd, Tabakât, III, 164; Taberî, Târih, II, 516.

drejt tij, por nuk mund të kalonin përtej sahabëve të lavdishëm që ishin si mburoja hekuri rreth tij. Tridhjetë trima (sahbë) të guximshëm thërrisnin: "O i Dërguari i Allahut! Ne nuk do të largohemi kurrë prej teje. Fytyrat tona janë mburojë për fytyrën tënde të bekuar, dhe trupat tanë janë të flijuar për ty. Për ne mjafton që ti të jesh i sigurt dhe të mos godasë asnjë mize (shigjetë apo shpatë) e armikut!" Ndërsa idhujtarët vazhdonin të sulmonin në grupe njëri pas tjetrit, i Dërguari i Allahut, ju kthye sahabëve dhe duke treguar njërin nga grupet tha: "Kush do të sakrifikojë trupin e tij për ne në rrugën e Allahut?" Ende pa përfunduar fjalën I Dërguari i Allahut pesë sahabë nga Medina menjëherë u hodhën përpara. Këta trima luftuan rreth të Dërguarit të Allahut duke thirrur tekbir dhe u përleshën deri në fund. Katër prej tyre ranë dëshmorë menjëherë, ndërsa i pesti, i Umâre bin Jezîdi, i cili kishte marrë plot 14 plag në trup, i plagosur rëndë ra në tokë. Kur e pa i Dërguari i Allahut ju tha të tjerëve: **"Afrojeni atë pranë meje."** Ai e vendosi kokën e tij të plagosur mbi këmbët e tij të bekuara. Dhe kështu në këtë gjendje Umâre r.a. duke u larguar nga kjo botë fitoi nderin e dëshmorëve.

Trimëria e Talha bin Ubejdiullahit

"Talha dhe Zubejri janë fqinjët e mi në Xhenet."
Hadith

Përleshjet ndërmjet idhujtarëve dhe myslimanëve prej orësh vazhdonin. Myslimanët edhe nga para edhe nga pas kishin mbetur nën sulmet e idhujtarëve. Idhujtarët i kishin thyer sahabët aq shumë sa që iu afruan shumë të Dërguarit të Allahut (paqja qoftë mbi të). I Dërguari i Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të) nga njëra anë luftontë me ata që e sulmonin nga afër dhe nga ana tjetër përpiqej të motivonte sahabët ku ju thoshte: **"Kush do t'i ndalojë këta?"** Talha bin Ubejdiullahu i cili ndodhej aty pranë**"Unë do ti ndal ata, o i Dërguari i Allahut!"** ju përgjigj dhe u nis të hidhet përpara në sulm. Por, i Dërguari i Allahut tha: **"A ka ndonjë tjetër si ti?"** Atëherë, një sahabi nga Medina tha: **"O i Dërguari i Allahut, unë do ta bëj këtë!"** Me lejen e tij, sahabiu u hodh përpara dhe sulmoi idhujtarët. Ai tregoi guxim të pashoq dhe, pasi vrau disa prej tyre, prej goditjeve që mori edhe vetë ra dëshmor. Kur pa i Dërguari i Allahut që dhe ai ra dëshmorë tha: **"Kush do t'i përballojë këta?"**Talha doli përsëri përpara, por i Dërguari i Allahut e pyeti përsëri: **"A ka ndonjë tjetër si ti?"** Një tjetër sahabi nga Ensarët tha: **"Unë do ti dal ballë, o i Dërguari i Allahut!"** Me lejen e tij, edhe ky sahabi luftoi deri në momentin kur ra dëshmor.[195]

Kështu të gjithë sahabët që ishin pranë të Dërguarit të Allahut, duke luftuar për të mbrojtur atë u flijonin njëri pas tjetrit. Më në fund pranë të Dërguarit të Allahut mbeti vetëm Talha bin Ubejdiullahi**. Talha, i shqetësuar se mos i ndodhte diçka të Dërguarit të Allahut, luftonte me gjithë shpirt. Ai vraponte në çdo drejtim, përballej me armiqtë me gjithë forcën e tij, duke e bërë trupin mburojë kundër shigjetave, heshtave dhe goditjeve të shpatave. Lufta dhe sakrifica e tij ishin të papara. Ai luftonte si një pervanë rreth dritës së dashurisë për Profetin. Njëkohësisht Talha ishte plagosur në të gjithë trupin. Atij nuk i kishte mbetur asnjë vend pa ju dëmtuar, madje edhe rrobat e tij ishin të mbuluara tërësisht me gjak. Megjithatë, ai nuk ndalonte së mbrojturi të Dërguarin e Allahut. Në fund, nga humbja e madhe e gjakut, Talha ra përtokë pa ndjenja. Trupi i tij ishte i mbushur me plot 66 plagë të mëdha ndërsa plagët e vogla ishin të panumërta.** I Dërguari i Allahut i urdhëroi Ebu Bekrin që të ndihmonte Talhanë. Ebu Bekri i hodhi ujë në fytyrë derisa ai erdhi në vete. Sapo u zgjua, Talha pyeti: **"O**

[195] SHemseddin SHâmî, Subulu'l-Hudâ, IV, 203.

"Nëse Dëshiron të shohë dikush një njeri nga banorët e Xhenetit që ecën mbi tokë? Le të shikojë Talha bin Ubejdullahun."
Hadith

Ebu Bekr, a është mirë Resulullahu?" Kjo ishte gjëndja e sahabëve që edhe në pikën e fundit të jetës së tyrë tregoin dashurinë dhe besnikërinë e tyre ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Allahut. Ndërsa Ebu Bekri i tha: **"I Dërguari i Allahut është mirë. Ai më dërgoi te ti."** Talha, i qetësuar, tha: **"Falënderimet i qofshin Allahut! Për aq kohë sa ai është mirë, çdo plagë e imja është e pavlerë."** Atë kohë u dukën disa sahabë të tjerë që ju bashkuan të Dërguarit të Allahut dhe ndihmuan Talhanë.

I nderuari i universit Muhamedi Mustafai (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të), iu afrua Talha bin Ubejdiullahut dhe kur e pak y i fundit se i Dërguarin e Allahut të gjallë, shpërtheu në lot nga gëzimi. Profeti i bekuar fërkoi trupin e tij dhe pastaj ngriti duart duke bërë këtë lutje: **"O Allah! Jepi shërim dhe fuqi!"** Pas kësaj lutjeje të Resulullahut, ndodhi një mrekulli: Talha sikur u shërua plotësisht, u ngrit në këmbë dhe vazhdoi të luftonte kundër armikut mu ashti sikur të mos kishte fare plagë në trup. Më vonë Profeti ynë i dashur tha për të: **"Për një moment në ditën e Uhudit, pashë se pranë meje përveç Xhibrilit në të djathtën time dhe Talha bin Ubejdiullahut në të majtën, nuk kishte askënd tjetër."**[196] Ai gjithashtu tha: **"Kush dëshiron të shikojë një njeri të Xhenetit që ecën mbi tokë, le të shohë Talha bin Ubejdiullahun."**

Në betejë, lufta vazhdonte me një intensitet të madh. Rreth Profetit ishin disa sahabë besnikë si Ebu Duxhane, mbajtësi i flamurit Musab bin Umejr, Talha bin Ubejdiullahu dhe Nesibe Hatuni, e cila kishte ardhur nga radhët e pasme për të mbrojtur të Dërguarin. Një idhujtar i ashpër dhe i armatosur rëndë, Abdullah bin Hunejdi kur pa Profetin bërtiti me një arrogancë: "Unë jam biri i Zuherit! Më tregoni Muhamedin! Ose do ta vras atë, ose do të vdes unë pranë tij!" Dh duke goditur kalin u nis drejt Profetit, Ebu Duxhane i doli përballë dhe i tha: "Eja nëse je burrë! Përball teje jam unë që trupin e Muhamedit a.s. e mbroj me trupin tim.'' Dha pas këtyre fjalëve Ebu Duxhane u vërsul mbi armikun duke i thenë atij ''Eja o idhujtar! Eja! Pa më mbytur mua, kurrë nuk do të mundësh t'i afrohesh Muhammedit alejhi selao!" dhe sapo u bërball me armikun Ebu Duxhane i dha atij një goditje të fuqishme i cili u rrëzua në toke dhe mbeti i vrarë në vënd. Profeti alejhi selam i cili ndiqte gjithë këtë skenë tha; **"O Allah! Siç jam i kënaqur me birin e Harëshës (Ebu Duxhanen), bëhu edhe Ti i kënaqur me të!"**

Një ndër idhujtarët që përpiqej të godiste Profetin a.s. ishte dhe Malik bin Zuhuri. Ky ishte një harkëtar i aftë dhe vazhdimisht përpiqej të godiste Profetin alejhi selam meu shigjetë. Kur ai mendoj se gjeti hapsiren e duhur lëshoi një shigjetë duke synuar kokën e Profetit a.s. por Talha bin Ubejdiullahu i doli përpara dhe e ndali shigjetën, e cila ja dëmtoi rëndë dorën e tij. Shigjeta i shkatërroi nervat dhe kockat e dores ndaj ai po ndjente dhimbje të mëdha. Profeti, i shqetësuar nga kjo skenë, tha**: "Nëse, në momentin kur e ndale shigjetën, do të kishe thënë 'Bismil-lahir-rahmanir-rahim', engjëjt do të të kishin ngritur në qiell përpara syve të njerëzve."**[197]

Në betejën Uhudit katër egërsira idhujtare ishin betuar se do të vrisnin Profetin alejhi selam. Ata ishin Abdullah bin Kamia, Ubaj bin Halefi, Utbe bin Ebi Vakasi dhe Abdullah bin Shehabi Zuheri. Të katër keto idhujtarë në një mënyrë tinzare ndiqnin Profetin dhe prisnin të gjenin ndonjë hapsirë për të kryer aktin betues të tyre.

[196] Hâkim, Mustedrek, III, 426; Heysemî, Mecma'udh-dhevâid, IX, 52; Suheylî, Ravd-ul-unf, VI, 9.
[197] Vâkıdî, Megâdhî, I, 254; İbni Sa'd, Tabakât, III, 217; Beyhekî, Sunen, II, 220; Hâkim, Mustedrek, III, 416.

Ndërsa disa sahabë të mbetur pranë Profetit alejhi selam u hodhën në sulm dhe po luftonin me gjithë forcën e tyre, vetëm Musab bin Umejri si mbajtës i flamurit kishte mbetur pranë Profetit a.s.. Mirëpo për shkak të trupit dhe pamjes së tij, ai ngjante shumë me Profetin a.s.. Dhe ai duke mbajtur flamurin në njërën dorë, ndërsa me dorën tjetër duke treguar një trimëri të madhe u përballte me armikun. Njëri nga armiqtë, Ibn Kamia, i veshur me mburojë hekuri ju afrua dhe tha me një zë të lartë filloi të thërrasë: "Më tregoni Muhamedin! Nëse ai sot shpëton i gjallë, atëherë unë nuk dua të jetoj më!" dhe u hodh në sulm për të goditur Profetin aljehi selam. Por Musabi dhe Nesibe Hatuni duke përdorur trupat e tyre si mburojë ia dolën ta mbrojnë Profetin alejhi selam. Ibn Kamia e sulmoi Musabin duke i prerë këtij të fundit dorën e djathtë, por Musabi nuk u rrëzua, edhe pse plağa e dorës i shkaktonte dhimbje ai me dorën e majtë edhe mbante flamurin edhe ashtu i plagosur vazhdoi të luftonte. Ai recitoi një pjesë nga Kur'ani: **"Muhamedi është vetëm një i Dërguar. Para tij kanë kaluar shumë të Dërguar..."**[198] (Sureja Ali Imran: 144). Gjatë luftimit atij edhe dora e majtë ju pre por ai e mbajti flamurin me krahë dhe e mbështeti tek trupi. Por nga pamundësia për tu vëtëmbrojtur idhujtari Ibn Kamia e goditi Musabin për vdekje me një shtizë të vetme. Kështu ra dëshmor Musab bin Umejri. Tashmë edhe Musabi ra dëshmorë por flamuri i shenjtë i Islamit nuk u rrëzua. Atë e kapi menjëherë një melek që mori formën e Musabit. Kjo ishte arsyeja që Profeti ynë i dashur (paqja dhe bekimet e Zotit qofshin mbi të) tha: **"Përpara, o Mus'ab! Përpara!"**, por meleku ia ktheu: "Unë nuk jam Musabi." Atëherë I Dashuri i Universit e kuptoi se ishte një melek dhe flamurin ia dorëzoi Aliut radijallahu anhu.[199]

Idhıjtari Ibn Kamia duke vrarë Musab bin Umejrin mendoi se kishte vrarë Profetin, ndaj ai me një nxitim të madh shkoi tek radhët e idhujtarëve dhe filloi të bërtiste: "E vrava Muhamedin! E vrava Muhamedin!" Kur dëgjuan idhujtarët këtë, duke menduar se kishin arritur qëllimin e tyre, u egërsuan edhe më shumë. Nga ana tjetër, shokët e Profetit, që nuk e dinin të vërtetën, mbetën të tronditur dhe i kaploi një atmosferë zie. Atë moment Omeri dhe disa sahabë të tjerë ranë të dëshpëruar dhe u ulën në vënd. Enes bin Nadri i pa ata ashtu, i pyeti: "Pse jeni ulur kështu?" Ata iu përgjigjën: "Profeti është vrarë!" Atëherë Enesi tha: **"Nëse Profeti është vrarë, Zoti i tij (Allahu) është I Gjallë dhe I Pavdekshëm! Çfarë kuptimi ka jeta për ne pas tij? Ngrihuni dhe le ta japim jetën për kauzën për të cilën ai luftoi dhe sakrifikoi jetën e tij!"** Më pas ai theu këllëfin e shpatës dhe, duke thirrur "Allahu Ekber!", u hodh në mes të armikut duke luftuar dhe mposhtur këdo armik që i dilte përpara. Enesi radijallahu anhu vazhdoi të përleshej me armiqtë derisa ra dëshmor. Trupi i Enesit kishte më shumë se shtatëdhjetë plagë dhe ishte aq i dëmtuar sa vetëm motrës së tij askush tjetër nuk mundi ta njohë.

Pas përhapjes së lajmit që është vrarë Muhammedi (alejhi selam) idhujtarët ishin tërbuar prej gëzimit dhe rinisën sulmet ndaj myslimanëvë sikur bishat e egëra që nuk kanë pikën e mëshirës ndaj gjahut të tyre. Faktikisht idhujtaria nuk është gjë tjetër vetëm se një egërsirë njërëzore që nuk e gjen askund tjetër vetëm se tek njeriu. Përballë kësaj gjëndje pas lajmit për vrasjen e Profetit alejhi selam shumë shokë të Profetit ishin shpërndarë ose kishin rënë dëshmorë. Çorjentimi dhe çmotivimi i shokëve të Profetit kishte arritur gjer aty sa që disa prej tyre nuk donin më të jetonin prej dëshprimit të humbjes së të dashurit të zemravë. Ndërkohë

[198] Âl-i İmrân: 3/144.
[199] İbni Hishâm, Sîret, II, 73; Vâkıdî, Megâdhî, I, 300; İbni Sa'd, Tabakât, II, 42; Bey hekî, Delâil-un-nubuvve, III, 255; Suheylî, Ravdu'l-unf, III, 258; İbni Kesîr, Sire, III, 39.

"Talha, në momentin që ndihmoi të Dërguarin e Allahut, e fitoi Xhenetin."
Hadith

që i dashuri i zemrave Muhammed Mustafai alejhi salatu ve selam ishte ende gjallë, ai po përballej me armiqte që e kishin rrethuar. Pranë tij ndodheshin vetëm dy apo tre shokë te tij. Por përshkak të rrethimit të idhujtarëve ai nuk dallohej nga larg. Idhujtarët ngaqë nuk po i mposhtnin shokët e Pejgamberit alejhi selam nisën ti godasin me gure. Ku një gur i hedhur nga Utbe bin Ebi Vakkasi goditi fytyrën e bekuar të Profetit alejhi selam. Guri e goditi Pejgamberin alejhi selam në fytyrë pikërisht në buzën e poshtme dhe i kishte thyer dhëmbin e djathtë të përparmë. Pastaj, Ibn Kamia goditi kokën e Profetit me një shpatë, duke i dëmtuar helmetën. Dy pjesë të metalit u ngulën në fytyrën e tij të shenjtë. Në fund, ai ra në një gropë të thellë të hapur nga Ebu Amiri për të penguar muslimanët.

Aty Profeti ynë i dashur u lut: **"O Allah, poshtëroje dhe shkatërroje këtë njeri!"** kur pa Ibn Kamia që Muhammedi alejhi selam ra në gropë ai duke menduar se e kishte vrarë atë i mbushur me gëzim të rremë, bërtiti: "E vrava Muhamedin!" dhe vrapoi tek Ebu Sufjani. Ndërkohë që Profeti ynë i bekuar, i cili ishte plagosur dhe fytyra e tij ishte përgjakur, fërkoi duart në fytyrë dhe pa që edhe mjekra e tij ishte mbuluar me gjak. Para se të binte një pikë në tokë, Xhibrili (alejhi selam) mbërriti dhe e kapi gjakun, duke thënë: **"O i Dashuri i Allahut! Për hir të Allahut, nëse një pikë e këtij gjaku do të binte në tokë, asnjë bimë nuk do të rritej më kurrë deri në Ditën e Gjykimit."** Profeti ynë i dashur i tha Xhibrilit: **"Nëse një pikë gjaku nga unë bie në tokë, nga qielli do të zbresë ndëshkimi. O Zot, fale popullin tim, sepse ata nuk dinë çfarë po bëjnë."**

Ndërkohë që idhujtarët gëzonin ndërsa shabët e nderuar ishin pikëlluar u dëgjua Kab bin Maliku, i cili e pa Profetin alejhi selam që po përpiqej të dilte nga gropa, bërtiti me zë të lartë: "O muslimanë, Përgëzimë! Përgëzimë! Profeti është gjallë! Shikoni! Ja ku është Profeti ynë I dashur!" Sahabët tashmë jo nga hidhrimi por nga gëzimi u gritën plot huti dhe sikur të mos ju kishte ndodhur asgjë në betëjë u gjallëruan dhe nxituan drejt tij. Të parët që arritën pranë Profetit alejhi selam ishin Aliu dhe Talha bin Ubejdiullahu, të cilët e nxorën Profetin nga gropa. Ndërsa Ebu Ubejda bin Xherrah ja hoqi pjesët e helmetës që i ishte ngulur në fytyrë Profetit alejhi selam. Ndërsa Malik bin Sinan prej gëzimit dhe shimbshërisë e lëpiu gjakun nga fytyra e bekuar e Profetit. Vallë ky ishte dhe shkaku që Profeti alejhi selam tha tha: **"Kushdo që ka gjakun tim të përzier me të vetin, nuk do të prekët nga zjarri i Xhehenemit."**

Kështu Myslimanët, të mbushur me gëzim që e panë Profetin të sigurt, formuan një rreth mbrojtës rreth tij dhe nuk lanë asnjë idhujtar të afrohej. Ndërkohë idhujtarët duke parë se nuk mund të bënin më asgjë, u tërhoqën në një kodër të afërt. Atëherë, Profeti ynë i dashur urdhëroi Sad bin Ebi Vakkasin: **"Ndaloji ata!"** Sadi i tha: "O i Dërguari i Allahut! Kam vetëm një shigjetë. Si mund t'i ndaloj?" Por kur Profeti e urdhëroi sërish. Sadi hodhi e shigjetën e tij, ajo vrau një idhujtar dhe më pas iu kthye në dorë si me mrekulli. Kjo ndodhi disa herë, derisa Kurejshët që ishin aty në kodër u tërhoqën plotësisht.

Nga ana tjetër idhujtarët sikur Ubej bin Halefi e ngasëte kalin e tij drejt Profetit tonë të dashur dhe bërtiste: "Ku është ai që pretendon se është Profet? Le të dalë përballë meje e të luftojë!" Sahabët e nderuar deshën ta ndalonin, por Profeti ynë nuk ua lejoi. Ai mori shtizën e Harith bin Simmes dhe doli përpara. Ubey, duke e shtyrë kalin përpara, bërtiti: "O Muhamed! Nëse ti shpëton sot, unë të dëshiroj të mos

"O Hamza! Asnjë njeri nuk ka përjetuar një vuajtje të tillë si ti. O xhaxhai i Profetit të Allahut! O Luani i Allahut dhe i të Dërguarit të Tij! Allahu të mëshiroftë!"
Hadith

shpëtoj!" Ubey ishte i mbuluar nga koka deri te këmbët me parzmore (mburojë hekuri). Profeti ynë i dashur shtizën që kishte në dorë e hodhi drejt tij. Ajo kaloi midis helmetës dhe jakës së parzmoreve, duke u ngulur në qafën e Ubeyt. Ai ra nga kali, duke bërtitur si një ka dhe duke u përplasur përtokë kockat e brinjëve iu thyen. Idhujtarët e ngritën dhe e larguan prej aty. Gjatë rrugës kur po e largonin Ubey derisa dha shpirt bërtiste: "Muhamedi më vrau!..." Ndërsa Profeti ynë i dashur së bashkë me shokët e tij, filloi të ngjitej drejt shkëmbinjve të Uhudit. Kur arritën pranë tyre, Profeti deshi të ngjitej më lart, por nga lodhja e madhe dhe për shkak të dy parzmoreve që mbante, si dhe më shumë se shtatëdhjetë goditjeve që kishte marrë, nuk pati më fuqi të ngjitej. Ishte Talha ai që e mori Profetin mbi shpinën e tij dhe e ndihmoi të ngjitej mbi shkëmbinjtë e Uhudir. Atëherë Profeti ynë tha: **"Talha, në momentin që ndihmoi të Dërguarin e Allahut, e fitoi Xhenetin."** Gjatë kësaj kohe në këmbët e malit sahabët që ishin mbrapa po luftonin me guxim të jashtëzakonshëm kundër idhujtarëve. Ata po ndëshkonin çdo idhujtar që kishte ngritur dorë kundër Profetit të dashur. Profeti dhe sahabët ishin aq të lodhur dhe aq të raskapitur sa që për shkak të lodhjes së madhe ata namazin e drekës e falën ulur. Pas namazit Hatib bin Beltea erdhi pranë Profetit dhe e pyeti: "O i Dërguar i Allahut! Jeta ime qoftë flijuar për ty. Kush ta bëri këtë?" Profeti tha: **"Utbe bin Ebi Vakkasi më qëlloi me një gur, duke më plagosur në fytyrë dhe duke më thyer dhëmbin e përparmë."** Hatibi pyeti përsëri: "O i Dërguari i Allahut! Nga cila anë iku ai?" Profeti i tregoi drejtimin me dorë. Atëherë Hatibi u nis me shpejtësi në atë drejtim. Pasi kërkoi, më në fund e gjeti Utben. E rrëzoi nga kali dhe me një goditje ia preu kokën. Pastaj shkoi pranë Profetit dhe dha lajmin e mirë. Atëherë Profeti tha: **"Allahu qoftë i kënaqur me ty. Allahu qoftë i kënaqur me ty,"** duke u lutur për të. Beteja e Uhudit ishte aq e mundimshme, aq e lodhshme dhe aq e ashpaër sa që edhe idhujtarët edhe myslimanët nuk kishin më as fuqi, as energji dhe as durim për të vazhduar. Idhujtarët kur panë që nuk i mposhtnin dot më myslimanët ishin ndarë dhe të dobësuar aq shumë sa që nuk po i bënin dot më ballë sulmeve që i vinin nga sahabet, të cilët ishin rigrupuar dhe kishin filluar një sulm të ri.[200] Ndaj idhujtarët nuk duke lanë mbi tridhjetë të vdekur dhe qindra të plogosur në fushën e betejës, u tërhoqën dhe nisën rrugën për në Mekke. Në Medina ishte përhapur lajmi i rremë se në Uhud është vrarë Profeti Muhammed (paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të). Fatimja (r.a.), Aisheja (r.a.), Ummu Sulejm, Ummu Ejmen, Hamne binti Jahsh dhe Kuaibe ishin ndër gratë që nxituan drejt Uhudit. Kur Fatimja pa të atin të plagosur filloi të qajë. Ndërkohë që Profeti alejhi selam e ngushëllonte Aliu r.a. i solli ujë me mburojën e tij, dhe Fatimja lau fytyrën e bekuar të Profetit nga gjaku. Megjithatë, gjaku nuk ndalonte. Fatimja për ti ndaluar gjakderdhjen dogji një copë hasër dhe i vuri hirin mbi plagë.[201] Pasi u mësua se Profeti a.s. ishte gjallë dhe i mjekuan plagët atij gratë umbërritën në fushën e betejës dhe u kujdesën për të plagosurit dhe i mbështollën plagët atyre që kishin mbetur në fushëbetejë. Kur arritën në fushë betejë vunë re se nga trajtimi mizor i idhujtarëve trupat e disa dëshmorëve ishin bërë të panjohura. Pas tërheqjes së Profetit dhe sahabëve në malin e Uhudit, idhujtarët ishin kthyer në fushbetejë dhe nga urrejtja dhe mizoria disave prej myslimanëve, dëshmorë ju kishin prere duart, veshet, hundët dhe gjymtyrët. Ndër ta ishte dhe Abdullah bin Jahshi. Kjo pamje tronditëse i preku zemrat e Profetit dhe shokëve të tij. Profeti, me lot në sy, tha: **"Unë do të dëshmoj në Ditën e Kiametit për këta**

[200] İbni Hishâm, Sîret, II, 79; Suheylî, Ravd-ul-unf, III, 263; İbni Kesîr, Sire, III, 45.
[201] İbni Mâce, Tıb, 15; Vâkıdî, Megâdhî, I, 250; Beyhekî, Sunen, II, 80; Taberânî, Mu'cemu'l Kebîr, VI, 144.

dëshmorë që dhanë jetën në rrugën e Allahut. Varrosini ata me gjakun e tyre, sepse në Ditën e Gjykimit do të dalin me plagët që rrjedhin gjak, ngjyra e tyre do të jetë si e gjakut, por aroma e tyre do të jetë sikur aroma e miskut." Më pas Profeti pyeti për xhaxhain e tij, Hamzain radijallahu anhu. Ishte Aliu r.a. ai që e gjeti atë, dhe Profeti u trondit kur pa trupin e tij të gjymtuar. Hamzai ishte vrarë mizorisht, veshët dhe hunda i ishin prerë, fytyra i ishte bërë e panjohshme, barku i ishte çarë dhe mëlçia i ishte nxjerrë jasht trupit. Profeti alejhi selam i mbushur me dhembje, tha: **"O Hamza! Asnjë njeri nuk ka përjetuar një vuajtje të tillë si ti. O xhaxhai i Profetit të Allahut! O Luani i Allahut dhe i të Dërguarit të Tij! Allahu të mëshiroftë!"** Në atë moment u pa një grua që vinte me ngut drejt fushës së betejës. Ajo ishte Safijja (r.a.), halla e Profetit alejhi selam. Ajo sapo kishte dëgjuar lajmin e rremë për vdekjen e Profetit a.s. ishte nisur me ngut drejt Uhudit. Profeti a.s. për të mos lejuar që ajo të shihte trupin e vëllait të saj të masakruar, i kërkoi djalit të saj, Zubejrit (r.a.), ta ndalte. Safijja, duke iu drejtuar të birit, tha: "O biri im! Më trego për Profetin!" Zubejri dhe Ali e siguruan atë se Profeti ishte mirë, ajo u qetësua por këmbënguli që ta shihte atë me sytë e saj. Kur pa Profetin që ishte gjallë Safijja falënderoi Allahun. Më pas, ajo kërkoi të shihte trupin e vëllait të saj, Hamzain, por djali i saj e ndaloi duke i thënë: "O nëna ime! Profeti të ka urdhëruar të kthehesh në Medina." Por ajo me këmbëngulje ju drejtua të birit "O biri im! Unë tashmë e di çfarë i është bërë atij. Ai ka rënë dëshmor në rrugën e Allahut. Edhe ne jemi të gatshëm për çdo sakrificë në këtë rrugë." Më pas Safijja si një grua fisnike tha: "Ne do të presim shpërblimin nga Allahu i Madhëruar. Inshallah, do të durojmë dhe do ta përballojmë këtë sprovë."

Zubejr bin Avami u kthye tek Profeti (paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të) dhe e lajmeroi atë për këmbënguljen e Safijes, Profeti alejhiselam i tha **"O Zubejr! Atëherë lëreni ta shohë."** Safijja ju afrua të vëllait dhe ju ul pranë trupit të Hamzait dhe qau në heshtje. Ajo kishte sjellë me vete dy mbulesa dhe tha: "I solla këto për vëllanë tim, Hamzain. Mbështilleni atë me to." Hamzai, i njohur si **"Sundimtari i Dëshmorëve"**, u mbështoll me njërën nga këto mbulesa që kishte sjellur e motra.[202]

Profeti ynë i dashur (paqja e Allahut qoftë mbi të), i cili po vizitonte dëshmorët, shkoi pranë Musab bin Umejrit, flamurtarit të betejës së Uhudit. Kur e pa se Musabi kishte humbur duart dhe në shumë vende ishte plagosur rëndë. Vëndi ku gjendej Musabi r.a. ishte mbuluar nga gjaku i tij. Profeti alejhi selam i trishtuar shumë nga kjo gjëndje lexoi ajetin 23 nga Surja Ahzab: **''Nga besimtarët ka burra që e mbajtën me të vërtetë besën e dhënë Allahut** (dolën në Xhihad – në luftën për Çështjen e Allahut**), prej tyre disa e plotësuan detyrimin** (ranë martirë) **dhe disa po presin akoma, por ata nuk e kanë ndryshuar aspak vendosmërinë (në besën e dhënë Allahut).''** Më pas, Profeti shtoi: **"Unë, i Dërguari i Allahut, jam dëshmitar që ju do të ngjalleni si dëshmorë në Ditën e Gjykimit."** Dhe duke ju kthyer atyre që ishin pranë tij ju tha: **"Vizitojini këta dëshmorë. Përshëndetini ata me selam. Pasha Allahun, kushdo që u jep selam atyre në këtë botë, këta dëshmorë do t'i kthejnë selamin në Ditën e Gjykimit."**

Pas ultimatumit të Profetit alejhi selam sahabët filluan të përgatisin shokët e tyre për varrim por kur erdhen tek Musabi (radijallahu anhu), për ta mbulaur atë nuk gjetën një qefin të plotë. Pelerina që ai kishte të veshur nuk e mbulonte të gjithë trupin e tij. Sahabët i mbulonin kokën, këmbët mbeteshin zbuluar, i mbulonin

[202] İbni Ebî SHeybe, Musannef, VIII, 493; Abdurradhdhâk, Musannef, III, 427; İbni Sa'd, Tabakât, III, 14.

"O Sahabë! Ne po kthehemi nga xhihadi i vogël dhe tani do të fillojmë xhihadin e madh."
Hadith

këmbët, koka i mbetej zbuluar. Sahabët ju drejtuan Profetit alehi selam dhe e lajmëruan për gjendjen e Musabit. Profeti a.s. ju tha: **"Mbulojani kokën me pelerinën e tij, ndërsa këmbët mbulojani me bar të njome."** Ky pra ishte Mushab bin Umeiri, sahabiu i dashur, që jetën e tij ia kushtoi shërbimit ndaj Islamit dhe që u ngrit në gradën e dëshmorit, duke u larguar nga kjo botë vetëm me një qefin të paplotë.[203] Në Betejën e Uhudit ranë dëshmorë 70 persona, prej të cilëve 64 ishin Ensarë dhe 6 ishin Muhaxhirë. Dëshmorët, pasi ju fal namazi i xhenazesë, u varrosën nga dy ose nga tre veta në një varr.

Beteja e Uhudit ishte dita më e vështirë e sahabëve. Zemrat e tyre ishin të thyera sepse në atë betejë shumë prej sahabëve kishin humbur të afërmit e tyre., Profeti a.s. për t'i ngushëlluar ata ju tha: ''**Pasha Allahun, unë gjithashtu do të doja të bëhesha dëshmor dhe gjatë natës të qëndroja në brendësi të malit Uhud. Kur vëllezërit tuaj ranë dëshmorë, Allahu i vendosi shpirtrat e tyre në kthetrat e gjelbra të zogjve. Ata vizitojnë lumenjtë e Xhenetit, pinë prej ujit të tyre dhe hanë nga frutat e tij. Fluturojnë nëpër kopshtet e tij dhe në mbrëmje qëndrojnë në kandila të artë të varur nën Arshin e Madhëruar. Kur ata shijuan kënaqësitë e ushqimit dhe pijeve në Xhenet, thanë: 'Ah, sikur vëllezërit tanë ta dinin se çfarë dhuratash na ka dhënë Allahu, që të mos hezitonin të luftonin dhe të mos tërhiqeshin nga frika e armikut.' Allahu ju tha atyre: 'Unë do t'ua përcjell këtë lajm vëllezërve tuaj.''** (Dhe Allahu i Lartësuar shpalli një ajet që thotë); ''**Mos mendoni për ata që janë vrarë në Rrugë të Allahut se kanë vdekur. (Jo!) Përkundrazi, janë të gjallë me Zotin e tyre dhe atje u shërbehet. Ata gëzohen në ato mirësi që u ka derdhur Allahu. Nga Begatitë e Tij të pafund, duke u gëzuar për hir të atyre që akoma nuk janë bashkuar me ta, por janë akoma** (e nuk kanë rënë Shehidë - martirë)**, se për ta nuk do të ketë aspak frikë e as nuk do të pikëllohen. Ata gëzohen në Mirësitë dhe Begatitë e Allahut dhe nuk ka dyshim se Allahu nuk ua humb shpërblimin besimtarëve.''**[204] *(Ali Imran: 169-171).* Allahu i Madhëruar u shfaq para tyre dhe ju tha: **"O robërit e Mi, më thoni çfarë dëshironi, që t'jua jap atë dhe më shumë."** Ata iu përgjigjën: **"O Zoti ynë, Ti na ke dhënë mirësi të pakrahasueshme. Çfarë tjetër të kërkojmë? Në Xhenet ne kemi çdo gjë që dëshirojmë. Megjithatë, nëse mund të kërkojmë diçka, do të dëshironim që shpirtrat tanë të riktheheshin në trupat tanë, të ktheheshim dynja dhe të luftonim përsëri në rrugën Tënde derisa të binim dëshmorë edhe një herë."**

Pas përfundimit të kësaj beteje të lavdishme në Uhud, ku historia dëshmoi heroizmat e jashtëzakonshme të sahabëve, Profeti Muhamed (paqja qoftë mbi të) dhe shokët e tij u kthyen në Medinë. Kur arritën në Harre, ai u ndal, rreshtoi shokët e tij dhe ngriti duart duke bërë këtë dua: **"O Allah! Të gjitha falënderimet dhe lavdërimet të takojnë Ty. O Allah! Askush nuk mund ta udhëzojë atë që Ti e ke lënë në humbje, dhe askush nuk mund ta largojë nga udhëzimi atë që Ti e ke udhëzuar. O Allah! Na e bëj të dashur imanin dhe na zbukuro zemrat tona me të. Na bëj të urrejmë mosbesimin, mëkatin dhe rebelimin. Na bëj prej atyre që janë të udhëzuar dhe na jep sukses në fe dhe në këtë botë. O Allah! Na jep jetë si myslimanë dhe na bëj që të vdesim si myslimanë. Na bashko me**

[203] Buhârî, Cenâidh, 27; Ebû Dâvûd, Vesâyâ, 11; İbni Ebî SHeybe, Musannef, III, 147; İbni Sa'd, Tabakât, III, 121; Suyûtî, Câmi-ul Ehâdis, XXXIV, 451.
[204] Âl-i İmrân: 3/169-171.

të drejtët dhe të mirët, ata që nuk e kanë humbur nderin dhe besimin e tyre. O Allah! Shkatërro ata që e kundërshtojnë të Dërguarin Tënd dhe që luftojnë kundër Teje. Zbrit mbi ta ndëshkimin Tënd të drejtë!" Të gjithë sahabët duke iu bashkuar kësaj lutjeje thanë **"Amin!"** me një zë të lartë.

Ndërsa ata po afroheshin Medina, panë që gratë dhe fëmijët kishin dolur në rrugë, duke pritur me ankth e mall të shihnin Profetin dhe ushtrinë që po kthehej. Kur e shihnin fytyrën e tij të ndritur, e falënderonin Allahun. Pastaj, me lot në sy, kërkonin mes ushtarëve baballarët, vëllezërit, bashkëshortët dhe djemtë e tyre. Nëse nuk i gjenin, shpërthenin në lot. Profeti ashejhi selam duke parë pikëllimin e tyre, nga mëshira dhe dhimbjet po derdhte lot së bashku me to. Në këtë kohë, nëna e Sad bin Muadhit, Kebshe Hatun, iu afrua dhe tha: **"O i Dërguari i Allahut! Prindërit dhe jeta ime qofshin flijuar për Ty! Falënderimi i qoftë Allahut që të shoh ty të sigurt. Për sa kohë që ti je i sigurt, çdo fatkeqësi tjetër është e papërfillshme për mua!"** Ajo nuk pyeti për djalin e saj, Amrin, i cili kishte rënë dëshmor në Uhud. Profeti e ngushëlloi për djalin e saj duke i thënë:**"O nëna e Sa'dit! Gëzohu, sepse të gjithë dëshmorët janë bashkuar në Xhenet dhe janë miq me njëri-tjetrin. Ata gjithashtu do të ndërmjetësojnë për familjet e tyre."** Kebshe Hatun u përgjigj: "Ne jemi të kënaqur me gjithçka që vjen nga Allahu! Pas këtyre lajmeve të gëzuara, kush mund të qajë për ta? Ju lutem, lutuni për ne që kemi mbetur pas." Profeti kur pa durimin dhe vendosmërinë e saj tha: **"O Allah! Largo hidhërimin nga zemrat e tyre dhe bëji ata më të mirët ndër të mbijetuarit!"**

Pastaj duke u kthyre nga shabaët Profeti tha: **"O Sahabë! Ne po kthehemi nga xhihadi i vogël dhe tani do të fillojmë xhihadin e madh."** (Duke iu referuar betejës kundër epsheve dhe dëshirave të ulëta).[205] Ai këshilloi sahabët të pushojnë dhe të shërojnë plagët e tyre ndërsa ai vetë shkoi në shtëpi për t'u çlodhur sepse ishte ende i plagosur.

Beteja e Hamra-ul-Esedit

Kur u kthye në Medinë, Resul-i Ekrem, (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të), duke qenë se ekzistonte mundësia që idhujtarët të ktheheshin mbrapsht dhe të sulmonin Medinën, mori masa paraprake. Të hënën, një ditë pas betejës së Uhudit, për të treguar se muslimanët nuk ishin dobësuar nga lufta e djeshme dhe për të penguar armikun të kthehej në Medinë, ai urdhëroi Bilal Habeshiun duke i thën lajmero se: **"Resulullahu ju urdhëron të ndiqni armikun! Ata që nuk morën pjesë në luftën e Uhudit dje, këtë herë nuk do të marrin pjesë. Me Resulullahun do të vijnë vetëm ata që luftuan luftuan dje në Uhud."** Bilali e përcolli këtë urdhër tek shokët e Profetit, edhe pse shumica ishin të plagosur, ata u menjëherë përgatitën. Madje, dy vëllezër të quajtur Abdullah dhe Rafi, të cilët ishin të plagosur rëndë, sapo dëgjuan këtë thirrje të Profetit, pavarësisht dhimbjeve dhe vuajtjeve të tyre, u drejtuan menjëherë drejt radhëve të luftëtarëve, duke thënë: "A do ta humbasim mundësinë për të dalë në betejë me Resulullahun?!"

I Dërguari i dashur i Allahut, së bashku me shokët e tij të ndritur, filloi ndjekjen e idhujtarëve. Kur arritën në një vend të quajtur Revha, mësuan se idhujtarët po përgatiteshin për për të sulmuar Medinën dhe për të shkatërruar muslimanët. Ky nxorri në pah një tjetër mrekulli e Profetit të nderuar.

[205] Suyûtî, Câmi-ul Ehâdis, XV, 139, XXXIV, 106.

Kur idhujtarët dëgjuan se Resulullahu po vinte drejt tyre, ata u frikësuan dhe duke u kthyer në Mekka braktisën vendin ku kishin qëndruar.[206]

Profeti ynë i nderuar i ndoqi ata deri në një vend të quajtur Hamra-ul-Esed. Gjatë kësaj ndjekjeje, dy idhujtarë u kapën robër. Ai dhe shokët e tij qëndruan në Hamra-ul-Esed për tre ditë dhe më pas u kthyen në Medinë. Allahu i Madhëruar zbriti ajetin 172 të sures Ali Imran ku përmendi këtë grup të ndritur të sahabëve: **"Ata që iu përgjigjën Allahut dhe të Dërguarit të Tij pasi qenë plagosur. Për ata të cilët bënë vepra të mira dhe iu frikësuan Allahut, do të ketë shpërblim të madh."**[207]

Ndër idhujtarët që ishin betuar për të vrarë Profetin në betejën e Uhudit, ishte edhe Ibni Kamia. Kur ky u kthye në Mekkë, një ditë u ngjit në një mal për të kontrolluar kopenë e tij të deleve pa se një dash u shkëput nga kopeja dhe vrapoi me forcë drejt tij, duke e goditur dhe e copëtuar atë derisa e vrau. Një tjetër armik, Abdullah Shihab Zuhri, ndërsa ishte rrugës për në Mekë, u pickua nga një gjarpër me njolla të bardha dhe vdiq.

Të gjithë ata që kishin bërë plane për të sulmuar Profetin e nderuar, brenda një viti u ndëshkuan me fatkeqsi dhe vdiqën.

Nëse një mik do të pinte helm të gjarprit, ai do t'i kthehej në ujë të jetës,
Nëse një armik do të pinte ujë, ai do të bëhej helm i gjarprit.

Çdo pikë e ujit është e mbushur me oqeane mëshire,
Një grusht me ujë abdesti, i jep fytyrës së bukur jetë si një trëndafil.

Për vite të tëra, uji endej duke goditur kokën nga një gur në tjetrin,
Vetëm për të arritur pluhurin e këmbëve tua.

Çdo grimcë pluhuri në pragun tënd dëshiron të përhapë dritë,
Dhe nuk largohet nga ai prag, edhe sikur të copëtohet.

Për ata që gabuan, përmendja e emrit tënd është ilaç,
Ashtu siç pijetarët e dehur pinë ujë për të larguar dhimbjen.

O i Dashur i Zotit, o më i miri ndër njerëz, jam i etur për ty,
Si buzët e thara që digjen nga etja dhe kërkojnë ujë.

Ti je deti i mrekullive, që natën e Miraxhit,
Uji i hirësisë sate e ngjalli të palëvizshmen dhe të lëvizshmen si vesë.

NGJARJA E RAXHIUT

"Ata që iu përgjigjën Allahut dhe të Dërguarit të Tij pasi qenë plagosur. Për ata të cilët bënë vepra të mira dhe iu frikësuan Allahut, do të ketë shpërblim të madh."
Âl-i İmrân: 3/172.

Beteja e Uhudit është një nga betejat më të rëndësishme të historisë islame, ku ndër sahabët e shquar ishte edhe Âsim bin Sâbit (r.a.). Në këtë betejë, ai vrau Musâfi bin Talhanë dhe vëllain e tij, Hârisin, të cilët ishin armiq të Islamit. Nëna e tyre, Sulâfe binti Sad, e njohur për urrejtjen e saj të madhe, premtoi një shpërblim prej njëqind devesh për atë që do të sillte kokën e Âsim bin Sâbitit. Madje, ajo u betua se do të pinte verë në kafkën e tij. Më vonë, në një ekspeditë të dërguar nga i Dërguari i

[206] Vâkıdî, Megâdhî, I, 4; İbni Sa'd, Tabakât, II, 48; Suheylî, Ravdu'l-unf, III, 289.
[207] Âl-i İmrân: 3/172.

NGJARJA E RAXHIUT

Allahut (a.s.), sahabiu Abdullah bin Uneys vrau Hâlid bin Sufyânin, i cili ishte nga fisi Lihiân. Për këtë arsye, fisi Lihiân për të organizuar një komplot kundër myslimanëve u bashkua me fiset Adel dhe Kare.

Të dy fiset që ndodheshin pranë Mekës, përgatitën një plan të hollësishëm. Ata dërguan disa përfaqësues tek i Dërguari i Allahut (a.s.), duke pretenduar se ishin bërë myslimanë dhe kërkuan mësues për të mësuar Islamin dhe për të mbledhur zekatin. Qëllimi i tyre ishte të vrisnin disa nga mësuesit dhe të tjerët t'i dorëzonin tek kurejshët në Mekkë që këtyre të fundit tju merrnin shpërblim. Në muajin Safer të vitit të katërt të Hixhretit. Një grup prej gjashtë ose shtatë personash nga këto dy fise me këtë kërkesë shkuan tek i Dërguari i Allahut (a.s.). Në atë kohë, Profeti (a.s.) kishte përgatitur një grup prej dhjetë sahabësh për të mbikëqyrur aktivitetet e armikut. Me kërkesën e këtyre fiseve, Profeti (a.s.) vendosi që të njëjtin grup ta dërgonte për të hulumtuar dhe për të mësuar më shumë rreth situatës. Grupi përfshinte sahabët e mëposhtëm: **Mersed bin Ebî Mersed, Hâlid bin Ebî Bukeir, Âsım bin Sâbit, Hubeib bin Adii, Zeid bin Desinne, Abdullah bin Târik, Muattib (Mugir) bin Ubeid dhe tre sahabë të tjerë të cilët nuk njihen me emër.** Të gjithë ishin nga sahabët e respektuar të Profetit (a.s.).

Grupi udhëtonte natën dhe fshihej gjatë ditës. Një mëngjes ata arritën pranë burimit të ujit Rexhi dhe për të pushuar për pak kohë qëndruan aty. Gjatë pushimit ky grup sahabësh aty kishte ngrënë hurma të mira nga Medineja. Më pas u larguan dhe u ngjitën në një kodër për t'u fshehur. Një grua nga fisi Huzeil, që po ruante delet në atë zonë, vuri re bërthamat e hurmave dhe kuptoi se aty kishin qenë njerëz nga Medineja. Ajo njoftoi fisin e saj, duke thënë: "sipas farërave të hurmës këtu kanë kaluar njerëz nga Medineja." Ndërkohë, një nga përfaqësuesit e fiseve Adel dhe Kare, që shoqëronte grupin e sahabëve, u largua me një justifikim dhe informoi fisin Lihiân për vendndodhjen e grupit mysliman.

Pas këtij informacioni Lihianët (një fis armik) morën masa dhe për të sulmuar këtë grup të vogël sahabësh dërguan një forcë prej 200 vetash, shumica prej të cilëve ishin harkëtarë. Ata i rrethuan sahabët, në mesin e të cilëve ishte edhe Âsîm bin Sâbiti, mbi një majë mali. Në këtë kohë, personi që kishte tradhtuar dhe informuar idhujtarët, iu bashkua sahabëve. Kur sahabët kuptuan që ishin tradhtuar, vendosën të luftonin, duke nxjerrë shpatat e tyre. Më pas, idhujtarët u përpoqën t'i mashtronin duke thënë: "Ju japim fjalën! Nëse dorëzoheni dhe zbrisni, nuk do t'ju vrasim. Betohemi në Allahun që nuk duam t'ju vrasim, por duam thjesht të kërkojmë fidie (shpërblim) nga mekkasit."

Âsîm bin Sâbit, Mersed bin Ebî Mersed dhe Hâlid bin Ebî Bukeir (r.a.) e refuzuan këtë ofertë duke ju thënë: "Ne nuk e pranojmë kurrë fjalën dhe besën e idhujtarëve!" Ndërsa Âsîmi ju tha: "Unë jam betuar që kurrë nuk do të pranoj mbrojtjen e idhujtarëve. Për Allahun, duke u dorëzuar nuk do të bie pre e fjalëve dhe mbrojtjes së tyre!" Pastaj ai ngriti duart dhe u lut: **"O Allah! Informoje të Dërguarin tënd për situatën tonë!"** Allahu e pranoi lutjen e tij dhe Profeti Muhamed (a.s.) u informua për këtë ngjarje.

Më pas Âsîmi i tha idhujtarëve: "Ne nuk kemi frikë nga vdekja, sepse jemi të sigurt në fenë tonë! (Nëse vdesim, bëhemi dëshmorë dhe shkojmë në Xhenet.)" Atëherë udhëheqësi i idhujtarëve i tha: "O Âsîm! Dorëzohu! Mos e shkatërro veten dhe shokët e tu." Âsîm bin Sâbit iu përgjigj duke hedhur shigjeta. Gjatë kohës që luftonte...

Unë jam i fortë, nuk kam asnjë të metë.
Tela i trashë i harkut tim është shtrënguar.
Vdekja është e vërtetë, jeta është e kotë dhe kalimtare.
Çdo gjë e caktuar nga fati do të ndodhë.
Njerëzit, herët a vonë, do të kthehen te Allahu.
Nëse nuk luftoj me ju,
Nëna ime (nga trishtimi) do ta humbasë mendjen.

"Pasha Allahun! Nuk do të pranoja kurrë që Muhamedit (paqja e Allahut qoftë mbi të) t'i shpohej këmba nga një gjemb, e lëre më të zëvendësohej me mua."
Hubeib bin Adij "radiallah anhu"

Âsîmi në torbën e tij kishte shtatë shigjeta. Me çdo shigjetë që gjuante, vriste një idhujtar. Kur mbaroi shigjetat, përdori shtizën dhe plagosi shumë prej tyre, por shtiza u thye. Ai nxori shpatën dhe hodhi teposhtë këllëfin e saj (një simbol që tregon se pa u dorëzuar do të luftonte deri në vdekje). Pastaj u lut: **"O Allah! Unë deri sot e kam mbrojtur fenë Tënde. Të lutem, ruaje trupin tim pas vdekjes."** Zërat e sahabëve që thërrisnin **"Allahu Ekber!"** përhapeshin nëpër male. Dhjetë sahabë luftonin me plot guxim kundër 200 idhujtarëve. Âsîmi më në fund u plagos rëndë dhe ra përtokë. Armiku nga frika, nuk iu afrua, por e qëlloi me shigjeta nga larg dhe e vrau. Nga dhjetë sahabët, shtatë ranë dëshmorë, ndërsa tre të tjerët u zunë rob. Idhujtarët donin ta prisnin kokën e Âsîmit dhe ta shisnin te Sulâfe binti Sadi, një grua që kërkonte hakmarrje për vrasjen e familjarëve të saj në Betejën e Bedrit. Por Allahu e pranoi lutjen e Âsîmit dhe dërgoi një grup bletësh që qëndruan mbi trupin e tij si një re. Armiku nuk mundi t'i afrohej dhe vendosën të prisnin deri në mbrëmje, me shpresën se bletët do të largoheshin. Në mbrëmje, ra një shi i madh dhe një përmbytje rrëmbeu trupin e Âsîmit, duke e çuar në një vend të paditur. Idhujtarët nuk mundën ta gjenin trupin e tij. Kështu, që ata nuk arritën të merrnin asnjë pjesë të tij. Lajmi kishte mbërritur në Medina mirëpo kur u përmend se trupi i Asimit ishte mbrojtur nga bletët Omeri r.a. tha: "Allahu gjithmonë e mbron robin e Tij besimtar. Ashtu sikur e mbrojti Âsîmin kur ishte gjallë nga idhujtarët, Ai ashtu e mbrojti edhe trupin e tij pas vdekjes." Për këtë arsye, Âsîmi u quajt **"Njeriu që u mbrojt nga bletët."**[208] Sahabët që u zunë rob ishin: Hubeib bin Adij, Zeid bin Desinne dhe Abdullah bin Târîk (r.a.). Lihjanët sapo i zunë rob sahabët i lidhën me tela të fortë harku. Abdullah bin Târîk nuk bind armikut dhe refuzoi që ata të mos e dërgonin në Mekkë duke ju thënë: "Shokët e mi që ranë dëshmorë dhe ata tashmë janë nderuar me Xhenet." Më pas ai i këputi telat dhe u nis te largohet me vrap por Lihjanët duke e qëlluar me gurë e vranë. Ndërsa Hubeib bin Adij dhe Zeid bin Desinne (r.a.) u dërguan në Mekkë, ku u shitën si skllevër tek ata që kërkonin hakmarrje për humbjet në Betejat e Bedrit dhe Uhudit. Hubeib bin Adij dhe Zeid bin Desinne (r.a.) u mbajtën të burgosur ku u dhunonin mizorisht nga idhujtarët por ata treguan durim e devotshmëri të jashtëzakonshme.

Një grua e quajtur Mâvije, e cila më vonë u bë myslimane, tregoi: "Hubeibi ishte i burgosur në shtëpinë tonë. Nuk kam parë asnjëherë një rob më të mirë se ai. Ne atë e linim pa ushqim por një ditë e pashë me një kokërr të madhe rrushi në dorë. Atëherë ishte koha që në Mekkë nuk kishte rrush, dhe ishte e pamundur ta gjeje atë. Atëherë e kuptova që atë e Allahu e furnizonte me rrizkun e Tij. Ai vazhdimisht lutej dhe falte namaz në qelinë e tij. Kur gratë dëgjonin recitimin e tij të Kur'anit, shpesh herë qanin nga emocionet. Kur e pyesja: 'A ke ndonjë nevojë?', ai thoshte: 'Vetëm ujë të pastër. Mos më jepni mish që është therur për idhuj dhe para se të më vrisni

[208] Buhârî, Megâdhi 28; Vâkıdî, Megâdhî, I, 354; Abdurredhdhâk, Musannef, V, 354; Ta-berânî, Mu'cemu'l Kebîr, IV, 221.

më tregoni.'" Kur u afrua dita që do të vritej, shkova dhe ia thashë këtë lajm. Pasi e dëgjoi lajmin që do të vritej nuk pashë tek ai as më të voglin ndryshim në qëndrimin e tij. Madje në fytyrën e tij nuk dukej qoftë edhe asnjë shenjë e vogël trishtimi.

Kur erdhi momenti që do të vrirej ai kërkoi të bënte pastërti trupore para vdekjes dhe kërkoi një brisk. Ia dërgova briskun nëpërmjet djalit tim, por më pas u tremba papritur dhe thashë me vete:"Mjerë unë! Ky njeri do ta presë djalin me briskun. Por duke menduar se gjithsesi, ai do të vritet" vrapova për ta parë djalin tim. Kur arrita atje Hubeibi kishte marrë briskun nga dora e djalit dhe e kishte ulur atë në prehër dhe ishte duke e përkëdhelur. Kur e pashë këtë gjëndje u tremba edhe më shumë dhe fillova të bërtas. Ai, duke kuptuar shqetësimin tim, më tha: "Mos u tremb! Si mund të mendosh se unë mund ta vras këtë fëmijë? Në fenë tonë është e ndaluar vrasja e fëmijëve. Po ashtu në Islam nuk është pjesë e nderit dhe virtyteve tona që ti marrim jetën një njeriu të pafajshëm."

Më në fund kishte ardhur dita kur Hubeib bin Adij dhe Zeid bin Desinne do të vriteshin. Në mëngjes herët, zinxhirët e tyre u hoqën dhe ata u dërguan jasht Mekkës, në një vend të quajtur Ten'im (rreth 5-8 km larg Qabes). Atje, një turmë e madhe njerëzish ishte mbledhur për të parë ekzekutimin e tyre, përfshirë këtu edhe prijësit e idhujtarëve, gratë dhe fëmijët. Për varjen e tyre, në vendin e ekzekutimit, idhujtarët kishin ngritur dy trekëmbësha. Dhe kur e çuan drejt Hubeibin trekëmbëshit ai tha: **"O idhujtarë! Para se të më vrisni, më lejoni që të fal dy rekatë namaz ."** Ata me plot neveri i thënë: "Falu aty ku je."

Hubeibi me një përulësi dhe qetësi të plotë i fali dy rekate namaz. Pas namazit, tha: **"Pasha Allahun, nëse ju nuk do të mendonit se e zgjata namazin nga frika e vdekjes, do ta kisha zgjatur edhe më shumë. Madje dhe do të kisha falur më shumë namz."** Ky veprim i Hubeibit u bë një traditë dhe një sunet për ata që përballen me ekzekutimin. Më pas kur Profeti Muhamed (paqja qoftë mbi të) mësoi se Hubeibi kishte falur dy rekate para vdekjes, e pëlqeu dhe e mbështeti këtë veprim të tij.[209]

Pas namazit, Hubeibin e lidhën duke ja kthyer fytyrën atij nga Kibla në drejtim të Medinës dhe e ngritën në trekëmbësh dhe i thanë: " O Hubeibin! Nëse ti e mohon fenë tënde ne do të të lirojmë ty!" Ai me vendosmëri ju përgjigj: **"Pasha Allahun, edhe sikur të më jepni tërë botën, nuk do të heq dorë nga Islami dhe kurre nuk do të kthehem nga ajo që ju po më kërkoni!"** Kur panë idhujtarët vendosmërine e tij i thanë me përqeshje dhe nënçmim: **"** O Hubeibin A do të dëshiroje që në vendin tënd të ishte Muhamedi (paqja e Allahut qoftë mbi të). Pra në vendin tënd ai të vritej, ndërsa ti të ishe i lirë në shtëpinë tënde?"Hubeibi u përgjigj: **"Jo! Kurrë! Pasha Allahun! Nuk do të pranoja kurrë që Muhamedit (paqja e Allahut qoftë mbi të) t'i shpohej këmba nga një gjemb, e lëre më të zëvendësohej me mua."**Kur e dëgjuan këtë, idhujtarët filluan të talleshin dhe të qeshnin me të, duke i thënë: "Kthehu nga Islami! Nëse nuk kthehesh, dije që ne do të të vrasim." Hubeibi me qetësi ju përgjigj: **" Mua më mjafton të jem në rrugën e Allahut ndaj vrasja për mua nuk ka asnjë rëndësi."** Më pas Hubeibi tha: **"O Allah! Këtu nuk shoh fytyrë tjetër përveç fytyrës së armiqve të mi. O Allah! Bëje që selami im t'i arrijë të Dërguarit tënd dhe tregoja atij që ne po vdesim në rrugën e tij!"**Dhe në fund shtoi: **"Es-selamu alejke, ja Resulallah!"**

[209] Buhârî, Megâdhi 28; Vâkıdî, Megâdhî, I, 354; Taberânî, Mu'cemu'l Kebîr, IV, 221.

Zeid bin Harisi transmeton se (kur ka ndodhur ekzekutimi i Hubeibit I Dërguari i Allahut (paqja e Allahut qoftë mbi të) ishte duke qëndruar me shokët e tij në Medina.) "Një ditë, ndërsa i Dërguari i Allahut po qëndronte me ne, ai tha: **'Ve alejhi selam.'** Ne e pyetëm: 'O i Dërguari i Allahut, kujt po i përgjigjesh?' Ai tha: **'Po i përgjigjem selamit të vëllait tonë Hubeibit. Xhibrili (paqja qoftë mbi të) ma përcolli selamin e tij.'"**[210]

Para se të ekzekutohej rreth Hubeibit ishin mbledhur kurejshët idhujtarë, të cilët, duke i nxitur të rinjtë dhe fëmijët i thoshin: "Ky është njeriu që vrau baballarët tuaj!" Të rinjtë nisën ta sulmonin me hurë, duke ja plagosur trupin e bekuar. Fytyra e Hubeibit ishte kthyer drejt Qabes por idhujtarët e kthyen atë drejt Medinës. Mirëpo Hubeibi e kishte të shenjtë kthimin e fytyrë nga qabja e shenjtë ndaj ai u lut: **"O Allah, nëse unë jam një rob i pranuar te Ti, ktheje fytyrën time nga Kibla!"** Dhe fytyra e tij u kthye përsëri drejt Qabes. Asnjë prej tyre nuk ishte në gjendje ta kthente fytyrën e tij në ndonjë drejtim tjetër. Kështu më fytyrë nga qabja Hubeibi, duke u ndjerë i vetëm mes armiqve, qëndronte në trekëmbëshin e ekzekutimit. Hubeibi ashtu i vetmuar në mest ë kallaballëkut idhujtar recitoi një poezi që shprehte ndjenjat e tij. Mirëpo kur idhujtarët, duke i ngulur heshta në trup, nisën ta torturonin, ai tha:**"Pasha Allahun, pasi po vritem si një mysliman, nuk më shqetëson nëse bie në njërën apo tjetrën anë. Të gjitha këto janë për hir të Allahut të Madhëruar."**

Pastaj Hubeibi nisi të mallkoi idhujtarët: **"O Allah! Shkatërroji kurejshët! Përça radhët e tyre! Merru jetën një nga një dhe mos i lër asnjë të gjallë!"** Kur dëgjuan idhujtarët këtë mallkim të Hubeibit, shumë prej tyre ikën prej frikës. Të tjerët nisën njëri pas tjetrit t'i ngulnin heshtat, derisa njëri prej tyre i nguli një heshtë në gjoks, ku heshta i hyri në gjok dhe i doli nga shpina. Kështi u ekzekutua Hubeibi, duke i rrjedhur gjaku rrëke dhe trupi i varur në trekëmbësh. Dhe në fund Hubeibit e dha frymën e fundit duke thënë: **"Eshhedu en la ilahe il-lallah ve eshhedu enne Muhammeden abduhu ve resuluhu."** Dhe Hubeib bin Adij (Allahu qoftë i kënaqur me të) u bë dëshmor.[211]

Trupi i tij qëndroi i varur në trekëmbëshin e ekzekutimit për 40 ditë, por nuk kalbej dhe nuk kundërmonte. Gjaku i tij rridhte sikur të ishte ende i freskët. Pasi e mësoi Profeti (paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të), që idhujtarët e mbanin trupin e pa jetë të Hubeibit në trekendëshin e ekzekutimit, që të merrnin trupin e tij, dërgoi Zubeir bin Avamin dhe Mikdad bin Esvedin. Ata hynë natën fshehurazi në Mekkë, e ulën trupin e Hubeibit nga trekëmbëshi dhe e ngarkuan në një deve për ta çuar në Medinë. Mirëpo kur mësuan idhujtarët për këtë, u nisën pas tyre dhe kur i arritën ata (sahabet) për t'u mbrojtur u detyruan ta linin trupin e Hubeibit në tokë. Më pas, panë se vendi ku ishte trupi u hap, e gëlltiti atë dhe u mbyll përsëri. Kështu Sahabët e Profetit u kthyen në Medinë pat rupin e Hubeibit.

Zeid bin Desinne, ishte sahabiu tjetër që u zu rob së bashku me Hubeibin. Idhujtarët edhe me të vepruan njësoj sikur vepruan me Hubeibin. Ata duke e lidhur Zeidin në një pemë u përpoqën ta detyronin atë që ai të mohonte fenë e tij. Por Zeidi vetëm jo që mohonte por sa vinte e forconte më shumë besimin e tij. Në fund, ata e bënë trupin e tij njënjestër gjuetije dhe nisën ta qëllonin me shigjeta. Ndërsa Safuan

[210] Taberânî, Mu'cemu'l Kebîr, IV, 221; Ebû Nuaym, Hilyet-ul-evliyâ, I, 159; İbni Ab-dilberr, İstî'âb, II, 28.
[211] Abdurredhdhâk, Musannef, V, 354; Taberânî, Mu'cemu'l Kebîr, IV, 221.

bin Umejje i tha skllavit të tij se nëse ti e qëllon atë për vdekjë atëherë unë do të lë të lire. Sklavi i Saufanit, duke e bërë edhe atë dëshmor, qëlloi me shigjetë dhe e vrau Zeidin.

"Ata (dëshmorët e Bi'r-i Maûnes), u bashkuan me Allahun e Lartësuar. Allahu i Lartësuar ishte i kënaqur me ta, dhe ata ishin të kënaqur me Allahun e Lartësuar."
Hadith

NGJARJA E BI'R MAUNËS

Po atë vit, në muajin Safer, në rajonin Nexhd të Arabisë, , Ebû Berâ Âmir bin Mâliku, i cili ishte kreu i fisit Âmir erdhi në Medinë për të vizituar të Dërguarin e Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të). Profeti ynë i dashur i foli atij për Islamin dhe e ftoi të bëhej mysliman. Megjithëse Ebû Berâ nuk e pranoi Islamin, ai deklaroi se Islami është një fe e bukur dhe fisnike. Për më tepër, ai kërkoi nga i Dërguari i Allahut, që për të përhapur Islamin në Nexhd, të dërgonte disa shokë të tij. I Dërguari i Allahut i tha: "Unë nuk jam i sigurt për sigurinë e njerëzve që do të dërgoj në mesin e popullit të Nexhdit." Atëherë Âmir tha: "Unë do t'i marr ata nën mbrojtjen time dhe askush nuk do t'i prek ata."

Pas kësaj garancie që i dha Ebu Bera, i Dërguari i Allahut përgatiti një grup nga Eshâb-ı Suffa prej shtatëdhjetë personash, të cilët njiheshin për mësimin dhe leximin e Kuranit. Të gjithë ishin hafizë të Kuranit dhe për ta përdorej termi Eshâb-ı Kurrâ. Disa nga emrat e tyre ishin: Âmir bin Fehr, Amr ibni Zamrî, Atijje bin Abdullah, Enes bin Muavije, Hakem bin Keisân, Hâris bin Samme, Ka'b bin Zeid, Mâlik bin Sâbit, Munzir bin Amr, Rafi' bin Mezil, Said bin Huzâm, Selim bin Milhân, Suheil bin Âmir, Tufeil bin Es'ad, dhe Urve ibn Salt (Allahu qoftë i kënaqur me ta).

Profeti alejhi selam në krye të grupit vendosi Munzir bin Amrin. Gjithashtu, i Dërguari i Allahut përgatiti dhe dërgoi letra për prijësit e fiseve Benî Âmr dhe Benî Nexhd. Ebû Berâ, i cili dëshironte që fisi i tij të nderohej duke pranuar Islamin, shkoi përpara grupit dhe e njoftoi fisin e tij se i kishte marrë nën mbrojtje ata njerëz dhe askush të mos guxonte ti prekte. Mirëpo nipi i tij, Âmir bin Tufeili për t'i sulmuar sahabët organizoi një grup të armatosur dhe e rrethuan grupin e shokëve të Profetit në zonën Bi'r-i Maûne. Sahabët në gjëndje të rrethuar luftuan heroikisht deri në pikën e fundit të gjakut të tyre. Ku përveç dy prej tyre, të tjerët ranë të gjithë dëshmorë. Prej atyre që mbetën gjallë ishte Amr bin Ummeja, i cili u zu rob, ndërsa tjetri ishte Kab bin Zeid i cili u la i plagosur, pasi idhijturatët kishin menduar se ai ka vdekur.

Fjalët e fundit të këtyre sahabëve të shenjtë ishin**: "O Zot! Vetëm Ti mund ta njoftosh të Dërguarin Tënd për gjendjen tonë. Dërgoji atij selamin tonë** (që ai ta di se ne nuk e braktisëm kurrë rrugën e tij)**!"** Në atë moment Xhebraili (alejhisselam) me pikëllim të thellë erdhi tek Profeti a.s. dhe ia përcolli atij selamin e tyre duke i thënë: **"O i Dërguari i Allahut! Ata tani janë bashkuar me Allahun. Allahu është i kënaqur me ta dhe ata janë të kënaqur me Allahun."**

I Dërguari ynë i dashur, pasi u përgjigj me fjalët: **"Ve alejhisselam"** me një zemër të rënduar nga pikëllimi u kthye nga sahabët e nderuar dhe ju tha: **"Vëllezërit tuaj u përballën me politeistët. Politeistët i prenë dhe i copëtuan ata, i shpuan me shtiza duke jua bërë trupin vrima vrima..."** Kështu, i njoftoi shokët e tij për atë që kishte ndodhur. Mirëpo gjatë kësaj kohe, Âmir bin Fuhejre (Allahu qoftë i kënaqur me të) ndërsa po luftonte me armikun, u qëllua me shtizë në shpinë nga një burrë me emrin Xhebbâr. Kur e goditi thika Âmiri tha: **"Betohem në Allahun, se fitova**

Ngjarja E Bı'r Maunës



O i Dërguari i Allahut! Shpirti yt është një pikë drite hyjnore,
Bukuria jote e lartë, që ngazëllen zemrat, është burim kënaqësie.

Shfaqja e qenies tënde, sjell mëshirë,
Dëbove errësirën e mosbesimit dhe bëre të njohur besimin.

Në kopshtin e profetësisë, vetëm qenia jote si trëndafil,
Është një filiz i përsosmërisë së të Plotfuqishmit.

O fisnik ndërmjetëso për ne në Ditën e Zotit!
Ndërmjetsimi yt është shërim për dhimbjen e besimtarëve.

Sultan III. Ahmed (Necîb)

Parajsën!" Pas kësaj ndodhie, përpara syve të Xhebbârit dhe të politeistëve trupi i Amirit u ngrit drejt qiellit. Të gjithë u habitën nga kjo pamje, por vetëm Xhebbâri, ai që e kishte vrarë, e pranoi Islamin.

"Betohem në Allahun, se fitova Parajsën!"
Âmir bin Fuhejre

I Dërguari i Allahut u trishtua thellësisht nga ngjarjet e Rexhi-së dhe Bi'r-i Maûnes. Profeti alejhi selam një muaj rrjesht, në çdo namaz bëri dua për ndëshkim e fiseve që kryen këto tragjedi. Allahu e pranoi lutjen e të Dërguarit të Tij. Allahu i ndëshkoi këto fise me një thatësirë dhe uri të tmerrshme. Më pas, një sëmundje ngjitëse përfshiu fiset dhe shkaktoi vdekjen e shtatëqind personave të atyre fiseve.[212]

Ti je mjek për të gjitha botët, ndërsa unë kam një zemër të sëmurë,
Me shpresën për shërim, e solla atë te ti.

Shpinën ma rëndon një mal mëkatesh, fytyra më është si kashte;
Me shpresë e solla këtu për t'u shuar kjo barrë.

O Prijësi i botëve, jam i dashuruar dhe mahnitur me ty;
Nga ndarja prej teje qaj ditë e natë.

Mëshira jote e madhe është ujë i jetës, ndërsa unë jam i etur;
Pa një pikë prej saj, do të vdes, do të jap shpirt.

Ta lavdërosh atë për moralin e tij, është përpjekje e kotë.
Ta përshkruash me fjalë, duket edhe më e vështirë.

Ai është falës dhe bujar, saqë është shumë dorëdhënë;
Prej ujit sjell perla, prej gurit xhevahire, prej ferrës sjell trëndafila.

Nëse dielli ndriçon, kjo është prej dritës së tij;
Pika e vesës mbi trëndafil është prej fytyrës së tij të ndritshme.

Ta përshkruash atë është diçka më e lartë se kaq,
Por nëse flas më lart, të huajt do ta mohojnë.

Të fusësh gjithë botën në një grimcë është e mundur,
Por ta përshkruash atë me fjalë, është më e vështirë se kjo.

Mevlânâ Hâlid-i Bağdâdî

[212] Buharî, Megâdhi, 28; Muslim, Îmâre, 147; İbni Hishâm, Sîret, II, 183; Vâkıdî, Megâdhî, I, 346-352; İbni Sa'd, Tabakât, II, 51-54.

Ekspedita kundër Beni Nadir



EKSPEDITA KUNDËR BENI NADIR

"Hebrenjtë planifikuan të më vrasin! Kur Xhebraili më njoftoi për këtë, unë u largova!"
Hadith

Amr bin Umeyye (r.a.), gjatë qëndrimit të tij në Maûne ishte kapur rob dhe idhujtarët e mbanin të lidhur. Por një ditë ai arriti të shpëtojë nga zinxhirët kur po kthehej në Medinë hasi dy njerëz nga fisi Beni Amir, të cilët ishin politeistë, gjatë përleshjes me ta Amri ja arriti ti mposhti dhe i vrau. Mirëpo këta dy njerëz kishin marrë mbrojtjen e Profetit Muhamed (a.s.), por Amri nuk ishte në dijeni për këstë. Pasi arriti në Medinë, ai ia raportoi ngjarjen Profetit (a.s.), i cili e cilësoi veprimin e Amr-it si një gabim dhe urdhëroi që të paguhej shpagimi për familjet e viktimave.

Duke qenë se Beni Amir dhe fisi hebre Beni Nadir kishin marrëdhënie miqësore, për pagimin e shpërblimit të njerëzvë që vrau Amri, Profeti (a.s.) kërkoi ndërmjetësimin e tyre. Në muajin Rabiul-Evvel të vitit të katërt hixhri, pas Betejës së Uhudit, për të diskutuar çështje Profeti (a.s.) së bashku me shokët e tij të afërt: Ebu Bekri, Omeri, Aliu, Zubejri, Talha, Sad bin Muadhi dhe Usejd bin Hudajr (r.a.) shkoi te Beni Nadir. Beni Nadir e pranoi propozimin e Profetit alejhi selam mirëpo kërkuan prej tij që ai së bashku me shokët e tij të priste derisa ata të përgatisnin një drekë. Ndërkohë që kryetari i tyre, Hujei bin Ahtab, propozoi që të shfrytëzohej ky rast për të vrarë Profetin Muhamed (a.s.). Plani i tij ishte që te bëhej një organizim dhe ta vrasin Profetin duke e goditur atë me një gur të madh nga maja e një ndërtese. Mirëpo disa nga anëtarët e fisit të tyre e kundërshtuan planin e tij. Por Hujei e vazhdoi planin e tij.

Këtë komplot Profetit Muhamed ia përcolli menjëherë Xhebraili (a.s.). Pas marrjes së lajmit Profeti Muhammed, (paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të), nuk e prishi qetësinë dhe pa ju rënë në sy antarëve të fisit hebre nuk priti drekën. Por për të shmangur kurthin që po i ngrihej u kthye ne Medina. Pas kësaj tradhëtie Profeti (a.s.) tek fisi Beni Nadir dërgoi Muhamed bin Meslemen (r.a.) dhe i tha atij përcillja atyre mesazhin se: **"O Paria e Beni Nadir! Ju e thyet marrëveshjen dhe duke planifikuar një atentat ndaj meje ju më tradhëtuat. Prandaj, brenda dhjetë ditësh duhet të largoheni nga kjo zonë. Pas dhjet ditësh kur ne të vijmë këdo që do të gjejmë do ta ekzekutojmë."**

Fisi filloi përgatitjet për t'u larguar, por Abdullah bin Ubej, kreu i hipokritëve, duke u premtuar atyre mbështetje kundër Muhammedit alejhi selam i nxiti ata që të mos largoheshin nga Medina. Por kur mësoi Profeti Muhamed (a.s.) se ata po përgatiteshin për sulm i përgatiti sahabët dhe marshuan drejt kështjellës së Beni Nadir, e cila ndodhej rreth katër kilometra larg Xhamisë së Profetit. Aliu (r.a.) mbante flamurin, ndërsa Ibni Umm Mektumi (r.a.) u la si përgjegjës në Medinë. Kështjella u rrethua, rrethim ky që zgjati më shumë se 20 ditë, nga Profeti Muhammed dhe shokët e tij.

Pas 20 ditëve Beni Nadir u dorëzuan dhe kërkoi prej Profetit Muhammed që ata do ti linin armët dhe të gjitha pasurit me kusht që ai të ju jepte leje që ata të largoheshin te sigurtë nga Medina. Kështu ata duke lënë armët dhe të gjitha pasuritë e tyre u larguan të sigurtë nga Medina ku një pjesë e tyre u vendos në Sham, ndërsa pjesa tjetër shkoi në Hajber. Pas largimit të fisit Beni Nadir në Medinë mbeti vetëm fisi hebre Beni Kurejdha.[213]

[213] Vâkıdî, Megâdhî, I, 441; Suheylî, Ravd-ul-unf, VI, 282.

Ngjarje të rëndësishme që ndodhën në vitin e katërt të Hixhretit

"Pas Ebu Talibit, askush nuk më ka bërë aq shumë mirësi sa kjo grua. Ajo ishte nëna ime!"
Hadith

Në këtë vit u shpall ajeti kuranor që ndaloi konsumimin e alkoolit.[214] Nga gratë e nderuara të Resulullahut (a.s.), Zeinep binti Huzeime pati nderin të martohej me Profetin (a.s.). Por tetë muaj pas martesës, në muajin Rebiul-Ahir, ajo ndërroi jetë në moshën tridhjetëvjeçare.[215] Po ashtu, në këtë vit, Aliu r.a. dhe Fatime r.a. u bënë prindër për herë të dytë, pra ishte viti kur lindi hazreti Huseini. Gjithashtu, në këtë vit, bashkëshorti i i Ummu Seleme, i cili ishte plagosur në Betejën e Uhudit, ndërroi jetë duke lënë pas disa fëmijë. Në gjendje të vështirë dhe me moshë të thyer, Ummu Seleme u përball me sfida të mëdha. Nga mëshira e tij, Profeti ynë i dashur (a.s.) e martoi atë dhe e mori nën mbrojtjen e tij.[216]

Vdekja e Fatime binti Esed

Në këtë vit ndërroi jetë edhe nëna e Aliut r.a. Fatime binti Esed. Lajmi e pikëlloi shumë të dashurin tonë Profetin (a.s.), i cili tha: **"Sot ndërroi jetë nëna ime!"**. Sepse pas vdekjes së gjyshit të tij, Abdulmutalibit, Profeti (a.s.) ishte rritur nën kujdesin e saj. Njëkohësisht kur i erdhi pejgamberlliku Profetit (a.s.) ajo ishte nga të parët që e pranoi menjëherë Islamin. Për shkak të mirësive dhe kujdesit të saj të veçantë ndaj tij, Profeti (a.s.) e konsideronte atë si nënën e tij. Ndaj ai e kishte atë ne vënd të nënës dhe tregonte shumë respekt ndaj saj. Nga mëshira e tij e madhe, Profeti (a.s.) hoqi këmishën e tij të bekuar dhe urdhëroi që ajo të përdorej si qefin për të mbuluar trupin e saj. Pas namazit të xhenazes, Profeti (a.s.) tha se në këtë namaz ishin të pranishëm 70 mijë melekë.

Profeti (a.s.) e shoqëroi xhenazen e Fatime binti Esedit deri te varri, e vendosi trupin e saj në varr dhe e rregulloi varrin e saj me duart e tij. Profeti alejhi selam e ndjente ndarjen e saj sikur të ndjente ndarjen e nënës së tij ndaj gjatë varrimit ai sytë i kishte të mbushur me lot, ku lotët e tij të bekuar rani mbi varrin e saj. Përballë kësaj ngjarje Omeri (r.a.) e pyeti të Dërguarin e Allahut: "O i Dërguari i Allahut! Për këtë grua bëre gjëra që nuk i ke bërë për asnjë tjetër. Cila është arsyeja?", Profeti (a.s.) iu përgjigj: "(O Omer!). **Pas Ebu Talibit, askush nuk më ka bërë aq shumë mirësi sa kjo grua. Ajo ishte nëna ime! Edhe kur fëmijët e saj ishin të uritur, ndërkohë që unë nuk isha fëmi i saj, ajo para se të ushqente fëmijet e saj më ushqente mua. Kur ata kishin rroba të pluhurosura, ajo fillimisht më rregullonte mua dhe më lyente flokët me vaj trëndafili. Ajo ishte nëna ime! Ndaj pikëllimi im dhe përkujedesia ime ndaj saj është i njëjtë me nënën time. Xhibrili më lajmëroi, nga Allahu i Lartësuar, se 'kjo grua është prej banorëve të Xhenetit.'"**

Më pas, Profeti (a.s.) ngriti duart dhe u lut: **"O Allah, falma dhe shpërblema nënën time, Fatime binti Esedin. O Allah, tregoji asaj fjalët e argumentit (huxhxhetin), zgjeroja varrin dhe bëja të lehtë dhe të këndshme jetën në varr. O më Mëshirëploti ndër të gjithë të mëshirshmit! Për hir të të dërguarve të mëparshëm dhe pejgamberit Tënd, pranoje këtë lutje!"**

Të Tjera Ngjarje Të Rëndësishme Që Ndodhën Në Vitin E Katërt Të Hixhretit:

Djali gjashtëvjeçar i Osmanit r.a., nga bashkëshortja e tij Rukajje, Abdullahu ndërroi jetë. Abdullahu ishte nipi i Profetit (a.s.) i cili e fali namazin e xhenazes

[214] Ajetet e sures Maide 90-91.
[215] Taberânî, Mu'cemu'l Kebîr, XXIV, 58; İbni Kesîr, Sire, IV, 593.
[216] Ahmed bin Hanbel, Musned, VI, 392; Heysemî, Mecma'udh-dhevâid, IV, 68.

së nipit të tij dhe e vendosi vetë me duart e tij në varr. Profeti alejhi selam ishte aq i pikëlluar sa që lotët e pikëllimit i binin mbi varrin e tij të vogël. Më pas duke vendosur gurin e varrit me duart e tij të bekuara tha: **"Mëshira e Allahut bie mbi robërit e tij që janë të dhembshur dhe të ndjeshëm."**[217]

O i dashur! Ti je Mbreti i të dërguarve, sundimtari i nderuar,
O i dashur! Për të pafuqishmit, je burimi i përhershëm i bekimit,
O i dashur! Në oborrin hyjnor, je prijësi i të gjithëve,
O i dashur! Me vulën e "Le-amruk", je i përforcuar nga Zoti.

O i dashur! Ti je Ahmedi Mahmud dhe Muhamed,
O i dashur! Nga Zoti për ne je sundimtari i përkrahur.

Shkëlqimi i shpirtërave të pastër është prej gjenealogjisë sate.
Pelegrinazhi i engjëjve është pluhuri i pragut tënd.
Pasqyra e pamjes hyjnore është shikimi yt.
Ebu Bekri, Omeri, Osmani dhe Aliu janë miqtë e tu.

O i dashur! Ti je Ahmed, Mahmud dhe Muhamed,
O i dashur! Nga Zoti për ne je sundimtari i përkrahur.

Hutbja jote do të lexohet në minberin e amshueshmërisë.
Vendimi yt do të pranohet në Gjykatën e Ditës së Gjykimit.
Jehoja e ardhjes sate do të dëgjohet në Arshin e Zotit.
Emri yt i shenjtë do të përmendet në tokë e qiej.

O i dashur! Ti je Ahmed, Mahmud dhe Muhamed,
O i dashur! Nga Zoti për ne je sundimtari i përkrahur.

Shejh Galibi

[217] Hâkim, Mustedrek, IV, 51; SHemseddin SHâmî, Subulu'l-Hudâ, XI, 35.

Beteja e Vogël e Bedrit

BETEJA E VOGËL E BEDRIT

"Pasha Allahun! Në dorën e të Cilit është shpirti im, do të dal për betejë!"
Muhammedi a.s.

Kjo ngjarje njihet gjithashtu si Bedri Mevud (Bedri i Caktuar) dhe Bedri Sugra (Bedri i vogël). Kur Ebu Sufjani po largohej nga beteja e Uhudit i tha: "O Muhammed! Vitit tjetër, do të përballemi përsëri në Bedër." Atij, me udhëzimin e të Dërguarit të Allahut (sal-lallahu alejhi ve sel-lem) iu përgjigj Omeri (radijallahu anhu) duke i thënë "Ashtu qoftë."

Kur vajti në Mekka Ebu Sufjani filloi të mblidhte ushtri dhe të inkurajonte kurejshitët për luftë. Mirëpo Ebu Sufjani në zemrën e tij nuk dëshironte tu përballte më me myslimanët. Por për të mos u akuzuar nga populli për mosmbajtje të fjalës, ai i nxiste ata që të përgatiten për luftë. Në atë kohë, Naim ibn Mesud Eshxhai kishte ardhur në Mekkë dhe ju kishte thënë idhujtarëve për fuqinë dhe përgatitjen e ushtrisë islame në Medina. Pasi e dëgjoi Ebu Sufjani i tha atij: "O Naim! Nëse shkon në Medinë dhe e bind Muhamedin dhe shokët e tij, që ata të heqin dorë nga lufta, unë do të të jap njëzet deve trevjeçare. Garantori i premtimit tim do të jetë Suhejl ibn Amri (njeriu që i besonte me shumë Naimi)." Naimi e pranoi propozimin e Ebu sufjanit dhe u nis për në Medina.

Naimi sapo shkoi në Medinë, duke shkaktuar dyshime tek disa prej sahabëve, nisi të përhapi lajmin për numrin e madh të ushtrisë së mosbesimtarëve dhe për përgatitjet e tyre. Propaganda e Naimit ishte bërë shkak që sahabët të diskutonin për daljen apo mos daljen përballë mushrikëve të Mekkas. Gjatë konsultit më shabët Ebu Bekri dhe Omeri (radijallahu anhuma) kërkuan nga Profeti (sal-lallahu alejhi ve sel-lem) që të dilnin për betejë. I Dërguari i Allahut i gëzuar nga guximi dhe vendosmëria e sahabëve tha: **"Pasha Allahun! Në dorën e të Cilit është shpirti im, do të dal për betejë!"** Më pas Profeti (sal-lallahu alejhi ve sel-lem) e la Abdullah ibn Revaha si përfaqësues në Medinë dhe duke i dhënë flamurin Aliut r.a. u nis për betejë.

Nga ana tjetër, për të ndaluar përhapjen e Islamit, edhe mosbesimtarët kurejshitë me një ushtri prej dy mijë vetash e cila udhëheqej nga Ebu Sufjani u nis drejt Bedrit. Ndërsa i Dërguari i Allahut ishte nisur me një ushtri prej 1,500 sahabësh. Ushtria myslimane mbërriti në Bedër para se të mbërrinin mushrikët Mekkas. Mirëpo kur dëgjuan mushrikët se myslimanët kishin arritur para tyre, i kaploi frika. Për këtë arsye ata nuk guxuan të përballeshin me ushtrinë islame dhe ne vëndin e quajtur Merruz-Zahran u kthyen mbrapsht. Mirëpo kur u kthyen në Mekka Populli i Mekës nisi ti përqeshi dhe tallej me ta. Populli ju thoshte se ju nuk patët guxim ti dilni në betejë Muhammedit (alejhi selam) dhe shokëve të tij mirpë Ebu sufjani duke përmendur si justifikim thatësirën e atij viti ja arriti ta bind popullin që të hiqte dorë nga përqëshja e ushtrisë së tyre.

Nga ana tjetër Myslimanët duke mos ditur që ushtria mushrike ishte kthyer mbrapsht qëndruan për tetë ditë në Bedër. Myslimanët kishin vetëm dy kuaj, por kishin mallra të shumta. Më pas pasi u mësua se mushrikët ishin kthyer në Mekka këto mallra u shitën me çmime shumë të larta ku shabët fituan shumë të ardhura. Në mes të muajit Dhul-Ka'de, Profeti (sal-lallahu alejhi ve sel-lem) dhe sahabët e tij të ndershëm me gëzim dhe dinjitet u kthyen në Medine.

Beteja e Mureisisë



Beteja e Zatu'r-Rika

Beteja e Zatu'r-Rika' (ose Ekspedita e Zatu'r-Rika') ndodhi gjatë muajit Muharrem. Një njeri i cili kishte ardhur në Medinë për të shitur dele lajmëroi se fiset Beni Enmar dhe Beni Seleme po mblidhnin forca ushtarake kundër myslimanëve. Kur i mbërriti ky lajm Profetit Muhamed (paqja e Allahut qoftë mbi të), ai u ngrit organizoi sahabët dhe duke lënë Osmanin r.a. si përfaqësues në Medinë u nis për ne betejë. Spas transmetimeve thuhet se ushtri e Pejgamberit alejhi selam përbëhej prej 400 ose sipas një transmetimi tjetër ushtria e Pejgamberit alejhi selam prej 700 personash. Mirëpo kur mbërritën në vendin ku kishin marrë lajmin që i prisnin mushrikët (idhujtarët) nuk gjetën askënd. Aty përveç disa grave, nuk kishte mbetur askush pasi burrat e fisit prej frikës ishin fshehur nëpër male.

Perballë kësaj situate Pejgamberi alejhi selam i porositi shokët e tij se për shkak që armiku mund të ri organozohet aty duhet të qëndronin për 15 ditë. Pas 15 ditëve pasi u sigurua që mushrikët nuk kishin më mundësi të riorganizoheshin për sulm myslimanët u kthyen në Medinë.[218]

Beteja e Dûmetu'l-Cendel

Në fund të muajit Rebî'ul-evvel Profeti Muhamed (paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të), kishte marrë ankesa për disa fise që ndoheshin përgjatë rrugës tregtare Medine-Sham. Antartët e këtyre fiseve plaçkisnin udhëtarët dhe tregtarët që udhëtonin drejt Shamit. Profeti alejhi selam organizoi sahabët dhe në ekspeditën kundër tyre u nis me një ushtri prej 1.000 ushtarësh. Ndërsa në Medina si prijës u la Sibâ bin Urtufa-n.

Kur morën vesh fiset e armiqve që drejt tyre po vinte ushtria islame i kaoloi frika dhe u larguan prej aty. Kur arriti ushtria myslimane atje pa që fiset ishin larguar dhe pasi u siguruan që ajo zonë tashmë ishte e sigurtë u kthye në Medinë. Kur u kthyen myslimanët në Medina data kalendarike shënonte 20 të muajit Rebî'ul-âhir.[219]

Beteja e Mureisisë

Kjo betejë, ndryshe njihet edhe si **Beteja e Beni Mustalak**. Mureisî ishte emri i puseve të ujit që ndodheshin në Kudeid, njëkohësisht edhe emri i një kështjelle të ndërtuar për t'i mbrojtur puset e ujit. Ky vend shërbente gjithashtu si një pikë strategjike për fisin Beni Hudhâa.

Në vitin e pestë pas Hixhretit, kryetari i fisit Beni Mustalak, Haris bin Ebi Dirar, për të sulmuar Medinën, mblodhi një numër të madh luftëtarësh dhe i mirë armatosi ato. Ky lajm mbërriti shpejt te Profeti Muhamed (paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të), i cili me një ushtri prej 700 personash u nis menjëherë drejt tyre. Ushtria Islame e vendosi kampin e saj pranë puseve të Mureisit. Profeti a.s. para se të nis betejën i ftoi Mustallakët që të pranonin Islamin. Por ata refuzuan dhe papritmas nisën luftën duke hedhur shigjeta. Atëherë e Profeti a.s. dha urhdhër për një sulm të menjëhershëm. Sahabët u dhonën menjëherë në sulme dhe duke ju kundër përgjigjur sulmeve të armikut i vranë dhjetë luftëtarë të fisit Mustallak. Ndërsa kryetari i fisit u largua nga beteja dhe ja arriti të shpëtoi. Por e bija e tij, Berre, dhe 600 njerëz të fisit të tij u zunë rob. Pas betejës pasuri që la pas fisi Mustallak u mor si plaçkë lufte, e cila j unda luftëtarëve mysliman.

[218] Buhârî, Vudhu', 34; Ahmed bin Hanbel, Musned, III, 343; İbni Hishâm, Sîret, II, 203; Vâkıdî, Megâdhî, I, 396; İbni Sa'd, Tabakât, II, 61; Suheylî, Ravd-ul-unf, III, 400.
[219] Vâkıdî, Megâdhî, I, 403; İbni Sa'd, Tabakât, II, 62; Suheylî, Ravdu'l-unf, III, 414; İbni Kesîr, Sire, III, 177.

> *"Nuk kam parë grua më të bekuar dhe më të dobishme për njerëzit e saj sesa Xhuvejrijen."*
> ***Aisheja radijallahu anhu***

E bija e kryetarit të fisit Mustallak, Berre iu drejtua Profetit Muhammed duke i thënë: "O Muhammed! Unë kam bërë një marrëveshje me zotërinë që më zuri rob që ait ë më liroi në këmbim të nëntë dinarëve. Por unë nuk e zotëroj atë shumë, ndaj ju lutem të më ndihmoni!" Profeti alejhi selam edhe njëherë e tregoi mëshirën e tij dhe duke i dhënë 9 dinarë zoterisë që e kishte zënë atë rob e bleu Berren dhe më pas e liroi atë. Mirëpo Berre u mahnit nga ky veprim i të Dërguarit të Allahut ndaj ajo dëshmoi se e pranoi Islamin. Më vonë Berre duke u martuar me të Dërguarin e Allahut u nderua të arrinte pozitën e nënës së ummetit Islam.

Martesa e Profetit me Berre, të cilën ai më vonë e quajti Xhuveirije, u bë edhe shkak për lirimin e qindra robërve të tjerë. Sepse pas martesës se Berren me Pejgamberin alejhi selam Sahabët thanë: "Ne nuk mund të mbajmë në shërbim të afërmit e nënës sonë dhe familjes së Profetit alejhi selam." Kështu që ata i liruan të gjithë robërit që kishin marrë nga beteja e Mureisisë.

Sipas transmetimeve Aisheja r.a., e cila ishte një nga bashkëshortet e Profetit, tha për Xhuvejrijen: "Nuk kam parë grua më të bekuar dhe më të dobishme për njerëzit e saj sesa Xhuvejrijen."[220]

Më pas ushtria islame me një fitore të madhe u nis drejt Medinës së ndritur. Kjo betejë ndryshe shquhet edhe si betejat ku fiset idhujtare përreth u frikësuan dhe kuptuan se tashmë është shumë e rrezikshme lufta kundër myslimanëve. Sepse myslimanët me në krye Muhammedin alejhi selam tashmë ishin bërë të pa thyeshëm.

Disa ngjarje të rëndësishme që ndodhën në vitin e pestë të Hixhretit

Pas kthimit nga Beteja Mustalak, në Medina filloi të frynte një erë e fuqishme. Sahabët menduan se mos ndoshta armiku kishte ardhur në Medinë për ta plaçkitur atë. Por, i Dërguari i Allahut i qëtësoi shabët kur ju tha: **"Mos kini frikë! Medina është një vend i sigurt dhe në çdo cep të saj ka engjëj që e mbrojnë. Mirëpo, sot ka vdekur një hipokrit. Ai ishte miku i Ubejj bin Selulit, Zeid bin Furae."**

Në ekspeditën e Mullakës morën pjesë edhe nënat e besimtarëve, Aisheja dhe Umm Seleme. Mirëpo gjatë kthimit, hipokritët shpifën kundër Aishes.[221] Madje edhe disa myslimanë u mashtruan nga shpifjet e hipokritëve. Me zbritjen e ajeteve të Kuranit, të cilët lavdërojnë Aishen, u zbuluan dhe shpifjet e hipokritëve. Kur zbritën këto ajete I Dërguari i Allahut i tha: **"Gëzohu, o Aishe! Zoti i Madhërishëm të ka shpallur të pafajshme dhe ka dëshmuar për pastërtinë tënde."** Më pas Pejgamberi (paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të) mblodhi sahabët në xhami dhe duke hipur në hytbe ju lexoi atyre ajetet e sapo shpallura. Me zbritjen e këtyre ajeteve u zhdukën dyshimet në zemrat e besimtarëve, ndërsa hipokritët, të ciliët ishin ata që guxuan të shpifnin u ndëshkuan.

Po ashtu gjatë kthimit nga kjo ekspeditë, zbriti ajeti i tejemumit.[222]

Po në atë kohë në një vend të quajtur Salsala, vënd ky që ndodhet afër Medinës, Aishes r.a. i humbi gjerdani. Sahabët qëndruan në atë vënd derisa u gjet gjerdani i Aishes r.a.. Mirëpo në atë vend nuk kishte ujë. Sahabëve ju kishte mbaruar uji që

[220] Ibni Hishâm, Sîret, II, 294; Vâkıdî, Megâdhî, I, 413; İbni Sa'd, Tabakât, II, 74; Suh eylî, Ravdu'l-unf, IV, 13.
[221] Buhârî, Megâdhi, 34; Muslim, Tovbe, 68; Ahmed bin Hanbel, Musned, VI, 194; Vâkıdî, Megâdhî, II, 431.
[222] Mâide: 6.

kishin marrë me vete. Atë kohë I Dërguari i Allahut po pushonte duke vendosur kokën në prehërin e Aishes radijallahu anha. Sahabët ju afruan Ebu Bekrit dhe e lajmëruan atë për mungesën e ujit. Ebu Bekri u ngrit dhe shkoi tek Profeti alejhi selam, i cili ishte në gjumë. Atë moment Allahu i shpalli atij ajetin e tejemumit.

Profeti alejhi selam u zgjua dhe i lajmëroi Sahabët për ajetin e tejmumit. Sahabët morën tejemum dhe falën namazin e sabahut. Më pas ata u ngritën dhe nisën të përgatitën për tu kthyer në Medina mirëpo kur Aisheja hipi në deve dhe sapo deveja u ngrit poshtë deves u gjet gjerdani që i kishte humbur Aishes radijallahu anha.

Ti je dritë e botës dhe i dashuri i të Madhërishmit Allah,
Mos i lër të dashuruarit të ndahen qoftë edhe për një çast.

Le të mos largohet emri yt i bekuar nga gjuha ime asnjëherë,
Ai është shërim për zemrën time të brengosur, i jep qetësi për herë.

Shpresoj që çdo emër yti të ndërmjetësojë për na,
O Ahmed, o Mahmûd, o Ebu'l-Kâsım, o Muhammed Mustafâ!

Pasi atij iu tha "Ve'sh-SHems" dhe "Ve'd-Duhâ",
Në fytyrën dhe ballin tënd drita sikur dielli e hëna u pa.

Kanûnî Sulltân Suleimân (Muhibbî)

BETEJA E HENDEKUT

Kjo betejë njihet edhe si **Beteja e Ahzabit**. Fjala Ahzab është shumësi i fjalës hizb, që do të thotë grup, fis ose fraksion. Kjo betejë mori këtë emër sepse disa grupe u bashkuan për të luftuar kundër të Dërguarit të Allahut. Ishte viti i pestë i Hixhretit. Fisi hebre Beni Nadir, i cili për shkak të intrigave dhe prishjes së rendit ishte përzënë nga Medina, ishte shpërndarë në grupe të ndryshme; Disa prej tyre kishin shkuar në Shami, ndërsa disa të tjerët patën shkuar në Hajber. Por urrejtja dhe dëshira e tyre për hakmarrje ndaj Islamit dhe të Dërguarit të Allahut (paqja qoftë mbi të) ju kishte pushtuar zemrat e tyre. Udhëheqësi i tyre, Hujej bin Ahtab, bashkë me njëzet burra të rëndësishëm të fisit të tij, shkoi në Mekë dhe u takua me Ebu Sufjanin. Ku ata ranë dakord për të eliminuar të Dërguarin e Allahut dhe për të shkatërruar Islamin. Hebrenjtë i premtuan Ebu Sufjanit se: "Ne do të jemi me ju deri sa të eliminojmë Muhammedin (alejhi selam)!"

Ebu Sufjani, i cili ishte lideri i mushrikëve në Mekka edhe pse nuk dëshironte të luftonte me myslimanët ju tha hebrenjëve: "dijeni se kushdo që është armik i armikut tonë, është mik i yni. Por, që të ju besojmë që ju jeni të sinqertë në këtë betejë atëherë duhet të adhuroni idhujt tanë. Nëse e bëni këtë, atëherë ne do ta pranojmë sinqeritetin tuaj." Hebrënjtë sikur do herë tjetër duke u përkulur përpara idhujve edhe një herë e treguan intigritetin e tyre. Sepse hebrenjtë ishin njerëz që i besonin Librit (Teuratit), por në momentin që ata ju përkulën idhujve e tradhëtuan librin e tyre dhe u bënë të pa fe. Edhe më e keqja ishte se ata e dinin mirë që në librin e tyre tregohej I Dërguari i Allahut. Por ata në vënd se ti besonin duke braktisur librin e tyre u betuan në idhuj për të shkatërruar të Dërguarin e Allahut dhe fenë Islame.

Mushrikët u mashttuan nga intrigat hbrenje dhe menjëherë nisën përgatitjet për luftë dhe dërguan njerëz për të mbledhur forca nga fiset fqinje. Ndërkohë, edhe

hebrenjtë me intrigat e tyre u përpoqën të bindnin fise të tjera duke u premtuar pasuri dhe hurma. Paganët e Mekës formuan një ushtri prej katër mijë burrash, të pajisur me treqind kuaj, shumë armë dhe një mijë e pesëqind deve. Ebu Sufjani ngriti flamurin në Dâr-un-Nedve dhe ia dha Osman bin Talhasë. Ushtri i nis drejt Medinas dhe kur arriti në Merruz-Zahran ushtrisë idhujtare ju bashkuan edhe fiset me ta edhe fise të tjera si Suleymoğulları, Beni Fedhare, Beni Gatfân, Bini Murre dhe Beni Esed. Me bashkimin e këtyre fiseve ushtria idhujtare përbëhej prej dhjetë mijë luftëtarëve – një numër ky që për atë kohë ishte shumë i madh.

"Gëzohu, o Aishe! Zoti i Madhërishëm të ka shpallur të pafajshme dhe ka dëshmuar për pastërtinë tënde."
Pejgamberi a.s.

Gjatë kësaj kohe Fisi Hudhâa, i cili kishte marrëdhënie miqësore me të Dërguarin e Allahut (paqja dhe mëshira e Allahıut qoftë mbi të), kishte mësuar për organizimin e idhujtarëve dhe për të njoftuar situatën menjëherë dërgoi një lajmëtar në Medine. Lajmëtari mbërriti në Medina brenda katër ditësh dhe kur arriti i tregoi në detaje për situatën e paganëve të Dërguarit të Allahut.

I Dërguari i Allahut i cili për çështje të rëndësishme konsultohej me shokët e tij, i mblodhi menjëherë sahabët dhe diskutoi rreth mënyrës dhe vendit ku duhet të zhvillohej beteja me mushrikët. Çdo sahab dha sugjerimin e tij. Në këtë këshillim mori fjalën edhe Salman-i Farisi, i cili tha: "O i Dërguari i Allahut! Ne persët kemi një taktikë në lufte. Kur kemi frikë nga një sulm i papritur i armikut, përreth nesh hapim hendeqe dhe kështu mbrohemi prej armikut." Propozimi i Selmanit i pëlqeu të Dërguarit të Allahut dhe sahabëve të tij. Dhe në fund pasi u dëgjuan të gjitha sugjerimet u fendos që rreth vëndit ku do të zhvillohej beteja të hapeshin hendegje (kanalet ë thella)[223].

I Dërguari i Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të) së bashku me disa prej sahabëve, përcaktoi vendet ku do të hapeshin hendeqet. Ana jugore e Medinës ishte e mbuluar me kopshte dhe pemë të dendura, prandaj mundësia që paganët të sulmonin nga ajo anë ishte e vogël. Për më tepër, një forcë e vogël mund ta mbronte lehtë atë pjesë. Ndërsa në lindje ndodhej fisi hebre Beni Kurejdha, me të cilin ishte bërë një akt marrëveshje që nëse ata do të jetonin në Medina me myslimanët nuk duhet ti tradhëtonin këto të fundit. Kështu që u pa se paganët mund të sulmonin vetëm nga perëndimi dhe veriu. Sepse edhe nga përëndimi edhe nga veriu terreni ishte i hapur.

Tashmë strategjia ishe e qarte edhe vendet ku do të hapeshin hendeqet caktuan, vetëm se ti përvisheshin punës asgjë tjetër nuk ju kishte mbetur. Për këtë arsye u vendo që çdo sahabi do të kishte për detyrë të hapte rreth tre metra hendek. Thellësia e tij do të ishte rreth dy herë se gjatësia e një personi (rreth 3,5 metra), ndërsa gjerësia e tij do të ishte aq e madhe (rreth 7-8 metra) sa që një kalë me vrap nuk mund ta kapërcente. Koha ishte e shkurtër, sepse armiku tashmë kishte nisur marshimin nga Mekka drejt Medinës. Kushtu që hendeqet duhet të përfundonin sa më shpejt që kur të vinte armiku tu pengonte nga hendeqet.

I Dërguari i Allahut (paqja qoftë mbi të), së bashku me sahabët e tij të guximshëm, filluan punën duke thënë **"Bismil-lahirrahmanirrahim."** Për të përfunduar hendekun sam ë shpejt secili sahab punonte me përkushtim maksimal. Për hapjen e hendekut ishin edhe fëmijët morën pjesë, ku ata dhanë kontributin e tyre në këtë

[223] İbni Hishâm, Sîret, I, 220; Vâkıdî, Megâdhî, I, 441; İbni Sa'd, Tabakât, II, 65-74; Suheylî, Ravd-ul-unf, III, 415.

përpjekje. Dheu i nxjerrur nga hendeqet mblidhej në këtë kodër, ndërsa për t'u përdorur kundër armikut nga mali Sel silleshin gurë të mëdhenj. Ata që nuk kishin mjete për të bartur tokën, e mbartnin me cepat e rrobave të tyre.

I Dërguari i Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të) ashtu sikur të gjithë të tjerët punonte derisa lodhej.[224] Kur e panë sahabët lodhjen e tij, i thanë: "O i Dërguar i Allahut! Jeta jonë është e flijuar për ty! Mjafton puna jonë, ti pusho." Por ai iu përgjigj: **"Unë dua të punoj bashkë me ju që të jem pjesë e shpërblimit tuaj."**

Në kohën kur po hapej hendeku moti ishte tepër i ftohtë. Për më tepër, atë vit, për shkak të thatësirës, kishte shpërthyer edhe një urie e madhe. Gjetja e ushqimit ishte mjaft e vështirë. Përfshirë edhe vetë të Dërguarin e Allahut, të gjithë sahabët e nderuar ishin në një gjendje të jashtëzakonshme urie. Për t'u ndjerë më të fortë, ata lidhin gurë në bark dhe duke e shtrënguar stomakun me gure ata ja lehtësonin vetes dhimbjen e urisë.

I Dërguari si mëshirës për të gjitha botët, i dashuri ynë Pejgamberi alejhi selam, nuk mendonte për urinë e tij, por mërzitej dhe ndiente dhimbje të madhe kur shihte se si punonin sahabët në të ftohtë, të uritur dhe në vuajtje. Ai lutej me këto fjalë: **"O Allah! Nuk ka jetë tjetër për t'u dëshiruar, përveç jetës së Ahiretit. O Zot! Fali Ensarët dhe Muhaxhirët!"** Sahabët, që e donin Pejgamberin më shumë se jetën e tyre e qetësonin atë duke i thënë: "O i Dërguar i Allahut! Ne, për të përhapur fenë Islame, jemi ndjekës të përjetshëm në rrugën e Allahut." Vetëm kjo dashuri e ndërsjellë ishte ajo që fshinte nga rrënjët vuajtjet si uria, etja dhe shumë vështirësi të tjera.

Rënia e Një Rrufeje!

Për hapjen e hendekut gërmimi fillonte çdo ditë herët në mëngjes dhe zgjaste deri në mbrëmje. Një ditë, gjatë gërmimit, Ali bin Hakemi u lëndua në këmbë. E ngjitën mbi një kafshë dhe e çuan tek i Dërguari i Allahut. I Dërguari i Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të) para se ti jap mjekimin tha : **"Bismilahirrahmanirrahim"** dhe e mjekuar këmbën e tij ja ndaloi gjakderdhjen por si një mrekulli Ali bin Hakemit ju zhduk dhimbja menjëherë.

Puna për hapjen e hendekut vazhdonte pa ndërprerë. Gjatë gërmimit sahabët ndeshën në një pjesë shumë të fortë të tokës, të cilën nuk mundën ta vazhdonin gërmimin në atë vënd. Ata iu drejtuan të Dërguarit të Allahut dhe i treguan atij për situatën që kishin hasur. I Dërguari i Allahut shkoi në atë vend, kërkoi një enë me ujë dhe pasi piu një gllënjkë, e hodhi përsëri në enë dhe pastaj e spërkati atë vend të fortë ujë. Me pas sahabët filluan të gërmpjnë me goditje të çekanit, sepse pas spërkatjes së Pejgamberit a.s. vendi i fortë ishte bërë i lehtë për t'u gërmuar. Gjatë punimeve sahabët panë se barku i bekuar i Pejgamberit ishte zbuluar dhe vunë re se ai, nga uria, kishte lidhur një gur mbi stomakun e tij. Këtë skenë e pa edhe Jabir bin Abdullahu, i cili iu afrua të Dërguarit të Allahut dhe i tha: "O i Dërguar i Allahut! Prindërit e mi qofshin të flijuar për ty. Nëse më lejon, do të shkoj pak në shtëpi dhe do të kthehem shpejt."

Sipas transmetimeve Jabiri tregonse : ''Pasi me dha leje i Dërguari i Allahut, shkova në shtëpi dhe i thashë gruas time: 'E pashë të Dërguarin e Allahut në një gjendje urie të papërballueshme. A kemi diçka për të ngrënë?' Ajo më tha: 'Vetëm

[223] İbni Hishâm, Sîret, I, 220; Vâkıdî, Megâdhî, I, 441; İbni Sa'd, Tabakât, II, 65-74; Suheylî, Ravd-ul-unf, III, 415.
[224] İbni Sa'd, Tabakât, II, 83; Taberi, Tarih, III, 45, 51.

"Unë dua të punoj bashkë me ju që të jem pjesë e shpërblimit tuaj."
Muhammedi alejhi selam

një kec të vogël dhe pak elb.' Une e thera kecin ndërsa gruaja ime e bluajti elbin dhe duke e bërë miell dhe më pas e bëri atë brumë. Mishin e vumë në një enë dhe e futëm në furrë për t'u pjekur. Kur u ktheva, ajo më tha: 'Të lutem, mos na vër në siklet, sepse nëse vijnë shumë njerëz, ky pak ushqim nuk do tu mjaftonte.'' Unë shkova te Pejgamberi dhe i thash: 'O i Dërguar i Allahut! Së bashku me shokët tuaj ju ftoj për ushqip' Ai më tha: **'Thuaji gruas tënde që të mosi nxjerrë mishin ose bukën nga furra deri sa të arrij unë.**' Më pas i Dërguari duke u kthyer nga sahabët ju tha: **'O populli i Hendekut! Jabiri na ka përgatitur një gosti dhe na fton për të ngrënë. Ushqimi i tij është i bollshëm dhe i shijshëm. Ejani të shkojmë tek shtëpia e Jabirit!'** Jabiri thotë se kur pash që Pejgamberi alejhi selam i bëri thirrje të hapur shokëve të tij unë prej sikletit shkova te gruaja dhe i tregova çfarë ndodhi. Ajo më pyeti: ' a të pyeti i Dërguari i Allahut për sasinë e ushqimit?' I thashë: Po më pyeti, dhe unë i tregova.' Atëherë ajo më tha: 'Ai e di më së miri.'

Nuk vonoi shumë dhe i Dërguari i Allahut mbërriti në derën tonë ku ju tha sahabëve: **'Hyni brënda me qetësi.'** Nje grup sahabësh prej dhjetë vetash u futën brënda njëherësh.' I Dërguari i Allahut për bollëkun e ushqimit bëri dua dhe filloi të shpërndante nga ena në pjatat e sahabëve.[225] Të gjithë hëngrën derisa u ngopën, edhe pse mund të ishin më shumë se një mijë njerëz, askush nuk mbeti i uritur. Pas gjithë kësaj, ena dhe buka mbetën të paprekura. Edhe ne hëngrëm dhe më pas ua shpërndamë komshinjve."

Selman Farisiu ishte ideatori dhe heroi i hapjes së hendekut. Madje ai përpiqej dhe punonte sikur po punonin dhjetë veta bashkë. Mirëpo gjatë gërmimit së bashkë me shokët e tij hasën me një shkëmb të madh. shkëmbi ishte i bardhë dhe shumë i fortë. Ata me çdo mjet që kishin u përpoqën ta thyenin gurin, por nuk ja arritën ta thyenin. Madje mjetet që u përdorën për të thyer gurin, sikur ishin baltozat, kazmat dhe lopatat e tyre, u thyen. Atëherë kur pa Selmani që guri nuk po thyhej shkoi te i Dërguari i Allahut dhe i tha: '' O i Dërguar i Allahut! Prindërit e mi dhe jeta ime qofshin të flijuar për ty. Ne filan vënd po hapim hendekun, por kemi hasur me një shkëmb të madh dhe të fortë. İ përdorëm të gjitha mundësitë dhe mjetet tona po të gjitha mjetet tona u thyen dhe nuk po mundemi ta thyejmë gurin." I Dërguari i Allahut së bashku me Selmanin u nis dhe shkoi në vendin ku ishte shkëmbi. Ku arriti atje kërkoi kërkoi prej sahabëve një baltoz. Sahabët që ishin të mbledhur aty, ja sollën atij baltozin. Pejgamberi ynë i Dashur zbriti te shkëmbi dhe, duke thënë; **"Bismilahirrahmanirrahim"** e ngriti baltozin dhe e goditi shkëmbin fort. Një rrufe, e cila ndriçoi tërë Medinën, ra në gur ku e çau një pjesë të shkëmbit. Më pas I Dërguari i Allahut tha: **"Allahu Ekber!"** ku së bashku me të edhe sahabët filluan të thërrisnin tekbir. Pastaj e goditi përsëri gurin për herë të dytë. Një tjetër rrufe ndriçoi gjithçka dhe një tjetër pjesë u shkëput nga shkëmbi. Pejgamberi a.s. tha përsëri: **"Allahu Ekber!"** edhe sahabët e ndoqën me tekbir. Kur baltozi ra për herë të tretë, një tjetër rrufe e ndriçoi tërë vendin dhe shkëmbi u bë copë-copë. I Dërguari i Allahut tha sërish: **"Allahu Ekber!"** dhe kesaj here sahabët e shoqëruan atë me tekbir.

Tashmë guri ishte thyer Selman i zgjati dorën Pejgamberit a.s. dhe e ndihmoi atë të ngjitej nga hendeku duke i thënë atij; ''O i Dërguar i Allahut! Prindërit e mi dhe

[225] Buhârî, Megâdhi, 27; Dârimî, Mukaddime, 7; İbni Ebî SHeybe, Musannef, VII, 425.

jeta ime qofshin të flijuar për ty. Unë sot pashë diçka që kurrë më parë nuk e kisha parë. Por nuk kuptova se cila është domethënia e kësaj që ndodhi?" I Dërguari i Allahut iu drejtua sahabëve dhe i pyeti: **"A e patë atë që pa Selmani?"** Ata thanë: "Po, o i Dërguar i Allahut! Kur e goditët shkëmbin, pamë një dritë të fortë si rrufe. Kur ju thirrët tekbir, edhe ne thirrëm." Atëherë Pejgamberi tha: "Gjatë goditjes së parë, në dritën që u shfaq, më dolën përpara pallatet e Kisras në Medain. Xhebraili më dha lajmin se: 'Umeti yt së shpëjti do t'i zotërojë ato vende.' Në goditjen e dytë, pashë pallatet e kuqe të vilajetit të Romakëve (Shamit). Xhebraili më tha: 'Umeti yt së shpejti do ti marrë edhe ato troje.' Në të tretën, pashë pallatet e Sanasë (Jemenit). Xhebraili më dha lajmin: 'Edhe ato vende do t'i përkasin umetiti tënd.'" Më pas, i Dërguari përshkroi sarajin e Kisras në Medain. Selman, i cili ishte nga Medaini i tha: " O i Dërguar i Allahut! Jeta ime qofte e flijuar për ty. Betohem në Allahun që të dërgoi Kuranin dhe me fenë e vërtetë se ato pallate janë pikërisht mu ashtu siç i përshkruat ju." Pejgamberi ynë i Dashur i tha**:"O Selman! Shami do të çlirohet. Herakliu do të arratiset në skajin më të largët të vendit të tij dhe ju do të jeni ata që do të sundoni tërë Shamin. Juve askush nuk do të mund t'ju ndalë. Gjithashtu edhe Jemeni do të çlirohet. Po ashtu, edhe ato troje të Lindjes që kanë mbetur pa u çliruar do të çlirohen. Madje edhe Kisra do të vritet. Pas meje Allahu do t'ua japë juve këto fitore."**[226] Transmetohet se Selman Farisiu (r.a.) ka thënë: "I pashë të gjitha me sytë e mi që u realizuan përgëzimet që na pat thënë i Dërguari i Allahut."

Ushtria idhujtare tashmë po i afrohej Medinas, por edhe dhe hendeku po gërmohej me shpejtësi të madhe për t'u përfunduar sa më parë. Sahabët, në rast nevoje, për ta ndërprerë punën merrnin leje nga Profeti (paqja qoftë mbi të), dhe pasi kryenin nevojat e tyre, ktheheshin menjëherë për të vazhduar punën aty ku e kishin lënë. Vetëm munafikët (hipokritët) ishin ata që vepronin me plogështi të madhe. Ata kur donin shkonin për të punuar dhe kur dëshironin largoheshin pa marrë leje nga Prefeti alejhi selam. Përveç kësaj, ata talleshin me përpjekjet e sahabëve, madje ata talleshin edhe me përgëzimet e dhëna nga i Dërguari i Allahut (paqja qoftë mbi të). Ata thoshin:" Habitemi me këtë gjendjen tuaj! Ne, duke u strehuar në hendekë, po fshihemi nga frika ndaj armikut, ndërsa ai na premton pallatet e Jemenit, Romës dhe Persisë." Për këtë arsye zbriti ajeti kuranor ku flet për sahabët që thotë: **''Besimtarë të vërtetë janë vetëm ata që besojnë në Njësinë e Allahut dhe në të Dërguarin e Tij** (Muhammedin sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem)**. Dhe kur ata janë me të në një çështje që ndikon mbi të gjithë bashkësinë, nuk largohen derisa të kërkojnë lejen e tij. Vërtet se ata që kërkojnë lejen tënde, mu këta janë ata të cilët vërtet kanë besuar në Allahun dhe në të Dërguarin e Tij. Kështu pra, në qoftë se ata kërkojnë lejen tënde për ndonjë çështje të tyre, lejo kë të duash dhe lute Allahun për falje të tyre. Sigurisht që Allahu është gjithnjë Falës i Madh, Mëshirëplotë.''** (Nur: 62)

Ndërsa për munafikët, u shpall një tjetër ajet, ku Allahu i Lartësuar thotë**: ''Mos e bëni thirrjen ndaj të Dërguarit** (Muhammed sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) **mes jush, siç thërrisni ju njëri-tjetrin. Allahu i di ata të cilët shkëputen vjedhurazi duke u fshehur** (pas ndonjë arsyeje pa marrë leje për t'u larguar nga i Dërguari i Allahut)**. Dhe le të kenë mendjen ata të cilët nuk pajtohen me urdhërin e të Dërguarit** (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem - Sunetin e tij, me rrugën e tij, zbatimin në jetë të Urdhërave të Allahut, të Islamit). **Që të mos bjerë mbi ta ndonjë Fitneh**

[226] Vâkıdî, Megâdhî, I, 450; İbni Kesîr, Sire, III, 159; Beyhekî, Delâil-un-nubuvve, III, 482

(mosbesim, sprovë, vështirësi, ose fatkeqësi, tërmet, vrasje, nënshtrim nga tiranë etj)**, ose t'u jepet një ndëshkim i dhimbshëm. Të jeni plotësisht të sigurt se Allahut i takon gjithë ç'është në qiej dhe në tokë. Padyshim që Ai e di mirë gjendjen tuaj dhe** (Ai di) **Ditën kur ata do të sillen prapë tek Ai, pastaj Ai do t'i njohë ata me ato gjëra që ata i vepruan. Dhe Allahu është për gjithçka i Gjithëditur."** (Nur: 63-64)

"O populli i Hendekut! Jabiri na ka përgatitur një gosti dhe na fton për të ngrënë. Ushqimi i tij është i bollshëm dhe i shijshëm. Ejani të shkojmë tek shtëpia e Jabirit!"
Muhammedi alejhi selam

Ishte dita e gjashtë e fillimi të gërmimit të hendekut. Të gjithë me përkushtim të plotë e kishin përfunduar punën e tyre. Por, për shkak të mungesës së kohës, një pjesë nuk ishte gërmuar aq thellë dhe aq gjerë sa duhej. Profeti ynë i Dashur (paqja qoftë mbi të) tha me shqetësim: **"Idhujtarët nuk mund të kalojnë nga asnjë vend tjetër përveç këtij."** Ndaj për të siguruar mbrojtjen e asaj zone ai urdhëroi shabët dhe i vendosi roje në atë zonë.

Allahu Është Mbrojtësi Më i Mirë

Për ushtrinë e idhujtare Medina ishte afruar shumë. Huiej, udhëheqësi i fisit hebre Beni Nadîr, i tha Ebu Sufjanit se: "Hebrenjtë e fisit Beni Kureidha në Medine janë në marrëveshje me muslimanët, por unë mund ta mashtroj udhëheqësin e tyre, Ka'b bin Esedin dhe ja arrij ta tërheq në anën tonë." Ebu Sufjani i tha: "O Huiej! Shko menjëherë te Ka'b bin Esedi dhe binde atë që të thyejë marrëveshjen me muslimanët dhe të mbajë anën tonë." Mirëpo një nga pikat e marrëveshjes mes hebrenjve dhe muslimanëve ishte që: **"Nëse një ushtri armike sulmon Medinen, hebrenjtë dhe muslimanët do të luftojnë së bashku kundër armikut."**

Huiej fshehurazi u largua nga ushtria e idhujtarëve dhe kur erdhi nata ai shkoi në shtëpinë e Ka'b bin Esedit, i cili ishte udhëheqësi i fisit Beni Kurejdha. Kur shkoi atje e lajmëroi atë duke i thënë: "O Kab! Bashkë me fiset Kinane dhe Gatfan kam sjellë me vete tërë ushtrinë e Kurejshëve. Unë i binda ata kundër Muhammedit (a.s.) dhe së bashku me ta kemi formuar një ushtri prej dhjetë mijë burrash. Muhamedi dhe shokët e tij nuk kanë asnjë shans për të na shpëtuar. Ndaj dije se ne jemi betuar që të mos largohemi nga këtu pa i shkatërruar ata plotësisht!" Kabi, duke shprehur shqetësimin e tij, tha:"Nëse Muhamedi dhe shokët e tij nuk do të munden nga ju. Atëherë Kurejshët dhe Gatfanët do të kthehen në vendet e tyre, ndërsa ne do të mbetemi të vetëm këtu. Ndaj kam frikë se do të na vrasin të gjithëve!" Huiej gjëja për ta siguruar atë i tha: "O Kab kërko si garanci që Kurejshët dhe Gatfanët të lënë ty peng shtatëdhjetë burra. Për sa kohë që këta pengje janë tek ti, ata nuk mund të largohen. Nëse ata mposhten dhe largohen, unë nuk do t'ju braktis ju. Kështu që çdo fatkeqësi që mund t'ju godasë ju, do të më godasë edhe mua." Huiej, duke i binduar ata të thyejnë marrëveshjen me muslimanët, me këto fjalë e mashtroi Kab bin Esedin dhe hebrenjtë e tjerë të Medinas. Pasi ja arriti qëllimit Hujej u kthye në kampin e ushtrisë së idhujtarëve dhe i informoi ata se Beni Kurejdha e kishte pranuar propozomin e tij dhe se ata tashmë ishin të gatshëm t'i sulmonin myslimanët nga prapa.

Në ditën e shtatë, ushtria e idhujtarëve, e përbërë nga dhjetë mijë burra, arriti në veri dhe veri-perëndim të Medines. Kur mbërritën aty ata zhvendosën duke ngritur kampin e tyre përballë hendekut. Qëllimi i tyre ishte të shkatërronin Medinen dhe të eliminonin të Dërguarin e Allahut (paqja qoftë mbi të) së bashku me shokët e tij. Pra qëllimi i tyre ishte të zhduknin Islamin. Ushtri idhujtare dukej një ushtri e madhe dhe e fuqishme, e cila mburrej se tashmë idhujtarët me ushtrinë e tyre ishin

të pamposhtur. Por kur panë hendekun, një pengesë që nuk e kishin parashikuar dhe nuk e kishin hasur kurrë me parë, nga befasia humbën moralin.

"O Selman! Shami do të çlirohet. Herakliu do të arratiset në skajin më të largët të vendit të tij dhe ju do të jeni ata që do të sundoni tërë Shamin. Juve askush nuk do të mund t'ju ndalë. Gjithashtu edhe Jemeni do të çlirohet. Po ashtu, edhe ato troje të Lindjes që kanë mbetur pa u çliruar do të çlirohen. Madje edhe Kisra do të vritet. Pas meje Allahu do t'ua japë juve këto fitore."
Muhammedi alejhi selam

Hendeku ishte aq i gjerë, sa as një kalë i shpejtë nuk mund ta kalonte atë me një kërcim. Kushdo që binte brenda tij, nuk mund të dilte lehtë, sidomos nëse ishte i pajisur me armaturë. Kur Profeti ynë (paqja qoftë mbi të) dëgjoi për afrimin e ushtrisë së idhujtarëve, menjëherë mblodhi shokët e tij, të cilët ishin të lodhur nga punë e pandërprerë për plot gjashtë ditë. Ai, duke lënë malin dhe Medinen në anën e pasme, e ngriti kampin e tij në këmbët e malit Sel. Ndërsa hendekun e la ndërmjet tij dhe armikut që ndodhej përtej tij. Ndërsa për kujdesje në Medine, ai caktoi Ibn Umm Mektumin. Githashtu për të mbrojtur qytetin gratë dhe fëmijët i vendosi mbi fortesat e qytetit. Ushtria muslimane përbëhej nga tre mijë burra, prej të cilëve tridhjetë e gjashtë ishin kalorës. Flamujt mbaheshin nga Zaid bin Harithi dhe Sad bin Ubadah (Allahu qoftë i kënaqur me ta).[227]

Profeti (paqja qoftë mbi të) e kishte ngritur çadrën e tij prej lëkure në këmbët e malit Sel. Ndërsa sahabët i kishte ngarkuar me detyra që ata të vëzhgonin me kujdes lëvizjet e ushrisë armike. Në këtë kohë, Omeri (Allahu qoftë i kënaqur me të) erdhi dhe i tha: "O i Dërguari i Allahut! Kam dëgjuar se hebrenjtë e Beni Kurejdhas kanë thyer marrëveshjen dhe po përgatiten të luftojnë kundër nesh!" I Dërguari i Allahut, i prekur thellë nga ky lajm i papritur, tha: **"Hasbunallahu ve ni'mel vekil" (Na mjafton Allahu, Ai është mbrojtësi më i mirë).** Situata ishte shumë e vështirë. Ushtria muslimane tashmë gjendej mes dy zjarreve. Ajo në veri dhe perëndim kishte idhujtarët, ndërsa në juglindje kishte tradhëtarët e fisit hebre Beni Kurejdha.

Pas lajmeve që fisi hebre Beni Kurejdha kishte tradhtuar dhe po përgatitej për luftë, i Dërguari i Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të) për të mbledhur informacione rreth situatës urdhëroi Zubeir bin Avamin. Zubejri shkoi në kështjellën e tyre dhe, kur u kthye tha; "O i Dërguar i Allahut! I pashë duke riparuar kështjellën nga jasht ndërsa nga brënda ata ishin duke u stërvitur për luftë, madje edhe bagëtitë i kishin mbyllur brënda në kështjellë." Atëherë, i Dërguari i Allahut, për ti këshilluar ata dhe për t'i ftuar që të rinovonin marrëveshjen me muslimanët dërgoi tek Beni Kurejdha pesë sahabë: Sa'd bin Muadh, Sa'd bin Ubade, Havvat bin Xhubejr, Amr bin Auf dhe Abdullah bin Revaha.[228]

Mirëpo kur mbërritën sahabët në kështjellën e fisit Beni Kurejdha hebrenjtë jo vetëm që refuzuan thirrjen e tyre por edhe nisën ti ofendonin. Ata i thanë shabëve me përbuzje: "Ne sot nuk njohim asnjë marrëveshje. Ndaj ne sot jemi me vëllezërit tanë që ju i dëbuat nga tokat e tyre! Kush është Muhamedi? Ne nuk kemi asnjë marrëveshje me të. Madje ne së bashku me vëllezërit tanë jjemi betuar se do të sulmojmë Muhammedin dhe dhe do ta vrasim atë!"

Pas kësaj bërballjeje përbuzëse të intrigantëve hebrenj sahabët u kthyen te i Dërguari i Allahut dhe, në një mënyrë të koduar që të mos kuptohej nga të gjithë, i raportuan atij tradhëtinë e hebrenjëve. I Dërguari i Allahut ju tha: **"Mos e përhapni lajmin që ky lajm të mbetet i fshehtë. Nëse lind nevoja tregojani vetëm atyre**

[227] İbni Sa'd, Tabakât, II, 67.
[228] Vâkıdî, Megâdhî, I, 460; Beyhekî, Delâil-un-nubuvve, IV, 8

që duhet ta dine. Sepse ndër strategjitë e luftës është edhe hilja."[229]

Sahabët ishin vendosur në gadishmëri dhe po prisnin udhëzimet e mëtejshme të të Dërguarit të Allahut. I Dërguari i Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të) ju afrua shabëve dhe në formë motivimi thirri: **"Allahu Ekber! Allahu Ekber!"** Sahabët menjëherë ju bashkuan atij në thirrjen e tekbirit, duke lartësuar emrin e Allahut dhe duke mbjellë frikë në zemrat e armiqve përtej hendekut. Mirëpo kur e dëgjuan idhujtarët brohorizmin dhe motivin e sahabëve thanë: "Si duket Muhamedi dhe shokët e tij kanë marrë një lajm të mirë." I Dërguari i Allahut u tha sahabëve: **"O Sahabë! Gëzohuni me ndihmën dhe fitoren që Allahu ju ka premtuar!"**

Edhe pse ushtria muslimane ishte përballur më parë me sfida të mëdha, sikur ishin betejat e Bedrit dhe Uhudit, situata e krijuar ne Hendek ishte aq sa e frikshme po aq dhe e vështirë. Sepse ushtria e idhujtarëve ishte akoma më e madhe dhe më e fuqishme se më parë. Ndërsa moti ishte i ftohtë por edhe uria ishte aq e rëndë sa që edhe vetë i Dërguari i Allahut për të mos ndjerë urinë kishte lidhur gurë në bark.

Pavarësisht situates shabët nuk u tundën nga besimi, as nga besa dhe vendosmëria që i kishin dhënë Allahut dhe të Dërguarit të Tij.

Dueli i Hazreti Aliut me Amr bin Abdu'd dhe epërsia e muslimanëve në betejën e Hendekut

Udhëheqësit e Kurejshëve dhe prijësit e fiseve aleate që kishin ardhur me ta po kërkonin të kalonin hendekun. Por ata panë se hendeku nuk kalohej ndaj nisën të kërkonin rreth hendekut se mos gjejne një vend të përshtatshëm që mund ta kalonin atë. Pasi e vëzhguan hendekun në të gjithë gjatësinë e tij, vendosën të sulmonin në një vend ku gjerësia ishte më e vogël. Përshkak të kohës së shkurtër sahabët nuk kishin arritur ta zgjeronin sa duhej fundin e hendekut, pikerisht vëndi ku idhijtarët planifikuan të kalojnë në sulm. Komandantët e Kurejshëve pasi e zbuluan atë dobësi pyetën ushtrinë se: "Kush mund të kalojë nga ky vënd dhe të nisë sulmin?" Prej tyre dolën vullnetarë pesë kalorës guximtarë, ku ata morën vrull dhe me një kërcim të fuqishëm e kaluan hendekun. Mirëpo veç këtyre kalorësve pjesa tjetër e kalorësve nuk arriti të kalontë hendekun ndaj mbetën në anën tjetër të hendekut.

Ndër pesë kalorësit që kaluan hendekun më i frikshmi ishte mushriku Amr bin Abdu. Amri për fuqinë dhe guximin e tij ishte një luftëtar i njohur. Ai ishte i veshur me një mburojë hekuri që i mbulonte atij tërësisht trupin. Amri nisi të sfidoi dhe të mbjell frikë frikë në radhët e kundërshtarëve. I ngjitur mbi kalë, i mirëmbuluar dhe mirë armatosur nisi të ju bëjë thirrje nënçmuese myslimanëve ku ju thoshte: "Cili nga ju guxon. Ta lërë gruan pa burrë le të më dalë përballë në dyluftim?" Amri dukej i frikshëm por Aliu (radijallahu anhu) me plot guxim dhe besim, iu drejtua të Dërguarit të Allahut dhe i tha: "O i Dërguar i Allahut! Më lejo që unë të dal përballë tij." I Dërguari i Allahut bëri sikur nuk e dëgjoi zërin e Aliut r.a. dhe duke ju drejtuar shabëve pyeti; **"kush do tja ndal zërin këtij mushriku?"** Mirëpo Aliu me këmbëngulje e ripërsëriti kërkësën e tij. Atëherë i Dërguari i Allahut i dha Aliut zirekun e tij ja lidhi atë në kokë dhe e përgatiti atë me duart e tij për dueli dhe u lut: **"O Allah! Në Bedër më vdiq kushëriri Ubejde dhe në Uhud më ra dëshmor axha Hamza. Tani më ka mbetur vetëm ky kushëri im, Aliu. Ndihmoje dhe ruaje atë kundër armikut!"**

[229] Buhârî, Cihâd, 157; Ebû Dâvûd, Cihâd, 101; Tirmidhî, Cihâd, 5; İbni Mâce, Cihâd,

BETEJA E HENDEKUT



"O Sahabë! Gëzohuni me ndihmën dhe fitoren që Allahu ju ka premtuar!"
Hadith

Nën shoqërinë e duave dhe tekbireve, "Luani i Allahut," Aliu r.a. u përball ballë për ballë me Amr ibn Abdudin, i cili mbi kalë dukej si ndonjë gjigant i fuqishëm. I nga koka te këmbët mbuluar me armaturë, ku vetëm sytë i dukeshin, Amri nga larg nuk e njohu se kush ishte përballë tij. Ndaj dhe e pyeti: "Kush je ti?" "Unë jam Ali ibn Ebi Talibi." Ju përgjigj ai. Amri habit nga guximi dhe trimëria e djaloshit që i doli përballë, por edhe i dukej vetja i nënçmuar përballë djaloshit Ali ndaj ai dhe i tha: "O biri i vëllait tim! Babai yt është miku im. Ndaj unë nuk dua të derdh gjakun tënd.'' Dhe duke ju ridrejtuar shabëve ripërsëriti fjalër; ''A nuk ka ndonjë burrë tjetër nga fisi kurejshit që të më dalë përballë?"

Këmbengulja dhe guximi i Aliut r.a. u duk kur i tha "O Amr! Vallahi! Unë jam ai qe dëshiron më së shumti derdhjen e gjakut të një mushriku zullumqar sikur ti. Por ty që të dukët vetja burrë a nuk e din se ne duhet të jemi të barabartë në përballje? Ti trimërohesh përse je mbi kalë dhe ndërsa muma më nënçmon përsë unë jam këmbësor. Ja pra që kjo nuk i shkon përshtat burrërisë dhe trimërisë tëndë!" Kur i dëgjoi Amri këto fjalë zbriti nga kali, dhe prej mushriku zullumqarë që ishte në shenjë nënçmimi dhe egërsie më shpatën e tij ja preu këmbët kalit. Prerja e këmbëvë të kalit e pikëlluan Aliun r.a. sepse Pejgamberi a.s. i Dërguar si mëshirë për mbarë universin i ksihte edukuar Sahabët, një prej të cilëve ishte edhe Aliu r.a. se kafshët asësi nuk duhet të dhunohen. Pra Aliu r.a. u prek shumë kur pak alin të binte në toke dhe të ulurinte nga dhimbjet që i shkaktoi Amri.

Gjithsesi Aliu radijallahu anhu nuk e prishi karakterin, moralin dhe vlerat e burrërisë prej myslimani ndaj i e pyeti: "O Amr! Kam dëgjuar se ti betohesh që ja plotëson dy dëshira kujtdo nga Kurejshët që të dalë përballë. A është e vërtetë kjo?" Amr tha: "Po, e vërtetë është." Atëherë Aliu r.a. vazhdoi ti thotë: "O Amr! Kërkesa ime e parë është që ti të heqësh dorën nga dy luftimi dhe të besosh në Allahun dhe të Dërguarin e Tij." Mirëpo Amri jupërgjigj me ironi duke i thënë: "Lëri këto fjalë! Nuk më duhen mu këto gjëra!" Mirëpo Aliu r.a. me qetësi shtoi: "Atëherë dëshira ime e dytë është që të ndalosh luftën dhe të kthehesh i sigurtë në Mekke. Dije se nëse Resulullahu fiton në këtë betëj kthimi yt pa luftë në Mekke do të konsiderohet si ndihmë ndaj tij." Por Amri më kryeneçsinë e tij i tha: "As këtë nuk e pranoj. Unë them se kam bërë betim që nuk do të ndalem pa marrë hak. Ti më thua hiq dorë!"

Tashmë veç dy luftimit nuk kishte mbetur rrugë tjetër. Sepse Amri i refuzoi të gjitha opsionet që i ofroi Aliu, i cili i tha: "O Amr! Tashmë për mua ti mbdetesh armik i Allahut! Ndaj nuk ka mbetur tjetër veçse përleshja për jetë a vdekje." Amri me një të qeshur ironike i tha: "Unë nuk do të besoja kurrë që nga fiset arabe do të dilte përballë meje ndonjë trim apo guximtarë. Por sot pashë që para meje ndodhet një djallosh guximtar. Të cilin unë nuk dua të ta vras, pasi babai yt ishte mik i imi." Ky ishte dhe fakti që Aliu i kishte kërkuar Amrit të hiqte dorë nga lufta sepse ai e dinte që Amri ishte shok i babait të tij. Ndaj ai i tha ''O Amr! Ne nuk heqim dorë nga lufta përderisa armiku ynë vazhdon të mbetet armik i Allahut dhe të dërguarit të tij. Ndaj sot është kohë që unë duke të eliminuar ty do të eliminoj të gjitha dhunërat dhe mizoritë tuaja që i shkaktoni të Dërguarit të Allahut.''

Mizoria dhe kryeneçsia e Amrit nuk kishte më durim të dëgjonte fjlatë e Aliut r.a. ndaj ai ngriti shpatën dhe goditi atë me gjithë forcëën që kishte. Aliu r.a. me një lëvizje dhe dredhi të shpejtë ja arriti ti shpëtoi sulmit të Amrit. Por goditja e tij ishte aq e fuqishme sa që ja theu mburojën Aliut dhe plagosi lehtë atë. Mirëpo

"Një goditje me shpatë e Aliut është më e vlefshme se gjithë adhurimet e njerëzve dhe xhindëve."
Hadith

edhe pse goditja e Amrit ishte e fuqishme Aliu nuk e humbi kontrollin dhe me një taktikë shkathtësie duke thirrur **"O Allah!"** Aliu e goditi me Amrin në këmbë dhe ja preu këmbët atij, mu ashtu sikur ai ja kishte prerë këmbët kalit. Amri ra përtokë me këmbë të prera dhe filloi të uluriste mu sikur kali i tij. Me këtë, Islami fitoi një betejë madhështore, ndërsa tekbiret **''Allahu Ekber! Allahu Ekber...!''** të ushtrisë myslimane jehuan mbi gjithë vendin.

Aliu ju afru Amrit ti priste kokën por ai në vënd se të pëndohej për gjëndjen që ishte e pshtyu Aliun në sy. Atëherë Aliu hoqi dorë nga prerja kokës atij. Amri nga dhimbjet bërtistë sikur të ishte një egërsirë ndërsa Aliu radijallahu anhu u nis të kthehej drejt shabëve. Amri nisi ti lutej duke i thënë '' o djalosh prema kokën! Më shpëto nga kjo turpsi që mua më mposhti një fëmi! Ndaj prema kokën.'' Por Aliu nuk ja vuri veshin për nje momnet u ndal dhe pastaj ja preu kokën atij. Kur e pyetën më vonë sahabët Aliun për këtë veprim ai ju përgjigj me fjalët; ''Kur Amri më pshtyu ne fytyrë unë u ndala sepse nefsi im prej neverisë më tha prija kokën, ndërsa unë atij qafiri kokën do ja prisja vetëm për Allahun. Ndaj frika se nefsi im prej neverisë mos e kalon atë që kërkonte Allahu u ndala derisa e mora nefsin tim nën këmbët e mia. Dhe pasi e mora nefsin tim nën këmbët e mia u ktheva dhe për Allah ja preva kokën atij qafiri.''

Kur panë shokët e Amrit se ky i fundit e humbi betëjën dhe duke përfituar edhe prej distances së largët të shokëvë të Aliut ju sulën këtij të fundit për ta mbytur. Por shokët e Aliut erdhën me shpejtësinë e erës dhe i dolën në ndihmë atij. Shokët e Aliut radijallahu anhuma u përballen me shokët e Amrit dhe për një kohë të shkurtër i mposhtën ata. Me humbjen e Amrit dhe shokëve të tij mushrikë ubënë shkak që pjesa tjetër e ushtrisë idhujtare ta ndjejë veten në kaos. Ndërsa komandanti i tyre që në fillim humbi çdo shpresë të betejës. Ndërsa nga ana tjetër kjo fitore u shoqërua me thirrje të fuqishme gëzimi nën shoqërimin e tekbirëve **"Allahu Ekber!"** Tekbirët e myslimanëve u bënë shkak që paniku përfshiu ushtrinë e idhujtarëve. Njëkohësisht kjo fitore edhe një herë tregoi epërsinë e besimtarëve dhe ishte një nga momente kyçe që ndikoi në përmbysjen e planit të armikut në betejën e Hendekut.

Strategjia e hendekut dhe mbrojtja heroike e muslimanëve në Medinë

Pas triumfit të Aliut r.a. në mposhtjen e Amrit lufta kishte marrë një formë të qartë. Hendeku, duke i kufizuar palët në përleshje me shigjeta dhe gurë, pengonte përplasjet trup më trup. Mirëpo kjo mënyrë e përballjes nuk po sillte ndonjë rezultat të dukshëm, vetëm se po zgjaste më shumë kohën e luftës. Ushtria idhujtarë pasi kishte kuptuar që kështu nuk mund ta arrinin fitoren, vendosi që nga të gjitha pikat e hendekut të kalontë e tëra në sulm. Nga ana tjetër, ushtria e muslimanëve e përbërë prej tre mijë vetash i rezistonte përpjekjeve të ushtrisë idhujtare e cila përbehej prej 10 mijë vetave. Pra tre mijë myslimanë me shigjeta dhe gurë po përpiqej të pëngontë dhjetë mijë mushrikë që të mos kalonin hendekun. Kështu përpjkeja vazhdoi deri në mbrëmje.

Kur u errësua nata i Dërguari i Allahut (paqja e Allahut qoftë mbi të) në pika të ndryshme të hendekut vendosi roje. Ndërsa ai vetë për të mbikëqyrur situatën qëndroi në një nga pikat më të dobëta të hendekut. Në të njëjtën kohë për të parandaluar ndonjë sulm të papritur nga hebrenjtë apo idhujtarët, ai dërgoi një grup prej pesëqind vetash në Medine. Kjo masë sigurie synonte të siguronte gratë dhe fëmijët nga ndonjë sulm i mundshëm. Ndërkohë, fisi hebre Beni Kureidha për

të kryer sulme natën i kërkoi Huiej bin Akhtabit që të sillte dy mijë luftëtarë nga radhët e idhujtarëve. Ata planifikonin të sulmonin gratë dhe fëmijët të cilët ishin të pambrojtur në Medina. Megjithatë, patrullat muslimane që patrullonin natën dhe tekbiret e tyre të fuqishme ngjallën frikë të madhe tek ata. Si pasojë, hebrenjtë u tërhoqën në kështjellat e tyre, duke pritur një mundësi më të mirë. Herë pas here, grupe të vogla përpiqeshin të futeshin fshehurazi në Medine. Një grup nga Beni Kurejdha i përbërë prej dhjetë burrash, të udhëhequr nga një prej krerëve të tyre, Ghazali, arriti të afrohej pranë një ndërtese ku ndodheshin gratë dhe fëmijët e shabëve. Mes tyre ishte edhe Safijja, halla e të Dërguarit të Allahut. Në këtë situatë kritike, Safijja veproi me një guxim të jashtëzakonshëm. Ajo kërkoi që të gjithë të qëndronin të heshtur dhe më pas zbriti poshtë me një shkop të madh në dorë dhe një thikë në brez. Pasi e përgatiti veten që ajo të dukej si burrë, doli nga dera dhe iu afrua një prej sulmuesve që kishte arritur të depërtonte deri në oborr. Me një goditje të fuqishme, ajo e rrëzoi përdhe dhe e vrau atë menjëherë. Më pas, kapi kokën e tij dhe e hodhi drejt shokëve të tij të cilët po sulmonin nga jashtë.

Kur hebrenjtë panë kokën e mikut të tyre, ata u frikësuan jashtë mase dhe ikën menjëherë. Duke ikur, ata mërmëritnin: "Ne na ishte thënë se muslimanët nuk kishin lënë asnjë burrë në shtëpitë e tyre dhe i kishin çuar të gjithë në luftë, por si duket në Medina paska burra!" Ky veprim heroik i Safijes, duke mbrojtur të pambrojturit dhe duke u bërë pengesë për planet e armikut, tregoi vendosmërinë dhe guximin e muslimanëve.[230]

Beteja e Ashpër Dhe Vendosmëria e Sahabëve

Nata kishte kaluar dhe dita spo ishte afruar. Të dyja ushtritë ruanin gadishmërinë. Idhujtarët në gadishmëri kërkonin të gjenin ndonjë dobsi dhe ti sulmonin shabët. Nga ana tjetër sahabët me përkushtueshmëri po përpiqeshin që të mos lejojnë asnjë sulm apo lëvizje të ushtrisë armike. Kështu në mëngjes lufta rifilloi me të njëjtën ashpërsi. Shigjetat fluturonin në ajër me një tingull të mprehtë. I Dërguari i Allahut (paqja qoftë mbi të), iu drejtua sahabëve të nderuar duke ju thënë:**"Pasha Allahun, në duart e të Cilit është jeta ime! Patjetër që vështirësitë me të cilat po përballeni do të ikin. Pas kësaj here ju do të arrini paqen, pasi armiku nuk do ketë më guxim me ju sulmuar. Rezistoni fitorja dhe triumfi është i yni."** Këto fjalë u bënë një burim frymëzimi për sahabët e ndritur, të cilët duke harruar urinë dhe lodhjen luftuan deri ne fund me gjithë shpirt. Ata nuk lejuan asnjë armik të kalonte hendekun.

Njëri nga sahabët më të shquar, Sad bin Muadhi (Allahu qoftë i kënaqur me të), gjatë betejës tregoi një trimëri të madhe. Gjatë luftës, ai u godit nga një shigjetë e një idhujtari të quajtur Hibban bin Kais. Shigjeta i preku atij një venë kryesore dhe shkaktoi humbje të madhe gjaku. Ai e kuptoi seriozitetin e plagës, ndaj ai u lut: **"O Zot! Nëse Kurejshët do të vazhdojnë këtë luftë, më dhuro jetë, sepse unë dua ti luftoj ata që i shkaktojnë vuajtje të Dërguarit Tënd. Por, nëse lufta po përfundon, më bëj martir të kësaj beteje. O Allah! Të lutem mos ma merr shpirtin pa parë fundin e Beni Kurejdhës."**

Nga ana tjetër, disa hipokritë, sikur ishte Abdullah bin Ubai, mbanin qëndrim të vakët dhe nuk ju afroheshin hendekut, pra nuk i afroheshin armikut. Për më tepër,

[230] Vâkıdî, Megâdhî, I, 463.

ata përpiqeshin të dobësonin moralin e muslimanëve dhe ti përçanin ata duke ju thënë: "Muhammedi na premton thesaret e Kajserit dhe Kisras! Ndërkohë që ne jemi të ngujuar në një hendek dhe nga frika nuk mund të lëvizim as andej as këndej. Allahu dhe i Dërguari i Tij nuk bëjnë gjë tjetër veçse na vështirsojnë!" Madje në raste të tensionuara, me pretkstin se duhet të mbronin familjet e tyre ata largoheshin nga pozicionet e tyre. Këto veprime të hipokritëve ishin një tjetër sfidë për muslimanët.

"Pasha Allahun, në duart e të Cilit është jeta ime! Patjetër që vështirësitë me të cilat po përballeni do të ikin. Pas kësaj here ju do të arrini paqen, pasi armiku nuk do ketë më guxim me ju sulmuar. Rezistoni fitorja dhe triumfi është i yni."
Hadith

Ushtria idhujtare, duke përdorur të gjithë fuqinë e saj, përpiqej të thyente mbrojtjen e sahabëve. Por përballë qëndresës së tyre heroike, ajo nuk mund të bënte asgjë. Sulmet më të shumta përqendroheshin në pikat më të dobëta të hendekut. I Dërguari i Allahut qëndronte aty dhe inkurajonte sahabët. Luftëtarët muslimanë, me një dëshirë të madhe për të qenë pranë tij, tregonin guxim të pashoq. Për një moment, idhujtarët filluan të qëllonin me shigjeta drejt çadrës së të Dërguarit të Allahut. Ai mbante një mburojë dhe një helmetë për mbrojtje dhe qëndronte para çadrës duke udhëhequr sahabët. Muslimanët e zjarrtë rendnin për të zmbrapsur armikun. Sa herë që përpiqej të sulmonte nga ndonjë vend të dobët shabët menjëherë i zmbarpsin ato. Kështu në një gjëndjë të zjarrtë lufta zgjati deri vonë në mbrëmje. Gjatë kësaj kohe, për shkak të betejës sahabët u ankoheshin se nuk kishin mundur të falnin namazet. I Dërguari i Allahut, i prekur thellë, tha: **"Betohem se as unë nuk kam mundur ta fal namazin."** Kur ra nata muslimanët me një sulm të fuqishëm e zmbrapsën ushtrinë idhujtare, të cilët u shpërndanë dhe u tërhoqën në kampet e tyre. Ndërsa sahabët u mblodhën pranë të Dërguarit të Allahut. Në atë moment, edhe pse zakonisht nuk bënte mallkime, i Dërguari i Allahut tha: **"Ashtu siç na penguan të falim namazin deri në perëndim të diellit, Allahu mbushtë shtëpitë, stomakët dhe varret e tyre me zjarr!"** Më pas, së bashku me sahabët falën namazet që kishin mbetur pa u falur (drekën, ikindinë dhe akshamin) dhe e përfunduan me faljen e jacisë.

O Allah Mposhti Idhujtarët

Idhujtarët pasi kuptuan se gjatë ditës nuk mund t'i mundnin myslimanët, vendosën që me të njëjtën intensitet të organizonin sulme natën. Sipas tyre, për të mposhtur myslimanët, kjo ishte mënyra e vetme. Ata, duke bashkëpunuar me hebrenjtë e fisit Kurejdha dhe duke organizuar bastisje natën, filluan që menjëherë të zbatonin këtë plan. Paganët e ndanë ushtrinë e tyre në grupe dhe filluan sulme të njëpasnjëshme. Kjo situatë vazhdoi për ditë të tëra. Pavarësisht nga uria, pagjumësia dhe lodhja, Profeti i dashur dhe shokët e tij trima vazhduan mbrojtjen. Ata nuk lejuan asnjë ushtar armik të kalonte përtej hendekut. Kjo mbrojtje heroike ishte më e frikshme, më e ashpër, më e vështirë dhe më e lodhshme se të gjitha betejat e mëparshme. Ndërkohë ushtria pagane filloi të përballej me mungesë ushqimi. Kuajt dhe devetë e tyre, duke mos gjetur asnjë grusht bari për të ngrënë, filluan të ngordhnin. Për këtë arsye, komandanti i tyre, Dırar bin Hattab, për të siguruar ushqime dërgoi një njësi drejt hebrenjve të Kurejdhas.

Hebrenjtë, që kishin vënë gjithçka në dispozicion të paganëve, dërguan menjëherë njëzet deve të ngarkuara me grurë, elb, hurma dhe kashtë për kafshët. Por kur po ktheheshin Dırari dhe ushtarët e tij plot gëzim, në Kubasë u përballën me një grup sahabësh (shokë të Profetit alejhi selam). Pas një përplasjeje të përgjakshme

paganët duke lënë devetë e ngarkuara me ushqime, u detyruan të tërhiqeshin. Tashmë gezimi kishte kaluar tek sahabët, të cilët kur i dorëzuan devetë e ngarkuara Profetit të tonë dashur, prej të cilit moren shumë lutje dhe bekime.[231]

I dashuri i Universit, njëkohësisht Profeti ynë i dashur (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të), gjatë kësaj lufte të ashpër njëmujore, ndiente dhembshuri të madhe për shokët e tij të lodhur e të uritur. Ai u tregonte atyre dashuri dhe dhembshuri më të madhe se ajo e baballarëve të tyre. Ndërsa shihte përpjekjet mbinjerëzore të sahabëve, ai vendoste ballin në sexhde dhe lutej për ta duke thënë: **''O Ti që i përgjigjesh nevojtarëve të dëshpëruar! O Allah që dëgjon dhe i ndihmon ata që janë të pafuqishëm e të pashpresë! Ti e di dhe e sheh gjendjen time dhe të shokëve të mi. O Zot! Bëji pabesimtarët të mposhtur, përçaj radhët e tyre dhe na dhuro neve ndihmën dhe fitoren Tënde!''** Profeti ynë i dashur gjatë ditëve të fundit të luftës e përsëriste shpesh këtë lutje.

Paganët, tashmë të dëshpëruar nga uria dhe mungesa e ushqimit, përpiqeshin me të gjitha forcat e tyre që të zhduknin myslimanët. Në një prej këtyre netëve, një njeri nga ushtria pagane, zemra e të cilit ishte ndriçuar me dashurinë për Islamin, erdhi te Profeti ynë i dashur. Ky ishte Nuaim bin Mesud nga fisi Gatafan, i cili tha: 'O i Dërguar i Allahut! Kam ardhur për të dëshmuar se Allahu është Një dhe se ti je i Dërguari i Tij. Me nder jam bërë mysliman, deri tani kam luftuar kundër jush, por tani do të luftoj kundër pabesimtarëve. Çfarëdo që të më urdhëroni, jam gati ta bëj! Askush nga fisi im nuk e di që unë jam bërë mysliman.' Profeti aljehi selam i tha: **'O Nuaim! A mund të futesh mes pabesimtarëve dhe të mbjellësh përçarje mes tyre?'** Numan me plot entuziazëm i tha; 'O i Dërguar i Allahut! Me ndihmën e Allahut, unë mund t'i përçaj ata. Por në të tilla raste a mund të them çfarë të dua?' Profeti i tha: **'Lufta është hile. Thuaj ç'të duash.**'"

Nuajm bin Mesudi fillimisht shkoi tek hebrenjtë e fisit Kurejdha dhe u tha: "Ju e dini mirë dashurinë dhe përkushtimin tim ndaj jush. Por, çfarëdo që të bisedojmë, le të mbetet mes nesh. Askush nuk duhet ta dijë." Hebrenjtë ju betuan duke i thënë: "Askush nuk do ta dijë atë që ti do të na e thuash." Pasi ju mori beën hebrenjëve Nuajmi ju tha: "Çështja e këtij njeriu (duke iu referuar Profetit alejhi selam) është një fatkeqësi e madhe. E dini çfarë u bëri ai banorëve të fiseve Beni Nadir dhe Beni Kajnuka. Të gjithë e patë sesi ata u dëbuan nga vendbanimet e tyre. Tani, kurejshët dhe fisi Gatafan po luftojnë kundër myslimanëve, dhe ju po i ndihmoni ata. Mirëpo pas kaq ditësh beteje, ende nuk kemi arritur asnjë rezultat. Nëse situata vazhdon kështu, dijeni se rrethimi do të zgjasë edhe më shumë. Por mallrat, pronat, vendet dhe familjet e kurejshëve dhe të fisit Gatafan nuk janë këtu, sikur janë tuajat. Nëse ata do ta fitojnë këtë luftë, do të mbledhin plaçkat dhe do të largohen. Por nëse humbasin, do të tërhiqen dhe do t'ju lënë vetëm për vetëm. Ju për përballë myslimanëve nuk keni as forcë dhe as kapacitet. Situata aktuale tregon qartë se myslimanët po shkojnë drejt fitores. Nëse ndodh siç parashikoj, ata për shkak të tradhtisë që ju i bëtë nuk do t'ju kursejnë dhe do t'ju ndëshkojnë me vrasje. Për këtë arsye, ju duhet të merrni masa sa më parë!"[232]

Fjalët e Nuajmit i bënë shkak që Hebrenjtë ti kaploi frika dhe paniku. Ndaj ata kërkuan prej tij duke i thanë: ''O Nuajm! Ti je miku ynë dhe deri më sot ti na ke orjentuar nga e duhura. Tani na thuaj tani çfarë masash duhet të marrim." Tashmë Nuajmi e kishte marrë atë që priste ndaj ai ju tha: "E vërteta është se: Pa ju marrë

[231] Vâkıdî, Megâdhî, I, 467.

garancinë mushrikëve mos hyni në luftë me myslimanët! Bisedoni me idhujtaret mekkas dhe thoni atyre se ne nuk do të hyjme në luftë kunder myslimanëve derisa ju të na lini peng disa prej liderëve të kurejshëve dhe të fisit. Kjo do bëhet shkak që, derisa këto pengje të jenë me ju, mekkasit nuk do mund të largohen nga lufta."

"O Allah! Të falënderoj për mëshirën Tënde ndaj meje dhe shokëve të mi."
Muhammedi a.s.

Hebrenjtë e pranuan këtë sugjerim të Nuajmit si një masë e duhur për to, ata e falënderuan Nuajmin duke e percjellur ate me nderime. Nuajmi u largua nga hebrenjtë dhe shkoi në kampin e kurejshëve ku i tha komandantëve të tyre: "Ju e dini armiqësinë time ndaj Muhamedit, por edhe se sa shumë ju dua juve. Unë sapo kam marr një lajm dhe për shkak të miqësisë sonë mendoj se këtë lajm duhet ta ndaj me ju." Kurejshët i kapi meraku, faktikish në luftë çdo lajm është i rëndësishm. Për këtë shkak mushrikët i thanë Nuajmit që të nadnte lajmin me to. Nuajmi i tha mushrikëve se "Pa u betuar se ju nuk do t'i tregoni askujt! Unë nuk ju them ju asgjë "Ata ju betuan dhe i thanë me padurim: "O Nuajm! Pa na thuaj, se po të dëgjojmë." Atëherë Nuajmi vazhdoi: "Dijeni se hebrenjtë e Kurejdhas janë penduar për aleancën që bënë me ju dhe i kanë dërguar lajm Muhamedit ku i kanë thënë atij se: 'Ne do të marrim peng disa nga të parët e kurejshëve dhe të Gatafanit. Sapo ti marrim ata pengje do jua dorëzojmë juve dhe më pas do të bashkohemi me ju dhe derisa ti shkatërrojmë plotësisht idhujtarët do të luftojmë krah jush. Prej jush nuk do të kërkojmë anjë shpërblim mjafton që ju të mos prekni vëllezërit tanë nga fisi Nadir!' Nuajmi vazhdoi duke ju thënë atyre se kishte dëgjuar që Muhamedi (alejhi selam) e kishte pranuar këtë ofertë të hebrenjëvë! Ndaj nëse hebrenjtë kërkojnë pengje prej jush, kurrë mos ia jepni! Sepse ata do t'ju vrasin të gjithëve. Nëse nuk më besoni mbajeni këtë lajm të fshëhur dhe mos i tregoni askujt këto fjalë. Kur të vijnë ata të kërkojnë pngjet atëherë do e mësoni realitëtin!" Kurejshët u shqetësuan shumë nga ky lajm, ndaj ata të nesërmen i dërguan një lajm fisit Kurejdha duke ju thënë atyrë së: "O Paria e Fisit Kurejdha! Qëndrimi ynë këtu po bëhet shumë i vështirë. Moti është i të ftohtë, kafshët tona po ngordhin nga uria. Ndaj ne duhet të përgatitemi mirë sonte që nesër të sulmojmë Muhammedin me tërë fuqinë tonë." Mirëpo fisi i Beni Kurejdhas ju përgjigjën kurejshve se: "O Pari e Mekkas! Ne nuk do të luftojmë përkrah jush deri sa ju të na jepni peng disa prej të parëve tuaj. Nëse rrethimi zgjat dhe ju nuk mund të vazhdoni më luftën, no do të na braktisni në duart e Muhamedit (alejhi selam). Por nëse na jepni si siguri pengjet që ju kërkojmë, atëherë ju nuk do të mund të na braktisni!"

Lajmi që hebrenjët kërkojnë pengje arriti shpejt tek komandanti i kurejshëve, të cilët thanë: " Paska të drejtë Nuajmi!" Dhe duke i dërguar një tjetër lajmëtarë fisit hebre Beni Kurejdha i thanë atyre se: "Ne nuk do t'ju japim ju as edhe një burrë peng. Nëse nesër luftoni me ne, mirë. Nëse jo, ne do të tërhiqemi dhe ju do të mbeteni vetëm përballë Muhamedit dhe shokëve të tij!" Edhe kur hebrenjtë e Kurejdhas dëgjuan këtë përgjigje, thanë: "Nuajmi kishte të drejtë!" Dhe "Atëherë ne nuk do të luftojmë me ju kundër myslimanëve!" ju përgjigjën ata. Tashmë hebrenjtë i shkëputën nga mushrikët edhe mushrikët nuk i kishin më besë hebrenjëve ndaj frika ju pushtoi zemrat e të dyja palëve.

Nga ana tjetër Pejgamberi alejhi selam po mbante të motivuar shabët që ata të mos tregonin ndonjë dobësi në betëjë që armiku mund të përfitontë. Nuk vonio

[232] Ibni Hishâm, Sîret, II, 228; Vâkıdî, Megâdhî, I, 481; Suheylî, Ravdu'l-unf, III, 433; Kettânî, Terâtîb-ul-idâri yye, I, 543.

shumë kur erdhi Xhebraili alejhi selam tek Profeti alejhi selam dhe i dha lajmin atij lajmin mirë se së shpëjti Allahu me një stuhi të fortë do ti shkatërronte idhujtarët. Kur mori këtë lajm, Profeti i dashur ra në gjunjë dhe ngriti duart drejt qiellit, duke thënë: **"O Allah! Të falënderoj për mëshirën Tënde ndaj meje dhe shokëve të mi."** Pastaj ai ua dha këtë lajm të mirë shokëve të tij.

Nata kishte ardhur një errësirë e thellë mbuloi gjithçka dhe një i ftohtë i tmerrshëm, i shoqeruar nga një erë e fortë, përfshiu gjithçka. Më vonë Huzejfe bin Jeman e rrëfen këtë natë si më poshtë: "Ishim në një natë të errët që kurrë më parë nuk kisha parë një errësirë të tillë. Atë natë së bashku me errësirën, një erë e fuqishme dhe një zhurmë e ngjashme me bubullimat shpërtheu mbi ne. Profeti alejhi selam na tha se armiku kishte rënë në panik dhe në mes tyre mbizotërontë një mosmarrëveshje. Ne ishim aq të lodhur dhe të uritur, sa nuk mund të ngriheshim nga vendi. Më pas I Dërguari i Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të) u ngrit për të falur namaz dhe një pjesë të natës e kaloi duke u falur. Pas namazit u kthye nga ne dhe tha: **"A ka ndonjë prej jush që do të shkojë te ushtria e idhujtarëve dhe të vëzhgojë gjëndjen e tyre? për atë që do të shkoi në vëzhgim do të kërkoj prej Allahut të Madhërishëm që ai të jetë shoku im në Xhenet."** Për shkak të të ftohtit dhe urisë, askush nuk u ngrit. Atëherë i Dërguari i Allahut erdhi pranë meje. Kur erdhi ai, unë prej të ftohtit dhe urisë isha i ulur mbi gjunjë. I Dërguari i Allahut mu afrua dhe duke më prekur mbi supe më pyeti: **"Kush je ti?"**: "Unë jam Huzejfeja, o i Dërguari i Allahut" iu përgjigja. Atëherë I Dërguari i Allahut më tha: **"O Huzejfe! Shko dhe shiko çfarë po bën ai popull. Pastaj kthehu dhe më trego! Derisa të kthehesh, mos qëllo as me shigjetë, as me gurë, as me shpatë e as me shtizë. Mos u tremb se derisa të kthehesh këtu, nuk do të vuash as nga të ftohtit apo të nxehtit, as nuk do të kapesh peng dhe as nuk do të dëmtohesh nga askush."** Unë pa hezituar mora shpatën dhe harkun tim dhe u bëra gati për të shkuar atje. Kur unë isha duke ikur I Dërguari i Allahut u lut për mua: **"O Zot! Mbroje atë nga përpara dhe nga pas, nga e djathta dhe e majta, nga lart dhe nga poshtë!"**

Une nisa të eci drejt idhujtarëve, por kur po shkoja drejt tyre betohem se nuk ndieva as frikë, as të ftohtë dhe as ndonjë shqetësim tjetër. Më në fund, arrita në kampin e idhujtarëve. Udhëheqësit dhe të parët e tyre ishin mbledhur rreth një zjarri për t'u ngrohur. Ebu Sufjani ju thoshte se: "Duhet të largohemi nga këtu." Më erdhi në mendje ta vrisja aty për aty. Nxora një shigjetë nga çanta dhe e vendosa në hark dhe duke përfituar nga drita e zjarrit, u përgatita ta qëlloja. Por, pikërisht kur po bëhesha gati të lëshoja shigjetën, m'u kujtua urdhri i të Dërguarit të Allahut që: "Të mos lija anjë gjurmë derisa të kthehesh te ai." Ndaj hoqa dorë nga ideja për ta vrarë Ebu Sufjanin. Më pas më lindi një guxim i madh brenda vetes. U afrova pranë tyre dhe u ula afër zjarrit. Ndërkohë, një erë e fuqishme, që ishte një nga ushtritë e padukshme të Allahut (engjëjt), filloi të bënte punën e saj mbi ta. Era përmbyste gjithçka: enët, zjarret po shuheshin dhe çadrat po ju shembeshin mbi kokë. Ebu Sufjani u ngrit dhe ju tha: "Midis nesh mund të ketë spiunë dhe vëzhgues. Kini kujdes dhe sigurohuni që ta dini kush është pranë jush! Çdokush le të marrë dorën e atij që ka pranë dhe ta pyesë për emrin e tij."

Ebu Sufjani dukej se kishte ndjerë praninë e një të huaji midis tyre. Menjëherë, shtriva duart dhe kapa duart e dy personave pranë meje, një në të djathtë dhe një në të majtë. I pyeta për emrat e tyre para se ata të më pyesnin mua, kështu duke shmangur që ata të mos më zbulonin. Pastaj Ebu Sufjani i foli ushtrisë së tij: "O

kurejshë! Tashmë po duket qartë që ky nuk është më një vend për të qëndruar. Kuajt dhe devetë po ngordhin. Uria ka pushtuar çdo gjë. Era e fortë na ka shkatërruar gjithçka. Çohuni dhe ikim menjëherë! Ja, unë po largohem i pari." Dhe hipi në devenë e tij dhe u nis drejt Mekkas. Kështu në një gjendje të mjerueshme ushtria idhujtare u shpërbë dhe filloi të lëvizte drejt Mekës. Kur ata po iknin me të katërta mbi ta po vërshontë kumi, rëra dhe guralecat e shkretëtirës.[233]

"Tani është radha juaj. Dijeni se që tani e tutje, Kurejshët nuk do të guxojnë të vijnë më kundër jush."
Muhammedi a.s.

Pasi ushtria e idhujtarëve u tërhoq, edhe unë u nisa drejt të Dërguarit të Allahut (paqja qoftë mbi të). Në gjysmën e rrugës, më dolën përpara njëzet kalorës me çallma të bardha (melekë), të cilët më thanë: "**Jepi lajmin të Dërguarit të Allahut: Allahu i Madhërishëm ka shkatërruar armikun.**" Kur u ktheva te i Dërguari i Allahut, ai ishte mbi një qilim duke u falur. Por, sapo u ktheva, të ftohtit dhe dridhjet që kisha përpara nisjes më pushtuan sërish. I Dërguari i Allahut, pasi mbaroi namazin, më pyeti për lajmin që kisha sjellë. I tregova për gjendjen e mjerueshme në të cilën kishte rënë ushtria e idhujtarëve dhe për tërheqjen e tyre. I Dërguari i Allahut u gëzua shumë dhe buzëqeshi.

Ishim të pagjumë prej ditësh. I Dërguari i Allahut më mori pranë vetes, dhe një cep të qilimit që kishte mbi vete ma hodhi edhe mua dhe kështu e kaluam atë natë. Në agim kur zbardhi dita, pamë se ushtria e idhujtarëve nuk ishte më aty. Një erë e fortë i ndoqi ata nga pas deri afër Mekës. Njëkohësisht vazhdimisht ata dëgjuan pas vetes tekbiret (thirrjet "Allahu Ekber") e gëzimit të sahabëve. Pasi Kurejshët u arratisën dhe e braktisën fuhshë betejën edhe fiset e tjera idhujtare që kishin ardhur me ta e braktisën Medinën. Ata u zhytën në trishtim dhe hidhërim për këtë disfatë të madhe që ata kishin përjetuar në Hendek. Ndërkohë, Zotëria i Krijesave (paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të) dhe shokët e tij të lavdishëm po i binin në sexhde falënderimi ndaj Allahut të Madhërishëm. Më pas luftëtarët e Allahut nën thirrjet: **"Allahu Ekber! Allahu Ekber!"** duke lënë pas gjatë dëshmorë u kthyen drejt Medinës,

Rrugët e Medinës u mbushën me fëmijë, të cilët dolën për të pritur Sundimtarin e Krijesave (paqja qoftë mbi të), si dhe baballarët, xhaxhallarët, dajallarët dhe vëllezërit e tyre të nderuar. I Dërguari i Allahut, me buzëqeshjen e tij, iu përgjigjej përshëndetjeve të tyre.

Allahu i Madhërishëm për betejën e Hendekut shpalli në Kuran këto ajete: **''Dhe Allahu i përzuri ata që mohuan me atë mllefin e tyre, (dhe) ata nuk përfituan asnjë mirësi (forcim të besimit, dashuri tek Allahu, ose qoftë edhe plaçkë lufte). Allahu u mjaftoi besimtarëve në luftë. Allahu është gjithnjë Fuqiplotë, i Gjithëfuqishëm (për të vendosur Vullnetin e Tij).''** (Ahzab, 33:25). Dhe ajeti tjetër**; ''O ju që keni besuar! Përkujtoni Mirësinë e Allahut mbi ju, atëherë kur erdhën kundër jush ushtri (të mëdha) dhe Ne dërguam kundër tyre erë dhe forca që ju nuk i shihnit dot** (melekë të dërguar nga Allahu në luftën e "Lidhjes së Madhe" kur u bashkuan forca të mëdha nga i gjithë Gadishulli Arab kundër muslimanëve në Medine)**. Dhe Allahu është kurdoherë Gjithëvëzhgues për gjithçka që ju bëni.''** (Ahzab, 33:9) Ndërsa i dashuri i Allahut ju tha shabëve: **"Tani është radha juaj. Dijeni se që tani e tutje, Kurejshët nuk do të guxojnë të vijnë më kundër jush."**

[233] Vâkıdî, Megâdhî, I, 489.

BETEJA E BENI KUREJDHA

Pasi Muhamedi (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), u kthye në Medinë, para pas Betejës së Hendekut, ai shkoi në shtëpinë e Aishes dhe kur po hiqte armët dhe parzmoren e luftës erdhi një kalorës i armatosur në formën e Dihje El-Kelb-it. kalorësi që erdhi ishte Xhebraili (a.s.) i cili tha:**"O i Dërguari i Allahut! Allahu i Plotfuqishëm të urdhëron të marshosh menjëherë kundër fisit të Beni Kurejdhës!"** Me këtë urdhër hyjnor, Profeti thirri Bilalin dhe e urdhëroi atë që t'u njoftonte sahabëve që te mblidheshin.

Kur u mblodhen shabët i Dërguri i Allahu ju tha; "**O shokët e mi! Ngrihuni dhe hipni mbi kuajt dhe devetë tuaja! Kush i bindet këtij urdhri, namazin e ikindisë le ta falë në territorin e Beni Kurejdhës."** Më pas Profeti (paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të) u vesh përsëri me parzmoren dhe armët, e vuri helmetën mbi kokë, hodhi mburojën në shpinë dhe mori shtizën në dorë. Profte a.a. hipi mbi kalë dhe kur u bashkua me ushtrinë e tij ia dorëzoi flamurin e Islamit Aliut r.a. të cilin e ngarkoi si pararojë të kalasë së Beni Kurejdhës. Fisi hebre Beni Kurejdha banonte në juglindje të Medinës dhe kur u nis ushtria drejt tyre Profeti alejhi selam në Medine, si përgjegjës, la Abdullah ibni Umm-i Mektûm.[234]

Ushtria Islame, duke e pasur Profetin në krye, u nis drejt kalasë duke thirrur tekbire: **"Allahu Ekber! Allahu Ekber!"**. Rrugës ata u takuan me antarët e Fisit Gani, të cilët ishin të armatosur dhe prisnin ardhjen e Profetit alejhi selam. Ata i treguan Profetit se kishin parë një kalorës me një mushkë të bardhë dhe një mbulesë kadife mbi të. Profeti ju tha se: **"Ai është Xhebraili. Ai është dërguar për të tronditur kalatë e Beni Kurejdhës dhe për të mbjellë frikë në zemrat e tyre."**

"O shokët e mi! Ngrihuni dhe hipni mbi kuajt dhe devetë tuaja! Kush i bindet këtij urdhri, namazin e ikindisë le ta falë në territorin e Beni Kurejdhës."
Muhammedi a.s.

Numri i ushtrisë islame arriti në tre mijë ushtarë. Para se ajo të mbërrinte te kalaja Aliu r.a. vendosi flamurin përballë kalasë, shenjë kjo qe tregonte fyerje për banorët e saj. Profeti (paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të) fillimisht i ftoi ata të pranonin Islamin dhe më pas i kërkoi që të dorëzoheshin duke iu nënshtruar urdhrit të Allahut dhe të Dërguarit të Tij. Por ata i refuzuan të dyja kërkesat e Profetit alejhi selam. Pas refuzimit të tyre, Profeti urdhëroi Sa'd ibn Ebi Vakkasin dhe shigjetarët që ata të fillonin sulmin kundër kalasë. Shigjetarët e nisen sulmin duke thirrur tekbir. Banorët e kalasë iu përgjigjën me gurë dhe shigjeta, por nuk guxuan të dilnin jashtë saj. Tradhtia dhe mohimi i tyre i profetësisë së Muhamedit (paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të) ishin motivet kryesore të këtij konflikti që tasmë ishte kthyer ne luftë.

Rrethimi i kalasë vazhdonte, shabët nuk lejonin as zogjtë me fluturuar mbi kala. Mirëpo brenda ushtrisë islame kishte hipokritë (munafikë) që fshehurazi i dërgonin lajme banorëve të kalasë së Beni Kurejdhës. Hipokritët i thonin atyre se:"Mos u dorëzoni! Edhe nëse ju kërkohet të largoheni nga Medina, mos pranoni! Nëse vazhdoni të luftoni, ne do t'ju ndihmojmë me gjithë forcën tonë dhe nuk do t'ju lëmë vetëm. Edhe nëse ju dëbojnë nga Medina, ne do të largohemi bashkë me ju."Këto lajme të hipokritëve u dhanë çifutëve të kalasë një shpresë të re për rezistencë. Por, kur një muaj kaloi dhe asnjë ndihmë nuk erdhi nga munafikët, zemrat e tyre u mbushën me frikë dhe ata u dëtyrun të negocionin për një marrëveshje.

[234] İbni Hishâm, Sîret, II, 234; Vâkıdî, Megâdhî, I, 497; İbni Sa'd, Tabakât, II, 74; Suheylî, Ravd-ul-unf, III, 436.

Beteja e Beni Kurejdha



"Jo! Nuk ka rrugë tjetër përveç se t'i nënshtroheni plotësisht vendimit tim dhe të dorëzoheni pa kushte!"
Muhammedi a.s.

Një nga udhëheqësit e tyre, i quajtur Nebbash bin Kajs, shkoi te Profeti Muhamed (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) dhe i tha:"O Muhamed! Na trego të njëjtën mëshirë që tregove ndaj fisit të Beni Nadirit. Pasuria dhe armët tona janë të tuat, vetëm mos derdh gjakun tonë. Na lejo të largohemi nga këtu me gratë dhe fëmijët tanë dhe lejo që çdo familje të marrë me vete një ngarkesë deveje, përveç armëve."Profeti (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) iu përgjigj:"**Jo! Nuk e pranoj këtë ofertë!**"Atëherë Nebbashi propozoi që:"Ne jemi të gatshëm të heqim dorë nga marrja e pasurisë, vetëm mos na vrit! Na lejoni të marrim gratë dhe fëmijët tanë."Profeti alejhi selam edhe këtë nuk e pranoi dhe i tha:"**Jo! Nuk ka rrugë tjetër përveç se t'i nënshtroheni plotësisht vendimit tim dhe të dorëzoheni pa kushte!**"Pasi e pa Nebbashi që nuk ka rrugë tjetër u kthye në kala dhe i tregoi popullit të tij për bisedimet që pati me Profetit alejhi selam.[235]

Banorët e kalasë sapo mësuan që Nebbashi nuk ishte arritur ndonjë marrëveshje ranë në dëshpërim dhe trishtim të thellë. Lideri i tyre, Ka'b bin Esedi u kthye drejt tyre dhe tha:"O populli im! Siç e shihni, një fatkeqësi e madhe na ka goditur. Anda ne sot nuk kemi rrugë tjetër vetëm se të zgjedhim njërën prej ketyre; Propozimin i parë; ''pranojeni fenë e tij dhe besoni në profetësinë e tij! Për Zotin, të gjithë ne e dimë se ai është i dërguari i Allahut, të cilin e kemi përshkruar në librat tanë. Nëse i besojmë atij, do të shpëtojmë jetët tona, gratë tona, fëmijët tanë dhe pasurinë tonë. Arsyeja e vetme që nuk e pranojmë është xhelozia jonë ndaj arabëve dhe fakti që ai nuk është nga pasardhësit e Izraelit. Por kjo është vendim i Allahut. Prandaj, le ta pranojmë profetësinë e Muhammedit alejhi selam!''

Jahuditë unanimisht e refuzuan dhe i thanë:"Jo! Nuk do ta pranojmë kurrë atë dhe nuk do të ndjekim askënd tjetër përveç vetes sonë!"Pas inatit dhe xhelozisë së jahudive Kabi vazhdoi duke thënë propozimin e dytë;"Atëherë, të gjithë të vrasim gratë dhe fëmijët tanë, që të mos kemi më asgjë për të menduar, dhe më pas të luftojmë me të deri në vdekje!"Por jahuditë e refuzuan edhe këtë propozim të Kabit. Tashmë Kabi e pa së nuk ka rrugë tjetër dhe propozoi alternativën e tretë:"Atëhere ju e dini që kjo natë është nata e së Shtunës. Myslimanët e dinë që ne nuk luftojmë natën e së Shtunës, kështuqë ata sonte nuk prensin sulm nga ne. Por ne duhet ta shfrytëzojmë këtë, ndaj të nxjerrim shpatat tona, dhe të dalim të gjithë bashkë që ti sulmojmë në befasi. Kjo është e vetmja mundësi që në mund të kemi sukses!"Por edhe këtë herë jahuditë refuzuan, duke thënë:"Ne nuk mund të thyejmë ligjin tonë të shenjtë, ndaj ne asesi nuk loftojmë të Shtunën!"Jahuditë dilinin në luftë prej frikës, jo se ata do i rrinin në besë librit të tyre. Sepse kur vinte puna për interesa ata i shkilnin të gjitha shenjtëritë e tyre.

Prej fisit hebre vetëm tre njerëz e pranuan këshillën e parë të Ka'b-it dhe u bënë myslimanë. Ata ishin Esid, Thalabe dhe kushëriri i tyre Esed. Ata dolën nga kalaja dhe u bashkuan me myslimanët.[236]

Hebrenjtë pas çdo konsulence që bënin me njëri-tjetrin kishin kontradita dhe nuk arrinin të merreshin vesh që të dilinin me një objektivë të përbashkët. Ndaj ata në fund nuk patën rrugë tjetër dhe ngritën flamurin e dorëzimit. Kur ngritën flamurin e dorëzimit kërkuan që Profeti Muhamed (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) të caktonte një gjykatës për të vendosur mbi fatin e tyre. Atëherë Profeti

[235] Vâkıdî, Megâdhî, I, 460.

(paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) ju tha:**"Zgjidhni cilindo nga shokët e mi, që ju e dëshironi si gjykatës."**Ata i thanë:"Ne pranojmë gjykimin e Sa'd bin Muadh-it."

Profeti (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) urdhëroi që Sa'd bin Muadh-i të vinte për të dhënë vendimin. Në atë kohë, Sa'd bin Muadh ishte i plagosur rëndë nga një plagë e marrë gjatë betejës së Hendekut dhe po trajtohej në një tendë pranë Xhamisë së Profetit. Ai u soll në kalanë e Beni Kurejdhës. Gjatë rrugës, Sa'd thoshte:"Pasha Allahun, unë nuk do të shqetësohem për fjalët e atyre që më qortojnë në rrugën e Allahut!"Dhe kur arriti para Profetit (paqja qoftë mbi të), Profeti i tha:"O Sa'd! Ata kanë pranuar të dorëzohen sipas gjykimit tënd. Ndaj ti sot duhët të gjykosh me vendimin tënd për to."Sa'd tha:"Jeta ime qoftë flijim për ty, o i Dërguar i Allahut! Vendimi më i drejtë është ai i Allahut dhe i Dërguarit të Tij."Profeti (paqja qoftë mbi të) iu përgjigj:"Allahu të ka caktuar ty për të dhënë gjykimin mbi ta."

Pas kësaj, Sa'd mori nga hebrenjtë një betim të prerë se do të pranonin vendimin e tij. Më pas para të gjithëve, ai shpalli këtë vendim:"Vendimi im është që të gjithë burrat e rritur të ekzekutohen, gratë dhe fëmijët të merren rob, ndërsa pasuria e tyre të ndahet mes myslimanëve."Mirëpo këtë vendim e priti një heshtje e rëndë. Hebrenjtë nuk e kundërshtuan, sepse në librat e tyre të shenjtë ishte e shkruar një ndëshkim i ngjashëm për ata që tradhëtonin besën e dhënë dhe silleshin me armiqësi.

Ne librin e hebrenjëve shkruhej;"Kur të shkojë lufta në një qytet, ftoji ata në paqe. Nëse pranojnë dhe hapin portat, ata do të paguajnë taksë dhe do të jenë në shërbimin tënd. Nëse refuzojnë dhe vendosin të luftojnë, rrethoji. Nëse Allahu të jep fitore, vrite të gjithë burrat, ndërsa gratë, fëmijët dhe pasurinë merr si plaçkë lufte. ''Pasi dëgjoi këtë vendim, Profeti Muhamed (paqja qoftë mbi të) e përgëzoi Sa'd bin Muadh-in, duke thënë: "**Ti ke dhënë një gjykim që përputhet me vendimin e Allahut që Ai e ka shkruar mbi Levhi Mahfudh."**

"O Allah! Sadi luftoi në rrugën Tënde dhe e besoi Dërguarin Tënd. I jep lehtësi!"
Hadith

Hebrenjtë nuk patën asnjë argument për ta kundërshtuar këtë vendim, sepse ai ishte në përputhje me ligjet e tyre të shenjta. Të gjithë burrat e rritur u lidhë dhe u çuan në Medinë. Ditën tjetër, sipas urdhrit të Profetit Muhamed (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), Hazreti Ali dhe Hazreti Zubejri ekzekutuan vendimin. Gratë, fëmijët dhe pasuria u ndanë mes shokëve të Profetit alejhi selam. Kështu që ky fis i fshehtë, tradhtar dhe intrigant, që kishte shkelur të gjitha marrëveshjet dhe kishte tentuar të vriste Profetin që nga fëmijëria e tij, u pastrua nga Medina dhe rrethinat e saj.[237]

Ndër të burgosurat ishte edhe një grua e quajtur Rejhane, e cila pati fatin të përqafonte Islamin. Ajo i takoi pjesës së Profetit Muhamed (paqja qoftë mbi të). Profeti i dha asaj mundësinë të zgjidhte mes qëndrimit në fenë e saj ose pranimit të Islamit. Në fillim, Rejhane tha se dëshironte të qëndronte në fenë e saj dhe u dërgua në shtëpinë e Umm-i Mundhirit. Më vonë, pas këshillave dhe përpjekjeve të Sa'lebe bin Sa'jes, zemra e saj u ngroh ndaj Islamit. Kur ajo pranoi Islamin, Profeti e pyeti: **"A dëshiron të ndjekësh rrugën e Allahut dhe të Dërguarit të Tij? Unë këtë e shoh si më të përshtatshmen për ty."** Rejhane iu përgjigj: "Po, dëshiroj." Profeti Muhamed (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) u gëzua shumë nga ky

[236] Ibni Hishâm, Sîret, II, 235; Vâkıdî, Megâdhî, II, 501; Suheylî, Ravd-ul-unf, III, 439; İbni Kesîr, Sire, III, 230..

vendim dhe, për ta nderuar atë, e liroi dhe e mori për grua. Pas martesës, ai i dha mehërin dhe celebrimi u mbajt në shtëpinë e Umm-i Mundhirit. Kështu që, Rejhane (radijallahu anha) fitoi nderin të bëhej një nga Nënat e Besimtarëve dhe një nga gratë e ndershme të Profetit Muhamed (paqja qoftë mbi të).[238]

Shehadeti i Sad Ibni Muadhit

Pas vendimit mbi hebrenjtë e Beni Kurejza, Sad Ibni Muadhi u dërgua përsëri në çadrën e tij. Plaga e tij u rëndua dhe gjendja e tij u përkeqësua. Profeti Muhamed (s.a.v.) shkoi te ai, e përqafoi dhe tha: **"O Allah! Sadi luftoi në rrugën Tënde dhe e besoi Dërguarin Tënd. I jep lehtësi!"** Kur Sadi i dëgjoi fjalët e Profetit, hapi sytë dhe tha: "O i Dërguari i Allahut! Të dërgoj përshëndetje dhe nderime. Dëshmoj se ti je Dërguari i Allahut." Pas kësaj, ata e morën Sadin dhe e çuan në shtëpinë e familjes së tij.

Gjatë natës, gjendja e tij u përkeqësua. Xhibrili (a.s.) shkoi tek Profeti a.s. dhe i tha: **"O i Dërguari i Allahut! Kush prej ndjekësve të tu do të vdesë sonte dhe do të njoftohet nga engjëjt?"** Profeti i pyeti shokët e tij për Sadin dhe ju tha që ai ishte çuar në shtëpi. Profeti a.s. U ngrit dhe i shoqëruar nga disa sahabe, shkoi te Sad bin Muazdhi. Në rrugë, ata u lodhën dhe thanë: "O i Dërguari i Allahut, po lodhemi!" Profeti ju përgjigj: **"Ashtu sikur engjëjt ishin para nesh në varrimin e Hanzallës, ashtu dhe ata do të jenë para nesh në varrimin e Sad bin Muadhit. Ndaj ne nuk do të arrijmë te ai në kohën e duhur."** Kur arritën tek Sadi e gjetën atë të vdekur. Profeti e pa dhe tha: "**O Ebu Amr! I ke shërbyer popullit tënd më së miri. Allahu sot ty të jep mirësi, begati dhe shpërblimin më të madh! Ti mbajte premtimin tënd ndaj Allahut, dhe Allahu do të të japë atë që të ka premtuar."** Kur e dëgjoi këtë nëna e Sadit, duke qarë, recitoi vargje poetike për të.[239]

Si mund të durojë, e mjera nën!
Kërkon durim, qaj për atë që don!

Eslem bin Harithi ka transmetuar se: "I Dërguari i Allahut erdhi në shtëpinë e Sad bin Muadhit. Ne po e prisnim atë tek dera. I Dërguari hyri brenda, duke ecur me hapa të shpejta. Edhe ne ecëm pas tij. Kur i Dërguari i Allahut na bëri me shenjë që të ndalonim, ndaluam dhe u kthyem mbrapsht. Brenda nuk ishte askush tjetër përveç trupit të pajetë të SaDit. I Dërguari i Allahut qëndroi për një farë kohe aty, pastaj doli jashtë. Nga kureshtja, e pyeta: 'O i Dërguari i Allahut! Cili ishte shkaku që ecët me hapa kaq të shpejta?' Ai më tha: '**Nuk kam qenë kurrë në një tubim kaq të madh. (Engjëjt ishin mbushur në atë vend). Një nga engjëjt më mbështeti në krahun e tij dhe vetëm atëherë munda të ulem.'** Më pas duke e përmendur sandın në nofkën e tij tha: '**O Eba Amr! Të qoftë shëndet! O Eba Amr! Të qoftë shëndet!'.** Vdekja e tij e pikëlloi shumë të Dërguarin dhe shokët e tij të nderuar. Të gjithë shokët e Profetit u mblodhën për varrimin e Sad bin Muadhit. I Dërguari i Allahut ia fali namazin e xhenazes dhe e mbajti mbi supe arkivolin e tij. Gjatë bartjes së xhenazes shokët e pyetën: 'O i Dërguari i Allahut! Nuk kemi parë kurrë një arkivol kaq të lehtë për t'u mbajtur!' I Dërguari u përgjigj: ''**Engjëjt kanë zbritur dhe po e mbajnë atë''**

Kur xhenazja po shkonte për në varr, hipokritët u përpoqën ta përqeshnin, duke thënë: 'Sa i lehtë është!' Por Profeti tha: '**Për xhenazen e Sa'd-it zbritën**

[237] Ibni Sa'd, Tabakât, II, 75; Suheylî, Ravd-ul-unf, VI, 294.
[238] İbni Hishâm, Sîret, II, 245; Vâkıdî, Megâdhî, II, 519; İbni Sa'd, Tabakât, II, 75; Suheylî, Ravdu'l-unf, III, 449; İbni Kesîr, Sire, III, 242.
[239] İbni Hishâm, Sîret, II, 250.

shtatëdhjetë mijë engjëj. Nuk ka ndodhur më parë që të zbresin në tokë kaq shumë njëkohësisht.'

"Shamitë e Sad bin Muadhit në Xhenet janë më të bukura se kjo."
Hadith

Ebu Sa'id-il Hudri rrëfen se gjyshi i tij ka thënë: 'Unë isha një nga ata që hapëm varrin e Sadit. Kur filluam të hapnim varrin, një erë misku u përhap rreth e qark.' Sherahbil bin Hasene shtoi: 'Kur po e varrosnin Sad bin Muadhin, njëri mori një grusht dhe kur e çoi në shtëpi, ai dheu u kthye në misk.'Gjatë uljes së trupit të tij në varr, i Dërguari i Allahut u ul pranë varrit, sytë iu mbushën me lot dhe me dorë prekte mjekrën nga pikëllimi. Tha: '**Nga vdekja e Sad bin Muadhit u drodh Arshi**.'Madde një herë të Dërguarit të Allahut iu dhurua një rrobë shumë e çmuar. Shokët thanë: 'Sa e bukur është kjo rrobë!' Por i Dërguari tha: '**Shamitë e Sad bin Muadhit në Xhenet janë më të bukura se kjo**.'

Pasi Ebu Sufjani u kthye nga Beteja e Hendekut, një ditë, ndërsa qëndronte mes fisit të tij, tha: "A nuk ka ndonjë burrë që të marrë hakun tonë nga Muhamedi?" Një beduin, duke dëgjuar këtë fjalë, iu afrua Ebu Sufjanit dhe i tha: "Nëse plotëson nevojat e mia, unë e marr përsipër këtë punë. E njoh mirë rrugën, kam një hanxhar të mprehtë dhe nuk kam frikë nga askush."

Kërkesat e Ebû Sufjanit për Hakmarrje

Ebu Sufjani nede nuk e kishte kapërcyer inatin e betejës së Hendekut. Ndaj ai thirri një beduin dhe i tha të kërkonte çtë dëshironte vetem që të shkonte në Medina dhe të merrte informacion për planet e myslimanëve. Pası i plotësoi kërkesat e tij, i dha një deve dhe i kërkoi që këtë çështje ta mbante sekret. Beduini u nis natën nga Meka dhe mbërriti në Medinë pas një kohe të shkurtër. Atje mësoi se Profeti (paqja qoftë mbi të) ndodhej në mes të fisit Beni Abduleshel. Lidhi devenë e tij dhe u nis në këmbë drejt vendit ku ndodhej Profeti, i cili po mbante një fjalim në xhaminë e atij fisi.

Kur Profeti e pa beduinin që po afrohej, tha: "**Ky person ka qëllime të këqija, por Allahu, me mirësinë dhe dhuntinë e Tij, do të vendosë një pengesë midis meje dhe tij."** Ndërsa beduini po afrohej, Usaid bin Hudayir e ndaloi dhe i tha: "Rri larg nga i Dërguari i Allahut, o i mallkuar!" Pastaj vuri dorën te brezi i tij dhe vuri re një hanxhar. Ai kuptoi se beduini kishte qëllime të këqija dhe e ndaloi aty në vend. Beduini, duke u dridhur, prej frikës i ra në gjunjë dhe bërtiti: "Mos më vrit!" Por Usaidi nuk i tha asgjë dhe duke e kapur për krahu e çoi te Profeti elejhi selam. Profeti a.s. e pyeti: **"O beduin, thuaj të vërtetën! Kush je? Vetëm e vërteta do të të shpëtojë. Nëse gënjen, Allahu do të më informojë për qëllimet e tua."** Beduini kërkoi mëshirë dhe tregoi të gjitha planet e tij. Profeti urdhëroi që ai të arrestohej. Të nesërmen e sollën përsëri para tij, dhe Profeti i tha: "**Të kam dhënë lirik të sigurtë. Tani shko ku të duash. Por, kam një propozim më të mirë për ty."** Beduini pyeti: "Cili është propozimi?" Profeti iu përgjigj: **"Dëshmo për Njësinë e Allahut dhe për faktin se unë jam i Dërguari i Tij."** Beduini menjëherë tha shehadetin dhe u bë mysliman. Ai tha: "O i Dërguar i Allahut! Unë nuk kisha frikë nga askush. Por kur të pashë, mendja më iku. Ti e mësove atë që ishte në mendjen time, gjë që vetëm unë dhe Ebu Sufjani e dinim. Kuptova se ti je me të vërtetë i Dërguari i Allahut dhe se je nën mbrojtjen e Tij. Idetë e Ebu Sufjanit nuk janë asgjë tjetër vetëm se mendime djallëzore."

Pas këtij incidenti, Profeti (paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të) urdhëroi Amr bin Umejje dhe Damra bin Eslem të shkonin në Mekke dhe, nëse gjenin një

mundësi, të eliminonin Ebu Sufjanin. Të dy sahabët shkuan në Qabe për të bërë tavaf. Një skllave i njohu dhe bërtiti: "O Mekkanës! Mos u shpërqendroni! Këta janë Amr dhe Ibni Umejja!" Pasi njerëzit i njohën, të dy sahabët u ndanë. Amri u fsheh në një shpellë në malet e Mekkës, ndërsa Ibni Eslemi u kthye në Medinë. Pas disa ditësh, Amri doli nga shpella dhe hasi dy spiunë të Ebu Sufjanit. Njërin e vrau me një shigjetë, ndërsa tjetri arriti të shpëtojë. Më pas, Amri u kthye i sigurt në Medinë.

Kur Ebu Sufjani mësoi për këto ngjarje, u tmerrua shumë dhe e ndaloi mendimin për të nisur ndonjë sulm kundër myslimanëve.

Në vitin e pestë të Hixhretit ndodhën disa ngjarje të rëndësishme:

- Në muajin dhulkade, i Dërguari i Allahut (paqja qoftë mbi të) u martua me Zejneb binti Xhahshin.[240]

- Në këtë vit zbriti ajeti i hixhabit, duke i urdhëruar gratë myslimane të mbuloheshin[241].

- Fisi Mudheiudine, që jetonte pranë Medinës, dërgoi një delegacion dhe pranoi Islamin, duke u bërë pjesë e muhaxhirëve.[242]

- Ndodhi një tërmet dhe një eklips hënor.

- Po në këtë vit, haxhi u bë obligim për myslimanët.

Pas Betejës së Hendekut, disa fise pranë Medinës filluan ta pranonin fuqinë e Shtetit Islam dhe menduan se të bëheshin miq me myslimanët, madje të përqafonin Islamin, ishte zgjidhja më e mirë. Disa prej tyre erdhën në Medinë dhe pranuan Islamin.

I Dërguari i Allahut (paqja qoftë mbi të), për të përhapur Islamin, dërgoi grupe sahabësh që të ftonin fiset e tjera në fe. Në disa raste, ai shkoi vetë personalisht. Fise si banorët e Duma-tul-Xhendelit pranuan thirrjen dhe u bënë myslimanë, ndërsa fise si Gatfani dhe Lihjan u frikësuan nga ushtria islame dhe u larguan nga zonat përrreth Medines. Kështu, fiset përreth e kuptuan fuqinë e myslimanëve dhe filluan ta shihnin me frikë dhe respekt Shtetin Islam.

Ekspedita kundër fisit Beni Lihjan

Në ngjarjen e quajtur "Rexhi," fisit Beni Lihjan i ishin besuar disa myslimanë si Âsım bin Sâbit dhe Hubeib bin Adij (Allahu qoftë i kënaqur me ta), të cilët më pas i tradhtuan dhe i vranë. Ky akt e pikëlloi shumë të Dërguarin e Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të) po priste një moment të përshtatshëm për t'i ndëshkuar ata. Kur u krijuan kushtet, i Dërguari i Allahut u nis me një ushtri prej 200 burrash kundër tyre, duke lënë në Medinë si përfaqësues Abdullah ibn Umm Mektumin. Për të mashtruar armikun, ata u nisën sikur po shkonin drejt Shamit, por më pas arritën në vendin ku ishin vrarë myslimanët në ngjarjen Rexhi. Atje, i Dërguari i Allahut u lut për faljen e tyre. Kur njerëzit e Beni Lihjanit dëgjuan për ardhjen e myslimanëve, u larguan drejt maleve. Myslimanët qëndruan një ditë në atë vend dhe dërguan ushtarë për të kërkuar fisin, por nuk gjetën asnjë. Frika që përjetuan pjesëtarët e fisit Lihjan u mjaftoi atyre si ndëshkim. Më pas, myslimanët arritën në Usfan, ku i Dërguari i Allahut urdhëroi Ebu Bekrin (Allahu qoftë i kënaqur

[240] İbni Sa'd, Tabakât, III, 42; Taberî, Târih, II, 231.
[241] Buhârî, Tevhîd, 22; İbni Sa'd, Tabakât, VIII, 106
[242] İbni Sa'd, Tabakât, I, 291.

me të) të dërgonte një grup prej 10 burrash për të hulumtuar zonën deri në Ganím. Kur armiqtë dëgjuan për ushtrinë islame, u tmerruan dhe u fshehën në male.

Kjo ekspeditë ishte një shfaqje fuqie për fiset përreth dhe një paralajmërim për ata që mendonin të vepronin kundër myslimanëve. Pas një marshimi 14-ditor, ushtria islame u kthye në Medinë.

Beteja e Gâbes (Beteja-i Dhë Karde)

Kjo ekspeditë, e njohur edhe si Beteja e Karde, ndodhi kur disa armiq guxuan të preknin pasurinë e Profetit Muhamed (paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të). I Dërguari i Allahut kishte një tufë prej njëzet devash, të cilat ruheshin nga djali i Ebu Dherrit (Allahu qoftë i kënaqur me të). Një natë të mërkure, një grup prej 40 kalorësish të udhëhequr nga Uieyjne bin Hasini i fisit Feraze sulmuan tufën, vranë rojen dhe rrëmbyen devetë. Kur lajmi arriti tek Profeti (paqja qoftë mbi të), ai la Abdullah ibn Umm Mektumin si përfaqësues në Medinë dhe për të ndjekur armiqtë u nis me një ushtri prej 500 kalorësish. Ai caktoi Mikdad ibn Esvedin si mbajtës të flamurit dhe e dërgoi atë si pararojë. Po ashtu, dërgoi Seleme bin Ekvan (Allahu qoftë i kënaqur me të) për të ndjekur armikun.

I Dërguari i Allahut ngriti kampin në vendin e quajtur Dhë Karde. Pararojat e ushtrisë islame arritën të ndjekin prapavijën e armiqve. Gjatë betejës, Ebu Katade (Allahu qoftë i kënaqur me të) vrau një armik të quajtur Mesadet el-Fezari, ndërsa Ukashe (Allahu qoftë i kënaqur me të) vrau një tjetër të quajtur Iban bin Amr. Ndërsa nga ana myslimane vetëm një luftëtar ra dëshmor. Seleme bin Ekva, i njohur për shkathtësinë e tij në hedhjen e shigjetave, ndoqi armiqtë dhe vrau shumë prej tyre dhe u tërhoq duke i plagosur disa të tjerë. Ai arriti të rikuperonte dhjetë deve të rrëmbyera dhe detyroi armiqtë të braktisin mallrat e tyre. Kur Ebu Katade u kthye në kamp, i Dërguari i Allahut u lut për të:"**O Allah! Jepi Ebu Katades shëndet dhe bëje të jetojë i fortë deri në fund të jetës së tij."** Pastaj Profeti a.s. ia dha atij kalin dhe armët e Mesadet el-Fezarit si shpërblim.

Pa kaluar shumë erdhi Seleme bin Ekva me dy kuaj të marrë nga armiqtë. Profeti (paqja qoftë mbi të) e lavdëroi dhe tha: "**Sot kalorësi më i mirë është Ebu Katade dhe këmbësori më i mirë është Seleme bin Ekva."**

Kjo ekspeditë ishte një paralajmërim i fuqishëm për idhujtarët dhe fiset e tjera që synonin të sulmonin myslimanët. Myslimanët qëndruan në Dhë Karde për një natë dhe një ditë, pastaj u kthyen në Medinë. Ndërsa e gjithë espedita zgjati gjithsej pesë ditë.

Ardhja jote është mëshirë, o i Dërguar i Allahut,
Ardhja jote është shërim për zemrat, o i Dërguar i Allahut.

Ti ishe i zgjedhuri që kur Ademi ishte ende baltë,
Imami i të gjithë profetëve është vetem për ty, o i Dërguar i Allahut.

Drita jote ndriçoi kulmin e përsosmërisë,
Ekzistenca jote është manifestimi i plotë i Allahut, o i Dërguar i Allahut.

Me ty, njerëzit arritën kënaqësitë shpirtërore,
Ti je dhuratë për ata që kanë nevoja, o i Dërguar i Allahut.

Ndërmjetëso për Hydain, qoftë në botën e dukshme apo të fshehur,
Ai është një kërkues në pragun tënd, o i Dërguar i Allahut.

Aziz Muhamut Hydai

Lutja për Shiun

"Sot (në Gazën e Gabe-së) kalorësi më i mirë është Ebu Katade, ndërsa këmbësori më i mirë është Seleme bin Ekva."
Hadith

Në vitin e gjashtë të hixhretit, ndodhi një thatësirë e madhe. Asnjë pikë shi nuk kishte rënë nga qielli dhe toka nuk prodhonte më asgjë. Njerëzit dhe kafshët po përballeshin me urinë, etjen dhe vështirësitë e jetës. Në një ditë të xhuma, gjatë muajit të shenjtë të Ramazanit, shokët e Profetit (paqja qoftë mbi të) iu drejtuan atij duke i thënë: ''O i Dërguari i Allahut! A mund të bëni dua që Allahu të na dhurojë shi?''

I Dërguari i Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të) shkoi bashkë me shokët e tij në një vend të hapur jashtë qytetit. Pa u thirrur ezani Profeti fali dy rekate namaz. Pastaj ai e ktheu mantelin e tij të shenjtë mbrapsht dhe filloi të bëjë tekbire. Duke ngritur duart lart aq sa t'i dukeshin sqetullat, ai u lut: "**O Allah! Na dhuro shi!**"Të gjithë shokët e tij thërrisnin:"**Amin! Amin**!'' Në atë moment, qielli ishte krejtësisht i kthjellët dhe nuk kishte asnjë re. Ndërsa i Dërguari i Allahut po lutej, filloi të frynte një erë e lehtë dhe qielli filloi të mbulohej me re. Pas pak, nisi një shi i lehtë. Profeti (paqja qoftë mbi të) u lut përsëri, duke thënë: "**O Allah! Bëje këtë shi të rrjedhshëm dhe të dobishëm për ne!''** Në atë çast, shiu filloi të binte me të madhe, si të derdhej nga një kovë. Të gjithë, përfshirë edhe Profetin dhe shokët e tij, u lagën plotësisht. Rruga deri në shtëpi u mbush me ujë dhe njerëzit po ecnin në ujë. Atë ditë shiu vazhdoi të binte pa pushim. Shiu vazhdoi edhe ditën tjetër, madje sipas transmetimeve thuhet se shiu vazhdoi gjatë gjithë javës.

Në xhumanë e ardhshme, shokët e Profetit i thanë: "O i Dërguari i Allahut! Shtëpitë tona po shemben nga uji dhe kafshët po na mbyten. A mund të luteni që shiu të ndalet?'' Profeti (paqja qoftë mbi të) buzëqeshi, ngriti përsëri duart dhe u lut: "**O Zoti im! Dërgoje këtë shi në fusha, në toka me bimësi dhe në lugina!**" Në atë moment, shiu ndaloi dhe filloi të binte vetëm në vendet për të cilat ishte lutur Profeti (paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të).

Universi u mbush me dritë
Natën kur lindi Muhamedi,
Besimtari nga hipokriti u dallua,
Natën kur lindi Muhamedi.

Nga qielli në tokë dritë u hodh,
Të shtatët dhe të dyzetët u bashkuan,
Gjuha e murgut u lidh,
Natën kur lindi Muhamedi

RASTI I HUDEYBISË

Nijeti për Umre, përfundimi në Hudeybije

Ishte muaji Dhul-Kade i vitit të gjashtë të Hixhretit. Një natë, i Dërguari i Allahut (s.a.s.) pa në ëndërr se si ai dhe shokët e tij po shkonin në Mekën e Shenjtë dhe po kryenin tavaf rreth Qabes së Bekuar. Disa prej tyre i kishin shkurtuar flokët, ndërsa të tjerët i kishin rruar. Kur i Dërguari (s.a.s.) ua tregoi këtë ëndërr shokëve të tij, ata u emocionuan shumë. Që nga hixhreti, ata nuk e kishin parë më Mekën, vendlindjen e tyre, që mbante kujtime të ëmbla e të hidhura. Tani do të kishin mundësinë të shkonin dhe të vizitonin Qaben e Shenjtë, drejt së cilës ktheheshin pesë herë në ditë gjatë namazit. Pra ky ishte një lajm i mrekullueshëm për sahabët! Sahabët me

entuziazëm filluan përgatitjet. I Dërguari i Allahut (s.a.s.) la Abdullah ibn Umm-i Mektumin si zëvendës në Medinë dhe ditën e parë të së hënës të muajit Dhul-Kade, hipi në devenë e tij të quajtur Kusva dhe së bashku me 1,400 shokët e tij u nis drejt Mekës. Të gjithë kishin bërë nijetin për umre dhe kishin marrë me vete vetëm shpatat si armë udhëtimi dhe 70 deve për kurban. Në grup kishte edhe katër gra, përfshirë Ummu Seleme (r.a.), bashkëshorten e nderuar të Profetit.

Në vendin e mikatit, të quajtur Dhul-Hulejfe, ata u ndalën për të veshur ihramin dhe për të falur namazin e drekës. Pastaj, shënuan devetë e tyre për kurban dhe filluan të thërrasin telbijen: **"Lebbeyk! Allahumme Lebbeyk! Lebbeyk! Lâ sherîke leke Lebbeyk! Innel hamde venni'mete leke vel-mulke lâ sherîke lek!"** ("Të përgjigjemi thirrjes Tënde, o Allah! Të përgjigjemi pa pushim, Ty që s'ke të barabartë! Lavdërimi, mirësitë dhe sundimi janë vetëm për Ty. Ti nuk ke asnjë shok!")

"Për hir të Allahut të Lartësuar, çfarëdo që Kurejshët të kërkojnë prej meje, me kusht që të respektojnë Bejtin e Shenjtë, do ta pranoj."
Hadith

Dhul-Hulejfe nga zërat e tyre u mbush me një atmosferë të ndritshme. Duke përshkuar rrugën, disa shokë, përfshirë Omerin dhe Sa'd bin Ubade, i shprehën shqetësimet e tyre të Dërguarit (s.a.s.): "O i Dërguari i Allahut! A do të shkojmë pa armë drejt atyre që janë ende në luftë me ne? Pra nëse kurejshët na sulmojnë dhe të dëmtojnë ty ne çfar mundësi të bejmë pa armë?" I Dërguari i Allahut (s.a.s.) ju përgjigj me qetësi: **"Unë kam bërë nijetin për umre. Ndaj që duke qenë në këtë gjendje nuk dua të mbaj armë."**

Rrugëtimi po kalonte qetësisht. Në rrugë, i Dërguari i Allahut (s.a.s.) ndalej te fiset e ndryshme dhe i ftonte ata në Islam. Disa prej tyre ngurronin të pranonin, ndërsa të tjerët i dërgonin dhurata. Duke kaluar më shumë se gjysmën e rrugës, karvani arriti në vendin e quajtur Gadîr-ul-Eshtât pas Usfanit. Në këtë vend, Bishr bin Sufiân (r.a.), i cili më herët ishte dërguar për të përcjellë një mesazh tek kurejshët, u kthye dhe i tregoi Profetit (s.a.s.) ato që kishte parë, ai i tha"O i Dërguari i Allahut! Kurejshët kanë marrë vesh se po vjen dhe prej frikës që kanë, ftuan fiset përreth dhe kanë kërkuar ndihmën e tyre kundër jush. Ata për të marrë masa kundër jush kanë dërguar një njësi prej 200 kalorësish, te cilët janë bashkuar në vendin Beldah. Pra kurejshët kanë bërë përgatitje të mëdha ushtarake dhe janë betuar se nuk do të të lejojnë ty të hysh në Mekke."[243]

Kur dëgjoi këtë lajm, i Dërguari i Allahut (s.a.s.) u prek shumë dhe tha: "**Kurejshët janë të shkatërruar. Lufta ndërmjet nesh tashmë ka mbaruar. A mos vallë kurejshët mendojnë se kanë ndonjë forcë kundër meje? Për Allah, derisa kjo fe të mbizotërojë dhe të përhapet në mbarë rruzullin toksorë, toksor dhe derisa koka ime të ndahet nga trupi, unë nuk do të ndalem së luftuari me ta!**" Më pas, i Dërguari (s.a.s.), për të kërkuar mendimet e tyre, u drejtua te shokët e tij të dashur. Shokët e tij besnikë, të përkushtuar ndaj Profetit me gjithë qenien e tyre, i thanë:"Allahu dhe i Dërguari i Tij e dinë më së miri. Jeta jonë të qoftë flijuar ty, o i Dërguari i Allahut! Ne kemi dalë me nijetin për të bërë tavaf rreth Qabes. Nuk kemi ardhur as për të vrarë e as për të luftuar. Por, nëse ata na pengojnë që të vizitojmë Qaben, do të luftojmë deri sa të arrijmë qëllimin tonë!" Vendosmëria e sahabëve e kënaqi shumë të Dërguarin e Allahut (s.a.s.), i cili tha:"**Atëherë, ecni në emër të Allahut të Madhëruar!**"

[243] Vâkıdî, Megâdhî, II, 574; İbni Sa'd, Tabakât, II, 95.

"A mos vallë kurejshët mendojnë se kanë ndonjë forcë kundër meje? Për Allah, derisa kjo fe të mbizotërojë dhe të përhapet në mbarë rruzullin toksorë, toksor dhe derisa koka ime të ndahet nga trupi, unë nuk do të ndalem së luftuari me ta!"
Hadith

Sahabët, duke thirrur: "**Lebbeyk! Allahumme Lebbeyk**!..."dhe duke thënë: "**Allahu Ekber! Allahu Ekber!**...'', Po ecnin me vendosmëri drejt Mekkës. Kur arritën në një vend për të falur namazin e drekës, Bilali (r.a.) i qetësoi të gjithë me ezanin e tij të bukur, duke shpallur hyrjen e kohës së namazit. Ndërkohë, një njësi prej 200 kalorësish të kurejshëve arriti aty dhe u pozicionua midis sahabëve dhe Mekkës, gati për sulm. Mirëpo i Dërguari i Allahut (s.a.s.) dhe sahabët e tij nuk u tronditën nga pozicionimi i tyre. Në të kundërt ata u rreshtuan për namaz. Pamja e më shumë se 1,400 sahabëve të rreshtuar në kurriz të tokës, të palëvizshëm në kijam, të përkulur në ruku dhe të ulur në sexhde ishte madhështore. Të gjitha së bashku ata dukeshin sikur një mal i fuqishëm po përulej dhe ngrihej përsëri në madhësinë e tij.

Gjatë përkuljes së tyre Allahut të Lartësuar në sexhde u bë shkak që disa nga kalorësit e Kurejshëve filluan të ndienin dashuri për Islamin në zemrat e tyre. Kur sahabët dolën nga namazi, komandanti i kalorësve të Kurejshëve tha: "Nëse do të kishim sulmuar myslimanët kur ata ishin në namaz, do të kishim vrarë shumicën prej tyre! Pra në gabuam që nuk i sulmuam kur ata ishin duke u falur?" Më pas ai shtoi: "Mos u dëshproni sepse ata do të falin një namaz tjetër që është më i dashur për ta se shpirtrat dhe fëmijët e tyre. Ndaj rrini gati që ne atëherë të mos humbasim mundësi!" Pra mushrikët filluan të prisnin ardhjen e namazit të ikindisë që ti sulmonin myslimanët kur ata të ishin në namaz. Por Allahu i Lartësuar, i Cili dëgjon dhe shikon gjithçka, planin e mushrikëve ia përcolli Profetit të Tij përmes Xhibrilit (alejhi selam). Në ajetin e shpallur thuhej: ''**Kur të jesh ti (Muhamed) në mes të besimtarëve dhe të drejtosh faljen e namazit (në luftë), atëherë njëri grup prej tyre le të falet me ty dhe le t'i mbajnë pranë edhe armët e veta! Pastaj këta, le të rrinë pas jush dhe le të vijë grupi tjetër, i cili nuk është falur dhe, le të falet me ty! Le të jenë syçelë dhe t'i mbajnë armët e veta! Jobesimtarët dëshirojnë që të jeni të pakujdesshëm ndaj armëve dhe pajimeve tuaja, që t'ju sulmojnë me tërë fuqinë. Nuk ka gjynah për ju nëse hasni në ndonjë shqetësim prej shiut ose sëmundjes e i lini armët, por edhe atëherë, bëhuni syçelë. Allahu, me të vërtetë, ka përgatitur dënim poshtërues për jobesimtarët.**'' [244](Kurani, Surja En-Nisa, 102)

Kur erdhi koha e ikindisë, Bilali (radijallahu anhu) thirri ezanin. Kalorësit e Kurejshëve, të cilët qëndronin të gatshëm për sulm, ishin zhvendosur ndërmjet Mekkës dhe sahabëve. Profeti (paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të) i udhëzoi sahabët të faleshin sipas ajetit të shpallur. Myslimanët falën namazin me kujdes të madh, ndërsa idhujtarët mbetën të habitur nga kjo strategji. Allahu i Lartësuar mbolli frikë në zemrat e tyre dhe ata nuk patën guxim të ndërmerrnin asnjë veprim. Në fund, ata u larguan me plot habi dhe u nisën për të dërguar lajme në Mekkë. Ndërsa Profeti (paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të) dhe shokët e tij filluan udhëtimin drejt Mekkës.

Kur arritën në kufijtë e Mekkëski së shenjtë, deveja e Profetit, Kusva, papritmas dhe pa ndonjë arsye të dukshme u ul në tokë. Edhe pse u përpoqën shumë ta ngrinin, ajo nuk lëvizi. Atëherë Profeti (paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të) tha: "**Kusva nuk ka zakon të ulet kështu. Por Allahu, i Cili ndaloi elefantin (e Ebrehes) të**

[244] En-Nisa, 102

Udhëtimi drejt Hudeybijesë



hynte në Mekkë, tani po ndalon Kusvanë. Për Atë që mban shpirtin tim në dorë, nëse Kurejshët kërkojnë prej meje diçka që Allahu e ka shpallur të ndaluar brenda Haram-it (si lufta dhe derdhja e gjakut), unë patjetër do ta pranoj kërkesën e tyre!"

"O Urve! Për Allahun, më thuaj: A mund të pengohet therja e këtyre kafshëve që janë kurban? A mund të ndalohet tavafi dhe vizita në Qabe?"
Hadith

Sahabët u përpoqën ta ngrinin Kusvanë. Deveja u çua me hov, por nuk hyri brenda kufijve të Haremit. Ajo ndaloi në Hudajbije, një vend i vendosur pikërisht në kufirin e shenjtë. Profeti (paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të) dhe sahabët e tij u vendosën në këtë zonë, mirëpo në këtë zonë uji ishte i paktë. Çadra e Profetit u ngrit jashtë kufirit të shenjtë të Mekës, ndërsa sahabët prisnin me durim udhëzimet e Pejgamberit alejhi selam. Kur vinte koha e namazit, ata falnin namazet brenda kufijve të shenjtë të Mekës.

Sahabët ja nisin të kerkonin ujë nëpër puset përrreth mirëpo ujërat e puseve prej thatësirës kishin shteruar. Sahabët shkuan te Profeti alejhi selam dhe i thanë:"Jeta jonë të jetë flijim për ty, o i Dërguari i Allahut! Neve nuk kemi më ujë, përveç atij në enën tuaj. Pra ne jemi në vështirësi të madhe prej pa ujësisë." Profeti (paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të) me qëtësi ju tha:"**Mos u shqetësoni se për sa kohë që jam me ju, ju kurrë nuk do të shkatërroheni.**" Më pas, ai mori enën me ujë dhe duke thënë "Bismilah" e vendosi dorën e tij të bekuar mbi të. Kur ngriti dorën, uji filloi të buronte nga gishtat e tij siKur të ishte një krua. Kur uji filloi të rridhte Profeti ju tha sahabëve;"**Ejani! Pini dhe merrni ujë!**"

Sahabët pinë ujë deri sa u ngopën, morën abdes, mbushën enët e tyre dhe ujitën edhe kafshët e tyre. Profeti (paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të) i vëzhgoi ata me një buzëqeshje plot mëshirë dhe falënderoi Allahun. Xhabiri (radijallahu anhu), që ishte aty atë ditë, trasnmeton se"Ne ishim një mijë e katërqind vetë. Edhe sikur të ishim njëqind mijë, ai ujë do të mjaftonte për të gjithë ne."

Beslidhja e Ridhvanit

Gjatë kohës që Profeti dhe sahabët e tij qëndronin në Hudajbije, udhëheqësi i fisit Huzaa, një fis që kishte qenë miqësor ndaj myslimanëve, erdhi për të biseduar me të. Ai i tregoi Profetit alejhi selam se Kurejshët me ndihmën e fiseve të tjera kishin mbledhur një ushtri të madhe dhe ishin të vendosur në Hudajbije për të luftuar deri sa të shpërbëheshin ushtritë që do ti sulmonin ata. Profeti (paqja qoftë mbi të) u përgjigj: "**Ne nuk kemi ardhur këtu për të luftuar me askënd. Ne kemi ardhur vetëm për të kryer Umren, për të vizituar dhe bërë tavafin rreth Qabes. Por, nëse dikush na pengon për ta vizituar Shtëpinë e Shenjtë të Allahut, atëherë do të luftojmë. Luftërat e mëparshme tashmë i kanë dëmtuar rëndë Kurejshët dhe i kanë dobësuar shumë ata. Nëse ata dëshirojnë, mund të caktojmë një periudhë armëpushimi, gjatë së cilës ata do të jenë të sigurt nga ne. Në këmbim, ata nuk duhet të ndërhyjnë midis meje dhe fiseve të tjera. Nëse gjatë kësaj periudhe fiset e tjera pranojnë Islamin, atëherë Kurejshët mund të bëjnë të njëjtën gjë. Por, nëse ata nuk e pranojnë këtë dhe vendosin të luftojnë, betohem në Allahun se do të luftoj derisa të jap jetën për këtë kauzë. Allahu patjetër do të përmbushë premtimin e Tij për mua**."

Pas këtyre fjalëve, udhëheqësi i Huzas, Budajli, për t'ua përcjellë mesazhin Kurejshëveu nis për në kampin ku ata ishin zhvendosur. Pasi dëgjuan kurejshët ato që kishte thënë Profeti, vendosën të dërgonin një përfaqësues të tyre, Urve bin

Mesud, për të negociuar me të. Kur Urve mbërriti te Profeti alejhi selam i tha atij se Kurejshët janë të vendosur që të mos lejonin askënd të hynte në Mekkë. Profeti iu përgjigj: "**O Urve! Për Allahun, më thuaj: A mund të pengohet therja e këtyre kafshëve që janë kurban? A mund të ndalohet tavafi dhe vizita në Qabe?''** Më pas, Profeti alejhi selam përsëriti të njëjtat fjalë që i kishte thënë Budajlit, duke e bërë të qartë qëllimin e tij paqësor.

Ndërkohë që Urve dëgjonte fjalët e të Dërguarit të Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të), vëzhgonte sjelljet e sahabëve dhe respektin e thellë që ata i tregonin Profetit alejhi selam. Ai e kuptoi qartë dashurinë dhe përkushtimin e tyre të jashtëzakonshëm ndaj Profetit dhe kur u kthye ju tha mushrikëve kurejshitë:"O popull i Kurejshëve! Ju e dini se unë kam qenë i dërguar në oborret e mbretërve si Kajseri, Nexhashiu dhe Kisra. Betohem se kurrë nuk kam parë një njeri që të respektohet dhe nderohet ashtu siç bëjnë myslimanët për Muhamedin. Asnjëri prej sahabëve të tij nuk flet pa marrë leje prej tij. Nëse një fije floku e tij bie, ata nxitojnë ta marrin dhe e ruajnë si bekim. Kur flasin pranë tij, zërin e ulin aq shumë sa mezi dëgjohet. Nga respekti i madh për të, ata nuk e shikojnë drejt në fytyrë dhe mbajnë sytë ulur. Nëse ai u jep një urdhër, ata bëjnë gjithçka për ta përmbushur, edhe nëse kjo do t'u kushtonte jetën e tyre. O popull i Kurejshëve! Edhe sikur të përdorni të gjitha mjetet dhe fuqinë tuaj, ata nuk do t'ju dorëzojnë as një fije floku të Profetit të tyre. Ata nuk do të lejojnë askënd t'i shkaktojë dëm apo t'i afrohet atij. Situata është e tillë. Mendoni mirë se çfarë do të bëni më tej! Ndërkohë, Muhamedi ju ka bërë një ofertë të drejtë paqeje. Pra përfitoni nga kjo mundësi!"

Mirëpo Kurejshët në vënd se ta dëgjonin këshillën e tij, filluan dhe u sollën keq me të, duke e fyer dhe duke e zemëruar Urven. Nga ana tjetër pasi nuk kishte marrë ende asnjë përgjigje pozitive nga kampi i Kurejshëve, Profeti (paqja qoftë mbi të) dërgoi Hiraash bin Umejjen si të dërguar për të përsëritur ofertën e tij. Por Kurejshët u sollën edhe më keq me të: ata therën devenë e tij dhe e përdorën për ushqim. Për më tepër, u përpoqën ta vrisnin Hiraashin, por ai arriti të shpëtonte me shumë vështirësi dhe u kthye te Profeti për ta informuar për situatën që i kishte ndodhur. Kur dëgjoi për këtë trajtim barbar nga ana e Kurejshëve ndaj shokut të tij, Profeti (paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të) u ndje i pikëlluar dhe i zemëruar. Ndërkohë që nga kampi i idhujtarëve u shfaq kryetari i fisit Ahabis, i cili quhej Huleis.

Huleisi erdhi duke iu drejtuar Profetit Muhamed alejhi selam si përfaqësues kurejshëve. Kur Profeti e pa Huleisin, tha: "**Ky që po vjen, i përket një fisi që respekton kurbanët dhe u përkushtohet adhurimeve ndaj Allahut. (O sahabë!) Dërgojini kurbanët në drejtimin e tij që ti shohë!**" Sahabët i lëshuan devetë e kurbanit drejt Huleisit dhe filluan të gjithë njëzëri: "Lebbejk! Allahumme Lebbejk!" (Ja, këtu jam, O Zot!). Nga ana tjetër Huleisi sapo pa devetë e lidhura, me veshët e shënuar në shenjë kurbani dhe dëgjoi tekbiret e shabëve, kuptoi se ata vërtetë kishin ardhur vetem për umre ndaj atij ju mbushën sytë me lot. Uleisi ashtu me sytë e përlotur dhe me një zë të pikëlluar tha: "Myslimanët nuk kanë asnjë qëllim tjetër përveçse të vizitojnë Qaben. Ti ndalosh ata nga kjo është një padrejtësi e madhe! Betohem në Zotin e Qabes se nese kurejshët nuk do i lejojnë ata të kryejnë umran prej kësaj padrejtësi do të shkatërrohen plotësisht!" Profeti alejhi selam u gëzua kur dëgjoi prej tij këto fjalë, ndaj ju pergjigj atij duke i thënë: "**Po, ashtu është, o vëlla nga fisi Kinane**." Huleisi, i turpëruar, nuk arriti të afrohej te Profeti aelejhi selam apo ta shihte atë në fytyrë. Ai u kthye në kampin e kurejshëve dhe u tha atyre

"Ata që bënë aktin e besëlidhjes nën këtë pemë nuk do të hyjnë në zjarrin e Xhehennemit."
Hadith

se: "Unë nuk e mbështes veprimin tuaj për ta ndaluar atë nga vizita e Qabes." Kurejshët u zemëruan me të dhe e akuzuan atë për padije. Më pas, kurejshët dërguan Mikrez bin Hafsin, i cili ishte njohur për ashpërsinë e tij, por as ai nuk arriti të zgjidhte gjë. Pas kësaj, kurejshët u frikësuan nga një sulm i mundshëm i myslimanëve. Përfundimisht Profeti Muhamed (paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të) vendosi të dërgojë një sahabë me ndikim të lartë për të negociuar dhe vendimi ra mbi Osman bin Affanin.

Profeti i tha Osmanit radijallahu anhu: "**Ne nuk kemi ardhur këtu për të luftuar me askënd. Qëllimi ynë është vetëm të kryejmë tavafin dhe të therim kurbanët. Thuaju kurejshëve se, pasi të kryejmë këto do të largohemi nga Mekka. Gjithashtu, ftoji ata në Islam dhe jepu myslimanëve të Mekës lajmin e mirë se fitorja është afër.**"[245] Osmani r.a ua përcolli kurejshëve fjalët e Profetit, por ata refuzuan. Në vend të kësaj, i thanë se ai mund ta kryente tavafin vetë, por Osmani ju tha se: "Unë nuk do të bëj tavafin pa Resulullahun." Pra, kurejshët jo që nuk e pranuan por e ndaluan Osmanin të kthehej te Profeti alejhi selam. Pas ndalimit të Osmanit r.a. u përhap lajmi i rremë se Osmani ishte vrarë dhe ky lajm arriti te myslimanët, të cilëve u shkaktoi shqetësim dhe zemërim thellë. Kur arriti lajmi tek Profeti alejhi selam ai tha: "**Nëse ky lajm është i vërtetë, ne nuk do të largohemi nga këtu pa luftuar me ta**." Më pas ai u ul nën një pemë të quajtur Pemë e Ridhvanit dhe tha: "**Allahut i ka pëlqyer që ju të bëni besëlidhje me mua**." Më pas sahabët, një nga një, vunë dorën e tyre mbi dorën e Profetit dhe dhanë besën duke thënë: "Ne do të luftojmë për Islamin derisa Allahu të na japë fitoren ose të biem dëshmorë." Profeti vendosi dorën e tij mbi të vetën për të bërë biat edhe në emër të Osmanit radijallahu anhu, i cili kishte mbetur peng tek mushrikët. Pastaj Profeti alejhi selam tha: "**Ata që bënë aktin e besëlidhjes nën këtë pemë nuk do të hyjnë në zjarrin e Xhehennemit.**'' Ky akt u quajt **Biat-ı Ridhvan** (Besëlidhja e Kënaqësisë)[246].

Sahabët e nderuar (radijallahu anhum) tashmë ishin gati, me shpatat e tyre të shtrënguara në duar, po pritnin vetëm një shenjë nga i Dërguari i Allahut. Ndërkohë, spiunët e Kurejshëve, që po vëzhgonin kampin e myslimanëve, panë se luftëtarët myslimanë kishin dhënë besën për të luftuar deri në dëshmorësi përkrah të dashurit të tyre, Profetit Muhamed (paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të). Pra, sipiunet e mushrikëve panë që sahabët ishin të përgatitur për çdo lloj situate. Ndaj ata shkuan menjëherë në kampin e Kurejshëve dhe i raportuan për atë që po ndodhte ne kampin e myslimanëve.

Nga ana tjetër Profeti ynë i dashur, për të shmangur çdo rrezik dhe për të mbrojtur kampin e myslimanëve caktonte rojtarë gjatë natës. Një natë, kur Osmani ishte ende i peng nga Kurejshët, një grup prej pesëdhjetë personash të udhëhequr nga Mikrez u përpoq të sulmonte myslimanët në befasi. Por atë natë, Muhamed bin Mesleme dhe disa shokë të tij ishin roje. Pas një përleshjeje të shkurtër, ata i zunë rob të gjithë sulmuesit, përveç Mikrezit, i cili arriti të shpëtonte. Të kapurit rob u çuan përpara të Dërguarit të Allahut. Disa prej tyre i burgosën, ndërsa të tjerët u liruan. Edhe të nesërmen, Kurejshët u përpoqën të organizonin një tjetër sulm, por sërish u kapën dhe Profeti i mëshirshëm i fali dhe i liroi.

[245] İbni Sa'd, Tabakât, II, 97.

Marrëveshja e Hudeibies

Kurejshët tashmë e panë që ushtria myslimane ishte gjithnjë e gatshme për luftë dhe se nuk mposhteshin as ditën dhe as natën. Madje kurejshët kuptuan se po të donin myslimanët mund ti sulmonin ata në çdo moment, për këtë shkak ata ndien një frikë të thellë në zemrat e tyre. Pra kurejshët kuptuan që nuk kishin zgjidhje tjetër veç se të negociojnë një marrëveshje me msylimanet. Në fund ata zgjodhën një delegacion të kryesuar nga Suhejl bin Amr, të cilit i thanë: "Përpiqu të arrini një marrëveshje, me kusht që këtë vit myslimanët të mos hyjnë në Mekkë." Profeti ynë i dashur e pranoi delegacionin e Kurejshëve dhe filloi bisedimet për një marrëveshje me ta.

I Dërguari i Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të) priti delegacionin e Kurejshëve dhe filloi të dëgjoi kërkesat e tyre. Kërkesa e tyre e parë ishte që të liroheshin njerëzit e tyre të kapur peng nga myslimanët. I Dashuri i Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të) tha: "**Përderisa nuk lironi shokët e mi që keni burgosur në Mekkë, unë nuk do ti liroj njerëzit tuaj**!" Suhejli pranoi që të lironte Osman bin Afvanin dhe dhjetë sahabë të tjerë, të cilët ishin burgosur më parë nga Kurejshët. Në këmbim të këtyre, u liruan dhe të burgosurit e Kurejshëve nga myslimanët.

Pas negociatave të gjata, u arrit një marrëveshje, mirëpo ishte koha që ajo të shkruhej dhe Aliu radijallahu anhu u caktua si shkrues i kësaj marrëvështje. Profeti i Allahut (paqja mëshira dhe begatitë e Allahut qofshin mbi të) i tha Aliut: "**Shkruaj: Bismilahirrahmanirrahim!**", Suhejli kundërshtoi duke thënë: "Betohem se nuk e njoh fjalën 'Rahman'. Shkruaje: 'Bismike Allahumme', ndryshe nuk do ta nënshkruaj marrëveshjen." Duke parë rëndësinë e paqes, Profeti alejhi selam tha: "**Edhe 'Bismike Allahumme' është e mirë**" dhe e urdhëroi Aliun ta shkruante kështu.

Më pas, Profeti vazhdoi: **"Ky është një dokument që përmban kushtet e arritura në marrveshjen ndërmjet Muhamedit, të Dërguarit të Allahut, dhe Suhejlit bin Amr."** Por Suhejli ndërhyri përsëri, duke thënë: "Ne nuk pranojmë që të shkruhet 'I Dërguari i Allahut'. Nëse do ta pranonim këtë, nuk do të ishim në kundërshtim me ty. Shkruaje 'Muhamed, biri i Abdullahut'."

Edhe pse shokët e Profetit u shqetësuan dhe kundërshtuan fuqishëm këtë ndryshim, Profeti i Allahut, me urtësinë e tij, tha: "**Edhe pse ju më mohoni, unë, pa dyshim jam i Dërguari i Allahut. Të shkruarit e emrit tim si 'Muhamed, biri i Abdullahut', nuk e ndryshon faktin që unë jam i Dërguari i Tij**." Pastaj, me urdhërin e tij, Aliut iu kërkua ta fshinte këtë pjesë, por Aliu r.a. tha: "**O i Dërguar i Allahut! Unë nuk mund ta bind veten për të fshirë titullin tënd të bekuar**." Atëherë Profeti alejhi selam kërkoi ti tregonte vendin ku shkruhej ''I Dërguri i Allahut'' dhe e fshiu vetë me dorën e tij të bekuar dhe tha tanı shkruaj: "**Muhamedi, biri i Abdullahut."**

Më pas, filluan të shkruheshin kushtet e marrëveshjes:

1. Marrëveshja do të jetë e vlefshme për dhjetë vjet dhe gjatë kësaj kohe, asnjëra palë nuk do të luftojë kundër tjetrës.
2. Myslimanët nuk do ta vizitojnë Qaben këtë vit, por do të lejohen ta vizitojnë pas një viti.
3. Vizitorët myslimanë do të qëndrojnë në Mekkë për tre ditë dhe nuk do të

[246] Buhârî, Megâdhi, 19; Ahmed bin Hanbel, Musned, I, 59; Vâkıdî, Megâdhî, I, 279; İbni Sa'd, Tabakât, II, 97.

mbajnë me vete armë përveç atyre që janë të nevojshme për udhëtim.

''(O Ebu Xhendel)! Bëj durim edhe pak! Duaje shpërblimin te Allahu për këtë që po kalon. Allahu me siguri do t'ju japë ty dhe myslimanëve të tjerë të pafuqishëm një rrugëdalje.''
Hadith

4. Gjatë kohës që myslimanët bëjnë tavaf në Qabe, banorët e Mekkës do të largohen nga Mekka që të mos i pengojnë myslimanët për adhurim.
5. Nëse një mysliman largohet nga Kurejshët dhe shkon në Medinë pa lejen e kujdestarit të tij, ai do ti kthehet Kurejshëve. Por edhe nëse dikush largohet nga myslimanët dhe shkon te Kurejshët, ai nuk do ti kthehet myslimanëve. Omeri radijallahu anhu u ngrit në këmbë dhe tha kjo nuk është e drejtë dhe duke u kthyer nga I Dërguari i Allahut dhe i tha ''O i Dërguari i Allahut! Edhe këtë do e pranosh!'' İ Dërguari i Allahut i tha; ''**O Omer! Nëse dikush kërkon të iki nga ne, Allahu e largoftë atë prej nesh!**''
6. Myslimanët që shkojnë në Mekë për haxh ose umre do të jenë të sigurt në jetën dhe pasurinë e tyre.
7. Po ashtu, edhe ata që kalojnë në Medinë duke shkuar në drejtim të Shamit ose Egjiptit do të jenë të sigurt në jetën dhe pasurinë e tyre.
8. Fiset arabe do të jenë të lira të zgjedhin anën e myslimanëve ose të Kurejshëve.[247]

Pas përfundimit të marrëveshjes dhe përgatitjes së dokumentit, myslimanët vunë re një njeri të lidhur me zinxhirë, i cili po afrohej drejt kampit të tyre... Ai po afrohej me ngut dhe duke thirrur: "Më shpëtoni!..." Këtë britmë e dëgjoi udhëheqësi i delegacionit të Kurejshëve, i cili menjëherë u ngrit nga vendi dhe duke kapur një degë peme me gdhena filloi ta godiste në kokë dhe fytyrë. Sklavi i dëshpëruar u përpoq dhe përdori gjithë forcën që kishte për të shkuar te këmbët e bekuara të të Dërguarit të Allahut dhe i thoshte atij: "Më shpëto, o i Dërguar i Allahut!" Ky ishte një mysliman, i cili për shkak të përqafimit të Islamit, babai i tij kishte lidhur me zinxhirë në Mekkë. Çdo ditë i nënshtrohej torturave të rënda dhe detyrohej të adhuronte idhujt. Ai duke përfituar nga mungesa e politeistëve që kishin shkuar në Hudejbijë, kishte thyer zinxhirët dhe kishte arritur të shpëtonte nga Mekka pa u vënë re nga mushrikët. Mirëpo përpjekja e tij kihste qene për te iu bashkuar myslimanëve. Ky njeri i bekuar, që kishte gjetur udhëzimin në Islam, ishte Ebu Xhendeli, biri i prijësit të delegacionit politeist, Suhejlit. Djali i Suhejlit tashmë kishte arritur te I Dërguari i Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të), por tashmë sapo ishte firmosur një marrëveshje. Ndaj Suhejli i tha të Dërguarit të Allahut, duke treguar të birin me gisht:"O Muhammed! Ky është njeriu i parë që, sipas marrëveshjes që sapo e shkruam, duhet të ma dorëzosh.'' I Dërguari i Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të) dhe shokët e tij u shokuan dhe u pikëlluan shumë nga kjo gjëndje. Të gjithë prisnin me ankth se çfarë përgjigje do të jepte i Dërguari i Allahut. Nga njëra anë ishte marrëveshja, nga ana tjetër një njeri i torturuar në mënyrë barbare. I Dërguari i Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të) i tha Suhejlit: "**Ne e kemi shkruajtur por ende nuk e kemi nënshkruar këtë marrëveshje!''** Por Suhejli ngulte këmbë dhe thoshte:"O Muhamed! Ne e përfunduam marrëveshjen para se të vinte im bir. Nëse nuk ma dorëzon tim bir, atëherë unë nuk do ta

[247] Buhârî, Megâdhi, 35; Ebû Dâvûd, Cihâd, 168; Ahmed bin Hanbel, Musned, IV, 323; İbni Hishâm, Sîret, II, 307; Vâkıdî, Megâdhî, II, 608; İbni Sa'd, Tabakât, II, 97-98.

"Me të vërtetë që Ne të kemi dhënë ty (O Muhammed) fitore të qartë."
El-Fet'h, 1.

nënshkruaj marrëveshjen.'' I Dërguari i Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të) e luti Suhejlin duke i thënë: **"O Suhejl! Ma lër atë për hatrin tim!"** Politeistët nuk pranuan dhe këmbëngulnin që Profeti alejhi selam të ja dorëzonte të birin e Suhejlit. Suhejli e tërhoqi birin e tij me forcë, ndërsa Ebu Xhendeli thërriste:"O i Dërguar i Allahut! O vëllezërit e mi myslimanë! Pasi pata nderin të bëhem mysliman dhe kërkova strehim tek ju, tani më po dorëzoni te politeistët? Po më dënoni të duroj torturat e tyre të përditshme? Po më ktheni te ata që më dhunojnë dhe detyrojnë të braktis fenë time?"

Këto thirrje prekëse të Ebu Xhendelit i pikëlluan aq shumë sahabët sa që disa prej tyre filluan të qanin. Madje edhe i Dërguari i Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të), u prek aq shumë sa që lotët i rrodhën në faqe. Ai iu drejtua Suhejlit duke ju lut përsëri: "**Të lutem, mos e bëj këtë! Ma lër atë!**" Por përpjekja e Profetit alejhi selam binte në veshët e shurdhër sepse Suhejli iu përgjigj me ashpërsi duke i thënë"O Muhammed! Kjo është pamundur, nuk e lë tim bir!'' Atëherë i Dërguari i Allahut iu kthye Ebu Xhendelit dhe i tha: "**Bëj durim edhe pak! Duaje shpërblimin te Allahu për këtë që po kalon. Allahu me siguri do t'ju japë ty dhe myslimanëve të tjerë të pafuqishëm një rrugëdalje.**" Më pas i Dërguari i Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të) duke u kthyer nga të tjerët tha: "**Ne nuk mund të prishim fjalën tonë.**"

Ebu Xhendeli, e pa vështirësine e Pejgamberit alejhi selam dhe me një me zemër të thyer, tha: "Në rregull, o i Dërguar i Allahut," dhe pranoi të bëjë durim. Ndërsa ne mesin e politeistëve që u prekën nga kjo skenë u ngritën dhe i thanë: "O Muhamed, për hatrin tënd, ne do ta mbrojmë Ebu Xhendelin dhe nuk do të lejojmë që Suhejli ta torturojë atë."Pas kësaj ngjarje të dhimbshme i Dërguari i Allahut dhe shokët e tij ndjenë njëfarë lehtësimi. Marrëveshja u shkrua në dy kopje dhe u nënshkrua nga të dyja palët. Politeistët u kthyen në kampin e tyre.[248] (Suhejli, pas çlirimit të Mekës, përqafoi Islamin dhe u bë një nga sahabët e nderuar). Marrëveshja u shkrua në dy kopje dhe u nënshkrua nga të dyja palët. Politeistët u kthyen të gëzuar në kampet e tyre. Gëzimi i tyre vinte për kushtet që ju kishin vendosur myslimanëve, në sipërfaqe dukej që në at kushte favorizonin ata. Por e vërteta ishte se, kjo marrëveshje ishte një fitore e madhe për myslimanët dhe këto kushte ishin në dobinë e tyre.

Së pari, kjo marrëveshje nënkuptonte se myslimanët tashmë njiheshin si një shtet më vete. Gjë që mushrikët e Mekkas deri atë kohë nuk e kishin njohur. Në të njëjtën kohë marrëdhëniet e myslimanëve me mushrikët ishin ndërprerë por sipas kushteve të marrëveshjes kur një politeist nga Mekka, do të shkonte për tregti apo për arsye të tjera në Sham ose Egjipt, do të kalonte nga Medinë. Kjo do t'u jepte politeistëve mundësinë të shihnin nga afër mënyrën e jetesës së myslimanëve, drejtësinë e Islamit dhe sjelljet e shkëlqyera midis shokëve të Profetit. Dhe kjo do bëhej shkak që shumë prej tyre do të ndikoheshin dhe do të pranonin Islamin. Kështu kishte ndodhur me vonë ku shumë prej atyre që pranuan Islamin iu bashkuan radhëve të sahabëve. Përmes kësaj marrëveshjeje, e cila duhej të zgjaste dhjetë vjet, myslimanët do të shumoheshin në numër dhe do të forcoheshin akoma më shumë. Madje arritja e paqes me mushrikët e Mekkës ju dha mundësinë muslimanëve që të mos harxhoninë më energji për tu mbrojtur nga sulmet e tyre. Ndaj tashmë sahabët u angazhuan që Islami të përhapej në të gjitha anët e gadishullit arabik dhe pertej kufijëve të këtij gadishulli.

E vetmja pikë që shqetësonte të Dërguarin e Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të), ishte kushti që thoshte: "Nëse dikush nga politeistët e Kurejshëve pranon Islamin dhe kërkon strehim në Medinë, ai duhet të kthehet përsëri te politeistët," ishte shqetësues për të Dërguarin e Allahut. Megjithatë, ai tha: "**Allahu me siguri do të hapë një rrugëdalje për ta.**" Tani që puna me politeistët kishte përfunduar, i Dërguari i Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të), i tha shokëve të tij: "**Ngrihuni! Therni kurbanët. Pastaj rruani kokat dhe dilni nga ihrami.**" Më pas ai vetë e preu kurbanin e tij i pari dhe më pas u rrua nga sahabiu Hirash bin Umejje. Sahabët morën flokët e bekuar të Profetit para se ato të binin në tokë dhe i ruajtën për bekim. Edhe shokët e tjerë flijuan kafshët dhe rruan ose shkurtuan flokët.[249]

Pas qëndrimit për rreth njëzet ditë në Hudejbi, Profeti dhe shokët e tij u nisën për në Medine. Gjatë rrugës, Allahu shpalli suren **El-Fet'h,** duke i përgëzuar për ndihmën dhe bekimet e Tij. Në ditët kur Profeti u kthye në Medinën e ndritshme si fitimtar, një njeri nga fisi Sakif i Kurejshëve, Ebu Basiri, pati nderin të përqafojë Islamin. Duke e kuptuar se nuk mund të jetonte më mes politeistëve, Ebu Basiri udhëtoi më këmbë deri në Medina. Por, sipas kushteve të marrëveshjes së Hudejbijes, ai duhej të largohej nga Medina dhe u vendos në një vend të quajtur Ijs, pranë bregdetit të Detit të Kuq.[250] Ky vend ndodhej në rrugën tregtare të politeistëve Kurejshitë që shkonin drejt Shamit. Më pas, myslimanët që iknin nga Mekka nuk shkonin më në Medinë, por bashkoheshin me Ebu Basirin në Ijs. I pari që iu bashkua atij ishte Ebu Xhendeli. Pas tij, numri i myslimanëve filloi të rritej, duke arritur në 50, 100, 200 dhe më shumë. Mirëpo kurejshëve ju binte të kalonin nga kjo zonë gjatë rrugës për në Sham. Ebu Basiri dhe myslimanët e tjerë, duke kaluar në veprim, i ndalonin politeistët që kalonin andej dhe i ftonin të pranonin Islamin. Ata që refuzonin shpesh përfundonin në përleshje, duke i lënë Kurejshët në një situatë të vështirë.

Politeistët e Mekkës, pasi panë se rrugët tregtare për në Sham tashmë ishin bllokuar, dërguan një delegacion në Medinë. Ata iu lutën të Dërguarit të Allahut që të hiqej neni i marrëveshjes së Hudejbijes, i cili thoshte: "Nëse një mekkan pranon Islamin dhe shkon në Medinë pa lejen e kujdestarit të tij, ai duhet të kthehet mbrapsht!" I Dërguari i Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të), me mëshirën e tij të pafund, pranoi kërkesën e tyre. Kështu, rrugët tregtare të Kurejshëve drejt Shamit u hapën përsëri. Ndërkohë, myslimanët që kishin duruar torturat dhe vështirësitë, tani mund të shkonin lirisht në Medinë dhe t'i bashkoheshin të Dërguarit të Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të).

[248] İbni Hishâm, Sîret, II, 321; Vâkıdî, Megâdhî, II, 608; İbni Sa'd, Tabakât, VII, 405; Su-heylî, Ravdu'l-unf, IV, 56.
[249] Buhârî, SHurût, 15; Ahmed bin Hanbel, Musned, IV, 323; Taberî, Târih, II, 283
[250] İbni Hishâm, Sîret, II, 324; Vâkıdî, Megâdhî, II, 625; Suheylî, Ravdu'l-unf, IV, 57.

O, i Bukuri i të Bukurve!

O, i Bukuri i të Bukurve, më dogje me dashurinë tënde!
Sytë e mi s'shohin asgjë, mendja ime endet çdo çast në ëndrrën tënde!

Ti je Mbret i "Kabe Kavsejn-it", ndërsa unë një rob i humbur,
Si mund ta shpreh këtë dëshirë, që të jem mysafiri yt?

Kur më shikon me mëshirë, zemrat e vdekura ngjallen,
Unë erdha tek dera jote, për të kërkuar mëshirën tënde!

Ti je burimi i mirësisë, oqeani i shërimeve,
Më dhuro një pikë prej dhembshurisë tënde!

Të gjithë vijnë në Mekkë, në Qabe, në Safa, në Merve,
Por unë për ty kam kaluar male dhe kreshta!

Natën e kaluar, në një ëndërr, koka ime preku qiellin,
Në derën tënde ndjeva sikur më përkëdhelej koka!

O Hazret i Xhamit, bilbili i të Dashurit tim,
Nga poezitë e tua zgjodha këtë varg:

"Si qentë e lënguar me gjuhë të varur,
Shkova në oqeanin e mëshirës, për të kërkuar një pikë ."

Mevlana Halid-i Bagdadi (kuddise sirruh)

Letrat e Thirrjes së Profetit të Nderuar

Dielli nuk ndriçonte botën
Po të mos vinte Ai i dashuri.
Drita nuk i jepte jetë botës,
Po të mos ndodhte ajo çast i Mevludit.

Kristali nuk do të formohej,
Me bukurinë e fytyrës së tij si trëndafil,
Me dritën që pasqyrohet në zemër,
Po të mos ishte trupi i tij i shndërruar në mish.

Ejjubi

FLETËTHIRRJET

Letrat e Dërguara Sundimtarëve

Pas kthimit nga Hudejbija, Profeti ynë Fisnik (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) dëshironte përhapjen e Islamit në mbarë botën, që njerëzit të shpëtonin nga dënimi i Ferrit dhe të arrinin lumturinë e vërtetë. Sepse misioni i tij ishte universal dhe ai ishte dërguar si mëshirë për mbarë njerëzimin. Për këtë arsye, ai vendosi t'u dërgonte mesazhe sundimtarëve të vendeve përreth, duke i ftuar ata në Islam.

"Thuaj (O Muhammed): "O ithtarë të Librave të Parë! (jehudi e të krishterë): Ejani te një fjalë që është e drejtë dhe e përbashkët mes nesh dhe jush: që të mos adhurojmë askënd përveç Allahut, që të mos i vëmë shokë Atij në adhurim, dhe që asnjë prej nesh të mos marrë të tjerë për zot përveç Vetëm Allahut." Pastaj në qoftë se ata largohen, thuaju: "Dëshmoni për ne se jemi muslimanë (besimdrejtë)."
Ali Imran, 64.

Në fund të muajit Dhulhixhe të vitit të gjashtë hixhri dhe në fillim të muajit Muharrem të vitit të shtatë hixhri, ai i dërgoi disa shabë si ambasadorë dhe i ngarkoi ata me këtë mision. Profeti (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) ju dërgoi letra të gjithë sundimtarëve me shabët si më poshtë;

- Amr bin Umejje (radijallahu anhu) u dërgua në Abisini (Etiopi),
- Dihje Kelbi (radijallahu anhu) u dërgua në Perandorinë Romake,
- Hatib bin Ebi Beltea (radijallahu anhu) u dërgua te sundimtari i Egjiptit,
- Abdullah bin Huzafe (radijallahu anhu) u dërgua te sundimtari i Persisë,
- Shuja bin Vehb (radijallahu anhu) u dërgua te sundimtari i Gasanit,
- Selit bin Amr (radijallahu anhu) u dërgua në Jemame,
- dhe Ala Hadrami r.a. u dërgua në Bahrejn te emiri Mundhir bin Savi.[251]

Këta ambasadorë ishin ndër shokët më të zgjedhur të Profetit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të), të cilët njiheshin për karakteristikat e lidershipit dhe oratorinë e tyre. Secilit sundimtar iu dërgua një letër më vete, pra për t'i ftuar ata në Islam Profeti alejhi selam i dërgoi secilit sundimtar një letër specifike për të. Profeti ynë i Dashur i vulosi këto letra me unazën e tij prej argjendi, ku në tri rreshta ishte shkruar: "**Muhamed, Resul, Allah.**"

Profeti alejhi selam kur i zgjodhi ambasadorët nuk i zgjodhi vetëm nga karakteristikat e lidershipit dhe oratoria por njëkohësisht i zgjodhi ata sipas gjuhës që dinin. Pra këta ambasadorë e kishin mësuar gjuhën e vendeve ku do të shkonin.[252]

Letra për Nexhashiun

Amr bin Umejje (radijallahu anhu), i dërguari për në Abisini, kishte për detyrë të kërkonte nga Nexhashiu, sundimtari i Abisinisë, të kthente shokët e Profetit që kishin emigruar atje më parë. Profeti i dërgoi Nexhashiut dy letra. Amr bin Umejje arriti në Abisini dhe u prit nga Nexhashiu Eshame. Ai fillimisht dorëzoi letrën e parë.

Nexhashiu zbriti nga froni i tij, e mori letrën me respekt dhe dashuri të madhe, e puthi, e vendosi në ballë dhe në sy, pastaj e lexoi. Letra fillonte me:

"***Bismil-lahirrahmanirrahim!***

Nga i dërguari i Allahut, Muhamedi (paqja qoftë mbi të),

për Mbretin e Abisinisë, Nexhashiun Eshame..."

[251] Buhârî, Tefsîr, 4; Megâdhi, 77, 82, 84; İlim, 7; Muslim, Cihâd, 109; Ahmed bin Hanbel, Musned, I, 262; III, 441; İbni Hishâm, Sîret, II, 607; Beyhekî, Sunen, II, 43, 353; İbni Sa'd, Tabakât, I, 259; Hudhâî, Tahrîc, 183-184; Kettânî, Terâtîb-ul-idâriyye, I, 345-346
[252] Ibni Sa'd, Tabakât, II, 15.

Paqja qoftë mbi ata që ndjekin udhëzimin!

O Mbret! Të uroj mirësi dhe falënderoj Allahun e Lartësuar për begatitë e Tij ndaj teje. Nuk ka të adhuruar tjetër përveç Allahut. Ai është Sunduesi *(i cili zotëron gjithçka në univers)*, **i Shenjtë** *(i pastër nga çdo mangësi dhe gabim)*, **Mëshiruesi** *(që mbron krijesat nga të gjitha rreziqet)*, **Besimdhënës** *(që dhuron siguri)* **dhe Mbikëqyrës** *(që i sheh dhe i ruan të gjithaë)*.

"Betohem se ai është i Dërguari për të cilin njerëzit e librit – hebrenjtë dhe të krishterët – kanë pritur dhe për të cilin profetët e mëparshëm kanë lajmëruar për ardhjen e tij. Sikur të kisha mundësi të shkoja te ai, do të shkoja patjetër dhe do të ndihesha i nderuar të isha në shërbim të tij!"
Nexhashiu

Unë dëshmoj se Isai (paqja e Allahut qoftë mbi të**) është shpirt dhe fjalë e Allahut të Lartësuar, të cilën Ai ia frymëzoi Merjemes, një gruaje të pastër dhe larg çdo papastërtie të kësaj bote. Ajo mbeti shtatzënë me Isain. Allahu, me fuqinë e Tij, e krijoi atë njësoj sikur krijoi Ademin**.

O Mbret! Të ftoj të besosh në Allahun e Vetëm, pa të barabartë, të adhurosh Atë dhe të më ndjekësh mua, si dhe të besosh në atë që Allahu më ka shpallur. Sepse unë jam i dërguari i Tij, i ngarkuar për t'ua përcjellë njerëzve shpalljen hyjnore. Kam përmbushur detyrën time ndaj teje, duke të ofruar këshilla për lumturinë e kësaj bote dhe botës së përjetshmes. Ju ftoj të ranoni këtë këshillë! Paqja qoftë mbi ata që arrijnë udhëzimin!"

Letra e të Dërguarit të Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) u lexua me respekt dhe përulësi nga mbreti Eshame. I cili menjëherë tha:"**E dëshmoj se nuk ka të adhuruar tjetër përveç Allahut dhe dëshmoj se Muhamedi është robi dhe i Dërguari i Tij"**dhe pranoi Islamin. Pastaj shtoi: "Betohem se ai është i Dërguari për të cilin njerëzit e librit – hebrenjtë dhe të krishterët – kanë pritur dhe për të cilin profetët e mëparshëm kanë lajmëruar për ardhjen e tij. Sikur të kisha mundësi të shkoja te ai, do të shkoja patjetër dhe do të ndihesha i nderuar të isha në shërbim të tij!"

Mbreti vendosi letrën me respekt në një kuti të bukur dhe tha:"Për sa kohë që kjo letër të qëndrojë këtu, vendi i Habeshishstanit nuk do të humbasë bekimet dhe mirësitë."[253]

Në letrën e dytë, mbreti Eshame lexoi me respekt urdhrat e përmendur dhe, duke ndjekur urdhrin e të Dërguarit të Allahut, martoi zonjën e nderuar, Ummu Habiben, me Profetin (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të). Pas dy muajsh mikpritjeje të zonjës Ummu Habibe dhe sahabëve që ndodheshin atje. Mbreti Nexhash i nisi ata me anije drejt Medinës, duke i pajisur me shumë dhurata dhe duke e informuar Profetin (paqja qoftë mbi të) nëpërmjet një letre, ne të cilën i fliste për pranimin e besimit Islam.

Letra për Perandorin e Romës, Herakliun

Sahabiu Dihje-i Kelbi (radhiallahu anhu) ishte ngarkuar që të ftonte perandorin e Romës në Islam. Letra do t'i dorëzohej mbretit të Gassanit, Harithit, i cilin ndodhej në Busrà, më pas ai do ta përcillte letrën te perandori Herakli. Me një respekt të madh për detyrën e tij, Dihje mbërriti shpejt në Busrà dhe ia shpjegoi situatën Harithit. Haristhi i dha atij shoqërues Adij bin Hatimin, i cili ende nuk ishte bërë mysliman, dhe së bashku shkuan në Jerusalem, ku ndodhej Herakliu. Para se të

[253] Ahmed bin Hanbel, Musned, IV, 198; İbni Hishâm, Sîret, I, 223; Beyhekî, Sunen, II, 79; İbni Sa'd, Tabakât, I, 207-208; Taberânî, Mu'cemu'l Kebîr, XX, 80.



Një letër e dërguar nga i Dërguari i Allahut
(paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) te sundimtarët.

*Në cepin e poshtëm të majtë të letrës, vula ishte shkruar në tri rreshta me fjalët "**Muhamed, Resul, Allah**", duke u lexuar nga poshtë lart. Kjo vulë ishte e gdhendur në pjesën e sipërme të një unaze argjendi dhe vendosej në fund të çdo letre të dërguar për ftesë në Islam.*

I Dërguari i Allahut (paqja qoftë mbi të) përdori këtë unazë si vulën e tij mbretërore deri në momentin që u nda nga kjo botë. Pas tij, unaza iu dorëzua hazreti Ebu Bekrit, pastaj hazreti Omerit dhe së fundmi hazreti Osmanit gjatë kalifateve të tyre. Hazreti Osmani e përdori këtë unazë për vetëm gjashtë muaj. Një ditë, unaza rrëshqiti nga gishti i tij dhe ra në Pushtin e Erisit. Pavarësisht përpjekjeve të shumta për ta gjetur, ajo nuk mundi të rikuperohej.

takohej me Herakliun, njerëzit e etij e udhëzuan Hazreti Dihjense;"Kur të dalësh para perandorit, ec me kokë ulur. Kur të afrohesh, bjer në sexhde dhe mos ngri kokën derisa të të japë ai leje." Por Dihje me vendosmëri iu përgjigj :"Ne myslimanët nuk i biem në sexhde askujt përveç Allahut të Lartësuar. Sexhdeja ndaj një njeriu është kundër natyrës së krijimit të tij."Ata ia kthyën: **"Nëse nuk i bën sexhde, Herakliu nuk do ta pranojë kurrë letrën tënde dhe do të të dëbojë nga pallati i tij." Dihje ju tha:"Profeti ynë Muhammedi (paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të) nuk e lejon askënd as të përkulet lehtë përpara tij, e jo më të bjerë në sexhde. Ai pranon këdo që vjen për ta takuar, edhe nëse është një rob. Ai e dëgjon hallin e tyre, i ndihmon dhe i ngushëllon. Për këtë arsye, të gjithë ata që e ndjekin Atë janë të lirë dhe të nderuar." Një nga ata që dëgjuan këtë thanë:"Nëse nuk do t'i bësh sexhde perandorit, atëherë të tregoj një rrugë tjetër për të përmbushur detyrën tënde. Herakliu ka një vend pushimi përpara pallatit. Çdo pasdite, ai del dhe shëtit në atë oborr. Aty ndodhet një minber, ku vendos dhe lexon çdo letër që gjen. Vendose letrën në atë minber dhe prit jashtë. Kur ta shohë letrën, do të të thërrasë dhe atëherë mund ta përmbushësh detyrën tënde."Dihje e pranoi këtë dhe veproi ashtu sikur iu sugjerua. Kur Herakliu pa letrën, kërkoi një përkthyes që dinte arabisht. Letra fillonte me:"**Bismilahirrahmanirrahim! Nga i Dërguari i Allahut, Muhammedi (paqja qoftë mbi të), për Herakliun, prijësin e Romakëve.**"

"Për Allahun, ky është ai që Musai dhe Isai (paqja qoftë mbi ta) na kanë përgëzuar se do të vijë. Ne kemi kohë që ishim duke pritur ardhjen e tij."
Uskufi, Prifti i Kudsit

Djali i vëllait të Herakliut, Jennaku, u zemërua shumë kur dëgjoi këtë hyrje dhe i dha një grusht të fortë përkthyesit, i cili ra në tokë dhe letra i ra nga dora. Herakliu, i zemëruar, i tha:"Pse e bëre këtë?"Jennaku iu përgjigj: "A nuk e sheh letrën? Ai e ka vendosur emrin e tij para emrit tënd dhe të ka quajtur vetëm 'prijës i Romakëve', jo 'mbret'. Kjo letër nuk duhet lexuar!" Ndërsa Herakliu i tha:"Për Allah, ti je ose një i çmendur ose një i marrë. Nuk e dija që ishe kaq mendjelehtë. A dëshiron ta grisim letrën para se të shohim përmbajtjen e saj? Betohem në jetën time, nëse ai është vërtet i Dërguari i Allahut, siç pretendon, atëherë ka të drejtë të vendosë emrin e tij para timit dhe të më quajë 'prijës i Romakëve'. Sepse unë jam vetëm kujdestar i tyre, jo mbreti i tyre."Pastaj e dëboi Jennakun nga prania e tij. Më pas, ai thirri Uskufin, i cili ishte dijetari më i madh i të krishterëve, njëkohësisht prijësi dhe këshilltari i tij. Ai e lexoi letrën, në të cilën thuhej:

"Paqja qoftë mbi ata që ndjekin udhëzimin e Allahut dhe gjejnë rrugën e drejtë! Pas kësaj: O udhëheqës i Rumëve! Të ftoj në Islam. Prano Islamin që të jesh i shpëtuar. Bëhu musliman dhe Allahu do të të japë shpërblim të dyfishtë. Por, nëse ia ktheni shpinën (këtij mesazhi)**, atëherë barra e të gjithë të krishterëve bie mbi ty. Thuaj: 'O ithtarë të Librit** (jahudi dhe të krishterë)**, ejani tek një fjalë e përbashkët ndërmjet nesh dhe jush, që të mos adhurojmë askënd tjetër përveç Allahut, të mos i vëmë Atij ortakë dhe të mos marrim askënd nga mesi ynë si zot përveç Allahut!' Nëse ata e refuzojnë, atëherë thoni: 'Dëshmoni se ne jemi muslimanë.'"**[254] Gjatë leximit të letrës së Profetit, nga balli i Herakliut rridhnin pika djerse. Kur letra mbaroi, ai tha: "Pas Sulejmanit (paqja qoftë mbi të), unë nuk kam parë një letër që fillon me '**Bismillahirrahmanirrahim**' (Në emër të Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit)." Pastaj Herakliu e pyeti Uskufin për mendimin e tij mbi këtë çështje. Ai u përgjigj: **"Për Allahun, ky është ai që Musai dhe Isai (paqja qoftë mbi ta) na kanë përgëzuar se do të vijë. Ne kemi**

[254] Al-i İmrân: 3/64.

kohë që ishim duke pritur ardhjen e tij." Herakliu e pyeti: "Çfarë më kështillon të bëj?" Uskufi u përgjigj: "Unë të kështilloj të ndjekësh atë" ndërsav Herakliu i tha: "Unë e di shumë mirë se çfarë thua. Por, nëse e ndjek atë dhe bëhem musliman, do të humbas mbretërinë time dhe populli im do të më vras mua."

Për këtë Ebu Sufjani transmeton se: "Në një kohë kur ne ishim në Gazza, guvernatori i Shamit (Sirisë) na erdhi me një vrull sikur donte të na sulmonte dhe ende pa u ndalur pranë nesh na pyeti: 'A jeni ju nga fisi i atij njeriu në Hixhaz që pretendon se është Profet?' 'Po,' i thamë. 'Atëherë ju do të vini me ne te perandori,' tha ai. Guvernatori i Shamit e çoi Ebu Sufjanin dhe shokët e tij në Sham dhe i paraqiti para Herakliut. Në atë kohë, Herakliu ishte në Kudsin e Shenjtë (Bajtul-Mukaddes). Ai ishte ulur me vezirin e tij, kishte vendosur kurorën mbi kokë dhe priti Ebu Sufjanin dhe rreth tridhjetë Mekkas që ishin me të. Herakliu thirri një përkthyes dhe pyeti: "Cili nga ju është më i afërmi, sipas prejardhjes, me këtë njeri që pretendon të jetë Profet?" Pasi Ebu Sufjani tha: "Unë jam më i afërmi me të, sipas prejardhjes." Herakliu urdhëroi që Ebu Sufjani të afrohej, ndërsa të tjerët të qëndronin pas tij. Pastaj e pyeti: "Çfarë lidhje farefisnore keni me të?" Ebu Sufjani u përgjigj: "Ai është djali i xhaxhait tim." (Sepse gjyshi i Ebu Sufjanit, Umeje, dhe gjyshi i Profetit Muhamed, Abdulmutalibi, ishin kushërinj nga babai, duke u takuar në paraardhësin e tyre të përbashkët, Abdul Manaf.)

Pas disa përpjekjeve fillestare për të gënjyer, Ebu Sufjani u frikësua nga kërcënimet e Herakliut dhe vendosi të flasë të vërtetën. Pastaj biseda vazhdoi si më poshtë:

Herakliu: - Çfarë prejardhjeje ka ky njeri që pretendon të jetë Profet?

Ebu Sufjani: - Ai është nga familja më fisnike e kohës sonë, dhe më i zgjedhuri ndër ne për nga prejardhja.

Herakliu: - A ka pretenduar ndonjë tjetër të jetë Profet para tij?

Ebu Sufjani: - Jo.

Herakliu: - A ka pasur ndonjë mbret në paraardhësit e tij?

Ebu Sufjani: - Jo.

Herakliu: - Kush i beson atij, të pasurit apo të varfrit?

Ebu Sufjani: - Kryesisht të varfrit, të dobëtit, të rinjtë dhe gratë. Nga të pasurit dhe pleqtë ka shumë pak që i besojnë.

Herakliu: - A po shtohen apo po pakësohen ndjekësit e tij?

Ebu Sufjani: - Po shtohen.

Herakliu: - A ka dikush që ka hyrë në fenë e tij dhe pastaj është larguar nga ai për shkak të pakënaqësisë?

Ebu Sufjani: - Jo.

Herakliu: - A ka gënjyer ndonjëherë ai njeri, para se të pretendonte të ishte Profet?

Ebu Sufjani: - Jo.

Herakliu: - A ka thyer ndonjë marrëveshje që ka bërë?

Ebu Sufjani: - Jo, por tani kemi bërë një marrëveshje armëpushimi dhe nuk e dimë çfarë do të bëjë gjatë kësaj kohe.

Herakliu: - Çfarë ju urdhëron ai?

Ebu Sufjani: - Ai na urdhëron të adhurojmë vetëm Allahun dhe të mos i bëjmë Atij shok. Na ndalon të adhurojmë idhujt që adhuronin etërit tanë. Na urdhëron të falemi, të jemi të drejtë, të ndihmojmë të varfrit, të largohemi nga të ndaluarat, të mbajmë premtimet, të mos tradhtojmë dhe të vizitojmë të afërmit."

Pas këtij dialogu, letra e Profetit Muhamed iu lexua Herakliut. Ai e mori letrën, e puthi, e vuri mbi kokë dhe kjo shkaktoi shqetësime mes popullit të tij. Pastaj, Herakliu urdhëroi që Ebu Sufjani dhe njerëzit e tij të largoheshin. Edhe pse Ebu Sufjani nuk ishte bërë ende musliman, ai deklaroi se besonte se kauza e Profetit Muhamed do të triumfonte.

"Ai është Profeti i Fundit, për të cilin Profeti Moisiu (Musa) dhe Profeti Jezus (Isai) kishin paralajmërur ardhjen e tij."
Prifti Safatir

Pas pak kohësh ambasadori i Pejgamberit alejhi selam Dihje doli para Herakliut dhe, me fytyrën e tij të bukur dhe zërin e tij të ëmbël, tha: "O Kajser! Më ka dërguar te ti nga Busra një njeri (Harithi), i cili është më i mirë se ti. Betohem në Allahun e Lartësuar se ai që më ka dërguar mua tek Harithi (Profeti Muhamed) është më i mirë se Harithi, por edhe më i mirë se ti. Ndaj ti duhet t'i dëgjosh me përulësi fjalët e mia dhe të pranosh këshillat që po të jap! Sepse, nëse tregon përulësi, do t'i kuptosh këshillat e tij. Por nëse nuk i pranon këshillat, atëherë ti nuk mund të jesh i drejtë." Kur Herakliu i tha: "Vazhdo," Dihje tha: "Atëherë, unë të ftoj të besosh në Allahun e Lartësuar, të Cilit i është falur në namaz Isai (paqja qoftë mbi të). Unë të ftoj të besosh në këtë Profet analfabet, ardhjen e të cilit Musa dhe më pas Isai (paqja qoftë mbi ta) e kanë lajmëruar dhe përgëzuar më parë. Nëse di diçka për këtë çështje dhe dëshiron të fitosh lumturinë e kësaj bote dhe të botës tjetër, reflekto për këto fjalë. Përndryshe, do të humbasësh lumturinë e ahiretit dhe do të mbetesh në kufër (mosbesim) dhe shirk (idhujtari). Dhe dije mirë se Zoti yt, Allahu i Lartësuar, është Ai që shkatërron zullumqarët dhe ndryshon begatitë e tyre." Pasi e dëgjoi thirrjen e Dihjes Herakliu i tha: " (O Dihje). Unë nuk heq dorë nga një shkrim që më bie në dorë pa e lexuar, dhe pa pyetur një dijetar për ato që nuk di në letër. Nga kjo metodë, unë kam parë vetëm dobi dhe mirësi. Ndaj më jep kohë që të mendoj dhe të kuptoi të vërtetën. Më pas do të ju përgjigjem thirrjes suaj."

Pasi u larguan të pranishmit Herakliu e thirri Dihjen dhe bisedoi me të kokë më kokë. Ai i shprehu Dihjes ndjenjat e tij duke i thënë: "Unë e di se ai që të ka dërguar është Profeti i Fundit, ardhja e të cilit është lajmëruar në libra, dhe që ne e prisnim ardhjen e tij. Por nëse e ndjek, kam frikë se rumët (bizantinët) do të më vrasin. Dua të të dërgoj te një njeri, Safatiri, i cili është më i madhi prej dijetarëve të tyre dhe ka më shumë autoritet sesa unë. Të gjithë të krishterët e ndjekin atë. Nëse ai beson, atëherë të gjithë rumët do të besojnë. Edhe unë atëherë do të shpall hapur atë që kam në zemër dhe bindjen time." Pas kësaj, Herakliu shkroi një letër, të cilën ia dha Dihjes radijallahu anhu për ta çuar te Safatiri.

Prifti Safatir

Profeti ynë i Dashur dërgoi gjithashtu një letër Safatirit. Kur Safatiri lexoi letrat dhe dëgjoi cilësitë e Profetit tonë, tha se nuk kishte dyshim që ai ishte Profeti i Fundit, për të cilin Profeti Moisiu (Musa) dhe Profeti Jezus (Isai) kishin paralajmërur ardhjen e tij. Më pas Safatiri shkoi në shtëpi, u mbyll dhe për tre javë rrjesht nuk mori pjesë në predikimet që mbante çdo të diel.

Të krishterët i kapi meraku dhe filluan të thonë; "Çfarë po ndodh me Safatirin që nuk ka dalë nga shtëpië që nga dita kur u takua me arabin? Ne e duam atë por ai po na fshihet ne!" Për këtë të krhiterët derguan një delegacion tek Safatiri, i cili

kishte hequr rrobën e zezë të priftit dhe kishte veshur një rrobë të bardhë dhe me shkopin në dorë erdhi në kishë. Aty ishin mbledhur njerëzit e qytetit dhe po prisnin çdo ju thotë prifti Satira, i cili u ngrit dhe tha; "O të krishterë! Dijeni se kemi marrë një letër nga Ahmedi (paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të!). Ai na ftoi në fenë e vërtetë. "Unë e di qartë dhe besoj se ai është i Dërguari i vërtetë i Allahut Teala.'' Kur e dëgjuan këtë, të krishterët e sulmuan Safatirin dhe vranë duke e rrahur. Dihje erdhi dhe e njoftoi Herakliun për këtë situatë. Herakliu; "A nuk të thashë? Safatiri është më i dashur i për mua edhe për të krishterët është më i dashur se unë. "Nëse do të dëgjonin për mua së kam pranuar Islamin, edhe mua do të më vrisnin sikur dëshmori Satira.''

Ndëdrsa në transmetimet e përmendur nga Buhariu në Sahihun e tij dhe të transmetuar nga Zuhri thuhet se; Herakliu thirri parinë e pallatit mbretëror në rezidencën e tij, në Homs, dhe urdhëroi të mbylleshin dyert. Pastaj ai vetë u ul në fronin e tij dhe tha; "O Pari! A dëshironi të arrini lumturinë, paqen, të ruani sovranitetin tuaj përgjithmonë dhe t'i bindeni asaj që tha Jezusi (Isai a.s.)?'' Ata të habitur ju përgjigjën duke i thënë; "O sundimtari ynë! Çfarë duhet të bëjmë në për këto?'' Herakliu ju tha; "O pari! Unë ju kam mbledhur për shkak se më erdhi një letër nga profeti Muhammed alejhi selam. I cili më fton në fenë islame. Pasha Allahun, ai është profeti, ardhjen e të cilit ne e kemi pritur, ardhjen e të cilit e kemi gjetur të shkruar në librat tanë dhe i dimë mirë shenjat e pejgamberllëkut të tij. Ndaj, ejani ta ndjekim atë dhe të gjejmë shpëtim në këtë botë dhe në ahiret.'' Të pranishmit sapo dëgjuan këto fjalë të gjithë, njëri pas tjetrit, duke bërtitur me fjalë të këqija dhe duke murmuritur vrapuan drejt dyerve. Por për shkak se dyert ishin të mbyllura, ata nuk mund të largoheshin. Kur Herakliu pa këto veprime të parisë së pallatit të tij dhe kuptoi se ata po i shmangeshin Islamit, u frikësua për jetën e tij dhe tha; "O pari! Fjalët që ju thashë ishin për të matur përkushtimin tuaj ndaj fesë suaj. Sot e pashë me sytë e mi përkushtimin tuaj ndaj fesë suaj dhe sjelljen tuaj që më bëri të lumtur." Të pranishmit i besuan atij se thirrja e tij ishte për ti provokuar ata, ndaj sapo dëgjuan fjalët e lartpërmendura i ranë në sexhde Herakliut dhe u larguan nëpër zyrat pallatit.[255]

Pasi u largua paria Herakliu thirri Dihjen dhe i tregoi atij se çfarë kishte ndodhur me parinë e tij. Më pas duke i dhënë dhurata shumë të çmuara dhe duke i shkruar një letër të Dërguarit të Allahut (s.a.s.) e porositi Dihjen të ja përcillte këto Pejgamberit alejhi selam sela. Pra sikur duket, Herakliu dëshironte të bëhej mysliman, por nga frika e humbjes së pozitës dhe nga frika e vdekjes nuk pati guxim të shpallte besimin hapur. Në letrën që i shkroi Profetit alejhi selam thuhej: " Për Muhammedin Të Dërguarit të Allahut, të cilin e ka përgëzuar Isai alejhi selam në Ungjill, nga Herakliu, sundimtari i romakëve! Lajmëtari yt erdhi tek unë me letrën tënde. Dëshmoj se ti je me të vërtetë je i Dërguari i Allahut. Madje, ne të kemi gjetur të përshkruar në Inxhil dhe Isai na ka përgëzuar për ty. I ftoj romakët të besojnë në ty, por ata nuk pranuan. Sikur të më dëgjonin mua, padyshim që do të ishte më e mira për ta. Unë e dëshiroj shumë të jem pranë teje, të të shërbej dhe të laj këmbët e tua."

Dihje u largua nga Herakliu dhe mbërriti në Hismë. Kur arriti në luginat e fisit Xhudham, konkretisht në luginën Shenar, Huneid bin Us, bashkë me të birin dhe njerëzit e tij, e grabitën Dihjen, duke i marrë atij gjithçka përveç rrobave të vjetra.

[255] İbni Sa'd, Tabakât, I, 259.

"O Hatib! Allahu të bekoftë ty në këtë detyrë!"
Hadith

Mirëpo nga banorët e këtij vendi, Dubejib bin Rifaa bin Zeid dhe fisi i tij kishin pranuar Islamin. Dihje shkoi tek këta dhe u tregoi atyre se çfarë i kishte ndodhur, ata sulmuan Huneid bin Usin dhe fisin e tij dhe ja morën përsëri të gjitha gjërat e grabitura. Më pas, i Dërguari i Allahut (s.a.s.) dërgoi Zeid bin Harisin kundër Huneid bin Us dhe njerëzve të tij. Por kur Zeidi shkoi atje ata të gjithë, që ishin në atë vend, e pranuan Islamin.

Dihje sapo mbërriti në Medinë, ai nuk shkoi në shtëpinë e tij, por menjëherë shkoi drejt e te dera e të dashurit të Allahut, Profeti (s.a.s.). Ai i trokiti në derë dhe kur Profeti pyeti: **"Kush është?"** Dihje u përgjigj: "Dihjet-ul Kelbi."Profeti a.s. "Hyr brenda." i tha. Dihje hyri dhe i tregoi Profetit a.s. gjithçka i kishte ndodhur dhe setaj meë detaj. Ai gjithashtu ia lexoi letrën e Herakliut Profetit. Pas kësaj, Profeti (s.a.s.) tha: **"Atij i është dhënë një kohë e caktuar për të qëndruar në fron. Për aq kohë sa letra ime të mbetet në duart e tyre, mbretëria e tyre do të vazhdojë."**[256]

Edhe pse Herakliu kishte shkruar në letër se ai kishte besuar në Profetin (s.a.s.), Profeti tha: "**Po gënjen. Ai nuk është kthyer nga feja e tij."**Herakliu e mbështolli letrën e Profetit në një copë mëndafshi dhe e vendosi në një kuti të artë me formë të rrumbullakët, duke e ruajtur atë me kujdes. Familja e Herakliut e ruajti këtë letër me shumë kujdes dhe nuk ia treguan askujt. Ata besonin se për aq kohë sa kjo letër të ishte në posedimin e tyre, mbretëria e tyre do të vazhdonte. Në të vërtetë ashtu ndodhi.

Letra për Sundimtarin e Egjiptit, Mukaukasin

Profeti ynë i dashur (s.a.s.) dërgoi Hatib bin Ebi Beltean si lajmëtar tek sundimtari i Egjiptit, Mukaukasi. Para se ta dërgonte, Profeti i pyeti sahabët se: **"Kush prej jush do ta çojë këtë letër tek sundimtari i Egjiptit, duke pritur shpërblimin vetëm nga Allahu?"** Hatibi u ngrit menjëherë dhe tha: "O i Dërguari i Allahut! Unë do ta çoj!" Profeti (s.a.s.) duke iu drejtuar atij i tha: **"O Hatib! Allahu të bekoftë ty në këtë detyrë!"** Hatib bin Ebi Beltea mori letrën nga Profeti dhe, pasi u përshëndet me të dhe me familjen e tij, u nis për në Egjipt. Mirëpo gjatë rrugës ai mësoi se Mukaukasi ndodhej në Aleksandri dhe ku arriti në pallatin e tij roja i pallatit, pasi mësoi qëllimin e vizitës, tregoi shumë respekt për Hatibin dhe e priti mirë atë. Mirëpo atë kohë, Mukaukasi ndodhej mbi një anije në det, i cili ishte duke diskutuar me njerëzit e tij. Hatibi hipi në një varkë dhe shkoi te Mukaukasi dhe i dorëzoi atij letrën e Profetit alejhi selam.

Mukaukasi e mori dhe nisi të lexoi letrën, ku shkruhej: **"Bismilahirrahmanirrahim! Nga Muhammedi, robi dhe i Dërguari i Allahut, për udhëheqësin e Egjiptit, Mukaukasin! Paqja qoftë mbi ata që ndjekin udhëzimin e drejtë. O sundimtar! Që të gjesh shpëtim dhe të përfitosh shpërblimin e dyfishtë nga Allahu, të ftoj të pranosh Islamin. Nëse refuzon, atëherë do të bartësh mëkatet e të gjithë koptëve** (egjiptianëve)**. Thuaj: 'O ithtarë të librit** (hebrenj dhe të krishterë)**, ejani në një fjalë të përbashkët mes nesh: të mos adhurojmë askënd tjetër veç Allahut, të mos i shoqërojmë Atij asgjë dhe të mos marrim njëri-tjetrin si zota përveç Allahut.' Nëse ata refuzojnë, atëherë thuaj: 'Bëhuni dëshmitarë se ne jemi myslimanë.'[257]"**

Pasi e lexoi letrën, Mukaukasi i tha Hatibit: "Qoftë për të mirë kjo punë!" Më pas ai mblodhi komandantët dhe zyrtarët e tij dhe filloi këtë bisedë me Hatibin:

[256] Buhârî, Tefsîr, 4; Ahmed bin Hanbel, Musned, III, 441; Beyhekî, Sunen, II, 353; İbni Sa'd, Tabakât, I, 259.
[257] Âl-i İmrân: 3/64.

Mukaukasi: "Më trego për atë që të ka dërguar. A është ai një profet? Na fol pak për të!"

Hatibi: "Po, ai vërtetë është Profet."

Mukaukasi: "Nëse është vërtet Profet, pse nuk bëri dua kundër popullit të tij, kur ai e dëboi nga vendi i tij?"

Hatibi: "Ti beson se Isai, biri i Merjemes, ishte profet, apo jo? Edhe ai, kur populli i tij deshi ta kapte dhe ta vriste, nuk bëri dua kundër tyre. Në vend të kësaj, Allahu e ngriti atë në qiell dhe e shpërbleu. Nëse Isai nuk bëri dua kundër popullit të tij, përse prisni që Muhammedi alejhi selam të veprojë ndryshe?"

Mukaukasi: "Shumë përgjigje e mençur! Ti je një njeri i urtë, i ardhur nga një njeri i mençur. Qëndro me ne sonte dhe nesër do të jap përgjigjen time."

Në vijim, Hatibi i tha Mukaukasit: "Para teje, këtu sundoi një faraon që pretendonte se ishte zot dhe i tha popullit të tij: 'Unë jam zoti juaj më i lartë.' Allahu e ndëshkoi atë si në këtë botë, ashtu edhe në botën tjetër. Merr mësim nga historia e tij që të mos bëhesh shembull i keq për të tjerët!"

Mukaukasi: "Ne kemi një fe dhe nuk do ta lëmë atë për një fe tjetër, përveç nëse ajo fe është më e mirë se e jona."

Hatibi iu përgjigj: "Feja që ju ndiqni është zëvendësuar me një fe më të mirë dhe më të përsosur. Allahu Suphanehu ve Teala, përmes këtij Profeti, e ka plotësuar fenë e Tij, Islamin. Ai nuk të fton vetëm ty, por i fton të gjithë njerëzit, në Islam. Kurejshët iu kundërvunë ashpër, hebrenjtë u treguan më të këqinjtë ndaj tij, ndërsa të krishterët janë më të afërtit. Muhammedi është i përmendur si i Dërguari që Isa e përgëzoi, njësoj sikur Musa e përgëzoi Isain. Prandaj, unë të ftoj në Islam dhe të ndjekësh Profetin të Fundit, Muhammedin alejhi selam."

"O ithtarë të librit (hebrenj dhe të krishterë), ejani në një fjalë të përbashkët mes nesh: të mos adhurojmë askënd tjetër veç Allahut, të mos i shoqërojmë Atij asgjë dhe të mos marrim njëri-tjetrin si zota përveç Allahut.' Nëse ata refuzojnë, atëherë thuaj: 'Bëhuni dëshmitarë se ne jemi myslimanë."
Ali Imran, 64.

Pas fjalëve të Hatibit r.a., Mukaukasi tha: "Kam vëzhguar me kujdes këtë Profet. Nuk kam gjetur asgjë që të mos jetë e logjikshme në urdhrat apo ndalimet e tij. Nga sa kuptoj, ai nuk është as magjistar, as fallxhi, dhe as gënjeshtar. Kam parë disa shenja të profetësisë tek ai. Zbulimi i gjërave të fshehta është një prej këtyre shenjave që ai zotëron. Une pasi të mendohem pak do ju përgjigjem ftesës suaj!" Pra, Mukaukasi kërkoi kohë për përgjigjen që do të jepte.

Kur nata kishte rënë ai e zgjoi Hatibin dhe i tha se kishte akoma më shumë pyetje për Profetin (s.a.s.). Ku mes tyre zhvillohet ky dialog:

Mukaukasi: "Kam tre pyetje për të bërë. Nëse më përgjigjesh saktë, do t'i dëgjoj me kujdes."

Hatibi: "Pyet çfarë të duash! Unë do të flas gjithnjë të vërtetën."

Mukaukasi: "Çfarë predikon Muhammedi? Për çfarë i fton njerëzit?"

Hatibi: "Ai i fton njerëzit të adhurojnë vetëm Allahun. Urdhëron faljen e pesë namazeve gjatë ditës dhe natës, agjërimin e Ramazanit dhe mbajtjen e premtimeve. Ai ndalon ngrënien e mishit të derrit të ngordhura."

Pas kësaj, Mukaukasi pyeti: "Përshkruam pamjen e tij fizike?"

Hatibi i dha një përshkrim të shkurtër, pa përmendur të gjitha veçoritë. Por Mukaukasi shtoi: "Ka edhe disa veçori të tjera që nuk i përmende. Ai ka një shenjë të profetësisë në shpinë, ka pak të kuqe në sytë e tij, vesh rroba prej leshi dhe ushqehet me hurma dhe ushqime të thjeshta. Ai është rritur nga xhaxhallarët ose kushërinjtë e tij."

Hatibi: "Po! Këto janë disa cilësi të tij."

Mukaukasi vazhdoi të pyesë për zakonet e Profetit (s.a.s.): "A përdor kuhl (lloj kozmetike për sytë)?"

Hatibi: "Po, ai përdor. Ai i kreh flokët dhe mban gjithnjë me vete pasqyrën, kutinë e kuhllit, krehërin dhe misvakun, keto i mban gjithnjë me vete, qoftë në udhëtim apo në vendbanim."

Mukaukasi: "Unë e di se do të vinte një Profet. Mendoja se do të dilte nga Shami, sepse shumica e profetëve dolën prej andej. Por gjithashtu e dija se Profeti i Fundit do të shfaqej në Arabinë e mbushur me pakënaqësi dhe varfëri. Kam lexuar në librat e mëparshëm se cilësitë e tij janë këto: 'Ai nuk bashkon dy motra në martesë, pranon dhuratat, por nuk pranon sadakanë. Shoqërohet me të varfërit dhe të pastrehët.' Koha e këtij Profeti përputhet me këtë periudhë. Por koptët nuk do të më dëgjojnë nëse përpiqem t'i bind për të. Dhe nuk mund të heq dorë nga froni im, sepse jam shumë i lidhur pas tij. E di që ky Profet do të pushtojë shumë vende dhe, pas tij, sahabët e tij do të vijnë deri në tokat tona. Në fund, ata do të triumfojnë mbi këto territore. Por unë nuk do t'i them koptëve asnjë fjalë për këtë dhe nuk dua që askush tjetër ta dijë për këtë bisedë."

Letra e Mukaukasit drejtuar Profetit Muhamed (a.s.) dhe reagimi i tij

Pas kësaj bisede, Mukaukasi thirri shkruesin e tij që shkruante në arabisht dhe diktoi një letër përgjigjeje drejtuar Profetit Muhamed (a.s.), ku thoshte:

"Drejtuar të biri të Abdullahut, Muhammedit, nga Mukaukasi, prijësi i Koptëve: O Muhammed! Paqja qoftë mbi ty! Kam lexuar letrën tënde dhe e kuptova atë që përmende dhe ftesën që bëre. Unë e dija se do të vinte një Profet, por mendoja se ai do të shfaqej në Sham. I kam pritur dhe i kam bërë nderime të dërguarit tënd. Ndërsa për ty kam dërguar dy skllave që kanë vlerë të madhe për koptët, veshje dhe një mushkë femër për ti hipur." Veç kësaj Mukaukasi nuk bëri asgjë më shumë dhe nuk e pranoi Islamin. Ai e mbajti Hatibin si mysafir për pesë ditë, ku u kejdes dhe tregoi shumë respekt dhe nderuarime për të. Në fund i tha: "Kthehu menjëherë në vendin tënd, te zotëria yt! Kam urdhëruar të dërgohen për të dy skllave, dy kafshë për mbajtje, një mijë miskale ari (një miskal = 4,8 gramë), njëzet sete veshjesh të hollë nga Egjipti dhe disa dhurata të tjera. Për ty kam urdhëruar të jepen njëqind dinarë dhe pesë sete veshjesh. Largohu nga këtu dhe bëj kujdes që koptët të mos dëgjojnë asnjë fjalë nga ty!" Mukaukasi gjithashtu dërgoi dhurata për Profetin Muhamed (a.s.), duke përfshirë: një gotë kristali, mjaltë, një shall, pëlhurë liri nga Egjipti, dru të çmuar, misk (aromë e veçantë), një bastun, një kuti me ngjyrë për sytë, vaj trëndafili, një krehër, gërshërë, misvak (furçë dhëmbësh tradicionale), një pasqyrë, gjilpërë dhe fije për të qepur. Më pas urdhëroi që Hatibi të përcillej me roje deri sa të kalonte kufirin e Egjiptit. Kur ata mbërritën në tokat arabe, takuan një karvan që po shkonte në Medinë. Hatibi i ktheu rojet e Mukaukasit dhe iu bashkua karvanit. Kur mbërriti në Medinë, ai i dorëzoi dhuratat Profetit Muhamed (a.s.) dhe ia përcolli mesazhin e Mukaukasit. Profeti (a.s.) e pranoi letrën dhe dhuratat,

por pas fjalëve të Mukaukasit tha: "**Sa njeri i keq! Nuk mundi të hiqte dorë nga mbretëria e tij. Megjithatë, mbretëria e tij nuk do të mbetet me të!**"[258]

Ndër skllavet që Mukaukasi i dërgoi Profetit Muhamed (a.s.), ishin dy motra: Maria dhe Sirini. Gjatë rrugës, Hatibi u ofroi atyre të pranonin Islamin, dhe ato pranuan. Profeti (a.s.) u gëzua shumë që Maria pranoi Islamin dhe e mori atë për grua. Nga ajo, Profeti (a.s.) pati një djalë të quajtur Ibrahim. Motrën e saj, Sirinin, ia dha një prej sahabëve të tij, poetit Hasan bin Thabit. Ndërsa nga kafshët e dhuruara, mushkës së bardhë thuajse gri iu dha emri "Duldul," ndërsa gomarit iu vu emri "Ufejr" ose "Jafur." Deri atëherë, në Arabinë Islame nuk ishte parë një mushkë e bardhë. Profeti (a.s.) shpesh përdorte gotën e kristaltë të dhuruar nga Mukaukasi për të pirë ujë.

Letra e durguar Mukaukasit u ruajt me respekt të madh nga ai, i cili e vendosi letrën e Profetit alejhi selam në një kuti fildishi dhe ia dorëzoi një prej skllaveve të tij për ta ruajtur. Historia e mëvonshme e letrës është se kjo letër u zbulua në vitin 1267 (1850) në një manastir të vjetër në rajonin Ahmin të Egjiptit, midis librave të koptëve. Ajo u ble nga Sulltani Abdulmexhid Han, kalifi i 96-të osman, dhe u vendos në Seksionin e Relikteve të Shenjta në Pallatin Topkapi, Stamboll.

Letra e Profetit Muhammed (A.S.) Drejtuar Kisras së Iranit, Husrev Perviz, dhe Ngjarjet Që Pasuan.

Letra e Profetit Muhamed (a.s.) drejtuar mbretit të Iranit, Husrev Perviz, iu dorëzua nga Abdullah bin Hudhafe. Kur Abdullah i paraqiti letrën e çmuar të Profetit (a.s.), mbretit arrogant, Kisras, i cili ia dha letrën shkruesit të tij për ta lexuar. Letra fillonte kështu:"**Bismil-lahirrahmanirrahim! Nga Muhamedi, i Dërguari i Allahut, drejtuar Kisras, mbretit të Persëve...**"Shkruesi e lexoi deri këtu, sepse kryeneçsia dhe arroganca e Kisras shpërtheu, pra ai e mori letrën dhe e grisi, duke u indinjuar nga fakti që letra fillonte me emrin e Profetit Muhamed (a.s.). Ai gjithashtu kërkoi të përzinte nga oborri i tij të dërgimtarin e letrës. letrë, sahabiun Abdullah radijallahu anhu.

Edhe pse rojtarët e sarajit të Kisras u përpoqën ta nxirrin Abdullahin pa e lënë atë të flas, por Adullahu para se të largohej iu drejtua mbretit dhe të pranishmëve të tjerë me këto fjalë:

"O popull i Persisë! Ju nuk besoni në profetët dhe nuk i pranoni librat e shenjtë. Ditët tuaja në këtë tokë janë të numëruara; jeta juaj është si një ëndërr e përkohshme. O Kisra! Para teje kanë sunduar shumë mbretër në këtë fron. Ata që ndoqën urdhrat e Allahut e fituan përjetësinë, ndërsa ata që nuk i dëgjuan urdhrat hyjnore, u dënuan me ndëshkimin e Tij dhe u larguan nga kjo botë. O Kisra! Letra që të solla ishte një mirësi e madhe për ty. Por ti e nënvlerësove atë. Betohem në Allahun e Madhëruar se feja që po e përbuz ti do të arrijë këtu, dhe atëherë nuk do të gjesh asnjë vend për t'u fshehur!"

Pasi i tha këto fjalë, Abdullahu e braktisi oborrin e Kisras, hipi në kafshën e tij dhe u largua me shpejtësi. Kur arriti në Medinë, i tregoi Profetit Muhamed (a.s.) gjithçka që kishte ndodhur. I Dërguari i Allahut tha:"**O Allah, ashtu siç ai e grisi letrën time, ti bëje atë dhe mbretërinë e tij copa-copa!**" Allahu i Plotfuqishëm

[258] Ibni Hishâm, Sîret, II, 607; İbni Sa'd, Tabakât, I, 260.

e pranoi lutjen e të Dërguarit të Tij. Kisra u vra nga i biri i tij një natë, i cili e kishte therur me thikë dhe trupin ja kishte copëtuar. Gjatë kalifatit të Hz. Omerit, të gjitha tokat e Iranit u pushtuan nga myslimanët dhe u bënë pjesë e shtetit Islam.[259]

Letra e Profetit Muhamed (a.s.) drejtuar Hâris bin Ebî Shimir, mbretit të Gassanëve.

Profeti Muhammed (a.s.) dërgoi sahabiun Shuça bin Vehb për t'i dorëzuar një letër mbretit të Gassanëve, Hâris bin Ebî Shimir. Kur Shuça arriti, fillimisht takoi portierin e mbretit dhe e ftoi atë në Islam. Portieri e pranoi ftesën dhe i përcolli nderimet dhe selamet e tij për Profetin Muhamed (a.s.). Ai gjithashtu e ndihmoi Shuçan që të takohej menjëherë me mbretin. Kur Hâris bin Ebî Shimir lexoi letrën e Profetit, ai shpërtheu në zemërim dhe duke e përbuzur e hodhi letrën përtokë. Ngjarjet që pasuan pas refuzimit të ftesës së Pejgamberit alejhi selam tregojnë qasjen e ndryshme të njerëzve ndaj ftesës hyjnore dhe fundin e atyre që zgjodhën të refuzonin të Vërtetën.

Letra për Hâris bin Ebî Shimir, mbretin e Gassanëve

Pas dorëzimit të letrës së Profetit (a.s.) nga Shuça bin Vehb r.a., mbreti Hâris bin Ebî Shimir reagoi me arrogancë dhe zemërim, duke hedhur letrën përtokë. Kur Shuça u kthye në Medinë dhe i tregoi Profetit (a.s.) atë që kishte ndodhur, ai tha:"**Le të zhduket mbretëria e tij!**" Pas një kohe të shkurtër, Hâris vdiq dhe mbretëria e tij u shpërbë.[260]

Letra për Hevze bin Ali, mbretin e Jemames

Selit bin Amr u dërgua te Hevze bin Ali, një sundimtar i krishterë, me një letër që thoshte:

"**Bismil-lahirrahmanirrahim! Nga Muhamedi, i Dërguari i Allahut, për Hevze bin Ali!**

Paqja qoftë mbi ata që ndjekin rrugën e drejtë! Dije se Islami do të përhapet deri në skajet më të largëta ku mund të shkojnë devetë dhe kuajt, dhe do të triumfojë mbi të gjitha fetë. Pranoje Islamin që të shpëtosh! Nëse bëhesh mysliman, do të vazhdosh të sundosh mbi tokat që tashmë ke nën kontroll."

Edhe pse Hevze refuzoi këtë thirrje të bekuar për shkak të ambicieve të tij për pushtet dhe frikës nga humbja e pozitës. Seliti i tha:"O Hevze, ti je udhëheqësi i këtij populli, por mos harro se, ata që i konsideron të mëdhenj, perandorët kanë vdekur dhe janë kthyer në dhe. Të mëdhenjtë e vërtetë janë ata që ndjekin urdhrat e Allahut dhe shmangen nga ndalesat e Tij. Mos u përpiq t'i largosh njerëzit nga rruga e drejtë për shkak të besimeve të tua të gabuara. Pranoje këtë thirrje dhe do të shpëtosh nga çdo frikë dhe do të arrish atë që shpreson. Por nëse nuk e pranon, të mbetet vetëm të mendosh për pasojat!"Hevze nuk e pranoi as këtë këshillë të Selit, i cili u kthye në Medinë dhe i tregoi Profetit Muhamed (a.s.) gjithçka që kishte ndodhur. I Dërguari u pikëllua për refuzimin e tij, por pas një kohe të shkurtër erdhi lajmi për vdekjen e Hevzes. Pasioni për pushtet dhe etja për lavdi përfunduan me humbjen e botës së përjetshme.[261]

[259] Buhârî, Tefsîr, 4; Megâdhi, 77, 82, 84; Elm, 7; İbni Hishâm, Sîret, II, 607; İbni Sa'd, Tabakât, I, 189, 259; Hudhâî, Tahrîc, 184.
[260] İbni Hishâm, Sîret, II, 607; İbni Sa'd, Tabakât, I, 261.
[261] İbni Hishâm, Sîret, II, 607; İbni Sa'd, Tabakât, IV, 203; Suheylî, Ravdu'l-unf, IV, 390

Letra për Munzir bin Savî, sundimtarin e Bahreinit

Ala bin Hadrami iu dërgua sundimtarit të Bahreinit, Munzir bin Savî. Kur Munziri lexoi letrën e Profetit Muhamed (a.s.), ai e pranoi me dashamirësi dhe e kuptoi përmbajtjen e saj. Pa hezituar, ai pranoi Islamin duke thënë:"**Eshhedu en la ilahe il-lallah ve eshhedu enne Muhammeden abduhu ve resuluhu!"**

"O Allah! Mundimet që ka duruar ajo në rrugën Tënde dhe për të Dërguarin Tënd nuk janë të fshehta për Ty."
Hadith

Ndryshe nga të tjerët, Munziri nuk tha: "Çfarë do të thonë të tjerët për mua?" ose "Do të humbas fronin tim!" Por me këtë vendim të mençur, ai shpëtoi veten dhe popullin e tij që e ndoqi atë duke pranuar Islamin. Pra Havze shpëtoi veten dhe popullin e tij nga zjarri i përjetshëm, xhehennemi. Kjo tregoi se edhe një udhëheqës me pushtet mund ta kuptojë të vërtetën dhe ta pranojë atë me sinqeritet.

Përgjigjja e Profetit ndaj sundimtarit të Bahreinit

Kur sundimtari i Bahreinit, Munzir bin Savî, i dërgoi një letër Profetit Muhamed (a.s.) për të njoftuar se disa nga njerëzit e tij kishin pranuar Islamin, ndërsa të tjerët ishin ende të pabindur, Profeti (a.s.) iu përgjigj:"**Atyre që të binden, mësoju Islamin. Ndërsa ndaj atyre që nuk binden dhe tregojnë armiqësi, të vendoset cizje (**taksë për jomyslimanët**). Nuk duhet të konsumohet mishi që theren nga mexhusitë (**zoroastrianët**), dhe as të bëhen martesa me ta.**"

Kështu, shtatë ambasadorët e Islamit kryen me sukses misionet e tyre, duke përhapur mesazhin e Profetit Muhamed (a.s.) në perandoritë më të mëdha të kohës. Ata paralajmëruan njerëzit për lumturinë e vërtetë (xhennetin) dhe për botën tjetër (Ahiretin). Kështu që parandorëve nuk ju la më shkas që ata të justifikohen duke thënë:"Nuk e kishim dëgjuar mesazhin Islam."

Reagimet e sundimtarëve ndaj letrave Profetike

Dy sundimtarët që pranuan Islamin ishin; Eshame, mbreti i Abisinisë (Habeshistanit që i bie Etiopia e sotme) dhe Mundhir bin Savî, sundimtari i Bahreinit.

Eshame, përveç se pranoi Islamin, pati nderin të shikonte disa nga shokët e Profetit (a.s.), të merrte duanë e tij dhe të shpallte martesën e Profetit me Ummu Habiben (r.a.).

Sundimtarët që nuk Pranuan Islamin

- Herakliu, perandori i Bizantit dhe Mukaukasi, sundimtari i Egjiptit, nuk u bënë myslimanë, por treguan respekt ndaj letrave profetike. Ata i dhanë përgjigje miqësore Profetit alejhi selam dhe në shenjë respekti dërguan dhurata shtetit Islam.

- Kisra, sundimtari i Persisë dhe mbreti i Gassanit nuk e pranuan Islamin. Të dy ata treguan armiqësi dhe i pritën shumë keq ambasadorët e Profetit (a.s.).

- Hevze bin Aliu, mbreti i Jemames, e trajtoi ambasadorin e Profetit alejhi selam me butësi, por refuzoi të prananote Islamin për shkak të ambicieve të tij për pushtet.

Ngjarje Të Tjera Gjatë Vitit Të Gjashtë Hixhri

1. Zîhari dhe shpallja e sures el-Muxhadele

Midis Havle bint Salebe dhe burrit të saj, Evs bin Samit, ndodhi ''zîhari'' (divorci i padrejtë që ndalonte ribashkimin me gruan), dhe si zgjidhje për këtë çështje u shpall sureja el-Muxhadele.

2. ***Garat e deveve dhe mesazhi i Profetit***

Profeti Muhamed (a.s.) lejoi garat me deve dhe kuaj. Kur deveja e tij, e cila nuk ishte mundur më parë, u mposht nga deveja e një beduini, sahabët u trishtuan. Profeti (a.s.) tha:"Çdo gjë që arrin kulmin, do të zbresë."

3. ***Vdekja e Ummu Rumân, nëna e Aishes (r.a.)***

Profeti (a.s.) mori pjesë në varrimin e Ummu Rumân dhe tha:"Kush dëshiron të shikojë një nga hyritë e Xhenetit, le të shikojë Ummu Rumân."Ai u lut për shpirtin e saj dhe tha: **"O Allah! Mundimet që ka duruar ajo në rrugën Tënde dhe për të Dërguarin Tënd nuk janë të fshehta për Ty."**

Këto ngjarje tregojnë mirësinë, drejtësinë dhe udhëheqjen shpirtërore të Profetit Muhamed (a.s.) si udhërrëfyes për gjithë njerëzimin.

ÇLIRIMI I HAIBERIT

Situata në Medinë para pushtimit të Hajberit

"Kështjella e Haiberit është çliruar me Ali ibn Ebu Talibin."
Hadith

Në Medinë, përveç myslimanëve të sinqertë, kishte edhe hipokritë që pretendonin se ishin myslimanë, por në të vërtetë ishin armiq të Islamit. Para ardhjes së Profetit Muhamed (a.s.) në Medinë, banorët e qytetit kishin zgjedhur Abdullah bin Ubej bin Selul si udhëheqës të tyre. Madje atij i kishin dhuruar një kurorë të stolisur me gurë të çmuar. Pas Hixhretit të Profetit (a.s.), shumica e banorëve e pranuan Islamin dhe u bashkuan me të. Kështu që Abdullah bin Ubej, u kthye në një figurë pa rëndësi, humbi ndikimin dhe rëndësinë e tij. Nga inati dhe urrejtja, ai filloi të bashkëpunonte me hebrenjtë për të komplotuar kundër Profetit Muhamed (a.s.).

Komploti dhe magjia ndaj Profetit Muhamed (a.s.)

Një grup hebrenjsh, të udhëhequr nga Lebid bin Asim, u organizuan për të dëmtuar Profetin (a.s.). Ata paguan një grua plakë të quajtur Hajre, e njohur për aftësitë e saj në magji. Kjo grua përgatiti një magji duke përdorur një pëllumb, i cili u mbështoll me fije të lidhura nyje dhe u fsheh në një pus të braktisur jashtë Medinës. Si rezultat i kësaj, Profeti Muhamed (a.s.) u sëmur rëndë dhe nuk mund të lëvizte për nëntë ditë. Në këtë periudhë, engjëlli Xhibril (a.s.) erdhi dhe e informoi Profetin (a.s.) për shkakun e sëmundjes. Së bashku me disa shokë të tij, Profeti (a.s.) shkoi te pusi dhe gjeti zogun me nyjet magjike. Për të zgjidhur nyjet, Xhibrili (a.s.) solli dy sure të Kur'anit: El-Felek dhe En-Nas. Ndërsa Profeti (a.s.) lexonte çdo ajet, një nyjë zgjidhej dhe një gjilpërë hiqej nga trupi i zogut. Pasi lexoi të gjitha ajetet, magjia u prish dhe Profeti (a.s.) u shërua plotësisht.

Ndëshkimi për Komplotistët

Pas kësaj ngjarjeje, ata që ishin përgjegjës për këtë akt u ndëshkuan rëndë nga banorët e Medinës. Ndërsa hebreu Lebid bin Asim, u kap dhe u soll para Profetit Muhamed (a.s.). Kur ai e pyeti **''Përse e bëre këtë akt?''** Lebidi u përgjigj: E bëra për dashurinë që kam ndaj floririt. Shokët e Profetit kërkuan leje për ta ndëshkuar me vdekje, por Profeti Muhamed (a.s.), i cili nuk ndëshkonte personalisht për çështje të tilla, tha: "**Ndëshkimi hyjnor që do të marrë ai është shumë më i ashpër.**[262]

[262] Buhârî, Tıb, 47; Ahmed bin Hanbel, Musned, IV, 63; İbni Sa'd, Tabakât, II, 198.

Hebrenjtë për shkak se u përfshinë në komplote të shumë përsëritura kundër myslimanëve, u dëbuan nga Medineja. Një pjesë e tyre u vendos në Hajber, ndërsa të tjerë shkuan në veriun e Shamit. Edhe pse ishin larguar, urrejtja dhe dëshira për hakmarrje ndaj myslimanëve nuk u shua kurrë. Ndaj ata përsëri planifikuan sulme kundër myslimanëve duke kërkuar ndihmë nga fise të ndryshme arabe dhe hebraike.

Myslimanët duke qenë të vetëdijshëm që hebrenjtë dhe mushrikët vazhdimisht planifikonin sulme kundër tyre ata nisën të organizohen për tu mbrojtur kundër tyre. Mirpo sapo morën vesh se myslimanët mund të organizonin një sulm kundër tyre, hebrenjtë e Hajberit u bashkuan me fiset arabe, të cilët ishin Gatfanët. Njëkohësisht ata kërkuan ndihmë nga hebrenjtë e vendeve si Fedek, Tejma dhe Vadi-ul-Kura. Synimi i tyre ishte të sulmonin Medinën dhe të merrnin hak ndaj myslimanëve.

Hebrenjtë e Hajberit e pranuan këtë thirrje dhe thirrën në ndihmë fiset hebraike të rajonit si dhe fisin Gatfan. Nga Gatfanët erdhën një numër i madh luftëtarësh të zgjedhur, të cilët filluan përgatitjet në Hajber. Ndërkohë që ata përgatiteshin, Muhammedi, paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të, u informua për situatën e hebrenjve. Ai dërgoi Abdullah ibn Revahan me tre shokë të tij për të zbuluar çfarë po ndodhte në Hajber. Abdullah ibn Revaha dhe shokët e tij mbërritën me shpejtësi në Hajber, një qytet i pasur që kishte tetë kështjella të fortifikuara, disa kështjella më të vogla, toka të begata, vreshta dhe kopshte të shumta.

Abdullahu r.a. dërgoi shokët një nga një në kështjellat Shik, Ketime dhe Natat, ndërsa ai vetë hyri në një kështjellë tjetër për të vëzhguar për tri ditë situatën dhe përgatitjet e hebrenjve për luftë. Pas tre ditësh, u bashkuan në vendin e caktuar për takimin dhe u kthyen me shpejtësi në Medinë për t'i raportuar të Dërguarit të Allahut mbi përgatitjet e tyre. I dashuri i Allahut, paqja qoftë mbi të, urdhëroi shokët e tij të përgatiteshin me shpejtësi.

Për të parandaluar një sulm të hebrenjve ndaj Medinës, Muhammedi alejhi selam vendosi të nisej drejt Hajberit. Lajmi për këtë vendim shkaktoi panik te hebrenjtë që ndodheshin në Medinë. Për të dobësuar moralin e myslimanëve, ata thoshin: "Betohemi se, po të kishit parë kështjellat e Hajberit, luftëtarët trima që janë mbledhur atje, nuk do të guxonit kurrë të shkonit atje! Kështjellat e larta në majat e maleve mbrohen nga trima të blinduar. Mijëra luftëtarë nga fshatrat përreth janë mbledhur për ndihmë. A është e mundur që ju të pushtoni Hajberin?!" Por sahabët trima përgjigjeshin: "Allahu i Madhëruar i ka premtuar të Dërguarit të Tij se Hajberi do të çlirohet." Pra, shabët duke treguar se nuk kishin frikë nga hebrenjtë edhe një herë treguan vendosmërinë e tyre në rrugën e Allahut. Kjo qëndresë e sahabëve i pikëllonte dhe i shqetësonte më shumë hebrenjtë. Por ky shqetësim ishte edhe për hipokritët. Ndaj kreu i hipokritëve, Abdullah ibn Ubeji, i dërgoi urgjentisht një lajm Hajberit, duke thënë: "Muhamedi po vjen drejt jush me një grup të vogël ushtarësh. Nuk ka asgjë për t'u trembur, por sigurohuni të merrni masa paraprake, të grumbulloni mallrat tuaja në kështjella dhe t'i përballoni jashtë kështjellave!"

Sahabët e nderuar përfunduan përgatitjet e tyre, u përshëndetën me familjarët dhe u mblodhën rreth të Dërguarit të Allahut. Ata ishin dyqind kalorës dhe një mijë e katërqind këmbësorë. Me dëshirën për të përhapur fenë e Allahut, për të luftuar në xhihad dhe për të fituar gradën e shehidit, ata u vunë në shërbim të të dashurit të tyre, të Dërguarit të Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qofte). Në këtë kohë, disa gra kërkuan leje nga i Dërguari i Allahut për të marrë pjesë në luftë, duke u

"Ne, Pejgamberët, nuk lëmë trashëgimi. Ajo që lëmë pas, bëhet sadaka për të varfrit."
Hadith

ofruar të përgatisnin ushqimin për sahabët, të kujdeseshin për të plagosurit dhe të sëmurët, të mjekonin plagët dhe të kryenin punë të tjera të nevojshme. I Dërguari i Allahut, nga mëshira e tij, nuk i la ato pa shpërblim për këto përpjekje. Kështu, në mesin e luftëtarëve u bashkuan edhe njëzet gra të devotshme, ndër të cilat ishte edhe e dashura e tij, bashkëshortja e tij e nderuar, Ummu Seleme.[263]

I Dërguari i Allahut caktoi si zëvendës në Medinë Siban nga fisi Gifar (dhe është raportuar gjithashtu se këtë detyrë e mbajti edhe Numejle ibn Abdullah). Udhëtimi filloi me tekbire. Ata që nuk mund të merrnin pjesë në luftë për arsye të ndryshme ose ishin shumë të rinj për t'u bashkuar, shikonin me admirim të Dërguarin e Allahut dhe luftëtarët, ndërsa i përcillnin me tekbire dhe lutje baballarët, gjyshërit, xhaxhallarët, dajallarët dhe vëllezërit e tyre. Ndërkohë kalendarët tregonin muajin Muharrem të vitit të shtatë të Hixhretit. Flamuri i shenjtë i të Dërguarit të Allahut, paqja qoftë mbi të, mbahej nga Aliu r.a., ndërsa komandant i krahut të djathtë ishte Omeri radijallahu anhu.[264] Ndërsa komandant i krahut të majtë ishte caktuar një tjetër sahabi.

Udhëtimi kalonte me gëzim të madh. Poetët i drejtonin lutje Allahut për begatitë e Tij, këndonin salavate për të dashurin e Allahut dhe lavdëronin sahabët e shquar. Sahabët, sikur të ishin duke shkuar në festë, brohorisnin të gjithë së bashku:"**Allahu Ekber! Allahu Ekber! La ilahe il-lallahu vallahu ekber!**"Zëri i tyre përshkonte çdo vend. Në çdo vendpushim, Pejgamberi alejhi selam bënte këtë dua:"**O Allah! Të kërkoj mbrojtje nga brengat për të ardhmen, nga shqetësimet për të kaluarën, nga dobësia dhe përgjumësia, nga koprracia dhe frika, nga borxhet që rëndojnë mbi supet dhe nga shtypja e padrejtë e mizorëve!"**Ndërsa kur iu afruan Hajberit, i dashuri i Allahut ndali ushtrinë dhe ngriti duart në lutje: **"O Allah, Zot i qiejve dhe i gjithçkaje që ato mbulojnë! O Allah, Zot i tokave dhe i gjithçkaje mbi to! O Allah, Zot i djajve dhe i atyre që i mashtrojnë! O Allah, Zot i erërave dhe i atyre që i shpërndajnë! Të lutemi për mirësinë dhe të mirat e këtij vendi, të njerëzve që jetojnë në të dhe të gjithçkaje që ndodhet këtu. Të kërkojmë mbrojtje nga e keqja e këtij vendi, nga njerëzit e këqij dhe nga gjithçka e keqe që gjendet këtu!"**Sahabët pëshpëritnin: "**Amin, amin!"** Më pas i Dërguari i Allahut u tha:"**Me emrin e Allahut të Gjithëmëshirshëm, të Mëshirëplotë, ecni përpara!"** Sahabët u nisën sërish duke rrethuar Profetin alejhi selam dhe kur mbërritën pranë kështjellës Natat, e cila ishte më e fuqishmja e Hajberit, ishte bërë mbrëmjë. Shabët e ngritën kampin aty dhe po përgatiteshin që të kaloi nata sepse I Dërguari i Allahut, si zakonisht, nuk sulmonte pa zbardhur dita dhe pa i ftuar armiqtë që të pranonin Islamin. Nëse nuk e pranonin, atëherë fillonte lufta. Kështu që sahabët pritën mëngjesin.

Hebrenjtë nuk e kishin kuptuar që ushtria islame kishte mbërritur. Në mëngjes, pas namazit, i Dërguari i Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të) përgatiti ushtrinë dhe e nisi atë drejt kështjellës Natat. Me rregull të përsosur, dyqind kalorës dhe një mijë e katërqind këmbësorë iu afruan kështjellës. Ndërkohë, disa hebrenj dolën nga kështjella për të punuar në vreshta dhe ara. Kur panë ushtrinë islame, mbetën të shtangur dhe thirrën:"Betohemi se, këta janë Muhamedi dhe ushtria e tij e rregullt!" Dhe menjëherë u kthyen me vrap drejt kështjellës. Kur pa këtë skenë,

[263] Ebû Dâvûd, Cihâd, 152; Vâkıdî, Megâdhî, II, 685.
[264] Buhârî, Megâdhi, 40; Vâkıdî, Megâdhî, II, 653; Kilâ'î, İktifâ, II, 258.

> *"Ditën kur morëm kalanë e Hajberit, Resulullahu (sallallahu alejhi ve selam) ndaloi ngrënien e mishit të gomarëve të zbutur dhe martesën e përkohshme (muta)."*
> ***Aliu radijallahu anhu***

i Dashuri i Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të) tha:"**Allahu Ekber! Allahu Ekber! Hajberi ka rënë!**" I Dërguari i Allahut i ftoi hebrenjtë:**"O hebrenjë! Pranoni Islamin dhe bëhuni myslimanë, ose dorëzohuni duke paguar haraç dhe xhizje, ndryshe do të luftojmë dhe do të derdhet gjak."**Hebrenjtë iu drejtuan prijësit të tyre, Selam ibn Mishkem, i cili ju tha:"Më parë ju thashë që të marshonit kundër Muhamedit, por nuk më dëgjuat. Tani, së paku, në luftë mos u tregoni të pavendosur. Luftoni derisa të vdisni, sepse të vdisni në betejë është më mirë se të mbeteni robër!"

Hebrenjtë nxituan të dërgonin gratë dhe fëmijët në kështjellën Ketibe, rezervat ushqimore në Naim ndërsa luftëtarët i dërguan në Natat. Më pas thirries së myslimanëve iu përgjigjën me të shtëna shigjetash. Luftëtarët myslimanë ngritën mburojat e tyre për t'u mbrojtur dhe me urdhërin e të Dërguarit të Allahut, filluan të qëllonin me shigjeta drejt kështjellës. Tashmë lufta kishte filluar. Njëra palë, nën udhëheqjen e të Dërguarit të Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të) , luftonte për të përhapur Islamin dhe për të shpëtuar hebrenjtë nga zjarri i Xhehenemit. Ndërsa pala tjetër, kokëfortë dhe ziliqare, refuzonte të pranonte të vërtetën dhe, për vite me radhë, kishte komplikuar planifikime për të eliminuar Profetin, por gjithmonë kishte dështuar falë mbrojtjes së Allahut.

Një mijë e gjashtëqind myslimanë përballeshin me mbi dhjetë mijë luftëtarë hebrenj që qëllonin pa pushim me shigjeta. Sahabët e nderuar mbroheshin me mburojat e tyre dhe herë pas here i kthenin shigjetat kundër armiqve. Megjithatë, disa prej tyre u plagosën. Në një moment, Habab ibn Mundhir iu afrua të Dërguarit të Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të) me respekt të madh dhe tha:"Jeta ime është për ty, o i Dërguar i Allahut! A nuk mund ta zhvendosim kampin tonë diku tjetër?"I Dërguari i Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të) ju përgjigj:**"Në mbrëmje, inshallah, do ta ndryshojmë!** Myslimanët tashmë ishin brenda rrezes së shigjetave të hebrenjve, dhe disa shigjeta arrinin deri prapa kampit të myslimanëve.[265]

Atë ditë, deri në mbrëmje, lufta vazhdoi me shkëmbim shigjetash. Rreth pesëdhjetë sahabë u plagosën nga shigjetat që gjuanin armiqtë. Kur erdhi mbrëmja, Profeti Muhammed (paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të) caktoi Muhamed bin Mesleme për të gjetur një vend të përshtatshëm për kampin e ushtrisë. Ai sugjeroi një vend të quajtur Rexhi, i cili u konsiderua i përshtatshëm, dhe kampi i myslimanëve u zhvendos atje. Ndërkohë, të plagosurit nisën ti trajtoheshin mjekimit. Të nesërmen, sahabët e guximshëm u kthyen për të luftuar pranë kështjellës Natat, ku lufta zgjati deri në mbrëmje. Luftimet vazhduan edhe në ditën e tretë, të katërt dhe të pestë, ndërsa hebrenjtë sulmonin tinzërisht nga brënda kalasë. Gjatë këtyre ditëve, i dashuri i Allahut vuante nga një dhimbje e fortë koke dhe për dy ditë nuk mund të ishte i pranishëm mes luftëtarëve. Në ditën e parë, flamuri iu dha Ebu Bekrit, ndërsa në të dytën, ju dha Omerit. Të dy udhëhoqën sahabët me guxim dhe luftuan ashpër kundër hebrenjve, por nuk arritën ta pushtonin kështjellën. Ndërkohë, hebrenjtë, të inkurajuar nga situata, hapën portat e kështjellës dhe nisën një kundërsulm. Lufta u bë ballë për ballë dhe shumë e ashpër. I Dërguari i Allahut u tha sahabëve të tij:"**Allahu Ekber! Allahu Ekber!...** Thoni tekbir!"Sahabët të gjithë

[265] Vâkıdî, Megâdhî, II, 641.

BETEJA E HAIBERIT



"Betohem në Allahun e Lartësuar, i Cili e nderoi Muhamedin me profetësi, se këtë flamur do t'ia dorëzoj një trimi që nuk e di çfarë është tërheqja prapa."
Hadith

në kor filluan të thërrasin "Allahu Ekber", tekbirët e cilëve jehonin në tokë dhe qiell. Sahabët nën shoqërinë e tekbirëve filluan të sulmonin me entuziazëm armikun tinzar, tradhëtar dhe të pa besë. Gjatë kësaj beteje, Muhamed bin Mesleme humbi të vëllanë e tij, Mahmudin, i cili ra dëshmorë. Luftimet vazhduan me ashpërsi deri në mbrëmje.[266] Të nesërmen, një nga komandantët më të famshëm të Hajberit, Merhabi, doli nga kështjella i armatosur deri në dhëmbë. Ai ishte një burrë i fuqishëm, si një gjigant, dhe deri atëherë askush nuk kishte mundur ta mposhtte. Duke iu drejtuar myslimanëve, ai tha:"Unë jam Merhabi, i njohur për guximin dhe trimërinë time!"Ndërsa ai mburrej në shesh, një nga sahabët, Amiri, doli përballë tij dhe tha:"Edhe unë jam Amiri, që nuk trembem të hidhem në zemër të betejave të ashpra!"

Amiri u përball me Merhabin. Gjiganti Merhab sulmoi me të gjithë forcën e tij duke goditur Amir me një shpatë të madhe, ku ishte shkruar:"Kushdo që e prek, shkatërrohet!"Amiri ngriti menjëherë mburojën e tij. Shpata e rëndë goditi mburojën me një zhurmë të fortë dhe u ngul në të. Pastaj, Amir, duke iu lutur Allahut, tha: "O Allah!" Dhe sulmoi me shpatën e tij këmbët e mbuluara me forca të çelikut të Merhabit. Por shpata e Amirit u përplas me çelikun dhe u kthye mbrapsht, duke e goditur vetë atë në këmbë. Goditja aksidentale preu një nga arteriet kryesore të këmbës së Amirit. Sahabët vrapuan ta ndihmonin Amirin dhe e çuan në kamp për trajtim, por ai, radijallahu anh, ndërroi jetë atje, duke fituar statusin e dëshmorit dhe duke fluturuar drejt Parajsës së Lartë (xhennetit)[267]. Luftimet vazhdonin me gjithë ashpërsinë e tyre. Afër mbrëmjes, i dashuri i Allahut, Profeti ynë (paqja qoftë mbi të), u bëri një ofertë Gatfanëve, të cilët kishin ardhur për të ndihmuar hebrenjtë me një ushtri prej katër mijë vetash. Ai duke u premtuar se do t'u jepte të gjithë prodhimin e hurmave të Hajberit për një vit, iu propozoi atyre të largoheshin nga beteja dhe të ktheheshin në vendin e tyre. Mirëpo Gatfanët e refuzuan këtë ofertë. Për këtë arsye, Profeti i Shenjtë i urdhëroi sahabët e tij që të qëndronin gjatë natës përreth fortesës ku qëndronin Gatfanët. Gatfanët ishin të tmerruar nga mundësia e një sulmi gjatë natës dhe nuk mundën të flinin. Atë natë, një zë misterioz, që nuk dihej nga vinte, shpalli se vendi i Gatfanëve ishte sulmuar, familjet dhe pasuritë e tyre ishin marrë nën kontroll. Ky zë u përsërit tri herë dhe gjithë Gatfanët, përfshirë komandantin e tyre, Ujejne, e dëgjuan me frikë të madhe. Para agimit, Gatfanët, të kapluar nga paniku, u tërhoqën nga Hajberi dhe u nisën drejt vendit të tyre. Në mëngjes, hebrenjtë u habitën kur mësuan për largimin e papritur të Gatfanëve dhe ranë në dëshpërim një dëshprim të madh. Ata u penduan thellësisht që kishin thirrur Gatfanët në ndihmë.

Heroizmi i Aliut Radijallahu Anhu

Ato ditë, përpara Haiberit ndodhën luftime të ashpra. Mirëpo, kështjella nuk u mor dot. Në mbrëmje, Pejgamberi alejhi selam tha: "Nesër do t'ia dorëzoj flamurin një trimi të tillë që ai e do Allahun e Lartësuar dhe të Dërguarin e Tij, dhe Allahu i Lartësuar dhe i Dërguari i Tij e duan atë. Allahu i Lartësuar do ta realizojë fitoren me duart e tij!" Atë natë, sahabët e nderuar e pritën me padurim mëngjesin. Secili shpresonte që flamuri t'i jepej atij dhe i luteshin Allahut të Lartësuar për këtë.

[266] Vâkıdî, Megâdhî, II, 641; Suheylî, Ravd-ul-unf, VI, 507.
[267] Ahmed bin Hanbel, Musned, IV, 51; Vâkıdî, Megâdhî, II, 639; Beyhekî, Sunen, II, 174; İbni Sa'd, Tabakât, II, 211.

Në mëngjes Bilal-i Habeshiu, me zërin e tij të bukur dhe plot ndjenjë, e këndoi ezanin e sabahut. Ndërsa ezani këndohej, secili përjetonte një ndjenjë të veçantë dhe një kënaqësi hyjnore, prej të cilës nuk i ngopej shpirti. I Dërguari i dashur i Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të), pasi fali namazin e sabahut me shokët e tij, u ngrit dhe urdhëroi që të sillnin flamurin e shenjtë të Islamit. Ndërsa flamuri i shenjtë po i sillej, sahabët prisnin në këmbë dhe dëgjonin me vëmendje të madhe fjalët që do të dilnin nga buzët e bekuara të Resulullahut. I cili tha: **"Betohem në Allahun e Lartësuar, i Cili e nderoi Muhamedin me profetësi, se këtë flamur do t'ia dorëzoj një trimi që nuk e di çfarë është tërheqja prapa."** Pastaj, duke drejtuar shikimin e tij të bekuar mes sahabëve, tha**: "Ku është Aliu?"** Sahabët i thanë: **"O i Dërguar i Allahut! Atij i dhembin sytë," ai tha: "Thirreni atë të vijë tek unë."** Aliu ishte prekur nga një dhimbje në sy që ia kishte bërë të pamundur t'i hapte ato. Sahabët shkuan dhe ia përcollën fjalët e të Dërguarit të Allahut dhe më pas e ndihmuan që të vinte tek ai. Kur erdhi Aliu radijallahu anhu Profeti alejhi selam bëri dua për shërimin e tij dhe i fërkoi sytë me gishtat e tij të bekuar dhe të lagur me pështymën e tij. Në atë çast Aliut r.a., dhimbjet e syve ju zhdukën plotësisht. Përveç kësaj, i Dërguari i Allahut tha: "**O Zot! Largoje nga ky çdo shqetësim të nxehtësisë dhe të ftohtësisë."** Më pas, I Dërguari i Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të) me duart e tij të bekuara e veshi Aliun me një parzmore, ia lidhi shpatën e tij në brez dhe flamurin e bardhë të Islamit ia dha në dorë. Në fund i tha; **" O Ali! Lufto derisa Allahu i Lartësuar të të japë fitoren dhe kurrë mos u kthe prapa!"** "Jeta ime qoftë e flijuar për ty, o i Dërguar i Allahut! Do të luftoj me ta derisa të hyjnë në fenë Islame." Ja ktheu Aliu radijallahu anhu. Ndërsa I Dërguari i dashur i Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të) i tha: "**Betohem se, nëse Allahu i Lartësuar, të bën shkak ty për udhëzimin, qoftë edhe një njeri, tyre kjo është më e mirë për ty sesa të zotërosh devetë e kuqe. Madje është aq e mirë saqë edhe sikur t'i japësh ato si sadaka në rrugën e Allahut të Lartësuar."**[268]

Pasi ju dha flamuri Ali r.a., me flamurin në dorë, i doli para ushtrisë Islame dhe nisi të përparonte drejt kalasë së hebrenjve. Ndërsa sahabët e nderuar e ndiqnin atë nga pas. Kur u afruan pranë kalasë dhe flamuri u ngul pranë një shkëmbi, u pa të hapej porta e kalasë Natat. Nga porta u pa të dilte një grup luftëtarësh hebrenj, të cilët ishin heronjtë më të zgjedhur të Haiberit, ku seçili prej tyre ishte i veshur me dy parzmore dhe të mbuluar me mburojë hekuri. Njëri prej tyre ishte Hârithi, vëllai i Merhabit, i cili njihej për trimërinë e tij të pashoq. Harithi iu drejtua Aliut r.a. për t'u ndeshur në dyluftim me të. Dhe nisi ta sulmoi me shpejtësi... Tingujt e dy shpatave mbushën fushën e betejës, ndërsa u pa, shpata e Aliut, e cila goditi si rrufe dhe ia ndau kokën nga trupi Hârithit. Në atë çast, thirrjet "**Allahu Ekber! Allahu Ekber!"** u ngritën deri në qiell. Kur Merhabi dëgjoi për vrasjen e të vëllait, ai doli në fushën e betejës me ushtrinë e tij. I veshur me dy parzmore dhe i pajisur me dy shpata, i cili dukej si një gjigant. Me një zemërim të madh, ai tha: "Unë jam Merhabi, që luftoj si hero në betejat më të ashpra! Jam ai që me shigjetën dhe shpatën time shpoja edhe luanët që vrumbullonin me egërsinë e tyre!" Ndërsa Aliu r.a., me një qetësi të madhe, iu përgjigj: "Unë jam Haidar (Luan), emër që ma dha nëna ime! Jam si një luan i fuqishëm dhe një trim që do të të rrëzojë në një lëvizje të vetme!" Kur Merhabi dëgjoi fjalën "Haidar", një frikë i pushtoi zemrën, sepse natën e kaluar kishte parë në ëndërr një luan që e shqyente. Dhe ai mendoi se mos vallë luani i ëndrrës ishte Aliu r.a.. Ndërsa këto mendime i kalonin në mendje, Merhabi me shpatat e tij sulmoi, por

[268] Vâkıdî, Megâdhî, II, 653

"O sahabët e mi! Hiqni dorë nga ky ushqim, sepse kjo copë mishi më lajmëroi se ishte e helmuar."
Hadith

Aliu r.a. i priti goditjet me mburojën e tij. Më pas, duke iu mbështetur Allahut, ai tha: **"Ja Allah!"** dhe goditi me shpatë. Goditja e tij e fuqishme e ndau në dysh mburojën e trashë të Merhabit, helmetën prej çeliku dhe kokën e tij deri në qafë. Nga trupi i tij i madh, pra Marhabit, nisi ti rridhte gjaku rrëke dhe pa kaluar shumë trupi i tij ra në tokë si një lis i shkulur. Zëri i fuqishëm i shpatës së Aliut r.a. u dëgjua në të gjithë Haiberin. Atë momënt I Dërguari i Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të) tha: **"Gëzohuni! Fitorja e Haiberit tashmë është e sigurt dhe e lehtë!"** Sahabët e nderuar u mahnitën nga trimëria e Aliut dhe me thirrjet **"Allahu Ekber! Allahu Ekber!"** tokën dhe mbushën qiellin. Tashmë beteja kishte nisur dhe vazhdonte me gjithë ashpërsinë e saj. Ndërsa luftonin pranë portës së kalasë, një hebre e goditi me shpatë mburojën e Aliut, e cila i doli nga dora dhe ra në tokë. Nuk kishte kohë për ta marrë përsëri, sepse hebreu e rrëmbeu dhe iku. I trishtuar nga kjo, Luan i Allahut shpërndau me shpatën e tij armiqtë përreth dhe pastaj vendosi të përdorte portën e kalasë si mburojë. Ai e kapi portën e madhe prej hekuri dhe e hoqi nga vendi i saj duke thënë **"Bismil-lahirrahmanirrahim."** Kjo portë, që as tetë ose dhjetë trima nuk do të mund ta lëviznin, u ngrit nga Aliu me një dorë dhe u përdor si mburojë në betejë. Ky akt i pabesueshëm ishte një mrekulli e të Dërguarit të Allahut dhe një shenjë e veçantë e Aliut.

Aliut i dolën përballë gjashtë luftëtarë të tjerë më të fuqishëm nga hebrenjtë. Ai i mposhti të gjithë me ndihmën e Allahut dhe, së bashku me shokët e tij trima, hynë në kala. Luftimet tashmë po zhvilloheshin brenda mureve të kalasë. Në një kohë të shkurtër, nuk kishte më askënd që të përballej me ta. Flamuri i Islamit u ngulit në kala. Kështu, kalaja më e fortifikuar e Haiberit, Natati, u çlirua. I Dërguari i Allahut, pasi e puthi Aliun në ballë i tha: **"Allahu dhe i Dërguari i Tij janë të kënaqur me ty për trimërinë që tregove."** Duke dëgjuar këto fjalë të bekuara, Aliu r.a. nga gezimi ja nisi të qajë. Kur e pa I Dërguari i Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të) e pyeti: **"Pse po qan?"**: "Jeta ime qoftë flijuar për ty, o i Dërguari i Allahut! Po qaj nga gëzimi, sepse Allahu dhe i Dërguari i Tij janë të kënaqur me mua." iu përgjigj Aliu radijallahu anhu. Atëherë I Dërguari i Allahut shtoi: **"Jo vetëm unë, por edhe Xhibrili, Mikaili dhe të gjithë melekët janë të kënaqur me ty."**

Ndërkohë që lufta në Heiber vazhdonte, katërqind myslimanë nga fisi Devs erdhën për të ndihmuar të Dërguarin e Allahut.[269] Luftimet vazhduan me intensitet për të pushtuar kalatë e tjera. Mirëpo kur u çliruan edhe shtatë kalatë e tjera të Haiberit, hebrenjtë kuptuan që nukmund të rëzistojnë më dhe ranë të pashpresë, ndaj ata dërguan një delegacion për të kërkuar paqe. I Dërguari i Allahut(paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të) e pranoi këtë propozim dhe u arrit një marrëveshje ndërmjet myslimanëvë dhe hebrenjëve i cila përmbantë kushtet e mëposhtme:

1. Hebrenjtë që luftuan kundër myslimanëve nuk do të vriten.
2. Hebrenjtë që dëshirojnë të largohen nga Haiberi mund të marrin me vete vetëm fëmijët e tyre dhe një barrë deveje me sende të nevojshme shtëpiake.
3. Të gjitha mallrat e tjera të lëvizshme dhe të palëvizshme, armët, pasuritë dhe kafshët do t'u mbeten myslimanëve.
4. Asnjë send që duhet t'u dorëzohet myslimanëve nuk do të mbahet i fshehur. Kushdo që shkel këtë rregull do të përjashtohet nga mbrojtja e Allahut dhe e të Dërguarit të Tij.

[269] İbni Sa'd, Tabakât, I, 353; İbni Sa'd, Tabakât, I, 353.

Ata që nuk i respektuan këto kushte, sikur Kinane bin Rebi, i cili kishte fshehur thesarë duke i varrosur në tokë, u ndëshkuan. Plaçka e luftës ishte e pafund. Toka pjellore e Haiberit dhe plantacionet e hurmave iu dorëzuan plotësisht ushtrisë islame. Në atë kohë, Gatfanët, të cilët ishin kthyer në vendin e tyre, u kthyen në Haiber për të ndihmuar hebrenjtë. Kur panë se i Dërguari i Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të) kishte pushtuar Haiberin dhe i kishte mposhtur hebrenjtë, ata thanë: "O Muhamed! Ti na premtove hurmat e Haiberit për një vit nëse nuk ndërhynim. Ne e mbajtëm fjalën tonë. Tani na i jep ato!" I Dërguari i Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të) iu përgjigj: "Filan mal le të jetë i juaji."[270]

Largimi i Fiseve të Gatafanëve nga Haiberi nuk u bë për shkak të propozimit të Pëjgamberit alejhi selam, por ata u larguan për shkak se ata i kaploi frika. Madje kur ata u larguan nga Haiberi nuk e lajmëruan Pejgamberin alejhi selam, por Pejgamberi alejhi selam me mëshirën dhe bujarinë e tij i bëri ata pjesëtarë në plaçkën e luftës. Por Gatfanët më dyfytyrësinë e tyrë nuk e pranuan pjesën që ju dha Pejgamberi alejhi selam ndaj ata thanë: "Atëherë, (O Muhammed), ne do të luftojmë me ju!" I Dërguari i Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të) tha: "Le të jetë Xhenefa vendi ku do të luftojmë."

Xhenefa ishte një zonë që ndodhej në tokat e Gatfanëve. Ndaj ata dikuë ditur që do të humbisnin në luftë kundër Pëjgamberit alejhi selam u tërhoqën nga frika. Sepse e dinin që nëse do të humbnin në luftë edhe pasuria e tyre do të kalonte në duart e Të Dërguarit të Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të) . Pas çlirimit të Haiberit I Dërguari i Allahut dhe sahabët e tij të nderuar ishin shumë të lodhur. Nga njëra anë, plagët e të plagosurve po trajtoheshin me mjekim, ndërsa nga ana tjetër, po pushonin. Në këtë kohë, Zejnepja, gruaja e Sellam bin Mishkem, një nga hebrenjtë e njohur, planifikoi të helmonte të Dërguarin e Allahut. Ajo përgatiti një dele dhe e mbushi mishin e saj me një sasi të madhe helmi. Pastaj, e solli atë si dhuratë për të Dërguarin e Allahut. I Dërguari i Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të) e pranoi dhe thirri sahabët e tij për të ngrënë së bashku. Ai vetë mori një copë nga mishi pjekur dhe duke thënë: **"Bismil-lahirrahmanirrahim"**, e vendosi në gojën e tij të bekuar. Pasi e përtypi disa herë, e nxori menjëherë nga goja dhe tha: **"O sahabët e mi! Hiqni dorë nga ky ushqim, sepse kjo copë mishi më lajmëroi se ishte e helmuar."** Sahabët menjëherë e ndaluan ngrënien e mishit. Mirëpo një prej sahbëvë i cili quhej Bishr bin Beraa radijallahu anhu kishte ngrënë nga mishi i helmuar. Bishri radijallahu anhu u helmua dhe trupi i tij mori ngjyrë të purpurt. Helmi u bë shkak për rënien ë tij shehid (dëshmor). Xhibrili (a.s.) erdhi dhe e urdhëroi Profetin alejhi selam që të bënte hixhama (largim i gjakut) për të pastruar helmin nga trupi i tij. Pas këtij lajmërimi të gjithë ata që kishin ngrënë nga mishi bënë hixhama ndërsa mishi i helmuar u gropos në tokë.

Sahabët shkuan të gruaja që kishte helmuar mishin, e kapën atë, Zejnebin, dhe e sollën para Profetit alejhi selam. I Cili e pyeti: **"A e helmove këtë mish?"** Ajo e pranoi dhe tha: **"Po, unë e helomova!"** Profeti alejhi selam përsëri e pyeti: **"Përse e bëre këtë?"** Ajo u përgjigj: **"Ti më vrave burrin, babain dhe xhaxhain. Mendova me vete: 'Nëse ai është me të vërtetë Profet, Allahu do ta mbrojë. Por nëse nuk është, helmi do ta vrasë dhe ne do të shpëtojmë prej tij.'"** Sahabët që ishin aty pranë kur e dëgjuan dëshminë e saj u prekën shumë nga kjo ngjarje dhe thanë: **"Jeta jonë qoftë flijuar për ty, o i Dërguari i Allahut! A ta vrasim atë?"** Mirëpo, Profeti

[270] İbni Hishâm, Sîret, II, 336; Vâkıdî, Megâdhî, II, 672.

alejhi selam, i cili falte çdo padrejtësi ndaj vetes së tij, e fali edhe këtë grua. Duke parë këtë mëshirë të madhe qe Profeti alejhi selam tregoi ndaj saj, ajo, pra Zejnebi, tha **"La ilahe il-lallah, Muhammedun Resulullah"** dhe u bë myslimane.[271]

Martesa me Hz. Safijen

Ndër robërit dhe plaçkën e luftës që u mor në Haiber ishte edhe Safije, vajza e Hujei bin Ahtab. Ku u nda plaçka e luftës Safija i ra për pjesë Profetit alejhi selam. Mirëpo Profeti alejhi selam e liroi dhe e la të lirë atë. Safija duke ditur se të rënët në skllavëri për të fituar lirinë duhej të paguaj liria ose do të mbetej skllav në shërbimin e pronarit të saj. Mirëpë kur pa që Profeti alejhi selam e liroi atë pa asnje lloj pagese dhe kushti ajo u habit. Safija e habitur dhe e prekur shumë nga ky xhest i Pejgamberit alejhi selam pranoi Islamin dhe shqiptoi shehadetin. Pasi ajo u bë myslimanë shprehu dëshirën të martohej me Profetin alejhi selam. Profeti alejhi selam, duke e nderuar atë si nënën e besimtarëve, u martua me Safijen, Ndërsa dasma e tyre u mbajt në Sehbâ, ku u shtrua një gosti për martesën e tyre.

Safija në njërin sy kishte një shenjë mori. Profeti alejhi selam e pyeti se çishte ajo shenjë Safija i tha**: "Një natë pashë në ëndërr hënën duke zbritur nga qielli dhe duke hyrë në prehrin tim. Kur ia tregova këtë ëndërr burrit tim, Kenane, ai duke më thënë: 'Ti ke dëshiruar të bëhesh gruaja e mbretit arab që po na sulmon!' dhe më goditi në sy. Goditja e tij më la këtë shenjë që ti po shikon në sy. "**[272]

Marrëveshja me Hebrenjtë

Pas pushtimit të Haiberit, hebrenjtë iu drejtuan të Dërguarit të Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të) dhe i thanë: **"O Muhamed! Ne do të largohemi nga Haiberi. Mirëpo ti e di mirë që ne e njohim mirë bujqësinë, kultivimin e tokave, vreshtave dhe kopshteve. Nëse dëshiron, që ti punojmë këto toka të begata. Ne do t'i punojmë ato dhe gjysmën e prodhimit do ta dorëzojmë ty!"** I Dërguari i Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të), dhe sahabët e tij (Allahu qoftë i kënaqur me to), nuk kishin kohë për t'u marrë me punët e bujqësisë. Pasi ata ishin të përkushtuar për përhapjen e fesë Islame dhe vazhdonin pa pushim përpjekjet e tyre në **"Xhihad fi sebilillah"** (luftë në rrugën e Allahut). Profetit alejhi selam i pëlqeu ky propozim i hebrënjëve ndaj ai dhe ju tha: **"Me kusht që t'ju largojmë kur ta shohim ne të arsyeshme."** Hebrenjtë e pranuan këtë kusht dhe mbetën në tokat e Haiberit.[273]

Kthimi në Medinë

Pas këtij triumfi të madh, Profeti aelhi selam dhe sahabët u kthyen në Medinë. Në të njëjtën kohë, myslimanët e fundit që ishin në Habeshistan, nën drejtimin e Xhafer bin Ebu Talibit, arritën në Medinë.[274] Profeti e priti me gëzim të madh ardhjen e tyre dhe tha: **"Nuk e di a të gëzohem më shumë për çlirimin e Haiberit apo për ardhjen e Xhaferit."**

Ky gëzim i pejgamberit alejhiselam vinte për shkak se me çlirimin e Haiberit, të gjithë hebrenjtë e Arabisë ranë nën autoritetin e Profetit alejhi selam dhe ata

[271] İbni Hishâm, Sîret, II, 337; Vâkıdî, Megâdhî, II, 678; İbni Sa'd, Tabakât, II, 202; Taberî, Târih, II, 303; Suheylî, Ravdu'l-unf, IV, 81; İbni Kesîr, Sire, III, 398; Gadhâlî, İhyâ, II, 891; DHehebî, Siyer, II, 86.
[272] Buhârî, Salât, 12; Cihâd, 74; Ebû Dâvûd, Harâc, 21; Ahmed bin Hanbel, Musned, III, 101; İbni Hishâm, Sîret, II, 330; Vâkıdî, Megâdhî, II, 669; İbni Sa'd, Tabakât, VIII, İbni Kesîr, Sire, IV, 645
[273] Ahmed bin Hanbel, Musned, II, 157; İbni Hishâm, Sîret, II, 641; Heysemî, Mecma'udh-dhevâid, I, 20
[274] İbni Sa'd, Tabakât, I, 353; DHehebî; Siyer, II, 82.

nuk kishin më mundësi të ndihmonin idhujtarët kundër Pejgamberit alejhi selam. Ky sukses i tregoi të gjitha fiseve dhe shteteve përreth fuqinë e madhe të myslimanëve. Njëkohësisht çlirimi i Haiberit tronditi idhujtarët e Mekkës sepse për shkak të çlirimit të Heiberit shumë fise të tjera filluan të pranonin Islamin. Ndërsa fiset që nuk i bindeshin dhe thurnin sulme dhe kurthe ndaj myslimanëve iu nënshtruan forcës së myslimanëve.

"Portën e kështjellës së Hajberit nuk e ngrita me forcë trupore, por me një fuqi shpirtërore."
Aliu r.a.

Ndodhia në Leile-i Taris

Kur po ktheheshin nga lufta e Hajberit, ndaluan për të pushuar në vendin e quajtur Ta'ris. Atë natë, i Dërguari i Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qofte mbi të) thirri Bilalin dhe i tha: **"O Bilal! Këtë natë mos fli! Vështro mëngjesin dhe na zgjo për namaz e sabahut."** Pastaj, i Dërguari i Allahut dhe sahabët ranë në gjumë. Bilali r.a. pasi fali disa rekate namaz u mbështet me shpinë mbi ngarkesën e tij dhe u kthye nga lindja e diellit për të pritur kohën e namazit. Mirëpo, nga lodhja e madhe, atë e kishte kapluar gjumi. Profeti alejhi selam dhe sahabët ishin aq të lodhur saqë nuk u zgjuan derisa dielli lëshoi rrezet e tij mbi tokë dhe ju kishte nxehur fytyrat atyre. I Dërguari i Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qofte mbi të) ishte i pari ai që u zgjua. Më pas, të gjithë u ngritën, morën abdest, ndërsa Bilali thirri ikametin. Kështu ata e falan kaza namazin e sabahut me xhemat. Pasi përfunduan namazin, i Dërguari i Allahut tha: "**Nëse dikush harron namazin, le ta falë sapo ta kujtojë. Sepse Allahu i Lartësuar ka thënë: 'Ekimi's-salâte li dhikri' (Fale namazin për të më përkujtuar Mua dhe për të madhëruar madhështinë Time).**"

Kthimi i diellit për Aliun r.a.

Teksa po ktheheshin nga Lufta e Hajberit, i Dërguari i Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qofte mbi të) po pushonte në vendin e quajtur Sahba. Ai kishte vënë kokën në prehrin e Aliut (radijallahu anhu) dhe në atë moment filloi të zbriste shpallja hyjnore (vahji). Dielli ishte ende në horizont, por Aliu r.a. ende nuk e kishte falur namazin e ikindisë. Kur shpallja përfundoi, dielli kishte perënduar. Atëherë, i Dërguari i Allahut bëri këtë lutje: **"O Zot! Nëse Aliu është në anën Tënde dhe të të Dërguarit Tënd, atëherë ktheje diellin prapa."**Dielli u kthye pas, ndriçoi përsëri tokën, dhe Aliu e fali namazin. Pas kësaj, dielli u zhyt përsëri në perëndim. Esma binti Umejs tregon:"Pashë me sytë e mi se dielli, ndonëse kishte perënduar, u kthye pas dhe ndriçoi përsëri tokën."

Lufta e Vadi'l-Kura-së

Kjo betejë ndodhi në muajin Xhemazi'el Ahir, në vendin e quajtur Vadi'l-Kura. Kur banorët hebrenj të atij vendi dëgjuan se i Dërguari i Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qofte mbi të) po vinte me ushtrinë islame, ata morën ndihmë nga disa arabë idhujtarë dhe u përgatitën për luftë. Dolën nga vendbanimet e tyre dhe zunë pozicione luftarake. I Dërguari i Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qofte mbi të) rreshtoi ushtrinë dhe ia dha flamurin njërit prej sahabëve. Pastaj ju tha kundërshtarëve dhe i tha:"**Nëse e pranoni Islamin, shpëtoni jetët dhe pasurinë tuaj."**Por ata refuzuan.

Një nga idhujtarët doli në dyluftim dhe u vra nga Zubejr bin Avami (radijallahu anhu). Një tjetër doli kundër Aliut r.a., por ai e dërgoi atë menjëherë në zjarrin e Xhehenemit. Edhe një tjetër luftëtar e sfidoi, por Aliu r.a. e vrau edhe atë. Dy hebrenj të tjerë u vranë nga Ebu Duxhane (radijallahu anhu). Gjatë asaj dite, pesëmbëdhjetë

jobesimtarë u vranë. Kur erdhi mbrëmja, secili u kthye në vendin e vet. Në mëngjes, të dyja palët sërish nxorën shpatat dhe u përgatitën për luftë. Kur dielli u ngrit sa një shtizë mbi horizont, frika i pushtoi jobesimtarët ndaj ata u larguan me vrap nga fushëbeteja.

Në këtë betëje muxhahidët (luftëtarët muslimanë) morën shumë begati dhe plaçkë lufte. Ndërsa hebrenjtë e Teimës, duke parë këtë fund të hebrenjve të Vadi'l-Kura-së, u frikësuan dhe për të ruajtur pronat e tyre, ata pranuan të paguajnë xhizjen (taksa për jomyslimanët) dhe u arrit një marrëveshje paqeje.

UDHËTIMI I UMRETUL-KADA

"Lebbejk! Allahumme Lebbejk! Lebbejk! La sherike leke Lebbejk! Innel hamde ven-ni'mete leke vel-mulke, la sherike lek!"
Telbiye

Një vit kishte kaluar nga marrëveshja e Hudejbijes. Një kohësisht kishte edhe nje që të vinte festa e Kurban Bajramit. Pra ishte në fillim të muajit Dhul-Kade, kur i Dërguari i Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qofte mbi të) urdhëroi sahabët e tij të përgatiteshin për umre. Në udhëtimin e umras do të merrnin pjesë vetëm ata që kishin marrë pjesë në betimin e Ridhvanit në Hudejbije. Me këtë urdhër, dy mijë sahabë nisën të përgatiten. U morën shtatëdhjetë deve për tu therur si kurban dhe u ngarkua Naxhije bin Xhundub r.a. me katër burra të tjerë për ti çuar devetë deri në Mekke. Përveç kësaj, një grup prej njëqind kalorësish, nën komandën e Muhamed bin Mesleme r.a., u dërgua përpara që në rast se idhujtarët do të sulmonin Mesleme me ushtrinë e tij ti pengonte.

Gjatë kohës kur po bëheshin përgatitjet disa nga sahabë i thanë të Dërguarit të Allahut (paqja she mëshira e Allahut qofte mbi të):"O i Dërguari i Allahut! Sipas marrëveshjes së Hudejbijes, nuk duhet të marrim me vete asnjë armë përveç shpatave të futura në mill."I Dërguari i Allahut (paqja she mëshira e Allahut qofte mbi të) ju përgjigj:"**Ne nuk do ti çojmë këto armë në Harem dhe nuk do ti marrim përpara kurejshëve. Ato do ti mbajmë pranë, vetëm në rast se ata na sulmojnë do ti nxjerrim nga brezi për vetëmbrojtje.**" Me pas para se te dilnin nga Medina Profeti alejhi selam la si përfaqësues në Medinë Ebu Dherr Gifarin, ndërsa sipas disa transmetimeve, edhe Ebu Ruhm Gifari.[275]

Dy mijë sahabë, së bashku me të Dërguarin e Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qofte mbi të), u nisën drejt Mekës. Sahabët ishin të mbushur me emocion, sepse pas shumë vitesh do të shihnin vendlindjen e tyre, të cilën e kishin braktisur për hir të Allahut dhe të Dërguarit të Tij (paqja dhe mëshira e Allahut qofte mbi të). Do të vizitonin Qaben e Shenjtë, drejt së cilës ktheheshin pesë herë në ditë gjatë namazit. Ndërsa ata që ende nuk kishin mundur të shkonin në Medinë për shkak të marrëveshjes, do të takoheshin me familjarët e tyre. Dhe, më e rëndësishmja ishte se ata do tu tregonin idhujtarëve kurejshitë, të cilët i kishin shtypur për vite me radhë, dinjitetin dhe madhështinë e Islamit. Ndoshta kjo do të prekte zemrat e tyre dhe do ti çonte idhujtarët drejt pranimit të Islamit. Ndërsa ata që mbetën në Medinë, përcollën të Dërguarin e Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qofte mbi të) me tekbire deri në luginën e Vedasë dhe më pas u kthyen. Kur i Dërguari i Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qofte mbi të) arriti në Dhul-Hulejfe, rreth dhjetë kilometra larg Medinës, ai veshi ihramin dhe sahabët e tij ndoqën shembullin e tij.

[275] İbni Hishâm, Sîret, I, 434; II, 289; Vâkıdî, Megâdhî, I, 8; İbni Sa'd, Tabakât, II, 59; Kettânî, Terâtîb-ul-idâriyye, I, 484-486.

Lufta e Vadi'l-Kura-së



Të gjithë ishin të veshur me të bardha dhe nisën udhëtimin e tyre për në Mekkës duke thirrur të gjithë njëzëri:"**Lebbejk! Allahumme Lebbejk! Lebbejk! La sherike leke Lebbejk! Innel hamde ven-ni'mete leke vel-mulke, la sherike lek!"**(Ja ku jam, o Allah! Ja ku jam! Ti nuk ke shok, ja ku jam! Me të vërtetë, lavdërimi, begatia dhe sundimi janë të Tuat! Ti nuk ke shok!).

Thirrjet "**Lebbeyk! Allahumme Lebbeyk!**" kumbonin qiell e tokë. Udhëtimi ishte i mbushur me lavdërime dhe përmendje të Allahut të Lartësuar. Ndërsa njësia e udhëhequr nga Muhamed bin Mesleme po i afrohej Mekkës, rojtarët Kurejshit sapo i panë ju afruan dhe të shqetësuar pyetën Meslemen: "Çfarë është kjo vizitë e papritur?"Mirëpo kur Muhamed bin Mesleme ju përgjigj me fjalë që ua ngrinë gjakun se:"Këta janë kalorësit e të Dërguarit të Allahut... Me lejen e Allahut, nesër ata do të nderojnë këtë vend me praninë e tyre!" Kurejshët i kaploi frika dhe u kthyen me të katërtat për në Mekkë dhe i lajmëruan mekkasit për situatën që kishin mësuar. Paria kurejshite e tronditur doli dhe ju tha mekkasve se:"Për Allah, ne i kemi qëndruar besnikë marrëveshjes. Ndaj Muhammedi (alejhi selam)nuk përse të na luftojë!"Më pas ata menjëherë organizuan dhe dërguan një delegacion për të biseduar me Profetin Muhamed (s.a.s.), i cili tashmë kishte arritur në Batni Jexhexh.

Nga ana tjetër Prpfeti Muhammed (paqja dhe mëshira e Allahut qofte mbi të) urdhëroi që të gjitha armët, përveç shpatave të futura në mill, të liheshin aty dhe caktoi dyqind sahabë si rojtarë. Atë kohë përfaqësuesit kurejshitë erdhën për të biseduar me të ku i thanë:"O Muhamed! Ne nuk kemi shkelur asnjë marrëveshje. A mos vallë do të hysh në Mekkë me armë? Sepse sipas paktit, ju lejohej vetëm shpatat në mill!"Profeti Muhamed (s.a.s.) u përgjigj:"**Unë gjithmonë kam qenë besnik ndaj fjalës sime. Nuk do të hyjmë në Harem me asgjë tjetër veç shpatave tona të futura në mill. Por dijeni se armët duhet të qëndrojnë pranë nesh."**Delegacioni kurejshit u qetësua nga kjo përgjigje e Profetit alejhi selam sepse ata tashmë kishin kuptuar se lajmi që kishin marrë ishte i shtrembëruar. Ndaj kurejshët u qetësuan dhe u kthyen për të informuar bashkëqytetarët e tyre në Mekka. Kur e dëgjuan realitetin mekkasit u qetësuan, ndërsa ata që ishin të mbushur me urrejtje dhe zili ndaj Pejgamberit dhe sahabëve, u larguan nga qyteti për të mos parë këtë çast triumfi të myslimanëve.

Profeti Muhamed (s.a.s.) vazhdonte me qetësi programin e tij për kryerjen e umras ndaj ai i dërgoi devetë e shënuara për kurban në Tuvâ. Pastaj, së bashku me sahabët e tij, u përgatit për të hyrë në Mekkë. Pamja ishte madhështore. Profeti Muhamed (s.a.s.), i rrethuar nga sahabët, po udhëtonte mbi devenë e tij Kusvâ. Ai dukej sikur dielli që e mbulon shkëlqimin e yjeve. Zërat e telbijes kumbonin gjithandej: **"Lebbeyk! Allahumme Lebbeyk! Lebbeyk! Lâ sherîke leke Lebbeyk!"**

Së bashku me çdo hap që hidhej drejt Qabes, shtoheshin edhe emocionet. Pamja e këtij konvoji hyjnor ndikoi edhe në zemrat e kurejshëve mosbesues, ku disa prej të cilëve filluan të ndienin dashurinë për Islamin. Dhe më në fund, i Dërguari i Allahut (s.a.s.), triumfoi...

O ju, mohues, largohuni nga rruga e Pejgamberit,
Sepse Allahu i Lartësuar i zbriti atij Kuranin.

Çdo e mirë dhe çdo begati gjendet në fenë e tij,
Dhe vdekja më fisnike është vdekja për këtë fe.

Ai është vërtet i Dërguari i Allahut, e pranoj me zemër,
Çdo fjalë të tij e besova, tani e pranoj plotësisht.

O ju, mohues! Kur Kurani zbriti nga Allahu, ju mohuat.
Ashtu siç e zbritëm atë, do të zbresin mbi ju goditjet në çast,

Dhe siç ndamë kokat nga trupat,
Ashtu do t'ju ndodhë dhe juve.

Nëse nuk i besoni kuptimit të tij,
Atëherë mbi ju do të zbresin të njëjtat goditje.

E filloj me emrin e bekuar të Allahut,
Sepse nuk ka fe të vërtetë veç fesë së Tij.

Dhe përsëri e filloj me emrin e Allahut,
Muhamedi është robi dhe i Dërguari i Tij.

"Betohem në Allahun e Madhëruar se fjalët e tij (Ibni Revahasë) kanë më shumë dhe ndikojnë më shpejt te këta politeistë të Kurejshëve sesa një shi shigjetash."
Hadith

Ja, i dashuri ynë Pejgamberi alejhi selam dhe sahabët (radijallahu anhum) e tij të lavdishëm po hynin në Qaben e madhërishme, me shpatat e tyre në brez. Litarin e devesë së Profetit, Kusvâ, e mbante Abdullah bin Revaha, duke e udhëhequr përpara. Disa prej idhujtarëve mekkanë, së bashku me gratë dhe fëmijët e tyre, ishin rreshtuar në Dâr-un-Nedve dhe po shikonin të dashurin e Allahut dhe sahabët e tij trima. Ndërsa Abdullah bin Revaha ecte përpara, ai recitonte vargje, të cilat u binin idhujtarëve si një çekiç i rëndë mbi kokë dhe depërtonin deri në thellësinë e zemrave të tyre. Ndërsa Omeri, i shqetësuar nga poezite e Revhasë, nuk mundi të përmbahej dhe i tha: "O Ibn Revaha! Si mund të recitosh poezi përpara të Dërguarit të Allahut dhe brenda Harem-it të shenjtë?" Mirëpo, Pejgamberi ynë i dashur e ndaloi duke i thënë: **"O Omer! Mos e pengo atë. Betohem në Allahun, fjalët e tij janë më ndikuese dhe më të shpejta në zemrat e këtyre Kurejshëve sesa shigjetat që mund tu hidhnim! Ndaj o Ibn Revaha, vazhdo!"** Më pas Pejgamberi a.s. i tha Abdullah bin Revahas që të thoshte se: **"Nuk ka zot tjetër përveç Allahut! Ai është Një! Ai e përmbush premtimin e Tij! Ai i ndihmon robërit e Tij! Ai u jep forcë ushtrisë së Tij! Ai i mposht të gjithë fiset që bashkohen kundër Tij!"** Abdullah bin Revaha përsëriti me zë të lartë:

"Nuk ka zot tjetër përveç Allahut!
Ska shok për Të, la ilahe il-lallah!
Ai u jep forcë muslimanëve!
Dhe Ai i shpërndan e i mposht mohuesit!"

Me pas të gjithë muslimanët filluan ta përsërisnin këtë thirrje. Pejgamber alejhi selam hyri në Qabe, dhe duke hapur supin e tij të djatht ku i dukej trupi i bekuar, tha: **"Sot, Allahu i Lartësuar e mëshiroftë dhe e faltë këtë grup të fortë burrash që po u tregojnë idhujtarëve fuqinë dhe shëndetin e tyre!"** Menjëherë, sahabët hapën supet e tyre të djathta dhe, me një ecje madhështore, filluan të bëjnë tavafin rreth Qabesë tre herë duke ecur shpejt. Vetëm në hapësirën mes **Rukn-i Jemani** dhe **Haxher-ul-Esved**, ecën ngadalë.

"Sot, Allahu i Madhëruar, me mëshirën dhe faljen e Tij, i mëshiroftë trimat që do t'u shfaqen të fortë dhe të fuqishëm këtyre idhujtarëve!"
Hadith

Pejgamberi dhe sahabët e tij iu afruan Haxher-ul-Esved, e puthën ose shtrinë duart drejt tij. Idhujtarët po i shikonin nga larg dhe habiteshin nga fuqia e tyre. Ata kishin dëgjuar lajme të rreme se muslimanët ishin dobësuar në Medinë, por tani po e shihnin të kundërtën. Katër xhirot e mbetura të tavafit u kryen me hapa të ngadaltë. Pas tavafit, ata falën dy rekate namaz te Makam-i Ibrahimi, pastaj bënë shtatë xhiro saj mes kodrave Safa dhe Merve. Dhe pas therjes së kurbaneve, Pejgamberi ynë i dashur rruajti kokën. Sahabët i kapën me dëshirë fijet e flokëve të tij të bekuar. Pastaj edhe ata i rruan kokat e tyre. Kështu, u realizua ëndrra që i Dërguari i Allahut kishte parë një vit më parë: pra vizita e umres u përmbush.

Tashmë hyri koha e drekës, Pejgamberi i urdhëroi Bilal Habeshiun të thërriste ezanin në Qabe. Teksa ai shqiptonte fjalët e thirrjes së shenjtë, e gjithë Mekka ushtonte. Sahabët e dëgjonin me përulësi dhe e përsëritnin ezanin me zë të ulët. Pas ezanit, Pejgamberi alejhi selam udhëhoqi faljen e namazit të drekës, dhe kjo la një ndikim të thellë në zemrat e idhujtarëve. Një çadër prej lëkure u ngrit për të Dërguarin e Allahut në Ebtah, dhe sahabët qëndruan rreth tij në çadrat e tyre për tre ditë. Ata faleshin në Qabe, takonin të afërmit dhe me moralin e tyre të lartë u jepnin shembull idhujtarëve. Këta të fundit, duke parë sjelljen e tyre të bukur, nuk mund ta fshihnin habinë dhe admirimin e tyre. Në këto tre ditë, Mekka u pushtua shpirtërisht nga Islami. Dhe kur kaluan tre ditët, Pejgamberi urdhëroi: "**Asnjë musliman që ka ardhur për umre nuk do ta kalojë natën në Mekke. Pra të gjithë do të nisen për ne Medina!**" Me këtë urdhër, muslimanët u përgatitën dhe u nisën për në Medinë. Kur arritën në vendin e quajtur Xhuhfe, i Dërguari i Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të) u takua me xhaxhain e tij, Abbasin, i cili i tha: "O i Dërguar i Allahut! Mejmunë bint Harisi është e ve. A nuk do ta merrje për grua?" Pejgamberi dërgoi Ebu Rafiun dhe një burrë nga Ensarët në Mekke për ti kërkuar dorën asaj. Kur Mejmuneja, mori lajmin ndodhej mbi deve, tha: "Edhe deveja dhe gjithçka mbi të i përket të Dërguarit të Allahut!" Ajo ia la këtë çështje motrës së saj, Ummu'l-Fadl dhe burrit të saj Abbasit.

Gjatë kthimit për në Medinë, në vendin Sherif, Abbas r.a. i dha Pejgamberit katërqind dirhem si mehër dhe e martoi me kunatën e tij, pra Mejmunen. Dasma u bë aty, dhe ajo u bë gruaja e fundit e të Dërguarit të Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të). Pra pas Mejmunes Pejgamberi alejhi selam nuk u martua më.

Nga Shami guxova të sjell këtë dhuratë, o i Dërguar i Allahut!
Dëshira ime është t'i shërbej të Lartësuarit, o i Dërguar i Allahut!

E pavlerë është kjo dhuratë e imja për Ravdën e bekuar,
Por pranoje, më dhuro mirësinë dhe ndihmën tënde, o i Dërguar i Allahut!

Kë kam unë tjetër veç teje? Kujt t'ia shpreh hallin tim?
Nga madhështia jote vjen mirësia dhe bujaria, o i Dërguar i Allahut!

Të kërkoj mbrojtje, siguri, po bie në pragun tënd,
Mëshiroje këtë rob, ndërmjetëso për mua, o i Dërguar i Allahut!

Në të dyja botët më mbaj pranë, o Mahmud i drejtë,
Sepse lavdia, në fillim e në fund, të përket ty, o i Dërguar i Allahut!

II. Mahmud Han

Halid bin Velidi Pranoi Islamin

I Dërguari i Allahut, (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të), kur shkoi në Mekke për umre, e pyeti shokun e tij, Velid bin Velid: **"Ku është Halidi? Një person si ai nuk mund të mos e njohë Islamin. Sikur të përdorte gjithë guximin dhe trimërinë e tij në anën e myslimanëve kundër idhujtarëve, sa e dobishme do të ishte! Ne do ta donim dhe do ta nderonim atë."** Velid bin Velidi, i cili më parë i kishte shkruar shpesh letra të vëllait të tij, duke e ftuar të bëhej mysliman, ia përcolli këto fjalë të bekuara të Profetit alejhi selam, gjë që e bëri Halidin edhe më të prirur drejt Islamit.

Pas kthimit të sahabëve nga umreja, kishin kaluar disa ditë dhe tashmë kishte hyrë viti i tetë i hixhretit. Halid bin Velidi nuk mund të qetësohej më. Ai digjej nga dëshira për të shkuar në Medinë dhe për ti besuar të Dërguarit të Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të), pra te bëhej mysliman. Ai vetë e ka tranmsetuar se: ''A**llahu më dhuroi dashurinë për Profetin a.s. dhe vendosi në zemrën time dashurinë për Islamin. Ai më bëri të dalloj të mirën nga e keqja. Më pas mendova kështu me veten time: 'Kam marrë pjesë në të gjitha luftërat kundër Muhamedit** (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të)**, por çdo herë që largohesha nga fusha e betejës, e ndjeja se isha në rrugë të gabuar. Dija se ai një ditë do të fitonte mbi ne.''** Dhe kur Profeti alejhi selam erdhi në Hudajbije, unë isha komandant i kalorësisë së mushrikëve. Dhe kur e pashë atë duke falur namazin e drekës me shokët e tij, të cilët ishin të pa mbrojtur, mendova ti sulmoja befas, por nuk ishte e mundur sepse shikoja që ata ishin të mbrojtur prej nje ushtrie të padukur. Kjo ishte ajo që më bëri të mendoj më shumë duke thëne me vete se: **"Nuk asnjë dyshim se ky njeri duhet të jetë i mbrojtur vetëm se nga Allahu. Ndryshe ne me gjithë mundësitë tona do ta kishim poshtur atë."** Më vonë, kur ai (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) erdhi në Mekë për umre, unë nuk dola para tij. Vëllai im, Velidi, erdhi bashkë me Profetin a.s. dhe më kishin kërkuar, por nuk më kishin gjetur. Në ikje më kishin lënë një letër në të cilën shkruahej: ***"Me emrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit! Pas falënderimeve për Allahun dhe përshëndetjeve për Profetin alejhi selam, po të them se: Nuk di asgjë më të çuditshme sesa largimi yt nga Islami! Ti nuk je i paaftë për të kuptuar që je në rrugë të gabuar. Si ka mundësi që nuk e pranon të vërtetën? Profeti alejhi selam më pyeti për ty dhe dëshiron që ti ta përdorësh forcën dhe guximin tënd për myslimanët, kundër idhujtarëve. O vëlla, ke humbur shumë mundësi. Tashmë është koha që të mos e humbasësh edhe këtë mundësi!"***

Kur e lexova këtë letër, dëshira për t'u bërë mysliman mu shtua shumë aq shumë sa nga fjalët e Profetit më lumturonin. Atë natë pashë në ëndërr sikur po dilja nga një vend i ngushtë, i thatë dhe shkretëtiror, në një vend të gjelbër dhe të hapur. Kur të arrija në Medinë, do t'ia tregoja këtë ëndërr Ebu Bekrit r.a. dhe do ta pyesja për domethënien e saj. Ndërkohë, po mendoja se kush mund të më bashkohej në rrugëtimin për në Medinë. I pari që i propozova ishte Safvan bin Umeje, por ai refuzoi. Më pas, iu drejtova Ikrime bin Ebu Xhehlit, por edhe ai nuk pranoi. Më në fund, hipa në kafshën time dhe shkova tek Osman bin Talha dhe i thashë se do të shkoja te i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) për t'u bërë mysliman dhe e ftova të më bashkohej. Ai e pranoi menjëherë, pa asnjë hezitim, propozimin tim dhe u nisëm së bashku në agimin e ditës së nesërme. Kur arritëm në vendin e quajtur Hîre, u takuam me Amr bin Asin. Ai na pyeti se ku po shkonim?

"Islami i fshin të gjitha mëkatet e së kaluarës."
Hadith

Kur i treguam qëllimin tonë, ai na tha se vinte nga toka e Habehasë dhe se ishte bërë mysliman te mbreti Nexhashi Eshame dhe tani po shkonte në Medinë për t'i dhënë besën të Dërguarit të Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të). Kështu që të tre së bashku arritëm në Medinë. Kur arritëm në Medine Profeti alejhi selam mori lajmin për mbërritjen tonë, tha: **"Mekka ka dërguar më të mirët e saj në anën tonë."**

Tashmë kishim mbërritur në Medine dhe sapo mbërritëm unë, hoqa rrobat e udhëtimit dhe vesha rrobat më të mira për t'u përgatitur për takimin me të Dërguarin e Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të). Në atë moment, vëllai im Velidi më erdhi dhe më tha: **"Shpejto! Sepse Profeti a.s. ka marrë lajmin për ardhjen tuaj dhe është gëzuar shumë. Ai po ju pret!"** Me nxitim shkova në prani të Profetit alejhi selam. Ai kur më pa buzgjeshi prej gezimit. I dhashë selam dhe thashë: **"Dëshmoj se nuk ka zot tjetër përveç Allahut dhe se ti je i Dërguari i Tij."** Ndërsa Profeti a.s. mu përgjigj kështu: **"Falënderimi i qoftë Allahut, që të udhëzoi dhe të tregoi rrugën e drejtë."** Më pas i kërkova të lutej për faljen e mëkateve të mia. Ai u lut për mua dhe tha: **"Islami i fshin të gjitha mëkatet e së kaluarës."** Edhe dy shokët e mi pranuan Islamin dhe u bënë myslimanë.[276]

Kështu pra, tre trimat më të famshëm të Mekkës, burra të patrembur që nuk ngurronin të jepnin jetën për kauzën e tyre, u bënë me zemër e me shpirt pjesë e besimtarëve të devotshëm. Sahabët u gëzuan pa masë për pranimin e tyre në Islam dhe brohoritën me tekbire: **"Allahu Ekber!"**

Muhamedi (a.s.) është zëri i së Vërtetës.
Ai është zotëria i të dyja botëve.
Arabët dhe Persët janë shërbëtorët e tij.
Koha s'ka parë një trëndafil si Ai.
Përkulu edhe ti para atij të Bukuri.
Imami Busajri

BETEJA E MUTEAS

Në vitin e tetë të hixhretit, i Dërguari i Allahut, (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të), dërgoi përsëri lajmëtarë në fise dhe shtete të ndryshme për të përhapur Islamin. Disa prej tyre patën rezultate pozitive, por Haris bin Umejri, i cili ishte dërguar te guvernatori i Busrasë, u arrestua nga ushtarët e krishterë në fshatin Mute të krahinës Belka në Sham (Siri). Ai u dërgua te guvernatori i Shamit, Sherahbil bin Amri, dhe megjithëse ishte lajmëtar, u vra mizorisht dhe ra dëshmor. [277]

Lajmi e trishtoi shumë Profetin a.s., i cili menjëherë urdhëroi mbledhjen e sahabëve të tij trima. Sahabët, pasi u përshëndetën me familjet e tyre, u mblodhën menjëherë në kampin ushtarak në Jurf.

Pas namazit të drekës, i Dërguari i Allahut tha: **"Si komandant të ushtrisë caktuam Zejd bin Harithin! Nëse Zejdi bie dëshmor, komandën le ta marrë Xhafer bin Ebi Talibi. Nëse Xhaferi bie dëshmor, atëherë komandën le ta marrë Abdullah bin Revaha. Nëse edhe ai bie dëshmor, atëherë myslimanët le të zgjedhin një komandant të përshtatshëm për veten e tyre."** Kur sahabët

[276] Beyhekî, Delâil-un-nubuvve, IV, 455; İbni Asâkir, Tarih-i Dımeshk, XVI, 228; DHe hebî, Siyer, II, 118.
[277] Vâkıdî, Megâdhî, II, 756; İbni Sa'd, Tabakât, II, 128; İbni Asâkir, Tarih-i Dımeshk, XI, 464.

dëgjuan këto fjalë, ata e kuptuan se këta burra të përmendur do të binin dëshmorë dhe nisën të qajnë. Ata thanë: **"O i Dërguari i Allahut! Sikur të jetonin më gjatë që të përfitonim më shumë prej tyre!"** Por Profeti heshti dhe nuk u përgjigj.[278]

Zejdi, Xhaferi dhe Abdullahu, të cilët ishin aty dhe dëgjuan këto fjalë, u mbushën me gëzim të madh, sepse dëshira e tyre më e madhe ishte të shpallnin fenë e Allahut dhe të binin dëshmorë për të. Ata e morën këtë lajm të mirë me gëzim të madh, pasi e dëgjuan me veshët e tyre nga vetë i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të). Pasi përgatitjet u përfunduan, ushtria priste komandantin e saj. Profeti alejhi selam ia dorëzoi flamurin e bardhë të Islamit Zejd bin Harithit dhe e urdhëroi që të shkonte deri në vendin ku ishte vrarë Haris bin Umejri dhe ti therrte ata në Islam. Nëse ata nuk do ta pranonin, atëherë do të luftonin kundër tyre. Ndërsa po përshëndeteshin me njëri-tjetrin para nisjes, Abdullah bin Revaha filloi të qante. Dikush e pyeti: **"O biri i Revahës! Përse po qan?"** Poeti Abdullah bin Revaha ju tha;.

Arsyeja pse po qaj nuk është dashuria për këtë botë,
Dhe për Allah, nuk është as malli për ju.

Arsyeja e vërtetë është kjo, që në Kur'anin e shenjtë,
Zoti ynë në një ajet ka thënë kështu:

Me siguri ta dini se askush prej jush
Nuk do të shpëtojë pa kaluar nga Xhehenemi...

E dëgjova këtë ajet nga i Dërguari i Allahut,
Dhe mendova: si do të duroj unë nëse kaloj në Xhehenem?!

Shokët e tij i thanë: **"Allahu të bashkoftë me robërit e Tij të dashur dhe të bëftë prej të drejtëve!"** dhe u lutën për të. Atëherë Abdullah bin Revaha tha: **"Por unë i lutem Allahut për falje, Dhe që të më japë një goditje shpate që të shpërthejë gjaku me vrull, ose një shtizë që më shpon deri në thellësi, dhe të bie dëshmor me shpirtin e dorëzuar!"**

Ndërkohë ushtria po përgatitej për nisje, Abdullah bin Revaha r.a. shkoi te Profeti për t'u përshëndetur dhe i tha: **"O i Dërguar i Allahut! Më këshillo diçka që ta mbaj mend dhe mos ta harroj kurrë!"**

I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) i tha: **"Nesër do të mbërrish në një vend ku pak njerëz bëjnë sexhde. Atje shtoje faljen e namazit dhe përmend Allahun!"** Abdullah bin Revaha tha: **"O i Dërguar i Allahut! Më jep edhe një këshillë tjetër!"** Profeti i tha: **"Përmende Allahun gjithmonë, Sepse përmendja e Allahut të ndihmon të arrish atë që dëshiron!"**

Ushtria islame prej tre mijë burrash filloi marshimin, duke brohoritur: **"Allahu Ekber! Allahu Ekber!"** Profeti alejhi selam dhe shokët e tij e përcollën ushtrinë deri në vëndin e quajtur Vedá. Aty Profeti u dha këshillën e fundit duke ju thënë: **"Ju këshilloj të ndiqni urdhrat e Allahut dhe të largoheni nga ndalesat e Tij. Tregohuni të sjellshëm me muslimanët që janë me ju. Luftoni në emër të Allahut dhe mos tradhtoni në plaçkë lufte! Mos vrisni fëmijë, mos shkatërroni**

[278] Buhariu, Megâdhi, 46; Vâkıdî, Megâdhî, II, 756-758; İbni Sa'd, Tabakât, II, 128-130.

"Zejd bin Harithin e kam caktuar komandant! Nëse ai bie dëshmor, le ta zëvendësojë Xhafer bin Ebi Talibi. Nëse edhe ai bie dëshmor, le ta zëvendësojë Abdullah bin Revaha. Nëse edhe ai bie dëshmor, atëherë zgjidhni një nga ju."
Hadith

shtëpitë, mos digjni pemët! Nëpër manastire do të gjeni njerëz që janë të përkushtuar në adhurim. Mos i prekni ata! Por do të gjeni edhe njerëz që janë robër të djallit. Prandaj, luftoni kundër tyre për hir të Allahut!" Me këto porosi të bekuara, ushtria islame u nis drejt frontit. Ndërsa banorët e Medinës i përcollën me lot në sy dhe me lutje për mbrojtjen e tyre... Kreu i ushtrisë, Zeid bin Hârithi i tha ushtrisë se Profeti alejhi selam e ka porositur se: **"Kur të takoni armiqtë, thirri ata në një nga këto tri mundësi:**

Nëse ata pranojnë Islamin, ftojini që të migrojnë në Medinë, dhe do të kenë të drejtat dhe përgjegjësitë e Muhaxhirëve.

Nëse ata pranojnë Islamin por duan të qëndrojnë në vendet e tyre,do të jenë si beduinët dhe do të jenë të nënshtruar ndaj të njëjtave ligje që janë për Arabët dhe tjerët pa pasur të drejtë të marrin ndonjë pjesë nga plaçkat e luftës.

Nëse ata nuk pranojnë Islamin, ftojini që të paguajnë xhizjen (taksa) dhe mos u shqetësoni për ata që e pranojnë këtë. Por Nnëse nuk pranojnë xhizjen, atëherë kërkoni ndihmën e Allahut dhe luftoni me ta!"

Pas këtyre këshillave, ushtarët u ndanë dhe udhëtimi i ushtrisë islame filloi me thirrje të tekbirit "**Allahu Akbar!**". Ata që mbetën, u lutën për ta dhe u përshëndetën me dorë, duke thënë: **"Allahut i lutëmi t'ju mbrojë nga çdo rrezik dhe t'ju kthejë përsëri të sigurt!"** Në udhëtim, Zeid bin Hârithi mbante flamurin dhe ushtria e Profeti alejhi selam po ecte shpejt drejt Sirisë. Ata ishin të entuziazmuar për të takuar armiqtë. Midis ushtarëve, Abdullah bin Revâha ishte një nga ata që dëshironte më shumë të bëhej dëshmor. Zeid bin Erkâm, që ishte një fëmijë jetim dhe ishte rritur nën kujdesin e Abdullah bin Revâha, e kujton se gjatë natës, Abdullah bin Revâha i thoshte vargje të tilla:

O deva ime! Nëse më çon në gropën e kuajve,
Dhe aty më shtrihesh, deri në katër stacione përpara,

Nuk do të të nxjerr më, deri në ndonjë herë tjetër,
Do të mbetesh pa zot, shpejt, kështu do të ndodhi.

Unë, sigurisht, nuk do të kthehem në shtëpinë time,
Shpresoj që në këtë luftë, për Allahun dhe do të bëhem dëshmor.

Në stacionin e fundit, besimtarët kaluan me shpejtësi,
O biri i Revâhas, edhe ata që ishin më të afërmit,

E lidhën marrëdhënien e vëllazërisë dhe më kaluan,
Më lanë dhe shkuan, duke më dorëzuar tek Allahu.

Tani nuk mendoj më për pasurinë që kam lënë,
Nuk më intereson as për pemët as për hurmat!

Kur i dëgjova këto fjalë, fillova të qaj. Abdullah bin Revâha më preku me kamçinë dhe më tha: "O i paditur! Çfarë po ndodh me ty? Çfarë dëmi ka kjo për ty? Nëse Allahu më jep dëshmorllëk, ti do të kthehesh në shtëpi, ndërsa unë do të shpëtoj

nga të gjitha vuajtjet, shqetësimet dhe ngjarjet e botës, dhe do të gëzoj paqe." Ai zbriti dhe fali dy rekat namaz. Pas një lutjeje të gjatë, më tha: "O fëmijë!" Kur iu përgjigja, ai vazhdoi: "Kjo herë, vullneti i Allahut, do të jetë që unë të bie dëshmorë!" Ndërkohë, ushtarët e heroikë të Pejgamberit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të), po i afroheshin Sirisë.

"Përmende gjithmonë Allahun e Madhëruar, sepse përmendja e Tij të ndihmon të arrish atë që shpreson."
Hadith

Udhëheqësi i Shamit Sherahbil bin Amr, kishte marrë lajmin për afrimin e ushtrisë islame. Ndaj ai menjëherë informoi perandorin bizantin Herakliusin dhe mori ndihmë të madhe për t'u siguruar. Sipas informacionit të tij, myslimanët ishin vetëm tre-pesë mijë vetë, ndërsa ushtria e tij kalonte njëqind mijë. Po ashtu, armët e tyre ishin të pakufishme. Dhe kur sahabët radijallahu anhuma arritën në Ma'an, ata morën lajmin se ushtria e krishterë kishte mbi njëqind mijë ushtarë dhe po iu afronte. Ata qëndruan atje dhe kaluan dy net. Komandanti Zeid bin Hârithi mblodhi ushtarët dhe u kërkoi mendimin e tyre se si të vepronin kundër ushtrisë romake. Disa prej shokëve thanë: "Përpara se të përballeshim me ushtrinë romake, le të organizojmë sulme të papritura në qytetet e tyre dhe t'i çojmë robër në Medinë." Disa të tjerë sugjeruan: "Të dërgojmë një letër Profetit a.s., dhe ta njoftojmë për numrin e ushtrisë dhe t'i kërkojmë ndihmë ose udhëzim se çfarë të bëjmë." Pas diskutimeve, ata vendosën të përqendroheshin te opinioni i dytë, kur Abdullah bin Revâha ndërhyri dhe tha:

O populli im, pse jeni kaq të pasigurt?
A nuk erdhëm ne këtu për të rënë dëshmorë?

Ne, për shkak të shumicës në armë dhe kalë,
Nuk luftuam asnjëherë me jobesimtarët.

Me fuqinë që na dha Allahu,
Luftuam si luanë për fenë tonë.

Shkoni dhe luftoni, padyshim ka mirësi,
Përfundimi do të jetë ose dëshmor ose fitore.

Në ditën e Bedrit, vallahi, kishim vetëm dy kuaj,
Në Uhud, kishim vetëm një kalë dhe armë të pakta.

Në këtë luftë, nëse fitorja është e shkruar,
Kjo është e premtuar nga Allahu dhe Profeti.

Allahu nuk e kthen kurrë premtimin e Tij,
O besimtarë, prandaj ecni përpara.

Nëse dëshmoria është e shkruar për ne,
Ne do të bashkohemi në Parajsë me vëllain tonë dëshmor.

Fjalët e Abdullah bin Revâha kishin inkurajuar sa që të gjithë njëzëri luftëtarët thanë; "Për All-llahun, i biri i Revâhës ka folur të vërtetën."

Kishin marrë një vendim të qartë. Ata do të vazhdonin luftën deri sa të binin dëshmor. Kur erdhën në fshatin Mûte, ata u përballën me një ushtri të madhe romake prej 100,000 ushtarësh. Malet dhe gurët ishin zënë plot me ushtarë të armikut. Nga njëra anë, kishte një ushtri islame prej tre mijë ushtarësh që kishin ardhur nga Medine për të përhapur fenë e Allahut, ndërsa nga ana tjetër, një turmë jobesimtarësh ishte mbledhur për të shuar dritën e Islamit. Pra duke u bazuar në

BETEAJ E MUTEAS



> *"O populli im, përse hezitoni? A nuk kemi ardhur në luftë me qëllimin për të rënë dëshmorë?"*
> ***Abdullah bin Revaha r.a.***

këtë situatë, çdo mysliman duhej të luftonte kundër tridhjetë romakëve.

Të dyja palët u rreshtuan për luftë. Në këtë moment, sipas urdhrit të Profetit a.s. një delegacion nga ushtria islame u dërgua në kampin romak, duke i ftuar ata të kalonin në Islam ose të paguanin xhizjen. Por ata e refuzuan këtë ftesë sepse tashmë koha për tu humbur kishte mbaruar. Ndaj komandanti Zeid bin Hârith, duke mbajtur flamurin e shenjtë të Islamit, dha urdhrin për të sulmuar. Pas urdherit të komndantit të tyre ushtria islame ne shoqërimin e tekbirëve "Allahu Ekber", u hodh në sulm më një vrull dhe vullnet sikur secili prej ushtarëve të ishin shigjeta që dilnin nga harku. Pra me një shpejtësi të papërshkrueshme, ata filluan të futen në mesin e armikut, duke tundur shpatat dhe duke bërë thirrje të mëdha, ndërohë betejat bëheshin gjithnjë e më intensive dhe më të ashpra. Zeid bin Hârithi, i cili mbante flamurin e Profetit alejhi selam, kishte hyrë në mesin e armikut dhe duke luftuar me guxim të pabesueshëm thërriste "Allahu Ekber!". Ai po hapte rrugë përmes sulmeve të tij, duke i shtyrë kundërshtarët që të tërhiqeshin pas. Disa shigjeta ranë mbi të dhe trupin e tij të bekuar e mbushën me plagë. Pas një kohe, ai ra në tokë dhe shijoi shijen që ai dëshironte më shumë, pra shijen e dëshmorisë që gjithnjë e kishte pritur.

Pas Zeidit, komandën e ushtrisë Islame e mori xhaxhai i Profetit alejhi selam, Xhaferi, i cili mori flamurin dhe vazhdoi luftën aty ku e la Zeidi. Myslimanët duke parë flamurin që fluturoi përsëri, vazhduan të luftonin me një forcë dhe emocion mallëngjyes. Xhaferri duke thyer radhët e armikut dhe duke frymëzuar shokët e tij luftonte me guxim të jashtëzakonshëm. Ai luftoi duke i goditur kundërshtarët me një shpejtësi të pabesueshme, duke u treguar atyre forcën e Islamit. Por, duke kuptuar se nuk kishte kthim pasi, ai vazhdoi të luftonte pa frikë, duke thirrur "Allahu Ekber!" në çdo goditje. Pas një shigjete të fortë nga armiku, dora e tij e djathtë u plagos, por ai vazhdoi të mbajë flamurin me dorën e majtë, duke e ngritur dhe duke e tunduar përsëri në altërsine e qiellit.

Pas disa goditjeve të tjera, ai humbi të dyja duar dhe po përpiqej të mbante flamurin ndërmjet duarve të tij të pre. Por pas disa goditjeve të ashpra nga armiku, ai ra dhe u ngrit në nivelin më të lartë të dëshmorisë. Trupi i tij kishte mbi 90 plagë, por shpirti i tij u ngjit në gradat më të larta të Xhenetit.[279]

Pasi panë se komandantët e tyre ranë dëshmor, luftëtarët e guximshëm të Islamit, morën flamurin e Islamit që ra në tokë dhe ia dorëzuan Abdullah bin Revâha. Ai, i hipur mbi kalë, nisi ta tundë flamurin dhe të sulmoi armikun me forcë. Ai po mposhte çdo armik që i dilte përpara dhe në të njëjtën kohë thoshte:

O nefsi im, patjetër që do të më nënshtrohesh,
Sot do të bëhem dëshmor, betim kam bërë në këtë luftë.

Ose do ta pranosh këtë vetë,
Ose me forcë do të të detyroj ta pranojësh.

Nëse nuk vritesh në këtë betejë,
A mos vallë nuk do të vdesësh kurrë?

[279] Vâkıdî, Megâdhî, II, 756.

Nëse bën atë që bënë
Xhfer bin Ebi Talib dhe Zeid bin Harithi,

Atëherë dije se mirë do të bësh.
Ata u bënë dëshmorë, o nefsi im, mos qëndro prapa,

Përndryshe do të mbetesh i humbur,
Hidhe veten përpara!

Abdullah, gjithashtu, mes thirrjeve **"Allahu Ekber!"**, u përfshi në një betejë të pamëshirshme me armikun. Në një moment, një goditje me shpatë i preu një gisht dhe gishti i prerë filloi ti varej nga dora. Ky komandant i bekuar, i djegur nga dashuria për Allahun dhe të Dërguarin e Tij, menjëherë u hodh nga kali në tokë, e vendosi gishtin e plagosur nën këmbë dhe tha: "A nuk je thjesht një gisht i plagosur? Në fund të fundit, edhe ti ke pësuar këtë fat në rrugën e Allahut!" Më pas e shkuli me forcë dhe u hodh përsëri mbi kalin e tij, duke luftuar me gjithë fuqinë. Megjithatë, pavarësisht gjithë kësaj lufte, ai nuk po arrinte të fitonte gradën e dëshmorit dhe filloi të qortonte veten. Ai sulmoi armikun pa pushim, derisa më në fund një goditje me shtizë e rrëzoi përtokë. Kështu, duke luftuar në rrugën e Allahut dhe të Dërguarit të Tij, ai ra dëshmor, dhe shpirti i tij i bekuar fluturoi drejt Parajsës...

"O Halid! Merre shpejt flamurin e shenjtë të të Dërguarit të Allahut! Betohem se e mora vetëm për ta dorëzuar ty. Ti e njeh më mirë sesa unë artin e luftës!"
Sabit bin Ekrem

Në atë moment, Ebul Jusr Kab bin Umejr, i cili po luftonte pranë Abdullahut, e mori flamurin për ta valëvitur përsëri. Duke vështruar shokët e tij, ai kërkoi dikë më të moshuar dhe më të mençur. Kur pa Sabit bin Ekremin, ia dorëzoi atij flamurin. Sabiti e nguli flamurin para luftëtarëve dhe tha: "O vëllezër! Zgjidhni shpejt një komandant nga mesi juaj dhe binduni atij!" Kur ata thanë: "Të zgjedhim ty", ai nuk e pranoi dhe u drejtua tek Halid bin Velid duke i thënë: "O Ebu Suleyman! Merre ti flamurin!" Mirëpo Halidi, që sapo ishte bashkuar me myslimanët, nuk guxoi të merrte flamurin për shkak të përulësisë së tij dhe tha me modesti: **"Nuk mund ta marr këtë flamur nga ti! Ti je më i denjë për të sesa unë, sepse je më i moshuar dhe ke pasur nderin të luftosh në Betejën e Bedrit pranë të Dërguarit të Allahut (paqja mëshira dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të)!"** Por koha ishte e çmuar. Shokët e bekuar po luftonin ashpër kundër armikut dhe po përpiqeshin të zmbrapsnin ushtrinë prej njëqind mijë vetash. Ndaj Sabiti e përsëriti fjalën e tij: "O Halid! Merre shpejt flamurin e shenjtë të të Dërguarit të Allahut! Betohem se e mora vetëm për ta dorëzuar ty. Ti e njeh më mirë sesa unë artin e luftës!" Më pas iu drejtua luftëtarëve të pranishëm: "O vëllezër! Çfarë mendoni për komandimin e Halidit?" Të gjithë me një zë thanë: **"Ne e pranojmë si komandantin tonë!"** Atëherë, Halidi mori flamurin e bekuar, të cilin i Dërguari i Allahut (paqja mëshira dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të) e kishte dhënë me dorën e tij të shenjtë. Ai e puthi me nderim dhe e ngiti mbi kalë dhe me një madhështi dhe fuqi të madhe, ai sulmoi armikun.[280]

Luftëtarët e guximshëm u hodhën përsëri në sulm pas komandantit të tyre të ri. Halidi luftonte me një guxim dhe aftësi të jashtëzakonshme, duke shkatërruar këdo që i dilte përpara. Në një moment, Kutbe bin Katade i preu kokën një prej komandantëve të armikut, Malik bin Zafile. Me vrasjen e këtij ushtria bizantine filloi të humbiste moralin. Por koha po kalonte dhe nata po binte, duke e bërë luftën më të rrezikshme. Sepse prej errësirës secila palë mund të godiste aksidentalisht shokët e tyre. Për këtë arsye, të dyja palët u tërhoqën në kampet e tyre. Luftëtarët e plagosur filluan të trajtoheshin me mjekim. Ndërsa Halidi, një gjeni i taktikave ushtarake,

[280] Vâkıdî, Megâdhî, II, 756; İbni Sa'd, Tabakât, I, 129; Abdurredhdhâk, Musannef, III, 390; Taberânî, Mu'cemu'l Kebîr, II, 105; Suheylî, Ravdu'l-unf, IV, 130.

planifikoi një manovër të re për të befasuar armikun në mëngjes. Gjatë natës, ai ndryshoi pozicionet e ushtarëve: ata që ishin në të djathtë, i vendosi në të majtë, ata që ishin në të majtë, i zhvendosi në të djathtë, dhe po ashtu bëri me rreshtat e parë dhe të fundit.

"O Allah! Falja Zejdin! O Allah! Falja Xhaferin! O Allah! Falja Abdullah bin Revahan!"
Hadith

Në mëngjes, myslimanët u hodhën përsëri në sulm, duke luftuar me thirrjet e "**Allahu Ekber!"** në buzë. Kur ushtarët bizantinë panë luftëtarët që u sulën mbi ta, u çuditën: "Këta nuk janë ata që luftuam dje!" Ata menduan se një ushtri e re myslimane ju kishte ardhur për ndihmë myslimanëve. Duke menduar se kishin përballë forca të freskëta, u kapën nga paniku dhe filluan të iknin me vrap nga fushëbeteja! Duke e parë këtë si një mundësi që duheshj shfrytëzuar, ushtria islame bëri një sulm të fuqishëm mbi ushtarët bizantinë. Pasi armiku u zmbraps, ata mbërritën në kështjellën Mute dhe, pasi e rrethuan, e pushtuan atë, duke vrarë shumë prej të parëve të saj. Halidi dhe sahabët e tij të guximshëm luftuan atë ditë edhe më trimërisht, duke u dhënë një goditje të rëndë armiqve dhe duke i dërguar mijëra prej tyre në Ferr. Në atë betejë, në duart e Halidit u thyen nëntë shpata.[281]

Me mirësinë e Allahut dhe bekimin e lutjeve të të Dërguarit të Tij (paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të), tre mijë myslimanë i mundën një ushtri prej njëqind mijë vetash. Në këtë betejë të madhe ranë dëshmorë pesëmbëdhjetë sahabë. Kështu, Perandorisë Bizantine iu tregua vendi i saj dhe njëkohësisht iu ndaluan sulmet më të thella drejt jugut. I Dërguari i Allahut, ende pa marrë asnjë lajm nga fusha e betejës, mblodhi sahabët e tij në xhami për t'iu treguar atyre çfarë kishte ndodhur në Mute. Fytyra e tij e bekuar reflektonte një trishtim të madh, aq sa askush nuk guxonte ta pyeste për shkakun e tij. Së fundmi, një nga sahabët u ngrit dhe tha: "O i Dërguari i Allahut! Që kur kemi parë trishtimin në fytyrën tënde, zemrat tona janë të thyera dhe dhimbja jonë është aq e madhe sa vetëm Allahu e di!" Atëherë, i Dërguari i Allahut (paqja mëshira dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të) filloi të derdhë lot dhe tha: "**Trishtimi që po shihni tek unë është për shkak të dëshmorëve të mi të dashur. Kjo dhimbje nuk u largua nga unë derisa i pashë ata si vëllezër, të ulur mbi frone të arta në Xhenet. Zejd bin Haritheti mori flamurin dhe luftoi derisa ra dëshmor. Ai tani ka hyrë në Xhenet dhe vrapon i lumtur aty. Pas tij, flamurin e mori Xhafer bin Ebi Talib. Ai sulmoi armiqtë me guxim dhe, në fund, ra dëshmor. Tani ai ka hyrë në Xhenet dhe fluturon me dy krahë prej xhevahiri. Më pas, flamurin e mori Abdullah bin Revaha. Edhe ai luftoi me guxim dhe ra dëshmor, duke hyrë në Xhenet. Ata më janë treguar mua të ulur në frone të arta në Xhenet. O Allah! Mëshiroje Zejdin! O Allah! Mëshiroje Xhaferin! O Allah! Mëshiroje Abdullah bin Revahën!"** I Dërguari i Allahut vazhdoi të derdhë lot dhe pastaj tha: "**Pas Abdullahut, flamurin e mori Halid bin Velid. Lufta u bë edhe më e ashpër. O Allah! Ai është një nga shpatat e tua, ndihmoje atë!"**[281]

Profeti ynë i dashur, me lejen e Allahut, pa dhe tregoi në mënyrë të mrekullueshme atë që ndodhi në fushën e betejës, ndonëse ishte më shumë se një mijë kilometra larg. Në ditën kur Xhaferi ra dëshmor, i Dërguari i Allahut (paqja mëshira dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të) u ngrit dhe shkoi në shtëpinë e tij. Gruaja e Xhaferit, Esma, ishte duke përfunduar punët e shtëpisë dhe kishte larë e krehur flokët e

[281] Buhariu, Megâdhi, 42; İbni Sa'd, Tabakât, IV, 253; İbni Ebî SHeybe, Musannef, IV, 582; Hâkim, Mustedrek, III, 44.

fëmijëve të saj. I Dërguari i Allahut tha: "**O Esma! Ku janë djemtë e Xhaferit? Mi sill ata!"** Kur ajo i solli fëmijët, Profeti ynë i mori në kraharorin e tij të bekuar dhe i puthi me mall. Lotët i rridhnin pa ndalur. Kur Esma pa këtë skenë, u shqetësua dhe pyeti: "O i Dërguari i Allahut! Prindërit dhe jeta ime qofshin flijim për ty! Pse po i përkëdhel djemtë e mi me kaq mëshirë? A ka ndonjë lajm të hidhur për Xhaferin dhe shokët e tij?" Profeti i Allahut (paqja mëshira dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të), i pikëlluar thellë, u përgjigj: "**Po... Ata sot ranë dëshmorë!"**[282] Kur dëgjoi këtë lajm, Esma i përqafoi fëmijët e saj dhe shpërtheu në lot. Profeti ynë i dashur nuk mundi ta përballonte më shumë këtë pamje dhe u largua...

Huritë e bukura erdhën,
Në djep drite e mbështollën,
Për Muhamedin ballin vunë,
Natën kur Muhamedi lindi.

U hapën portat e qiellit,
Mëshira u derdh mbi botë,
Rrobat e dritës u qepën,
Natën kur Muhamedi lindi.

Yunusi thotë: "O vëllezër,
Lot të përgjakur rrjedhin nga sytë,
Bënë sexhde malet e gurët,
Natën kur Muhamedi lindi.

[282] Ahmed bin Hanbel, Musned, V, 299; İbni Sa'd, Tabakât, VII, 395; İbni Ebî SHeybe, Musannef, VIII, 546; Taberî, Târih, II, 322; Heysemî, Mecma'udh-dhevâid, VI, 150.
[283] Ahmed bin Hanbel, Musned, VI, 370; İbni Hishâm, Sîret, II, 380; İbni Sa'd, Tabakât, VIII, 282; İbni Kesîr, Bidâye, III, 474; IV, 251; Heysemî, Mecma'udh-dhevâid, VI, 156.

Një pamje e vjetër e Qabesë së Madhërueshme /Mekëja e Shenjtë [1890]



ÇLIRIMI I MEKKËS

"Lebbeyk! Po i përgjigjem thirrjes suaj!"
Hadith

Ishte viti i tetë i hixhretit. Një nga pikat e marrëveshjes së paqes së Hudeybijes ishte:**"Fisët arabe jashtë dy palëve mund të hynin nën mbrojtjen e cilësdo prej tyre dhe ishin të lirë të bashkoheshin ose me myslimanët, ose me idhujtarët."** Sipas kësaj marrëveshje, fisi Hudhâa, i cili ishte aleat i Profetit tonë të dashur (paqja mëshira dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të), u bashkua me myslimanët, ndërsa fisi Benî Bekr qëndroi në anën e idhujtarëve. Hudhâat dhe Benî Bekrët kishin qenë armiq të vjetër dhe sa herë që gjenin mundësi, luftonin kundër njëri-tjetrit. Megjithatë, për shkak të marrëveshjes së Hudeybijes, ata e kishin pezulluar armiqësinë për një kohë. Por Benî Bekrët nuk mundën më të respektonin marrëveshjen për më shumë se dy vjet. Një poet nga fisi i tyre tha një poezi fyese ndaj të Dërguarit të Allahut (paqja mëshira dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të). Këtë e dëgjoi një i ri nga fisi Hudhâa, i cili nuk mundi ta duronte dhe e goditi me shkop, duke i çarë kokën. Kjo u bë pretekst për Benî Bekrët, të cilët, me ndihmën e fshehtë të idhujtarëve të Kurejshëve, i sulmuan papritur Hudhâat. Në këtë bastisje, kurejshitët jo vetëm që i furnizuan me armë, por edhe dërguan njerëzit e tyre për të ndihmuar në luftim. Ata vranë mbi njëzet veta nga fisi Hudhâa, madje edhe në territoret e shenjta të kabes bënë po të njëjtën gjë me pjestarët dhe mbështetësit e këtij fisi.

Disa myslimanë nga fisi Huzâa kërkuan ndihmë nga Profeti (s.a.s.). Atë natë, i Dërguari i Allahut ndodhej në shtëpinë e bashkëshortes së tij, Meymûnes. Ndërsa po ngrihej për të marrë abdest dhe për të falur namaz, Allahu i dha atij një mrekulli dhe e bëri të dëgjonte thirrjen për ndihmë nga Mekka. Ai u përgjigj: **"Lebbeyk! Po i përgjigjem thirrjes suaj!"** bashkëshortja e tij Meimûneja u habit dhe e pyeti: "O i Dërguari i Allahut! A është dikush tjetër me ju?" Profeti (s.a.s.) i tregoi për ngjarjen e ndodhur në Mekkë dhe për tradhtinë e Kurejshëve, të cilët kishin shkelur marrëveshjen. Tre ditë më vonë, një burrë nga fisi Hudhâa, i quajtur Amr bin Sâlim, mbërriti në Medinë me dyzet kalorës dhe i rrëfeu të gjitha ndodhitë të Dërguarit të Allahut (paqja mëshira dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të). Ndërkohë, lideri i Kurejshëve, Ebu Sufjani, i cili ishte larguar për tregti në Shamin (Sirinë e sotme), ende nuk ishte në dijeni për këtë ngjarje.

I Dërguari i Allahut (s.a.s.) tha: **"Nëse nuk i ndihmoj bijtë e Hudhâas, atëherë as mua të mos më ndihmojnë!"** Ai urdhëroi të shkruhej një letër dhe ua dërgoi idhujtarëve të Kurejshëve, ku u kërkonte: **"Ose të tërhiqeni nga aleanca me fisin Benî Bekr dhe të hiqni dorë nga ndihma që u keni dhënë, ose të paguani gjakun e njerëzve të vrarë nga fisi Hudhâa! Nëse nuk veproni asnjërën prej tyre, atëherë ju paralajmëroj për luftë!"** Kurejshët nuk e pranuan këtë ofertë dhe u përgjigjën: "As nuk e prishim aleancën tonë, as nuk e paguajmë dëmshpërblimin! Nëse duam, vetëm mund të luftojmë!" Pas kësaj përgjigjeje, ata u penduan thellësisht dhe, nga frika e pasojave, nisën të mendonin për një mënyrë për ta rregulluar situatën. Ata prisnin me padurim kthimin e Ebu Sufjanit nga Shami (Siria e sotme), duke shpresuar se ai do të gjente një zgjidhje. Kur Ebu Sufjani u kthye në Mekkë, Kurejshët i treguan për situatën dhe i thanë: "Duhet të gjejmë patjetër një zgjidhje! Nëse nuk e rregullojmë këtë çështje, Muhamedi do të na dëbojë nga Mekka!" Ebu Sufjani tha: "Edhe pse nuk e kam ditur për këtë, duhet të nisem menjëherë për në Medinë për të rinovuar marrëveshjen e paqes dhe për ta zgjatur atë." Pa humbur kohë, ai u nis drejt Medinës.[284]

[284] İbni Hishâm, Sîret, II, 395; Vâkıdî, Megâdhî, II, 783; İbni Sa'd, Tabakât, II, 134; Abdurredhdhâk, Musannef, V, 374; İbni Ebî SHeybe, Musannef, VIII, 531.

Para se të mbërrinte Ebu Sufjani në Medinë, i Dërguari i Allahut (s.a.s.) u tregoi shokëve të tij për ardhjen e tij dhe tha: **"E kuptoj se ai po vjen për të rinovuar marrëveshjen dhe për ta zgjatur atë. Megjithatë, ai nuk do ta arrijë qëllimin e tij dhe do të kthehet ashtu siç ka ardhur."**

"O Zoti im! Ndalo spiunët dhe lajmëtarët e Kurejshëve derisa të arrijmë papritur në vendin e tyre. Bëji ata që të mos na shohin dhe të mos na dëgjojnë, derisa të na shohin dhe dëgjojnë papritur."
Hadith

Ebu Sufjani sapo mbërriti në Medinë shkoi në shtëpinë e së bijës, Ummu Habîbes. Ummu Habi njëkohësisht ishte njëra nga gratë e Profetit (s.a.s.). Ebu sufjani hyri në shtëpinë e saj dhe deshi të ulej mbi shtrojën e të Dërguarit të Allahut (paqja mëshira dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të). Por Ummu Habîbe e ngriti menjëherë shtrojën dhe nuk e la babain e saj, Ebu sufjanin, të ulet mbi të. I habitur, Ebu Sufjani e pyeti: "Oj bijë! Po ma kursen shtratin tënd?" Ummu Habîbe iu përgjigj me vendosmëri: "Ky është shtrati i të Dërguarit të Allahut. Një idhujtar si ti nuk mund të ulet mbi të! Ti je i papastër dhe nuk je i denjë për këtë shtrat!" I zemëruar, Ebu Sufjani tha: "Oj bijë! Që kur u largove nga shtëpia ime, duket se shumë gjëra kanë ndryshuar tek ti!" Ajo iu përgjigj me bindje: "Falënderimi i qoftë Allahut që më udhëzoi në Islam! Ndërsa ti ende adhuron idhujt prej guri, që nuk dëgjojnë dhe nuk shohin! Si mundet një njeri si ti, që është udhëheqës i Kurejshëve dhe një burrë i mençur, të qëndrojë larg Islamit?" I tërbuar, Ebu Sufjani tha: "Ti po më ofendon dhe po më trajton si të paditur! A mendon se unë duhet të braktis besimin e paraardhësve të mi dhe të pranoj fenë e Muhamedit?!" [285]

Pas këtyre fjalëve, ai u largua i zemëruar nga shtëpia e së bijës. Më pas, ai shkoi tek i Dërguari i Allahut dhe i tha: "Unë kam ardhur për të rinovuar marrëveshjen e Hudeibijes dhe për të zgjatur afatin e saj. Hajde, le ta rishkruajmë këtë marrëveshje!" Por Profeti (s.a.s.) iu përgjigj: **"Ne nuk kemi thyer asnjë nen të marrëveshjes së Hudeybijes dhe nuk kemi nevojë ta ndryshojmë atë."**

Ebu Sufjani e përsëriti kërkesën e tij disa herë, por i Dërguari i Allahut (paqja mëshira dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të) nuk i dha asnjë përgjigje. Kur pa se asgjë nuk po funksionon te, ai u kthye në Mekkë dhe u tregoi Kurejshëve për dështimin e tij. Të zemëruar, idhujtarët e Kurejshëve i thanë: "Pra, nuk arrite të bësh asgjë dhe u ktheve duarbosh?!" Tani ata e kuptuan se nuk u kishte mbetur tjetër veçse të prisnin fatin e tyre, duke qenë të vetëdijshëm se Profeti (s.a.s.) do të vepronte së shpejti.

Kushdo që strehohet në Mescid-i Haram është i sigurt.

Pas largimit të Ebu Sufjanit nga Medina, i Dërguari i Allahut (s.a.s.) mori vendimin për të çliruar Mekkën, pasi Kurejshët kishin shkelur marrëveshjen dhe besën që ishin dhënë. Por Profeti (paqja mëshira dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të) e mbajti këtë plan shumë sekret, pa lejuar që idhujtarët të kishin mundësinë të përgatiteshin dhe pa shkaktuar derdhje gjaku në Harem-i Sherif. Kjo ishte një masë ushtarake për të siguruar që çlirimi të ndodhte pa dhunë, dhe që shumë njerëz mund të ktheheshin në Islam pa ndikuar nga ndonjë luftë e hapur. Ai e informoi Ebu Bekrin r.a. dhe disa nga shokët e tij më të afërt për këtë plan, duke u urdhëruar që të fillonin përgatitjet.

Ushtria Islame, megjithatë, nuk e dinte ende se ku do të shkonte, pasi Profeti (paqja mëshira dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të) dëshironte të mbante sekretin sa më gjatë. Kështu, ai i dërgoi një thirrje fiseve myslimane përreth, si Eslem, Eshxha',

[285] Beyhekî, Delâil-un-nubuvve, V, 43; İbni Kesîr, Sire, III 530.

XhuheyXhine, Husain, Gıfâr, Muzeyine, Suleyim, Damra dhe Hudhâa, duke i ftuar që të ishin në Medinë në fillim të Ramazanit për t'u bashkuar në luftë. Për të mbajtur sekretin dhe për të parandaluar çdo informacion të mundshëm që mund të shkonte deri te Kurejshët, Profeti (paqja mëshira dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të) e caktoi Omerin r.a. që të vëzhgonte rrugët dhe kalimet që çonin në Mekkë. Ai vendosi ushtarë dhe roje për të parandaluar çdo njeri që mund të përpiqej të informonte kurejshët. Gjithashtu, Profeti (s.a.s.) bëri një lutje të fuqishme: **"O Zot! Mbaj ata që dërgojnë lajme te Kurejshët të papërgatitur, që ne të mund të arrijmë papritur dhe të mos na shohin e dëgjojnë!"**

Në këtë periudhë, për të krijuar përshtypjen se Profeti (paqja mëshira dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të) po përgatitej për një fushatë kundër Bizantit, ai dërgoi njësi ushtarake, të udhëhequra nga Ebu Katade, drejt luginës Idhâm, në veri. Për të penguar përhapjen e informacionit te kurejshët, Profeti (s.a.s.) urdhëroi Aliun r.a. që të kapte dërguesin e një letre, e cila ishte dërguar për të njoftuar kurejshët për përgatitjet ushtarake të myslimanëve. Aliu e zbuloi dhe e ndaloi këtë plan. Deri në ditën e dytë të Ramazanit, fiset myslimane të thirrura kishin mbërritur dhe kampi ushtarak ishte vendosur në Ebû Inebe, ku 12,000 luftëtarë u mblodhën. Prej tyre, 4,000 ishin Ensarë (myslimanët nga Medina), 700 ishin Muhaxhirë (myslimanët që ishin shpërngulur nga Meka) dhe pjesa tjetër ishin myslimanë nga fiset e tjera aleate.[286] Profeti la Abdullah bin Umm-i Mektûm si përfaqësues në Medinë, për të udhëhequr në mungesë të tij.[287] Ai gjithashtu dërgoi Zubeir bin Avvamin me një grup prej 200 kalorësish për të bërë një operacion zbulimi dhe për të siguruar informacionin në terren. Të gjitha këto përgatitje ishin pjesë e një plani të madh për të çliruar Mekkën dhe për të siguruar që populli i Mekkës do të kishte mundësinë të kthehej në Islam pa pasur nevojë për një luftë të dhunshme. Në vitin e tetë të Hixhretit, pikërisht të hënën e dhjetë të muajit të Ramazanit, Profeti (s.a.s.), së bashku me 12,000 sahabë, të cilët jëpnin shpirtin për dashurinë që kishin për Allahun dhe të Dërguarin e Tij (paqja mëshira dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të), u nisën nga Medina drejt Mekkes.

Ata po udhëtonin drejt Mekës, atij qyteti që kishin lënë pas nga përndjekjet dhe persekutimet para tetë vjetësh. Tani, po shkonin për të pastruar Kâben e shenjtë nga idhujt dhe për të shpallur të vërtetën e Allahut. Ata po shkonin për të shpëtuar popullin e Mekkës nga vuajtja e përjetshme e Xhehenemit dhe për të shpallur dritën e Islamit. Në Dhul-Huleife, udhëheqësit e ushtrisë islame u takuan me Abbâsin r.a., xhaxhanë e Profetit (paqja mëshira dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të), i cili kishte migruar me familjen e tij nga Mekka për në Medina. Profeti (paqja mëshira dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të) u gëzua shumë kur e pa Abbâsin r.a. dhe i tha: **"O Abbâs! Ashtu siç unë jam Pejgamberi i fundit, edhe ti je i fundit nga muhaxhirët."** Më pas Ai (paqja mëshira dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të) e dërgoi ngarkesat e Abbâsin r.a. për në Medinë dhe e ftoi që të qëndronte me të dhe të merrte pjesë në pushtimin e Mekkës.[288] Kur Profeti a.s. arriti në Kudeid, afër Mekkës, ai dha urdhra për t'u organizuar në formacion luftarak. Çdo fis kishte flamurin e tij, të cilat iu dorëzuan komandantëve të fiseve. Flamujt e Muhaxhirëve i mbajtën Aliu, Zuubeyir bin Avvami dhe Sa'd bin Ebi Vakkasi (Allahu qoftë i kënqur me të gjithë sahbët). Ensarët kishin gjithashtu 12 flamuj, ndërsa fiset e tjera të aleatëve,

[286] İbni Sa'd, Tabakât, II, 135.
[287] İbni Sa'd, Tabakât, II, 135.
[288] İbni Asâkir, Tarih-i Dımeshk, XXVI, 297.

si Eshxhâ dhe Suleim, kishin flamuj të tyre. Pasi ishin larguar nga Medina dhe kishin kaluar dhjetë ditë, ushtria islame arriti pranë Mekkës, ku, në mbrëmje, ata u ndalën në Merrudh-dhahrân. Profeti urdhëroi që të digjeshin zjarret në mënyrë që çdo ushtar të ndizte një zjarr më vete. Kështu që më shumë se dhjetë mijë zjarre u ndezën. Kurejshët, të papërgatitur, u tmerruan kur panë dritat që vinin nga çdo anë. Ata ishin të shqetësuar dhe dërguan Ebu Sufjanin për të zbuluar se çfarë po ndodhte.[289]

"Kush hyn në shtëpinë e Ebu Sufjanit dhe strehohet aty, është i sigurt dhe do të shpëtojë nga vrasja... Kush hyn dhe strehohet në Mescid-i Haram, është i sigurt! Kush e mbyll derën e shtëpisë së tij dhe qëndron brenda, është i sigurt!"
Hadith

Për t'iu mundësuar kurejshëve të kërkonin paqe pa luftuar, Profeti (s.a.s.) i tha shokëve të tij: **"Mbani një sy mbi Ebu Sufjanin, se ku do ta gjeni."** Kur Ebu Sufjani dhe shokët e tij po afroheshin pranë kampit të ushtarëve të Islamit, ata ishin të shokuar nga sasia e ushtarëve dhe zjarreve. Kur ata arritën në vendin e quajtur Erak, Profeti (paqja mëshira dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të) tha: **"Ebu Sufjani tani është në Erak."** Abbâsi r.a., i cili po udhëtonte në atë drejtim, e pa dhe e njohu zërin e Ebu Sufjanit. Ai e thirri: **"O Ebu Hanzala!"** Ebu Sufjani, duke e njohur Abbâsin, iu përgjigj: **"O Ebu'l-Fadl, jeta ime është për ty!"** Të dy ata nisën të lëvizin drejt kampit të ushtrisë islame. Mieëpo gjatë rrugës, Ebû Sufyjânji i kërkoi informacion Abbâsit që ai ti tregonte për situatën ndaj e pyeti: "O Abbas! Çna thua si janë lajmet?" Abbasi ju përgjigj duke i thënë: "O Ebû Sufiân, dëshpërim për ty! Pejgamberi (a.s) po vjen me një ushtri që nuk mund të ndalohet. Betohem se Kurejshët do të kalojnë një kohë të vështirë. Mjerë ata për atë që do të vijë mbi ta!" Në atë kohë Ebû Sufjâni dhe të tjerët po kakonin me frikë midis luftëtarëve dhe arritën te Pejgamberi ynë i dashur. Ai i priti me mirësjellje, pyeti për gjendjen e Mekkës dhe foli me ta deri vonë. Pas bisedës, i ftoi ata për në Islam. Hâkim bin Hizâm dhe Budeil menjëherë e pranuan shahadetin dhe u bënë myslimanë. Ndërsa Ebû Sufiân mbeti në mëdyshje. Kur erdhi mëngjesi, Pejgamberi ynë i dashur (paqja mëshira dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të) i tha: "**O Ebû Sufyiân, a nuk ka ardhur ende koha që të besosh se nuk ka Zot tjetër përveç Allahut?"** Ebû Sufiâni iu përgjigj: **"O pejgamberi im, ti je i shkëlqyer në sjelljen tënde, nderin që ke dhe kujdesin për të afërmit. Pas gjithë kësaj që ne të kemi bërë, ti ende na fton në rrugën e udhëzimit. Sa bujar je! Besoj se nuk ka Zot tjetër përveç Allahut dhe se ti je i Dërguari i Allahut."** Dhe kështu, ai u nderua si një sahabe.[290]

Më pas Abbâsi r.a. i tha Pejgamberit alejhi selam: "O Pejgamberi i Allahut, a mund të bëjmë diçka që të nderojmë Ebû Sufyjânin në sytë e Mekkas?" Pejgamberi i dha leje dhe tha: **"Kush hyn në shtëpinë e Ebû Sufjânit dhe kërkon mbrojtje, do të jetë i sigurt nga vdekja."** Ebû Sufjânji kërkoi më shumë lehtësim dhe Pejgamberi tha: **"Kush hyn në Xhaminë e Shenjtë, ai do të jetë i sigurt. Kush mbyllet në shtëpinë e tij, do të jetë i sigurt."** Pastaj Pejgamberi (a.s) i kërkoi Abbâsit r.a. që ta çonte Ebû Sufjânin në një ngushticë malore ku do të shihte fuqinë e madhe të ushtrisë islame, që kur të kthehej ti trgonte mekkasve që të mos e kundërshtojnë Muhammedin alejhi selam sepse tashmë ai është bërë i pa thyeshëm.

Kur po shkonin te kodra, mbi të cilen e dukej e tera ushtria e myslimanëve, po kalonin ne mes te ushtrise. Ebu Sufjani pse se çdo fis i kishte nga një flamujt të tyren.[291] Ebû Sufjâni kurrë më parë nuk e kishte parë një organizim të tillë ushtarak,

[289] Ibni Sa'd, Tabakât, II, 135.
[290] Ibni Hishâm, Sîret, II, 400; Vâkıdî, Megâdhî, II, 811; Beyhekî, Delâil-un-nubuvve, V, 62; Suheylî, Ravdu'l-unf, IV, 155.
[291] Vâkıdî, Megâdhî, II, 800.

ndaj ai nga habia pyeti se kush ishin ata? Abbâsi r.a. iu përgjigj duke i perzantuar secilin fis ku i thoshte: "Këta janë pasardhësit e Sulejmanit, komandanti i tyre është Hâlid bin Velid!" "Këta të tjerët janë pasardhësit e Gîfarit!" "Këta janë pasardhësit e Kâbit!" dhe kështu me radhë. Gjatë kosaj kohe nga sahabët dëgjoheshin thirrjet e tekbiëre **"Allahu Akber!"** Tashmë Ebû Sufjâni e kishte parë madhështinë e ushtrisë së pejgamberit alehji selam ndaj u drejtua me këtë pyetje "A është kjo ushtria e Pejgamberit?" Abasi r.a. e pa në sy dhe i tha: "Po! Kjo është ushtria e Pejgamberit. Ata janë muhaxhirët dhe ensarët që vdesin për të shpëtuar dhe do të luftojnë për të!"

"Sot është dita kur Allahu i Lartësuar do ta madhërojë nderin e Qabesë. Sot është dita kur do t'i vendoset mbulesa Bejtullahut! Sot është dita e mëshirës. Sot është dita kur Allahu i Lartësuar do t'i lartësojë kurejshitët me Islamin."
Hadith

Më pas Ebu Sufjani u afrua tek Pejgamberi alejhi selam i cili i tha: "(O Ebu Sufjan)! **Sot është dita që Allahu do të nderojë Kâben. Sot është dita që do t'i nderojë Kurejshët me Islamin."** Pas gjithë kësaj, Ebû Sufjâni, duke shikuar dhe dëgjuar gjithçka, tha: "Kam parë perandoritë e Kaisarit dhe Kisras, por kurrë nuk kam parë një ushtri të tillë. Asnjë ushtri nuk mund t'i përballojë këta." Më pas u kthye në Mekkë dhe i tha popullit të Kurejshëve: "Muhammedi (a.s) ka ardhur me një ushtri që nuk mund të përballohet. Nuk do të ndiheni më të sigurt nëse nuk e pranoni Islamin. Kush hyn në shtëpinë time, kush hyn në Xhaminë e Shenjtë, kush mbyllet në shtëpinë e tij, do të jetë i sigurt." [292]Më pas disa nga kundërshtarët e tij u ngritën kundër dhe filluan të përgatiteshin për luftë, por ata ishin shumë pak. Të tjerët nuk iu përgjigjën dhe shkuan në shtëpitë e tyre ose u futën në Xhaminë e Shenjtë për të gjetur mbrojtje. Pejgamberi (a.s) dhe shokët e tij erdhën pranë Zî-tuvâ, ku ai kujtoi ditët e kaluara, kur kishte ikur nga Mekka, dhe e kujtoi mirësinë dhe ndihmën që Allahu kishte dhënë në çdo luftë që kishte luftuar. Ai e falënderoi Allahun dhe e ngriti kokën e tij me dashuri dhe adhurim për të.

Pejgamberi ynë i Dashur i ndau sahbët në katër grupe. Për komandantin e krahut të djathtë emëroi Hâlid bin Velidin, për komandantin e krahut të majtë Zubeyir bin Avvâm, për komandantin e këmbësorisë Ebû Ubeide bin Xherrâh, dhe për grupin tjetër Sa'd bin Ubâde (Allahu qoftë i kënaqur me të gjithe sahabët). Hâlid do të hynte nga jugu i Mekkes dhe do të ndëshkonte ata që do të kundërshtonin apo do të pengonin hyrjen e tij ne Mekkë. Më pas do të takohej me Pejgamberin (a.s) në majën e Safâsë. Zubeiri do të hynte nga veriu dhe do të vendoste flamurin në Haxhu dhe aty do të priste Pejgamberin (a.s). Sad bin Ubâde do të lëvizte nga perëndimi dhe do të takoheshin me Pejgamberin a.s. aty ku ai i kishte caktuar vendtakimin.[293]

Pra, Pejgamberi (a.s) ndërtoi një strategji ku ushtria do të gynte në Mekka nga të katërta anët e saj. Por u dha urdher komandantëve: **"Kurrë nuk do të ndesheni dhe nuk do të luftoni me askënd, përveç nëse sulmoheni. Nuk do të vrisni dhe nuk do të sulnoni askënd."** Ky rregull nuk përfshinte tradhëtarët dhe mizorët që ishin të përbetuar në armiqësine dhe mizorinë e tyre ndaj pejgamberit, shabëve dhe njerëzve të pafajshëm, pra ata edhe sikur të fshiheshin nën mbulesën e Kâbes, do të ekzekutoheshin.[294]

[292] Ebû Dâvûd, Harâc, 25; Ahmed bin Hanbel, Musned, II, 292; İbni Hishâm, Sîret, II, 401; Vâkıdî, Megâdhî, II, 817; Suheylî, Ravd-ul-unf, VII, 80.
[293] Ebû Dâvûd, Harâc, 25; Abdurredhdhâk, Musannef, V, 377; Beyhekî, Delâil-un nubuvve, II, 431.
[294] İbni Hishâm, Sire, II, 859.

E Vërteta Erdhi, E Kota U Zhduk.

"E vërteta erdhi dhe e kota u zhduk! E vërtetë është që e kota gjithmonë do të zhduket."
El-Isra: 81

Kurejshitët e ashpër, si Ikrime bin Ebu Xhehli, Safuan bin Umejja dhe Suhejll bin Amri, së bashku me disa njerëz nga fisi Beni Bekr dhe Beni Haris, sapo morën vesh se Halid bin Velidi po afrohej, zunë pritë në rrugë dhe filluan të përgatiteshin për betejë. I pari që u nda me grupin e tij ishte i Halid bin Velidi, i cili komandonte komandën që do të hynte në krahun e djatht të Mekkës. Kur mbërritën në jug të Mekës, në shpatet e malit Handeme, panë se idhujtarët kurejshitë po hidhnin shigjeta mbi ta. Dy prej myslimanëve ranë dëshmorë: njëri ishte Kurzdh bin Xhabiri dhe tjetri Habes bin Eshari.

Përballë kësaj situate Halidi pa se nuk kishte rrugë tjetër veç luftës ndaj ai i dha urdhër ushtrisë së tij që të rrjeshtohej në pozicionin luftarak dhe ju tha: "Prej këtyre të pabesëve do të shpëtojnë vetëm ata që ikin dhe ata që dorëzohen. Pra ata që ikin dhe ata që dorëzohen nuk do të vriten" dhe më pas u hodhën vetë i pari në sulm. Për një çast, ata i zmbrapsën idhujtarët duke përparuar deri në Mesxhid-i Haram (Qaben). Gjatë përleshjes, gjashtë prej idhujtarëve u vranë, ndërsa disa të tjerë u arratisën malesh dhe disa nëpër shtëpitë e tyre.

Shokët e ndritur të Profetit alejhi selam, të cilët hynë në Mekkën e Shenjtë nga drejtimet e tjera të Mekkës, nuk hasën në asnjë rezistencë. Nga ata që ishin urdhëruar të ekzekutoheshin, pesë u kapën dhe u ndëshkuan menjëherë, ndërsa të tjerët ikën nga Mekka.

Muxhahidët, në ditën e njëzetë të Ramazanit, të enjten, hynë në Mekkë me një emocion të madh, duke thirrur valë pas vale: **"Allahu Ekber! Allahu Ekber!"** I Dërguari i Allahut, (paqja dhe bekimet e Zotit qofshin mbi të), po hynte në qytetin e tij të lindjes, Mekkën e Shenjtë, me përulësi të madhe, duke qenë mbi devenë e tij Kusva, ndërsa pas tij qëndronte Usame bin Zeidi. Ai falënderonte Allahun që i kishte mundësuar të shihte këtë ditë dhe lexonte suren **Fet'h**, e cila përgëzonte fitoren e Mekës.

Profeti ynë i Dashur (paqja dhe bekimet e Zotit qofshin mbi të), i rrethuar nga shokët e tij triumfues, u drejtua nga Qabeja e Madhërueshme. Në të djathtën e tij ishte Ebu Bekri r.a. dhe në të majtën Usaid bin Hudairi r.a. Kur u afruan te Qabeja, ai vizitoi **Haxheru'l-Esvedin** dhe bëri telbije dhe tekbire. Sahabët e tij e ndoqën atë dhe thirrjet **"Allahu Ekber! Allahu Ekber!"** që tronditnin qiellin e Mekkës së Shenjtë. Kjo skenë madhështore i mbushi zemrat e myslimanëve me gëzim dhe lotët u rridhnin në faqe, ndërsa idhujtarët, të strukur në shtëpitë e tyre ose të fshehur në **Harem-i Sherif**, po prisnin, se çdo të bëhej me to, me frikë dhe ankth.

Pastaj, i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimet e Zotit qofshin mbi të) dhe shokët e tij filluan të kryenin tavafin (rrotullimin rreth Qabes). Pasi përfunduan shtatë xhirot, Profeti a.s. zbriti nga deveja dhe fali dy rekate namaz tek vëndi i quajtur **Makami Ibrahim**. Pastaj piu ujë nga Zemzemi, që Abbasi r.a. e kishte nxjerrë nga pusi. Ai shprehu dëshirën për të marrë abdes me ujin e Zemzemit. Ndërsa merrte abdes, shokët e tij, sahabët, nuk linin asnjë pikë nga uji i tij të prekte tokën, duke e kapur atë në ajër. Duke parë këtë skenë, idhujtarët thanë të habitur: "Në jetën tonë nuk kemi parë dhe as kemi dëgjuar për një sundimtar të tillë!"

I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimet e Zotit qofshin mbi të), pastaj, urdhëroi shkatërrimin e të gjithë idhujve prej guri dhe druri përreth Qabes. Ai lexoi ajetin:

Çirimi i Mekës së Shenjtë



"E vërteta erdhi dhe e kota u zhduk! E vërtetë është që e kota gjithmonë do të zhduket."(Sureja El-Isra: 81)[295] dhe me bastunin e tij i tregoi idhujt një nga një. Çdo idhull që ai prekte, rrëzohej dhe thyhej. Në total, 360 idhuj u shkatërruan dhe u fshinë nga Qabeja. Kur erdhi koha e namazit të drekës, i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimet e Zotit qofshin mbi të) urdhëroi Bilalin r.a. të thërriste Ezanin në Qabe. Bilali r.a. menjëherë e kreu këtë detyrë të shenjtë. [296]

Ndërsa ezani jehonte nëpër Mekkën e Shenjtë, zemrat e besimtarëve u mbushën me lumturi të pafundme, ndërsa idhujtarët u zhytën në trishtim dhe dëshpërim të madh. I dashuri i yni, Profeti Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të), kërkoi çelësin e Qabes. Kur ja sollën çelsin ai hyri brënda në Qabe së bashku me Usame bin Zejdin, Bilalin dhe Osman bin Talhën dhe pasi i pastroi nga brenda të gjitha figurat dhe idhujt e rrëzuar fali dy rekate namaz duke u kthyer nga dera e Qabes. Në çdo kënd të saj ai bëri tekbir dhe u lut.[297]

Ndërkohë, Halid bin Velidi qëndronte te dera dhe përpiqej të parandalonte turmat e njerëzve të afroheshin. Profeti alejhi selam mbante me të dy duart e tij të bekuara dy kanatat e derës së Qabes. Tërë fisi i Kurejshëve ishte mbledhur në rreth qabes, duke e vështruar me frikë dhe shpresë. Ata e kishin fyer, e dhunuar, e kishin sulmuar, madje dhe kishin tentuar ta vrisnin. I kishin torturuar shokët e tij në mënyrat më mizore, duke i lidhur me litarë, duke i djegur në zjarr, duke i shpuar trupat me heshta të skuqura në prush. Për tre vjet i kishin izoluar në një lagje të Mekkës, duke i lënë pa ushqim dhe pa ujë. I kishin dëbuar nga vendlindja dhe madje, me tentativën për ta shfarosur, kishin luftuar disa herë kundër tij. Por, pavarësisht gjithë këtyre mizorive, ata shpresonin në mëshirën e tij. Sepse përpara tyre ndodhej ai që ishte dërguar si mëshirë për gjithë botët.

Pas një pauze të shkurtër, Profeti ynë i dashur tha: **"O fis i Kurejshëve! Çfarë mendoni se do të bëj me ju tani?"** Ata iu përgjigjën: "Ne presim nga ti vetëm mirësi. Ti je një vëlla fisnik, biri i një vëllai fisnik. Ti ke fituar mbi ne, por ne shpresojmë në mëshirën tënde." Atëherë, i Dërguari i Allahut buzëqeshi dhe tha: **"Sot unë nuk do t'ju kërkoj llogari për ato që më keni bërë. Unë do t'ju them atë që Jusufi (alejhi selam) u tha vëllezërve të tij: 'Sot nuk ka qortim për ju. Allahu ju faltë!' Shkoni! Ju të gjithë jeni të lirë!"**[298]

Kjo mëshirë e madhe zbuti zemrat e tyre të ngurta dhe e ktheu urrejtjen në dashuri. Ndaj kur Profeti ynë i thirri ata në Islam, ata erdhën masivisht për të pranuar besimin. Pastaj, ai u ngjit në kodrën **Safa**, pikërisht aty ku për herë të parë i kishte thirrur në Islam. Burrat dhe gratë e Mekkës erdhën për të dhënë besën dhe u bënë myslimanë, duke pasur kështu nderin të bashkoheshin me sahabët e tij të ndritur. Pasi burrat dhe gratë (mekkasit) i dhanë besën, Profeti alejhi selam kërkoi prej tyre që:

- Të mos i shoqëronin Allahut askënd (të mos bënin shirk),
- Të mos kundërshtonin Profetin,
- Të mos vidhnin,
- Të ruanin nderin dhe moralin e tyre,

[295] Sureja El-Isra: 81
[296] İbni Hishâm, Sîret, II, 416.
[297] Suheylî, Ravd-ul-unf, IV 172.
[298] Surja Jusuf 12/92

- Të mos përhapnin shpifje, dhe
- Të mos vrisnin vajzat e tyre.

> *"Gjendja ime me ju është si ajo e Jusufit (alejhis-selam) me vëllezërit e tij. Ashtu siç u tha ai: 'Sot nuk ka qortim dhe fajësim për ju. Allahu ju faltë' (Sureja Jusuf: 92), edhe unë po ju them të njëjtën gjë. Shkoni! Jeni të lirë dhe të çliruar."*
> ***Hadith***

Të gjitha gratë dhe burrat pranuan dhe dhanë besën vetëm me fjalë.[299] Profeti bëri dua për to dhe kërkoi falje për mëkatet e tyre. Ndër gratë prezente ishte edhe **Hindi**, gruaja e Ebu Sufjanit dhe nëna e Muaviut, e cila ishte udhëheqësja e tyre. Ajo foli në emër të grave. Me këtë premtim dhe me këtë falje të Profetit alejhi selam, ajo fitoi shumë. Çdo grua myslimane që pranon këto kushte dhe i përmbahet atyre, përfiton nga ky premtim dhe nga kjo lutje. Pas kësaj, çdo mysliman shkatërroi idhujt që kishte në shtëpinë e tij. U dërguan trupa ushtarake në fiset përreth për të rrëzuar edhe atje të gjithë idhujt. Me ardhjen e të vërtetës, rrënjët e së kotës u shkulën njëherë e përgjithmonë.

Të dënuarit

Që nga ditët e para të Islamit deri në vitin e tetë të hixhretit, disa persona ishin dënuar me vdekje për shkak të krimeve të tyre. I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) kishte përmendur emrat e tyre (njëmbëdhjetë burra dhe gjashtë gra) dhe kishte urdhëruar:**"Vritini ata kudo që ti shihni."**

Burrat e dënuar ishin: Ikrime bin Ebi Xhehli, Vahshi bin Harb Habeishi, Abdullah bin Ebi Sarh, Hebar bin Esved, Safvan bin Umejje, Ka'b bin Zuhejr, Abdullah bin Zebari, Abduluzza bin Hatal, Huvejris bin Muadh, Makis bin Sababe, Haris bin Tula

Gratë e dënuara ishin: Hind bint Utbe, Karita, Karite, Një skllave e birit të Hanzalës, Një skllave e Beni Abdulmuttalibit, me emrin Sare, Ummu Sa'd,

Të mëshiruarit

Megjithëse disa prej tyre ishin dënuar, disa arritën të fitonin faljen dhe mëshirën e të Dërguarit të Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të).

Hind bint Utbe: Ajo ishte gruaja e **Ebu Sufjanit** dhe ndodhej në listën e të dënuarve. Hindi ishte një nga ata që i kishin bërë shumë dëm myslimanëve. Pikërisht me nxitjen e saj, trupat e **Hamzait** r.a. dhe të dëshmorëve të tjerë të Uhudit ishin përdhosur pas betejës. Por, kur Profeti (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) u vendos në kodrën **Safa**, filluan të vinin burrat e pastaj gratë për të dhënë besën e tyre në Islam. Mes tyre ishte edhe **Hind**, e cila u afrua dhe dha betimin e saj si përfaqësuese e grave. Profeti bëri dua për të dhe ajo u nderua me faljen e tij.

Ikrime bin Ebi Xhehli: Ai ishte djali i **Ebu Xhehlit** dhe një nga burrat e dënuar. Gjatë pushtimit të Mekkës, ai vrau një sahab dhe më pas iku në Jemen. Kur ky lajm i erdhi Profetit a.s., ai buzëqeshi. Kur sahabët e pyetën përse, ai u përgjigj:**"Ikrime dhe sahabiu që ai vrau, tani janë të kapur për dore duke ecur bashkë në Xhenet."**Gruaja e tij, U**mmu Hakîm binti Haris bin Hisham**, kishte pranuar Islamin dhe kërkoi falje për të. Ajo u kthye me të në Mekkë dhe kur ai kërkoi mëshirën e Profetit a.s., Profeti (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) e fali dhe u lut që Allahu ta mëshironte. Pas pranimit të Islamit, **Ikrime** u bë një nga sahabët më të përkushtuar në fe dhe u angazhua me përpjekje të mëdha në shërbim të Islamit.

Vahshi bin Harb Habeishi: **Vahshi** ishte skllav i fisit Beni Xhumeh dhe njihej si një luftëtar i aftë me shtizë. Ai është i njohur kryesisht për faktin se vrau **Hamzain**

[299] İbni Sa'd, Tabakât, VIII, 9.

(radijallahu anhu) në **Betejën e Uhudit.** Myslimanët kishin një dëshirë të madhe për ta ekzekutuar për këtë veprim. Në një rast, disa sahabë e pyetën të Dërguarin e Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) pse nuk e mallkonte Vahshin, ashtu siç kishte bërë me disa idhujtarë të tjerë. Profeti a.s. u përgjigj:**"Gjatë natës së Miraxhit, e pashë Hamzan dhe Vahshin, të kapur dorë për dore, duke hyrë bashkë në Xhenet."**

Pas **Çlirimit të Mekës**, Vahshi iku nga frika prej hakmarrjes. Ai u ndje shumë i penduar dhe së bashku me disa banorë të **Taifit**, shkoi në Medinë, ku u paraqit në xhami dhe e përshëndeti të Dërguarin e Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të). Profeti a.s. e pranoi përshëndetjen e tij, dhe ai u bë mysliman. Megjithëse ai u fal, e ndjeu veten shumë të turpëruar dhe jetoi gjithmonë me kokën ulur nga ndjenja e fajit. Ai nuk qëndroi më në Medinë, por me urdhrin e Profetit a.s. u dërgua në **Jemame**.

Lufta Kundër Rrenacakut Mesejleme

Në vitin e **11-të hixhri**, në Jemame ndodhi një betejë e madhe kundër gënjeshtarit **Mesejleme Kedh-dhabi**, i cili pretendonte se ishte profet. Në këtë betejë, ushtria e **Halid bin Velidit** (radijallahu anhu) u përball me ushtrinë e Mesejlemes. Fillimisht myslimanët u tërhoqën, por pastaj bënë një sulm të fuqishëm. Vahshi (radijallahu anhu) luftoi me trimëri dhe e vrau **Mesejlemen** me të njëjtën shtizë me të cilën kishte vrarë **Hamzain**.[300] Kur myslimanët e panë këtë, ata u trimëruan dhe sulmuan me më shumë forcë, duke siguruar fitoren. Kështu, parashikimi i Profetit alejhi selam për **shkakun e dërgimit të Vahshisë në Jemame** u vërtetua si një mrekulli.

Më pas, Vahshi mori pjesë edhe në **Betejën e Jermukut** kundër bizantinëve, ku tregoi shumë heroizëm. Më vonë, ai u vendos në **Homs** (Siri), ku jetoi deri në **kohën e Halifatit të Osmanit r.a.**. Ai ndërroi jetë në Homs, duke lënë pas një histori të jashtëzakonshme të pendimit, faljes dhe heroizmit.

Ai pranonte justifikimet e fajtorëve, me faljen dhe mëshirën e Tij,
Ishte me moral të madh, i mëshirshëm dhe plot dhembshuri, ai burim bujarie.

Nuk e donte pasurinë, por varfërinë e çmonte dhe krenohej me të,
Dhe i trajtonte të varfrit si vëllezër të tij, ai burim bujarie.

Vishte rroba të thjeshta dhe i qepte vetë, sandale mbathte,
Dhe çdo të sëmuri i shkonte për t'i dhënë shërim, ai burim bujarie.

Edhe shërbimet e familjes i bënte vetë me kënaqësi,
Dhe çdo vështirësi e bënte të lehtë, ai burim bujarie.

Nëse e ftonin për bukë të thjeshtë dhe supë me thjerrëza,
Ai prapë do të shkonte si mysafir, ai burim bujarie.

Nganjëherë hipte në deve, nganjëherë në kalë, ndonjëherë në mushkë, herë në gomar,
Dhe shpesh ecte zbathur, ai sovran, ai burim bujarie.

[300] Vâkıdî, Megadhî, II, 863; Taberânî, Mu'cemu'l Kebîr, XXII, 36; İbni Asâkir, Tarih-i Dımeshk, LXII, 404.

BETEJA E HUNEJNIT

"Nëse dëshiron Allahu, nesër ata (Hevazinët dhe Sakifët) do të jenë plaçkë lufte për myslimanët."
Hadith

Hunejni është një luginë midis Mekkës dhe Taifit. Kjo betejë njihet edhe si *Beteja e Hevazinëve*. Kur i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) u nis nga Medina me qëllim të çlirimit të Mekës, dy fise të mëdha, Hevazinët dhe Sekifët, që jetonin rreth Mekkës, menduan se myslimanët do ti sulmonin ata. Për këtë arsye, ata filluan të përgatiteshin për luftë. Por kur mësuan se Profeti a.s. po shkonte për të çliruar Mekkën, ata u qetësuan disi, por menduan se: "Pas kurejshëve, me siguri do të vijë radha jonë." Për këtë arsye, ata vazhduan përgatitjet me më shumë përkushtim. Përveç kësaj, ata thanë: "Betohemi se myslimanët ende nuk janë përballur me një popull që di të luftojë mirë. Para se ata të na sulmojnë, le tu tregojmë ne atyre se çfarë është lufta!"

Nën komandën e prijësit të tyre, Malik bin Auf, ata nisën një ushtri të fuqishme prej njëzet mijë luftëtarësh. Për të rritur guximin e ushtarëve dhe për të mos i lejuar të tërhiqeshin nga frika, ata morën me vete të gjitha pasuritë e tyre, gratë dhe fëmijët. Ky lajm mbërriti shpejt në Mekkë. I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të), për të vërtetuar lajmin, dërgoi Abdullah bin Ebi Hadredin si lajmëtarë në mesin e Hevazinëve. Abdullah ndryshoi pamjen e tij dhe u infiltrua në fisin armik. Ai mësoi planet dhe strategjitë e tyre dhe menjëherë e informoi të dashurin tonë, Profetin Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të).

Pasi vërtetoi lajmin Profeti alejhi selam menjëherë thirri sahabët e tij dhe vendosi të veprojë shpejt. Ai e caktoi Attab bin Esidin, i cili ishte vetëm njëzet vjeç, si guvernator të Mekkës dhe u nis me ushtrinë e tij për të goditur Hevazinët dhe Sekifët në kampin e tyre. Ushtria myslimane përbëhej nga dymbëdhjetë mijë luftëtarë, ndërsa flamurin e mbante Aliu r.a..[301] Ndërkohë, komandanti i forcave pararojë ishte Halid bin Velidi.[302]

I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) kishte veshur helmetën dhe dy parzmore të njëpasnjëshme dhe po udhëtonte mbi mushkën e tij të quajtur Duldul. Më 11 të muajit Sheval, ushtria arriti në luginën e Hunejnit. Atë natë, Profeti a.s. inspektoi ushtrinë dhe e rreshtoi në formacion lufte. Pas faljes së namazit të sabahut, ai dha urdhrin për sulm.

Nga ana tjetër, komandanti i armikut kishte fshehur ushtrinë e tij në dy anët e luginës, duke përgatitur një pritë të papritur për myslimanët. Halid bin Velidi, i cili po udhëhiqte forcat pararojë, nuk ishte në dijeni të kësaj prite dhe vazhdoi të ecte përpara. Errësira e mëngjesit e vështirësonte shikimin e armikut. Papritmas, mijëra shigjeta filluan të bien mbi myslimanët. Ky sulm i papritur i befasoi dhe i detyroi myslimanët të tërhiqeshin mbrapsht.

Të gjithë të mbeten të mahnitur, qofshin të shenjtët apo profetët.
Me tmerr thërrasin të gjithë, duke thënë: "Nafsi im!"

Gjendja e mëkatarëve bëhet plot dëshpërim e rrëmujë.
Me lejen e ndërmjetësimit, prapë fusha është e jotja.

Ti je Ahmed, Mahmud dhe Muhamed, o imzot!
Nga Zoti je për ne sulltani i përkrahur, o imzot!

Shejh Galibi

[301] İbni Sa'd, Tabakât, IV, 357; Suheylî, Ravd-ul-unf, IV, 204.
[302] Ahmed bin Hanbel, Musned, IV, 350; İbni Hishâm, Sîret, II, 428; Vâkıdî, Megâdhî, II, 912; Suheylî, Ravdu'l-unf, IV, 195.

BETEJA E HUNEJNIT



"O Abbas! Thirri ata: 'O Medinas! O ju që i dhatë besën Profetit nën pemën Semure!"
Hadith

Kjo tërheqje e shpejtë e Halidit shkaktoi çrregullim në radhët e ushtrisë myslimane. Kur ushtarët në prapavijë u kthyen për tërheqje, u pa se njëzet mijë luftëtarë armikë po derdheshin në luginë si një lumë i tërbuar. I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) u hodh përpara, i vetëm, drejt sulmit të idhujtarëve. Vetëm Abbasi, Ebu Bekri dhe rreth njëqind sahabë trima (radijallahu anhum), të gatshëm të vdisnin për kauzën, menjëherë arritën pranë tij. Ata e mbrojtën atë me trupat e tyre, duke u bërë mburojë për të.

Abbasi i mbante frerët e mushkës së Profetit a.s., ndërsa Sufjan bin Harithi mbante shalën për ta penguar të hynte mes radhëve të armikut. I Dërguari i Allahut, i brengosur për fatin e Islamit, i tha Abbasit: **"O Abbas! Thirri ata: 'O Medinas! O ju që i dhatë besën Profetit nën pemën Semure!' "**Abbasi ishte një burrë i fuqishëm dhe kishte një zë të fortë që jehonte larg. Ai me gjithë fuqinë e tij, thirri: "O Medinas! O ju që i dhatë besën Profetit nën pemën Semure, mos u shpërndani! Mblidhuni këtu!" Kur sahabët dëgjuan këtë thirrje, deshën të ktheheshin, por frika e kafshëve të tyre ua vështirësonte kthimin. Më në fund, ata hodhën armaturat e tyre, u hodhën nga kafshët dhe me shpejtësi u bashkuan me të Dërguarin e Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të). Ata u përplasën ashpër me armikun dhe beteja u ndez.

Thirrjet e tyre **"Allahu Ekber! Allahu Ekber!"** tronditën tokën dhe frikësuan armikun. Sahabët, të cilët kishin treguar guxim të madh në Bedër, Uhud, Hendek dhe Hajber, si Aliu, Ebu Duxhane dhe Zubejr bin Avami (radijallahu anhum), luftuan me vendosmëri, duke i zmbrapsur radhët armike. Ndërsa I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) e ndiqte nga afër luftën e sahabëve të tij dhe nga buzët e tij dëgjoheshin lutjet: **"O Allah, zbrit ndihmën Tënde! Ti nuk dëshiron që ata të na mposhtin!"** Në mes të lutjeve, ai mori një grusht rërë nga toka dhe e hodhi mbi armikun, duke thënë: **"Fytyrat e tyre u nxifshin!"** Si një mrekulli e tij, pluhuri mbushi sytë e çdo armiku në fushëbetejë. Në të njëjtën kohë, engjëjt erdhën në ndihmë. Profeti (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) tha: **"Betohem në Allahun se ata tashmë janë thyer!"**

Idhujtarët u demoralizuan dhe nisën të largoheshin me shpejtësi nga fushëbeteja. Ndërkohë që ata iknin nga pas kishin sahabët që ishin duke ndjekur nga pas. Ata, duke u arratisur në drejtime të ndryshme, lanë pas gratë, fëmijët dhe pasuritë e tyre. Disa u strehuan në kështjellën e Taifit, ndërsa të tjerë ikën drejt Nahles dhe Evtasit. Në fushëbetejë mbetën të vrarë shtatëdhjetë armikë, gjashtë mijë të zënë rob dhe një pasuri e pallogaritshme.[303]

Në këtë betejë, me lejen e Allahut të Madhëruar, me ndihmën dhe bekimin e të Dërguarit të Tij (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të), fitorja përsëri i takoi myslimanëve. Ata humbën katër dëshmorë, ndërsa disa sahabë u plagosën. Dhe kur i Dërguari i Allahut dëgjoi se edhe Halid bin Velidi ishte plagosur, ai shkoi tek ai dhe i preku plagën me duart e tij të bekuara dhe u lut për shërimin e tij.

Ekspedita e Evtasit

Pasi idhujtarët e fisit Hevadhin u shpartalluan në betejën e Huneinit, ata u mblodhën në Evtas. I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) dërgoi një njësi ushtarake nën komandën e Ebu Amirit, xhaxhait të Ebu Musa el-

[303] İbni İshâk, İbni Hishâm, IV, 95; Vâkıdî, III, 914; İbni Sa'd, Tabakât, I, 151.

Eshariut. Në Evtas ndodhi një përleshje e ashpër dhe Ebu Amiri ra dëshmor. Pas tij, komandën e mori Ebu Musa el-Eshariu, i cili arriti ta thyente armikun.[304]

"Dashuria për atdheun është nga imani."
Hadith

Myslimanët prej kësaj beteje u kthyen triumfatorë dhe me shumë robër dhe plaçkë lufte. Ndër robërit ishte edhe Shejmaja, motra e qumështit e të Dërguarit të Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të). Ajo tha: **"Unë jam motra e qumështit e Profetit tuaj."** Sahabët nuk i besuan dhe e çuan atë para të Dërguarit të Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të). Shejmaja tregoi në detaje shumë kujtime nga fëmijëria e tyre. I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) e shtriu mantelin e tij në tokë dhe e uli motrën e tij të qumështit mbi të. Më pas u ul edhe vetë dhe qau shumë.[305] Ai e pyeti për nënën e tyre të qumështit, Halimen, dhe për babanë e saj. Shejmaja iu përgjigj se ata kishin ndërruar jetë prej shumë kohësh. E ndikuar nga respekti dhe nderimi që i tregoi Profeti (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të), Shejmaja pranoi Islamin.[306] I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) i tha: **"Nëse dëshiron, mund të qëndrosh me ne dhe do të të shërbehet siç duhet.[307] Por nëse dëshiron, të kthejmë në vendlindjen tënde."** Shejmaja zgjodhi të kthehej, duke u bazuar në fjalën e Profetit: **"Dashuria për atdheun është nga imani."** I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) e përcolli atë me dhurata duke i dhuruar: një ndihmëse, tre shërbëtorë dhe një numër të madh devesh e delesh.

Beteja e Taifit

Pas fitores në Hunein, i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) vendosi të vazhdonte ndjekjen e armikut dhe të thyente përfundimisht rezistencën e tyre. Një pjesë e idhujtarëve, nën udhëheqjen e Malik bin Aufit, ishte strehuar në Taif.[308] Ky qytet, që ndodhej pranë Mekkës, ishte një nga bastionet më të forta të idhujtarisë.

I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të), për ti ftuar banorët e tij në Islam, kishte shkuar në Taif edhe para emigrimit në Medina. Megjithatë, ata jo vetëm që e kishin refuzuar, por edhe e kishin keqtrajtuar rëndë, aq sa këmbët e tij ishin mbuluar me gjak. Ai dhe Zejd bin Harithei, prej banorëve te taifit, kishin përjetuar ditët më të vështira dhe më të dhimbshme të jetës së tyre.

Në muajin Sheval të vitit të tetë hixhri, pas fitores në Hunein, i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) vendosi plaçkën e luftës në Xhirane dhe u nis drejt Taifit. Ai dërgoi përpara Halid bin Velidin me një njësi ushtarake, ndërsa vetë arriti me sahabët pas tij. Banorët e fisit Sakif, që ishin mbyllur në kështjellën e tyre të fortifikuar, kishin depozituar më parë rezerva të mëdha ushqimore. Kur panë se myslimanët po afroheshin, ata mbyllën portat dhe kaluan në mbrojtje. Nga muret e kështjellës, ata sulmonin myslimanët me shigjeta, ndërsa nuk guxonin të dilnin jashtë për të luftuar ballë për ballë. Lufta vazhdoi në këtë mënyrë për një kohë të gjatë.

[304] Vâkıdî, Megâdhî, II, 925.
[305] İbni İshâk, İbni Hishâm, Sîre, IV, 101; Vâkıdî, Megâdhî, III, 913.
[306] Vâkıdî, III, 913; İbni Hacer, IV, 344.
[307] İbni İshâk, İbni Hishâm, Sîre, IV, 101; Vâkıdî, Megâdhî, III, 913.
[308] İbni Sa'd, Tabakât, II, 158; İbni Seyyidinnâs, Uyûn-ul-eser, II, 200.

Rrethimi i Taifit

Disa nga sahabët sugjeruan që të përdornin katapulta për të sulmuar kalanë. I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) e pa këtë të përshtatshme dhe urdhëroi ndërtimin e tyre. Myslimanët vazhduan rrethimin duke hedhur gurë me katapulta dhe duke luftuar me të gjithë forcën e tyre për të çliruar kalanë. Megjithatë, forca dhe qëndrueshmëria e saj e bënte fitoren të vështirë. Gjatë rrethimit, dymbëdhjetë sahabë ranë dëshmorë.[309]

Ndërkohë, Ebu Sufjani luftoi me trimëri, por humbi njërin sy. I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) e pyeti: **"O Ebu Sufjan! Çfarë dëshiron? Nëse do, do të lutem që syri yt të kthehet në vend, ose nëse dëshiron, Allahu do të të japë një sy në Xhenet."** Ebu Sufjani u përgjigj: **"O i Dërguari i Allahut** (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të)**! Unë zgjedh syrin në Xhenet."**[310] Në natën e njëzetë të rrethimit, i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) pa në ëndërr një enë të mbushur me gjalp që u përmbys nga një gjel dhe u derdh në tokë. Ai e interpretoi këtë si shenjë se Taifi nuk do të pushtohej atë vit dhe vendosi të ndërpresë rrethimin.

Mëshira e Profetit për banorët e Taifit

Të Dërguarit të Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) i ishte ofruar më parë mundësia për të shkatërruar banorët e Taifit, pasi ata e kishin keqtrajtuar rëndë vite më parë. Një engjëll i tha: **"Nëse dëshiron, do t'i rrëzoj malet mbi ta."** Por i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) u përgjigj: **"Unë jam dërguar si mëshirë për të gjithë botët. Shpresa ime e vetme është që Allahu xh.sh. të nxjerrë nga këta idhujtarë një brez që do ta adhurojë Atë pa i shoqëruar asgjë."** Edhe tani, pas luftës, ai u lut: **"O Allah! Udhëzoje fisin Sakiif dhe bëji ata të vijnë tek ne."**

Pasi u kthye nga Taifi, i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) mbërriti në Xhirane, ku ishin mbledhur të gjitha plaçkat e luftës dhe robërit e Huneinit. Myslimanët kishin kapur gjashtë mijë robër, mbi njëzet mijë deve dhe mbi dyzet mijë dele, si dhe një sasi të madhe stolisjesh. Në atë kohë, një delegacion nga fisi Hevadhin kërkoi të takohej me të. Kur u pranuan në audiencë, ata njoftuan se i gjithë fisi kishte pranuar Islamin. I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) u gëzua shumë dhe menjëherë liroi robërit që i përkisnin atij. Sahabët, duke e ndjekur shembullin e tij, bënë të njëjtën gjë. Në këtë mënyrë, falë mëshirës së Profetit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të), gjashtë mijë njerëz u liruan dhe u kthyen në vendin e tyre.

Ky lajm arriti te kreu i fisit Hevadhin, Malik bin Auf, i cili ishte strehuar në Taif. Ai erdhi dhe u bë mysliman, dhe i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) e mbuloi me dhurata dhe mirësira.[311] Tani nuk kishte më punë për tu kryer atje. I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) qëndroi në atë vend për trembëdhjetë ditë dhe më pas, një natë të mërkure, u fut në gjendjen e ihramit me nijetin për të kryer umren. Ashtu si gjithmonë, Profeti alejhi selam mbërriti në Mekkë i triumfueshëm, së bashku me shokët e tij. Ai e rrethoi Qaben e Shenjtë dhe kreu umren e tij. Më pas, e emëroi Attab bin Esidin si guvernator

[309] Belâdhurî, Futuhu'l-buldân, I, 66; Kastalânî, Mevâhib-i leduniyye, I, 215.
[310] İbni Asâkir, Târîh,-i Dımeshk, VI, 408; İbni Hacer, el-İsâbe, II, 179.
[311] İbni Hishâm, Sîret, II, 452; Vâkıdî, Megâdhî, III, 925; İbni Sa'd, Tabakât, I, 312; DHehebî, Siyer, II, 207.

Rajonet ku u Dërguan Përgjegjësit e Zekatit

Një ditë, teksa u fundosja në detin e trishtimit, u thellova në mendime.
E humba veten nga njerëzit, rashë në gjendje të pavetëdijshme.
Kur kujtova mëkatet e mia, u frikësova për fundin tim.
Atëherë dëgjova një të devotshëm që recitonte këto vargje:

Ti je Ahmed, ti je Mahmud, ti je Muhamed, o i dashuri ynë!
Nga Allahu je për ne një sundimtar i fuqishëm dhe i bekuar!

Ne jemi plot shpresë, nuk biem në dëshpërim.
Kurrë nuk e humbasim pasurinë tonë më të madhe – besimin.
Nuk braktisim derën tënde për të kërkuar strehë tek të huajt.
Nën hijen tënde, askënd tjetër nuk kërkojmë.

Ti je Ahmed, ti je Mahmud, ti je Muhamed, o i dashuri ynë!
Nga Allahu je për ne një sundimtar i fuqishëm dhe i bekuar!

Shejh Galibi

të Mekkës dhe e ngarkoi gjithashtu me detyrën e udhëheqësit të haxhit.[312] Ndërsa Ebu Musa el-Eshari u caktua për të mësuar Kur'anin dhe çështjet fetare në Mekkë. Ebu Sufjan bin Harb u emërua guvernator i Nexhranit në Jemen, ndërsa Kethir bin Abdullah u caktua si ndihmës i tij.[313]

"Kudo që të jeni, jini të devotshëm. Edhe nëse nuk bëni hixhret, nuk do t'ju dëmtojë. Feja dhe kombi juaj nuk do të pësojnë asnjë të keqe."
Hadith

Pasi u përfunduan punët në Mekkë, ata u drejtuan për në Merrudh-Dhahran, ku u ndanë plaçkat e mbetura të luftës. Më pas, i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) dhe shokët e tij u nisën përsëri dhe arritën në Medinë në fund të muajit Dhul-Kade. Ata ishin nisur nga Medina në ditën e dhjetë të Ramazanit, ditë e mërkurë, dhe ky udhëtim i gjithi zgjati rreth tre muaj.

Ngjarje të tjera që ndodhën në vitin e tetë të hixhretit

Katër burra nga fisi Benu Thalebe erdhën në kuvendin e të Dërguarit të Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) dhe thanë: "Fisi ynë na ka dërguar te ti. Kemi dëgjuar se pa bërë hixhretin, Islami nuk është i plotë." I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) u përgjigj: "**Kudo që të jeni, jini të devotshëm dhe nuk ka rëndësi nëse nuk bëni hixhret. Feja dhe kombi juaj nuk do të pësojnë ndonjë dëm."** Më pas, ai i dërgoi në shtëpinë e Remle bint Harithit dhe u dha një gosti. Përveç kësaj, secilit prej tyre u dha katër okë argjend dhe i lejoi të ktheheshin në shtëpitë e tyre.

Në po atë vit, vajza e të Dërguarit të Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të), Zejnebi, ndërroi jetë. Për të u ndërtua një arkivol, duke qenë kështu personi i parë në Islam për të cilin u përdor një arkivol. Ajo ishte e martuar me Ebul Asin. Kur ajo po largohej nga Mekkeja për në Medinë gjatë kohës së betejës së Bedrit, një njeri i quajtur Hebar i hodhi një shtizë devesë së saj. Ajo ra dhe humbi fëmijën e saj, gjë që e sëmuri dhe çoi në vdekjen e saj. Pas saj mbetën dy fëmijë.

Në muajin Dhul-Hixhxhe të atij viti, lindi i biri i të Dërguarit të Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të), Ibrahimi. Nëna e tij ishte zonja Mari (radijallahu anha). Ebu Rafi e solli lajmin e mirë dhe, si shenjë gëzimi, Profeti çliroi një skllav. Për akiken (ritin e lindjes), ai theri një dash, i rroi flokët e foshnjës dhe dha sadaka me peshën e tyre në argjend. Më pas, flokët e tij u varrosën.

Ngjarje të rëndësishme që ndodhën në vitin e nëntë hixhri

Në fillim të muajit Muharrem të vitit të nëntë hixhri, i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) caktoi mbledhësit e zekatit (amilët, saijtë) për fiset e ndryshme. Për sa ishte e mundur, ai caktoi një person nga vetë fisi për të mbledhur zekatin ai dërgoi:

- Ibn Hasib el-Eslemi te fiset Eslem dhe Gaffar,
- Abbad bin Bishr te fiset Benu Selim dhe Muzeine,
- Amr bin As te fisi Fedhare,
- Dahhak bin Sinan te fisi Benu Kilab,
- Rafi bin Meknet el-Xhehni te fisi Xhehine,

[312] İbni Mâce, Ticarât, 20; İbni Hishâm, Sîret, II, 440; Hâkim, Mustedrek, III, 687; Beyhekî, Sunen, I, 498; II, 264; Vâkıdî, Megâdhî, I, 890, 960; İbni Sa'd, Tabakât, II, 137; Edhraki, Ahbâru Mekke, I, 232.
[313] Vâkıdî, Megâdhî, III, 959; İbni Sa'd, Tabakât, II, 137.

- Bishr bin Sufjan Ka'b te fiset Benu Ka'b dhe Benu Temim.
- Banorët e Taifit Pranojnë Islamin

Një vit më vonë, banorët e Taifit dërguan një delegacion prej gjashtë personash në Medinë për t'u takuar me të Dërguarin e Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) dhe për të pranuar Islamin. Një vit më parë, kur Profeti alejhi selam u largua nga Taifi, ai ishte lutur: **"O Zoti im! Udhëzoji banorët e fisit Sakeef dhe sill-i ata tek ne."** Dhe tani ata kishin ardhur për të pranuar fenë islame. I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) u gëzua shumë për këtë dhe u dha atyre disa privilegje, pastaj i dërgoi përsëri në Taif. Ai caktoi Osman bin Ebil-Asin si guvernator të tyre.[314]

Vdekja e Nexhashiut

Në muajin Rexheb të vitit të nëntë hixhri, një ditë, i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) u tha shokëve të tij: **"Sot ka ndërruar jetë një vëlla i drejtë. Ngrihuni dhe falni namazin e tij."** Profeti alejhi selam u bë imam dhe fali namazin e xhenazes në mungesë për Nexhashiun, mbretin e Abisinisë, i cili kishte pranuar Islamin dhe kishte mbrojtur myslimanët e parë që emigruan në vendin e tij.

Disa kohë më vonë, nga Abisinia erdhi lajmi se Nexhashiu Eshame (rahmetullahi alejhi) kishte ndërruar jetë, dhe dita e vdekjes së tij përkonte me atë kur i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) e kishte falur namazin e tij të xhenazes në Medinë.[315]

Jetoj i flijuar për ty, në rrugën tënde,
Emri yt është i bukur, vetë ti i bukur, Muhammed,
O Zot, bëj që të më ndihmosh, më mbështet,
Emri yt është i bukur, vetë ti i bukur, Muhammed.

Dhembjet e besimtarëve janë shumë,
Në botën tjetër do të gjejnë kënaqësi dhe shijim,
Mustafa, i cili është i dërguar për të gjithë botët,
Emri yt është i bukur, vetë ti i bukur, Muhammed.

Ai që ka udhëtuar nëpër shtatë shtresa qiellore,
Ai që është ngjitur mbi Arsh,
Ai që ka lutur për ummetin e tij në Miraxh,
Emri yt është i bukur, vetë ti i bukur, Muhammed.

Çfarë mund të bëjë JunusJi për të dy botët pa ty?
Ti je i Dërguari i vërtetë, pa dyshim dhe pa mëdyshje,
Ata që nuk të ndjekin, do të shkojnë pa besim,
Emri yt është i bukur, vetë ti i bukur, Muhammed.

[314] Ebû Dâvûd, Salât, 12; İbni Mâce, Mesâcid, 3; Ahmed bin Hanbel, Musned, IV, 21; İbni Hishâm, Sîret, II, 541; İbni Sa'd, Tabakât, V, 509.
[315] Buhariu, Cenâidh, 52; Nesâî, Cenâidh, 37; İbni Ebî SHeybe, Musannef, III, 183; SHemseddin SHâmî, Subulu'l Hudâ, III, 92.

EKSPEDITA E TEBUKUT

"O Omer! Dallimi mes teje dhe Ebu Bekrit është si dallimi mes fjalëve tuaja."
Hadith

Tebuku është një vend i njohur midis Medinës dhe qytetit të Shamit. Disa thonë se është emri i një burimi uji. Kjo ekspeditë njihet si **Lufta e Tebukut**, pasi ishte ekspedita e fundit e Profetit Muhamed (s.a.s.). Gjithashtu quhet **Fâdıha**, sepse në këtë luftë hipokritët u poshtëruan. Emri tjetër është **Xheish-ul-ushret**, për shkak të vështirësive të mëdha që përjetuan muslimanët gjatë këtij udhëtimi. Ekspedita ndodhi në muajin Rexheb të vitit të nëntë hixhri, gjatë një periudhe të vështirë ku muslimanët po përballeshin me vapë të madhe dhe mungesë ushqimi. Distanca e madhe dhe fuqia e ushtrisë armike e bënin situatën edhe më të vështirë. Për shkak të varfërisë dhe mungesës së furnizimeve, ndodhte që dhjetë burra të ndanin një deve për udhëtim.

Ushtria muslimane kaloi një muaj duke konsumuar vetëm hurma, ndonjëherë edhe elb të pjekur, e ndonjëherë nuk gjenin as atë. Në atë kohë, Islami po përhapej me shpejtësi në Gadishullin Arabik. Arabët e krishterë i shkruan një letër perandorit bizantin Herakliut, duke e informuar se Profeti Muhamed (s.a.s.) kishte vdekur dhe se muslimanët ndodheshin në varfëri e vështirësi. Ata e inkurajuan të vepronte kundër tyre, duke e bindur se ishte momenti i duhur për t'i kthyer muslimanët në fenë e tij. Pas kësaj letre, Herakliu mobilizoi një ushtri prej 40,000 ushtarësh nën komandën e Kubadit për të luftuar kundër muslimanëve. Kur Profeti Muhamed (s.a.s.) mori vesh për këtë rrezik, ai mblodhi shokët e tij dhe i urdhëroi të përgatiteshin për luftë.

Por atë kohë për shkak të thatësirës, muslimanët përjetuan një krizë ekonomike dhe vetëm tregtarët kishin një gjendje pak më të mirë financiare. Edhe pse ushtria islame ishte e madhe, kishte shumë pak ushqim dhe pajisje luftarake. Profeti Muhamed (s.a.s.) i nxiti shokët e tij të ndihmonin financiarisht për pajisjen e ushtrisë. Kjo thirrje mobilizoi sahabët, të cilët dhanë gjithçka që kishin për hir të Islamit. Ebu Bekri r.a. solli gjithë pasurinë e tij. Kur Profeti alejhi aelam e pyeti se çfarë kishte lënë për familjen e tij, ai u përgjigj: **"Allahun dhe të Dërguarin e Tij."** Omeri r.a. solli gjysmën e pasurisë së tij dhe, kur u pyet nga Profeti (s.a.s.) për pjesën e mbetur për familjen, u përgjigj: **"Sa kam sjellë, po aq kam lënë."** Atëherë Profeti (s.a.s.) tha: **"Dallimi mes jush është si dallimi mes fjalëve tuaja."** I prekur nga kjo, Omeri pranoi se nuk do të mund ta tejkalonte kurrë Ebu Bekrin në veprat e mira.[316]

Sahabët u përpoqën të ndihmonin sa më shumë që mundnin, por hipokritët talleshin me ta, duke thënë: **"Ju e bëni këtë vetëm për sy e faqe."** Profeti Muhamed (s.a.s.) tha: **"Kush jep një sadaka sot, ajo do të dëshmojë për të në Ditën e Kiametit."** Pas këtyre fjalëve, besimtarët u motivuan edhe më shumë për të ndihmuar. Osman bin Affan r.a. dha një ndihmë të jashtëzakonshme, duke pajisur gjysmën e ushtrisë me 950 deve, 50 kuaj dhe pajisjet e tyre, si dhe duke dhuruar 10,000 dinarë ose 700 monedha ari.[317] Ai kujdesi edhe për detajet më të vogla, madje edhe për gjilpërat që do të përdoreshin për të riparuar qeset e ujit.[318] Për këtë bamirësi të madhe, Profeti Muhamed (s.a.s.) tha: **"Nga sot e tutje, asnjë mëkat nuk do t'i shkruhet Osmanit."** [319]

Një sahab i varfër, që nuk kishte pasuri për të dhënë, kaloi gjithë natën duke punuar në një kopsht hurmash për të fituar diçka. Ai ia solli hurmat e fituara Profetit

[316] Vâkıdî, Megâdhî, II, 990; İbni Asâkir, Tarih-i Dımeshk, II, 34.
[317] Sunen-i Dârekutnî, IV, 198.
[318] Cevâb Veremedi, 89.
[319] Vâkıdî, Megâdhî, II, 990.

(s.a.s.) dhe i tha: "O i Dërguari i Allahut! E kam sjellë këtë për hir të Allahut. Pranoje, të lutem!" Kjo tregoi se ndihma nuk matej me sasinë, por me sinqeritetin e dhënies.

"Kush jep një sadaka sot, ajo do të dëshmojë për të në Ditën e Kiametit."
Hadith

Gratë muslimane, gjithashtu bënë pjesën e tyre, duke dhuruar çfarë kishin, për të ndihmuar përgatitjet për ekspeditën. Në atë kohë, situata ishte shumë e vështirë. Për shkak të urisë dhe varfërisë, shumë sahabë erdhën tek Profeti (s.a.s.) dhe thanë: "O i Dërguari i Allahut! Nuk kemi as kafshë për të hipur e as ushqim. Nuk duam të mbetemi pas, por nuk kemi mundësi të shkojmë." Profeti (s.a.s.), i prekur thellë, iu përgjigj: **"Nuk kam asgjë për t'ju dhënë."** Disa prej tyre u larguan me lot në sy nga dhimbja se nuk mund të merrnin pjesë në këtë luftë. Për këtë arsye, Allahu shpalli një ajet ku tha: *"***Ata që vijnë tek ti për të marrë një mjet udhëtimi dhe ti nuk ke çfarë t'u japësh, kthehen me sytë e mbushur me lot nga mërzia që nuk mund të marrin pjesë."**[320]** Më pas, Abbasi dhe Osmani morën përsipër të ndihmonin këta sahabë, duke u siguruar mjete për të marrë pjesë në ekspeditë. Dhe kur gjithçka ishte gati, Profeti Muhamed (s.a.s.) mblodhi ushtrinë në **Senijet-ul-Veda,** la Muhamed bin Meslemen si zëvendës të tij në Medinë[321] dhe, përpara nisjes, u këshilloi ushtarëve: **"Merrni me vete më shumë këpucë. Për sa kohë që keni këpucë të tepërta, nuk do të keni vështirësi."**

Tashmë ushtria muslimane u nis, Abdullah bin Ubej, kreu i hipokritëve, u përpoq t'i frikësonte muslimanët me fjalë të pavërteta. Ai madje tha: "Betohem se po i shoh ata të lidhur me litarë dy nga dy!" Por sahabët nuk i dhanë rëndësi këtyre fjalëve dhe dëshira e tyre për të marrë pjesë në luftë u shtua edhe më shumë, gjë që e zemëroi akoma më shumë grupin e hipokritëve. Para nisjes nga Senijet-ul-Veda, Profeti Muhamed (s.a.s.) dha urdhër që flamujt e ushtrisë të ngriheshin. Flamuri kryesor iu dorëzua Hazreti Ebu Bekrit. Një flamur tjetër iu dha Zubejr bin Avamit. Evsitët e morën flamurin nga Usejd bin Hudajr, ndërsa Hazrexhitët nga Ebu Duxhane.[322] Ushtria muslimane përbëhej nga 30,000 luftëtarë, ku 10,000 ishin kalorës. Krahun e djathtë e komandonte Talha bin Ubejdullah. Krahun e majtë e drejtonte Abdurrahman bin Auf.[323]

Ushtria muslimane marshonte në një vapë përvëluese. Mungesa e ushqimit dhe ujit nuk i ndaloi ata, pasi kishin për udhëheqës të Dërguarin e Allahut (s.a.s.). Pas çdo ndalese, ata vazhdonin rrugën me vendosmëri. Kur mbërritën në Hixhr, vendi ku populli i Salihut (a.s.) u shkatërrua për shkak të mosbindjes së tyre ndaj Allahut, Profeti Muhamed (s.a.s.) paralajmëroi: **"Këtu ka zbritur dënimi i Allahut. Sonte do të fryjë një stuhi e fortë nga drejtimi i kundërt. Askush të mos qëndrojë vetëm. Lidhni devetë dhe mos pini nga ky ujë."**

Ashtu siç paralajmëroi Profeti (s.a.s.), natën shpërtheu një stuhi e fortë. Një burrë që nuk e kishte lidhur devenë u ngrit për ta kërkuar atë, por u mor nga stuhia dhe u hodh në shpatet e malit Taj. Një tjetër, që shkoi për nevojë personale, u prek nga hunaki (boçkolla, një sëmundje e fytit), por u shërua me lutjen e Profetit (s.a.s.). Në mëngjes, sahabët panë se uji kishte mbaruar. Të lodhur dhe të etur, ata filluan të ndjenin dobësi. Hipokritët e shfrytëzuan këtë moment për të thënë: "Nëse Muhamedi (a.s.)do të ishte me të vërtetë profet, do të lutej dhe do të binte shi!"Kur iu paraqit

[320] Tevbe: 9/92.
[321] İbni Hishâm, Sîret, II, 519; Vâkıdî, Megâdhî, I, 8; Beyhekî, Delâil-un-nubuvve, V, 294; İbni Kesîr, Sire, IV, 12; Suheylî, Rav-du'l-unf, IV, 297; Hudhâî, et-Tahrîc, 327; Kettânî, et-Terâtîbu'l-idâriyye, I, 485.
[322] Vâkıdî, Megâdhî, II, 996; İbni Asâkir, Tarih-i Dımeshk, II, 36; SHemseddin SHâmî, Subu-lu'l-Hudâ, V, 443.
[323] Vâkıdî, Megâdhî, II, 1001; İbni Asâkir, Tarih-i Dımeshk, II, 36.

Lutfa e Tebukut



Muhammedit a.s. ky pretendim i hipokritëve, ai ngriti duart e tij të bekuara dhe iu lut Allahut të Lartësuar që tu dhuronte shi.

"Nesër, nëse dëshiron Allahu, në kohën e duhasë do të arrini te burimi i Tebukut. Derisa të vij unë, mos e prekni atë ujë."
Hadith

Në një ditë të nxehtë dhe pa re, papritmas u shfaqën re të errëta dhe një shi i furishëm filloi të binte. Të gjithë mbushën enët me ujë, morën abdes dhe i ujitën kafshët e tyre. Kur shiu pushoi dhe retë u shpërndanë, u pa qartë se shiu kishte rënë vetëm mbi ushtrinë muslimane. I dashuri i Allahut dhe sahabët e tij thirrën tekbir dhe e falënderuan Allahun. Pasi u vu në dukje kjo mrekulli pejgamberane, hipokritëve iu tha: **"Tani nuk keni më asnjë justifikim. Besoni në Allahun dhe në të Dërguarin e Tij dhe bëhuni muslimanë të mirë!"** Por hipokritët, të paskrupullt, u përgjigjën: "Çfarë ndodhi?! Një re kaloi dhe ra shi, kaq!" Uria kishte arritur kulmin.

Sahabët ndanin një hurmë mes dy vetash. Pavarësisht nxehtësisë së madhe, urisë dhe etjes, ata vazhduan rrugën dhe iu afruan Tebukut. I Dërguari i Allahut (s.a.s.) tha: **"Nesër, në kohën e paradites, me lejen e Allahut, do të arrini te burimi i Tebukut. Deri sa të arrij unë, mos e prekni atë ujë."** Kur arritën atje, uji ishte shumë i pakët. I Dërguari i Allahut (s.a.s.) urdhëroi që t'i sillnin pak ujë, e vuri dorën e tij të bekuar në të dhe u lut. Më pas e hodhi ujin në burim, i cili papritmas shpërtheu me bollëk. Ushtria e tërë e muslimanëve, e përbërë nga tridhjetë mijë veta, piu ujë pa kufizim, dhe ai nuk u pakësua. Më vonë, ky vend u bë një tokë e gjelbëruar dhe e begatë, një mrekulli e të Dërguarit të Allahut (s.a.s.).

Kur muslimanët arritën në Tebuk, nuk e gjetën ushtrinë bizantine dhe fiset arabe të krishterizuara, si Lahm, Xhuzam dhe Amile. Në betejën e Mutës, tre mijë muslimanë kishin mundur një ushtri romake prej njëqind mijë vetash. Tani, përballë tyre ishin tridhjetë mijë luftëtarë të udhëhequr nga i Dërguari i Allahut (s.a.s.). Romakët sapo kishin dëgjuar për ardhjen e ushtrisë muslimane, ata u tërhoqën dhe u shpërndanë. Disa fise të atij rajoni, të frikësuar nga forca e muslimanëve, dërguan delegacione për të kërkuar mbrojtje dhe pranuan të paguanin xhizjen. I Dërguari i Allahut (s.a.s.) i pranoi kërkesat e tyre dhe u siguroi atyre mbrojtje.

I Dërguari i Allahut (s.a.s.) qëndroi në Tebuk për gati njëzet ditë, duke pritur armikun dhe duke i dhënë mësime sahabëve të tij. Në një nga këto mësime, ai tha: **"A doni t'ju tregoj kush është njeriu më i mirë?"** Sahabët u përgjigjën: "Na trego, o i Dërguari i Allahut!" Ai tha: **"Më i miri i njerëzve është ai që, mbi kalin, devenë ose në këmbë, vazhdon të luftojë në rrugën e Allahut deri në frymën e fundit. Njeriu më i keq është ai që lexon Librin e Allahut dhe nuk përfiton aspak prej tij."** Kur një person e pyeti për shpërblimin e dëshmorëve, ai u përgjigj: **"Pasha Allahun, në Ditën e Gjykimit, dëshmorët do të vijnë me shpatat e tyre të varura në qafë dhe do të ulen mbi minberë prej drite."**[324]

Në këtë ekspeditë, u shfaqën shumë mrekulli të të Dërguarit të Allahut (s.a.s.). Një ditë, kur ushtria ishte e lodhur dhe e uritur, sahabët iu ankuan të Dërguarit të Allahut (s.a.s.). Ai urdhëroi që të mblidheshin mbetjet e ushqimit të tyre mbi një rrobë. Sasia mezi mbushte një enë të vogël. Ai u lut, mori abdest dhe fali dy rekatë namaz. Pastaj tha: **"Sillni enët tuaja!"** Të gjithë sahabët mbushën enët e tyre dhe tërë ushtria u ushqye, por ushqimi nuk u pakësua aspak. Kështu përfundoi ekspedita e Tebukut, një nga fitoret më të mëdha të Islamit, pa derdhur asnjë pikë gjaku.

[324] Vâkıdî, Megâdhî, II, 1018.

Fushata e Hâlid bin Velîdit në Dûmet-ul-Xhendel

Ndërsa i Dërguari i Allahut (sallallahu alejhi ve selam) ndodhej në Tebuk, dërgoi Hâlid bin Velîdin (radijallahu anhu) drejt Dûmet-ul-Xhendelit. Mbreti i këtij vendi, Ekîdir bin Abdulmelik, ishte i krishterë. Ushtria islame u afrua pranë kështjellës dhe u fsheh në pritë. Në atë kohë, një dem i egër u shfaq pranë portës së kështjellës. Kur Ekîdiri e mori vesh këtë, hipi në kalë dhe u nis për ta ndjekur. Ai, bashkë me vëllanë e tij, Hassanin, dhe disa ndjekës të tij, dolën për gjueti. Në atë moment, muslimanët i rrethuan. Kur Hassani nxori shpatën, ata e vranë. Ekîdiri u kap rob, ndërsa të tjerët u arratisën dhe u strehuan brenda kështjellës.

Hâlid bin Velîdi i tha Ekîdirit: **"Do të të lëmë të lirë dhe do të të çojmë tek i Dërguari i Allahut** (sallallahu alejhi ve selam)**, por me një kusht: duhet të futesh në kështjellë dhe të dorëzosh dy mijë deve, tetëqind kuaj, tetëqind mburoja dhe katërqind shtiza. Kështu që ti do të mbetesh po mbret i vendit tënd."** Ekîdiri pranoi. Ai u kthye në kështjellë dhe solli pasurinë e kërkuar. Më pas, së bashku me muslimanët, ai udhëtoi për në Medinë, ku u pranua në prani të të Dërguarit të Allahut (sallallahu alejhi ve selam). Më pas Ekidiri dhe vëllai i tij, Hasari, e pranuan Islamin dhe u bënë muslimanë.

Kurthi i Munafikëve

Ndërsa ushtria islame po kthehej nga Tebuku për në Medinë, disa munafikë (hipokritë) u bashkuan dhe planifikuan ta vrisnin të Dërguarin e Allahut (sallallahu alejhi ve selam). Ata vendosën të ngrinin pritë në një kalim të ngushtë malor dhe ta sulmonin atje. Atë natë, deveja e Profetit (sallallahu alejhi ve selam) po udhëhiqej nga Ammâr bin Jâseri, ndërsa pas tij ishte Huzeife bin Jemâni. Xhibrili (alejhi selam) e informoi të Dërguarin e Allahut për këtë kurth. Kur Profeti (sallallahu alejhi ve selam) iu afrua grykës së ngushtë, ai urdhëroi ushtrinë: **"Ju vazhdoni përmes luginës, atje është më e gjerë dhe më e lehtë për ju."**

Ndërsa ushtria vazhdonte rrugën nëpër luginë, i Dërguari i Allahut (sallallahu alejhi ve selam) e drejtoi devenë drejt kalimit të ngushtë. Papritur, një grup munafikësh, të mbuluar me maska, u hodhën përpara për ta sulmuar. Por Huzeife bin Jemâni reagoi menjëherë dhe, duke i goditur ata dhe kuajt e tyre me një shkop, bërtiti: **"O armiq të Allahut!"** Të frikësuar nga kjo situatë, dymbëdhjetë munafikë u shpërndanë mes ushtarëve dhe u zhdukën në turmë.

I Dërguari i Allahut (sallallahu alejhi ve selam) i tregoi Huzeifes emrat e tyre, por i kërkoi të mos ia thoshte askujt. Kur Usêjd bin Hudairi e mësoi këtë ngjarje, ai i tha Profetit (sallallahu alejhi ve selam): **"O i Dërguari i Allahut! Më trego kush janë ata që të sjell kokat e tyre!"** Por i Dërguari i Allahut (sallallahu alejhi ve selam) nuk i dha leje që t'i ndëshkonte.[325]

Mesxhid-i Dirâr

Kur Profeti dhe shokët e tij iu afruan Medinës, disa munafikë i dolën përpara dhe e ftuan të Dërguarin e Allahut (sallallahu alejhi ve selam) që të vizitonte një xhami të re që ata kishin ndërtuar dhe kishinemërtuar Mescid-i Dirâr. Kjo xhami ndodhej në Kubâ, përballë xhamisë së parë që Profeti alejhi selam kishte ndërtuar pas hixhretit në Medinë. Gjatë nisjes për në Tebuk, munafikët e kishin ftuar të Dërguarin e Allahut (sallallahu alejhi ve selam) të vinte dhe të falte namaz në këtë xhami, por ai i kishte thënë se do ta vizitonte në kthim.

[325] Vâkıdî, Megâdhî, II, 1040.

"Pasha Allahun, në Ditën e Gjykimit, dëshmorët do të vijnë me shpatat e tyre të varura në qafë dhe do të ulen mbi minberë prej drite."
Hadith

Qëllimi i vërtetë i tyre nuk ishte ndërtimi i një xhamie për adhurim të sinqertë, por përçarja e muslimanëve, krijimi i një grupi të veçuar dhe përgatitja e një komploti kundër Islamit. Ata madje planifikonin të sillnin ushtarët bizantinë në Medinë dhe të përdornin këtë xhami si bazë për rebelimin e tyre. Teksa Profeti (sallallahu alejhi ve selam) po mendonte të pranonte ftesën e tyre, Allahu i Lartësuar shpalli vargjet 107-108 të sures Teube, ku e informoi për qëllimet e fshehta të munafikëve.

Menjëherë pas kësaj, i Dërguari i Allahut (sallallahu alejhi ve selam) urdhëroi Mâlik bin Duhshumin dhe Âsım bin Adîun: **"Shkoni te kjo xhami e ndërtuar nga të padrejtët dhe shkatërrojeni!"** Ata shkuan mes akshamit dhe jacisë, e dogjën dhe e rrafshuan xhaminë. Munafikët nuk mundën të bënin asnjë kundërshtim.[326]

Mirëpo kur banorët e Medinës dëgjuan se i Dërguari i Allahut (sallallahu alejhi ve selam) po kthehej, ata dolën me entuziazëm për ta pritur. Në këtë mënyrë, muslimanët u kthyen në qytetin e tyre, me moral të lartë dhe me një fitore të qartë ndaj armiqve të Islamit.

Vdekja e Abdullah bin Ubejit

Dy muaj pas kthimit nga ekspedita e Tebukut, në muajin Shevval, udhëheqësi i munafikëve (hipokritëve), Abdullah bin Ubei, ndërroi jetë. Pas vdekjes së tij, grupi i munafikëve u shpërbë dhe u shpërnda.[327]

Kështu, jo vetëm munafikët, por edhe idhujtarët edhe hebrenjtë që ishin kundër Islamit në Arabinë e atëhershme, u thyen përfundimisht dhe nuk patën më forcë për të kundërshtuar apo penguar përhapjen e fesë islame.

Ngjarjet e tjera të vitit të nëntë hixhri

Kur i Dërguari i Allahut (sallallahu alejhi ve selam) mbërriti në Tebuk, sunduesit e Ejles dhe Xherbasë i sollën atij xhizjen e tyre si shenjë nënshtrimi. I Dërguari i Allahut (sallallahu alejhi ve selam) u siguroi atyre një marrëveshje mbrojtjeje.

Gjatë kësaj ekspedite, ai i dërgoi një letër Herakliut (perandorit bizantin), duke e ftuar sërish në Islam, por atij nuk iu dha udhëzimi i Allahut për ta pranuar fenë e vërtetë.

Po këtë vit, vajza e të Dërguarit të Allahut, Ummu Kulthum, ndërroi jetë. Profeti (sallallahu alejhi ve selam) fali namazin e xhenazes dhe, ndërsa po e varrosnin, nga sytë e tij rridhnin lot.

Viti i Delegacioneve

Pas kthimit nga Tebuku, i Dërguari i Allahut (sallallahu alejhi ve selam) nisi të dërgonte delegatë dhe mësues në vende të ndryshme për t'i ftuar ata në Islam. Banorët e Omanit dhe Bahreinit e pranuan Islamin dhe u nderuan me këtë fe të drejtë.

